

KONFERENCA E PARË NDËRKOMBËTARE NË GJUHËSI
“Ligjërimi i shkruar dhe i folur, probleme reale dhe propozime konkrete për zgjidhjen e tyre”

Materialet e punimeve (proceedings)

ISBN: 978-1-78911-007-4



UNIVERSITETI “ALEKSANDËR MOISIU”, DURRËS
FAKULTETI I EDUKIMIT
DEPARTAMENTI I GJUHËS SHQIPE



KONFERENCA E PARË NDËRKOMBËTARE NË GJUHËSI

1st INTERNATIONAL CONFERENCE ON LINGUISTICS

“LIGJËRIMI I SHKRUAR DHE I FOLUR, PROBLEME
REALE DHE PROPOZIME KONKRETE PËR ZGJIDHJEN E
TYRE”

“WRITTEN AND SPOKEN LANGUAGE,
REAL & CONCRETE PROBLEM SOLVING PROPOSALS”

Materialet e punimeve (05 MAJ 2023)

PROCEEDINGS (MAY 05TH, 2023)

KONFERENCA E PARË NDËRKOMBËTARE NË GJUHËSI
“Ligjërimi i shkruar dhe i folur, probleme reale dhe propozime konkrete për zgjidhjen e tyre”

Materialet e punimeve (proceedings)

ISBN: 978-1-78911-007-4

**“LIGJËRIMI I SHKRUAR DHE I FOLUR, PROBLEME
REALE DHE PROPOZIME KONKRETE PER ZGJIDHJEN E
TYRE”**

*“WRITTEN AND SPOKEN LANGUAGE,
REAL & CONCRETE PROBLEM SOLVING PROPOSALS”*

ISBN: 978-1-78911-007-4

E drejta e botimit, ribotimit apo e përkthimit, i përket vetëm Departamentit të Gjuhës shqipe, pranë Fakultetit të Edukimit, UAMD, Durrës.

SHËNIM: autorët mbajnë përgjegjësi individuale për origjinalitetin e punimit si dhe për të dhënat e tyre personale.

BORDI SHKENCOR **Editorial Board**

Prof. dr. Kseanela Sotirofski (Kryetar, Head of the Editorial board)

Prof. dr. Emil Lafe

Prof. dr. Shezai Rrokaj

Prof. dr. Ledi Shamku Shkreli

Prof. dr. Dhimitri Bello

Prof. dr. Asllan Hamiti

Prof. dr. Teuta Arifi

Prof. as. dr. Klodiana Leka

Prof. dr. Ismet Osmani

Prof. dr. Ajten Hajdari

Prof. dr. Arbër Çeliku

Prof. dr. Sokol Pacukaj

Prof. dr. Naim Berisha

Prof. dr. Arta Toçi

Prof. dr. Lavdosh Ahmetaj

Prof. as. dr. Teuta Vinca Kafexholli

Prof. as. dr. Izer Maksuti

Prof. as. dr. Xhafer Beqiraj

Prof. as. dr. Shkelqim Millaku

Prof. as. dr. Flamur Shala

Prof. as.dr. Sejdi Gashi

Prof. as.dr. Abdurrahim Maxhuni

Prof. as. dr. Brunilda Dashi

Prof. as. dr. Faton Krasniqi

Prof. as. dr. Kledi Satka

Prof. as. dr. Mimoza Zekaj

Dr. Zamira Shkreli

Dr. Mimoza Hysa

Prof. as. dr. Edlira Abdurahmani

Prof. as. dr. Suela Kastrati

Doc. dr. Aida Kurani

Dr. Manola Myrta

Prof. as. dr. Helena Grillo Mukli

Dr. Greta Jani

Dr. Manjola Zaçellari

Dr. Natasha Poroçani

Dr. Rovena (Vata) Mikeli

BORDI ORGANIZUES **Organizing committee**

Prof. as. dr. Edlira Abdurahmani (Kryetar, Head of the Organizing Committee)

Prof. as. dr. Suela Kastrati

Doc. dr. Aida Kurani

Dr. Manola Myrta

Prof. as. dr. Helena Grillo Mukli

Dr. Greta Jani

Dr. Manjola Zaçellari

Dr. Natasha Poroçani

PASQYRA E LËNDËS

<i>Fjala përshëndetëse nga prof. Emil Lafe</i>	<i>7</i>
<i>Për pastërtinë e gjuhës shqipe në kohën tonë (Gjuha shqipe – mikpritëse bujare, por edhe zonjë e rëndë në shtëpinë e vet)</i>	<i>8</i>
<i>Lënda e Gjuhës shqipe dhe standardi në shkollë.....</i>	<i>14</i>
<i>Gjuha shqipe në Maqedoninë e Veriut, një rrugëtim i gjatë drejt barazisë gjuhësore.....</i>	<i>22</i>
<i>Varieteti i folur i të rinjve në Maqedoninë e Veriut përballë shqipes standarde.....</i>	<i>38</i>
<i>Gjuha standarde shqipe dhe përdorimi apo shpërdorimi i saj.....</i>	<i>46</i>
<i>Gjedhe ndërndikimi gjuhësor italian në terminologjinë juridike shqipe.....</i>	<i>54</i>
<i>Edukimi gjuhësor nëpërmjet leximit të lekturve.....</i>	<i>61</i>
<i>Trajtimi i gjuhëve në shoqëritë multietnike. Rast studimi: Republika e Maqedonisë së Veriut.....</i>	<i>66</i>
<i>Leksiku dialektor dhe fjalorët dialektorë.....</i>	<i>71</i>
<i>Lindja e implikaturave të reja kuptimore të leksemës ‘komandant’ në komunikimin publik ndër shqiptarët e Maqedonisë së Veriut.....</i>	<i>75</i>
<i>Memoria kolektive përmes gjuhës dhe historisë së folur në bashkësinë e shqiptarëve të Çamërisë.....</i>	<i>81</i>
<i>Parimet e drejtshkrimit të gjuhës shqipe dhe propozimet e Këshillit Ndërkademiç për Drejtshkrimin.....</i>	<i>100</i>
<i>Leksiku dialektor në faqet e revistës “Gjuha shqipe”, mundësi për pasurimin e shqipes standarde.....</i>	<i>113</i>
<i>Pasurimi i strukturës sintaksore të shqipes me dukuri e mjete shprehëse.....</i>	<i>119</i>
<i>Fjala shqipe nën trysinë e fjalës së huaj. Gjuha e medias vizive në ditët e sotme.....</i>	<i>124</i>
<i>Veçantitë e gjuhës në prozën e Kutelit.....</i>	<i>129</i>
<i>Atë Marlaskaj e ndihmesa e tij në fushë të edukimit gjuhësor.....</i>	<i>133</i>
<i>Shumëgjuhësia dhe të drejtat gjuhësore në Republikën e Kosovës.....</i>	<i>140</i>

<i>Veçori të termave në medie nga fusha e teknologjisë.....</i>	<i>144</i>
<i>Kontributi fishtjan për gjuhën shqipe në shkrimet e tij publicistike.....</i>	<i>148</i>
<i>Varianti verior në normën letrare.....</i>	<i>155</i>
<i>Zhvillimi i aftësive komunikative përmes teknologjisë.....</i>	<i>164</i>
<i>Rëndësia e menaxhimit të aftësive gjuhësore dhe implikimet në biznesin ndërkombëtar.....</i>	<i>169</i>
<i>Transformimi i formantit ligjërimor të mësuesit të gjuhës shqipe dhe letërsisë.....</i>	<i>175</i>
<i>Ngërthimi bashkëbisedimor si element analize e ligjërimit politik.....</i>	<i>180</i>
<i>Komunikimi dhe të shprehurit kompetencë gjuhësore.....</i>	<i>187</i>
<i>Kultura gjuhësore, vepra letrare, lexuesi.....</i>	<i>193</i>
<i>Leksiku dialektor-krahinor i autorëve gegë që ka gjetur pasqyrim në fjalorët shpjegues të shqipes. (Frang Bardhi, Nikollë Gazulli, Benedikt Dema).....</i>	<i>197</i>
<i>Raporti i lidhës me paskajoren në ligjërimitin e folur dhe të shkruar.....</i>	<i>207</i>
<i>Fjala e rrallë e popullit burim i pashtershëm për pasurimin e gjuhës shqipe- krahina e Postribës.....</i>	<i>213</i>
<i>Veçoritë fonetike-fonologjike të të folmes së Malishevës.....</i>	<i>224</i>
<i>Zhvillime të reja në shqipe.....</i>	<i>231</i>
<i>Mitologjia si intertekst në disa vepra të periudhës së Rilindjes.....</i>	<i>236</i>
<i>Fjalëformimi në poezinë e Migjenit.....</i>	<i>242</i>
<i>Variacioni gjuhësor dhe kujdesi ndaj gjuhës së shkruar shqipe.....</i>	<i>247</i>
<i>The importance of bilingualism (multilingualism) and the avoidance of consequences.....</i>	<i>249</i>

Fjala përshëndetëse nga prof. Emil Lafa

E nderuar prof. Klodiana Leka, dekane e Fakultetit të Edukimit të UAMD,
E nderuar kryesi e punës e konferencës,
të nderuar kolege e kolege,
të dashur studentë!

E kam pritur me interesim dhe kënaqësi këtë konferencë që na ka mbledhur sot. Tema e saj “Ligjërimi i shkruar dhe i folur, probleme reale dhe propozime konkrete për zgjidhjen e tyre” përmban në vetvete një problem shkencor, arsimor, shoqëror e shtetëror me rëndësi të dorës së parë. Më vjen shumë mirë që thirrja për konferencën ka pasur jehonë dhe kemi një pjesëmarrje të përshtatshme e cilësore, veçanërisht në vështrimin gjeografik. Më gëzon pjesëmarrja e kolegëve të çmuar nga Kosova, RMV dhe Mali i Zi, të cilët i përshëndes përzemërsisht, po ashtu edhe gjithë të tjerët.

Dua të përgëzoj sinqerisht departamentin e gjuhës shqipe të Fakultetit të Edukimit si nismëtar dhe organizator të konferencës, përgjegjësen këmbëngulëse dhe të palodhur të departamentit prof. Edlira Troplini Abdurahmani, gjithashtu vetë Fakultetin dhe dekanatin për mbështetjen që i kanë dhënë konferencës, po ashtu rektoratin dhe rektoren prof. Kseanela Sotirofski për mbështetjen e tyre.

Kjo konferencë mendoj se shënon një ngjarje shkencore jo vetëm për Universitetin e Durrësit, por për jetën universitare në hapësirën shqiptare në përgjithësi. Organizimi i saj dëshmon përgjegjësinë dhe gatishmërinë e profesorehave të vyera të Departamentit të gjuhës shqipe për të njohur dhe për të përballuar problemet, për të sjellë ndihmesën e tyre në fushën e studimit të shqipes standarde dhe për të dhënë njëkohësisht edhe një shembull për t’u ndjekur.

Unë dhe kolegët e mi në Shoqatën e Gjuhësisë Shqiptare, që e kemi lidhur jetën tonë me studimin e gjuhës shqipe, ashtu si ju, kemi kënaqësi kur shohim se në Universitetin e Durrësit ka një kolektiv me përgatitje të shëndoshë shkencore, me aftësi profesionale dhe me përkushtim të dëshmuar për të sjellë vlera të reja në gjuhësinë tonë dhe për të përgatitur specialistë të cilësuar për shkollën dhe kulturën shqiptare.

Punë të mbarë konferencës sonë!

EMIL LAFA
Durrës, 5 maj 2023

*Për pastërtinë e gjuhës shqipe në kohën tonë
(Gjuha shqipe – mikpritëse bujare, por edhe zonjë e rëndë në shtëpinë e vet)*

PROF. DR. EMIL LAFE
Universiteti i Tiranës

Abstrakt

Pastërtia e gjuhës përbën një temë studimi e veprimi të përhershme për gjuhësisë dhe kulturën shqiptare. Intelektualët dhe gjuhëtarët shqiptarë për këtë ndoqën shembullin e kolegëve të tyre në vendet ku zgjimet kombëtare kishin nisur më herët. Që nga periudha e Rilindjes Kombëtare, kur kujdesi për pastërtinë e gjuhës u bë pjesë e programit kulturor të saj, e deri në ditët tona ajo mbetet një politikë gjuhësore që gëzon përkrahje të gjerë. Falë kësaj politike gjuha shqipe ka shumëfishuar fjalët e leksikut aktiv me burim nga brumi i vet, duke fituar një fytyrë më kombëtare; krahas kësaj janë krijuar organizma të posaçëm për veprimtari me baza shkencore në këtë fushë. Një ndikim të fortë pati për këtë krijimi i Komisionit të Përhershëm për Pastrimin dhe Pasurimin e mëtejshëm të gjuhës shqipe (1979) dhe veprimtaria e tij dhjetëvjeçare. Objekt i veprimtarisë në këtë fushë është gjuha standarde në përdorimin e saj në veprimtarinë shtetërore e në publicistikë dhe terminologjia tekniko-shkencore.

Në kohën tonë, sidomos me shpalljen e Republikës së Kosovës (2008) dhe me përparimin e pozitës së gjuhës shqipe në RMV, si edhe me krijimin Agjencisë për Zbatimin e Gjuhës Shqipe në Shkup pastërtia e gjuhës ka marrë përmasat e një problemi mbarëkombëtar, që kërkon forca e mjete të bashkuara dhe përpjekje të bashkërenduara për t'i çuar më përpara arritjet dhe për të përballuar detyrat në rrethanat e sotme të Europës gjuhësore dhe të konvergencës së mëtejshme brenda shqipes standarde. Objekt kryesor i punës mbetet mënjanimi i fjalëve të huaja të panevojshme dhe krahas kësaj ruajtja e natyrës së gjuhë sonë në fushën e ndërtimeve sintaksore. Çështjet e pastërtisë së gjuhës janë të lidhura drejtpërdrejt me hartimin e fjalorëve të rinj shpjegues dhe të fjalorëve shqip – gjuhë e huaj e anasjelltas, po ashtu edhe të gramatikave, prandaj nuk mund të vështrohen si diçka e dorës së dytë.

Në rrethanat e sotme është e nevojshme që: a) Komisioni i dikurshëm për Pastrimin dhe Pasurimin e Gjuhës Shqipe të rithemelohej si Komision ndërqeveritar (Shqipëri, Kosovë, RMV) dhe b) në arsimin parauniversitar e në fakultetet filologjike të universiteteve shqiptare problemet e pastërtisë së gjuhës të integrohen në mënyrë më organike e më të gjerë.

Fjalë çelës: *pastërtia e gjuhës, fjalë të huaja, ndërtime sintaksore të huaja, gjuha standarde, politika gjuhësore.*

Gjuha dukuri shoqërore komplekse ashtu si dhe vetë shoqëria. Tema e konferencës sonë është “Ligjërimi i shkruar dhe i folur, probleme reale dhe propozime konkrete për zgjidhjen e tyre”. Kjo nënkupton në radhë të parë përdorimin publik të gjuhës, d.m.th. gjuhën standarde. Edhe kumtesa ime, që ka si temë pastërtinë e gjuhës në kohën tonë, ka parasysh në radhë të parë shqipen standarde, shqipen në përdorim zyrtar e publik.

Kumtesës sime i kam vënë një nëntitull “Gjuha shqipe – mikpritëse bujare, por edhe zonjë e rëndë në shtëpinë e vet”. Kisha parasysh se do të ishte sot këtu edhe kolegu im Xhevat Lloshi, që ka botuar një artikull me titull “Shqipja – gjuhë e hapur dhe dinamike”. Titulli mund të kuptohet në mënyra të ndryshme, prandaj një diskutim i përbashkët këtu do të ishte me vlerë. Sidoqoftë, unë, duke pasur parasysh, siç thashë, përdorimin publik të gjuhës, d.m.th. gjuhën standarde, jam i prirë ta vështroj gjuhën shqipe si mikpritëse bujare (të elementeve nga gjuhët e tjera), po edhe zonjë të rëndë në shtëpinë e vet.

Është shkruar shumë për temën që do të trajtoj. Puna për pastërtinë e gjuhës në përgjithësi është vështruar dhe vështrohet si detyrë e nevojshme dhe e përhershme. Kur themi

Materialet e punimeve (proceedings)

ISBN: 978-1-78911-007-4

pastërti e gjuhës kemi parasysh që një gjuhë e caktuar, si p.sh. shqipja, t’i përballojë nevojat e komunikimit me mjetet e veta, me fjalët që ka ose që mund të formohen me brumin e vet. Kështu pastërtia shkon krahas me pasurimin, d.m.th. me krijimin e fjalëve të reja të nevojshme.

Ja si e kanë shprehur këtë disa personalitete të shquara të kulturës dhe të jetës mendore në përgjithësi:

Naum Veqilharxhi, 1845: E para e punësë ish që si të mund të nxjerr fjalët e shprehjet e huaja, dhe në vend të tyre të formoj të tjera nga vetë gjuha jonë, edhe me gjithë që he për he munt edhe të mos tingëllojnë ëmbël në të dëgjuarit e veshëve, po kam shpresë se koha do t’i ëmbëlsojë.

Naim Frashëri 1896: Gjuha jonë duhet shkruar thjesht shqip, se fjalët e huaja e shëmtojnë shumë. Është e gjerë gjuha jonë dhe e bukur shumë., ka fjalë fort të mira për të vënë në vend të fjalëve të huaja.

Luigj Gurakuqi, 1905: Këto fjalë e terma [*që do të formojmë nga brumi i gjuhës shqipe për të mënjeluar përdorimin e fjalëve të huaja*] për t’parën herë mund të duken si t’vështirshme e mund t’mos pëlqehen aq fort, por me kohë përdorimi i përditshme ka për t’iu ndrrue pak ka pak fytyrën e ka për t’iau fitue kombësinë shqipe sikur iau fitoi edhe sa e sa tjerëve.

Eqrem Çabej, 1979: Shumë fjalë që do të vendoset të përdoren e të hyjnë në gjuhë, edhe neve në fillim do të na duken pakëz çudi. Porse brezat që do të vijnë, do t’i përdorin vetiu; shumë fjalë vendi që janë farkuar prej paraardhësve tanë e prej brezit tonë, janë për ne sot të natyrshme e janë bërë pronë e qëndrueshme e gjuhës. Dhe po në atë artikull ai do të shprehej: “Gjuha është pasqyra më e qartë e një kombësie dhe e kulturës së saj. Shkalla e pasurisë dhe e pastërtisë së gjuhës është një tregues i nivelit të kësaj kulture. Prandaj ringjalljet kombëtare kudo e në çdo kohë kanë shkruar hap më hap me pasurimin dhe pastrimin e gjuhës” (E. Çabej, “Për pastërtinë e gjuhës”, gazeta “Mësuesi” 28 mars dhe 4 prill 1979)

Kujdesi për pastërtinë dhe pasurimin e gjuhës ka përkrahje jo vetëm nga shtresa të gjera të popullit. Por pastërtia e gjuhës, mbrojtja e gjuhës së sonë, e veçantisë kombëtare të saj nuk është vetëm detyrë gjuhësore e shoqërore, po edhe detyrë shtetërore. Në këtë çështje do të ndalem më tej, por këtu dua të përmend një gjykim të gjuhëtarit arbëresh Marco La Piana (1883-1958): *Nëse për të gjitha gjuhët çështja e pastërtisë ka rëndësi të madhe, për gjuhën shqipe ajo ka rëndësi jetike. Me këto fjalë ai vlerësonte rëndësinë e librit të Aleksandër Xhuvanit “Për pastërtinë e gjuhës” (1956) dhe të punës së tij e të tjerëve në këtë fushë.*

Pse pastërtia e gjuhës për rastin e shqipes është një problem kaq i mprehtë, me rëndësi jetike? Shqiptarët fituan pavarësinë në fillim të shek. XX dhe deri atëherë shqiptarët nuk kishin as institucione arsimore e kulturore në gjuhën e vet (popuj të tjerë nuk kanë pasur shtetin, po kanë pasur shkollat dhe botime në gjuhën e vet, p.sh. polakët, çekët, grekët, serbët, bullgarët). Mjafton të përmendim se vërtet u shpall pavarësia më 28.11.1912, por shteti në një pjesë të rëndësishme të veprimtarisë së tij, sidomos në fushën gjyqësore, përdoret turqishten. Pse? Gjykatësit shqiptarë që flisnin shqip në shtëpi, nuk kishin terminologji gjyqësore shqipe! Ja disa shembuj termash të asaj kohe: *arzuhall - lutje, karar - vendim, mehqeme - gjyq, shahid - dëshmitar, shart - kusht, zarar - dëm* (këto fjalë edhe sot mund të dëgjohen në ligjërimin bisedor, por shumë terma të tjerë juridikë ishin krejt të panjohur për popullin e thjeshtë). Pra pavarësia shtetërore solli detyrimisht edhe pavarësinë gjuhësore. Pavarësia shtetërore mbrohet me shumë mjete e mënyra, edhe me forca të armatosura. Pavarësia gjuhësore mund të quhet e *cenueshme* (ka filluar të përdoret kjo fjalë për të mënjeluar fjalën e huaj *vulnerabël*). Të folurit tonë dhe gjuha shqipe po dëmtohen nga fjalët e huaja që na hyjnë përditë nga mediat.

Materialet e punimeve (proceedings)

ISBN: 978-1-78911-007-4

Mediat përçojnë te ne fjalët e gjuhës së raporteve burokratike të administratës së shtetit. Kështu p.sh., kthehet djali në mbrëmje në shtëpi dhe e pyet e ëma: *Do të hash darkë apo ke konsumuar ndonjë gjë me shokët?* Tani po harrohen foljet *ha* e *pi* dhe për gjithçka që futet në gojë, thuhet se *konsumojmë!* Por nuk mjafton kjo. Edhe për një çështje të thjeshtë që dikush ka nevojë t’i shtrojë dikujt pyetet prapë: *E ke konsumuar me shefin (drejtorin...)?*

Dëgjoni deri ku shkon shpërftyrimi i të folurit shqip nga mania e përdorimit të fjalëve të huaja: *Kudo ku shkonte Tefta Tashko provokonte lot në sytë e vajzave dhe të grave, lot hidhërimi sepse ishin të mbyllura brenda ekonomive familjare.* Kjo do të ishte shqip: *Kudo ku shkonte Tefta Tashkoja, sytë e vajzave dhe të grave përloteshin, sepse ato ishin të mbyllura brenda mureve të shtëpive ...* Ose kur dëgjojmë të na thonë nga studiot e televizioneve: *Gazetarja jonë është pozicionuar përpara ndërtesës së Kryeministrisë ...* (sikur gazetarja të kishte zënë ndonjë pozicion luftimi me mitraloz në dorë në vend të mikrofonit!) – a nuk mund të thuhej thjesht e qartë shqip: *Gazetarja jonë ndodhet ose ka zënë vend përpara ndërtesës së Kryeministrisë?* Në korridoret e Radio Tiranës mund të lexoni: *Këtu dezinfektoni duart tuaja!* Në gjuhën shqipe (ashtu si edhe në shumë gjuhë të tjera) thuhet: *Po laj duart (jo Po laj duart e mia – si në anglishte).* Në lajmet dëgjojmë herë pas here se *Presidenti i ... me bashkëshorten e tij bëri një vizitë në ose Po udhëtonte bashkë prindërit e saj...* Te shembuj të tillë përemrat pronorë janë krejt të panevojshëm, janë ndikime të dëmshme nga gjuhët e huaja. Nuk besoj se këto mund të përligjen me formulën “gjuhë e hapur dhe dinamike”. Në gjuhën shqipe themi p.sh.: *Kush ka ardhur? /Tezja (Daja). / Me kë ka ardhur? / Me vjazën (djalin, mbesën). Ka ardhur një mik (një shok) me gruan.* Nuk ka nevojë për përemër pronor. Vetëkuptohet që është gruaja e Në gjuhën shqipe thuhet *Unë me burrin (me gruan, me djalin, me vajzën, me mbesën etj.)* dhe kuptimi është i qartë për këdo. Në gjuhë të tjera thuhet ndryshe, por ato janë gjuhë të tjera, kanë rregullat e tyre. Profesorët e gjuhëve të huaja sidomos duhet t’ua shpjegojnë këtë nxënësve, ti paralajmërojnë nga rreziku i përkthimit fjalë për fjalë.

Problemi kryesor për shqipen standarde janë huazimet moderne, fjalët me burim nga gjuhët neolatine dhe kohët e fundit nga anglishtja, gjuha e globalizimit. Në veprimtarinë konkrete për mënjanimin e fjalëve të huaja gjuhësia jonë mban parasysh se gjuha shqipe nuk është një gjuhë romane ose gjysmë e romanizuar (si anglishtja në leksikon shkencor-dituror). Si kriter pune është pasur parasysh që ndërkombëtarizmat të pranohen e të përdoren edhe në gjuhën tonë. Por del pyetja: cilat fjalë do të vështrohen si ndërkombëtarizma? Përcaktimi i të ashtuquajturave ndërkombëtarizma është një problem teorik mjaft i diskutueshëm. Që prej krijimit të sektorit të terminologjisë në Institutin e Shkencave (1955) është caktuar ky kriter praktik: Do të cilësohen si ndërkombëtare fjalët dhe termat që i kanë të përbashkëta jo vetëm gjuhët romane (shpesh dhe anglishtja), por edhe gjuhët e tjera gjermanike e sllave (si p.sh. *atom, biologji, element, diametër, diapazon, fizikë, kimi, makinë, mekanikë, radio, revolucion* e shumë të tjera). Ndërkaq, një numër i mirë fjalësh të tjera që nuk e përmbushin këtë kusht, zëvendësohen me fjalë shqipe të njohura ose me fjalë të krijuara rishtas. Kështu kemi çifte të tilla: *adaptoj - përshtat, adoptoj - birësoj, ambient - mjedis, anuar - vjetar, atak - sulm ose goditje, atakoj - sulmoj ose godas, bilateral - dypalësh, centrifugal - qendërikës, centripetal - qendërsynues, definicion - përkufizim, definitiv - përfundimtar, ekstrem - i skajshëm, ekstremitetet - anësitë ose gjymtyrët, frutikulturë - pemëtari, kalkuloj - njehsoj, konkav - i lugët, konveks - i mysët, lokal-e - vendor-e, novacion - risi, nuklear - bërthamor, ortografi - drejtshkrim, prezencë - prani, primar - parësor, sekondar - dytësor, solucion - tretësirë etj.etj.*

Detyrat e shkollës (në rrafsh mbarëkombëtar)

a) arsimit parauniversitar:

1. Në gjithë veprimtarinë mësimore dhe dokumentacionin shkollor të mos përdoren fjalë të huaja të panevojshme. Mësuesit e gjuhës shqipe dhe të gjuhëve të huaja të tregojnë kujdesin më të madh për ngulitjen e shprehive të pastërtisë së gjuhës.

2. Kujdes i veçantë t’i kushtohet terminologjisë së lëndëve mësimore. Ajo duhet të jetë sa më e njësuar dhe e shqipëruar. Mendoj se është e nevojshme që Ministria e Arsimit të përcaktojë paraprakisht terminologjinë e lëndëve mësimore dhe hartuesit e teksteve do të jenë të detyruar t’i përmbahen asaj.

3. Në tekstet e gjuhës shqipe, sidomos që nga klasa VII deri te klasa XII, të ketë ushtrime e këshillime për pastërtinë e gjuhës. Për këtë mund të punohet paraprakisht një material i përgjithshëm: “Çështje të pastërtisë së gjuhës në arsimin parauniversitar” dhe të caktohet si do të ndahet kjo lëndë në programin e teksteve sipas klasave. Kam vënë re se ushtrimet në tekstet e gjuhës janë të mbingarkuara me gjithfarë hollësish gramatikore; në vend të tyre të shtohen ushtrimet me çështje të fjalorit dhe sidomos të pastërtisë së gjuhës.

4. Në tekstet e gjuhëve të huaja dhe në mësimin e tyre në klasë të ketë udhëzime dhe shpjegime për çështje të pastërtisë së gjuhës si në fushën e fjalorit e të frazeologjisë, ashtu edhe në fushën e ndërtimeve sintaksore. Ja dy shembuj të thjeshtë. Thënien angl. *Never hesitate!*, ital. *Non esitare mai!* fr. *Ne jamais hésiter!* nxënësi dhe mësuesi shqiptar do të përkthenin drejtpërdrejt *Mos hezito kurrë!* Sepse fjalën *hezitoj* e dimë të gjithë, por kemi të bëjmë me një fjalë të huaj të panevojshme, sepse shqip themi *ngurroj*, pra *Mos ngurro!* A ka ndonjë dallim semantik a stilistik ndërmjet *hezitoj* dhe *ngurroj*? Për mua ato janë plotësisht të barasvlershme. Atëherë, për këtë rast dhe raste të tjera të ngjashme në mësimin e gjuhës së huaj, mësuesi duhet të ndërhyjë, të tërheqë vëmendjen. Shembulli tjetër: *Këtu dezinfektoni duart tuaja* (mbishkrim) - a është i nevojshëm përcaktori *tuaja*? Në gjuhën shqipe aspak. Prandaj nuk duhet përkthyer anglishtja fjalë për fjalë. Edhe ky është një element i rëndësishëm i pastërtisë së gjuhës, për t’u pasur parasysht në mësimin e gjuhëve të huaja.

5. Çështjet e pastërtisë së gjuhës të zënë një vend të rëndësishëm në konkurset gjuhësore.

b) arsimit i lartë:

1. Në fakultetet filologjike në lëndën e leksikologjisë së gjuhës shqipe programi të përmbajë seminare për pastërtinë e gjuhës dhe pedagogët të përgatisin materiale të posaçme për studentët. Por mund të ndërtohet edhe një seminar teorik e praktik i posaçëm si lëndë me zgjedhje. Ju ftoj që Universiteti i Durrësit të bëhet nismëtar i kësaj risie dhe ju premtoj ndihmën time e të kolegëve të mi.

2. Në fakultetet e gjuhëve të huaja të përfshihet në program leksikologjia e gjuhës shqipe. Mendoj se kjo lëndë është më e nevojshme se gramatika që bëhet tani. Fakultetet e gjuhëve të huaja nuk kanë si detyrë vetëm që studentët e tyre t’i zotërojnë sa më mirë gjuhët e huaja që mësojnë, por njëkohësisht këta studentë të kenë kompetencën e nevojshme për të shprehur korrekt shqip një tekst të një gjuhe të huaj.

3. Në të gjitha shkollat e larta në përgjithësi dokumentacioni dhe tekstet mësimore të jenë me cilësi më të lartë. Në tekstet e shkollave të larta t’i kushtohet kujdes njësimi dhe shqipërimin të terminologjisë. Tekstet të kenë redaktorë letrarë të profilizuar.

4. Disertacionet e doktoratës të kenë detyrimisht redaktor letrar të profilizuar, në rast se këtë detyrë nuk e merr përsipër vetë autori. Të mos lejohet mbrojtja e disertacionit me të meta gjuhësore.

Detyra të përgjithshme

Pastërtia e gjuhës, kultura gjuhësore dhe kujdesi për gjuhën në tërësi janë një çështje e përgjithshme dhe mbarëkombëtare. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë ka një nen të posaçëm për këtë, por që prej miratimit të saj nuk ka pasur veprime konkrete. Nisma për ligj për gjuhën shqipe ka mbetur në vend prej njëzet vjetësh.

Në rrethanat tona të sotme mendoj se shtrohet nevoja e riorganizimit të Komisionit të Përhershëm për Pastrimin dhe Pasurimin e Mëtejshëm të Gjuhës Letrare Shqipe, i ngritur pranë Këshillit të Ministrave më 1979 me propozim të Akademisë së Shkencave. Në vendimin përkatës thuhet ndër të tjera se Komisioni do të ketë si detyra kryesore: Të organizojë e të drejtojë punën për pastrimin dhe pasurimin e gjuhës sonë amtare në të gjitha fushat dhe të kujdeset që të vihen në jetë përfundimet e kërkimeve dhe të studimeve në këto fusha; Të bashkërendojë e të kontrollojë punën për shqipërimin e njësimin e mëtejshëm të terminologjisë tekniko-shkencore dhe për zbatimin e saj nga të gjithë; Të kujdeset për zbatimin e normës së gjuhës letrare në veprimtarinë administrative e publike; Akademia e Shkencave, ministritë dhe institucionet e tjera kërkimore shkencore, shkollat e larta, të përfshijnë në planet e tyre të punës vjetore detyrat që u dalin dhe të caktojnë për këtë qëllim njerëzit më të aftë e më të përgatitur; Për të trajtuar çështjet e pastrimit dhe të pasurimit të gjuhës shqipe të krijohet revista “Gjuha jonë”.

Nga përvoja ime unë kam bindjen se sado të aftë, të zellshëm e të papërtuar të jemi ne gjuhëtarët për këto çështje që trajton konferenca jonë, ne pa bashkëpunimin e drejtpërdrejtë të shtetit nuk kemi fuqi të arrijmë atë që duhet. P.sh. kush do të urdhërojë që fjala e shëmtuar *siguracion* të hiqet nga përdorimi shkresor dhe nga të gjitha mbishkrimet e tabelave? Kush do të urdhërojë që fjala *sezon (provimesh)* të hiqet nga përdorimi në të gjitha shkollat e larta, sepse është një gabim trashanik? Pjesëmarrja e shtetit është e pashmangshme për mbarëvajtjen e gjuhës shqipe. Deri tani shteti ia ka lënë këtë detyrë kryesisht shkollës dhe disa redaktorëve letrarë në institucione qendrore të administratës, por kjo nuk mjafton. Duhet një organizëm i përhershëm, sepse problemet janë të shumta dhe të vijueshme.

Detyra në rrafsh mbarëkombëtar

Vjet u përkujtua në mënyrë të denjë me veprimtari shkencore 50-vjetori i Kongresit të Drejtshkrimit. Vërtet të gjithë shqiptarët në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni në Malin e Zi, në Serbi e kudo gjetkë kanë një gjuhë standarde të përbashkët, por deri tani kjo kufizohet kryesisht te drejtshkrimi e te gramatika. Në fushën e leksikut e sidomos të terminologjisë nuk kemi ende një standard dhe problemet janë të shumta. Nuk është çështja vetëm te përdorimi i fjalëve të huaja, por edhe te njësimi i terminologjisë. Një akademik i shquar i Kosovës, Esat Stavileci është shprehur se shkalla e mosnjësimit të terminologjisë që përdoret në Shqipëri dhe në Kosovë “ndonjëherë arrin kuotën e moskuptimit dhe nevojën e sqarimit term për term për të kuptuar thelbin e problemit.” Këto fjalë u shqiptuan në Konferencën për gjendjen dhe zhvillimin e terminologjisë shqipe të organizuar nga dy Akademitë Shqiptare të Shkencave. Me këtë rast u kërkua që të ndërtohet një bashkëpunim i qëndrueshëm dhe i vijueshëm në fushën e terminologjisë, por mjerisht nuk është hedhur deri më sot as hapi i parë. Unë kam krijuar bindjen se terminologjia nuk është detyrë hulumtimesh akademike, prandaj duhet një organizëm tjetër, *ad hoc*, për ta përballuar. Ashtu si edhe në vende të tjera, edhe te ne duhet të krijohet në Komitet ndërshtetëror (Shqipëri - Kosovë - RMV) për terminologjinë. Ky Komitet sigurisht do të mbështetet te të gjitha institucionet akademike dhe forcat e tjera shkencore, por do të ketë edhe tagër për t’i tërhequr ato në komisione për përcaktimin e terminologjive të fushave të ndryshme e në afate të caktuara, duke nisur nga më të ngutshmet. Nuk është çështja te zëvendësimi i fjalëve të huaja me fjalë të shqipes, por edhe për njësimin e terminologjisë.

Materialet e punimeve (proceedings)

ISBN: 978-1-78911-007-4

Për ta konkretizuar: Kodi i Qarkullimit Rrugor i Shqipërisë dhe i Kosovës kanë jo pak mospërputhje terminologjike. Natyrisht secili shtet do të ketë kodin e vet, por terminologjia duhet të jetë e njëjtë, p.sh. automjeti që zhvendos veturat e parkuara në kundërvajtje me rregullat ose kur kanë pësuar ndonjë avari, te ne quhet *karrotrec* (që është një shtrembërim i trashë i italishtes *carro attrezzi*), ndërsa në Kosovë kjo lloj makine quhet rëndom *merimangë* (përkthim i serbishtes *pauk*). Po në RMV cilin term duhet të marrin? Prandaj për terminologjinë e qarkullimit rrugor duhet ngritur një komision i përbashkët, i përbërë nga specialistë të kësaj fushe dhe nga gjuhëtarë. Termat që do të përcaktojnë ky komision i ngushtë, do të diskutohen në një rreth më të gjerë, do të bëhen përmirësimet e nevojshme dhe do të marrin fuqi ligjore, duke u përdoruar në kodet përkatëse të ripunuara. Unë mendoj se kjo është një detyrë që nuk pret. Pa vënë në rrugën e zgjidhjes njësimin dhe shqipërimin në terminologjisë, Fjalori i madh akademik që po hartohet, do të ketë një vlerë relative, sado të përkryera të jenë struktura kuptimore dhe shpjegimet e fjalëve të leksikut të përgjithshëm joterminologjik.

Përmbyllje:

Një luftëtar i Rilindjes dhe vjershëtar popullor, në moshë të shkuar, nxori një këngë: *Në kohë të pleqërisë/ Ç'më zunë halle të rënda,/ Për sebeb të Shqipërisë./ Që s'u bë siç ma kish ënda.* Ka vite që sikur e kam në veshë këngën e tij. Por jeta vazhdon, brezat ndërrohen, vijnë kohë më të mira e njerëz më të mençur e vullnetmirë, që do t'i zgjidhin një nga një “hallet e rënda” të brezit tim dhe nuk do t'i lënë të mblidhen një mbi një! Kjo konferencë është një shenjë e një shpresë se brezat e sotshëm aktivë të filologëve shqiptarë janë të vetëdijshëm e të përgjegjshëm për detyrat dhe detyrimet e tyre. Profesorati i Universiteteve shqiptare duhet të jetë një faktor i zëshëm, gjallërues, në jetën mendore të vendeve tona dhe në radhë të parë për çështje që kanë të bëjnë me gjuhën shqipe. Çdo gjuhë ka nevojë për mirëmbajtje, për përkujdesje. Gjuha shqipe edhe më shumë se të tjerat. Prandaj jemi sot këtu.

Lënda e Gjuhës shqipe dhe standardi në shkollë

PROF. DR. SHEZAI RROKAJ - BEHAR HOXHA
Universiteti i Tiranës

Abstrakt

Në dallim nga shumë lëndë të tjera në sistemin parauniversitar, lënda e gjuhës shqipe merr një rëndësi të veçantë, pasi gjuha shpreh në vetvete një mënyrë të caktuar të perceptimit të shoqërisë shqiptare dhe ndikon drejtpërdrejt në formësimin e identitetit kombëtar. Kemi mbështetur mendimin se veçimi i saj nga letërsia pra, mësimdhënia me dy tekste të ndryshme, në kushtet e sotme, është më dobiprurëse në formimin gjuhësor e letrar të nxënësve, të metodologjisë së mësimdhënies dhe të mësimnxënies.

Sipas nesh, është gjithashtu i nevojshëm të mbështetet argumenti se, në dallim nga lëndët e tjera, si për çdo gjuhë tjetër, lënda e gjuhës shqipe ka një funksion të dyfishtë: përvetësimin e standardit si pjesë e gjuhës natyrore të shqipfolësve, nga njëra anë, dhe përvetësimin e koncepteve gjuhësore ose, siç quhet ndryshe, metagjuha, nga ana tjetër. Mendojmë se në funksion të gjendjes së sjelljes gjuhësore është e nevojshme të konceptohet edukimi gjuhësor i cili, në lëndën e gjuhës shqipe, më së pari duhet të zgjidhë në programin e saj peshën e raportit të përvetësimit të standardit të gjuhës shqipe, si e tillë përpos peshës që duhet të marrë përvetësimi i koncepteve gjuhësore, pra i metagjuhës dhe se si mund të rregullohet ky raport në programet lëndore të gjuhës shqipe në varësi të rritjes moshore në sistemin parauniversitar.

Nga ana tjetër, pyetja që shtrojmë është se çfarë t’u mësojnë në shkollë fëmijëve: vetëm standardin, gjuhën e institucioneve apo në mënyrë krahasuese e dalluese, duke e shoqëruar mësimdhënien me një proces vetëdijeje për dialektet, variantet dialektore apo sociolektet, pra gjuhën e përrethësisë? Si kudo, në shoqëritë e zhvilluara, në shkollë synimi kryesor është të mësohet standardi si gjuhë komunikimi, si gjuhë e shtetit dhe e gjithë piramidës institucionale shtetërore. Por për shoqëritë në proces njësimi, ku ndodhet areali shqipfolës është e nevojshme të mos lihet jashtë vëmendjes së edukimit gjuhësor pjesa tjetër e natyrshme, e përditshme, gjenetike e gjuhës, që është dialekti, e folmja, sociolekti pra, ‘gjuha tjetër’ në përdorim.

Fjalë çelës: *gjuhë shqipe, standard, metagjuhë, gjuhë në përdorim, dialekt, sociolekt, ligjërime*

1. Hyrje

Të gjithë ndajmë të njëjtin mendim, shpresojmë, se reforma në shkollë është pjesë e pandarë e punës sonë, duke filluar nga qeveritë, institucionet e varësisë, universitetet e deri te mësuesit, të cilët janë në fakt edhe promotorët e zbatimit të saj. Duhet pohuar se është bërë një punë e dobishme për hartimin e kurrikulave dhe rinovimin e gati gjithë tekstologjisë shkollë, duke zbatuar në to përvojat më të mira evropiane e më gjerë, si dhe duke u mbështetur në traditën më të mirë të shkollës shqiptare. Kjo përvojë është marrë dhe po merret edhe në lëmin e gjuhës dhe të letërsisë, kryesisht në përzgjedhjen e tematikës e, sidomos së fundi, në zbatimin e metodologjisë moderne mbi bazë kompetencash e nivelesh në procesin e mësimdhënies dhe të mësimnxënies me qendër nxënësin. Pjesë e kësaj reforme është edhe lënda e Gjuhës shqipe, e parë kjo edhe në gjithë kompleksitetin e politikës gjuhësore shqiptare e planifikimin e saj në gjithë shtrirjen e arealit shqipfolës.

Në konferenca e në ligjërata të ndryshme janë shtjelluar aspekte të ndryshme për këto çështje: janë rrahur mendime, të cilat hedhin dritë mbi atë që na përket të gjithëve: si nxënësit mund t’i afrohen dhe përvetësojnë më mirë gjuhën amtare, cila është metodologjia e duhur për t’iu afruar këtij synimi. Në këtë drejtim departamentet tona kanë detyrimin kombëtar e

shtetëror të japin përvojën e tyre profesionale e shkencore si dhe të sugjerojnë qasje metodologjike, duke u nisur jo vetëm prej faktit se aty përgatiten mësuesit e gjithë sistemit të edukimit, me njohuri shkencore e metodologji mësimdhënieje bashkëkohore, por edhe sepse nga vetë natyra e tyre ato (departamentet) mbeten aktorë të pazëvendësueshëm të formimit të vazhdueshëm. Nga ana tjetër, departamentet dhe qendrat kërkimore kanë grumbulluar tashmë një përvojë studimore të vlefshme për gjuhën amënore, veçoritë e saj në dallim nga gjuhët e tjera, kontekstet gjeopolitike të shtrirjes së arealit shqipfolës si dhe për problematikat e njësisimit, përvetësimit dhe zbatimit të standardit në administratën e shtetit, në shkollë dhe në media. Në kumtesën tonë po ndalemi të trajtojmë disa çështje që lidhen me gjuhën shqipe dhe standardin në shkollë, duke i parë nga qasje e këndvështrime të ndryshme, të cilat gjykojmë se përbëjnë interes.

2. Lënda e Gjuhës shqipe vs lëndët e tjera

Në dallim nga shumë lëndë të tjera në sistemin parauniversitar, lënda e gjuhës shqipe merr një rëndësi të veçantë, pasi gjuha shpreh në vetvete një mënyrë të caktuar të perceptimit të shoqërisë shqiptare dhe ndikon drejtpërdrejt në formësimin e identitetit kombëtar. Të gjitha vendet tregojnë përkujdesje të veçantë për mësimdhënien e lëndës së gjuhës. Edhe shoqëria shqiptare, qeveritë dhe institucionet, që merren me këto çështje, kanë treguar dhe tregojnë një interes të veçantë për mënyrën se si konceptohet kjo mësimdhënie, për standardet që duhet të arrihen, duke i parë e krahasuar edhe me metodologjitë e përdorura në vende të ndryshme për përvetësimin e gjuhës amtare.

Së pari, duam të pohojmë se ka qenë i drejtë vendimi i sugjeruar edhe prej departamenteve tona se, në gjendjen e sotme të mësimdhënies në shkollë, gjuha dhe letërsia të trajtohen ndaras si tekste e lëndë të veçanta. Përvojat e shteteve rreth nesh kanë qenë të ndryshme: ose gjuhë-letërsi bashkë, ose dhe të ndara. Në rastin e parë, edhe për arsye zotësie profesionale të hartuesve të tyre, por edhe të problemeve gjatë mësimdhënies prej mësuesve në shkollë, tek ne tekstet e njësuara gjuhë-letërsi nuk ia kanë dalë të konceptojnë një tekst unifikues që të krijonte një sinergji të natyrshme, ku tematikat letrare të gërshetoheshin me ato gjuhësore në funksion të njëra-tjetrës. Ta themi qartas se nuk ia kemi dalë dot të realizojmë si duhet tekste që shprehin në mënyrë të sintetizuar një bashkim organik të këtyre dy disiplinave brenda temave që trajtohen në një mësim. Në shumë raste, të dyja disiplinat jepeshin si bashkime artificiale, pa mundur që problematika e njëjës të ishte në funksion të problematikës së tjetrës dhe ndërsjelltas. Për më tepër, në mjaft raste vetë mësuesit janë prirur drejt një mësimdhënieje shproporcionale të njëjës disiplinë në dëm të tjetrës.

Përpos sa theksuam më lart, vlen të mbahet parasysh gjithashtu fakti se përvojat e vendeve të tjera si dhe metodat e zbatuara në përputhje me natyrën e gjuhëve përkatëse, nuk mund të zbatohen *ad litteram*, ndryshe ato bëjnë efektin e kundërt. Siç do ta shohim më tej, vetë natyra specifike e gjuhës shqipe, periudha e shkurtër standardizuese krahasimisht me gjuhë të tjera, kushtet gjeopolitike të arealit shqipfolës, kërkojnë qasje ad hoc. Ndaj mendojmë se veçimi i këtyre disiplinave, pra mësimdhënia me dy tekste të ndryshme, në kushtet e sotme, është më dobiprurëse në formimin gjuhësor e letrar të nxënësve, të metodologjisë së mësimdhënies dhe të mësimnxënies. Natyrisht, kjo nuk do të thotë se, rast pas rasti, si teksti i gjuhës dhe ai i letërsisë të mos trajtojnë elemente ndërdisiplinore, aty ku natyrshëm është e mundur.

Së dyti, për ne është gjithashtu i nevojshëm argumenti se, në dallim nga lëndët e tjera, si për çdo gjuhë, lënda e Gjuhës shqipe ka një funksion të dyfishtë: përvetësimin e standardit si pjesë e gjuhës natyrore të shqipfolësve, nga njëra anë, dhe përvetësimin e koncepteve

Materialet e punimeve (proceedings)**ISBN: 978-1-78911-007-4**

gjuhësore ose, siç quhet ndryshe, metagjuha, nga ana tjetër. Pra, si çdo lëndë tjetër (biologjia, kimia, matematika, historia, gjeografia etj.), lënda e Gjuhës shqipe duhet t’u mësojë nxënësve konceptet mbi gjuhën por, ndryshe nga lëndët e tjera, ajo synon edhe përvetësimin e vetë gjuhës amtare, kryesisht në variantin standard. Në parim, deri këtu, siç u përmend më lart, ajo nuk bën dallim nga lëndët simotra që përdorin edhe vende të tjera për përvetësimin e gjuhës amënore. Kjo do të thotë se nxënësit duhet të mësojnë gjuhën shqipe në variantin shtetëror (standard ose zyrtar) e më gjerë si dhe, përpos kësaj, edhe konceptet shkencore të kësaj dukurie që lidhen me metagjuhën. Mirëpo ajo që na dallon nga shoqëritë e tjera përreth nesh, lidhur me procesin e edukimit në gjuhën amtare dhe metodat që përdoren, nuk është vetëm veçanësia tipologjike e natyrore e shqipes kundrejt këtyre gjuhëve, siç u përmend më lart, por edhe gjendja në të cilën ndodhet vetë procesi i përvetësimit të standardit nga shoqëria shqipfolëse (pra, tradita e shkurtër), krahasimisht me shoqëritë e tjera si dhe qasja ndaj këtij realiteti gjuhësor në mënyrë të përveçme.

Dihet se konceptimi, shtrirja, përsosja dhe përvetësimi i një standardi është një proces dinamik, historik dhe gjeopolitik. Në arealin shqipfolës për pesë dekada shqiptarët po zbatojnë një standard i cili, në kohën kur u vendos, kushtet gjeopolitike, shoqërore e publike nuk ndihnin në masën e duhur në përhapjen dhe njësimin e tij brenda gjithë arealit indigjen. Gjithashtu, vetëm prej tri dekadash gjuha shqipe në tërësi ka filluar të rrjedhë gati natyrshëm në gjithë kapilarët e kombit. Vetëm prej një dekade e gjysmë në Kosovë kemi një shtet që ushtron një trysni konverguese në zbatim të një politike gjuhësore dhe vetëm prej afër gjashtë vitesh gjuha shqipe në Maqedoninë e Veriut është në përdorim pjesërisht zyrtar. Përpos këtyre veçorive, ndryshe nga disa shoqëri të zhvilluara rreth nesh, ku shkollimi në kopshte përfshin thujtë gjithë brezin, statistikisht tek ne tregojnë se shkollimi gjuhësor në kopshte e parashkollorë në fshat nuk mbërrin përtej shifrës 30%, kurse në qendrat urbane jemi diku mesatarisht në shifrat 60%.

Po kështu, pas viteve ‘90 gjuha shqipe po ‘çlirohet’ gradualisht prej ‘gjuhës së drunjtë’ e cila, gjatë periudhës komuniste, në shumë aspekte të ligjërimit politik e publik, shprehte një model perceptimi të shqiptarëve brenda kornizës së dogmës ideologjike komuniste. Vetë ndryshimi gjeopolitik pas viteve ‘90 po krijon mundësi të reja lëvizjeje të njerëzve e bashkë me ta edhe të vetë gjuhës, e cila po del prej enklavave tradicionale, duke kapërcyer pengesat e dikurshme, që vinin nga izolimi i kufijve politikë e demografikë. Pra, ashtu si gjithëgjuha edhe standardi aktual, i parë në përgjithësi si gjuhë e shtetit, shkollës dhe medias, është vënë ‘në provë’ përballë sfidave të një zhvillimi të brendshëm drejt një shoqërie në proces urbanizimi, i cili po shpërfaqet në ligjërimitin zyrtar politik e publik në shkallë të gjerë, por gjithaq i hapur edhe ndaj teknologjisë, gjinive letrare, përkthimeve etj.

Në ndërkohë, këto ndryshime politike e shoqërore pas viteve ‘90 e hapën shoqërinë shqiptare ndaj globalizmit, gjë që është shoqëruar edhe me një trysni të madhe të fjalëve dhe strukturave të huaja në gjuhën shqipe, herë të dobishme e herë të dëmshme, duke krijuar ndonjëherë në komunikim situata shprehëse të një mbivendosije gjuhësore me pasoja mbi ligjërimitin standard e më gjerë në gjithë gjuhën shqipe. Këto fakte shpjegojnë qartë se sa i ngjashëm është krahasimi me mësimdhënien e gjuhës amtare në shoqëri përreth nesh, por gjithaq ato tregojnë edhe se sa i ndryshëm është realiteti gjuhësor në arealin gjuhësor shqipfolës. Prandaj është e rëndësishme që nga këto realitete të përveçme të orientohet problematika e edukimit gjuhësor në lëndën e Gjuhës shqipe. Në funksion të këtij realiteti të gjendjes së sjelljes gjuhësore është e nevojshme të konceptohet edukimi gjuhësor i cili, në lëndën e Gjuhës shqipe, më së pari duhet të zgjidhë në programin e saj peshën e raportit të përvetësimit të standardit të gjuhës shqipe, si e tillë përpos peshës që duhet të marrë

përvetësimi i koncepteve gjuhësore, pra i metagjuhës. Jo vetëm kaq, por edhe se si mund të rregullohet ky raport në programet lëndore në varësi të rritjes moshore në sistemin parauniversitar.

Jemi të mendimit se në përputhje me rritjen moshore në ciklet shkollore, kurrikula lëndore e Gjuhës shqipe është e nevojshme të harmonizojë në programin e lëndës raportin për sa i përket procesit të përvetësimit të gjuhës standarde, nga njëra anë me atë të metagjuhës, nga ana tjetër. Në ciklin fillor dhe të mesëm të ulët duhet të dominojë programi që synon mësimin e gjuhës natyrore, rregullat e drejtshkrimit, mësimin praktik të tyre përmes veprimtarive didaktike të diktimit masiv, hartimit, esesë e, sidomos, të të lexuarit të letërsisë në gjuhën shqipe. Pra, konceptet e metagjuhës është mirë të kalojnë në plan të dytë, krahasuar me mësimin praktik të gjuhës në variantin shtetëror zyrtar në tërë shtrirjen e saj.

Në këtë fashë moshore hidhen bazat e përvetësimit dhe të mirëpërdorimit të gjuhës, nga njëra anë, por gjithaq edhe vetë zotërimi si duhet i gjuhës amtare krijon gjasa për një vetëdije gjuhësore, e cila ndih më natyrshëm (dhe jo të mësuarit në mënyrë mekanike, siç ndodh shpesh) në përvetësimin e koncepteve gjuhësore, pra të metagjuhës. Për këtë arsye është gjithashtu e nevojshme të ndërmerren studime psikolinguistike dhe sociolinguistike që t'i trajtojnë këto çështje për të ofruar zgjidhje konkrete me rekomandime të mbështetura shkencërisht për të mënjanuar një përvetësim mekanik e jo natyror të gjuhës. Nga ana tjetër, për vetë kohën e shkurtër, kur po zbatohet standardi i njësuar, sipas nesh, është e dobishme të ndërtohen strategji mësimore të gjuhës shqipe, të cilat përfshijnë gjithë sistemin tonë arsimor deri në universitet, pavarësisht nga orientimet disiplinore. Nëse për dy-tri dekada punohet fort me këtë orientim në lëmin e gjuhës, atëherë njësimi i standardit me shtrirje të gjerë në gjithë arealin shqipfolës sa më pranë gjithë gjuhës, pasurimi i tij dhe afrimi me gjuhën në përdorim është i mundur më lehtësisht. Një komb me dy shtete dhe me standard të ri, ende të pashtirë e njësuar në gjithë arealin shqipfolës, kërkon një planifikim gjuhësor *ad hoc*, sikundër kanë vepruar e veprojnë edhe kombe të tjera, edhe pse me standarde gjuhësore më të vjetra e më të ngulitura se ky yni.

3. Shqipja standarde dhe gjuha në përdorim

Si dhe në gjuhë të tjera, në arealin shqipfolës gjuha shqipe përthyeret në një mozaik ligjërimor standard, por edhe me një shpërfaqje dialektesh, sociolektesh e ligjërime të tjera, të cilët kanë veçori të dallueshme nga njëra trevë te tjetra apo edhe nga njëri grup shoqëror te tjetri. Qysh në moshën e përftimit të gjuhës fëmija fillon e përshtatet me këtë realitet gjeolinguistik. Deri në moshën 6-7-vjeçare ‘gjuha’ e tij është në harmoni të plotë me ‘gjuhën’ e familjes, të fqinjëve, të qytetit ku jeton. Por, me hyrjen në shkollë kjo moshë fillon përballet me të ashtuquajturën ‘diglosi brendagjuhësore’, ku fëmija gjendet në mjedise gjuhësore të ndryshme, brenda së njëjtës gjuhë, si: idioma familjare e përrethësisë, nga njëra anë, dhe idioma e standardit që mësohet në shkollë, nga ana tjetër. Midis gjuhës së rrethinës dhe gjuhës së shtetit a standardit shqipfolësit fillojnë të ndërtojnë atë që quhet gjuhë në përdorim. Me gjuhë në përdorim kuptojmë mënyrën si përdoret gjuha nga folësit në një fazë të caktuar kohore e hapësinore, parë kjo si produkt i një procesi dinamik të marrëdhënies së vetë standardit me varietetet e gjithëgjuhës brenda arealit shqipfolës.

Në vitet e para të shkollimit nxënësi e ka shumë të vështirë të bëjë një dallim të qartë midis këtyre dy realiteteve, gjë që shoqërohet hera-herës me një ‘konfuzion gjuhësor’, i cili mund të sjellë si pasojë pasiguri, ankth etj., duke krijuar situata të një hiperkorrektimi gjuhësor apo të një përzierjeje gjuhësore ndërshtresore që, në disa raste, e nxjerrin fëmijën nga gjendja e tij natyrore e përdorimit të gjuhës. Gjendjet gjuhësore paraqesin ose jo konflikt

te nxënësit varësisht distancës që ekziston midis gjuhës së shtetit dhe gjuhës së qumështit si dhe mënyrës se si shkolla i harmonizon këto realitete gjuhësore për të qenë frytdhënëse në përvetësimin e gjuhës amtare prej nxënësit.

Çështja që po shtrojmë është se si mund të ndërtohet një proces mësimdhënieje, i cili të marrë parasysh këto kontekste gjuhësore ku ndodhen nxënësit, të cilat janë specifike në varësi të trevave shqipfolëse, ndërsa norma e standardit është një e vetme. Pra, procesi i edukimit gjuhësor do të ndërtohet mbi përvetësimin vetëm të standardit, duke mos e marrë parasysh idiomën dialektore apo ligjërimi të tjera përreth, si dhe duke zbatuar një metodologji përjashtuese a diskriminuese për to, si të ishin gjuhë me prestigj të ulët apo deficitar kundrejt këtij standardi, i cili mbahet si gjuhë prestigji, apo ky proces përvetësimi i standardit gjatë mësimdhënies do të realizohet duke u përqasur me dialektin dhe trajta ligjërimore të tjera pra, në ‘fqinjësi të mirë’ me to? Dhe këtu nuk e kemi thjesht fjalën për dhënien e disa njohurive metalinguistike mbi dialektet, pasi kjo gjë realizohet deri diku edhe në tekstet aktuale.

Pyetja që shtrojmë është se çfarë t’u mësojnë në shkollë fëmijëve: vetëm standardin, gjuhën e institucioneve apo në mënyrë krahasuese e dalluese, duke e shoqëruar mësimdhënien me një proces vetëdijeje për dialektet, variantet dialektore apo sociolektet pra, gjuhën e përrethësisë. Si kudo, në shoqëritë e zhvilluara, në shkollë synimi kryesor është të mësohet standardi si gjuhë komunikimi, si gjuhë e shtetit dhe e gjithë piramidës institucionale shtetërore. Por për shoqëritë në proces njësimi, ku ndodhet areali shqipfolës, është e nevojshme të mos lihet jashtë vëmendjes së edukimit gjuhësor pjesa tjetër e natyrshme, e përditshme, gjenetike e gjuhës, që është dialekti, e folmja, sociolekti pra, ‘gjuha tjetër’ në përdorim. Vetë standardi i shqipes nuk është një proces i përfunduar. Përpos kësaj edhe në vetvete ai është një proces dinamik zhvillimi. Nga ana tjetër, shkollimi me fokus vetëm standardin, duke lënë mënjanë a diskriminuar këtë pjesë po aq vitale të vetëdijes gjuhësore, e cila është po aq gjuhë amtare në përdorim, krijon gjasa për deformimin e përvetësimin të gjuhës natyrore në tërësi si dhe ka mundësi që, në disa drejtime, të shpërqendrojë lidhjen e qenësishme që ka fëmija me realitetin përreth nëpërmjet idiomës natyrore. E folmja familjare, dialektore fillon me qumështin e nënës dhe e rrit fëmijën në harmoni me mjedisin përreth. Me anë të saj ai shenjëzon rrethinën dhe vetveten, i sjell ato në kodin e gjuhës së vet natyrore. Ndaj mendojmë se për shoqëri të panjësuar sa duhet nga pikëpamja urbane, integritet të territorit dhe kohezionit social, me standard në proces njësimi e shtrirjeje, siç është rasti i arealit shqipfolës, aty ku ka dallime të rëndësishme midis idiomës së standardit dhe të folmes së rrethinës, ndërtimi i një procesi mësimdhënieje vetëm në standard, me shikëputje të menjëhershme nga ky ‘kontekst shenjor’ ekzistues, sjell dëm në hapësirën perceptuese të fëmijës. Në mbështetje të këtij argumenti vjen edhe vetë realiteti ynë historik, kur kemi gati 5 dekada që janë vendosur rregullat e drejtshkrimit dhe vetëm prej tri dekadash shqiptarët komunikojnë lirshëm me njëri-tjetrin. Realiteti gjuhësor gjeopolitik i shqiptarëve i para viteve ‘90 në trevën kombëtare nuk ka ushqyer një përshpejtim të shtrirjes së njësimin të standardit. Shqiptarët janë ende në një proces unifikimi gjuhësor, *ipso facto* edhe kombëtar, që do të thotë se lëvizjet standard-dialekt-sociolekt etj., për shkak të lëvizjeve demografike, janë qartazi sot në një kahje konvergjente, por brenda një diversiteti ende mjaft të ndjeshëm. Kjo është arsyeja përse norma e standardit është e nevojshme të kundrohët nga këndvështrimi dinamik i zhvillimit të tij, por edhe të marrëdhënies që ky standard krijon me pjesën tjetër të gjuhës gjatë përdorimit të tyre prej folësve.

Në të kundërt, një ndarje e prerë, duke konceptuar një tekstologji dhe një proces mësimnxënieje të natyrës ngurtësisht preskriptive, pra të orientuar vetëm te standardi, jo vetëm që dëmton botëkuptimin tërësor të fëmijës, por edhe e mban atë në një gjendje

Materialet e punimeve (proceedings)

ISBN: 978-1-78911-007-4

vetëdijeje hiperkorrektuese, në një ankth gjuhësor, në pasiguri e dyshim të përhershëm, duke e bërë të pavendosur për të kuptuar e dalluar se në cilën gjendje gjuhësore ndodhet: në standard, në ‘gjuhën tjetër’ apo edhe andej, edhe këtej. Mënyra më e mirë për të mësuar standardin është duke mos ia mohuar të folmen e përditshme nëpërmjet një qortimi hiperkorrektues, por duke e krahasuar atë me ‘gjuhën tjetër’ si dhe duke e pasuruar standardin me prurjet e saj, në kontekstin e gjuhës në përdorim.

Në këtë mënyrë fëmijëve u garantohej në radhë të parë universi i plotë perceptiv e receptiv, ruhet bashkëveprimi me gjithëgjuhën në larminë e varianteve të saj, por njëkohësisht vetëdijësohen më qartazi se kur gjenden në standard e kur ndodhen në ‘gjuhën tjetër’. Sipas krahinës, aty ku këto dallime janë më të theksuara, mësuesi orienton edhe procesin e mësimit të standardit nëpërmjet krahasimit me këtë kontekst gjuhësor. Prej ciklit parashkollor e në vijim me klasat e para, të dyta e kështu me radhë, ky proces bashkëveprimi e dallimi mund të zgjerohet jo vetëm në fushën e fonetikës e të drejtshkrimit, por edhe të gramatikës, të leksikut etj. Kjo qasje bashkëvepruese garanton mbi të gjitha moskufizimin e kodit të shenjave të përfaqësimit përballë tërësisë së sjelljeve natyrore në hapësirën perceptuese, pikërisht atë çfarë e shoqëron në mënyrë natyrore nxënësin, prej shtëpisë deri në shkollë dhe në gjithë përrethësinë mjedisore.

Në përfundim mund të themi se mësimi i standardit nuk mund të jetë plotësisht frytdhënës nëse ai realizohet jashtë vetëdijes së bashkëveprimit me gjithëgjuhën, pra duke lënë mënjanë formimin e vetëdijes për gjallimin e ligjërimeve të tjera, e ca më pak, vështrimin e tyre si të ishin tabu a gjuhë tjetër. Lidhur me edukimin gjuhësor në shkollë De Mauro do të shprehej se ‘thelbësore është të mos u kërkojmë fëmijëve të flakin tutje si diçka të fajshme atë çka ka qenë mënyra e tyre e parë e të folurit... Duhet të mbajmë parasysh këtë fakt: kur të na duhet t’ia mësojmë standardin (fëmijës, *shën. ynë*) le t’ia mësojmë pa u dhënë thupra duarve. Në lëmë të gjuhës, thuprat bëjnë efektin e kundërt’.

Për më tepër, duke qenë se jemi një shoqëri me standard gjuhësor të ri, ende të pangulitur e të panjësuar sa dhe si duhet në gjithë trevën shqipfolëse, ndarja e prerë me ‘thikë’ e tij nga pjesa tjetër e gjuhës së rrethinës është jo vetëm e padobishme, por edhe tepër e dëmshme. Gjuhët standarde në proces standardizimi dhe të ndodhura në kontekste geopolitike si shqipja e kanë jetike lejimin e varianteve gjuhësore, kryesisht tek fjalësi, pasi kështu folësit nuk trysnohen drejt tabuizimit, por priren më me vetëdije drejt mundësisë përzgjedhëse sipas kontekstit ku ndodhen. Vendimmarrja preskriptive për njësimin e rregullave të drejtshkrimit në vitin 1972 nuk nënkupton se gjuha standarde është e njësuar, pasi ky është një proces që kërkon një planifikim gjuhësor për t’u shtrirë në gjithë arealin shqipfolës. Përpos kësaj, vetë ky standard nuk mund të jetë një koine statike, e dhënë njëherë e përgjithmonë. Si dukuri gjuhësore dinamike, standardi është vetëzhvillues *sui generis*, por gjithashtu bashkëveprimi me larminë e ligjërimeve në procesin e mësimdhënies krijon me shumë gjasë vetëdije më të plotë për dallimet midis tyre e përvetësim më të mirë të tij sesa një proces mësimdhënijeje që e mban larg këtë pasuri gjuhësore prej standardit, si për ta ruajtur atë prej ‘ndikimit të dëmshëm’ të këtyre ligjërimeve. Një mësimdhënie bashkëvepruese jo vetëm ndikon për mirë për t’u shndërruar gradualisht në gjuhë në përdorim, por edhe qartëson gjithashtu më mirë në vetëdijen e përdoruesve nivelet e komunikimit të gjuhës së shtetit, shkollës dhe mediave në raport me gjuhën tjetër të përrethësisë.

Prirjet drejt një purizmi të skajshëm të variantit standard në procesin e mësimdhënies, i zbatuar në një hark kohor prej pesë dekadash nga Kongresi i Drejtshkrimit dhe vetëm tri dekada prej ndryshimeve të mëdha politiko-shoqërore, kanë qenë e vijnë jo shumë frytdhënëse për të mbërritur më shpejt te një standard më afër gjuhës në përdorim, me kahe

për t’u njësuar në gjithë trevën shqipfolëse. Mbajtja në distancë e standardit prej idiomës dialektore dhe varianteve të tjera ligjërimore me shumë gjasë ka ndikuar e mund të vijojë të ndikojë më tej në kufizimin e aftësisë perceptuese dhe të vizionit të shqipfolësve mbi botën e tyre, ashtu si edhe në afrimin e tyre drejt gjuhës në përdorim në shkallë të gjerë, por ky pohim ka ende nevojë të verifikohet me studime në terren në fushën e psikolinguistikës, sociolinguistikës, filozofisë së gjuhës, etnolinguistikës etj.

Për sa parashtriam më lart, duke marrë parasysh vetë problematikat njësuese të standardit aktual në gjithë hapësirën shqipfolëse, jemi të mendimit gjithashtu se është ende herët për të ndërmarrë një reformë standardizuese me spektër të gjerë, sa kohë që trojet nuk kanë arritur një unifikim gjeopolitik e publik me frekuencë të lartë. Në gjendjen e sotme shqiptarët me gjuhën e tyre, bashkë me mallrat e idetë, perceptimet mbi botën brenda enklavave të territorit përkatës, janë ende në ‘kërkim’ të njëri-tjetrit dhe në një qarkullim spontan, hera-herës kaotik. Shkolla, media si dhe gjuha administrative nuk po e ‘thyejnë’ me fuqinë e duhur barrierën e enklavës gjuhësore brenda territorit indigjen dhe nuk po e mbajnë ende dot barrën e kësaj shpërfaqjeje gjeopolitike në kontekstin e ri gjuhësor. Ndaj edhe çështja e standardit është sa përgjegjësi individuale e folësve, shkollës, medias, studiuesve, por gjithaq edhe përgjegjësi e institucioneve shkencore, që merren me gjuhën, siç janë edhe departamentet tona. Por kjo përgjegjësi është medoemos e shtetit, i cili e ka ‘gjuhën e vet’ të komunikimit në tërë shtrirjen e marrëdhënieve shtetërore e publike. Kurse në rrafshin gjeopolitik të shqiptarëve kjo është një përgjegjësi kombëtare ndërshtetërore, duke përfshirë shqiptarët edhe aty ku janë pakicë kombëtare e në diasporë.

Për të harmonizuar këto nivele përgjegjësie është më e udhës që qasjet mbi shqipen të bëhen nisur nga këndvështrimi i rezultateve të kësaj ecurie gjuhësore në kushtet e reja gjeopolitike dhe sfidave të përbashkëta kombëtare për të ardhmen. Shoqëria jonë po vetëdijësohet se, në vend të shpërfaqjeve të diletantizmit shkencor, të euforisë nacionaliste apo të egocentrizmit krahinorist, është e nevojshme të kemi sa më shumë studime që mbajnë parasysh dinamizmin e gjuhës në realitetin gjeopolitik aktual, duke zbatuar metodologjinë shkencore që merr parasysh faktorët brendagjuhësorë dhe jashtëgjuhësorë, në mënyrë që eksperimentet parashkencore, që gëlojnë nëpër qarqe ‘gjithologësh’, të mbudhen drejt laboratorit të vetë shqipes natyrore.

Referenca

- ASH e RPSSH, Fjalor i gjuhës së sotme shqipe, Tiranë, 1980.
 ASHSH, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Fjalor i shqipes së sotme, “Toena”, Tiranë, 2002.
 Bussmann H., Lexikon der sprachwissenschaft, digjitalizuar, 2008.
 De Mauro T., ‘Disa konsiderata mbi politikat gjuhësore’, si dhe ‘Mbi gjuhën dhe edukimin gjuhësor, në Dukuri të shqipes bashkëkohore, 5-8 tetor, 2005.
 Demiraj Sh., Shqipja e sotme letrare në prag të shekullit XXI, GjJ, 1-4, 1998.
 Dhrimo A., Memushaj R., Fjalor Drejtshkrimor i Gjuhës Shqipe, infobotues, Tiranë 2015.
 Haugen E., Language Planning in Modern Norway. De Cruyter Mouton, 1968.
 Hobsbawm E.J., Nazioni e nazionalismi dal 1870, Einaudi, Torino, 1990.
 Françoise Th., La langue de bois, Commentaire Julliard, 1987.
 Ismaili R., Drejtshkrimet e shqipes, Tiranë, ASHA, 2021.
 Konferencë gjuhësore: Shqipja në etapën e sotme: Politikat e përmirësimit dhe të pasurimit të standardit, Durrës, 2010.
 Kostallari A., Gjuha e sotme letrare shqipe dhe disa probleme të drejtshkrimit të saj, Tiranë, 1973.
 Lyons J., Hyrje në gjuhësinë teorike, Dituria, Tiranë. 2010.
 Louis Martinez, La langue de bois soviétique, në Commentaire, vëll. 4, 1981-1982.

KONFERENCA E PARË NDËRKOMBËTARE NË GJUHËSI
“Ligjërimiti i shkruar dhe i folur, probleme reale dhe propozime konkrete për zgjidhjen e tyre”

Materialet e punimeve (proceedings)

ISBN: 978-1-78911-007-4

- Nelson G., Description and prescription, University College London, London, UK, Elsevier, Ltd, Encyclopedia of language and Linguistics, 2006.
- Richard A., Sociolinguistika, Tiranë, 1995.
- Rrokaj Sh., Çështje të gjuhës shqipe 1, Albatros, Tiranë, 2007.
- Rrokaj Sh., Çështje të gjuhës shqipe 2, Shkronjë pas shkronje, Tiranë, 2009.
- Rrokaj Sh., Çështje të gjuhës shqipe 3, Shkronjë pas shkronje, Tiranë 2014.
- Rrokaj Sh., Çështje të gjuhës shqipe 4, Pegi, Tiranë, 2018.
- Rrokaj Sh., Çështje të politikave arsimore në Shqipëri, Pegi, Tiranë, 2019.
- Savoia L., Aspekte ideologjike të nacionalizmit gjuhësor, GjJ, 1-2/2003.
- Shamku-Shkreli L., Standard dhe neostandart. Prirje vetëstrukturuese të shqipes së sotme, Çabej, Tiranë, 2007.
- Vebiu A., “Shqipja totalitare: Tipare të ligjërimit publik në Shqipërinë e viteve 1945-1990”, Çabej, 2009.

Gjuha shqipe në Maqedoninë e Veriut, një rrugëtim i gjatë drejt barazisë gjuhësore

DR. TEUTA ARIFI

Katedra për Gjuhë dhe Letërsi Shqipe, Fakulteti Filologjik, UKM, Shkup

Abstrakt

Ky punim ka për qëllim të ofruarit e një konteksti politik, shoqëror dhe historik për sa i përket çështjes së përdorimit zyrtar të gjuhës shqipe në Maqedoninë e Veriut. Kornizën e punimit e përbëjnë teoritë mbi identitetin nga Balibar/Valershtajn/Derrida, si teori moderne e postmoderne të cilat ndërtimin e identitetit gjuhësor e vendosin në kontekstin e formimit të kombit dhe e kontekstualizojnë si identitet bazik në formimin e shtetit-komb, koncept ky i cili i kundërvihet realitetit objektiv të shtrirjes së territoreve shtetërore mbi arealin e më shumë gjuhëve në përdorim.

Përdorimi i gjuhës shqipe në Maqedoninë e Veriut duhet parë në aspektin identitar si diferencuesi kryesor i identitetit të ndryshëm të shqiptarëve nga fqinjët apo bashkëqytetarët e tyre, kurse rruga e mbajtjes gjallë të kësaj gjuhe ndjek fatin e përbashkët të shqiptarëve të cilët pas shpalljes së pavarësisë në vitin 1912 mbetën të jetonin jashta shtetit Shqiptar. Në kontekstin kohor dallojmë tri periudha të përdorimit dhe statusit të gjuhës shqipe tek shqiptarët në Maqedoninë e Veriut, edhe atë: **Periudha e parë**, që nga viti 1945 e njohur si RSM e gjer tek shpërbërja e Federatës Jugosllave dhe shpallja e Maqedonisë së atëhershme si shtet i pavarur. **Periudha e dytë**, që nga shpallja e së Maqedonisë në vitin 1991 e gjer tek lufta e vitit 2001 dhe Marrëveshja Kornizë e Ohrit. **Periudha e tretë**, e cila përfshin vitet e pas Marrëveshjes Kornizë të Ohrit së bashku me legjislacionin dhe praktikën që dalin pikërisht nga kjo Marrëveshje. Në këtë punim analizohet aspekti identitar dhe përdorimi zyrtar i gjuhës shqipe përgjatë dy periudhave të para.

Përdorimi zyrtar i gjuhës shqipe në Maqedoninë e Veriut ka kaluar dhe vazhdon të kalojë në një rrugë sa sfiduese po aq edhe komplekse përgjatë këtyre periudhave të sipërpërmendura. Duke filluar që nga njohja dhe e drejta e përdorimit *de jure* në dokumentet shetërore të Maqedonisë socialiste por me përdorim simbolik *de facto*. Për të vazhduar pastaj me periudhën e pas pavarësisë (1991) gjatë të cilës e fuqishme ishte rezistenca e establishmentit për të pasur përdorim real të gjuhës shqipe si dhe kthim pas nga të drejtat paraprake *de jure*. Dhe për të pasur si përfundim periudhën e pas Marrëveshjes Kornizë të Ohrit, kur përgjatë dy dekadave përdorimi i gjuhës shqipe do të rritet në mënyrë evolutive nga disa ligje të aprovuara përpara ligjit të gjuhës shqipe në fuqi si dhe ligje tjera të cilat prekin në forma të ndryshme përdorimin e gjuhës shqipe.

Dy janë përfundimet kryesore të këtij punimi: si e para, përdorimi i gjuhës shqipe në Maqedoninë e Veriut si karakteristikë identitare e shqiptarëve në këtë vend është kundërshtuar në bazën e konceptit të shtetformësisë konservative monoetnike e cila shtetin e pavarur të Maqedonisë ka mëtuar ta identifikojë si koncept monoetnik identitar dhe gjuhësor, kuptim ky i cili është suprimuar me Marrëveshjen Kornizë të Ohrit. Si e dyta, në fuqi është ligji i fundit për përdorimin e gjuhës shqipe i cili siguron gamën më të gjerë gjer më tani të përdorimit zyrtar të shqipes, por që sfidat e realizimit në praktikë të këtij ligji janë të shumta dhe të natyrës sa juridike, por gjithnjë e më shumë në përdorimin praktik të saj. Prandaj, mbetet e lartë përgjegjësia e institucioneve shtetërore, arsimore dhe shkencore për sa i përket përdorimit në praktikë të gjuhës shqipe në Maqedoninë e Veriut.

Fjalë kyçe: *gjuha shqipe, identitet, institucion, barazi gjuhësore, gjuhë zyrtare.*

Shumësia e identiteteve politike shqiptare – një rezultat i gjeopolitikës

Në proceset e shumta dhe të ndryshme të ndërtimit të identiteteve kombëtare dhe shtetërore do të dallonim më shumë elemente identifikuese dhe veçuese të cilat janë kyçe në formimin dhe identifikimin e kombeve në nivel botëror, dhe shumësia e këtyre karakteristikave arrin me sukses të shkrihet në një identitet fillimisht etnik, duke u ngritur mëtej në një identitet të definuar kombëtar, për të përfunduar këtë proces duke u bërë edhe

identitet shtetëror më në fund. Ndërtimi i identitetit kolektiv kombëtar i shkrirë në institucionalitetin e *shtetit*, në kuptimin e realizimit është dhe mbetet projekt shekullor në realizimin e të cilit marrin pjesë gjenerata të tëra dhe që jo gjithnjë arrijnë të realizojnë këtë synim, meqë shumë gjëra varen nga rrethanat momentale të cilat edhe paracaktojnë rrugën jo të lehtë të popujve dhe kombeve për të mbajtur gjallë ekzistencën e tyre. Apo siç do e definojë Balibar, *projekti dhe fati janë dy figurat simetrike të iluzionit të quajtur identitet kombëtar* (Balibar 1991:86), duke dashur të përafrojë idenë se është iluzion mendimi i një gjenerate se veprimet e saj janë kulminacioni historik i arritjeve në rumbullaksimin e identitetit kombëtar. Përkundrazi, rrugëtimi i gjatë i cili fillon nga një mit dhe përfundon në një realitet institucional është ajo rrugë e gjatë dhe reale e ndërtimit identitar dhe shtetëror njëkohësisht, pra një dekonstruksion i mitit dhe konstruksion i realiteteve (Malkolm, 2020:682).

Po qe se vazhdojmë të ndjekim këtë logjikë të figurave simetrike të projektit dhe fatit, Rilindja Kombëtare Shqiptare arriti të ndërtonte dhe të dimensiononte siç duhet projektin e ndërtimit të identitetit kombëtar, në frymën e shekullit XIX, kur edhe idetë mbi kombin ishin të njësuara me shtetin dhe gjuhën kombëtare. Në kontekstin gjeopolitik të zhbërjes së dy perandorive, asaj Otomane fillimisht dhe asaj Austro-Hungareze më vonë, lindja e shteteve të reja në truallin e Europës Juglindore, jo vetëm që ka për të ndryshuar hartën e këtij rajoni, por gjer në ditët e sotme ka për të mbetur si një fushë e betejave etno-identitare me nëntekst gjeo-strategjik. Dhe nëse në rastin e ndërtimit identitar shqiptar në Rajon projekti për një aktivitet të tillë ishte i përpiluar tanimë, nuk mund të thuhet që fati kolektiv ishte simetrik me Projektin shtet-komb shqiptar në shekullin XIX.

Shikuar nga perspektiva e sotme sikur duket shumë e largët distanca njëshekullore për të shpjeguar dhe kuptuar këtë proces identitar tek shqiptarët në RMV, megjithatë pa pasur pretendime historiciste dhe glorifikuese ndaj kaluarës, përgjigjet kryesore në ndërtimin identitar i gjejmë në fillimet e këtij procesi kaq kompleks, gjithnjë duke pasur në mendje kuptimin që *e kaluara është kryesisht fenomen moral, e më pas është fenomen politik për të përfunduar si një fenomen i përhershëm bashkëkohor.* (Wallerstein 1991:78). Kjo e kaluar historike bartet në të tanishmen reale, në situatat kur ky identitet përpëlitet për të dalë në sipërfaqen e realitetit objektiv shoqëror dhe politik. Pra, duke pasur parasysh këtë të kaluar, identiteti shqiptar projektohet dhe ndërtohet si një identitet i vetëm i cili të drejtën për të ekzistuar si identitet i veçantë e gjeneron nga e kaluara, origjina antike dhe pelazgjike (Vasa, 1989:271), nga një gjuhë dhe konform një gjuhe edhe një alfabeti unik, si dhe nga territori, gjithnjë duke pasur parasysh faktin që Lidhja Shqiptare e Prizrenit si një aktivitet i organizuar politik, i kishte të përcaktuar kufijtë brenda të cilëve do të ndërtohej një autonomi e sistemuar dhe organizuar shtetërore. Është pikërisht ky përcaktim i vijave potenciale të kufijve që përcakton formimin e një *kombi*, një kategori socio-politike e një bashkësie e cila tejkalon kategorizimin vetëm kulturor me të cilin definohet një *grup etnik*. Në këtë proces formësimi identitar të shekullit XIX, ndërtimi i identitetit shqiptar shkon edhe më tej duke ndërtuar formulë edhe sa i përket raporteve me religjionin, gjithnjë duke pasur parasysh faktin e më shumë religjioneve të pranishme brenda botës shqiptare. (Shpuza, 2013). Kombi-shteti, vendoset si binomi suprem mbi të gjitha format e tjera të identitetit, duke planifikuar një shtet i cili do të mundësojë bashkëjetesë institucionale mes religjioneve të ndryshme duke vulosur kështu supremacinë e kombit mbi të gjitha nën-identitetet e tjera të cilat janë pjesë e pandashme e kombit-shtet.

Megjithatë, si pasojë e zhvillimeve në Ballkanin e shekullit XIX të cilat kishin për rezultat formimin e shteteve-kombe që dualën nga Perandoria e shkatëruar tanimë Otomane, si dhe si rezultat i ndikimeve gjeo-politike të kohës të cilat nuk shkuan në favor të realizimit të

Materialet e punimeve (proceedings)

ISBN: 978-1-78911-007-4

projektit të Rilindjes Kombëtare, pas shpalljes së pavarësisë së shtetit shqiptar, pjesa e kombit shqiptar e cila mbeti të jetonte jashta kufijve të shtetit shqiptar do të kalojë një rrugë më se sfiduese jo vetëm në mbrojtjen e identitetit të vet kulturor dhe kombëtar, por edhe në transformimin e këtij identiteti nga një ideal kombëtar në një realitet të identitetit në rrezik brenda shteteve në të cilat ai karakterizohet si një identitet i *tjetrit* dhe si i tillë duhet eliminuar, absorbuar apo asimiluar nga identiteti i kombit bartës të shtetit të ri.

Është teoria e Roxhers Brubejker ajo e cila diferencon tri forma të nacionalizmit si fenomen zhvillimor i Europës së shekullit XIX. Sipas kësaj teorie janë tre lloje nacionalizmi që rezultojnë nga procesi i formimit të shteteve që pasojnë perandoritë e shpërbëra të shekullit XIX, dhe duke ndjekur po të njëjtin parim janë edhe shtetet e reja të cilat dalin si rezultat i shpërbërjes së federatave komuniste, atyre Jugosllave, Çekosllovaqe dhe Sovjetike. Kështu diferencohet *nacionalizmi nacionalizues* i shtetit të sapoformuar dhe ka për qëllim asimilimin e identiteteve që nuk i përkasin identitetit etnik i cili është identiteti bartës i shtetit-komb, mandej *nacionalizmi i shtetit amë* i cili ka për qëllim përkujdesjen, interesimin dhe angazhimin ndaj popullatës me identitet etnik të njejtë por e cila jeton në shtet tjetër, dhe së fundmi *nacionalizmi i minoritetit etnik*, i cili ndërton ekzistencën dhe identitetin e vet specifik ndërmjet këtyre dy koncepteve thellësisht etnike (Brubaker, 1996:20). Sipas kësaj, në shënimet e tij, Brubejker shpjegon se përdor konceptin *minoritet etnik* jo në kuptimin e numrit të këtyre popullatave me identitet të ndryshëm etnik, por për të bërë diferencimin identitar të popullatave të cilat kanë identitet të ndryshëm nga identiteti etnik i popullatës shumicë në shtetin ku jetojnë. Sepse konceptet *shteti nacionalizues*, *shteti amë* dhe *minoriteti etnik*, përshkruajnë qëndrim politik dhe jo fakte etno-demografike.

Në këtë kontekst, rruga e zhvillimit identitar e shqiptarëve në Ballkan u përcaktua nga realiteti i ri politik i vulosur pas Luftërave Ballkanike dhe Luftës së parë Botërore. Sipas kësaj, identiteti shqiptar brenda shtetit Shqiptar u zhvillua dhe ndërtua konform realiteteve dhe rrethanave brenda tanimë shtetit dhe të gjitha sfidave pasuese të shtetndërtimit dhe si i tillë mund të definohet si identitet ekstrovert, ndërkohë që pjesa e kombit shqiptar e cila mbeti të jetonte në tri shtete të sapoformuara sipas konceptit shtet-komb si që ishin Greqia, Serbia dhe Mali i Zi, do të ndërtojnë identitetin e tyre i cili është kryesisht identitet introvert, pra identitet etnik vetëmbrojtës dhe konservues ndaj vlerave etnike. Ky identitet ndërtohet duke u konfrontuar me *nacionalizmin nacionalizues* që tanimë është politikë shtetërore ndaj identitetit shqiptar. Ky projekt i *nacionalizmit nacionalizues* nënkupton ndërtimin e një shteti të një etnosi dhe jo një shteti të qytetarëve që jetojnë në të. *Kombi kryesor* është bartësi i proceseve politike, ekonomike, zhvillimore dhe arsimore të vendit, duke e bazuar të drejtën e sundimit mbi të tjerët në të ashtuquajturën të drejtë historike dhe në padrejtsinë shekullore që i janë bërë dhe që i kompenson duke vendosur sundimin dhe primatin identitar etno-politik mbi identitetet e tjera. Edhe pse sipas këtyre teorive, këto politika asimiluese dhe diskriminuese janë rezultat i dobësisë identitare të shtetit të ri në formën e mbretërisë Jugosllave, megjithatë pasojat mbi ekzistencën reale dhe fizike të identitetit etno-kulturor shqiptar janë të mëdha dhe afatgjata. Duke qenë të përballur fillimisht me dhunën fizike dhe spastrimin e organizuar etnik, si dhe me mungesën totale të një procesi të organizuar arsimor dhe kulturor, identiteti shqiptar në mbretërinë Jugosllave zhvillohet si një identitet i rezistencës popullore, identitet i cili kulturën e vet e konservon nëpërmjet memorjes kolektive historike dhe folklorike, pra një identitet i cili do të rrisë brenda vehtes idetë çlirimtare dhe revolucionare. Raporti i Komisionit Karnegi pas luftërave ballkanike do të dëshmojë edhe një herë këtë koncept të teorive politike moderne, atë që shtet-kombe në Ballkan kanë përdorur si politika nacionalizuese forcën ushtarake për të vendosur në këtë mënyrë primatin e kombit-

Materialet e punimeve (proceedings)

ISBN: 978-1-78911-007-4

shtet, kombit bartës të sovranitetit dhe shtetësisë, kombit i cili sundon mbi të tjerët dhe imponon identitetin etnik të tijin mbi të tjerët pa zgjedhur metodat për të realizuar këtë qëllim. (Carnegie Endowment for International Peace, 1914).

Shqiptarët në Mbretërinë Jugosllave përgjatë disa dekadave zhvillojnë një identitet të përbashkët etno-social dhe etno-kulturor i cili siç nënvizuar më sipër është një identitet kolektiv i rezistencës e cila nuk ka institucione për të rezistuar përveç se memorjes kolektive, ashtu si që edhe ka shumë pak hapësirë për të ndërtuar vepra e vlera kulturore me të cilat identifikohen të gjithë shqiptarët pavarësisht rajonit se ku jetojnë. Politikat e Mbretërisë Jugosllave janë specifike veçanërisht kur janë në pyetje shkollat në të cilat mësojnë shqiptarët. Janë këto politika sipas të cilave jo vetëm që mësohet në gjuhën serbe, por njëkohësisht përdoren programe specifike arsimore për të bërë të pranueshëm nënçmimin, fyerjen dhe asimilimin e identitetit shqiptar (Banac, 1984:280). Vepra letrare e Esad Mekulit, përkatësisht poezitë e tij të viteve 30’, përfaqësojnë këtë identitet shprehës sa i përket ideve kolektive që do të artikulohej në të ardhmen. (Mekuli, 1989).

Të kthehemi edhe një herë tek teorinë e Brubejkerit, përkatësisht tek definicioni i *nacionalizmit të shtetit amë*, pra, siç definojnë ai politikat e shtetit i cili ka identitetin e njëjtë etnik me popullatën e cila jeton jashta kufijve të tij. Në kuptimin identitar brenda shtetit shqiptar ndërtohet kuptimi për një pjesë të trungut identitar i mbetur jashta kufijve të shtetit shqiptar dhe në kuptimin territorial, identitar dhe gjuhësor kjo pjesë e munguar identifikohet me Kosovën. Ky kuptim ndërtohet në memorjen kolektive në Shqipëri si vlerë nostalgjike dhe folklorike, ku madhërohet rezistenca e popullatës kosovare. Gjithnjë shikuar sipas kësaj teorie, është ky nacionalizëm i shtetit amë ai i cili reagon i pari në situatat kur identiteti i kombit i cili jeton në shtetin tjetër është i rrezikuar nga metodat ekstreme të nacionalizmit nacionalizues (Brubaker, 1996:34). Megjithatë, mundësitë e shtetit të ri dhe të brishtë shqiptar janë tejet modeste për të vepruar në drejtim të ndonjë ndryshimi statutar të popullatës shqiptare jashta Shqipërisë në këto vite turbulencash dhe stabilizimi të aparatit shtetëror përbrenda vetë shtetit Shqiptar.

Një rikonfigurim të identitetit etnik shqiptar të popullatës jashta shtetit shqiptar kemi me fillimin e Luftës së Dytë botërore, rikonfigurim ky i cili përbën edhe shkakun e shumësisë së identiteteve politike shqiptare pas vitit 1945. Pas fillimit të Luftës së dytë botërore dhe aneksimit të Shqipërisë nga Italia fashiste, ndodh edhe rikonfigurimi territorial i shtrirjes së kufijve në lindje duke përfshirë brenda shtetit shqiptar një pjesë nga vendbanimet me shumicë shqiptare të mbetura nën mbretërinë Jugosllave. Me formimin e qeverisë së Mustafa Krujës në vitin 1941, do të themelohet edhe *Ministria e Tokave të Liruara*, (Lita, 2022) me ministër Eqrem bej Vlorën, dhe me vendim qeverie do të hapen 116 shkolla fillore kombëtare në këto vende, që përbën edhe fillimin e parë të shkollimit në gjuhën shqipe në vendbanimet jashta Shqipërisë së 1912-tës. Hapja e shkollave do të pasohet me hapjen inspektorateve në pesë qendra edhe atë: në Prizren, Pejë, Prishtinë, Tetovë dhe Dibër të Madhe, me qëllim të kontrollimit dhe mbarëvajtjes së procesit edukativo-arsimor. Ministri i asokohshëm i arsimit, Ernest Koliqi, drejtohet me një qarkore të gjitha institucioneve arsimore duke kërkuar angazhimin e *shpirtit të sakrificës për këtë detyrë historike* (Lita, 2018). Edhe pse funksionuan për katër vite jo të plota këto shkolla kishin një rol të veçantë në ndërtimin identitar dhe ndërtimin e vetëdijes së përkatësisë etnike. Pas tri dekadash identitet etnik i memoruar dhe folklorik, këto shkolla krijojnë mundësinë e parë për fillimin e një identiteti institucional dhe krijimin e një memorjeje kolektive institucionale, apo sipas teorisë moderne mbi identitetin, krijimin e një psikologjie kolektive e cila është parakushti për të kaluar nga kategoria kulturore e etnosit në nocionin politik të kombit.

Edhe pse studimet shkencore e konsiderojnë shekullin XIX si shekulli i krijimit të shtetit-komb dhe si i tillë ky proces llogaritet i rrumbullaksuar me shekullin XX, procesi identitar në Ballkan mbetet një proces i cili rrugëtimin e vet nuk llogaritet ta ketë përfunduar as edhe në ditët e sotme. Jo vetëm për arsyen që shtetet të cilat dualën nga Perandoritë e shpërbëra nuk pasqyruan realitetet etnike, por edhe për shkak të zhvillimeve të përmasave botërore, rezultatet gjeostrategjike të të cilave u përthyen në forma të ndryshme mbi popujt dhe shtetet e Ballkanit, duke ndikuar në riformësimin, rindërtimin dhe stratifikimin e më shumë elementeve në identitetet e popujve të Ballkanit. Një proces i tillë, me pasoja komplekse identitare është jo vetëm periudha e Luftës së dytë Botërore si e tillë, por rezultati që prodhoi periudha e pasluftës për Ballkanin dhe Europën në kuptimin identitar dhe ideologjik. Kryeministri britanik, Winston Çerçil, ishte i vetëdijshëm që duke ndërtuar koalicionin me Stalinin po zgjidhte të keqen më të vogël në kuptimin e të ardhmes së Botës Demokratike, ashtu si edhe ishte i vetëdijshëm se kur para përfundimit të Luftës në bisedimet dypalëshe me Stalinin, gjysma e Kontinentit Europian së Bashku me Ballkanin pa Greqinë, privohej nga e drejta për zgjedhje demokratike dhe këta popuj pa pasur mundësinë e tyre për të vendosur do të mbeteshin për gjysmë shekulli nën regjime diktatoriale komuniste (Kisinxher, 1999:417). Një rast i tillë do të jetë Federata Jugosllave e cila në vitin 1945 konstituohet në kufijtë e përparshëm të Mbretërisë Jugosllave, por tani si Federatë fillimisht Popullore e më vonë Socialiste dhe njëkohësisht bashkësi e gjashtë republikave socialiste dhe dy Krahinave autonome socialiste. Dhë është kjo ndarje federative e cila do të prodhojë fragmentim të ri të identitetit etno-politik të shqiptarëve, pra të Kosovës – sot shtet i pavarur, shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut, shqiptarëve në Mal të Zi dhe shqiptarëve në Luginën e Preshevës. Pikërisht për këtë arsye koncepti i *shekullit të gjatë XIX-të* (Meadwell) i cili fillon me Revolucionin Francez më 1879 dhe përfundon më 1945 me fitoren mbi fashizmin si ideologji apo thënë ndryshe një fitore e mendimit revolucionar dhe liberal mbi konservatorizmin, nuk vlen për vendet europiane të cilat mbetën pjesë e bllokut komunist. Do të duhej edhe një gjysmë shekulli përpjekje për tu afruar deri tek demokracia e cila për popujt e gjendur pa vullnetin e tyre nën diktatura jo vetëm ideologjike por edhe etnike, do të ishte një shans për ndryshimin.

Nga viti 1945 fillon një periudhë e re në Europën Lindore dukë përfshirë këtu Ballkanin me shqiptarët, periudhë kjo gjatë së cilës në këtë pjesë të botës vendoset sundimi ideologjik i Marksizëm-Leninizmit dhe komunizmit mbi trupin e shteteve të cilat kanë brenda tyre çështje të pazgjidhura etnike dhe probleme të thella të natyrës identitare. Logjika, teoria dhe praktika e këtyre sistemeve jo-demokratike dhe despotike në thelbin e tyre, konsiston në abrogimin e temës së çështjes etnike, për ta zëvendësuar të njejtën me ideologjinë komuniste dhe për të vënë çështjen klasore si prioritet të shoqërisë së re dhe barazine klasore si ideal i cili suprimon të gjitha diferencat dhe idealet e tjera. Ideologjia e re erdhi dhe u vendos jo vetëm mbi trupin gjeografik të këtyre rajoneve europiane, por u vendos mbi historitë e papërfunduara në shekullin e XIX, u vendos mbi çështjet kombëtare të pazgjidhura por të mbuluara sa nga një sundim hegjemonist sa nga ideologji të reja dhe të paprovuara nga këta popuj dhe mbi të gjitha ideologjia komuniste u vendos mbi konflikte latente ndër-etnike të cilat vetëmse u lanë mënjanë për kohëra që do vinin në të ardhmen. Ishte kjo ideologji e cila mbuloi *konfliktin e përhershëm ndërmjet homogjenizimit dhe diversitetit etnik, ndërmjet asimilimit dhe pluralizmit. Që përbëjnë shumën e çështjeve kombëtare.* (Banac, 1990) Megjithatë, edhe përkundër ideologjisë në rastin e Federatës Jugosllave ashtu siç ishte rasti i Federatës Sovjetike, ndarja në njësi federative u bë në bazat etnike, meqë etnosi ishte identitet i pakapërcyeshëm edhe për ideologjinë. Por qëllimi për të

dobësuar identitetet e veçanta etnike në një identitet të ri *jugosllav*, ishte dhe mbeti qëllim asimilues dhe homogjenizues i kësaj ideologjie e cila përveç luftës klasore në prapavijat e saja kishte dhe asimilimin identitar dhe veçanërisht asimilimin identitar të popujve joslavë, në këtë rast shqiptarët. Në kuptimin entno-identitar formimi i Federatës Jugosllave duhej të shërbente si një *melting pot* për të shkriur identitetet e ndrëshme etnike në këtë identitet të ri etno-ideologjik, gjë që ishte e paradispozuar të dështonte meqë ishte fenomen fare i kundërt me zhvillimin dhe dinamikat reale të kombeve ballkanike. Dhe në kuadër të këtij koncepti, shqiptarët në Republikën socialiste të Maqedonisë do të detyroheshin të akceptonin këtë identitet titoist, (Petiffer, 2001:137).

Në fillim të vitit 1990 Partia komuniste Jugosllave do të mbajë kongresin e fundit të saj të pasuar nga proceset e rradhës së ndarjes së njësisve federale. Pa idologjinë dhe despotizmin e prodhuar nga ideologjia dhe shteti komunist nuk kishte si mbahej një bashkësi e tillë federative. Prandaj edhe nuk kishte si të bëhej një kalim i thjeshtë nga një sistem komunist në atë demokratik pa u kaluar në rrugën e vështirë dhe fatkeqësisht të përgjakshme të risistemimit të çështjeve të pazgjidhura etnike. Nuk kishte qendër balansi dhe rrënimi i Federatës po linte pas vetes një *Armatë Popullore e cila ishte ushtri e armatosur Partiake pa parti dhe një ushtri shtetërore tanimë edhe pa shtet*. (Banac, 1992) Konfliktet e përgjakshme prodhuan shtetet e reja, por njëkohësisht kufijtë e brendshëm të federatës së dikurshme prodhuan dhe identitetet e reja etnopolitike brenda trupit etnik shqiptar. Jo me dëshirën e tyre, por si rezultat i rrethanave politike dhe gjeo-politike, shqiptarët mbeten të ndarë në më shumë entitete dhe kjo do të rezultojë edhe me ndërtimin e identitetit të ri etno-politik të shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut, ndërkohë që gjuha shqipe mbetet shtylla kryesore e këtij identiteti si në kuptimin kulturor, poashtu edhe në atë politik.

Argumenti historik

Themelimi i shtetit të pavarur të Maqedonisë në vitin 1991 gjithësesi që në kuptimin ndërkombëtar do të thoshte edhe një shtet i ri në këtë skenë të madhe politike dhe diplomatike botërore, por në kuptimin e brendshëm themelimi i këtij shteti ishte përplasja identitare e dy identiteteve të cilat në një mënyrë apo tjetrën, për herë të parë gjendeshin përpara sfidave të të bërit shtet. Koncepti identitar maqedonas ishte ai i cili shtetin e ri e trajtonte si të vetin, si momentin historik për të pasur shtetin-komb dhe sfidës identitare që i vjen nga fqinjët i përgjigjet me politikën konservatore dhe nacionalizuese karshi identitetit shqiptar, të cilin e trajton si rrezik dhe si identitet të *tjetrit* në kuptimin lakonian të fjalës. Nga ana tjetër, themelimi i shtetit të ri i shte një sfidë identitare poaq e madhe edhe për shqiptarët në këtë vend, gjithnjë duke pasur parasysh faktin që shqiptarët në Maqedoni nuk kishin pasur ndonjë eksperiencë institucionale, kishin gjetur epiqendrën kulturore tyren tek Prishtina universitare, dhe tani të ndarë dhe privuar nga kjo mundësi duhej të ndërtonin identitetin e tyre duke bërë betejën e tyre politike për gjuhën shqipe dhe qenien e tyre kombëtare në përgjithësi. Duke pasur parasysh këtë sfidë identitare, argumenti kryesor i debatit nga ana e përfaqësuesve shqiptarë ishte se me kushtetutën e Maqedonisë së vitit 1991 shqiptarët privohen nga të drejtat gjuhësore të trashëguara, që d.m.th se të drejtat gjuhësore shqiptare kanë qenë më të mëdha në Maqedoninë socialiste se sa në Maqedoninë e pavarur. Ky opinion duhet shikuar dhe analizuar me kujdes.

A kishin të drejta gjuhësore të trashëguara nga koha e Maqedonisë socialiste shqiptarët? Ishte vallë korpusi i të drejtave të tyre kombëtare më i gjerë? Janë këto pyetje të cilat kërkojnë përgjigje të bazuara në fakte normative dhe në praktikën e jetës së përditshme. Përgjigja do të ishte që mbase deri diku *de jure* sipas Kushtetutës së vitit 1974 po, ndërsa *de*

Materialet e punimeve (proceedings)

ISBN: 978-1-78911-007-4

facto gati se aspak. Dhe kjo na kthen në çështjen reale të raportit mes identiteteve etnike, çështjeve të pazgjidhura kombëtare dhe ideologjisë komuniste. Kjo ideologji erdhi dhe u vendos mbi terrenin e identiteteve etnike në formim e sipër dhe mbi çështjet e pazgjidhura kombëtare me kauzën e barazisë për të gjithë, barazi sociale e cila do të mbisundonte si ideologji dhe do të neutralizonte çështjet identitare etnike. Këtë dëshmojnë edhe dokumentet e para të Republikës Popullore të Maqedonisë dhe Kushtetuta e vitit 1946, e cila nuk ka aspak Preambulën si parahyrje të kontekstit historik por vetëm pjesën e vet normative. Aspektet e përdorimit të një gjuhe tjetër nga maqedonishtja rrjedhin nga normativat kundër diskriminimit të kësaj Kushtetute dhe nuk bëjnë një definim të qartë të nivelit, formës apo mënyrës së përdorimit të gjuhës shqipe.

Pakicat kombëtare në Republikën Popullore të Maqedonisë e gëzojnë të drejtën dhe mbrojtjen e zhvillimit të tyre kulturor dhe të drejtën e përdorimit të lirë të gjuhës së tyre, (Kushtetuta e Republikës Popullore të Maqedonisë, 1946).

Fenomen ky i cili shpjegon natyrën e ideologjisë komuniste e cila kishte mosdiskriminimin deklarativ si formë të shtetndërtimit ndërkohë që aparatit shtetëror e shihte si instrument të shkrirjes identitare, kryesisht të identitetit shqiptar në një amalgam më të madh jugosllav. (Banac, 1990). Ky koncept i unitarizmit socialist i cili është identik me konceptin sovjetik si formë ideologjike e shkrirjes identitare të shumë popujve josllavë në BRSS do të vijojë të jetë në fuqi deri në vitin 1974. Në rastin e Maqedonisë, ky koncept manifestohet në Kushtetutën e viti 1963, kur kjo njësi federative riemërohet nga Republikë Popullore në republikë socialiste të Maqedonisë. Për dallim nga Kushtetuta e vitit 1946, kjo kushtetutë ka Preambulën në të cilën edhe përkundër karakteristikave ideologjike komuniste, kjo njësi federative emërohet si shtet i aspiratave historike të kombit maqedonas.

Duke u nisur nga fakti historik që populli maqedonas i udhëhequr nga klasa punëtore me në krye Partinë Komuniste, me luftën e bashkuar me popujt tjerë jugosllavë në Luftën Nacional Çlirimtare dhe Revolucionin Socialist... krijoi shtetin e vet, Republikën Popullore të Maqedonisë, në të cilën realizoi aspiratat historike të popullit maqedonas për liri kombëtare dhe pavarësi shtetërore, të kombësive-pakicave kombëtare për barazi.. (Kushtetuta e Republikës Socialiste të Maqedonisë, 1963, Preambula)

Në këtë kushtetutë poashtu kemi edhe lokalizimin e gjuhës shqipe si gjuhë e pakicës dhe gjuhë e cila përdoret në lokalitete të caktuara në Maqedoninë socialiste dhe sipas kësaj i përcaktohen edhe kufijtë e përdorimit të kësaj gjuhe.

Në komunat, përkatësisht në rrethet brenda territorit të të cilave jetojnë një numër i madh i anëtarëve të kombësive-pakicave kombëtare, vendimet dhe aktet tjera të rëndësishme të kuvendeve dhe rretheve botohen në gjuhën e kombësisë-pakicës kombëtare. Të gjithë banorët e zonave të përziara etnikisht në Republikën Socialiste të Maqedonisë, kanë të drejta të barabarta për ta përdorur gjuhën e tyre në procedurat administrative dhe gjyqësore. Mbishkrimet publike në këto zona janë dygjuhëshe. Statuti i komunës, përkatësisht i rrethit, në pajtim me kushtet e rregulluara me ligj përcakton kushte dhe procedura më të afërta që sigurojnë realizimin e të drejtave të pjesëtarëve të kombësive-pakicave kombëtare, (Kushtetuta e Republikës Socialiste të Maqedonisë, 1963, neni 75)

Duhet nënvizuar fakti që në të dy dokumentet e mësipërme, kushtetutat e viteve 1946 dhe 1963 nuk përmendet populli shqiptar e rrjedhimisht as gjuha shqipe, si identitet i veçantë,

por kushtetuta u referohet si kombësi-pakicë kombëtare, gjë që vërteton edhe një herë konceptin e unitarizmit socialist si aparat asimilues i identitetit të ndryshëm identitetit *tjetër*, gati se inekzistent.

Historia e rreth pesë dekadave të shekullit të kaluar dëshmon se fati i gjuhës shqipe në RMV dhe i pozicionimit të identitetit shqiptar në këtë vend ishte ngushtë i lidhur me dinamikën e zhvillimeve politike në nivel të Jugosllavisë dhe ndryshimet statuto-re të përdorimit të gjuhës ishin kryesisht rezultat i ndryshimeve që përcaktoheshin nga turbulencat politike të cilat kishin për rezultat ndryshimet e normativave kushtetuese sa i përket shprehjes së identitetit etnik dhe statusit të gjuhës shqipe. Kështu që unitarizmi jugosllav i shprehur me ideologji dhe masa represive që identifikoheshin me emrin e ministrit të brendshëm Ranković, do të sfidohet fuqishëm nga forcat intelektuale dhe politike që promovonin decentralizim të federatës, procese të cilat do të prodhojnë kushtetutë të re federative dhe rrjedhimisht kushtetutë të re republikane në Maqedoni në vitin 1974.

Duke qenë se trendi politik i këtyre viteve ishte një lloj kohabitimi me idetë dhe presionet liberale që kryesisht vinin nga Veriu i federatës, kjo ndjehet edhe në tekstin kushtetues të RSM-së nga viti 1974. Në preambulën e këtij teksti për herë të parë kur flitet për sovranitetin e Maqedonisë në kuptimin etnik, përveç kombit maqedonas si bartës kryesor i kësaj të drejte historike shënohen kombësitë shqiptare dhe turke të emërtuara si kombësi dhe jo si pakica etnike.

Kombi maqedonas, së bashku me kombësitë e Maqedonisë, në Luftën e përbashkët Nacionalçlirimtare me kombet dhe kombësitë e tjera jugosllave, krijuan Republikën Socialiste të Maqedonisë, si shtet kombëtar i kombit maqedonas dhe shtet i kombësisë shqiptare dhe turke në të, në të cilin u realizuan aspiratat historike të kombit maqedonas për liri kombëtare dhe pavarësi shtetërore, të kombësive për barazi dhe të klasës punëtore dhe të të gjithë njerëzve punonjës për një shoqëri socialiste..., (Kushtetuta e Republikës Socialiste të Maqedonisë, 1974, Preambula).

Me këtë kushtetutë zgjerohet juridikisht sfera e përdorimit të gjuhëve në zona dhe komuna, dhe si një moment i ri përdorimi i gjuhës në komunikim me organet shtetërore. Poashtu është i dukshëm deklarimi për të garantuar përdorimin e lirshëm të gjuhës nga këto kombësi-etnitete.

Në zonat ku jetojnë pjesëtarët e kombësive, në jetën publike dhe shoqërore, gjuhët dhe alfabetet e kombësive janë të barabarta me gjuhën maqedonase. Në komunat ku jetojnë pjesëtarët e kombësive, vendimet dhe aktet e tjera të rëndësishme të këshillave komunale dhe të organizatave të punës së bashkuar dhe të organizatave tjera vetëqeverisëse, publikohen në gjuhët e kombësive. Mbishkrimet publike në këto zona janë gjithashtu edhe në gjuhët e kombësive. (Gazeta Zyrtare e RSM, Neni 180)

Pjesëtarët e kombësive kanë të drejtë të përdorin gjuhën dhe alfabetin e tyre në realizimin e të drejtave dhe detyrimeve të tyre, si dhe në procedurën para organeve shtetërore dhe organizatave që kryejnë autorizime publike. (Gazeta Zyrtare e RSM, Neni 181).

Çdo kombësi i garantohet e drejta për ta përdorur lirisht gjuhën e vet, për të shprehur dhe zhvilluar kulturën e vet, dhe për të krijuar institucione dhe organizata që i sigurojnë këto të drejta. Komunat dhe Republika kujdesen për zhvillimin e edukimit dhe arsimit, si dhe zhvillimin e shtypit, radios, televizionit dhe veprimtarive kulturore në gjuhën e kombësive. Kombësitë kanë të drejtë të përdorin flamurin e kombësisë së tyre. (Gazeta Zyrtare e RSM, Neni 178).

Materialet e punimeve (proceedings)

ISBN: 978-1-78911-007-4

Një element i ri është formimi i komisioneve për marrëdhënie ndër-etnike dhe proporcionaliteti në përfaqësimin e kombësive në organet e shtetit dhe në institucionin e mbrojtjes territoriale.

Në këshillat e komunave, në territorin e të cilave jetojnë pjesëtarët e kombësive dhe në Kuvendin e Republikës Socialiste të Maqedonisë, formohet komisioni i marrëdhënieve ndër-etnike. Komisioni monitoron dhe shqyrton realizimin e barazisë së kombësive dhe të drejtave të tyre të tjera të përcaktuara me kushtetutë e ligje dhe propozon masa për realizimin e tyre. Në komisionin e marrëdhënieve ndër-etnike zgjidhet një numër i barabartë i pjesëtarëve të kombit maqedonas dhe kombësive shqiptare dhe asaj turke. (Gazeta Zyrtare e RSM, Neni 183).

...Në shtabet, njësitë dhe institucione e mbrojtjes territoriale zbatohet parimi për përfaqësimin më proporcional të pjesëtarëve të kombësive të Republikës, si dhe barazia e gjuhëve dhe alfabetit të tyre. Në njësitë e mbrojtjes territoriale të përbëra nga pjesëtarët e kombësive, në komandimin dhe stërvitjen e tyre përdoret gjuha e asaj kombësie. (Gazeta Zyrtare e RSM, Neni 293).

Në praktikën e asaj kohe ky aspekt i liberalizimit kushtetues rezultoi me zgjerim të programeve televizive në gjuhën shqipe si dhe me hapjen e katedrës për gjuhë shqipe dhe Shkollës së Lartë Pedagogjike në Shkup si institucione të vetme universitare me mësim në gjuhën shqipe.

Ashtu siç edhe thamë në fillim, statusi i përdorimit të gjuhës shqipe *de jure* dhe *de facto* është plotësisht i varur nga zhvillimet dhe tendencat politike brenda Federatës, pra atëherë kur këto tendenca kanë qenë më liberale në përgjithësi, më liberale kanë qenë edhe normat juridike të përdorimit të gjuhës shqipe, dhe anasjelltas. Kjo dëshmohet me zhvillimet politike gjatë vitit 1989, kur me ardhjen e S. Milosheviqit në krye të PK në Serbi, filloi projekti hegjemonist serb i cili i përkrahur dhe ndërtuar nga ASHAS, do të prodhojë shpërbërjen e dhunshme të federatës dhe luftë të përgjakshme qytetare. Në këtë drejtim, nëse në nivel federativ ndryshimet kushtetuese rezultuan me suprimimin e autonomive krahinore të Kosovës dhe Vojvodinës, në RSM rezultoi me ndryshimet e kushtetutës republikane të vitit 1974, ndryshime me të cilat u pezullua ajo pjesë e Preambulës kushtetuese e cila edhe popullin shqiptar e bënte pjesë të sovranitetit shtetëror, si dhe u eliminua e drejta për përdorim të gjuhës së kombësive, duke vendosur formulën e përdorimit eksklusivisht të maqedonishtes si gjuhë zyrtare në vend.

Republika Socialiste e Maqedonisë është shteti i popullit maqedonas, e bazuar në sovranitetin e popullit, pushtetit dhe vetë udhëheqjes së klasës punëtore dhe të gjithë personave punëtorë, si dhe të komunitetit socialist vetudhëheqës demokratik të personave punëtorë dhe qytetarëve të popullit maqedonas dhe të barabartë me pjesëtarët e popujve të tjerë dhe popujve që jetojnë në të. (Amandamenti kushtetues LVI për Kushtetutën e Republikës Socialiste të Maqedonisë, 1989).

1. Në Republikën Socialiste të Maqedonisë në përdorim zyrtar dhe publik është gjuha maqedonase dhe alfabeti cirilik. 2. Pjesëtarët e popujve kanë të drejtë ta përdorin lirshëm gjuhën dhe alfabetin e tyre, si dhe ta shprehin dhe zhvillojnë kulturën e tyre, si dhe me këtë të themelojnë organizata. 3. Pjesëtarët e popujve kanë të drejtën e mësimin në gjuhën e tyre, në pajtim me kushtetutën dhe ligjin. (Amandamenti kushtetues LVI për Kushtetutën e Republikës Socialiste të Maqedonisë, 1989).

Gjuha shqipe tanimë jo vetëm që u gjend nën trysni normativo-politike, por njëkohësisht ishte e sulmuar edhe në praktikimin e saj. U hoqën mbishkrimet dygjuhësore, evidenca shkollore u kthye vetëm në gjuhën maqedonase, u mbyllën shumë klasa në gjuhën shqipe në shkollat e mesme profesionale dhe u imponua ndryshimi i toponimeve nga shqipja në maqedonisht në tekstet shkollore, gazetat dhe televizionet e radiot të cilat emitonin programe në gjuhën shqipe. Federata jugosllave e cila kishte filluar jetën e vet reale dhe politike duke deklaruar bashkësinë dhe barazinë e popujve të kësaj federate, po shkatërrohej përgjatë linjave etnike, meqë ideologjia komuniste në shkuarje nuk mbulonte dot çështjet e pazgjidhura kombëtare që rëndonin mbi Ballkanin përgjatë një shekulli të tërë. Në këtë proces të shpërbërjes, Maqedonia e pavarur po e fillonte rrugëtimin e vet me të njëjtën peshë të këtyre raporteve etnike të pazgjidhura dhe me një fragmentim të thellë ndëretnik. Shumica maqedonase vendosi të injoronte këtë fakt, gjë që do të dëshmohej dhjetë vite më vonë me fillimin e konfliktit të armatosur në Maqedoni.

Gjuha shqipe si vlerë themelore identitare e shqiptarëve në RMV

Gjuha, kjo vlerë e jashtëzakonshme dhe e veçantë vetëm për qeniet njerëzore, kjo shprehje e ndjenjave, kjo mundësi komunikimi, kjo gjuhë që ka ashtu si edhe njeriu lindjen dhe vdekjen e vet, jo rastësisht është jo vetëm një nga çuditë inspiruese për të kuptuar njeriun si qenie e veçantë, por njëkohësisht edhe inspirim filosofik që nga antika e deri më sot. Dhe akoma më inspiruese, akoma më provokative në kuptimësitë e gjera teorike është gjithësesi shumësia e gjuhëve, ai dallim mes tyre i cili po aqë sa është i ndryshëm dhe i pakuptueshëm në shikim të parë, mban brenda vetes në çelës të padukshëm komunikimi dhe mirëkuptimi sado të ndryshme mes tyre qofshin ato gjuhë. Është kjo shumësi e gjuhëve e shprehur si *Kulla e Babelit* nga Derrida, ajo e cila sfidon jo vetëm të kuptuarit dhe të komunikuarit, por njëkohësisht sfidon edhe relacionet të cilat ndërtohen mes popujve dhe këto relacione nuk nënkuptojnë vetëm të komunikuarit mes tyre, por edhe relacionet institucionale dhe politike ndërkomunikuese. Në këto relacione gjuhësore specifike mbetet e pambaruara e pakompletuara sepse *Kulla e Babelit* jo vetëm që përshkruan shumësinë e padiskutueshme të gjuhëve, por njëkohësisht pamundësinë për të përfunduar, kompletuar një konstruksion. (Derrida,1985) Në këto konstelacione mitologjike të problematikës së shumëgjuhësisë dhe konfuzitetit të qëllimshëm për të mos u kuptuar me të ndryshmit nga ne, të kërkuarit e rrugëve të mirëkuptimit dhe komunikimit gjuhësor, mbetet një çështje sfiduese po aqë sa është sfidues dallimi gjuhësor dhe kulturor mes popujve.

Sidoqoftë, duke lëvizur nga mitologjia dhe duke ecur nëpër shekuj edhe një herë vërtetojmë faktin e pamohueshëm të krijimit të identitetit komb-shtet në shekullin e XIX dhe gjuhën si pjesë të pandarë të këtij identiteti. Dhe ashtu siç edhe përmendëm më sipër, identiteti gjuhësor shqiptar shkon përtej kufijve politikë të shtetit të atëhershëm shqiptar, dhe me fragmentimet e mëvonshme të viteve 90, bëhet shprehja kryesore identitare për shqiptarët të cilët jetojnë tanimë jo vetëm jashta territorit të Shqipërisë, por edhe jashtë territorit të Shtetit të Kosovës.

Shpërbërja e Federatës Jugosllave rezultoi me formimin e shteteve të pavarura në kufijtë administrativë të republikave të mëhershme socialiste dhe Maqedonia nuk ishte përjashtim nga ky proces. Por ky proces ishte turbulent nëse kemi parasysh konceptet e ndryshme në të kuptuarit të shtetit i cili ishte në krijim e sipër. Parimi politik maqedonas në shtetformimin konsistonte në konceptin e shekullit XIX, pra një shtet-një komb-një gjuhë, duke konceptuar kështu vetëm një komb, atë maqedonas si bartës të sovranitetit shtetëror, parim i cili u sfidua politikisht nga shqiptarët, me argumentimin e të drejtave që i takonin

kësaj popullate sipas dokumentave dhe konventave ndërkombëtare të shekullit XX. Aspekti tjetër me shumë rëndësi në formimin e këtyre shteteve të pavarura kishte të bënte me faktin që shpërbërjet e federatave ishin rezultat i drejtpërdrejtë i rënies së komunizmit, dhe procesi i shtetformimit do të lidhej me zgjedhjet shumëpartiake që duheshin organizuar në këto vende si dhe referendimet të cilat do të duhej të ishin vendimet popullore për të formuar këto shtete. Duke ndjekur këtë dinamikë, formohen edhe partitë e para politike në Maqedoninë e atëhershme, parti politike të cilat kanë parashtesën politike dhe ideologjike, por që janë të ndara përgjatë vijave etnike. Në blokun etnik maqedonas do të diferencohen dy parti politike: LSDM (Lidhja Social Demokrate e Maqedonisë) si parti e blokut të majtë dhe VMRO-DPMNE (Organizata e Brendshme Revoluconare Çlirimtare-Partia Demokratike për Bashkim Kombëtar Maqedonas) si parti politike e blokut të djathtë, ndërkohë që në blokun politik shqiptar do të veprojnë PPD (Partia për Prosperitet Demokratik) si parti më e madhe shqiptare e pasuar nga PDP (Partia Demokratike Kombëtare) si parti më e vogël shqiptare e po të njëjtit blok. Debat i etno-politik shqiptaro-maqedonas bartet tanimë në parlament dhe ky debat i ashpër dhe intensiv i zhvilluar vetëm në gjuhën maqedonase është dëshmi e një beteje identitare. Koncepti politik maqedonas duke imponuar vullnetin etnik në emër të shumicës duke injoruar vullnetin etnik të shqiptarëve dëshiron që nëpërmjet të *nacionalizimit të vonuar të shoqërisë* (Balibar, 1991:88), të vendosë themelet e një shteti që ka vetëm një bashkësi etnike titullare dhe kjo realizohet si me Referendumin për Pavarësinë e Maqedonisë ashtu edhe me votimin e Kushtetutës së Maqedonisë së pavarur. Sipas Preambulës së kësaj Kushtetute është fakt historik që,

Maqedonia është konstituuar si shtet nacional i popullit maqedonas në të cilin sigurohet barazia e plotë qytetare dhe bashkëjetesa e përhershme e popullit maqedonas me shqiptarët, turqit, vllëhtë, romët dhe nacionalitetet e tjera që jetojnë në Republikën e Maqedonisë (Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, 1991).

Edhe përkundër diskutimeve të shumta, intensive dhe të argumentuara të deputetëve shqiptarë në përbërjen e parë të parlamentit të Maqedonisë së pavarur, kjo kushtetutë u votua me shumicën e votës maqedonase duke injoruar vullnetin politik të shqiptarëve të Maqedonisë së viteve 90, vullnet ky i shprehur nëpërmjet antarëve shqiptarë të zgjedhur në zgjedhje demokratike në parlamentin e atëhershëm. Në kuptimin teorik, Ashtu siç përshkruan Brubejker procesin e *nacionalizimit* si një proces të shkrirjes së më shumë identiteteve të ndryshme në një identitet të vetëm etnik si bazament i shtetit-komb, e ngjashme është edhe teoria e Balibar, me faktin që ky i fundit konsideron se kur ky proces kalon kufinj të kohorë thellë në shekullin XX, atëherë është një *nacionalizim i vonuar*.

Gjuhët janë flamujt e popujve të shtypur. Ata nëpërmjet gjuhës shprehin idealet e tyre dhe në gjuhën e vet e kanë armë në luftën kundër robërisë, (Hagege, 1992:12)- fjali kjo e cila përshkruan në një formulim të qartë dhe plastik raportin e shqiptarëve të RMV me gjuhën e tyre. Me shpërbërjen e Federatës Jugosllave, kjo pjesë e popullatës shqiptare mbetej pa një qendër institucionale, kulturore, universitare dhe gjuhësore, rol të cilin e kishte kryeqendra e Kosovës së atëhershme si krahinë autonome dhe si qendër arsimore universitare për të gjithë shqiptarët e ish-Jugosllavisë. Pa asnjë institucion të vetin shkencor apo arsimor të nivelit të lartë (përpos një Katedre për gjuhën dhe një shkolle pedagogjike), popullata shqiptare e këtij vendi kishte vetëm një vijë të fuqishme identitare e cila nuk mund ti shqitej dhe ajo ishte gjuha shqipe. Mundej ti ndalohej përdorimi i flamurit, të minimizohej numri i klasëve në gjuhën shqipe në shkollat e mesme, asnjë mbishkrim të mos ishte në gjuhën shqipe, por ama

nuk mund ti merrej gjuha nga gjuha, kjo thjesht ishte e pamundur. Prandaj edhe gjuha shqipe përbën boshtin identitar të formimit etnik dhe politik të shqiptarëve në këtë vend, si identitet i cili është i vetëdijshëm për ekzistencën e vet dhe mbi të gjitha si identitet supra-klasor dhe supra-religjioz. Rruga e bërë deri më tani gjatë këtyre tri decenieve të ndërtimit dhe zhvillimit identitar të shqiptarëve shënon kalimin nga koncepti i kategorisë kulturore të *grupit etnik*, në kategorinë socio-politike të *kombit*, dhe e tëra kjo si një rrugë akoma e pambaruar në shprehjen dhe nivelet e përdorimit zyrtar të gjuhës shqipe.

Duke pasur parasysh këto fakte të mësipërme është e qartë të mësohet arsyeja identitare e kësaj beteje për gjuhën shqipe. Duke e definuar shtetin si shtet nacional të kombit maqedonas në preambulën e kushtetutës së vitit 1991, dhe gjithnjë duke pasur parasysh faktin që Preambula është pjesë deklarative e Kushtetutës, por ajo që përfundimisht vulos anashkalimin e gjuhës shqipe është pjesa normative e cila idenë e shtetit nacional të një kombi e jetëson nëpërmjet pjesëve normative të kushtetutës të cilat kanë të bëjnë me gjuhën. Këto pjesë normative njohin vetëm një gjuhë zyrtare, atë maqedonase si identitet të vetëm etnik maqedonas i cili me anë të këtyre dispozitave kushtetuese është edhe identitet gjuhësor shtetëror. Sipas nenit 7 të kësaj kushtetute:

Në Republikën e Maqedonisë gjuhë zyrtare është gjuha maqedonase dhe alfabeti i saj cirilik. Në njësitë e vetadministrimit lokal në të cilat si shumicë jetojnë pjesëtarët e nacionaliteteve, në përdorim zyrtar, krahas gjuhës maqedonase dhe alfabetit cirilik janë edhe gjuha dhe alfabeti i nacionaliteteve në mënyrë të përcaktuar me ligj. (Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, 1991, neni 7)

Ky dokument i cili gjuhës shqipe i jep një karakter lokal dhe i cili më tej, sanksionon përdorimin e gjuhës shqipe si gjuhë mësimore vetëm në shkollimin fillor dhe të mesëm, por jo edhe në atë universitar, është dëshmia kryesore e mungesës së vullnetit politik tek bashkësia etnike maqedonase për të vendosur shtetin e ri në themelet e barazisë etnike dhe kulturore si një vlerë themelore e cila do të garantonte jo vetëm përparimin dhe stabilitetin e shtetit të ri, por do të ndërtonte kohezion të brendshëm për një përballje më të suksesëshme me sfidat identitare-gjuhësore që ky shtet kishte me fqinjët e vet, Bullgarinë dhe Greqinë.

Pjesëtarët e nacionaliteteve kanë të drejtë lirisht ti shprehin kultivojnë dhe zhvillojnë identitetin e tyre dhe veçoritë nacionale. Republika ua garanton nacionaliteteve mbrojtjen e identitetit etnik, kulturor, gjuhësor dhe fetar. Pjesëtarët e nacionaliteteve kanë të drejtë të themelojnë institucione kulturore dhe artistike, shoqata shkencore dhe shoqata të tjera me qëllim të shprehjes, kultivimit dhe zhvillimit të identitetit të tyre. Pjesëtarët e nacionaliteteve kanë të drejtë për mësim në gjuhën e tyre në arsimin fillor dhe atë të mesëm, në mënyrën e përcaktuar me ligj. Në shkollat ku arsimit zhvillohet në gjuhën e nacionalitetit mësohet edhe gjuha maqedonase. (Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, 1991, neni 48).

Dhjetë vite të pa marrë vesh

Theksuam që argumenti kryesor i përfaqësuesve politikë shqiptarë në debatin për Kushtetutën e Maqedonisë së pavarur (1991), ishin të drejtat e trashëguara kombëtare sa i përket sovranitetit të vendit, gjuhës shqipe dhe përdorimit të simboleve kombëtare. Nga sa pamë më sipër, këto të drejta lidhen me kushtetutën e vitit 1974, nëse kemi parasysh faktin që para kësaj kushtetute nuk kemi standarde juridike që definojnë barazinë dhe pjesëmarrjen e shqiptarëve në sovranitetin e Maqedonisë, kurse në vitin 1989 kemi abrogimin e këtyre zgjidhjeve kushtetuese. Për këtë arsye lëvizjet shqiptare për të bojkotuar referendumin për pavarësinë e Maqedonisë dhe për të organizuar referendum alternativ për autonomi janë

trajtuar si lëvizje të provokuara nga ngushtimi edhe i këtyre të drejtave deklarative të kushtetutës së viti 1974 (Petiffer, 2001:138). Debati parlamentar për këtë kushtetutë vuri në pah logjikën e ndryshme në të kuptuarit e shtetit në formim, edhe atë ishte ky debat mes dy koncepteve: atij maqedonas i cili kishte mendimin për të krijuar shtetin me identitet monoetnik duke nacionalizuar identitetet tjera në përgjihësi dhe atë shqiptar në veçanti, dhe konceptit politik shqiptar i cili pluralizmin politik dhe demokratizimin e kuptonte si një formë obligative të njohjes së të drejtës për sovranitet, gjuhë dhe simbole kombëtare. Në ato vite kur tanimë kishte filluar lufta qytetare në vendet e ish-Jugosllavisë dhe në kohën kur akoma ishte i fuqishëm ndikimi politik i Beogradit, partitë politike maqedonase dhe përfaqësuesit e tyre në parlament përdorën metodën e mbivotimit për të sjellur kushtetutën e vitit 1991, e cila përveçse nuk kishte sens për kërkesat politike shqiptare, ishte kushtetutë në frymën e amandamenteve kushtetuese të vitit 1989. Kjo frymë duket qartë në tekstin e Preambulës së kësaj kushtetute dhe në nenin 7 i cili rregullon përdorimin e gjuhëve në vend.

Duke u nisur nga trashëgimia historike, kulturore, shpirtërore dhe shtetërore e popullit maqedonas, dhe nga lufta e tij shekullore për liri nacionale dhe sociale, dhe për krijimin e shtetit të vet, e veçanërisht nga traditat shtetërore juridike të Republikës së Krushevës, dhe vendimeve historike të KAÇKM-së dhe kontinuitetit kushtetues juridik të shtetit maqedonas si republikë sovraane në federatën jugosllave, nga vullneti i shprehur lirisht i qytetarëve të Republikës së Maqedonisë në Referendumin e 8 shtatorit të vitit 1991, si dhe nga fakti historik Maqedonia është konstituuar si shtet nacional i popullit maqedonas në të cilin sigurohet barazia e plotë qytetare dhe bashkëjetesa e përhershme e popullit maqedonas me shqiptarët, turqit, vllëhtë, romët dhe nacionalitetet e tjera që jetojnë në RM..., (Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, Preambula, 1991).

Në Republikën e Maqedonisë gjuhë zyrtare është gjuha maqedonase dhe alfabeti i saj cirilik. Në njësitë e vetadministrimit lokal, në të cilat si shumicë jetojnë pjesëtarët e nacionaliteteve, në përdorim zyrtar krahas gjuhës maqedonase dhe alfabetit cirilik, janë edhe gjuha dhe alfabeti i nacionaliteteve në mënyrë të përcaktuar me ligj..., (Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, Neni 7, 1991).

Përgjatë një dekade të konstituimit të Republikës së Maqedonisë, u kalua një proces kompleks i çështjes së emrit të shtetit, kontekst ky i cili zgjati deri në vitin 2017, ashtu si nuk qe e lehtë përballja me kriza të tjera të natyrës politike apo ekonomike. Për fat të keq, edhe përkundër më shumë kërkesave të institucioneve ndërkombëtare, edhe përkundër të më shumë rekomandimeve dhe intervenimeve dashamirëse ndërkombëtare nuk kishte vullnet për të akomoduar të drejtat gjuhësore dhe arsimuese të shqiptarëve në Maqedoni. Kërkesat e artikuluara për të ngiritur në nivele më të larta përdorimin zyrtar të gjuhës shqipe përgjatë periudhës 1991-2001 u refuzuan duke u trajtuar si të rrezikshme për natyrën unitare të shtetit të Maqedonisë, duke qenë se ky shtet mëtonte të ndërtohej si shtet me një gjuhë zyrtare ekskluzive – atë maqedonase. Dhe në fakt, ky unitarizëm i deklaruar si i rrezikuar nga përdorimi zyrtar i gjuhës shqipe kontestohet nga më shumë institucione ndërkombëtare të cilët kishin Maqedoninë nën mandatin e tyre, duke u theksuar që duhet shkruar përtej diskutimit mbi natyrën unitare të shtetit si koncept i maqedonasve dhe ndryshimin e kësaj natyre të shtetit sipas shqiptarëve, për tu angazhuar në një dialog të mirëfilltë lidhur me kërkesat e komunitetit etnik shqiptar. (HCNM, OSCE:1998). Vendimi pas vitit 1992 për të inkuadruar partitë shqiptare si pjesë qeverisëse nuk ishte i parëndësishëm, por, megjithatë ky akomodim qeveritar nuk arriti të krijonte tek shqiptarët ndjenjën kolektive të përkatësisë ndaj institucionit shtet, mes tjerash edhe për shkak të mosnjohjes së përdorimit zyrtar të gjuhës

shqipe si një nga shenjat kyçe të identitetit shqiptar. (Server, 2019:53). Përgjatë këtij dhjetëvjeçari janë më shumë rekomandime të Komesarit të lartë të OSBE-së për minoritetet, Maks Van der Shtul, nën mandatin e të cilit gjendej edhe Maqedonia e atyre viteve. Në rekomandimet e tij, Komesari i Lartë i OSBE-së vë theksin kryesor mbi tri çështje: arsimin në gjuhën shqipe, shkollimin e lartë në gjuhën shqipe dhe qasjen për shqiptarët etnikë në të gjitha nivelet e administratës shtetërore dhe lokale (HCNM,OSCE:1998). Në të njejtën linjë janë edhe rekomandimet e Asamblesë parlamentare të KE, në të cilat nënvizohet rekomandimi që përdorimi i gjuhës shqipe në institucione të lehtësohet konform Konventës për Gjuhët e Minoriteteve dhe të implementohen rekomandimet e Komesarit të Lartë lidhur me përdorimin e gjuhës shqipe në shkollimin universitar. (COE:2000). Po qe se analizohen me kujdes raportet ndërkombëtare për Maqedoninë përgjatë këtij dhjetëvjeçari duket qartë se përdorimi i gjuhës shqipe në Maqedoni shikohet, analizohet dhe raportohet si i pandarë nga procesi arsimor, përkatësisht e drejta për të përdorur gjuhën shqipe si gjuhë shkollimi universitar, duke qenë se me kushtetutën dhe ligjet e para vitit 2001 nuk ishte e lejuar që gjuha shqipe të ishte gjuhë mësimi në një insitucion universitar. Pas shumë protestave dhe kundërprotestave më vitin 1997 ndryshoi ligji për arsimin e lartë që mundësoi funksionimin në gjuhën shqipe të fakultetit pedagogjik në Shkup (Rosulek, 2001:48), ndërkohë që autoritetet e atëhershme nuk njohën legalitetin e Universitetit të Tetovës, i cili filloi me punë më 17 dhjetor të vitit 1994, gjë që kulminoi me përplasje të popullatës vendore me policinë dhe përfundoi me viktimitë civile. Ky aspekt krijoi tensione akoma më të mëdha dhe gjithësesi vuri në pyetje praninë e Misionit të KB-ve në vend si një mision i cili ishte shumë i ngadalshëm kur ishte fjala për çështje të brendshme etnike.(Petiffer, 2001:141, Veremis, 2014:85, Ackermann, 2000:162). Në këtë drejtim ndërkombëtarisht u vlerësua që institucioni i Komesarit të Lartë për Minoritetet në kuadër të OSBE-së ishte më i pranueshmi për të intervenuar në këtë çështje, dhe në deklaratën e bërë nga ky institucion pas këtyre zhvillimeve në Tetovë, Komesari i Lartë do të pranojë dhe njohë të drejtën për shkollim universitar në gjuhën shqipe, por duke theksuar se e gjitha duhet të jetë në harmoni me ligjet e vendit dhe si përfundon propozon rishikim të Ligjit për arsim universitar si formë për të akomoduar këto kërkesa gjuhësore dhe identitare.(HCNM,OSCE:1995). Komisari i Lartë lidhur me këtë çështje do udhëheqë një proces disavjeçar i cili do rezultojë me ndryshimet në Ligjin për arsim të lartë i cili nuk do të mundësojë përdorimin e gjuhës në institucion shtetëror universitar, por do ta lejojë këtë mundësi për insitucione universitare private. (Ligji për arsim të lartë, 2000:16). Si rezultat i këtij ligji u themelua Universiteti i Europës Juglindore në Tetovë në vitin 2001 me përkrahje akademike dhe financiare të SHBA dhe BE dhe i mbështetur në konceptin e tanimë ish-Komesarit për Minoritet Maks Van der Shtul për mësim në tri gjuhë: atë shqipe, maqedonase dhe angleze dhe me një sistem publiko-privat të finansimit. Pas vitit 2001 dhe Marrëveshjes së Ohrit me ndryshimet tjera të Ligjit për arsim të lartë u bë e mundur njohja dhe legalizimi i Universitetit Shtetëror të Tetovës dhe paskëtaj themelimi dhe regjistrimi i Universitetit shtetëror Nëna Terezë në Shkup.

Shënime përmbyllëse: Drejt Marrëveshjes së Ohrit

Kjo eksperiencë dhjetëvjeçare dëshmoi se nuk është me rëndësi se cila parti politike shqiptare është në pushtet, po qe se nuk ka kushtetutë dhe ligje të cilat garantojnë të drejtat kolektive të popullit që këto parti përfaqësojnë. Këto dhjetë vite dëshmuar se për shqiptarët në Maqedoninë e Veriut dhe institucionalizimin e identitetit të tyre gjuhësor nuk mjaftonte vetëm ndryshimi i sistemit politik dhe zgjedhjet shumëpartiake po qe se nuk kishte mekanizma shtetërorë dhe institucional të cilët do të mbronin nga majorizimi çështjet e

Materialet e punimeve (proceedings)

ISBN: 978-1-78911-007-4

natyrës identitare-etnike, në këtë rast gjuhën shqipe. Prandaj, duke ndjekur një rregull të pashkruar sipas të cilës shtresimi i problemeve të pazgjidhura etnike prodhon konflikte të cilat përfundojnë me zgjidhje, rezultoi lufta e vitit 2001 e cila përfundoi me Marrëveshjen Kornizë të Ohrit e cila adresoi këto probleme dhe kishte për rezultat ndryshimet kushtetuese, të cilat krijuan një realitet të ri dhe një fillim të ri në rrugëtimin e këtij vendi drejt integriteteve euro-atlantike. Aspekti i mosmarrëveshjeve lidhur me përdorimin e gjuhës shqipe trajtohet si një nga çështjet e pazgjidhura që krijuan parakushte konflikti (Andeva,Sela,Matovski, 2022:115).

Kushtetuta e vendit u ndryshua në vitin 2001 sipas kësaj Marrëveshjeje edhe atë: ndryshoi Preambula dhe nenet kushtetuese lidhur me gjuhën, qeverisjen lokale, dokumentet personale si dhe procedurat parlamentare të cilat siguruan shqiptarët dhe bashkësitë e tjera se nuk mund të mbivotoheshin në parlament për ligje të cilat prekin të drejtat kolektive etnike. Marrëveshja e Ohrit i referohet si 20% bashkësisë së dytë etnike dhe si rezultat teksti në kushtetutë ndjek këtë shprehje në të gjitha nenet, përfshirë nenin 7 i cili rregullon përdorimin e gjuhës së ndryshme nga maqedonishtja, në këtë rast gjuhës shqipe. Edhe pas ndryshimit të kushtetutës konform Marrëveshjes së Ohrit, transformimi në ligje i dispozitave kushtetuese kishte dinamika të ndryshme, kështu që për herë të parë u aprovua një ligj për përdorimin e gjuhës që flasin 20% të popullatës, në vitin 2008 për të arritur deri tek ligji aktual për përdorimin e gjuhëve në fuqi nga viti 2018. Gjuha shqipe mbetet shtylla kryesore identitare për shqiptarët në Maqedoninë e Veriut, por njëkohësisht një sfidë serioze për vënien në funksion dhe jetësimin e dispozitave ligjore në jetën e përditshme institucionale, publike dhe private të qytetarit në RMV.

Literatura

- Ackermann, A.(2000), *Making Pace Prevail, Preventing Violent Conflict in Macedonia*, Syracuse University Press;
- Andeva, M.,&Sela, Y.,& Matovski,L., (2022), Languages and Identities in North Macedonia: Legal and Political Challenges to State Formation, *MPRA Paper* No.116695, <https://mpra.ub.uni-muenchen.de>;
- Balibar, E.&Wallerstein,I. (1991) *Race, Nation,Class, Ambiguous Identities*, London-New York , Verso;
- Balibar, E, (1991), *The Nation Form: History and Ideology* London-New York, Verso;
- Balibar, E. (2001), *Nous, Citoyens D'Europe? Les frontieres, l'Etat, le peuple*, Paris, Editions La Decouverte;
- Banac, I.(1984), *Nacionalno Pitanje u Jugoslaviji, Porijeklo, Povijest, Politika*, Zagreb, Globus;
- Banac, I. (1990), *Political Change and National Diversity*, Daedalus Vol. 119/1, MIT Press on Behalf of American Academy of Arts&Sciences, <https://jstore.org>;
- Banac, I. (1992), *The Fearful Asymmetry of War: The Causes and Consequences of Yougoslavia's Demise*, Daedalus, Vol. 121/2, MIT Press on Behalf of American Academy of Arts&Sciences, <https://jstore.org>;
- Brubaker, R. (1996), *Nationalism reframed, Nationhood and the National Question in the New Europe*, Cambridge University Press;
- Derrida, J. (1985), *Des Tours de Babel, Difference in Translation*, Edited by Joseph. F.Graham, Ithaka&London, Cornell University Press;
- Gjuha shqipe para dhe pas miratimit të ligjit të përdorimit të gjuhëve të vitit 2019, (2021), *Konferenca shkencore ndërkombëtare për Ditën Ndërkombëtare të Gjuhës Amtare*, Punimet e konferencës, Shkup, Agjencia e Zbatimit të Gjuhës e RMV-së;
- Hagege, C. (1992), *Le souffle de la langue*, Paris, Editions Odile Jakob;
- Kissinger, H. (1999), *Diplomacia*, Tiranë, Shtëpia Botuese e Lidhjes së Shkrimtarëve;

Materialet e punimeve (proceedings)

ISBN: 978-1-78911-007-4

- Kushtetuta e Republikës Popullore të Maqedonisë (1946), *Gazeta Zyrtare e RPM*, nr 1/47, Shkup, Gjuha shqipe para dhe pas miratimit të ligjit të gjuhëve, Agjencia e zbatimit të gjuhës e RMV;
- Kushtetuta e Republikës Socialiste të Maqedonisë (1963), *Gazeta Zyrtare e RSM*, nr.15/63, Shkup, Gjuha shqipe para dhe pas miratimit të ligjit të gjuhëve, Agjencia e zbatimit të gjuhës e RMV;
- Kushtetuta e Republikës Socialiste të Maqedonisë e vitit 1974, *Gazeta Zyrtare e RSM*, nr. 7/74, Shkup, Gjuha shqipe para dhe pas miratimit të ligjit të gjuhëve, Agjencia e zbatimit të gjuhës e RMV;
- Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, (1991), *Gazeta Zyrtare e RM*, nr 52/91, <https://www.slvesnik.com.mk>;
- Ligji për arsimimin e lartë, (2008), *Gazeta Zyrtare e RM*, nr. 35/2008, <https://www.slvesnik.com.mk>;
- Lita, Q. (2022), *Mustafa Kruja dhe tokat e liruara*, Shkup,Koha;
- Lita, Q. (2018), *116 Shkollat shqipe në Tokat e Lirue, Dibra e Madhe gjatë Luftës së Dytë Botërore*, Shkup,Koha;
- Malkolm, N. (2020), *Rebelët, Besimtarët, të Mbijetuarit, Studime mbi historinë e shqiptarëve*, Prishtinë, Botime Artini;
- Meadwell, H. (2001), The Long Nineteenth Century in Europe, *Review of International studies*, N.27, p. 165-189, London, British International Studies Association;
- Mekuli, E. (1989), *Drita që nuk shuhet*, Prishtinë, Rilindja;
- Pettifer, J. (1999), *The new Macedonian Question*, London, Palgrave Macmillan;
- OSCE Principles in Practice (2017), HCNM Recommendations, *Center for International & Security Studies*. University of Maryland;
- Report of the International Commission to Inquire into the Causes and Conduct of the Balcan Wars, (1914), *Carnegie Endowment for International Peace, Publication No.4*, Washington D.C., Published by Endowment;
- Report by the Commisar for Human Rights of Council of Europe Thommas Hamarberg on his visit to the “Former Yougoslav Republic of Macedonia” (2008), Strasbourg, Council of Europe, <https://www.coe.int>;
- Report of European Comission against Racism and Intolerance on “The Former Yougoslav Republic of Macedonia” (2001), Strasbourg, Council of Europe, <https://www.coe.int>;
- Rosulek, P. (2002), Albanians in the Republic of Macedonia (1991-2001), Could the attempt to create a Multiethnic Society Suced, *Perspectives*, N.17, pp.43-58, www.jstor.org;
- Serwer D. (2019), *From War to Peace in the Balkans, Middle East and Ukraine*, Palgrave Macmillan;
- Shpuza, G. (2013), Kuvendi themelues i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit (15-17 Qershor 1787), *Gjurmime Albanologjike N.43*, Prishtinë, Instituti Albanologjik;
- Vasa, P. (1989), *E vërteta për Shqipërinë dhe Shqiptarët. Studim historik e kritik*, Prishtinë, Rilindja;
- Vendimi për shpalljen e Amandamentit kushtetues LVI për Kushtetutën e Republikës Socialiste të Maqedonisë,(1989), *Gazeta Zyrtare e RSM*, nr.16/89, Shkup, Gjuha shqipe para dhe pas miratimit të ligjit të gjuhëve, Agjencia e zbatimit të gjuhës e RMV;
- Vendimi për shpalljen e Amandamentit kushtetues XLII për Kushtetutën e Republikës Socialiste të Maqedonisë, (1989), *Gazeta Zyrtare e RSM*, nr.16/89, Shkup, Gjuha shqipe para dhe pas miratimit të ligjit të gjuhëve, Agjencia e zbatimit të gjuhës e RMV;
- Veremis, Th. (2014), *The Modern Balkans: A concise giude to Nationalism and Politics, The rise and Decline of Nation State*, London, LSEE;
- Wallerstein, I. (1991), *The Construction of Peoplehood: Racism, Nationalism, Ethnicity*, London-New York, Verso;

Varieteti i folur i të rinjve në Maqedoninë e Veriut përballë shqipes standarde

PROF. DR. ASLLAN HAMITI dhe PROF. DR. AJTEN HAJDARI-QAMILI
Universiteti “Shën Kirili e Metodi” – Shkup, Maqedonia e Veriut

Abstrakt

Folësit e asnjë mjedisi gjuhësor nuk flasin një gjuhë të vetme dhe plotësisht të njëjlojtë në të gjitha segmentet pa asnjë përjashtim. Ekzistojnë shumë forma gjuhësore të ndryshme në të njëjtën hapësirë dhe kohë. Faktorët kryesorë për paraqitjen e kësaj dukurie janë: karakteri shoqëror-kulturor i folësit, faktorët gjeografikë, kohorë (diakronia dhe sinkronia), përkatësia klasore e folësit, funksioni në shoqëri, profesioni, mosha, rrethi, religjioni, gjinia etj. Variantet e një gjuhe janë të shumta në numër dhe është e pamundur të bëhet ndarja e tyre e saktë, sepse edhe modalitetet që e shkaktojnë paraqitjen e tyre janë të ndryshme, të llojllojshme dhe të shumta. Disa nga ato modalitete janë të rastësishme dhe të ndërlikuara, prandaj është rëndë të përcaktohen veçantitë e përbashkëta dhe të zakonshme; e disa të tjera janë bukur mirë të përcaktuara dhe mund të ndahen dhe të përshkruhen sipas vetive të brendshme gjuhësore. Si variante gjuhësore me vlerë sociolinguistike është sociolekti i të rinjve, për arsye se çdo ditë e më shumë pasurohet dhe evoluon.

Qëllimi i këtij hulumtimi është të analizojmë e të vëmë në pah se si përhapet dhe evoluon varianti gjuhësor i të rinjve, sa ata e njohin dhe e përdorin shqipen standarde, cilat janë shkaqet e këtyre dukurive dhe si mund të parandalojmë rrezikimin e shqipes standarde.

Materialin e mbledhur në terren e kemi klasifikuar sipas ndikimeve nga vendi ku janë shkolluar nxënësit dhe studentët, elemente nga interneti dhe sajesa lokale vetanake.

Në fund kemi dhënë disa rekomandime që mund të ndihmojnë që variantet gjuhësore të rinisë së sotme të mos e dëmtojnë nxënien dhe përdorimin e drejtë të shqipes standarde.

Fjalët çelës: *sociolekt, të rinj, faktor, klasifikim, shqipe standarde.*

Hyrje

Çdo brez nxënësish e studentësh ka njohur ndër vite ndryshime në përzgjedhjen e fjalëve që përdorin ata në komunikim formal e joformal. Jo vetëm rrobat zgjidhen sipas modës, e njëjta gjë ndodh edhe me fjalët. Veç kësaj, dëshira për të pasur shpejtësi maksimale të komunikimit, koha e cila është gjithnjë e më pak e disponueshme për këdo, dalja në treg e prodhimeve më të sofistikuara elektronike, ndërthurja e teknologjisë dhe komunikimit ndërnjerëzor ka shtyrë pjesën më të madhe të përdoruesve, kryesisht të rinjtë, të krijojnë shumë varietete gjuhësore me një fjalor të tyre. Njerëzit e sotëm gjithë ditën rrinë me telefon në dorë dhe komunikimet i zhvillojnë përmes rrjeteve sociale si Instagram-i, Tiktok-u, Snapchat-i, Facebook-u, Viber-i, WhatsApp-i dhe rrjeteve të tjera sociale, edhe nëse personat me të cilët komunikojnë përmes rrjeteve sociale mund të jenë shumë afër njëri-tjetrit, madje edhe brenda shtëpisë.

Pa dyshim se këto dukuri kanë lënë pasojat e veta në shumë fusha të jetës, përfshirë këtu edhe në kulturën gjuhësore të rinisë. Nga hulumtimet e shumta që kemi bërë ndër vite lidhur me çështje të ndryshme gjuhësore, kemi konstatuar se kultura gjuhësore e të rinjve në Maqedoninë e Veriut dhe më gjerë është në shkallë të ulët. Natyrisht, se një ndër shkaqet e përdorimit të gabuar të shqipes standarde është edhe ajo se në aspekt fonetik dhe morfologjik, shqipja normative mbështetet kryesisht në të folmet toske. Rrjedhimisht, vetëm folësit e asaj izoglose nuk kanë vështirësi gjatë përdorimit të shqipes së normuar, ndërsa praktika gjuhësore e deritashme na tregon se të gjithë folësit e tjerë që nuk i përkasin atij territori të caktuar shprehin pakënaqësi dhe me vështirësi i përvetësojnë këto forma. Por, a është vetëm ky

shkaku se të rinjtë e Maqedonisë së Veriut, sepse qenkan gegë, paskan vështirësi ta përvetësojnë dhe zbatojnë shqipen standarde?!? Jo.¹

Një nga shkaqet kryesore është se në dekadën e fundit gjejmë shumë pak lexues të librave gjuhësisht të redaktuara e të lekturuara dhe kjo ndodh pikërisht për shkak të epokës digjitale, e cila është pranuar për së prapthi e po keqpërdoret, sidomos nga gjeneratat e reja. Brezi që e njeh më së miri dhe e zbaton mirëfilli shqipen standarde janë ata që kanë diplomuar para 20-15 vitesh. Gjeneratat më të reja nuk lexojnë shumë libra, sepse vazhdimisht lexojnë tekste nga interneti (të cilat më shpesh janë të paredaktuara) dhe kontaktojnë shumë më tepër përmes rrjeteve sociale me shkurtesat dhe cungimet e tyre sociale.²

Shmangiet nga shkrimi dhe shqiptimi i drejtë që bëjnë të rinjtë e sotëm

I. Ndër gabimet më të shpeshta në fushë të fonetikës e të fonologjisë të varietetit të folur të të rinjve të Maqedonisë së Veriut janë: përdorimi i varianteve territoriale të fonemave zanore (zanoret e buzorëzuara, të hundorëzuara, diftongjet e diftongoidet, si p.sh.: *mⁱerr, nâtën*); rënie tingujsh të papranueshme për shqiptimin letrar; zhbuzorëzimi i /y/-së në /i/ (si: *atire = atyre, ki = ky, di = dy*); humbja e opozicionit fonologjik ndërmjet bashkëtingëllores shumëdridhëse /rr/ dhe njëdridhëse /r/ (*mar / marr, pjesmarje / pjesëmarrje, kur / kurë ~ kurrë / kurr, regull / rregull, rradha / radha, korigjim / korrigjim, morra / mora*); mospërdorimi i glotales [h] (*kuptoet, dyshoet*); shqiptimi më i përparmë e ndonjëherë edhe afrikatizimi i mesgjuhoreve /q, gj/ në /ç, xh/ (*gjithqka = gjithçka, valigje = valixhe, çë = që, qdo = çdo, bejtegji = bejtexhi*); këmbimi i /h/-së me /f/-në (*njof = njoh, shof = shoh*); ndërrimi i /nj/-së në /j/ (*bejtexhij, shkopij barij, bektashij*); monoftongimi i grupit të zanoreve /ua/ dhe /ue/ në zanore të rëndomta të gjata (*e kuptushme, bashkbisedus, mreklushëm, lujn rol*); alternimi i /ç/-së në /zh/: **zh**do gjë apo **xh**do gjë; alternime të tjera si: *ndjej, ndjehem (ndiej, ndihem), gitarë (kitarë), karike (karrige), spjegim (shpjegim), njejt (njëjtë), gjërë (gjerë), ligjerat (ligjëratë), sod (sot), qëndrore (qendrore)*; metatezë dhe alternim, si: *shëndrojt (shndërroj), pregadis (përgatis), përthkys (përkthyes)*; përdorim të fjalëve protetike, si: *ndigjoj, nvarret / mvarret, mbrenda* etj.; përdorim i gabuar i apostrofit te trajtat e shkurtra të përemrave (*t'i, t'ua, t'u, t'ju, m'i, m'u ~ ti, tua, tu, tju, të ju, mi, mu*) dhe (*ta ~ t'a, ma ~ m'a*); po ashtu **ç'** kur është përemër pyetës dhe kur është parashtesë antonimike apo përforcuese herë shkruhen të gjitha me apostrof e herë pa apostrof (nuk dallohen *ç'ka ~ çka, çarmatim ~ ç'armatim na qenka ky?!*); pjesëza mohuese **s'** nuk shkruhet me apostrof, bile fjalia *s'e di* shkruhet si një fjalë e vetme = *sedi*;³

Viteve të fundit në ndikim të mediave dhe rrjeteve sociale është bërë modë shqiptimi më i butë e më i prapëm i dridhëses /r/, shqiptim tërësisht qiellzor i /q/ dhe /gj/, përdorim të /ë/-së së theksuar të toskërishtes veriore në vend të /e/-së theksuar, si *vënd, mëndje, mënçur* etj.

Gabimisht shkruhen edhe fjalët ndërkombëtare që kanë depërtuar edhe në shqipe edhe në maqedonishte, të cilat duhet të shkruhen sipas parimit historik-tradicional (etimologjik),

¹ Ajten Hajdari-Qamili, *Shqipja “standarde” e studentëve të Maqedonisë*, Konferencë shkencore “Dyzet vjet të shqipes standarde”, Prishtinë, 7 – 8 dhjetor 2012.

² Ajten Hajdari-Qamili, *Zbatimi i shqipes standarde në Maqedoninë e Veriut*, Konferenca shkencore “Sfidat e përkthimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut”, Agjencia për Zbatimin e Gjuhëve e RMV-së, mbajtur më 30.09.2019, Dita Ndërkombëtare e Përkthimit, Shkup, 2020, f. 11-31.

³ Ajten Hajdari-Qamili, *Shqipja “standarde” e studentëve të Maqedonisë*, Konferencë shkencore “Dyzet vjet të shqipes standarde”, Prishtinë, 7 – 8 dhjetor 2012.

por ndikuar nga drejtshkrimi i maqedonishtes shkruhen kështu, p.sh.: *dijagonale (diagonale)* ~ *дијагонално, iracional (irracional)* ~ *ирационален, fakulltet (fakultet)* ~ *факултет, disiplinë / disciplinë (disiplinë)* ~ *дисциплина, zhirafë (gjirafë)* ~ *жирафа, akvarium (akuarium)* ~ *аквариум, funksion (funksion)* ~ *функција, univerzitet (universitet)* ~ *универзитет* etj.

Problemi më i shpeshtë i drejtshkrimit dhe i drejtshqiptimit është zanorja /ë/ e patheksuar, e cila në ligjërimin bisedor dhe në të folurit e shpejtë rrudhet (tkurret, reduktohet) në shkallë të ndryshme ose ndodh e kundërta, në vendet ku ajo duhet të shkruhet për shkak të parimit morfologjik apo historik-tradicional, gjatë të folurit (të lexuarit) shqiptohet pa pasur nevojë. Konkretisht, po veçojmë se gjatë të shkruarit më shpesh nuk shkruhet fare ose shtohet pa nevojë zanorja /ë/ te:

➤ Çiftet e mbiemrave dhe ndajfoljeve të të njëjtit tip, si: *drejt ~ i drejtë, drejtpërdrejt, shpejt ~ i shpejtë, shpejtësi, lart ~ i lartë, i lartpërmendur, vërtet ~ i vërtetë* etj.

➤ Tek emrat e gjinisë femërore që nuk mbarojnë me **-i**, **-e** apo **-o**, të cilat duhet të mbarojnë me **-ë**, shpesh nuk e shkruajnë: *profesoresh, shpuz, drras, fush, çant / qant, unaz, kmish, kpus, dëshir, muzik, pjes* etj.

➤ Mbaresa për vetën e parë dhe të tretë e shumësit: *shkojm (shkojmë), shkojn (shkojnë), luajn (luajnë), këndojm (këndojmë)* etj.

➤ Mbaresat e gjinore, dhanore dhe kallëzore në njëjës dhe të emërores e kallëzore në shumës tek emrat e gjinisë femërore, si: *letërsisë, gjuhësisë, dashurisë, fonologjisë, lumturisë, letërsinë, gjuhësinë, dashurinë, leksikologjinë, lumturinë, letërsitë, njësitë, llogaritë, dukuritë* etj.

➤ Prapashtesa trajtëformuese e shumësit: *disa shkrimtarë, dy ushtarë, pesë këngëtarë, jemi studentë*.

➤ Mbiemrat që mbarojnë me **-r** ose **-v** kur janë në formë shumësi: *titujt arsimorë, kufij administrativë* etj.

➤ Kur /ë/-ja ndodhet në pozitë mesore dhe është e patheksuar, e cila duhet të shkruhet për shkak të parimit morfologjik, si p. sh.: *mirpo (mirëpo), hapsira (hapësira), pjesmarje (pjesëmarrje), pikpamje (pikëpamje), vazhdimsi (vazhdimësi), përkthasi (përkatësi), vetvrasje (vetëvrasje), gjelltoje (gjellëtore)* etj.

➤ Tek ato emra të gjinisë mashkullore të cilat duhet të shkruhen me /ë/ fundore për shkak të parimit historik-tradicional, si: *djath, brum, mjalt, djal, kal, lum* etj.

➤ Ngatërrohen dhe nuk dallohen përemri përcaktues, identifikues (vetë) që ka prejardhjen nga përemri vetvetor me përemrin pronor vetvetor (i / e vet): *jam vetë ~ erdhi me nënën e vet* (pra, në të dyja rastet shkruhet ose pa /ë/ ose me /ë/ nga po i njëjti student).

➤ Te foljet: *kam qen, dje pash një..., kam par diçka, nuk thash ashtu, ...* etj.

II. Shpeshherë hetohen gabime morfologjike, si p.sh: përdorimi i kundërt i gjinisë së përemrave vetorë **ata** dhe **ato** (*ato burra, ata gra ose ata burra, ata gra*), por edhe te disa emra si: *ky fëmiu* apo *kjo fëmija* (për: *ky fëmija*); në vend të përemrave vetorë **ne, ju** përdoren trajtat e tyre të dhanores **neve, juve** (*Neve kemi ardh*); përdorim në rasë të gabuar të përemrave pronorë: *Ne i respektojm kritikën e juaja* (= > *tuaja*); përdorim i kundërt i trajtave të shkurtra të përemrave të vetës së dytë dhe të tretë në shumës, si: **T'ju** them atyre, **T'u** ndihmoj juve; *Profesoresh ua kam dërguar detyrat; Profesoresh dua të ju pyes ...*; gabime në përdorimin e nyjës **i / e** me **të** ose nyjës **të** me **së** (... *forma e mënyrës lidhore të kohës së tashme të vetës së parë shumës formohet...*, *Ministri i Punëve të Brendshme të Maqedonisë, Ministrisë të Arsimit, kohës të tashme*); e ardhmja ndërtohet me **do + foljen**, pa pjesëzën **të**,

në vend: **do të + folja** (*Do bëj të pamundurën. Ne do veprojmë...*)⁴; mospërshtatja e saktë e fjalëve përcaktuese me emra mashkullorë që e formojnë shumësin me **-e** dhe **-ra** (*ata male, këta materiale, këta fshatra* => ato male, këto materiale, këto fshatra), e pakryera veprorë e foljeve ndonjëherë përdoret në formë sigmatike (*punojshna, punosha, punojsha*) në vend të formës josigmatike (punoja); hasen pjesoret e foljeve të reduktuara: (kam) *lexu.;* *shku.;* *shkru.;* *ardh;* gabohet e kryera e thjeshtë e foljes *shkruaj* në të gjitha vetat: *unë i shkruajta, shruajta, shkrojta (shkrova), ai i shkrujti, ne i shkrojtëm* etj.; Mjaft shpesh gabohet forma e mënyrës lidhore, sepse në vend të /ë/-së përdoret /e/-ja ose përdoret me pjesëzën **të** + forma e mënyrës dëftore e kohës së tashme e vetës së tretë njëjës, p.sh.: *të shkoje / të shkoe* ose *të shkon* (të shkojë), *të punoje / të punoe* ose *të punon* (të punojë), *të mësoje / të mësoe* ose *të mëson* (të mësojë), *ai të jep* (ai të japë), *ajo të merr* (ajo të marrë), *ai të flet* (ai të flasë), *Nuk guxon të vjen...* (ai / ajo nuk guxon të vijë). *Nuk guxon t'i sheh ajo fëmijët* (nuk guxon t'i shohë) ose forma të tipit: *Nëse vie, duhet të ...* (nëse vjen). *Mos ma bën këtë* (mos ma bëj këtë) etj. Gjithashtu hasim struktura të shtrembëruara, si p.sh.: *ai mos të shkon, ajo mos të bën, mos ta lija vetë, un mos të jem* (për: ai të mos shkojë, ajo të mos bëjë, të mos e lija vetë, unë të mos jem) etj.⁵ Nga një numër jo shumë i madh i studentëve ngatërrohen e nuk dallohen e kryera e thjeshtë e vetës së tretë njëjës me të tashmen e vetës së parë njëjës (*ora mbaroj* = mbaroi, *ngjarja vazhdoj* = vazhdoi, *personazhi përjetoj* = përjetoj, *ai shkoj* = shkoi).

III. Në rrafshin leksikor hasim fjalët e huaja të panevojshme (barbarizmat), të cilat nga dita në ditë shkojnë duke u shtuar dhe, ç'është më e keqja, ato ndonjëherë përdoren në vend apo formë të gabuar, si p. sh.: *posedoj informata; kam predispozita, evitoj problemin, përkthej bukvalisht, ..., A mundem të prezentoj në orë?* (për kuptim: *A mund të marr pjesë ose A mund të jem i pranishëm në orë të mësimi?*); Apo raste edhe nga ligjërimi bisedor i studentëve, si: *bleva një prijav* (fletëparaqitje), *po pres në shallter* (sportel), *shkova në studentski* (administratën studentore), *tash prej në ora 13.00 kemi sovremen* (gjuhë bashkëkohore maqedonase), *e zaverita semestrin* (e vërtetova) e shumë e shumë raste të këtilla.

Këtu mund të përmendim edhe disa anglicizma që përdorin më shpesh të rinjtë në komunikimin e rrjeteve sociale apo në bisedat gojore mes tyre, si p.sh.: *dounllaudoj* (shkarkoj), *e bëra save* (e ruajta), *akaunt* (llogari) *çek in* (vendndodhje), *ed* (shto), *follder* (dosje), *folloversa* (ndjekës), *follow* (ndiq), *friends* (miq), *full* (i/e stërm bushur), *invajt* (fto), *like* (pëlqej), *memori* (kujtesë), *story* (ngjarje), *share* (shpërndaj), *tag* (etiketo), *sissy* (motër), *bro* (vëlla), *mommy* (nënë), *hubby* (bashkëshort), *shumë cool*, *marketing*, *promotor*, *leasing*; *fast-food*, *hamburger*, *hot-dog*, *cheeseburger*, *boyfriend*, *VIP*, *weekend*, *ok*, *nice*, *go*, *mood*, *party*, *super-vajzë*, *bebe*, *real*, *trend*, *make-up*, *top model*, *prinojt*, *dizajner*, *shopping*, *show*, *showman*, *gamer* (lojtar) etj. Këto fjalë ndonjëherë shkruhen ashtu siç shkruhen në anglisht (*download*, *account*, *follow* etj.), por nga disa përdorues shkruhen ashtu siç lexohen.

IV. Dukuri tipike që i krijoi interneti

Në komunikimin e rrjeteve sociale të rinjtë përdorin shkurtesa me heqjen e zanoreve: *dtl* = ditëlindje, *dtm* = ditën e mirë, *fb* = facebook, *fix* = fiksoj, *flm* = falemnderit, *gr* = grupi, *gz* = gëzohem *klm* = kalofsh mirë, *mbr* = mirëmbërë, *mrz* – mërziur, *nrm* = normal, *ntm* –

⁴⁴ Kjo dukuri është përhapur nga mediat e Shqipërisë.

⁵ Më gjerësisht rreth kësaj shih: Ajten Qamili, *Shqipja “standarde” e studentëve të Maqedonisë*, Konferencë shkencore “Dyzet vjet të shqipes standarde”, Prishtinë, 7 – 8 dhjetor 2012.

Materialet e punimeve (proceedings)

ISBN: 978-1-78911-007-4

natëm e mirë, mszh – mesazh, pc = kompjuter, plq = pëlqej, prsh = përshëndetje, pz = për zotin, sps = s'ka përse, srz = seriozisht, thz = ta ha zemrën, zmr = zemër etj.

Për shprehjen e urimeve ose ndjenjave të ndryshme përdoren vetëm shkronjat e para dhe tashmë shkurtesa të tilla si, *tdsh, tkshxh, tkz, klb, klm* janë bërë klishe dhe gjenden kudo nëpër biseda të ndryshme. Pavarësisht se i takojnë gjuhës së shkruar, ndonjë prej këtyre shkurtesave është bërë pjesë e komunikimit të përditshëm, jashtë kufijve virtualë nga të rinjtë, por jo vetëm (*klb, klm, flm*).⁶

Në mesin e të rinjve është shumë interesante përdorimi i emërtimeve të profileve të tyre në facebook, në instagram, por edhe në rrjetet e tjera, përkatësisht shkurtimeve e mbiemrave të tyre në profil. Shembull: *Vebi Cani* (Hasani), *Drita Osm* (Osmani), *Lirim Slm* (Selmani) etj.

Ajo që shpesh bie në sy gjatë komunikimit online është edhe përdorimi i shkurtimeve të toponimeve (nga shkurtesat e përdorura në tabelat e veturave) kështu duke iu referuar vendbanimeve të ndryshme: *AL = Shqipëri, KS = Kosovë, KU – Kumanovë, PR = Prishtinë, SK = Shkup, TR = Tiranë* etj. *Dje ishim në KS dhe nga lodhja nuk munda të zgjohem. Për momentin jam në TR. Kur te kthehem do te thirri. Jam nga SK.*

Mjaft interesante është edhe ngatërrimi i shkronjave të ndryshme, gjë që nuk e hasim vetëm në biseda interne në mes bashkëbiseduesve, por edhe në postime të ndryshme publike në internet. Përdorimi i q-së ose c-së në vend të ç-së është si pasojë e tastierave që nuk e përmbajnë këtë shkronjë dhe përdoruesit duke mos e bërë ndërrimin e tastierës në gjuhën shqipe, si alternativë për ta zëvendësuar ç-në e shohin q-në dhe për ta zëvendësuar ë-në përdorin e-në. Megjithatë, njëkohësisht këtu kemi edhe ndikimin dialektor, që ka përgjithësisht gegërishtja (verilindore dhe qendrore), pra afrikatizimin e qiellzoreve. Për këtë shkak, folësit e këtyre trevave shpesh nuk e dallojnë q-në nga ç-ja.

P.sh.: *Qerdhja jone per femije nesor do te organizoje shfaqje. Qdo gatim u juaji eshte i mireseardhur! Qanten e bleva lir. Isha n'qajtore. Gjithqka ishte bukur. Sa esht qmimi i patikave? Cka ben?*

Shenjat e ndryshme të pikësimit, përdoren jo vetëm si shenja gramatikore për ndarjen e fjalive ose pjesëve të një fjalie, por rregullat e përdorimit të tyre janë modifikuar nga përdoruesit për të realizuar nevojat e tyre gjatë komunikimit. Me anë të përsëritjes së shenjave të pikësimit, bashkëbiseduesit arrijnë të shprehin elemente të ndryshme prozodike si një mënyrë për të kompensuar mungesën e gjesteve të fytyrës, gjuhën e trupit dhe rrethana të tjera kontekstuale të hasura zakonisht në një bisedë ballë për ballë.

Kur biseda bëhet e pakuptueshme ose kur personi nuk përgjigjet apo vonon përgjigjen, bashkëbiseduesi, në vend të pyetjes me fjalë, zgjedh të vendosë disa pikëpyetje një pas një:

??????????

A kaq pak veta ishit????

ku je???

hejjj??????????

qka????????

Pikëçuditja përsëritet në rastet e urimeve për të shprehur ndjenjën e kënaqësisë, për të shprehur habi, për të përforcuar mendimin, por edhe për të shfaqur zhgënjimin ose pakënaqësinë:

Mazallah !!! Larg qoftë!!!

Të pershendes !!!!!!!!

⁶ <https://anxhelinalanga.wordpress.com/2017/02/15/deformimi-i-gjuhes-shqipe-ne-rrjetet-sociale/>

Materialet e punimeve (proceedings)

ISBN: 978-1-78911-007-4

Kshtu paskam then a??!!!!!!!!

Katastrof!!!!

Khaaaa!!!!!!

Pika në formë të përsëritur, përdoret për të treguar se përmbajtja e mesazhit vazhdon më tej ose nuk është e lehtë për t’u shprehur diçka:

Sa keq... zdi si përfundoi gjithqka... më vjen t’i them...

Sot tan ditën lava, fshiva, pastrova, bona buken.....

Një tjetër strategji për të shprehur gjendjet e ndryshme emocionale nga përdoruesit e rrjeteve sociale është përsëritja e zanoreve ose bashkëtingëlloreve për përforcimin e ngarkesës emocionale të fjalëve e për të shprehur qëndrimet emocionale si lumturinë, gëzimin, zhgënjimin, mërzitjen etj., si p.sh.:

Hahahhahaahaha sa interesante.

Ahhhh bre shpirt.

Saaaa mirë, dua të jem me ty.

Te thashhhhh të ikje me kohë.

Te dua shuuuum

Përdorimi i disa fjalëve me shkronja të mëdha ose ndonjëherë i gjithë mesazhi është një zgjedhje e bashkëbiseduesve për të vënë në pah atë që duan të theksojnë më tepër dhe për të rritur gjendje emocionale të tilla si gëzim, kënaqësi, neveri, frikë etj.

Fotografia të ngjallte EMOCIONE DASHURIE dhe DHEMBËSHURIE njëkohësisht. Sa hyjnore është lidhja në mes partnerëve të jetës!

Të dua SHUUUMË!

Përfundimi

Nga e gjithë ajo që u trajtua më sipër, mund të konstatojmë se, marrë në përgjithësi, në këto 10 vitet e fundit kultura gjuhësore e të rinjve të Maqedonisë së Veriut dhe më gjerë nuk është në nivelin që dëshirojmë, sepse varieteti i folur i tyre nga dita në ditë po vërshohet me forma të gabuara, me kalke nga maqedonishtja dhe anglishtja, me krahinorizma, me zhargonizma dhe tash së fundi me elemente të tjera që i ka krijuar komunikimi në rrjetet sociale. Këto dukuri mund të krijojnë shumë variante gjuhësore duke u larguar gjithnjë e më shumë nga standardi. Megjithatë, për këtë situatë nuk duhet të fajësojmë vetëm njërën palë apo strukturë shoqërore, sepse ky është një sistem dhe duhet të funksionojë si i tillë, pra secili element duhet ta kryejë obligimin që ka duke bashkëvepruar me elementet e tjera për ta krijuar tërësinë (nxënësi – mësuesi – familja - studenti – profesori – institucionet publike - media).

Prandaj, detyra kryesore e institucioneve dhe e secilit individ është të gjejnë metoda dhe strategji se si e me çka konkretisht t’i motivojmë gjeneratat e reja që ta mësojnë dhe zbatojnë shqipen standarde, pra të bëjnë çmos për ngritjen e përgjithshme intelektuale të rinisë në përgjithësi dhe për vetëdijesimin mbi vlerën e gjuhës që përdorin ata. Gjithashtu duhet t’i njoftojmë për dëmet që mund t’i shkaktojë moszbatimi e keqinterpretimi i gjuhës standarde dhe se nuk guxojnë të gërshetojnë shqipen standarde me varietet gjuhësore të tyre.

Veç kësaj, duhet që institucionet arsimore (Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, Byroja e Zhvillimit të Arsimit) të mos bëjnë ndryshime rrënjësore të vazhdueshme të planprogrameve dhe të librave, por të përmirësojnë ato që janë; Tekstet shkollore të përkthehen dhe të

Materialet e punimeve (proceedings)

ISBN: 978-1-78911-007-4

redaktohen nga profesionistë të fushës; Shkollat të punësojnë vetëm mësuesit më cilësorë; Prindërit të mos i lazdrojnë fëmijët e tyre, duke kërkuar nota e duke mos i përfillur mësuesit; Fëmijët dhe të rinjtë të mos e teprojnë përdorimin e pajisjeve teknologjike dhe rrjetet sociale, ku dominojnë elemente të huaja, elemente dialektore, shkurtesa të krijuara nga secili individ etj.

Literaturë

Ajten Hajdari-Qamili, *(Mos)zbatimi i shqipes standarde në Maqedoni*, Kongresi i drejtshkrimit të gjuhës shqipe – vepër me vlera të mëdha kombëtare, (13. 06.2012), Shkup, Instituti i Trashëgimisë Kulturore dhe Shpirtërore të Shqiptarëve, Shkup, 13 qershor 2012.

Ajten Hajdari-Qamili, *Cilat janë sfidat me të cilat ballafaqohet gjuha amtare*, KOHA, 21.02.2014.

Ajten Hajdari-Qamili, *Dukuritë gjuhësore që i krijoi interneti dhe rrjetet sociale*, Konferenca e Shtatë Ndërkombëtare Shkencore e Fakultetit filologjik – ISCFP, Universiteti i Tetovës, Tetovë, 16-18 nëntor 2022 (në bashkautorësi me V. Ismani), e botuar në tetor 2023).

Ajten Hajdari-Qamili, *Kujdes për shkronjat dhe gjuhën shqipe*, Portalb, Shkup, 16:33 më 20.11.2016.

Ajten Hajdari-Qamili, *Laryshia e përvetësimit të shqipes standarde në Maqedoni ndër vite*, Konferenca VII Shkencore Ndërkombëtare “Gjuha, letërsia dhe kultura shqiptare nga Pavarësia deri sot”, Tetovë, 23 nëntor 2012.

Ajten Hajdari-Qamili, *Përmirësimi i cilësisë së shqipes standarde në institucionet e Maqedonisë*, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve, Scupi vëllimi 22, Gjuha shqipe në Maqedoni – histori dhe perspektiva (Panel shkencor mbajtur më 18.06. 2018, Shkup), Shkup, 2018, f. 101 - 109.

Ajten Hajdari-Qamili, *Si ta përmirësojmë të nxëniet e shqipes standarde në shkollat e RMV-së*, ITSHKSH- Shkup, Konferencë shkencore “Gjuha dhe shkolla shqipe në Maqedoninë e Veriut, 24.09.2020, Shkup.

Ajten Hajdari-Qamili, *Shqipja “standarde” e studentëve të Maqedonisë*, Konferencë shkencore “Dyzet vjet të shqipes standarde”, Prishtinë, 7 – 8 dhjetor 2012.

Ajten Hajdari-Qamili, *Varieteti i folur i studentëve në Strugë*, Kumtesat nga konferenca vjetore e shkencës “Java e Shkencës”2017, Prishtinë: Republika e Kosovës, Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë, 2018, f. 9 - 20.

Ajten Hajdari-Qamili, *Zbatimi i shqipes standarde në Maqedoninë e Veriut*, Konferenca shkencore “Sfidat e përkthimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut”, Agjencia për Zbatimin e Gjuhëve e RMV-së, mbajtur më 30.09.2019, Dita Ndërkombëtare e Përkthimit, Shkup, 2020, f. 11-31.

Akademia e Shkencave e RP të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Drejtshkrimi i gjuhës shqipe*, Tiranë, 1973.

Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Konferenca shkencore "Shqipja standarde dhe shoqëria shqiptare sot"*, Tiranë, 11 – 12 nëntor 2002, Shtëpia botuese "Shkenca", Tiranë, 2003.

Asllan Hamiti, *Kultura e gjuhës për të gjithë*, Shkup, 2018.

Asllan Hamiti, *Shtjellime gjuhësore*, Shkup, 2020.

Gjovalin Shkurtaj, *Si të shkruajmë shqip, Nga drejtshkrimi te shkrimet profesionale* (Ligjërata dhe elemente të domosdoshme shkrimtarie), BOTIMET TOENA, Tiranë, 2008.

Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, *Studime filologjike*, 3 – 4, VITI LXII (XLVII), Tiranë, 2008.

Rami Memushaj, *Shqipja standarde, Si ta flasim dhe ta shkruajmë*, BOTIMET TOENA, Tiranë, 2005.

Thomas S. Kane, *Si të shkruajmë shqip, Manual i Oksfordit për të shkruarin dhe retorikën i përshtatur për shqipen*, Qendra për Arsim Demokratik, Tiranë, 2010.

KONFERENCA E PARË NDËRKOMBËTARE NË GJUHËSI
“Ligjërimi i shkruar dhe i folur, probleme reale dhe propozime konkrete për zgjidhjen e tyre”

Materialet e punimeve (proceedings)

ISBN: 978-1-78911-007-4

Универзитет „Св. Кирил и Методиј“, Филолошки факултет „Блаже Конески“ – Скопје,
Монографија на Филолошкиот факултет „Блаже Конески“ 2006-2021, по повод 75 години од основањето 1946-2021, Скопје, 2021.

<http://portalb.mk/375268-dy-dekada-reformim-te-pasuksesshem-te-sistemit-arsimor-shqiptaret-mbeten-ne-vendnumero/>

<https://anxhelinalanga.wordpress.com/2017/02/15/deformimi-i-gjuhes-shqipe-ne-rrjetet-sociale/>

<https://sq.warbletoncouncil.org/abreviaturas-redes-sociales-1840>

<https://telegrafi.com/e-dini-se-cfare-te-thote-ngl-dhe-e-perdorni-si-duhet-kete-shkurtese/>

<https://wetransfer.com/downloads/fe785d938ab0f4350f0e11d04491e39520200312202901/87ff55564220805a7d0d5ac6a99760ce20200312202901/577a1d>

<https://www.facebook.com/289839541067084/posts/3040213716029639/>

<https://www.facebook.com/AlsatMTelevision/videos/199068451440059/?vh=e>

<https://www.facebook.com/radiokosova1/videos/1125854260957605/UzpfSTY1MTg2NTI0NzoxMDE1NjQ4MzA3NzA0NTI0OA/>

<https://www.portalishkollor.al/news/shqipja-e-perdorur-ne-rrjete-sociale-rasti-i-facebook-ut>

<https://www.youtube.com/watch?v=W1SyyUpIhkM&feature=share>

<https://youtu.be/KYh2pRD3t7I>

Gjuha standarde shqipe dhe përdorimi apo shpërdorimi i saj

PROF.ASOC.DR.SHKELQIM MILLAKU
Fakulteti i Filologjisë, Prizren

Abstrakt

Obligimi i një shoqërie përparimtare është që ata ta ruajnë, zhvillojnë dhe ta përdorin drejt gjuhën e tyre. Kjo dukuri, si për respektim e saj, ashtu edhe për mos respektim të shqipes standarde ka filluar ta ketë shtrirjen identifikuese të saj, në të gjitha sferat e jetës shoqërore. Në institucionet e ndryshme publike dhe private, kjo çështje meriton një kujdes të shtuar, sepse përmes përdorimit të tyre dhe komunikimit me publikun e ruan apo e zhvillon gjuhën, por edhe ka raste që janë duke e shpërdoruar. Përdorimi i fjalëve dhe i fjalive të arsyeshme dhe të paarsyeshme, por edhe të pakuptimta, si në aspektin fonetik, morfologjik e sintaksor mund të shihen në një shkallë të lartë nga përdoruesit e ndryshëm.

Ky studim do të paraqet disa shembuj dhe analiza fonetike e morfologjike, por edhe rolin gjuhësor të fjalëve dhe fjalive të përdorura, si të gabuara nga përdoruesit e ndryshëm, të cilët përmes atij shpërdorimi gjuhësor mund të krijojnë pasoja për t’u riparuar apo përdoruese i caktuar vështirë do ta këtë për ta rikodifikuar gjuhën. Objektiva e studimit është e rreshtuar në disa dimensione, të cilat do ta brumëzojnë punimin dhe si të tilla janë etapat e historisë së gjuhës standarde, fenomenet e ndryshme gjuhësore, rrjetet sociale, faqet zyrtare të institucioneve tona edukativo-arsimore, pastaj edhe përdorimi i fjalëve të huaja në vend të atyre shqipe dhe përmes tyre edhe shpërdorimi i gjuhës dhe i strukturës së fjalisë.

Fjalë çelës: *Gjuha standarde, përdorimi dhe shpërdorimi i saj, rrjetet sociale, fjala, fjalialia.*

Prova e parë e organizuar në punën kolektive për të standardizuar gjuhën shqipe ishte në viti 1916 nga *Komisija Letrare Shqipe e Shkodrës*, e cila, për herë të parë ka arritur ta hartonte *Ortografinë* e parë të shqipes dhe si e tillë do t’i shërbente brezave si bazë, mbi të cilën do të krijohej shqipja standarde. Veprime kolektive e shkencore para mendimit e veprimit në fjalë ishte edhe ai i *Kongresit të Manastirit* (1879, 1908)⁷ dhe në këtë kohë apo gjatë kësaj periudhe, shqipja shkruhej në dy apo tri variante: *në toskërishten letrare, në gegërishten e mesme letrare dhe në shkodranishtja letrare*. Ortografia e *Komisisë Letrare të Shkodrës* ishte ngritur mbi bazën e gegërishtes së mesme. Kontributdhënësit e saj ishin: *Fishta, Gurakuqi, Pekmezi, Mosi, Logoreci, Mjeda, Xhuvani* etj., kurse albanologët e huaj ishin *Maksimilian Lamperc (Vjenë) e Rajko Nahtigal (Grac)*.

Komisija ka filluar punën, më 1 shtator 1916 dhe ka mbaruar, më 3 janar 1917. *Komisija Letrare Shqipe e Shkodrës* dhe vendimet e saj nuk patën jetë të gjatë.⁸

Pas veprimit të parë kolektiv në fjalë, rrethanat sociopolitike dhe ato socioekonomike qenë të kufizuara dhe nuk qe e mundur për të pasur apo organizuar ndonjë përpjekje kolektive serioze për ta standardizuar gjuhën.

Pas *Luftës së Dytë Botërore* rrethanat ndryshuan në të mirë të zhvillimit të shoqërisë dhe të kodifikimit të gjuhës. Për këtë qëllim qenë organizuar disa sesione shkencore, në vitin 1952, 1953 dhe 1956 në Tiranë, të cilët përmes takimeve të tilla bënin përpjekje për hartimin e një *Ortografi të gjuhës shqipe*, mirëpo në një rrugëtim të ngjashëm ishte vepruar edhe në

⁷ Në Manastir është hartuar e miratuar alfabeti i shqipes me 36 shkronja, i cili, u vendos mbi disa parime dhe parimi fonetik ishte themelor për drejtshkrimin dhe përbërjen e saj ishte me 36 fonema.

⁸ Propozimet ishin: Rregullat e drejtshkrimit nuk qenë të plota, prandaj standardizimi nuk shkoi deri në fund dhe intelektualët shkodranë nuk e pranuan dhe si propozim të tillë.

Prishtinë, në vitin 1957 dhe në vitin 1963, kur edhe qe hartuar edhe *Ortografia e gjuhës shqipe* e vitit 1964.

Këto përpjekje individuale e grupe ishin të suksesshme, sepse hapen rrugën për një trajtim e analizë më serioz për këtë çështje. Në vitin 1967 *Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë*, në Tiranë botoi një projekt të *Rregullave të Drejtshkrimit të Shqipes*, kurse një vit më vonë, në Prishtinë është organizuar *Konferenca Gjuhësore*, e cila i mbështeti propozimet e 67-s. Botimi i Projekti të drejtshkrimit të gjuhës shqipe, më 1967, në Tiranë dhe konfirmimi nga *Konsulta Gjuhësore e Prishtinës*, më 1968 në Prishtinë, pastaj si të tilla ia lehtësuan punën *Kongresit të Gjuhës Shqipe* (1972), i cili e vlerësoi se ky *Projekt* qe një rezultat i mirë për drejtshkrimin e shqipes që ishte shtrirë në *Shqipëri, Kosovë, Maqedoni* dhe në pjesën e arbëresheve të Italisë.

Gjuha shqipe dhe populli ynë ka kaluar nëpër shumë etapa e përpjekje dhe sfida serioze, të cilat kanë lënë gjurmë dhe pasoja të dukshme, të riparueshme dhe të pariparueshme, pothuajse në gjitha sferat përbërëse të jetës.

Për të vazhduar këtë punim dhe për ta mishëruar mendoj nuk do të jetë e tepërt nëse do t’i përmbledhim në pika thelbësore etapat e zhvillimit të gjuhës standarde.

Çështja apo hapi i parë kolektiv dhe shumë i rëndësishëm ishte njësimi i alfabetit⁹ të shqipes (...). Kongresi i Manastirit i filloi punimet më 14 nëntor 1908 dhe i përfundoi punimet më 22 nëntor 1908, kështu që ky veprim kolektiv hyri dhe krijoi historinë e kulturës shqiptare për njësimin e alfabetit të gjuhës shqipe. Parimi për një shkronjë dhe një fonemë ishte parim thelbësor fonetik. Ndër vendimet e Kongresit të Manastirit, vend të rëndësishëm zinte edhe vendimi për mbajtjen e një kongresi tjetër që do t’i kushtohej drejtshkrimit të gjuhës shqipe dhe do të krijonte bazat e një gjuhe letrare të përbashkëta për të gjithë shqiptarët¹⁰. Pas Kongresit të Manastirit (1908), rruga sociopolitike e gjeopolitike për të ardhur deri të unifikimi i drejtshkrimit ishte e gjatë dhe e sfiduar, si nga faktorët e brendshëm, ashtu edhe nga ata të jashtëm.

Çështja e dytë për gjuhën shqipe qe një gurthemel në fushën e drejtshkrimit edhe ai ishte kontributi i *Komisisë Letrare*¹¹ të mbledhur në Shkodër, më 1916.

Çështja e tretë apo edhe etapat e tjera për t’u shënuar janë projektet e drejtshkrimit të punuara në Institutin e shkencave, në Tiranë: më 1948 dhe 1951 nga Aleksandër Xhuvani, Kostaq Cipo dhe Eqrem Çabej; pastaj dy projekte të hartuara nga Mahir Domi, më 1953 e

⁹ Përfaqësuesit e Rilindjes Kombëtare: K. Kristoforidhi, P. Vasa, Jani Vreto, Hasan Tahsini, Ismail Qemajli etj, pranuan idenë e Naun Veqilharxhit, të cilët doni ta formonin një alfabet të përbashkët. Kjo shoqëri ishte kryesisht e Stambollit dhe më vonë është quajtur “*Shoqëria e Sambollit*” dhe alfabeti i propozuar nga ata është quajtur: *Alfabeti i shoqërisë së Stambollit*. Kjo nuk ishte e vetmja shoqëri, mirëpo në janar të vitit 1899 u formua shoqëria “*Bashkimi*” në Shkodër, e cila është themeluar nga Preng Doçi. Vëllezërit Lazër dhe Ndre Mjeda formuan shoqërinë kulturore artistike “*Agimi*”. Qëllimi i tyre ishte të hartonin një alfabet për çdo tingull një shkronjë.

¹⁰ Mahir Domi, *Alfabeti i gjuhës shqipe dhe Kongresi i Manastirit*, SF, 1968, nr.4, f.7.

¹¹ Vendimi i Kongresit të Manastirit, për mbajtjen e një kongresi tjetër ishte shumë i rëndësishëm, i cili planifikonte për të diskutuar për drejtshkrimin e gjuhës shqipe. *Komisinë Letrare* e drejtoi gjuhëtari Gjergj Pekmezi dhe disa nga përfaqësuesit e tjerë që ishin, si: L. Gurakuqi, N. Mjeda, A. Xhuvani, M. Logoreci, Gj. Fishta (të huaj Rajko Nahtigal dhe Maksimilian Lamerci) etj. Komisia ka punuar një vit dhe 3 janar 1917 e ka shpallur vendimin. Vendimi ishte gurthemeli për njësimin e drejtshkrimit të gjuhës letrare shqipe.

Rregullat që mund t’i theksojmë janë: Ë-ja e patheksuar u vendos të përdorej në trup, fund të fjalës (shtëpi, shëndet, lexojmë, shkojmë, thashtë, të, së). Përdorimi i diftongjeve ie, ue, ye (diell, miell, mësues lye, fyell. Shenja grafike për zanorët hundore (ʌ). Bashkëtingëlloret mb, nd, ng, ngj. Këto rregulla dhe shumë të tjera ishin të pranuar edhe nga mbreti Zog.

1954 dhe të diskutuara në konferenca të posaçme; pastaj edhe projekti i vitit 1956, i cili qëndroi në përdorim mbi dhjetë vjet, kështu që pas gjitha këtyre përpjekjeve vjen projekti shpirtëror i drejtshkrimit të vitit 1967,¹² i cili, qe hartuar nga Androkli Kostallari, Mahir Domi, Eqrem Çabej dhe Emil Lafe rreth të cilit projekt janë zhvilluar diskutime të gjera dhe si e tillë i ka shërbyer si bazë për *Konsultën Gjuhësore të Prishtinës (1968)* dhe pastaj ishte brumi kryesor për *Kongresin e Drejtshkrimit (1972)*¹³.

Dobitë prodhuese të çështjeve në fjalë janë të shumta, mirëpo si të tilla krijuan mundësi dhe dritare të reja shkencore. Pas *Kongresit të Drejtshkrimit* janë hapur rrugët për të botuar vepra të ndryshme shkencore, të cilat e ngritën vlerën shkencore të punës kolektive që ishin bërë deri në atë kohë, por edhe ishte krijuar mundësia për vepra të tjera shkencore dhe disa nga ato mund t'i citoj, si: “*Drejtshkrimi i gjuhës shqipe*” (1974); “*Fjalori drejtshkrimor i gjuhës shqipe*” (1976); “*Fjalori i gjuhës së sotme shqipe*” (1980,1981); “*Fjalori i shqipes së sotme*” (1984); “*Gramatika e gjuhës së sotme shqipe I* (1995); “*Gramatika e gjuhës së sotme II*” (1997) etj.

Sidoqoftë, gjuha standarde shqipe dhe përdorimi apo shpërdorimi i saj në gjitha trojet etnike ka zënë vend meritore apo pjesërisht e respektuar.

Çështja e statutit të një gjuhe është e lidhur ngushtë me statusin politiko-shoqëror të popullit që e përdor atë.

Fati i (mos) respektimit të gjuhës standarde shqipe është i dyanshëm. Në rrafshin e parë kemi të bëjmë me një përpjekje të një elite të heshtur, e cila me fanatizëm e ruan dhe zhvillon gjuhën standarde. Në këtë rrafsh duhet vlerësuar kujdesin e shtuar ndaj gjuhës nga shkollat parauniversitare e universitare, nga administrata publike e private, pastaj nga mediet

¹² *Plotësim*: Në Projektin e vitit 1967 u synuan rregullat për një formë të njësuar të gjuhës letrare dhe “*dalini gjithsej 255 rregulla dhe 57 përjashtime e sqarime*”. Rregullat që përfshihen në Projektin e drejtshkrimit të vitit 1967 mund të klasifikohen në tri grupe të mëdha:

- *Rregullat udhëheqëse*, ku jepen kushtet në të cilat duhet të zgjidhen pikërisht disa ortograme dhe jo të tjerat.
- *Rregullat dëftuese*, ku nuk jepet ndonjë kusht a motivim, por konstatohet se në atë a këtë rast duhet shkruar kështu, pra vetëm dëftohet sesi duhet të shkruhet një ortogram i caktuar. E këtillë është, p.sh., rregulla për sqarimin që shkruhen me r dhe rr.
- *Rregullat udhërrëfyese* që sqarojnë si duhet vepruar për të gjetur zgjidhjen e saktë drejtshkrimore.

Projekti i drejtshkrimit i 1967-s mbart në vete një varg risish, të cilat nuk vërehen në ortografitë e mëparshme. Studiuesit dhe hartuesit e projektit ishin të bindur se përveç parimit fonetik të gjuhës, ortografia duhet të mbështete edhe në parime të tjera si në ato morfologjike dhe në parimin historik-tradicional (për saktësinë shkencore të citatit në fjalë, shih: Fadil Faka, *Shqipja Letrare e shekujve XIX – XX*, Prishtinë, 2010, f.184, i cili e ka cituar A. Kostallar, *Gjuha e sotme letrare shqipe dhe disa problem...*, f.64).

¹³ Pasojë e gjithë këtyre veprimeve kulturore dhe gjuhësore nga “Formula dhe deri të veprimtaria gjuhësore dhe kulturore e vitit 1968” qe organizimi i *Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe*, që u mbajt, në Tiranë, në (20-25) nëntor 1972, ku merrnin pjesë një numër i madh delegatësh – studiues, shkrimtarë, punonjës kulture e profesorë (gjithsej 87 – 11 prej të cilëve nga viset shqiptare në ish-Jugosllavinë dhe dy-tre arbëreshë e të huaj). Mesazhi i tyre kryekëput ishte për “*Një gjuhë dhe një komb shqiptar*”.

Parimet e drejtshkrimit të shqipes standarde janë: Parimi fonetik, morfologjik, historiko-tradicional, semantik dhe simbolik.

e ndryshme, kujdesi i shtuar ndaj mbishkrimit të rrugëve, shkrimet dhe publikimet e ndryshme në faqet zyrtare të institucioneve publike dhe private, faqet elektronike zyrtare të institucioneve qendrore apo lokale, emërtimi i emrave të përvëçëm, por edhe përdorimi i drejtë i shkronjës së madhe, shmangja nga mundësia të përdorimit të fjalëve të huaja etj., nga gjithë këto që u thanë ka elemente respektuese për përkujdesje ndaj gjuhës, mirëpo në rrafshin e dytë, në disa qendra si ato të lartë përmendura kemi raste si nga grupet apo nga individët e caktuar, të cilët kanë koncepte të ndryshme për të mos e respektuar gjuhën, qoftë nga e padituri së tyre, apo nga dija e gabuar. Andaj, kjo rrymë mund të shihet në gjitha fushat e jetës, si në administratë, në media (gazeta, radio, TV), në mbishkrimet e rrugëve, shkrimet dhe publikimet e ndryshme në faqet zyrtare të institucioneve publike dhe private etj.

Shtirirja e përdorimit dhe shpërdorimit të gjuhës standarde shqipe është gjithandej.

a. Në Shqipëri gjuha standarde është në përdorim zyrtar në të gjitha institucionet, mirëpo gjithandej në gjitha fushat e jetës kanë nisur të hyjnë e të përdoren pa asnjë kriter fjalët a shprehjet e huaja “moderne”, për të cilat shqipja standarde nuk ka edhe aq shumë nevojë, sidomos për prurjet e reja që janë nga italishtja dhe anglishtja, të cilat si fjalë të tilla janë dhe do të jenë sfiduese për paradigmat kodifikuese të gjuhës shqipe.

b. Në Kosovë gjuha standarde është në përdorim zyrtar në të gjitha institucionet e vendit, mirëpo pasojat e ndikimit të administratës serbe mund të shihen edhe në gjuhë, mirëpo prurjet e reja sidomos ato të anglishtes janë aktive në të gjitha fushat e mundshme dhe në veçanti vërehen në fushën e teknologjisë “moderne” apo në zhvillimin e risimtarisë shkencore.

c. Në qytetet lindore të Kosovës (Preshevë ...), por edhe në Maqedoni e në Mal të Zi gjendja e gjuhës nuk është e respektuar ashtu si do të duhej dhe si e meriton, pra është gjysmë e respektuar.

d. Në diasporat, shqiptarët janë gjithandej dhe gjuha nuk ruhet e zhvillohet sa duhet e si duhet.

e. Një pikë tjetër e veçantë dhe meditative për ta trajtuar është edhe fati zhvillimit global, i cili po i sfidon gjuhët, të cilat kanë varësit e tyre sociopolitike e socioekonomike.

Nga pika /a/ deri në /e/ shoqëria përbërëse ka sfida të natyrave të ndryshme ekzistenciale, mirëpo kur është në pyetje ruajtja dhe zhvillimi i gjuhës, këtu mirë do të ishte që gjithë ne të shërbejmë ndeshëm për ta ruajtur dhe zhvilluar shqipen standarde.

Në vazhdim do t'i prezantoj **njëmbëdhjetë** çështje të ndryshme gjuhësore (me dhjetëra shembuj), të cilat studiuesit serioz, disa nga ato çështje i kanë trajtuar dhe disa nga ato i citoj, apo si trajtime shqyrtohen për herë të parë, mirëpo si të tilla disa janë duke u përdorur drejt dhe disa nuk janë duke u përdorur e zhvilluar drejt sipas rregullave normative, prandaj duke i prezantuar këtë çështje gjuhësore, të cilat me një kujdes të shtuar mund ta pasurojnë kodifikimin gjuhësor apo edhe e kundërta ta sfidojnë atë.

Në vazhdim i prezantoj çështjet e hapura për analizë, studim dhe për vendimmarrje, si:

1. Siparshesë apo si fjalë duhet të trajtohen shembujt: *para-, prapa-, pas-, jashtë, brenda-, larg-, lart-, pranë-, sipër-, anti-, pas-, pro-, drejt-, gjithë-, gjysmë-, jashtë-, plot-, shumë-, vet-, bashkë-, drejt-, tej-*, apo *para, prapa, pas, jashtë, brenda, larg, lart, pranë, sipër, anti, pas, pro, drejt, gjithë, gjysmë, jashtë, plot, shumë, vet, bashkë, drejt, tej, si: paraardhës, paraburgim, paracaktoj, paramendim, parandiej, parapëlqej, parapaguaj, jashtëshkruaj, brendashkruaj, i brendashkruar, largpamës, largpamje, pranëvendosje, i lartpërmendur, sipërmarrje, sipërmarrës, sipërvendosje, prapambetje, prapaskenë, prapashtesë; kundërmasë, kundërmësymje, kundërpeshë, kundërthënie, kundërorvatje,*

Materialet e punimeve (proceedings)

ISBN: 978-1-78911-007-4

kundërvlerë; sipërfaqe, sipërmarrës; pranëvënie; pasardhës, pasdreke, pasrregull, kundëratomik, kundërbërthamor, kundërfetar, kundërkimik, kundërligjor, i kundërligjshëm, kundërnjerëzor, kundërshtetëror; drejtvizor, drejtkëndor, i gjithëfuqishëm, gjithëkombëtar, i gjithëpushtetshëm etj.; gjysmanalfabet, gjysmëbujqësor, gjysmëzyrtar, gjysmëshekullor; i plotfuqishëm, i plotpushtetshëm, jashtëfisinor, jashtëgjuhësor, jashtëkohor, i shumëdëshiruar, shumëshekullor, shumëvjeçar; vetëbartës, vetëkritik, i vetëkuptimshëm, vetëmbushës, vetëmohues etj.

Në tekstin *Gramatikë e gjuhës shqipe 1*, botuar nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë, në Tiranë, në vitin 2002 shembujt në fjalë trajtohen siparashtesa dhe krijojnë fjalë të prejardhura, kurse në studimin tim¹⁴ këto i trajtojmë si fjalë motivuese dhe krijojnë fjalë të përbëra apo kompozita përcaktore.

2. Me rregullat e drejtshkrimit emri i përveçëm Europë rekomandohet të shkruhet Evropë dhe kjo sigurisht sipas ndikimit të gjuhëve sllave, mirëpo duhet të shkruhet me -u- dhe jo me -v-.

“Drejtshkrimi i gjuhës shqipe” i vitit 1972 e ka miratuar trajtën me “ev”, pra “Evropë”. Shqipja nuk ka diftong /ev/, prandaj edhe pse përdoret si e tillë dhe ka zënë vend në shoqëri, kjo çështje mund të rregullohet dhe të vendoset me /eu/, për ato raste, të cilat i përshtatet paradigmave stilistike, semantike dhe gramatikore të shqipes. Në këtë rast /eu/ dhe /ev/, pra /eu-ja/ është diftong, kurse /ev-ja/ nuk është dhe v-ja është një bashkëtingëllore lehtëshqiptuese, e cila në rastet morfologjike ku dy zanore nuk mund të krijojnë diftong, por kërkohet për të lehtësuar shqiptimin e fjalës, si për të krijuar shumësin e gjinore, dhanores e rrjedhore (disa zanore – e zanoreve në gjinore dhe në dhanore zanoreve dhe në rrjedhore zanoreve), apo për të krijuar apo ndërtuar të kryera e thjeshtë të dëftores, si në rastin e zgjedhimit të parë të foljeve, apo si në rastin e foljes laj që është lava, lexoj është lexova, mësoj është mësova, këndoj është këndova etj., kështu që v-ja është e obliguar për t’u përdorur dhe krijuar si shumësin e rasës gjinoren, dhanoren e rrjedhore në shumësin e shquar, ashtu edhe për të formuar kohën e kryer të thjeshtë të dëftores, por edhe si bashkëtingëllore e tillë për të lehtësuar shqiptimin e fjalës.

Sot gjithandej dëgjojmë fjali dhe shembuj të tillë, si: *Diplomat bachelor ekzistojnë në pothuajse në çdo vend të Evropës. Bachelor në Evropë. Universitet Evropiane; Evropë; evropian; evropianizo; evropianizim etj.* Mendoj duhet: *Diplomat baçelor ekzistojnë në pothuajse me çdo vend të Europës. Baçelor në Europë, si dhe euro; euroatlantik; Euroazi; eurodeputet; eurolindor; europarlamentar; europaerëndimor; Eurovizion; eurokomunizëm.*

3. Një çështje tjetër për normën letrare përbën shumësi i emrave të pashquar të gjinisë mashkullore me -a dhe me -e, si: gisht -a, nip-a, hap-a, por këto i gjejmë edhe duke u përdorur në trajtat gishtërinj, nipër, hape etj.

4. Përdorimi dhe shpërdorimi i zanores /ë/ të patheksuar, sidomos i ë-së paratheksore shihet gjithandej se ka probleme, prandaj edhe ka vend për ndonjë kategori të caktuar fjalësh për ta rishikuar mundësinë e përdorimit të zanores ë, siç është heqja e ë-së se patheksuar fundore te disa emra mashkullor, si: lumë djalë, burrë, atë etj. dhe disa emra lëndësh që kanë kaluar nga gjinia asnjënëse në gjininë mashkullore, si: ujë, djathë, gjalpë¹⁵ etj.

¹⁴ Shkelqim Millaku, *Siparashtesë apo fjalë*, Gjuha shqipe, Prishtinë, 1/2023, f.57.

¹⁵ Mehmet Çeliku, *Për një përmirësim të mëtejshëm të shqipes standarde: Mbi ndryshimin e disa rregullave të “Drejtshkrimit të gjuhës shqipe (1973)”*, botuar në: *Shqipja në etapën e sotme: politikat e përmirësimit dhe të pasurimit të standardit*, Tiranë, 2011, f.329 – 338.

5. Kompozitat, si: vetëshërbim, vetëveprim, vetëbesim, vetëbindje, vetëdashje, vetëdije, vetëdrejtim etj., këtu mund të bëhet përjashtime dhe të mos përdorët ë-ja në trup të fjalës si në rastin e përemrave vetvetor, si: vetvetor, vetvetiu, vetvete etj., pra ka mundësi përmirësimi dhe pa e dëmtuar sistemin gramatikor të gjuhës.

6. Mënjanimi i shkrimit të -nj-së në fund të fjalëve tek shumësi i emrave mashkullorë, duke pasqyruar trajtën e re fonetike me -j, si: barij, heroj, lumej në vend barinj, heronj, lumenj etj., mirëpo sipas Çeliku “shkrimi i j-së në vend të nazalit palatal fundor -nj te shumësat e disa emrave mashkullorë dhe në shumësin e disa mbiemrave, si: ftoj, ullij, barij, lumej (në vend të ftonj, ullinj, barinj, lumenj etj.); të mëdhej, të rij (në vend të mëdhenj, të rinj etj.) mund të plotësohet¹⁶.

7. Në komunikimet e ndryshme apo shkrimet tona janë duke u përdorur me të madhe fjalët e huaja, pra “fjalët e huaja, kurdoherë janë si malli që importohet¹⁷,” por edhe shpeshherë si të panevojshme për t’u përdorur dhe disa nga ato shembuj janë, si: apel (nga frëngjishtja apel apo nga italishtja apelo, kurse në shqip) thërras; aplikoj (në latinisht aplicare) vend të zbatoj apo përdor; aprovoj, aprovim (nga latinishtja approvare) në vend të miratoj apo miratim; kurrikul në vend plan-program; curriculum vitae (nga latinishtja kurrikulum vite), në vend jetëshkrim; ezan (nga turqishtja), në shqip thirrje; hajat (nga turqishtja), në shqip korridor; harxhoj (nga turqishtja harc + -o-j), në shqip shpenzoj; human (nga latinishtja humanes), në shqip njerëzor, dashamirë; interpol (nga frëngjishtja Organisation internationale de police criminelle, ose nga anglishtja Internacional Police) në gjuhën shqipe: Organizatë ndërkombëtare e policisë kundër kriminelëve; interpretoj (nga latinishtja interpretari), në shqip shpjegoj, sqaroj; janar (nga latinishtja janarius), në shqip muaji i parë i vitit; jubilar (nga latinishtja jubilaum), në shqip përvjetor; juridiksion (nga frëngjishtja jurisdiction, ose nga latinishtja iudicatio), në shqip e drejtë e një organi për të bërë një gjyq; justifikoj (nga latinishtja justificare), në shqip shfajësoj; jurispodencë (nga latinishtja jurisprudentia), në shqip shkenca e drejtësisë; modifikoj (nga latinishtja modificare), në shqip ndryshoj; preferoj (nga latinishtja praeferre), në shqip parapëlqej; prefiks (nga latinishtja praefixum), në shqip parashtesë etj.

8. Në shkrimet e ndryshme dhe kryesisht ato elektronike mund të vërehen shpesh duke u përdorur variante të ndryshme të paskajores, si: me punu, me punue, kam me bo, kam me ba apo edhe përdorimi i formave të ndryshme të pashtjelluara, si: për të punuar, duke punuar, pa punuar, me punue, tuj punue, pa punue, pa punu, me te punue etj. Këto forma shihen se përdorën në shkrimet e ndryshme elektronike apo edhe në komunikimet e përditshme.

9. Emrat e përveçëm apo të përgjithshëm të gjuhëve të huaja, siç e kemi rastin e anglishtes dhe përdorimin e fonemës /w/, e cila në gjuhën shqipe ka mundësi të zëvendësohet me zanoren /u/ apo bashkëtingëlloren /v/, si: Edward – Eduard – Edvard; New York – Neu York – Nev York – Nju Jork; Weekend – uikend – vikend, News, show, windows, word Willam Woker etj. Kjo nuk është një problem grafik i vogël, sidomos nga roli apo nga ndikimin i anglishtes që ka sot në gjitha sferat e jetës, prandaj kjo çështje meriton vëmendje studimore të shtuar.

10. Terminologjia është tërësia e termave të një fushe të shkencës, si ajo e gjuhës, e kulturës, e teknikut, e juridikut, e bujqësisë, e psikologjisë, e informatikës, e artit, e jetës

¹⁶ Mehmet Çeliku, *Për një përmirësim të mëtejshëm të shqipes standarde: Mbi ndryshimin e disa rregullave të “Drejtshkrimit të gjuhës shqipe (1973)”*, botuar në: *Shqipja në etapën e sotme: politikat e përmirësimit dhe të pasurimit të standardit*, Tiranë, 2011, f.329 – 338.

¹⁷ Asllan Hamiti, *Kultura e gjuhës për të gjithë*, Shkup, 2018, f.5

shoqërore, e politikës, terminologjisë popullore etj., të fusha janë duke u pasuruar çdo ditë me fjalë të reja. Në këtë pikë do t’i veçoj vetëm dy fusha:

a. Në fushën e informatikës kemi prurje të reja, të cilat nuk janë të lehta edhe të shqipërohen, apo edhe të zëvendësohen dhe t’i përshtatën sistemit gramatikor të shqipes, si: Harduer¹⁸, memoria, tastier, miu, monitori, printer, altoparlanti, mikroprocesor, softueri, windows, serverët, desktop, laptop, notebook, mikrokontrolluesi, wan, web-ueb, link, folder, flash, file (fajll-skedarët - dokument a skedë), start, input, output, run, license, agreement, install, segmentuesve, accept – pranoj, delete-heq, error-gabim, close (kllouz- mbyll), save (sejv – ruaj), place (pillejs- vendos), page (pejxh- faqe), mouse (maus- miu, mijuesi), box (boks- kuti), typeover (tajpouer - mbishkruarje a mbishtypje), formatim apo formatizim (angl. Formatting), klikoj, klikim, pikoj pikim; listoj listim, pulsoj pulsime, memorioj memorim, skenoj, skenim (skenerim), resetoj resetim, printoj, printim, kuadroj, kuadrim, ributoj, ributim, editoj, editim etj., dhe shumë shembuj të tjerë që janë duke u përdorur në gjuhë si të tilla, por sfiduese për sistemimin e tyre.

b. Përdorimi i grupit të fjalëve në terminologjinë e drejtësisë është prodhimtar dhe si i tillë mund ta pasuron gjuhën. Në këtë studim prezantojmë tre shembuj: fjalën *kod*, *kontratë* dhe *e drejtë*, të cilat kur të përdoren në grupe të qëndrueshme të fjalëve mundësojnë me dhjetëra variante kuptimore, si: *Kodi Civil*; *Kodi Civil Francez*; *Kodi Civil i Mbretërisë Shqiptare*; *Kodi i procedurës civile*; *Kodi i procedurës penale*; *Kodi i sigurisë së llogarisë*; *Kodi penal*; *Kodi Penal Francez* etj. *Kontratë*¹⁹ *abstrakte*, *kontratë aderimi*, *kontratë adezioni*, *kontratë administrative*, *kontratë agjencioni*, *kontratë aksesore*, *kontratë autorizimi*, *kontratë bamirësie*, *kontratë bilaterale*, *kontratë bilaterale ndërkombëtare*, *kontratë dërgimi*, *kontratë dhurimi*, *kontratë detyrimi*, *kontratë huasë* etj., *E drejta absolute*, *e drejta administrative*, *e drejta ajrore*, *e drejta bashkëshortore*, *e drejta biznesore*, *e drejta civile*, *e drejta derivate*, *e drejta detare*, *e drejta diplomatike*, *e drejta e personalitetit* etj.

11. Çështja e njëmbëdhjetë nuk është që ka vlerë ndikuese me pak, mirëpo i radhitem në këtë formë në mënyrë që kjo e fundit kërkon një mobilizim logjistik të shtuar, pra rrjetet sociale janë shtrirë gjithandej dhe në nivele të ndryshme të komunikimit. Në komunikime sociale vërehet një shkujdesje e tepruar e gjuhës. Lëshimet apo shmangiet vërehen në përdorimin e fjalëve të huaja në vend të fjalëve shqipe. Mos përdorim i drejtë i ë-së. Përdorimi i gabuar i shkurtësive. Përdorimi i gabuar i shkronjës së madhe. Shmangie hetohet në këmbimin e ç-së me q-në apo edhe xh-së me gj-në. Fjalët përdoren me kuptime të gabuar. Përdorimi i shenjave të pikësimit vende e pavend. Përdorimi i shkurtësive jashtë standardit. Fjalitë nuk kanë mbarim logjik dhe shumë lëshime të tjera, të cilat mund të vërehen në publikimet e ndryshme sociale, të cilat mund të jenë edhe shkresa zyrtare.

Përfundim

¹⁸ Hardueri: Lidhet me funksionin e pajisjeve mekanike, magnetike, elektrike që mund të përfshihen në sistemin kompjuterik... Hardueri si fjalë e tillë është e vështirë që t’i përshtatet paradigmave të gjuhës shqipe. Si emër i lakimit të parë është bukur e vështirë që të lakohet si në njëjës, ashtu edhe në shumës në të gjitha rasat dhe të mbetet fjalë kuptimore, prandaj kërkohet përkthim i kujdesshëm dhe përshtatje profesionale për këtë term të fushës kompjuterike.

¹⁹ Terminologjia e drejtësisë ka një rol të veçantë për pasurim e gjuhës. Për ta fuqizuar këtë fjali marrim shembullin e fjalës *kontratë*, e cila në fjalorët tonë shpjegues, që ju kemi referuar deri me tani, e kemi fjalë me një kuptim dhe për shembuj e prezantuar nuk përshkruhen kuptimet e tyre, kurse në *Fjalor i termave të drejtësisë* për fjalën *kontratë* e kemi me tetëdhjetë versione kuptimore. Për më shumë informacione shih: Sylë Kasumaj, *Fjalor i termave të drejtësisë*, Prishtinë, 2019.

Materialet e punimeve (proceedings)

ISBN: 978-1-78911-007-4

Përdorimi i drejtë i gjuhës standarde shqipe është obligim kushtetues. Fati i (mos) respektimit të gjuhës standarde shqipe, aty ku është gjuhë zyrtare apo e lejuar si gjuhë zyrtare në përdorim, varësisht nga vendi, fati i gjuhës shqipe është i lidhur edhe me fatin ndikues të zhvillimeve të reja globale, të cilat janë duke i sfiduar gjuhët dhe popullit që kanë zhvillim ekonomik të dobët. Në trojet shqiptare në të gjitha fushat e mundshme shihet vullneti për ta respektuar dhe përdorur drejt shqipen standarde. Nuk mund të mohojmë se nuk ka respekt të shtuar ndaj gjuhës, si në shkolla, në administratë, pastaj në media të ndryshme, apo në mbishkrime të ndryshme të rrugëve, të institucioneve, shkrimet dhe publikimet e ndryshme në faqet zyrtare të institucioneve publike dhe private, faqet elektronike zyrtare të institucioneve qendrore apo komunale, emërtimi i emrave personal apo emrave të përveçëm etj., dhe në fusha të tjera, shihet se ka elemente për përkujdesje ndaj gjuhës, mirëpo natyrshëm nga gjitha këto që i thamë ose nga pika një deri në njëmbëdhjetë që i kemi prezantuar me shembuj janë të mundshme për të kërkuar përkujdesje të shtuar për ruajtjen, zhvillimin dhe përdorimin e drejtë të gjuhës standarde.

Literaturë

- ASh e RPSSh: *Fjalor drejtshkrimor i gjuhës shqipe*, Prishtinë, 1983.
- ASh e RSh: *Për pastrinë e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1998.
- Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, *Drejtshkrimi i gjuhës shqipe*, Tiranë, 1973.
- Fjalor i fjalëve të huaja*, Prishtinë, 1988.
- Fjalori i shqipes së sotme*, botimi i dytë i ripunuar, Tiranë, 2002.
- Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, *Gramatikë e gjuhës shqipe I, II*, Tiranë, 2002.
- Instituti i Albanologjik i Prishtinës, *Drejtshkrimi i gjuhës shqipe*, Prishtinë, 1974.
- Islamaj, Sh: *Gjuha ligjërimi dhe fjala*, Prishtinë, 2004.
- Islamaj, Shefkije, *Shqipja standarde dhe modernizimi i saj*, Gjuha shqipe, 3/2008, IAP, Prishtinë, 2008.
- Kostallari, Androkli, *Gjuha e sotme letrare shqipe dhe disa probleme themelore të drejtshkrimit të saj*, Tiranë, 1973.
- Lafe, Emil, *Gjuha e medias sot -probleme dhe detyra*, Gjuha jonë, 1-2/2000, Tiranë, 2000.
- Memushaj, R: *Shqipja standarde*, Tiranë, 2004.
- Millaku, Sh: *Kërkime gjuhësore 2* (monografi), Prishtinë, 2019
- Millaku, Sh: *Shqipja e sotme dhe marrëdhënies e saj me gjuhët e tjera*, Prizren, 2019
- Millaku, Sh: *Tekst ushtrimesh për lakimin e emrave dhe zgjedhimin e foljeve*, (ribotim), Prishtinë, 2019.
- Millaku, Sh: *Historiku i njëjës se prapme (kontrast me gjuhët ballkanike)*, Edukologjia, Prishtinë, 2015, nr.2, f.81-96. Prishtinë.
- Millaku, Sh: *Kërkime gjuhësore*, Prizren, 2015.
- Millaku, Sh: *Kontributi i Zellik Harris për gjuhësinë*, IASH. Tetovë, (2009).
- Millaku, Sh: *Strukturat sintaksore*, Prishtinë, 2011.
- Millaku, Sh: *Studime gjuhësore I*, Prishtinë, 2011.
- Rregullat e pikësimit në gjuhën shqipe*, AShRSh, Titanë, 2002.
- Shkurtaj, Gjovalin, *Ta duam dhe ta mbrojmë gjuhën tonë të bukur*, ShBLSh, Tiranë, 1998.

Gjedhe ndërndikimi gjuhësor italian në terminologjinë juridike shqipe

PROF. AS. BRUNILDA DASHI

Fakulteti i Letërsisë dhe i Filozofisë, Sapienza Universiteti i Romës – Itali

Abstrakt

Kontaktet shumëshekullore, historike dhe kulturore, midis dy popujve në brigjet e Adriatikut kanë lënë gjurmë veçanërisht në leksikon e shqipes. Ky punim analizon një gjedhe të veçantë të ndërndikimit gjuhësor italian në terminologjinë juridike shqipe. Bëhet fjalë për leksemën *e drejtë* (-a) / (il) *diritto* “tërësi normash” në traditën gjuhësore italiane e shqipe.

Rindërtimi kronologjik i historisë së fjalës zë fill detyrimisht me qasjen, formale e semantike, ndaj leksemës burimore latine, e cila paraqet, në rrugë krejt të pavarur në italishte dhe në shqipe, modalitete të ndryshme marrjeje dhe përshtatjeje fonetike, çka varet nga origjina e specifikave e dy idiomave, dhe përqendrohet, më pas, në hetimin jo vetëm të ndërrimit kategorial të huazimit latin në të dyja gjuhët marrëse por edhe të specializimit e tij në fushën juridike vetëm në italishte.

Vjelja e dëshmimeve shkrimore të leksemës në shqyrtim nga tekstet e vjetra shqipe (Buzuku, Bardhi e Bogdani) deri te fjalorët dygjuhësh shqip-italisht e italisht-shqip të autorëve italianë të shekujve të XIX e të XX (Rossi, Buseti, Leotti e Cordignano), që e regjistrojnë në fjalësin e tyre, bën të mundur të diktohet fenomeni - vërtet tejet i papritur - i realizimit të kalkut kuptimor në gjuhën shqipe me shtysën e gjuhës-model, pra të italishtes, dhe të përcaktohet koha e lentimit të tij. Fenomeni gjuhësor nuk sjell si pasojë pasurimin e inventarit leksikor të gjuhës amtare me një zë të ri, por zgjerimin e spektrit semantik të një zëri ekzistues në gjuhë, zë i ligjërimin të zakonshëm, huazim i vjetër latin tashmë i stabilizuar prej shekujsh, që përfton përdorim sektorial e specializohet në terminologjinë juridike vetëm falë ndërndikimit të gjuhës fqinje.

Fjalë kyçe: *Huazim, kalk kuptimor, terminologji juridike*

Kontaktet shumëshekullore, historike dhe kulturore²⁰, midis dy popujve në brigjet e Adriatikut kanë lënë gjurmë veçanërisht në leksikon e shqipes²¹. Gjuha italiane, e perceptuar me të drejtë me prestigj më të lartë, e pasuron gjuhën shqipe, e cila herë-herë paraqet mangësi leksikore, sidomos në terminologji, meqenëse i afrohet kulturës, falë ngjarjeve historike që e kanë karakterizuar, më vonë se simotrat e saj më të zhvilluara evropiane.

Ky punim përqendrohet në ndërndikimin gjuhësor italian në terminologjinë juridike shqipe. Analiza e një fenomeni të tillë gjuhësor imponon një vështrim kronologjik që zë fill detyrimisht me latinishten, burim i përbashkët nga kanë vjelur, në mënyrë krejt të pavarur, të dyja gjuhët: italishtja ka trashëguar nga nëna e saj *leksema të përbashkëta*, disa prej të cilave në epokën moderne janë specializuar dhe kanë përfutur *përdorim sektorial*, siç është ai *juridik*; në të njëjtën mënyrë, shqipja, falë *kontaktit direkt me latinishten ballkanike* deri në shek. X, ka huazuar dhe stabilizuar qëndrueshëm në gjuhë zëra të shumtë nga latinishtja, ndër të cilët pikërisht ato fjalë që sot i përkasin sferës të *së drejtës*, ende të gjalla dhe të pazëvendësueshme.

²⁰ Khs. R. Gusmani, *Saggi sull'interferenza linguistica*, vëll. I, Le Lettere, Firenze 1981, f. 7.

²¹ Khs. P. Di Giovine, *Un millennio di storia linguistica albanese: l'influsso lessicale della lingua italiana*, në «L'Italia dialettale», rivista di Dialettologia italiana, vëll. LXIX (Serie Terza, V), Edizioni ETS, Pisa 2008, ff. 108-139.

Kjo trajtesë synon të hulumtojë rrugën e marrjes dhe të përshtajtjes së leksemës juridike bazë, *e drejtë* (-a) / (il) *diritto* “tërësi normash”, në traditën gjuhësore italiane e shqipe.

Paraardhësja formale dhe semantike është sigurisht latinishtja *iūs* “tërësi normash / *diritto*”, marrë si në italishte dhe në shqipe, në mënyra krejt të ndryshme, siç janë të ndryshme ndërrimet fonetike, të kushtëzuara nga origjina specifike e dy gjuhëve.

Në italishte, latinishtja *iūs* vijon në fjalë të thjeshta, të prejardhura dhe të përbëra.²²

Në dhjetëvjeçarët e parë të shek. XIV regjistrohet për herë të parë emri i thjeshtë *giure* “e drejtë (it. “*diritto*” -sic-)” [*giura*: para vitit 1321 - DELI] në kuptimin “tërësi normash ligjore o kanunore”, marrë nga latinishtja *iūs* (gjinore *iūris*), që në origjinë kishte kuptimin “formulë fetare që ka fuqi ligjore” [Zingarelli].

Fjalë të prejardhura që në latinisht nga *iūs*- vijnë te mbiemri *giusto* “që përputhet, që i përket tërësisë së normave” [lat. *iūstu(m)*, nga *iūs*; para vitit 1250 - Po aty], i cili haset së pari nga mesi i shek. XIII, dhe te emri *giustizia* “sipas tërësisë së normave” [lat. *iustitia(m)*, nga *iustus*; rreth vitit 1261 - Po aty], që ndeshet vetëm disa vite më vonë.

Bashkëkohëse e zërave të prejardhur është edhe vazhdimi i kompozitës latine me *iūs*-, *giudice* “ai që tregon ose thotë/kumton (nga tema e foljes *dicere*) tërësinë e normave (*iūs*)” [lat. *iūdice(m)* - DELI], në origjinë “ai që kumton formulën fetare të drejtësisë, që quhet *iūs*” [rreth vitit 1261 - Zingarelli].²³ E njëjta fjalë e përbërë latine shërben si temë e foljes së prejardhur *giudicare* “them, kumtoj (*dicere*) tërësinë e normave (*iūs*)” [DELI] [lat. *iudicāre*, nga *iūdex iudicis* “giudice”; rreth vitit 1261 - Zingarelli] dhe i emrit të prejardhur *giudizio* “vendim i atij që tregon ose kumton tërësinë e normave” [Zingarelli], “proces gjyqësor” [lat. *iudiciu(m)*, nga *iūdex iudicis* “giudice”, para vitit 1294 - DELI].

Në shqipe, vazhdimet e latinishtes *iūs*, në fjalë të thjeshta dhe të prejardhura, gjegjëse të zërave italiane *giure*, *giusto* e *giustizia*, që u përmendën më sipër, mungojnë.

Por ndeshen huazime kompozitash latine me *iūs*-. I përkasin kësaj tipologjie folja *gjykoj* (†*gjukoj*) [lat. *iudicāre* - Çabej SE IV] dhe emri *gjyq* (në kuptimin *gjykim* “processo, causa”) [lat. *iudiciu(m)* - Po aty], që del së pari te Buzuku [Ashta I]. Pra, gjuha shqipe huazon leksemat latine *gjykoj* e *gjyq* njëllor si italishtja që vazhdon leksemat e barasvlerëshme *giudicare* e *giudizio*.

Veçse, ndryshe nga italishtja, shqipja nuk huazon kompozitën latine *iūdice(m)*, it. *giudice*, sepse këtë fjalë e lenton brenda gjuhës (në mjedis njëgjuhësh), duke përdorur rrënjën latine të përshtatur dhe prapashtesën vendëse, sipas rregullave të veta të formimit të fjalëve: neologjizmi i Pesëqindës *gjukatës* [*gjukatës*, Buzuku: Ashta I] ndiqet nga ai më modern, i Tetëqindës, *gjyqtar* [*gjyqtar*, Rossi 1866 (te zëri *giudicatore*, *giudice*)]²⁴. Të dyja krijimet janë ende të gjalla në gjuhën amtare.

²² Për të thjeshtuar analizën semantike, zërat e italishtes radhiten sipas formimit të tyre (nga fjalë të thjeshta te fjalë të prejardhura e të përbëra), pavarësisht kronologjisë së dëshimit.

²³ Përkufizimi modern është “pubblico ufficiale investito della funzione di giudicare in un giudizio attuando nel caso concreto la norma generale del diritto” [Zingarelli].

²⁴ Neologjizma të tjerë janë formimet prapashtesore: *gjukatë* [leksemë e regjistruar me kuptimin “tribunale; corte (organo giurisdizionale)” duke filluar nga Busetti. Varianti *gjukatë*, nomen actionis, nga *gjukoj*, sipas Çabejt [SE IV], del te Budi e te Bardhi, me kuptimin “rasë” [Ashta II e III]; me të njëjtin kuptim e regjistron edhe Da Lecce: *gjukatë* “fatto (sic), destino”, po aty shton edhe “condannazione (sic)”, *gjykim* [*gjukim*, Bogdani: Ashta IV], *gjyqësor* [*gjuqësor*, Leotti; *gjyqësuer*, Cordignano], etj.

Një vëmendje të veçantë meriton mbiemri *giuridico* “që ka të bëjë me tërësinë e normave”.

Në italishte regjistrohet së pari në shek. XIV sec. dhe ndjek rrugën e zakonshme të përshtatjes së kompozitave latine me *iūs*- [fjalë e ligjërimit libror, lat. *iuridīcu(m)*, e përbërë nga *iūs* (gjinore *iūris*) “diritto” dhe nga *dicēre* “dire” - DELI].

Ndërsa në shqipe fjala latine *iuridīcus* nuk është huazuar. Shqipja përdor mbiemrin *juridik* (*terminologjia juridike*), i marrë në vitet Tridhjetë [Leotti e Cordignano]²⁵ nga gjuhët neolatine (nga it. *giuridico* ose, ndoshta edhe më e mundshme, nga fr. *juridique*), duke mbajtur formën latine *iūs* (gjinore *iūris*).²⁶

Po të vështrohet me kujdes kjo përfaqje leksikore, sigurisht e njohur, referimi specifik i fjalës *e drejtë / diritto*, objekt i kësaj kumtese të shkurtër, del vetëm në italishte, në zërin *giure*, dhe nuk ekziston në shqipe. Fjalët e tjera të cituara, në të dyja gjuhët, kanë të bëjnë me *veprime, përkatësi, operatorë* etj. të *së drejtës* si “tërësi normash”.

Për më tepër, në italishte, fjala *giure* nuk përdoret rëndom për të dhënë përkufizimin e zërit *diritto*, si “tërësi normash ligjore o kanunore”, sepse është fjalë e stilit të lartë, kryesisht letrar (p.sh. flitet për *ius soli* “e drejtë [*diritto*] që vjen si pasojë e lindjes në një shtet të caktuar” por askush nuk thotë “e drejtë [*giure*] që vjen si pasojë ...”).

Pikërisht këtu lind nevoja e lënies mënjane të fjalës latine *iūs* “e drejtë / giure, diritto” dhe e marrjes në shqyrtim të leksemës italiane *diritto*, e përdorur rëndom në kuptimin “tërësi normash”.

Në italishte zëri *diritto*, i adoptuar nga latinishtja, regjistrohet nga mesi i shek. XIII si mbiemër me kuptimet “në vijë të drejtë” dhe “i ndershëm” [lat. volg. **dirīctū(m)* për lat. klas. *dirēctū(m)*, përbërë prej *dī-/dē-* e *rēctus* “i hequr në vijë të drejtë”; rreth vitit 1250 - Zingarelli].

Vetëm disa vite më vonë, përdorimi i vazhdueshëm si emër i mbiemrit *diritto* [fjalë e ligjërimit libror, lat. e vonë *dirēctū(m)* “në vijë të drejtë” si e kundërta e *tōrtū(m)* “i shtrëmbër”; rreth vitit 1261 - Po aty] lenton në italishte një njësi leksikore të mëvetësishme, e cila merr kuptimin e sotëm “tërësi normash”, duke u specializuar në sektorin juridik. Fjala *giure*, që u përmend më sipër, regjistrohet më vonë.

Edhe shqipja huazon të njëjtën leksemë latine [*derēctus* o *dirēctus*]. Lentohej ndajfolja *drejt* (†*dërejt*, †*dëreq*) [lat. volg. *derēctus* o lat. klas. *dirēctus* - Çabej SE III (më parë dhe Miklosich-i e Meyer-i)], nga del pastaj mbiemri *i, e drejtë* (†*i, e dërejtë*). Të dy zërat dalin te Buzuku [Ashta I].

Edhe në shqipe haset emërimi i mbiemrit, në gjininë femërore, siç ndodh rëndom për kategorinë e emrave abstraktë, *e d(ë)rejtë*, por ndryshe nga italishtja, që lenton kuptimin e ri modern të leksemës *diritto* “tërësi normash”, shqipja ruan kuptimin origjinal të latinishtes. Në të vërtetë, te Buzuku, Bardhi e Bogdani, pra deri në fund të shek. XVII, del kuptimi “i drejtë si karakter, i sinqertë; drejtësi veprimi; e vërteta, vërtetësi” [Ashta I, III e IV] dhe te Budi “drejtësi” (*i së dërejtësë*) [Ashta II].

²⁵ Da Lecce regjistron zërin *giuridico* dhe e përkthen “i gjykës, me gjyq” (sic); ndërsa Rossi 1866 te zëri *giuridico, secondo della giustizia* (sic) shënon “*dërejt, me gjyq, me sheriat*” (sic).

²⁶ Huazimi latin përjashtohet, sepse evoluimi i tingujve latinë *iū-* (në fillim të fjalës) jep *gju-/gju-* në shqipe dhe, për më tepër, mbylltorja ndërzanore zhduket rregullisht (khs. *iudīciu(m)* → *gjuq; iudicāre* → *gjuqoj / gjuqoj*). Ndoshta rruga e marrjes së fjalës nga frëngjishtja është shkrimore, gjë që shpjegon dhe *j-* për *zh-* në fillim të fjalës.

Bashkohet me këtë grup autorësh shqiptarë dhe Francesco Da Lecce (1702), autori i parë italian i fjalorit dygjuhësh (italisht-shqip), që regjistron leksemën *të dërejt*, si emër të gjinisë asnjane (*të dërejt, itë, it -sic-*), për të përkthyer zërin italian *innocenza*.

Del qartë se, deri në vitet e para të shek. XVIII, mungon në kulturën shqiptare, kuptimi modern i fjalës *diritto*, në kuptimin e mirëfilltë të italishtes. Me kureshtje shtrohet pyetja se cila mund të ishte fjala shqipe e përdorur në atë periudhë për të treguar “tërësinë e normave ligjore o kanunore”.

Dihet se kultura shqiptare nuk është fort e pasur me tekste të shkruara në fazat e hershme të saj. Prandaj, duhet kapërcyer një hark kohor prej një shekulli e gjysmë, për të shfletuar një vepër leksikografike e cila kontribuon në sqarimin e pyetjes.

Dhe vërtet, i përket gjysmës së dytë të shek. XIX botimi i fjalorit italisht-shqip, *Vocabolario italiano-epirotico* (1866), të një tjetër autori italian, Francesco Rossi, që jetoi 15 vjet me radhë në Shqipërinë e Veriut. Ati françeskan, pasi u kthye në Itali, u mundua t’u jepte një vepër të dobishme bashkëvëllezërve të tij që do të niseshin nëpër misione në tokat shqiptare.

Ai regjistron për *dirittanza, giustizia, rettitudine* leksemën shqipe *dërejt (-a)*²⁷, si pararendësit, dhe deri këtu s’ka asgjë të re (le të vihet re mungesa e nyjës së përparme femërore *e*, gabim tipik i një personi që nuk ka gjuhë amtare shqipe dhe që nuk e ka një nyjë të tillë në gjuhën e vet).

Por kur përkthen *diritto, dritto, giustizia*, përdor *kanun* e *ligjë* (sic). Ja, pra, është e qartë se brenda gjuhës (në mjedis njëgjuhësh), nuk kishte një zbrazëti leksikore që duhej plotësuar, si italishtja, më parë, sepse gjegjësi semantik i emrit *diritto* ekzistonte. Për më tepër, ishin dy fjalët e barasvlershme: e para, leksema turke *kanun* “tërësi normash kanunore” (kodi kanunor) [turq. *kanun* “rregull, normë”, nga gr. e re *kanōn* “rregullore” - Çabej SE V], dhe e dyta, leksema latine *ligjë* “normë, rregull” [lat. *lēge(m)* - Po aty], të huazuara dhe të stabilizuara qëndrueshëm në gjuhë.

Radhitja është domethënëse: zëri *kanun*, që nuk del te tekstet e vjetra²⁸ dhe as te Da Lecce (1702), ishte fjalë e përdorimit të përditshëm, e cila i referohej një ‘institucioni’ autokton (mjafton të kujtohet *Kanun i Lekë Dukagjinit*, që i përket shek. XV), prandaj përbënte përzgjedhjen e parë sinonimike të Autorit, ndërsa latinizmi *ligjë*, megjithëse me traditë më të vjetër, i regjistruar nga Buzuku e më vonë, ishte fjalë librash dhe me sa duket nuk përbënte një konkurrent ‘autoritar’.

Por vetë Rossi, italishtfolës, ndiente një lloj ‘papërsosurie’, të themi, në përqasjen semantike të fjalës *diritto*, përkthyer me “canone” (*kanun*) e “legge” (*ligjë*). Kjo del qartë kur përkthen *giure, diritto, gius* (sic) me leksemat *ligjë* e *kanun*, siç kishte përkthyer *diritto, dritto, giustizia*, që u përmendën më lart, të cilave u shton dhe leksemën sinonimike [e]²⁹ *dërejt (-a)* [it. “(il) diritto”].

Është dëshmia e parë e zgjerimit semantik të zërit tashmë të shqipes, [e] *dërejt* (themi, të shqipes, sepse fjala nuk e mëton menjëherë origjinën e vet latine).

Lind pyetja, pse të përdoret pikërisht kjo leksemë, [e] *drejtë* [it. “diritto”]?

Përzgjedhja ka një bazë pararendëse, duke qenë se ekzistonte që më parë një korrespondencë midis leksemash të ngjashme nga ana semantike: gjegjësit e mbiemrit italian

²⁷ Shënohet forma e shquar, siç regjistrohet në fjalor, për të vënë në dukje përkatësinë në kategorinë gramatikore të emrit.

²⁸ Budi regjistron italianizmin *kanon* për “canone (regola fondamentale)” [Ashta II].

²⁹ Plotësimi me nyjën e përparme në kllapa katrore [e] bëhet për të respektuar traditën shkrimore të leksemës.

Materialet e punimeve (proceedings)

ISBN: 978-1-78911-007-4

diritto ishin në fillim ndajfolja *drejt* dhe mbiemri *i drejtë* në shqipe. Dhe për analogji me modelin italian, që ka një leksemë polisemike³⁰ (*diritto*), duhet të ketë qenë e natyrshme për Rossi-n shtrirja e ngjashmërisë semantike edhe te mbiemrat gjegjës të emëruar, të pranishëm në të dyja gjuhët, me nxitjen apo përcjelljen e kuptimit të ri në leksemën ‘tjetër’, atë vendase, shqipe: *diritto* (emër) “tërësi normash” → *e drejtë* (emër) “tërësi normash”.

Nga ana e ndërndikimit të gjuhës dhënëse, pra të italishtes, te gjuha marrëse, pra te shqipja, fenomeni gjuhësor quhet *kalk semantik*.³¹ Dhe është pikërisht ky fenomen gjuhësor që ka vepruar në leksemën *e drejtë* në gjuhën amtare.

Veçse Rossi ka gjuhë të nënës italishten; si rrjedhim, ndryshon kriteri kryesor për realizimin e kalkut: lentuesi duhet të jetë shqipfolës, të ketë gjuhë të nënës shqipen. Prandaj, megjithëse është e arsyeshme të mendohet se Rossi ishte mendjemprehtë dhe novator, siç do të shihet në vijim, është e logjikshme të mendohet se shtrirja e ngjashmërisë semantike, që tashmë dihet se do të ishte jetëgjatë, mund t’i ishte sugjeruar Autorit nga vendësit me të cilët ishte në kontakt, sepse ishte në qarkullim, ndoshta në mjedise të ngritura kulturore.

Disa vite më vonë, Rossi boton versionin shqip-italisht të *Fjalorit* të tij (1875). Ndryshimi i thellë leksikor midis dy idiomave, me siguri gjerësisht i perceptuar, e bën të jetë më përzgjedhës dhe i matur. Dhe vërtet regjistron *kanun*, që përkthen me *diritto; canone, regola* (f. 114 e f. 635), njëlloj si në botimin e mëparshëm italisht-shqip, por nuk rendit midis kuptimeve të zërit *ligjë*, përkthyer me fjalët *legge; regola*, kuptimin *diritto* (ff. 740-741), duke e përjashtuar qëllimisht.

Pra, mban gjegjëset *kanun* → *diritto* por eliminon *ligjë* → *diritto*, sepse ndërkohë Rossi ka krijuar një ide tjetër për leksemën *diritto*.

Në kulturën italiane, shkenca juridike lind, në kuptimin modern, rreth mesit të shek. XVII (1667) [DELI]; zëri *diritto* është tashmë specializuar dhe i përket terminologjisë juridike. I nxitur nga modeli italian, Autori zgjedh, për herë të parë, të specializojë zërin e ri [e] *dërejt* (-a) (ff. 261-262), duke e preferuar ndaj fjalës turke *kanun* (dhe, mund të shtohet, edhe ndaj latinishtes *ligjë*, të cilën e kishte lënë mënjanë më parë, siç u tha më lart).

Kjo kuptohet jo vetëm nga përkthimi i leksemës [e] *dërejt* (-a)³² me *diritto*, por sidomos nga shembujt e përdorimit në italishte që pasurojnë zërin, shembuj që i përkasin *sektorit juridik*, e pikërisht: *diritto civile, o canonico* e *diritto naturale*. Për më tepër, jep edhe shpjegimin e tyre, vetëm italisht (përkatësisht: “corpo delle leggi civili, o ecclesiastiche”, “facoltà che ha l’uomo di operare secondo i proprii naturali sentimenti” -sic-), dhe nuk shënon gjegjësit shqip.

Nuk është harresë, por zbrazëti terminologjike: Rossi, me sa duket, nuk dispononte, ashtu si edhe rrënjësit, fjalë vendëse që të ishin gjegjëse të gjuhës sektoriale të specializuar italiane, sepse terminologjia nuk kishte depërtuar mjaftueshëm në kulturën shqiptare. Rossi sugjeron rrugën që duhet ndjekur: specializimin e leksemave të rëndomta të gjuhës, ato të përdorimit të përditshëm.

U pranua ideja e tij? Po, por jo menjëherë, dhe jo në mjedis njëgjuhësh.

Konfirmimi arrin në dekadën e parë të Nëntëqindës, kur sheh dritën në Shkodër *Fjalori* shqip-italisht i shoqërisë *Bashkimi*. Aty regjistrohet *e drejtë* që përkthehet me *giustizia, verità*, sipas traditës së konsoliduar (me përjashtim të Rossi-t), dhe *kanunë* (sic) me *diritto, legge*.

³⁰ Khs. R. Gusmani, *Saggi sull’interferenza linguistica*, vëll. II, Le Lettere, Firenze 1983, ff. 13-14.

³¹ Po aty.

³² Është regjistruar edhe zëri *drejt,-a* për *diritto* (f. 306), që shpie te *dërejt* (ff. 261-262) [Rossi 1875].

Është fare e qartë se fjala turke ishte ende më e përdorura ose, më mirë, mbizotëruese në shqipen e asaj kohe dhe zgjerimi kuptimor i leksemës *e drejtë*, i regjistruar në fjalorin e Rossi-t, nuk ishte përhapur. Sidoqoftë ky rrugëtim është karakteristik i fenomenit të kalkut: zgjerimi semantik është fillimisht i rastësishëm, në kontekste të caktuara,³³ pastaj stabilizohet, për shembull, në përdorim sektorial. Tamam si sugjeronte Rossi.

Njihet përfundimi i këtij fenomeni. Qëndrimi i përgjithshëm, karakteristik i lëvizjes kulturore të Rilindjes, që nxiste mënjanimin e fjalëve turke në shqipe, ndoshta ka ushtruar ndikimin e vet në konkurrencën, më parë, dhe në epërsinë, më pas, të kalkut semantik italian (*e drejtë*) ndaj huazimit leksikor turk (*kanun*).

Konfirmon kontributin origjinal të autorëve italianë në gjuhën shqipe, megjithëse në bashkëpunim me shqipfolës (gjithmonë të cituar për ndihmën bujare që u jepnin), një tjetër prift italian, Buseti, autor i fjalorit italisht-shqip, botuar në Shkodër, vetëm tri vite më vonë, se ai i *Bashkimit*, i cili përkthen zërin *diritto* me *e drejtë*, duke futur në përdorim kuptimin e ri të regjistruar nga Rossi.

Pikërisht në këtë fjalor për herë të parë zëri *e drejtë* përfshihet në përkthime profesionale: *diritto naturale* “e drejtë-a natyrike” dhe *diritto divino* “e drejtë-a e hyjnueshme”, bashkë me zërin e konsoliduar *kanun*: *diritto civile* “kanun-i shekullarë” dhe *diritto canonico* “kanun-i kishtarë” (f. 326). Ja, pra, fillimet e depërtimit të terminologjisë juridike në gjuhën shqipe, duke ndjekur modelin italian.

Ndjek Buseti-n fjalori i Leotti-t, shqip-italisht, që rendit si kuptim të parë të fjalës *e drejtë*, “diritto”, pastaj “verità, ragione, legge”. Dhe shënon: *e drejta ndërkombëtare* “il diritto internazionale”; *e drejta ndëshkimore* “il diritto penale”; *të drejtat njerëzore* “i diritti dell’uomo” (f. 129).

Të njëjtën gjë bën Cordignano në fjalorin e tij italisht-shqip: *diritto* është përkthyer me *e drejta*, *kanû* (sic) [formë e gegërishtes]. Për më tepër regjistron gjeçësitet shqipe të sektorëve të ndryshëm të së drejtës: *diritto costituzionale* “e drejta kostitucionare asë themelore”, *positivo* “pozitive”, *naturale* “natyrore”, *personale* “vehtjake”, *privato* “private”, *pubblico* “botore”, *amministrativo* “administratore” op. “sundimtare” (sic), *internazionale* “ndërkombtare”, *civile* “civile osë qytetare”, *penale* “penale osë ndëshkimore”, *ereditario* “trashigimore”, *religioso* “fetare”, *commerciale* “tregtare”, *marittimo* “detare” (ff. 115-116). Dallohet qartë se leksema *kanun* është mënjeluar përfundimisht nga terminologjia juridike.

S’është e tepërt të kujtohet këtu se tradita leksikografike e shqipes, e përruarur më 1635 me *Dictionarium latino-epiroticum* të Bardhit, që u përmend më sipër, është konsoliduar me një sërë fjalorësh dygjuhësh, edhe të autorëve italianë, të cilët kanë punuar pareshtur e me zell të madh. Kultura shqiptare regjistron, për herë të parë, pasurinë e vet leksikore në një fjalor shpjegues (njëgjuhësh), të përdorimit të përgjithshëm, vetëm në vitin 1954³⁴. Zëri *e drejta*, që trajtohet këtu, regjistrohet aty me kuptimin e ri, që i përket terminologjisë juridike, dhe përligj përfundimisht këtë përdorim në gjuhën amtare.

Bibliografia

Ashta I = K. Ashta, *Leksiku i plotë i veprës së Gjon Buzukut* (1555), «Revistë shkencore e Institutit Pedagogjik dyvjeçar të Shkodrës» Shkodër 1964, n. 1: 97-180, ribotim *Leksiku historik i gjuhës shqipe*, vëll. I, Universiteti i Shkodrës ‘Luigj Gurakuqi’, Sektori Shkencor i Albanologjisë, Shkodër

³³ Khs. R. Gusmani, *Saggi sull’interferenza linguistica*, vëll. I, cit., ff. 150-151.

³⁴ Khs. *Fjalor i gjuhës shqipe*, Instituti i Shkencave, Sekcioni i Gjuhës e i Letërsisë, Tiranë 1954.

Materialet e punimeve (proceedings)

ISBN: 978-1-78911-007-4

2000 (ribotim 1996): 225-281; «Buletin shkencor i Institutit Pedagogjik dyvjeçar të Shkodrës», Shkodër, 1964, numër i posaçëm: 119-184; 1965: 59-96; 1966, n. 4: 27-66, ribotim *Leksiku historik i gjuhës shqipe*, vëll. I, Universiteti i Shkodrës ‘Luigj Gurakuqi’, Sektori Shkencor i Albanologjisë, Shkodër 2000 (ribotim 1996): 281-494.

Ashta II = K. Ashta, *Pjetër Budi dhe vepra e tij (1618-1621)*, në *Leksiku historik i gjuhës shqipe*, vëll. II, Universiteti i Shkodrës ‘Luigj Gurakuqi’, Sektori shkencor i Albanologjisë, Botimet Toena, Tiranë 1998: 91-309.

Ashta III = K. Ashta, *Leksiku i shqipes nxjerrë nga Dictionarium Latino-Epiroticum i Frang Bardhit (1635)*, «Buletin shkencor i Institutit të Lartë Pedagogjik të Shkodrës», Shkodër, 1971, n. 1: 139-167; 1972, n. 1: 131-155; 1973, n. 2: 109-133; 1974, n. 1: 122-144; 1974, n. 2: 91-111; 1975, n. 1: 63-90, ribotim *Leksiku historik i gjuhës shqipe*, vëll. III, Universiteti i Shkodrës ‘Luigj Gurakuqi’, Sektori shkencor i Albanologjisë, Shkodër 2000: 35-303.

Ashta IV = K. Ashta, *Leksiku i plotë i shqipes nxjerrë nga Cuneus Prophetarum i Pjetër Bogdanit*, «Buletin shkencor», Instituti i Lartë Pedagogjik, Shkodër, 1982, n. 2: 69-83; 1983, n. 1: 79-94; 1983, n. 2: 95-109; 1984, n. 1: 141-156; 1984, n. 2: 139-151; 1985, n. 1: 165-183; 1985, n. 2: 165-189; 1986, n. 1: 179-193; 1986, n. 2: 161-182; 1987, n. 1: 151-168; 1988, n. 1, 1989, n. 1, ribotim *Leksiku historik i gjuhës shqipe*, vëll. IV, “Camaj-Pipa”, Shkodër 2002: 3-388.

Bardhi = F. Bardhi, *Dictionarium latino-epiroticum*, Romae 1635.

Bashkimi = *Fjaluer i Rii i Shcypés, Perbâam Prëi Shocniët t’Bashkimit*, Shkodër 1908, ribotim *Fjalori i ‘Bashkimit’*, Rilindja, Prishtinë 1978.

Bogdani = P. Bogdani, *Cuneus Prophetarum*, Padua 1685.

Budi = P. Budi, *Doctrina christiana*, Romae 1618; *Rituale Romanum*, Romae 1621; *Speculum Confessionis*, Romae 1621.

Busetti = A. Busetti, *Vocabolario italiano-albanese*, Tipografia dell’Immacolata, Scutari d’Albania 1911.

Buzuku = E. Çabej, ‘Meshari’ i Gjon Buzukut (1555), botim kritik, vëll. I-II, Universiteti Shtetëror i Tiranës, Instituti i Historisë e i Gjuhësisë, Tiranë 1968.

Çabej SE III, SE IV, SE V = E. Çabej, *Studime etimologjike në fushë të shqipes*, vëll. III, IV, V, Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë 1987-2014.

Cordignano = F. Cordignano, *Dizionario italo-albanese*, Scutari 1938, rist. anastatica, Forni Editore, Bologna 1968.

Da Lecce = F. M. Da Lecce, *Dittionario italiano-albanese (1702)*, Botim kritik, me hyrje dhe fjalësin shqip përgatitur nga Gëzim Gurga, Botime Françeskane, Shkodër 2009.

DELI = *Il nuovo etimologico. DELI. Dizionario etimologico della lingua italiana* di M. Cortelazzo - P. Zolli, seconda edizione in volume unico a cura di M. Cortelazzo e M.A. Cortelazzo, Zanichelli, Bologna 1999.

Di Giovine, P., *Un millennio di storia linguistica albanese: l’influsso lessicale della lingua italiana*, «L’Italia dialettale», rivista di Dialettologia italiana, vol. LXIX (Serie Terza, V), Edizioni ETS, Pisa 2008: 107-139.

Fjalor i gjuhës shqipe, Instituti i Shkencave, Seksioni i Gjuhës e i Letërsisë, Tiranë 1954.

Gusmani R., *Saggi sull’interferenza linguistica*, Le Lettere, vëll. I, Firenze 1981, vëll. II, Firenze 1983.

Leotti = A. Leotti, *Dizionario albanese-italiano*, Istituto per l’Europa Orientale, Roma 1937.

Rossi 1866 = F. Rossi, *Vocabolario italiano-epirotico*, Stamperia della s. c. di Propaganda Fide, Roma 1866.

Rossi 1875 = F. Rossi, *Vocabolario della lingua epirotica-italiana*, Tipografia poliglotta della s. c. di Propaganda Fide, Roma 1875.

Zingarelli = *Vocabolario della lingua italiana di Nicola Zingarelli*, Zanichelli, Bologna 2007.

Edukimi gjuhësor nëpërmjet leximit të lektyrave

PROF. DR. FARKETA DIBRA-ZEQIRI
Universiteti "Shën Kirili dhe Metodi" – Shkup

Abstrakt

Me anë të kësaj kumtese mëtojmë të pasqyrojmë rolin dhe rëndësinë që luan leximi i lektyrave shkollore në edukimin gjuhësor të nxënësit dhe rrjedhimisht në përvetësimin e gjuhës standarde shqipe. Edukimi gjuhësor fillon në familje, për të vazhduar më pas në shkollë me ndihmën e të gjitha lëndëve mësimore, por barrën më të madhe e ka lëndë e gjuhës shqipe dhe letërsisë ku brenda saj është përcaktuar lektyra si fushë më vete për t'u punuar me një numër të caktuar veprash letrare brenda çdo vit shkollor, duke filluar që nga klasa I-XII. Përfitimet gjuhësore që sjell leximi i lektyrave janë të shumta dhe atë:

1. Leximi i lektyrave sjell dobi jo vetëm në përmirësimin e aftësive të të folurit, por edhe të të shkruarit. Kjo është më e dallueshme veçanërisht në strukturimin e një fjalie. Një fjali e shkruar mirë ka si forcën gramatikore, ashtu dhe aftësinë për të lidhur ide me njëra-tjetrën. Kështu, sa më shumë që lexojnë nxënësit, aq më shumë përmirësohen në aftësinë e tyre të të shkruarit, për shkak se janë duke u ekspozuar ndaj formacioneve dhe funksioneve të ndryshme të një fjalie, duke e bërë këtë, lexuesit kuptojnë se ata janë të aftë të mësojnë gramatikën dhe fjalorin e gjuhës.

2. Zhvillimi gjuhësor i nxënësve, si dhe pasurimi i fjalorit të tyre - nëpërmjet leximit të veprave të ndryshme, nxënësit njihen me modelet më të mira të përdorimit të gjuhës dhe kanë mundësi të zgjerojnë aftësitë e tyre për të formuar fjali në mënyra të ndryshme, të organizojnë mendimet dhe pjesët e tekstit në formate të ndryshme, si dhe të përzgjedhin fjalorin që përshtatet në mënyrë të saktë me një mendim ose veprim.

3. Letërsia është autentike dhe siguron informacion autentik për mësimin e gjuhës. Ajo mund të jetë veçanërisht e pasqyruar në drama dhe romane, ku gjithsecili ndeshet me dialogje, shprehje emocionale dhe përshkrime të ngjarjeve me elemente që nxisin imagjinatën e gjithsecilit.

Fjalët çelës: *lexim, edukim, gjuhë, lektyrë, nxënës.*

Veprimtaria jonë jetësore është e ndërtuar para se gjithash mbi komunikimin gjuhësor. Me pak fjalë, çfarë themi e çfarë shkruajmë, si duhet ta themi e ta shkruajmë, kujt dhe më ç'qëllim? Ne komunikojmë me njëri-tjetrin me anë të teksteve të folura e të shkruara. Kur vjen puna për t'i prodhuar, perceptuar e interpretuar këto tekste, nxënësit por edhe mësuesit, gjatë veprimtarisë mësimore përballen ende me vështirësi të natyrave të ndryshme. Madje, edhe zgjedhjet dhe zgjidhjet e deritanishme shkencore nuk ia kanë gjetur fillin këtij ngërçi të vazhdueshëm. Problemin rrekemi ta gjejmë kudo, sa te sistemi arsimor, sa te kurrikula, programet mësimore, tekstet shkollore, sa te mësuesi dhe nxënësi e shumëçka tjetër që ka të bëjë me të.

Në një vështrim të parë, vërejmë se ecuria e mësimin të këtyre dijeve është mbështetur në trashëgiminë tonë shkencore e pedagogjike, si dhe në atë evropiane. Por, në këtë hapësirë edhe pse janë bërë përpjekje për zgjidhjen e problemeve që lidheshin me modernizimin e programeve dhe teksteve të gjuhës amtare, edhe pse kanë kaluar më se dy dekada që kur iu çel shtegu konceptimeve bashkëkohore, të cilat për dhënien e mësimin të gjuhës amtare në shkollë marrin parasysh larmin e stileve dhe faktorët komunikues, zotërimin e përftesave ligjërimore në situata të caktuara komunikative, përsëri performanca gjuhësore e nxënësve lë për të dëshiruar (Beci, 1993: 101). Vihen re raste të përdorimit të pakujdesshëm të gjuhës në situata ligjërimore me njëri-tjetrin ku mënyra e përdorimit të gjuhës tregon më së shumti për një rënie

Materialet e punimeve (proceedings)**ISBN: 978-1-78911-007-4**

të edukimit dhe kulturës gjuhësore në përgjithësi. Një prej këtyre çështjeve, përbën edhe interesin qendrorë të punimit tonë, është çështja që ka të bëjë me edukimin gjuhësor që synohet të arrihet nëpërmjet leximit të lekturës shkollor. Ndaj, në këtë punim kemi marrë përsipër të sjellim një kontribut sado të vogël, për të reflektuar e vepruar në mënyrën se si duhet konceptuar lektyra shkollor, që të ndikojë në edukimin dhe formimin e kulturës gjuhësore të nxënësit.

Kultura gjuhësore e një nxënësi vjen në shprehje, atëherë kur ai është në gjendje që të shprehë me gojë dhe me shkrim qartë mendimet, pikëpamjet, qëndrimet, nevojat, dëshirat, interesimet, gjendjen e tij shpirtërore dhe të të tjerëve me një fjalor të pasur dhe adekuat, me një gjuhë të rrjedhshme, të kuptueshme në pikëpamje gramatikore, sintaksore dhe stilistikore, në nivel të normës letrare dhe të normës drejtshkrimore deri në krijimtari të pavarur. Përvetësimi me sukses i këtyre aftësive varet në masë të madhe nga roli i shkollës dhe mënyra se si konceptohet e mësohet lënda e gjuhës shqipe dhe e letërsisë në shkollë, e cila si një disiplinë e veçantë udhëheqëse e disiplinave të tjera shkencore, përveç pajisjes së nxënësve me njohuri shkencore përmes terminologjisë përkatëse, i ndihmon ata të marrin edhe kulturë gjuhësore (Hamiti, 2018: 13).

Brenda kornizave të lëndës së gjuhës amtare mes tjerash është përcaktuar edhe **lektyra** si fushë më vete për t'u punuar, fushë e cila i detyron nxënësit të lexojnë një numër të caktuar veprash letrare, ku profesionistët i zgjedhin sipas moshës, duke vlerësuar se do t'ju ndihmojë nxënësve për zhvillimin intelektual të tyre. Pësia, kësaj fushe i shtohet edhe me karakterin plotësues të programit, nëpërmjet saj nxënësit njihen edhe me veprat e autorëve të tjerë që nuk janë të planifikuar në plan-program dhe në këtë mënyrë i plotësojnë njohuritë e tyre të përgjithshme gjuhësore, letrare dhe kulturore.

Lektyra shkollore dhe puna mësimore me të kanë traditë të gjatë në shkollat tona, në plan-programet bashkëkohore të gjuhës amtare për të gjitha ciklet e shkollimit duke filluar nga klasa I-XII, lektyra shkollore është konceptuar si lëmë i posaçëm i lëndës mësimore, me përmbajtje dhe orë të veçanta mësimore, gjë e cila e bën të radhitet në plan-programet e vendeve me sistem të avancuar të arsimit. Paralelisht me këtë është formuluar edhe qëllimi i mësimi të gjuhës amtare, ku një nga detyrat kryesore është se nxënësit duhet të fitojnë bazë gjuhësore dhe kulturë letrare që nga shkrim-leximi e deri të zhvillimi i dashurisë ndaj librit në përgjithësi.

Si rrjedhojë, ora e lekturës është vendi ku fillon dhe ndërtohet procesi i të lexuarit, i cili i bashkuar me instruksionet që japin mësuesit për realizimin e të lexuarit të suksesshëm, kanë krijuar shtratin dhe janë bërë bërthamë e krijimit të aftësive të nxënësve në lidhje me të lexuarit e tyre (Gjokutaj, 2009: 218). Andaj, jo rastësisht themi se leximi i lekturave ka rëndësi të madhe për mësimin e gjuhës amtare në shkollën, për drejtshkrimin, drejtshqiptimin, për kulturën gjuhësore e letrare, sepse këtu hidhen themelet, krijohen dhe kultivohen shprehitë e të lexuarit. Si njohuritë e gjuhës dhe të stilit, ashtu edhe konceptet letrare të marra në orët e rregullta në procesin e punës mësimore, nxënësit do të mund të kontrollojnë dhe plotësojnë me anë të shembujve konkretë të krijimeve të shkrimtarëve të përzgjedhur.

Nxënësi, do të jetë në gjendje t'i zotërojë më mirë katër aftësitë gjuhësore: leximin, shkrimin, dëgjimin dhe të folurit, në rast se gjendet ekuilibri i nevojshëm mes parapëlqimeve të tija dhe lekturave shkollore, që detyrohet t'i lexojë në lëndën e gjuhës amtare. Nëse arrihet ky harmonizim, nxënësi jo vetëm që do të jetë në gjendje të fitojë njohuri të gjuhës, por ai do të ndiejnë kënaqësi nga ajo që ka lexuar. Kjo nga ana tjetër siguron motivimin, i cili rrit aftësinë e leximit. Ndryshe thënë, nëse nxënësi është i interesuar për atë që e lexon, ai jo

vetëm që fillon t’i përvetësojë më lehtësisht aftësitë themelore gjuhësore, por e koncepton dhe e kupton vazhdimisht atë që e lexon (Dibra-Zeqiri, 2022: 48).

Në këtë vazhdë, mësimdhënësi duhet të jetë i vetëdijshëm se cila vepër letrare përkon me moshën e nxënësve, cila ka subjektin e vetë, stilin e vetë, vlerat e veta edukative-arsimore, dinamikën e leximit dhe interpretimit, gjithashtu ka edhe qasje specifike didaktiko-metodike të shtjellimit të saj. Andaj, duhet t’i kushtojë rëndësi përgatitjes dhe motivimit të nxënësve për leximin e kujdesshëm të saj. Mësimdhënësi është faktor vendimtar që i udhëzon nxënësit për mënyrën e leximit të veprës, natyrisht pasi ta ketë lexuar edhe studiuar vetë ai, përcakton kohën e leximit të veprës, përcjell procesin dhe cilësinë e leximit të veprës dhe në kohë të caktuar në bashkëpunim me nxënësit, i qaset shqyrtimit të vlerave të saj gjuhësore, letrare, artistike dhe edukative.

Leximi i lektyrave përmes mesazheve që përcjell, ndikon te nxënësi në zhvillimin e gjithanshëm të tij. Kjo është shumë e rëndësishme për çdo moshë, sidomos për moshën e adoleshencës, moshë tranzitore, moshë e zhvillimeve të vrullshme, moshë ku ridimensionohet personaliteti i individit, ku për vetë natyrën e tij në kërkim të vetë afirmimit, të pozicionimit në shoqëri, gjithmonë ndjek modele të ndryshme identifikimi, të cilat i përzgjedh gjatë veprimtarive në të cilat merr pjesë, një ndër to është edhe leximi i lektyrave. Marrja e informacionit përmes leximit të lektyrës e formon dhe e informon nxënësin, duke e rritur, si nga ana intelektuale, ashtu edhe nga ajo emocionale. Kjo e shprehur në mënyrën e përvetësimit të dijeve, arritjen e suksesit apo dyshimin e mossuksesit, në rritjen e vetëvlerësimit dhe vetëbesimit, në ndjenjën e kuriozitetit, në krijimin e raporteve pozitive shoqërore. Pra, synimi është që leximi të kthehet në shprehje për nxënësit, duke u kthyer në shprehje, leximi do të bëhet kulturë për ta, pasi në këtë mënyrë fëmijët bëhen lexues të mirë dhe nxënës të suksesshëm (Pepa, 2001:45).

Në kuptimin didaktik me kulturë leximi, nuk nënkuptohet vetëm zotërimi i teknikës së leximit të drejtë, të natyrshëm dhe ekspresiv, por nënkuptohet edhe leximi logjik, interpretativ, leximi "mes rreshtave", përkatësisht, nënkuptohet njohja e kontekstit të fjalëve dhe fjalive, të mesazhit të tërë tekstit që lexohet (Brada, 2005: 374). Pra, nënkuptohet zhvillimi i interesimit, motivimi për lexim, që do ta përshejtojë zhvillimin dhe afirmimin e aftësive për të marrë qëndrim kritik ndaj asaj që lexohet; nënkuptohet zhvillimi i dashurisë dhe respektit ndaj librit, ndaj autorit i cili ka derdhur mund, dije, përvojë jetësore vizionare, emocione dhe kohë të pakursyer, në interes të përparimit kulturor të brezave të tashëm dhe të ardhshëm.

Kultura e leximit te nxënësit, do të formohet dhe do të brumoset akoma më shumë në proceset e integritetit të saj me kulturën nga letërsia (Rexhepi, 2002:154). Mund të thuhet se nxënësi ka formuar kulturë leximi dhe nga letërsia atëherë, kur i është bërë shprehje në shkallë pasioni, të lexojë, të përjetojë dhe të interpretojë vlerat e njëmendta të veprave letrare, atëherë kur leximi i veprave letrare i është bërë ushqim i shpirtit, pjesë e jetës. Formimi i kësaj kulture dëshmohet në klasë me pjesëmarrjen aktive të nxënësve në bisedat që zhvillohen rreth leximit, përjetimit dhe interpretimit të lektyrës se lexuar (Brada, 2005: 376).

Leximi i lektyrave, duke u konsideruar si një proces i rëndësishëm intelektual dhe edukativ nuk mund të perceptohet pa lënë gjurmë qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo tërthorazi në edukimi dhe formimin gjuhësor të një nxënësi. Përfitimet gjuhësore që arrin t’i marrë nxënësi janë të mëdha, ndaj si më të rëndësishme kemi veçuar:

1. Zhvillimi gjuhësor i nxënësve, si dhe pasurimi i fjalorit të tyre. Nëpërmjet leximit të veprave të ndryshme, nxënësit njihen me modelet më të mira të përdorimit të gjuhës dhe kanë mundësi të zgjerojnë aftësitë e tyre për të formuar fjali në mënyra të ndryshme, të organizojnë

mendimet dhe pjesët e tekstit në formate të ndryshme, si dhe të përzgjedhin fjalorin që përshtatet në mënyrë të saktë me një mendim ose veprim.

2. Leximi i lektyrave sjell dobi jo vetëm në përmirësimin e aftësive të të folurit, por edhe të të shkruarit. Kjo është më e dallueshme veçanërisht në strukturimin e një fjalie. Një fjali e shkruar mirë ka si forcën gramatikore, ashtu dhe aftësinë për të lidhur ide me njëra-tjetrën. Kështu, sa më shumë që lexojnë nxënësit, aq më shumë përmirësohen në aftësinë e tyre të të shkruarit, për shkak se janë duke u ekspozuar ndaj formacioneve dhe funksioneve të ndryshme të një fjalie, duke e bërë këtë, lexuesit kuptojnë se ata janë të aftë të mësojnë gramatikën dhe fjalorin e gjuhës.

3. Leximi i lektyrave ndihmon nxënësit të mësojnë shkathtësitë e të hartuarit dhe të shkruarit, duke u futur në botën e krijimeve më të mira të letërsisë botërore dhe asaj kombëtare. Nxënësit mësojnë shumë edhe nga leximi i krijimtarisë popullore: nga përrallat, legjendat, këngët lirike dhe epike e veçanërisht nga fjalët e urta e gjëgjëzat, të cilat dallohen për strukturë të përkryer gjuhësore, pasuri informacioni që bartin dhe bukuri shprehjeje.

4. Njëherazi, zbulojnë kënaqësinë e të lexuarit të letërsisë dhe bëhen të vetëdijshëm për shumësinë e mënyrave të perceptimit të botës përreth tyre; gjykojnë për vlerat estetike të gjuhës në një tekst letrar; lidhin tekstin që lexojnë me jetën dhe përvojat e tyre, si dhe me botën që i rrethon.

5. Letërsia është autentike dhe siguron informacion autentik për mësimin e gjuhës. Ajo mund të jetë veçanërisht e pasqyruar në drama dhe romane, ku gjithsecili ndeshet me dialogje, shprehje emocionale dhe përshkrime të ngjarjeve me elemente që nxisin imagjinatën e gjithsecilit. Letërsia ofron materiale autentike me vlerë, të cilat stimulojnë zhvillimin personal të nxënësit dhe kontribuon në pasurimin kulturor dhe gjuhësor të tij. Një përfitim i tillë vjen nga përfshirja personale që nxit letërsia, pasi ajo bën që nxënësit të jenë më entuziastë dhe më të lidhur me historitë dhe personazhet e ngërthyera brenda një veprë letrare.

6. Leximi i lektyrave ndikon në një edukim ndërkulturor, sepse të njohësh kultura të ndryshme nëpërmjet veprave të letërsisë evropiane dhe botërore rezulton në perceptimin më të thellë të asaj kulture, e cila me vonë rrit aftësinë e nxënësve në komunikim ndërkulturor. Natyrisht, se procesi i përvetësimit të gjithë këtyre njohurive nuk mund të arrihet brenda një ore mësimi, është proces i gjatë dhe kompleks, para se gjithash kërkon punë, këmbëngulje dhe vullnet nga të dy palët. Barra në masë të madhe i bie mësimdhënësit, i cili që t'u mundësojë nxënësve një kulturë solide gjuhësore, si në të folur ashtu edhe në të shkruar, duhet të zgjedhë vepra që nuk i privojnë nxënësit prej suksesit për shkak të vështirësive gjuhësore. Nxënësve duhet t'u jepen vepra që janë paksa mbi nivelin e tyre, në mënyrë që, përveç se të jenë në gjendje të kuptojnë se çfarë janë duke lexuar, po ashtu ata duhet të nxiten që ta shtyjnë veten për të kuptuar koncepte të reja, të cilat mund të shfaqen në vepër drejtpërsëdrejti a tërthorazi. Në praktikë, procesi i përfitimit të kulturës dhe edukimit gjuhësor gjatë orës së interpretimit të lektyrës mund të realizohet në mënyra nga më të ndryshmet, varësisht nga gjinia dhe lloji letrar të cilës i përket ajo vepër. P. sh. nxënësve mund t'u jepet si detyrë leximi i një romani brenda një harku kohor prej një jave, pa qenë nevoja për ta përdorur edhe aq shumë fjalorin shpjegues të gjuhës. Një praktikë e këtillë, jo vetëm që do ta dyfishonte shpejtësinë e leximit të tyre, por edhe do t'i shtynte ata që të mendojnë vet sipas situatës kontekstuale të përdorimit rreth kuptimit të fjalëve të panjohura në vepër. Nga ana tjetër, veprat më të mira letrare për lexime intensive mund të jenë poezitë. Poezia të jep më shumë mundësi për analiza të hollësishme. Kështu, nxënësve mund t'u kërkohet që ta lexojnë çdo strofë ndaras, në mënyrë që të depërtojnë më shumë në përmbajtjen e saj dhe për të zbuluar konotacionet e shumta të fjalëve përmes tropeve letrare, si metafora, krahasimi apo alegoria etj (Luli, 1984: 65).

Një ushtrim tjetër mund të jetë ai ku nxënësve t’u kërkohet që tekstin e një poezie ta kthejnë sipas normave standarde të gjuhës. Letërsia është lënda gjuhësore ku ndihen më së shumti thyerjet e normës sintaksore të standardit, si inversioni apo thyerja e përmbysja e vargut. Në këtë hulli, duke ditur se sistemi i gjuhës shqipe ka mundësi të mëdha shprehëse, lind nevoja që gjatë interpretimit të lektyrës të përdoren edhe mundësitë që paraqiten edhe në fonetikë, në morfologji e në fjalëformim, në leksik e në sintaksë (Luli, 1984: 66).

Në fonetikë: efektet shprehëse që lindin nga shqiptimi, nga përdorimi i theksave etj.

Në morfologji: përdorimi i shumësit për njëjës, ndërtimi jo i rregullt i gjinisë femërore nga mashkullorja për efekte stilistike, përdorimi i mbiemrit për të futur emrin në një fushë të caktuar ligjërimi; përdorimi i foljes në joveprore në vend të veprës, i urdhërores në vend të lidhores, përdorimet me vlera të mëdha shprehëse të habitores dhe dëshirores etj., përdorimi i numërorëve për fuqizimin e hiperbolizimit etj.

Në fjalëformim: përdorimi i neologjizmave, i prapashtesave me kuptim keqësues e zvogëlues dhe i kompozitave.

Në leksik: përdorimi i polisemisë, sinonimisë, antonimisë etj.

Nga e gjithë kjo që u tha më lartë, mund të konstatojmë se në orën e analizës së lektyrës të mos rrëmohet për të gjetur element të paqenë apo dytësor, por në mënyrë të natyrshme, pa shkaktuar mbingarkesë, të trajtohen në rrugë praktike ato elemente gjuhësore që nxjerrin më mirë në pah përmbajtjen, idenë, vlerat artistike të veprës që trajtohet. Pra, edukimi gjuhësor të burojë nga vetë përmbajtja e materialit letrar dhe nga forma e temës mësimore.

Edukimi gjuhësor nëpërmjet leximit të lektyrave të bëhet për qëllime praktike, në shërbim të përvetësimit më të thellë të letërsisë, por edhe të gjuhës, pa të cilën ajo nuk mund të ekzistojë, në shërbim të përsosjes së të folurit dhe të shkruarit të nxënësve me normën e gjuhës letrare kombëtare. Ato elemente gjuhësore që evidentohen në mësimin e letërsisë, nxënësit jo vetëm duhet t’i njohin e t’i shfrytëzojnë në orën e mësimin, por duhet ngulmuar që t’i përdorin edhe në ligjërimin me gojë dhe me shkrim.

Kërkesa për t’i aftësuar nxënësit për zotërimin e katër kompetencave komunikative (të lexuarit, të shkruarit, të folurit dhe të dëgjuarit) mendojmë se është shprehur dhe materializuar saktë në kurrikulën e gjuhës dhe të letërsisë, sidomos dhjetëvjeçarin e fundit. Mbetet detyrë e mësuesve ta njohin mirë atë, të krijojnë vizion të qartë e të punojnë me objektiva të afërta e të largëta me efektivitet synimet e vëna.

Literaturë

1. Beci, Bahri. 1993. *Për një konceptim bashkëkohor të mësimin të gjuhës amtare në shkollë*, Gjuha jonë, nr. 1-4.
2. Brada, Riza. 2005. *Metodika e gjuhës shqipe për shkollën fillore*, botimi III i plotësuar, Pejë.
3. Dibra-Zeqiri, Farketa. 2022. *Lektyra në shkollat e mesme me mësim në gjuhën shqipe në Republikën e Maqedonisë së Veriut*, Shkup.
4. Luli, Faik. 1984. *Metodika e letërsisë dhe e leximit letrar*, Tiranë.
5. Hamiti, Asllan. 2018. *Kultura e gjuhës për të gjithë*, Shkup.
6. MIMOZA Gjokutaj. 2009. *Didaktika e gjuhës shqipe*, SHBLU, Tiranë.
7. Pepa, Vjollca. 2001. *Letërsi në shkollë*, Tiranë.
8. Rexhepi, Nuhi. 2002. *Letërsia shqipe në tekstet shkollore të Kosovës (1945-1990)*, Logos, Prishtinë.

Trajtimi i gjuhëve në shoqëritë multietnike. Rast studimi: Republika e Maqedonisë së Veriut

PROF. DR. ARTA TOÇI
Universiteti i Evropës Juglindore

Abstrakti

Multikulturalizmi është një doktrinë sipas së cilës disa kultura ndërveprojnë në një kontekst të përbashkët. Në këto shoqëri secili grup dallohet për qytetërimin, mentalitetin dhe gjuhën e tij. Megjithatë, përkufizimi i multikulturalizmit varet kryesisht nga konteksti social, politik, kulturor dhe sociolinguistik. Në shoqëritë multikulturore pritet që të ketë grupe shoqërore të cilat realizojnë vlerat e tyre kulturore si gjuha. Megjithatë, a janë edhe shoqëritë multikulturore gjithmonë shumëgjuhëshe? Këmbëngulja për të ndërtuar një ideologji njëgjuhëshe në një vend multikulturor dhe multietnik do të dështojë gjithmonë sepse roli i gjuhës në këto shoqëri nuk është vetëm të vendosë komunikim të ndërsjellë, por edhe të shpëtojë identitetin kombëtar. Në kontekste të ndryshme gjeopolitike, kur ka dy gjuhë në kontakt, shpesh ndodh që njëra prej tyre të konsiderohet e kategorisë së parë dhe pritet që nga të tjerat t'i binden të parës. Kjo qasje çon në ndjenjën e mungesës së besimit dhe humbjes së identitetit për individët që i përkasin një prej grupeve të kategorive të tjera.

Ky punim synon të reflektojë mbi humbjen e identitetit kolektiv në shoqëritë multikulturore, multietnike dhe shumëgjuhësore. Republika e Maqedonisë së Veriut është një vend i krijuar në vitet '90 të shekullit të kaluar, i cili në aspektin politik përballet me një mohim të historisë, gjuhës dhe kishës së saj, ndërsa me politikën e brendshme vështirë se pranon ekzistencën e gjuhëve dhe kulturave të tjera. Është një shoqëri multikulturore ku diversiteti kulturor dhe gjuhësor në vend që të përfaqësojnë vlerat, ato përjetohen si një përplasje kulturash.

Fjalët kyçe: *gjuha, kultura, multikulturalizmi, identiteti*

1. Hyrja

Multikulturalizmi është i lidhur ngushtë me shoqëritë që përmbajnë kultura të ndryshme. Si term, lidhet me ideologjitë që mbështesin këtë shumësi. Sipas Kenan, M (2006, fq.62):

Ideologji apo politika të tilla ndryshojnë shumë, duke përfshirë një vend në tjetrin, duke filluar nga mbrojtja e respektit të barabartë për kulturat e ndryshme në një shoqëri, në një politikë të promovimit të ruajtjes së diversitetit kulturor, në politika në të cilat njerëzit e grupeve të ndryshme etnike dhe fetare janë adresuar nga autoritetet siç përcaktohet nga grupi ku ata bëjnë pjesë.

Megjithatë, dy strategji kryesore të ndryshme dhe në dukje kontradiktore janë zhvilluar përmes politikave dhe strategjive të ndryshme të qeverisë. E para fokusohet në ndërveprimin dhe komunikimin midis kulturave të ndryshme, ndërsa e dyta përqendrohet në diversitetin dhe individualitetin kulturor. Sipas Anne-Marie Mooney Cotter (2017, fq.24):

Izolimi kulturor mund të mbrojë veçantinë e kulturës lokale të një kombi ose zone dhe gjithashtu të kontribuojë në diversitetin kulturor global. Një aspekt i përbashkët i shumë politikave që ndjekin qasjen e dytë është se ato shmangin paraqitjen e vlerave specifike etnike, fetare ose kulturore të komunitetit si qendrore.

Burgess & Burgess (2010) madje pohojnë se 'Multikulturalizmi është shpesh në kontrast me konceptet e asimilimit dhe është përshkruar si një "tas sallate" ose "mozaik kulturor" dhe jo një "tenxhere shkrirjeje".

Republika e Maqedonisë së Veriut është vend multikulturor dhe multietnik. Shumica e popullsisë janë maqedonas, ndërsa e dyta është ajo shqiptare. Në mungesë të të dhënave të përditësuara për shifrat e sakta, ky studim do t'i referohet regjistrimit të fundit të vitit 2002, ku 64.2% janë maqedonas, 25.2% janë shqiptarë, ndërsa turqit, serbët, vllahët, boshnjakët, romët përbëjnë 10.6% të të gjithë. popullatë. Me këtë diversitet kulturor Maqedonia e Veriut mund të shërbejë si model për një vend ku kulturat do të çonin drejt një shoqërie me respekt të ndërsjellë.

2. Pavarësia e Maqedonisë së Veriut

Shpallja e Pavarësisë së Maqedonisë ishte akti i parë politik me rëndësi historike për Maqedoninë e Veriut si shtet i pavarur, pas zgjedhjeve të para pluraliste. Deklarata u miratua nga Kuvendi i Maqedonisë, më 25 janar 1991. Ajo ishte 'Deklarata për sovranitetin e Republikës, me të cilën, ndër të tjera, Republika e Maqedonisë u përcaktua si shtet sovran, e cila në përputhje me interesat e veta, do të vendoste në mënyrë të pavarur për marrëdhëniet e saj të ardhshme me shtetet e popujve të tjerë të Jugosllavisë.' (Akademia e Shkencave dhe Arteve e Maqedonisë Shkup, 1993). Ky akt ishte një hap i parë i rëndësishëm drejt pavarësisë politike të Maqedonisë. Në truallin e saj u ndërtuan të gjitha aktet e mëvonshme të shtetit të ri të pavarur në Ballkan. Pas referendumit të 8 shtatorit 1991, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë miratoi Deklaratën për legalizimin e rezultateve të referendumit. Në deklaratë thuhet se:

Republika e Maqedonisë si shtet sovran dhe i pavarur do të përpiqet për respektimin e vazhdueshëm të parimeve përgjithësisht të pranuarra të marrëdhënieve ndërkombëtare të përfshira në Kartën dhe dokumentet e tjera të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, Aktin Përfundimtar të KSBE-së nga Helsinki dhe Kartën e KSBE-së të Parisit, dhe atë. veprimtarinë e saj në marrëdhëniet ndërkombëtare do ta bazojë në respektimin e standardeve ndërkombëtare dhe në veçanti në parimet e respektimit të integritetit dhe sovranitetit territorial, mosndërrhyrjes në punët e brendshme, forcimit të respektit dhe besimit të ndërsjellë dhe bashkëpunimit të gjithanshëm me të gjitha vendet dhe popujve (Deklarata e Pavarësisë, Neni 2).

Që në ditët e para të pavarësisë, struktura politike maqedonase filloi të përhapë platformën e sapokrijuar për shtetin etnik maqedonas. Platforma kombëtare maqedonase nuk ishte në përputhje me aspiratat dhe pritjet e grupeve të tjera etnike në Maqedoni. Në shoqërinë multikulturore, vendi i sapokrijuar bëri hapat e parë drejt një shteti liberal. Moore (1998) thekson se pothuajse të gjitha shtetet liberale kanë një kulturë dhe sistem vlerash mbizotëruese, nga i cili disa pakica kombëtare ndjehen të marginalizuara.

3. Pozita e ‘tjetrit’ në shtetin e sapoformuar

Qëllimi i përbashkët i të gjitha partive politike shqiptare ishte përmirësimi i të drejtave politike dhe kulturore të shqiptarëve etnikë. Në realitet, zbatimi i të drejtave u pa nga shumë njerëz si i pakënaqshëm dhe tepër i ngadalshëm.

Që nga fillimi i pavarësisë, për shkak të përjashtimit të tyre nga institucionet politike, shqiptarët në Maqedoni ishin organizatorë të protestave të ndryshme. Këto protesta ishin kryesisht shprehje emocionale e pakënaqësisë së tyre ndaj reformave në aparatet shtetëror për

sa i përket qëndrimit të tij ndaj popullsisë shqiptare e cila ishte e dyta në numër. Në vitin 2001, pakënaqësitë e popullatës shqiptare u përshkallëzuan në një rebelim të armatosur kundër autoriteteve maqedonase. Ai zgjati disa muaj dhe me ndërhyrjen politike të faktorëve vendimmarrës ndërkombëtarë, konflikti përfundoi në gusht të po atij viti. U miratua Marrëveshja Kornizë e Ohrit, e cila ende shërben si pikënisje për riorganizimin e pozitës së popullatës shqiptare në Maqedoni. Universiteti Shtetëror i Tetovës është themeluar në vitin 1994, por deri në vitin 2004, kur u njoh zyrtarisht nga qeveria maqedonase, funksioni i tij varej nga mbështetja financiare nga popullata shqiptare në Maqedoni dhe kryesisht nga shqiptarët që punonin në vendet e Evropës Perëndimore. Universiteti i parë i themeluar për nevojat shqiptare ishte Universiteti i Evropës Juglindore në Tetovë, i themeluar në vitin 2001, menjëherë pas konfliktit. Për shkak të faktit se qeveria maqedonase nuk ka njohur asnjë universitet në gjuhë të tjera përveç maqedonishtes, ky universitet është dashur të njihet si universitet tregjuhësh i mbështetur dhe financuar nga bashkësia ndërkombëtare. Megjithatë, në të njëjtën kohë Universiteti i Tetovës ende funksiononte ‘ilegalisht’. Ecuria ishte e ngadaltë dhe në të njëjtën kohë rritej pakënaqësia e popullsisë shqiptare. Në përputhje me të, “Gabric (2006), shprehet se reformat kërkojnë një kohë të caktuar para se të arrijnë efektin e tyre të plotë, më shumë në vendet më pak të zhvilluara, dhe pjesë të popullsisë etnike shqiptare ishin dukshëm të pakënaqur me ritmin me të cilin statusi i tyre po përmirësohej. (siç citohet në Wanis & Grizold, 2001).

3.1 Pozita e gjuhëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut

Në shoqëritë multikulturore ekzistojnë grupe të ndryshme shoqërore dhe kulturore dhe pritet që këto grupe të zbatojnë vlerat e tyre kulturore, siç është gjuha e një grupi të caktuar. Megjithatë, a janë të gjitha shoqëritë multikulturore shumëgjuhëshe në të njëjtën kohë? Investimi në ideologjinë njëgjuhëshe në një shoqëri multikulturore është i vendosur të dështojë pasi roli i gjuhëve në këto shoqëri përveç rolit kryesor të krijimit të komunikimit, është të perceptojnë identitetin kombëtar të grupeve etnike. Në vendet postkomuniste, duke përfshirë Maqedoninë e Veriut si ish-republikë jugosllave, shpesh ndodh që njëra nga gjuhët të konsiderohet si gjuhë e dorës së parë dhe të gjitha gjuhët e tjera duhet të pajtohen me të.

Anëtarësimi në një komunitet kulturor është një çështje e zgjedhjes personale, por kjo nuk do të thotë se anëtarët kanë zgjedhur të jenë pakicë. Ky status u imponohet atyre dhe mund të shihet si një arsye për të mbështetur shanset e tyre për të bërë një jetë kuptimplote dhe të vlefshme, pa pasur nevojë të heqin dorë nga angazhimet e tyre kulturore (Tamir, 1993, f.8).

Republika e Maqedonisë së Veriut, si shtet i ri i pavarur, në sferën politike kishte një identitet të kontestuar, ndërsa me politikën e brendshme në mënyrë sistematike injoronte gjuhët dhe kulturat e tjera. Politika gjuhësore dhe e drejta e përdorimit të gjuhës amtare nënkupton trajtim të barabartë të gjuhëve në institucionet shtetërore.

Me Deklaratën Universale të të Drejtave Gjuhësore, e njohur si Deklarata e Barcelonës (1996):

Të drejtat e të gjitha bashkësive gjuhësore janë të barabarta dhe të pavarura nga statusi i tyre ligjor si gjuhë zyrtare, rajonale ose pakicë. Terma të tillë si gjuhët rajonale ose të pakicës nuk përdoren në këtë Deklaratë, sepse, megjithëse në raste të caktuara njohja e gjuhëve rajonale ose të pakicës mund të lehtësojë ushtrimin e disa të drejtave, këta dhe modifikues të tjerë përdoren shpesh për të kufizuar të drejtat e bashkësive gjuhësore. (Neni 5)

Në shoqëritë multietnike dhe multikulturore është e qartë se përveç përzierjes së kulturave ndodh edhe një përzierje e gjuhëve, prandaj popullsia zakonisht është së paku dygjuhëshe, duke e folur rrjedhshëm gjuhën amtare si dhe gjuhën e rrethit. Në këtë drejtim, rasti i Maqedonisë së Veriut është unik. Siç u tha më lart, popullsia shqiptare në Maqedoninë e Veriut jeton kryesisht në pjesën perëndimore të vendit, fqinjë me Shqipërinë dhe Kosovën. Disa nga qytetet me shumicë shqiptare janë Tetova, Gostivari, Dibra si dhe disa komuna të Shkupit. Megjithatë, gjuha e vetme në përdorim të përditshëm mbetet vetëm maqedonishtja. Sipas teorisë së mësimit të gjuhës, gjuha e dytë është gjuha e rrethit dhe është gjuha ku ekspozohemi. Ekspozimi ndaj gjuhës së dytë është më i madh se sa ndaj gjuhës së huaj; megjithatë refuzimi i përhershëm maqedonas për të mësuar shqip dhe në të njëjtën kohë aftësia e tyre për të folur anglisht është në kundërshtim me të gjitha teoritë e mësimit të gjuhës.

Gatishmëria për të mësuar dhe përdorur gjuhët e mjedisit është e lidhur ngushtë me politikën shtetërore. Trajtimi dhe qasjet ndaj gjuhës shqipe në Maqedoni ka kaluar nëpër periudha të ndryshme, me ato më kufizuese për sa i përket përdorimit të gjuhës, dhe duke vazhduar me periudhat kur u shpall integrimi i gjuhëve në një shoqëri të vetme. Në vitet '80 u zbatua projekti i arsimit të integruar në nivelin e mesëm, në pamje të parë si integrim i palëve të ndryshme në një, por me këtë projekt u injoruan totalisht gjuhët e pakicave pasi e vetmja gjuhë e praktikuar në klasa ishte ajo. gjuha maqedonase. Pasojat e këtij integrimi ishin qindra mësues jomaqedonas të mbetur jashtë objekteve shkollore.

Një nga përpjekjet për shoqëri të integruar ishte edhe projekti për zbatimin e gjuhës maqedonase për nxënësit e klasës së parë, 6 vjeç. Për shkak të rezistencës së madhe të prindërve jomaqedonas, projekti u refuzua nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Maqedonisë. Sipas fjalorit Merriam Webster, termi integrim social përkufizohet si përfshirja e të barabartëve në një shoqëri. Përderisa popullsia shumicë në Maqedoni vazhdon me të njëjtin mentalitet, do të ketë vetëm një popullatë që nuk do të kërkohet të ndryshojë, ndërsa nga të gjithë të tjerët do të pritët që të bëjnë përpjekjet e tyre të vazhdueshme për ta bërë Maqedoninë e Veriut një shoqëri të integruar.

Në janar 2018, pas diskutimeve dhe mosmarrëveshjeve të gjata, Kuvendi i Maqedonisë³⁵ miratoi Ligjin për përdorimin e gjuhëve, i cili ligj e shtrin përdorimin zyrtar të shqipes në të gjithë vendin. Ende ka një refuzim të ashpër për zbatimin e tij në praktikë dhe shumë shpesh u lihet individëve që të merren me ekzekutimin e tij në institucionet shtetërore. Më tej, ky ligj nxori në pah emocionet e fshehura ndaj një gjuhe, emocione të akumuluar prej vitesh në një vend që u përket të gjithë atyre që jetojnë në të.

Referencat:

1. Anne-Marie Mooney Cotter (2011). *Culture clash: an international legal perspective on ethnic discrimination*. Ashgate Publishing, Ltd. Retrieved on Nov 10th, 2013
2. Bottomley, Gillian, (1991). *Identity, Difference and Inequalities: Gender, Ethnicity and Class in Australia* ed. Price, Charles A. Australian National Identity, Canberra: The Academy of the Social Sciences in Australia.

³⁵ Në Marrëveshjen e Prespës të qershorit 2018, vendi ndryshoi emrin në Republika e Maqedonisë së Veriut. Në këtë punim, të gjitha ngjarjet para këtij ndryshimi, i referohen emrit të vendit përpara qershorit 2018

3. Calhoun, Craig, (1994). ‘*Nationalism and Civil Society: Democracy, Diversity and Self Determination*’ in *Social Theory and The Politics of Identity*, ed. Calhoun, Craig, Oxford: Blackwell.
4. Framework Agreement of Ohrid, accessed at www.president.gov.mk
5. Kenan, M (2006). *Multiculturalism and the Road to Terror*, essay published at kenanmalik.com
6. International Crisis Group. 2000. Macedonia’s Ethnic Albanians: Bridging the Gulf
7. International Crisis Group. 1999. Towards Destabilization? (ICG Balkans Report 67, May 1999). Brussels.
8. Moore, M. (1997). “On National Self- Determination”. *Political Studies*
9. Tamir, Y. (1993). *Liberal Nationalism*, A Princeton University Press
10. <http://www.historyofmacedonia.org/IndependentMacedonia/RepublicofMacedonia.html>, Retrieved on Sept 3rd, 2013
11. Wanis & Grizold, (2001). Conflict Prevention and Management in the New security Context: The Case of Macedonia, Retrieved from <http://www.american.edu/sis/faculty/upload/Wanis-Chs-1-9-conflict-Prevention-and-Macedonia.pdf>

Leksiku dialektor dhe fjalorët dialektorë

PROF. DR. NAIM BERISHA
Instituti Albanologjik-Prishtinë

Abstrakt

Fjalët e shprehjet që rrojnë në ligjërimin popullor janë gurrë e pashtershme për pasurimin e gjuhës shqipe, prandaj duke qenë kështu, përmes këtij punimi mëtohet të vihen në pah disa vlera potenciale të kësaj pasurie gjuhësore. Së këndejmi, do të trajtohen fjalë që kanë hyrë ose mund të hyjnë në gjuhën letrare si të reja apo si sinonime leksikore të fjalëve, të cilat e pasurojnë gjuhën me nuanca kuptimore, ngjyresa emocionuese etj. Po veçojmë vetëm disa nga emërtimet e shprehjet që përdoren me kuptime figurative negative (pazhorativë) veçojmë: *barkaçok, bishtjegun, bethuk, bub, buzooq, cofëtinë, cub, dallavesh* etj.

Në këtë punim synohet të vihen në pah vlera potenciale të leksikut dialektor për pasurimin e gjuhës, pikërisht në kohën kur po vazhdon puna në hartimin e Fjalorit të Madh të Gjuhës Shqipe (pra, tashmë janë vjelë mijëra njësi leksikore dialektore dhe janë ofruar si material për këtë projekt) dhe të prezantohet një pasqyrë e fjalorëve dialektorë që janë botuar deri më tani. Përqendrimi i këtij punimi do të jetë te leksiku dialektor i të folmeve të Kosovës, duke provuar të bëhen disa krahasime me disa fjalorë dialektorë të të folmeve veriore të shqipes.

Studimet gjuhësore për leksikun dialektor konsiderohen si njëra ndër fushat më të ndërlikuara në sistemin e përgjithshëm të leksikut të shqipes, që duhet të bëhen me kujdes dhe duke i respektuar disa parime të përgjithshme studimore. Sipas profesor Jani Thomait, “leksiku dialektor e krahinor ka edhe një *kufizim kohor*: shumë fjalë, shprehje e kuptime dikur dialektore a krahinore sot nuk janë më të tilla, sepse i kanë kapërcyer kufijtë e dialektit dhe kanë hyrë në leksikun e gjuhës standarde...”. Sa i përket leksikut të shqipes përgjithësisht pranohet se në mes të dy dialekteve të shqipes nuk ka dallime shumë të mëdha. Por dallimet nuk janë të papërfillshme sa të mos e tërheqin vëmendjen e studiuesit, që përfshijnë fjalë, variante fjalësh, kuptimet e tyre, njësitë frazeologjike etj. Për këto çështje duhet ta kemi parasysh se në bazë është raporti ligjërim popullor (të folme) – gjuhë letrare(standarde), që ndërlidhet me zhvillimin historik e gjuhësor, me traditën dhe zhvillimin e përgjithshëm kulturor e letrar ndër shqiptarë.

Në kuadër të studimeve për leksikun, kategori më vete janë huazimet leksikore që kanë gjetur përdorim nëpër të folmet dialektore. Kur jemi në këtë pikë, për shkak të rrethanave të njohura historike, politike e shoqërore, ka raste kur dallimet nuk janë vetëm veri – jug (në toskërishte –gegërishte), por edhe në raportet Kosovë (ose troje shqiptare nga ish-Jugosllavia) – Shqipëri.

Duke u nisur nga mendimi se kufijtë gjuhësorë nuk janë të prerë, përgjithësisht ka kalime e ndërndikime, edhe leksiku dialektor duhet parë sipas këtyre vlerësimeve, sidomos në Kosovë ku ndarja territoriale e popullsisë, si për shkaqe të terrenit, si për ndonjë ndarje tjetër historike apo administrative. nuk ka qenë asnjëherë e theksuar. Si bëhen studimet gjuhësore në fushë të leksikut dialektor? Trajtimi leksikografik i dialektizmave dhe i krahinorizmave bëhet kryesisht në tri tipa fjalorësh: në fjalorët shpjegues kombëtarë, në fjalorët dygjuhësh dhe në fjalorët dialektorë e

krahinorë³⁶. Edhe fjalorët dialektorë konsiderohen si fjalorë shpjegues, sepse fjalorët e mirëfilltë dialektorë, edhe pse përbëjnë një tip më vete në tipologjinë leksikografike, në fund të fundit, janë njëgjuhësh dhe shpjegojnë kuptimin e fjalëve dhe të njëjive frazeologjike që pasqyrojnë. Rëndësia e tyre është sepse ata zbulojnë, ruajnë dhe dokumentojnë pasurinë leksikografike dialektore të shqipes që i ka shpëtuar syrit të studiuesve më herët. Fjalorët dialektorë e krahinorë janë fjalorë të tipit leksikologjikë, jo enciklopedikë, d.m.th. njëjia bazë është fjala me kuptimet e saj dhe jo koncepti, prandaj variantet fonetike që nuk e shfjtyrojnë ose nuk e tjetërsojnë leksemën, nuk futen në fjalorë të tillë, këto i studion fonetika dialektore, jo leksikologjia e leksikografia³⁷.

Studimet në fushën e leksikut dialektor e krahinor kanë treguar se vendin kryesor në materialet e vjela në terren e zënë fjalët shënjuese, si: emrat, mbiemrat, foljet, ndajfoljet etj. Edhe brenda të folmes së caktuar mund të bëhet shtresimi i leksikut krahinor sipas gjerësisë e dendurisë së përdorimit, sipas fushave të jetës e të veprimtarisë, sipas burimit e formimit, sipas vlerave leksiko-semantike, fjalëformuese e stilistike, etj³⁸. “Njëherësh kjo lëndë leksikore shpalos një sinonimi të larmishme me fjalë të figurshme, me ngjyresa emocionale, me fjalëkrijime të zhdërvjella e shumëkuptimshme, si: *skurrjel*, *pip* për *curril*; *gojshoshë*, *goçakallë* për *llafazan*; *kobndjellës* për *ndjellakeq*; *syhapët*, *syunët*, *syshqyer*, *sykuçedër*, *syvangirë* për *i babëzitur*, *i pangopur*; *lakmues* *i madh*”³⁹.

Sikurse e përmendëm më lart, në kuadër të leksikut dialektor të shqipes mund të hyjë edhe një shtresë e veçantë leksikore, që janë huazimet leksikore. Mbështetur në statusin e tyre të përdorimit (përdorim aktiv), zakonisht këto fjalë (huazime) trajtohen si dialektizma derisa përdorimi i tyre është i kufizuar në treva të caktuara. Huazime leksikore, të cilësuar si krahinorizma më shumë ka në të folmet kufitare me sllavishte a greqishte, por edhe orientalizmat e turqizmat kanë zënë vend të konsiderueshëm në korpusin dialektor të shqipes. Huazime të tilla hasen më shumë në të folmet shqipe jashtë kufijve të shtetit shqiptar, sidomos në krahinat shqiptare të ish-Jugosllavisë. Përveç faktit se kanë qenë në kufi me të folmet sllave, disa të folme shqipe ishin pjesë e një hapësirë të përbashkët administrative, pra kanë bashkëjetuar brenda një shteti dhe huazimet leksikore janë si pasojë kontakteve të drejtpërdrejta që konsiderohen zhvillime të zakonshme të gjuhës. Kurse për orientalizmat në përgjithësi, është e kuptueshme se bashkëjetesa e detyrueshme me kulturën orientale për kohë të gjatë ka lënë gjurmë edhe në gjuhë. Në këtë drejtim, përveç rrethanave e faktorëve të shumtë, procesin e huazimit dhe përdorimit e orientalizmave e ka intensifikuar edhe feja, por edhe mendësia jonë e riformësuar gjatë pushtimit osman.

Kur i kemi parasysh rrethanat e krijuara sot, është e vërejtshme që të folmet krahinore kanë filluar një proces nëse do të mund ta quaja të vetëpastrimit nga huazimet, sidomos nga ato sllave e orientale. Sot janë më të rralla rastet kur përdoren huazime të tilla si: *zid*, *perzore*, *opçinë*, *rekë*, *bardak*, *sini*, *namazgjah* etj. Në harmoni me rrethanat e përgjithshme ekonomike, kulturore e gjuhësore, huazimet gjuhësore të ditëve të sotme janë nga gjuhë tjera, në masë më të madhe nga anglishtja. Gjithashtu, duhet ta theksojmë se në një masë të caktuar dialektizmat në përgjithësi janë duke iu nënshtruar një procesi të rrafshimit leksikor në raport me leksikun e shqipen standarde. Ky proces zhvillohet nga ndikimi që kanë shumë faktorë njëherësh, si shkollimi, tekstet shkollore, leximi, mediat, kontaktet intensive brendashqiptare etj.

³⁶ J. Thomai, *Krahinorizmat leksikorë në fjalorë të gjuhës shqipe*, në: “Gjurmime albanologjike”, nr. 43, Prishtinë 2014, f. 21.

³⁷ J. Thomai, po aty, f. 31

³⁸ J. Thomai, po aty, f. 86.

³⁹ Abdyl Sula, *Visare gjuhësore-kulturore nga Malësia e Gjakovës*, Tiranë, 2000, f. 51.

Materialet e punimeve (proceedings)

ISBN: 978-1-78911-007-4

Një pjesë e rëndësishme e leksikografisë shqiptare janë edhe botimet (fjalorët) e veçanta me materiale nga krahinat e ndryshme gjithandej trojeve shqiptare. Studiuesi Thanas Feka, në artikullin *Rreth fjalorëve krahinorë të gjuhës shqipe*, të botuar në vitin 2005 konstaton: *Në një hark kohor prej më se gjashtëdhjetëvjeçar janë botuar mbi katërmëdhjetë fjalorë e fjalorthë të kësaj gjinie, të cilët nën një emërtim më përgjithësues, janë konsideruar si “fjalorë krahinorë”⁴⁰. Aty autori i përmend këta fjalorë:*

1. “Fjalorth i ri” i Nikollë Gazullit, në Visaret e Kombit, vëll. XI, Tiranë, 1941.
2. “Fjalorth i ri” i Pano Tases, në Visaret e Kombit, Vëll. XII, Tiranë, 1941
3. “Fjalorth i fjalëve të rralla” i Abdullah Zyberit, Prishtinë, 1979.
4. “Fjalë e shprehje të shqipes i Aleksandër Xhuvanit;
5. “Fjalorth fjalësh e shprehjesh popullore” i Sulejman Drinit, Ibrahim Goçit, Mehmet Halimit, Skënder Gashit, Prishtinë, 1982.
6. “Fjalë popullore nga Myzeqeja”, i Jani Nushit, Tiranë, 1991.
7. “Shprehje popullore nga krahina e Korçës”, i Niko Mustakës, Tiranë, 1989.
8. “Fjalor i të folmeve të Malit të Zi”, i Mehmet Ahmetaj, Prishtinë, 1996.
9. “Fjalor i shqipes truallsoretë Maqedonisë”, i Qemal Muratit, Tetovë, 1998.
10. “Fjalor i fjalëve të rralla të përdorura në viset shqiptare të Maqedonisë” i Qemal Muratit, Shkup, 2003.
11. “Fjalor me shprehje e fjalë të rralla” i Petrit Zenelit, Tiranë, 2000.
12. “Visaret gjuhësore-kulturore nga malësia e Gjakovës”, në dy vëllime i Abdyl Sulës, I,II, Tiranë, 2000.
13. “Faqe nga visari leksikor i Mirditës” i Preng Cub Lleshit, Mirditë, 2002.
14. “Fjalor i shqipes së Plavës e Gucisë” i Pavli Haxhillazit e Sulejman B.Ahmetit, Tiranë, 2004
15. “Emërime për kafshë dhe shpendë në Labëri”, V. Memisha, Gjirokastër, 2001

Aty veçohen edhe disa fjalorë të tjerë me lëndë leksikore të burimit krahinor, por të specializuar për fusha të caktuara, si “Fitonimia e Kosovës” i Shefki Sejdiut (Prishtinë, 1979), “Leksiku bujqësor e blegtoral i të folmeve shqipe të Malit të Zi” i Abdullah Zyberit (Prishtinë, 1996) dhe “Emërime për kafshë e shpendë në Labëri” i Valter Memishës (Gjirokastër, 2001)⁴¹.

Përveç fjalorëve të lartshënuar, duhet t’i përmendim edhe këta fjalorë të botuar më vonë:

1. “Fjalor fjalësh të rralla të gjuhës shqipe” At Benedikt Demës, 2005
2. “Fjalor i gjuhës shqipe”, Mehmet Elezi, Tiranë, 2006
3. “Fjalor fjalësh e shprehjesh popullore”, Abdyl Sulos, Tiranë 2009.
4. “Fjalor dialektor i së folmes së Deçanit”, Bajram Mehmetaj, IAP, Prishtinë 2011 etj.
5. “Fjalor i Fjalëve e shprehjeve të Kosovës”, Qemal Murati

Se sa i plotësojnë këto botime të gjitha kriteret e një fjalori krahinor, qoftë ky i plotë apo i përzgjedhur, është një problem me mjaft diskutime e njëherazi dhe i vështirë, që lidhet me faktin se ende nuk është përpunuar në rrafshin teorik e atë praktik ndonjë platformë a manual me parimet përkatëse për fjalorë të kësaj gjinie lidhur “me përcaktimin e saktë të lëndës leksikore, me kronologjinë e burimit të saj, me kufijtë e shtrirjen e përdorimit, me vlerat e shumanshme që mbart, sidomos të natyrës stilistike, me interferencat e të folmeve të ndryshme⁴².

Sipas J. Thomait, “asnjë nga këta fjalorë nuk është dialektor e krahinor i mirëfilltë, por në një vështrim më të gjerë mund të cilësohen si të tillë, pasi pjesa më e madhe e fjalëve, shprehjeve

⁴⁰ Thanas Feka, *Rreth fjalorëve krahinorë të gjuhës shqipe*, në: “Leksikografia shqipe – trashëgimi dhe perspektivë”, ASHSH, Tiranë 2005, f. 204.

⁴¹ Th. Feka, *po aty*, f. 205.

⁴² Th. Feka, *po aty*, f. 205.

Materialet e punimeve (proceedings)

ISBN: 978-1-78911-007-4

dhe e kuptimeve, janë provë e këtyre të folmeve ku janë mbledhur⁴³. Pavarësisht kësaj, ai shton se këta i kryejnë detyrat e fjalorëve dialektorë, pa qenë tërësisht të tillë.

Kur flasim për leksikon dialektor e krahinor, vlerësoj se kjo pasuri gjuhësore është paraqitur në mënyrë të kufizuar në fjalorët shpjegues të shqipes të botuar deri më tash. Duke e pasur parasysh se tashmë është duke vazhduar puna në hartimin e Fjalorit të Madh të Gjuhës Shqipe (FMGjSh), kjo pasuri gjuhësore duhet të zërë vend më të gjerë, si burimi i rëndësishëm i pasurimit të leksikut të shqipes standarde me fjalë, togfjalësha të qëndrueshëm, njësi frazeologjike etj. Por, njëkohësisht duhet ta kemi të qartë se ky fjalor nuk është fjalor dialektor e aq më pak krahinor, siç nuk është i huazimeve apo i ndonjë fushe terminologjike etj. Prandaj variantet fonetike dialektore a krahinore, që nuk sjellin njësi të reja leksikore, sidomos huazimet (p.sh. *xhyzenti, ekmek, tabakhane, razí, apet, rekë, zid, perzore, tarrnagop* etj.), që kanë përdorim shumë të kufizuar në të folme të ngushta, nuk mund të përfshihen në FMGjSh. Variantet fonetike krahinore duhet të bëhen pjesë e Fjalorit kur në kontekstin e tyre i shërbejnë këtij qëllimi, sjellin nuanca plotësuese kuptimore a lidhje të veçanta sintaksore të fjalës.

Ashtu siç e përmendëm më lart, intensiteti i botimeve të kësaj fushe rritet vetëm në dekadat e fundit. Përveç rritjes së kuantitetit, studimet dhe botimet në këtë drejtim shquhen edhe për një ngritje të dukshme të nivelit të tyre shkencor. Në gjuhën shqipe, tashmë kemi në përdorim një numër fjalorësh dialektorë, materiale të shumta leksikore të botuara nëpër revista të ndryshme etj. Kjo lëndë leksikografike jo vetëm që e pasuron fjalorin e shqipes, por është edhe interesante, mbi të cilën mund të ndërmerren studime nga disiplina të ndryshme gjuhësore dhe jogjuhësore. Fjalorët e tillë janë të rëndësishëm për faktin se e mbledhin një pasuri të çmuar leksikore e semantike e cila rrezikon të zhduket.

Literatura

- A. Maxhuni, *Mbi leksikon dhe frazeologjinë e Vushtrrisë me rrethinë*, IAP, Prishtinë, 2017.
- A. Sula, *Visare gjuhësore-kulturore nga Malësia e Gjakovës*, Tiranë, 2000.
- F. Dulaj, *E folmja e Rahovecit me rrethinë*, Prishtinë, IAP 2016.
- J. Thomai, *Krahinorizmat leksikorë në fjalorë të gjuhës shqipe*, në: “Gjurmime albanologjike”, nr. 43, Prishtinë 2014.
- J. Thomai, *Leksiku dialektor e krahinor i shqipes së sotme*, Tiranë, 2002.
- M. Halimi, *E folmja e Kabashit të Prizrenit*, IAP, Prishtinë, Pridhtinë, IAP, 1985; *E folmja e Karadakut*, Prishtinë, IAP, 2008.
- N. Berisha, *Vëzhgime leksiko-frazeologjike në të folmet e Rrafshit të Dukagjinit*, IAP, Prishtinë 2017; *E folmja e Gjakovës*, IAP, Prishtinë, 2020.
- S. Gashi, *Fjalor i mikrotoponimisë së Istogut*, IAP, 2020; *Areali gjuhësor i Istogut me rrethinë*, IAP, Prishtinë, 2018.
- Sh. Ismajli, *Fjalë dhe njësi frazeologjike nga rajoni i Llapit*, IAP, 2018.
- Th. Feka, *Rreth fjalorëve krahinorë të gjuhës shqipe*, në: “Leksikografia shqipe – trashëgimi dhe perspektivë”, ASHSH, Tiranë 2005.
- B. Mehmetaj, *E folmja e Deçanit me rrethinë*, Prishtinë, 2006; *Fjalor dialektor i së folmes së Deçanit*, Prishtinë, IAP, 2011.
- L. Mulaku, *E folmja e Shalës së Bajgorës*, Prishtinë, IAP, 2005.
- Mulaku, Ragip: *Hulumtime dialektologjike dhe onomastike*, Prishtinë, 2005.
- Murati, Qemal: *Fjalor i fjalëve dhe shprehjeve të Kosovës*, IAP, 2018; *Elemente të shqipes në gjuhët sllave jugore*, 1990

⁴³ J. Thomai, *Leksiku dialektor e krahinor i shqipes së sotme*, Tiranë, 2002, f. 221.

Pajaziti, Naser: *E folmja e Anadrinit*, Prishtinë, 2008; *E folmja e Opojës*, 2005.

Zymeri, Abdullah: *Leksiku bujqësor e blegtoral i të folmeve shqipe të Malit të Zi*, Prishtinë, IAP, 1996

Lindja e implikaturave të reja kuptimore të leksemës ‘komandant’ në komunikimin publik ndër shqiptarët e Maqedonisë së Veriut

PROF. DR. ARBËR ÇELIKU / MR. SC. OSMAN ISMAILI
Universiteti i Tetovës, Fakulteti i Filologjisë

Abstrakt

Pas konfliktit të vitit 2001 midis Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare dhe organeve të rendit të shtetit të Maqedonisë (sot Maqedonia e Veriut) e deri më sot, leksema ‘komandant’, ndryshe nga kuptimi i saj origjinar ‘person me gradë të lartë në ushtri’, në ndërveprimin shoqëror dhe në diskursin publik në Maqedoninë e Veriut ka gjeneruar implikatura të reja kuptimore. Fillimisht, ky është një titull nderi, që persona të caktuar, të cilët kanë luftuar për të drejtat kombëtare, i ngre në piedestalin shoqëror dhe i favorizon në piramidën institucionale shtetërore. Megjithatë, jo rrallëherë në këto dy dekada, ka ndodhur dhe po ndodh që kjo leksemë të lindë edhe implikatura negative kuptimore, shkaku i veprimtarisë jo etike shoqërore. ‘Komandanti’ rezulton të jetë personi uzurpator, individi, i cili abuzon me të mirën kolektive në emër të kauzës, individi, i cili pa meritë zë një vend pune në piramidën e shtetit dhe rri në shtëpi, personi, i cili është mbi ligjin dhe të drejtën, i forti i partisë, i qytetit, lagjes, etj.

Ky do të jetë objekti i trajtimit të këtij punimi, i mbështetur me shembuj konkretë nga përditshmëria e shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut pas konfliktit të vitit 2001 e deri më sot. Gjithashtu do të mëtohet të bëhet edhe një kategorizim i implikaturave kuptimore të leksemës ‘komandant’ edhe në rrafshin sintagmatik gjuhësor.

Fjalët kyçe: *Shqiptarët e Maqedonisë së Veriut, implikaturat e reja kuptimore të leksemës ‘komandant’, ndryshimi kuptimor, komunikimi publik.*

1 Hyrje

Me zhvillimin e hovshëm të teknologjive informative, sidomos të inteligjencës artificiale (AI), nuk ndryshon vetëm mënyra e jetesës njerëzore, por edhe dinamizmi gjuhësor bëhet më i vrullshëm dhe gërryes në membranën tradicionale dhe konservative të gjuhëve dhe, kësaj, gjuhës i atribuohet karakteristika e një konceptimi *sui generis* mbi botën.

Në këto ndërthurje, dijet paraprake, të cilën ne i përvetësojmë nëpërmjet një gjuhe të caktuar, nuk qëndrojnë statike njëherë e përgjithmonë. E mira në këtë rast është se ne nuk do të kishim mundur të mësonim asgjë të re në ndërveprim me botën dhe në bisedë me të. Kësaj gjuha hyn në vorbullën e saj të transformimit, sado që i ngadalshëm mund të na duket neve. Dhe në këtë vorbull transformimi dikotomitë kantiane (konstitutiv vs. regulativ, transcendental vs. empirik, imanent vs. transcendent, etj) e humbasin saktësinë e tyre dalluese, sepse detranscendentalizimi nënkupton një qasje të thellë në arkitektonikën e pikëpamjeve bazë.

Në dritën e këtyre raporteve gjenealogjike ne i zbulojmë edhe udhëkryqet, në të cilët filozofia analitike gjuhësore e nxjerr në sipërfaqe traditën e ideve të arsyes kantiane. Megjithatë, shikuar nga perspektiva ontologjike, në vendin e një idealizmi transcendental, i cili tërësinë e objekteve njohëse e koncepton si një botë ‘për ne’, pra si një botë të dukshme,

hyn një realizëm intern, një realizim gjuhësor specifik nga shoqëria në shoqëri. Bota vetë nuk na e imponon neve gjuhën ‘e saj’; ajo vetë nuk flet dhe ‘përgjigjet’ vetëm në kuptimin e nëntëshëm, figurativ. Me këtë rast, entitet të qenë e quajmë ne ekzistimin e gjendjeve a rrethanave shprehëse. Mirëpo, kjo prani e fakteve, kuptohet sipas një modeli reprezentativ të njohjes, nuk guxon të prezantohet si një realitet i riprodhuar dhe kështu të përshtatet me vetë ekzistencën e objekteve.

Në praktikë gjuha nuk e mundon veten me idhujt dhe kultet e traditës, të ruajtura me fanatizëm në korpusin e tërësishëm shkencor, pra me rebusin e figurave dhe idealeve të saj dhe shikon përmes shoqërisë si përmes një xhami të tejdukshëm dhe krijon membranën e pavarur të së ashtuquajturës veprimtari komunikuese (termi sipas Habermas-it 1977).

Dhe, në tërësinë e kësaj veprimtarie komunikuese, po gjenerohen struktura e fraza gjuhësore specifike që, para së gjithash, ndërlidhen edhe me mentalitetin kolektiv, implikaturat kulturore, traditat, doket e zakonet.

Në këtë kontekst, ne po shtjellojmë implikaturat e reja të leksemës komandant ndër shqiptarët e Maqedonisë pas konfliktit të vitit 2001 dhe po i kategorizojmë ato në rrafshin gramatikor, semantik dhe pragmatik.

2 Mbi nocionin e ndryshimit kuptimor të fjalëve

Teoria gjuhësore, në veçanti semantika, e cila e sqaron kuptimin e shprehjeve gjuhësore me anë të kushteve të të kuptuarit të gjuhës, është vendi ku mund të takohej një pragmatikë formale me hulumtimet e karakterit empirik. Dhe, pikërisht tradita e hulumtimit empirik nisët nga situatat elementare të një premise jo idealizuese, që rezultojnë me gjendjet faktike se si frazat dhe shprehjet predikative në shumëllojshmërinë e konteksteve të tyre të përdorimit nuk e ruajnë dot tërësinë dhe identitetin e domethënies origjinare, por që rezultojnë me implikatura të reja në rrafshin metagjuhësor. Kështu me patjetër duhet të bëhet dallimi midis konceptit origjinar semantik të një lekseme të caktuar (si në rastin tonë i leksemës ‘komandant’) me përdorimin e saj praktik në një shoqëri, respektivisht gjuhë të caktuar.

Me këtë rast, rrafshi i përdorimit merr implikatura të reja në diskursin publik dhe ato fillojnë e etablohen dhe kuptohen në kontekste ndryshe nga ato të zakonshmet, duke e pasuruar diskursin gjuhësor si në rrafshin konceptual ashtu edhe në atë leksikor.

Kështu, semantika e përdorimit realizon një raport të brendshëm mes domethënies dhe kushteve të vlefshmërisë së thënies dhe, me këtë, trason një rrugë të re drejt koncepcioneve të një racionaliteti gjuhësor, komunikues dhe pragmatikor, duke iu përgjigjur tiparit bazë semantik, pra domethënies të ndryshueshme në rrafshin sintagmatik.

Putnam (1975:215-271) pohon, se “Njohuria e ndryshuar mbi realitetin objektiv indukton një ndryshim të njohurive gjuhësore, dhe përparimet e njohjes projektohen në ndryshimin e kuptimit të koncepteve teorike bazë”, por që në rastin e leksemës ‘komandant’, si postulat kryesor i këtij punimi, ne mund t’ia atribuojmë edhe faktorin gjeografik, që në këtë rast përcakton veprimtarinë komunikuese të një bashkësie gjuhësore siç jemi ne shqiptarët e Maqedonisë së Veriut, gjë që ngjashëm e definojnë edhe Dummett (1993:181), kur pohon se “domethënia e një pohimi nuk sqarohet me premisën e ‘vërtetësisë’ së tij, por me përdorimin në një situatë të caktuar ligjërimore”.

Një analizë të thuktë, jo vetëm nga perspektiva gjuhësore, por edhe ajo sociologjike, sa i përket nocionit të ndryshimit të nocioneve gjuhësore, bën Pierre Bordieu (1977). Ai e sheh gjuhën si një formë kapitali dhe si një mjet drejt distikcionit social (po aty, fq. 647), në kuptimin e një kapitali kulturor, të cilin përdoruesit e caktuar të tekstit mund ta implementojnë në fusha të ndryshme shoqërore, me synimin e pohimit dhe përmirësimit të statusit të tyre

shoqëror, gjë që është mjaft evidente me ‘komandantët’ e periudhës kohore pas konfliktit të vitit 2001 ndër shqiptarët e Maqedonisë së Veriut. Kësisoj implikaturat e reja të leksemës ‘komandant’, fillimisht, lindën si rezultat i një beteje për njohje dhe legjitim shoqëror, më vonë, pasi njohja dhe legjitimimi u pranuan në masë të madhe ndër popullatën shqiptare në Maqedoninë e Veriut, ato u shfrytëzuan për ndikime politike dhe pushtet. Një definicion lidhur me këtë ma dha një fiqinji im, pensionist, i cili, në bisedë e sipër për situatën e krijuar shoqërore-politike ndër shqiptarët e Maqedonisë së Veriut, më tha: “Komandantët po i kontrollojnë edhe mendimet tona, ëndrrat tona, dëshirat tona. Ata po ndikojnë edhe virtualisht në psiken tonë kolektive” (bisedë me N.Ç., 12 tetor 2023).

Me këtë rast, duhet thënë se, përveç faktorëve gjuhësorë dhe kognitivë, natyrisht se në ndryshimin kuptimor të leksemave, ose në lindjen e implikaturave të reja, luajnë rol kyç edhe faktorët jashtëgjuhësorë si: mentaliteti, format e jetesës, mënyra e perceptimit mbi realitetin objektiv, parametrat socialë, etj.

3 Metodologjia e punës

3.1 Qëllimet

- Të shtjellohen implikaturat e reja kuptimore të leksemës ‘komandant’ në komunikimin publik ndër shqiptarët e Maqedonisë së Veriut
- Të trajtohen faktorët shoqërorë-politikë dhe psikologjikë të përdorimit të këtyre implikaturave të reja kuptimore
- Cili është impakti shoqëror i përdorimit të këtyre implikaturave
- Të diskutohet çështja e pasurisë së gjuhës shqipe me këtë rast

3.2 Ndërtimi i korpusit të të dhënave

Korpusi i hulumtimit është ndërtuar në bazë të bisedave të rastit me individë kryesisht nga shoqëria civile. Gjithashtu për analizë është marrë poezia e shkrimtarit gjerman Bertolt Brecht: *Gjeneral tanku yt është një mjet i rëndë*, përkthyer nga Arbër Çeliku dhe botuar në portalin letrar Observer Kult dhe një qasje publicistike e shkrimtarit shqiptar nga Maqedonia e Veriut, Kalosh Çeliku.

Një tjetër burim i të dhënave është edhe Fjalori thesar i Gjuhës Shqipe (2006) prej të cilit janë shqyrtuar në mënyrë shteruese implikaturat normative të leksemës ‘komandant’, që në rastin e dhënë pësojnë ndryshim kuptimor gjatë përdorimit në ligjërimin publik.

Materiali i shfrytëzuar nga burimet e sipërpërmendura na krijoi mundësinë për të ndërtuar një tipologji gjuhësore përdorimi, kuptimi dhe perceptimi.

3.2 Shtrimi i rezultateve të hulumtimit

Në Fjalorin thesar i gjuhës shqipe hasim në këto implikatura të leksemës ‘komandant’:

1. usht. Ushtarak që merret me organizimin, me drejtimin dhe me përgatitjen luftarake të një njësie ushtarake; ushtaraku që komandon një njësi a një repart në luftë, trupat në një parade etj. Komandanti i skuadrës (i togës, i kompanisë). Komandanti i garnizonit. Komandanti i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura. Detyra e komandantit.

2. Nxënës që është zgjedhur në krye të një skuadre, të një kompanie a të një çete pionierësh. Komandanti i çetës së pionierëve.

3. Ai që drejton punën e një njësie me organizim të brendshëm të ngjashëm me atë të ushtrisë (brigadën e vullnetarëve në një aksion për ndërtimin e vendit etj.). Komandant i brigadës së vullnetarëve.

4. bised., keq. Ai që ka dëshirë të japë urdhra dhe kërkon që të tjerët t'u binden këtyre patjetër, ai që e heq veten si kryetar e përgjegjës. Na u bë komandant!

Pikënisje e këtij punimi paraqet implikatura semantike e leksemës ‘komandant’ si në pikën 4 të Fjalorit thesar të gjuhës shqipe, të cilën do ta shtjellojmë më tej me lindjen e implikaturave të reja semantike në diskursin publik ndër shqiptarët e Maqedonisë së Veriut.

Para konfliktit të vitit 2001 midis forcave të sigurisë maqedonase dhe ushtarëve të UÇK-së, leksema ‘komandant’ në diskursin publik ndër shqiptarët e Maqedonisë së Veriut ka pasur kryesisht përdorim normativ si në pikën 1. të Fjalorit thesar të shqipes dhe, rrallëherë, edhe si në pikën 4, respektivisht në një mënyrë ambivalente (herë si respekt dhe herë si ironi), duke ia veshur si atribut leksemëm ‘komandant’ burri gruas përpara miqve të tij, si psh:

- 1) Si të thotë komandanti/Komandanti e ka fjalën.
- 2) Edhe unë kam një komandant në shtëpi.

(*dëshmi dëgjimore*)

Në shembullin 1) është e pranishme edhe gruaja e folësit dhe implikatura kuptimore është respekt, bindje, madje edhe shprehje emancipimi. Shembulli 2) kryesisht shprehje e ironisë karshi mikut, i cili i druhet gruas së vet dhe folësi, me këtë rast, ironizon me një situatë, kur ai nuk ka mundur të lëvizë nga shtëpia.

Pas konfliktit të armatosur rreth 6-mujor, leksema ‘komandant’ vërshoi në implikatura të shumta të reja kuptimore në diskursin publik dhe e bë kryetema e veprimtarisë shoqërore, që vazhdon edhe sot t’i ndikojë ato ndër shqiptarët e Maqedonisë së Veriut.

Implikatura e parë paraqet **respekt** për luftëtarin e lirisë, i cili sakrifikoi edhe veten për realizimin e të drejtave kolektive të shqiptarëve në Maqedoninë e Veriut.

Me kalimin e kohës, koncepti i Bordieu-t (1977) i “pohimit dhe përmirësimit e legjitimitimit të statusit shoqëror” u vu si asnjëherë më parë në praktikë. Kështu leksema ‘komandant’ u kthye në një **titull nderi**, jo në kuptimin normativ, por praktik shoqëror. Kur komandantët u mësuan me këtë nderim kolektiv, filluan të shikojnë në shoqëri si përmes një xhami të tejdukshëm dhe filluan të ushtrojnë ndikimin e tyre në çdo sferë shoqërore, dhe, me pjekjen e kushteve, edhe në sferën institucionale-shtetërore, duke e ngritur veten në një autoritet kolektiv, i cili nuk e kufizon hapësirën individuale të veprimit për asnjë çast. Kësisoj, në kushtet e krijuara shoqërore ndër shqiptarët e Maqedonisë së Veriut të paskonfliktit 2001, normat morale dhe ato ligjore u shkëputën nga trajta e tyre universale dhe filluan të pavarësohen në norma të kufizuara përreth individëve të caktuar, që mbanin epitetin e ‘komandantit’ jo-normativ. Dalëngadalë, këta persona u pajisën me tiparin e pushtetit dhe filluan të vepronin në të mirë të vetes, por duke anashkaluar normat morale-shoqërore dhe juridike shtetërore. Disa sosh ia mësnyë rendit shoqëror dhe institucional si buburrecat një rrapi qindra vjeçar, duke ia brejtur rrënjët, që më pas ta plandosin përtokë. Në fillim, në sajë të titullit të tyre të nderit, të perceptuar gjerësisht nga shoqëria, u pajisën me diploma universitare dhe ua mësnyë institucioneve shtetërore, duke marrë pozita të rëndësishme në piramidën e shtetit, për ta vazhduar më tej ndikimin në ndërtimin e një filozofie të fuqishme klienteliste insdtitucionale, që vazhdon edhe sot. Në rrafshin diskursiv lindën maksima të tilla si: “E di kush jam unë? Jam komandant X, Y”, ose “Ky është vëllai/djali/nipi i komandant filan fistekut” ose “Kjo është gruaja/vajza/mbesa e komandant filan fistekut”, që presupozonte se duhej me patjetër t’i kryhet puna.

‘Komandantët’ shpejt u bënë si Harry Potter me shkopin magjik, që plotësonin **dëshirat**, por edhe **hallet e dertet** e përditshme të njerëzve: kryesisht në punësim në

administratën shtetërore, intervenime për marrjen e notave në tërë sistemin arsimor në RMV (shkollim fillor, të mesëm dhe të lartë) dhe instalimin e personave të caktuar nëpër pozita udhëheqëse nëpër institucionet publike. Sigurisht se, në këto ndërthurje të krijuara shoqërore, ka pasur dhe abuzime të mënyrave të ndryshme si: marrje të ryshfetit, caktimin e tarifave për një vend pune dhe favore të natyrave të ndryshme. Korpusi i mbledhur në terren për afër dy dekada e dëshmon këtë. Gjatë anketimit tonë lidhur me këtë çështje, në dhjetor 2023, përmes platformës Facebook, personi me inicialet A.E. i cili me prejardhje është nga një fshat i Tetovës, por që jeton në Suedi, shkruan: “Teksa vija me familjen nga Suedia me makinë, në kufirin e Maqedonisë më ndaloi policia kufitare sivjet (2023) për një gjë fare banale dhe, fjalja e parë që më tha vëllai në Tetovë përmes telefonit, ishte: ‘Prit ta marr në telefon komandantin’”. I pyetur për emrin e tij, ai tha: “Është një hero, komandant i vetëshpallur, i cili ka lidhje të forta politike në RMV. Ai një ngjarje të thjeshtë e bëri problem shumë të madh. 10 persona u përfshinë dhe tërë kohën përdornin termin ‘komandant’. Në fund komandanti më tha: ‘për rastin tënd kanë marrë vesh e gjithë qeveria e RMV-së. Është përfshirë edhe ambasadori i Maqedonisë së Veriut në Danimarkë’, e kishte ngatërruar faktin që unë jetoja në Suedi. Qëllimi ishte që të jepja ryshfet, megjithatë unë prita 8 orë në kufi, por nuk e hapa kuletën”.

Një implikaturë tjetër kuptimore që ka lindur me kalimin e kohës sa i përket leksemës komandant, është ajo e **sarkazmit**. Kalosh Çeliku (kryetar i Lidhjes së Shkrimtarëve të Maqedonisë së Veriut), në librin e tij publicistik *Me tre varre* (2002) shkruan kështu: “Pas Luftës nga malet të gjithë zbritën si komandantë përveç njërit ushtar, një plaku 72 vjeçar nga një fshat i Kërçovës, të cilin ai e quan me nofkën ‘Askeri’ (fq. 37). Në këtë kontekst edhe shkrimtari i njohur gjerman, Bertolt Brecht, në poezinë e tij *Gjeneral, tanku yt është i rëndë*, ka përdorur sarkazmin si mjetin e protestës kundër regjimit të Hitlerit, por që ai përdor leksemën ‘gjeneral’ në kuptimin normativ, e cila gjen përdorim edhe në diskursin tonë si leksema ‘komandant’, por shumë më rrallë:

Gjeneral, tanku yt është një mjet i rëndë

Gjeneral, tanku yt është një mjet i rëndë
Ai e bën copa malin dhe shtyp qindra njerëz.
Por, ka një të metë:
I duhet një shofer që ta vozisë.

Gjeneral, aeroplani yt bombardues është i fuqishëm.
Ai fluturon më shpejt se stuhia dhe ngarkohet më shumë se një elefant
Por, ka një të metë:
I duhet një montazher ta bëjë gati.

Gjeneral, njeriu është shumë i përdorshëm.
Ai mund të vozisë aeroplan dhe të vrasë.
Por, ka një të metë:
Ai di të mendojë dhe të ndiejë.

(Përkthimi dhe përshtatja A.Ç.)

Materialet e punimeve (proceedings)

ISBN: 978-1-78911-007-4

Së fundmi, në komunikimin publik përkitazi me leksemën ‘komandant’, përdoret edhe implikatura kuptimore e **qesëndisë**, **talljes** dhe **përçmimit**, si rrjedhojë e veprimtarisë degraduese ndaj imazhit të vetvetes të ‘komandantëve’ të caktuar, siç u përshkruajt më lartë, duke lindur epítete negative nga më të ndryshmet si: “Komandant laperi”, në kuptimin e një personi pa etikë, interesxhi dhe të degraduar, “komandat kriminel”, në kuptimin e një personi që është mbi ligjin, “komandant dhelpra”, në kuptimin e një personi dinak, përfitues dhe mashtrues, “komandant rriqna”, person që të ngjitet keq dhe ta thith gjakun me pambuk, derisa të të shtrydhë mirë e mirë, etj. Të gjitha këto janë dëshmi dëgjimore.

4. Përfundime

Leksema ‘komandant’ është njëra ndër më të përdorurat në diskursin publik ndër shqiptarët e Maqedonisë së Veriut pas konfliktit të vitit 2001 dhe, siç mundëm të vërejmë, shpreh implikatura të shumta kuptimore si: respekt, nderim, por edhe realizim dëshirash dhe zgjidhje të problemeve dhe halleve të njerëzve, e deri te përdorimi i saj si mjet i sarkazmit, ironisë, qesëndisë, etj.

Pra, ajo ka rezultuar me një përmbajtje jo-normative nga praktika argumentuese, tek e cila përdoruesit e saj, në ndërthurje shoqërore si tonat, e shohin gjithmonë të drejtuar veten në praktikën e përditshme komunikuese, gjatë së cilave pengesat rutinë drejt pritjeve për ligjura. Pikënisjen e përbën gjithsesi përmbajtja jo-normative e premisave pragmatike, për të cilat shprehen në mënyrë implicite pjesëmarrësit e argumentimit, sapo ata, me synimin e zgjidhjes së kontroversave, të marrin pjesë në një kërkim kooperues për gjetjen e argumenteve më të mira.

Bibliografia

Bourdieu, Pierre: The Cultural Transmission of Social Inequality. Në: *Harvard Educational Review* (1977) 47 (4): 545–555

Bourdieu, Pierre: Perspectives on language in society. Në : *Handbook of Pragmatics* 2015: 36-47.

Habermas, Jürgen: Zur Logik der Sozialwissenschaften. Suhrkamp, Frankfurt am Main 1970

Putnam, Hilary: “The meaning of meaning” (Domethënia e kuptimit), në: *Mind, Language and Reality*, Cambridge 1975, fq. 215-271.

Dummett, Michael: “Language and Communication”, në: *The Seas of Language*, Oxford 1993, fq. 181.

Burimet:

Çeliku, Kalosh: Me tre varre. Shkup 2002

Brecht, Bertold: Gjeneral, tanky yt është një mjet i rëndë. Përkthyer nga Arbër Çeliku, botuar nga portali kosovar ObserverKult ([Bertolt Brecht: Gjeneral, tanku yt është një mjet i rëndë - ObserverKult](#))

Memoria kolektive përmes gjuhës dhe historisë së folur në bashkësinë e shqiptarëve të Çamërisë

Ph.D MATILDA LIKAJ
Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës

PROF. AS. DR. EDLIRA ABDURAHMANI
Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës

Abstrakt

Ndërlidhjet midis historisë dhe gjuhës së folur janë bërë shpesh objekt kërkimesh analitike postmoderne të shkencave shoqërore. Përdorimi i kësaj metode ndihmon në ruajtjen e njohurive që nuk gjenden të dokumentuara. Studimi përqendrohet tek historia e treguar përmes gjuhës dhe ka për qëllim të sjellë në vëmendje memorien kolektive të bashkësisë së shqiptarëve të Çamërisë në Shqipëri.

Studimi është mbështetur në një fushë të përbashkët studimi midis sociologjisë dhe gjuhësisë.

Përmes historisë së shqiptarëve të Çamërisë të treguar në çamërisht, studimi kërkon të eksplorojë në jetën individuale të të moshuarve çamë, duke marrë sa më shumë njohuri rreth gjuhës së tyre krahinore, historisë së krahinës më jugore të Shqipërisë, kulturës së kësaj krahine të mbartur e të trashëguar deri në ditët tona. Punimi synon të portretizojë identitetin e tyre social dhe gjithçka tjetër që do të mund të na ndihmonte në analizimin siç duhet të memories kolektive çame.

Metodologjia e studimit është ajo e intervistimit të drejtpërdrejtë duke regjistruar me origjinalitet të gjithë informacionin e vjelë përmes gjuhës së tyre të folur. Synimi ynë pra, nuk është vetëm thjesht interpretimi, por regjistrimi i dëshmiave reale në mënyrë që të krijojmë burime parësore në trajtë dokumentacioni për t'u shfrytëzuar në të ardhmen edhe nga brezat pasardhës. Për rrjedhojë, studiuesit e ardhshëm të disiplinave të ndryshme do të kenë mundësinë të hedhin dritë mbi historinë dhe gjuhën nga njëra anë, si dhe të rindërtojnë të shkuarën nga ana tjetër. Përmes bankës së të dhënave ato do të mund të analizojnë kapitalin social si dhe të formësojnë memorien kolektive të bashkësisë së shqiptarëve të Çamërisë.

Fjalë çelës: *historia dhe gjuha e folur, formimi i kujtesës kolektive, kapitali social, bashkësia e shqiptarëve të Çamërisë*

Hyrje

Ky studim është përqëndruar tek historia e shqiptarëve të Çamërisë e treguar përmes gjuhës së folur dhe ka për qëllim të sjellë në vëmendje memorien kolektive të bashkësisë së shqiptarëve të Çamërisë në Shqipëri.

Përmes historisë së shqiptarëve të Çamërisë të treguar në çamërisht, ne informohemi më shumë rreth historisë së krahinës më jugore të Shqipërisë, si dhe kulturës së kësaj krahine; një kulturë e mbartur dhe e trashëguar deri në ditët tona. Përmes saj ne informohemi gjithashtu rreth identitetit të tyre social dhe gjithçkaje tjetër që do të mund të na ndihmonte në analizimin siç duhet të memories kolektive çame.

Nga ana tjetër, përmes historisë së shqiptarëve të Çamërisë, të treguar në çamërisht, ne informohemi më shumë rreth të folmes së tyre krahinore dhe vlerës së saj për gjuhën shqipe. Gjithësesi, vetë punimi na kufizon për shkak të volumit për lëvrimin siç duhet të të gjitha këtyre çështjeve. Për rrjedhojë, kjo temë është një sprovë fillestare dhe hapi i parë i një pune e cila do të kurorëzohet në një formë më të zgjeruar në të ardhmen.

Metodologjia e këtij studimi dhe e studimeve që do të vijojnë, është ajo e intervistimit të drejtpërdrejtë, duke regjistruar me origjinalitet të gjithë informacionin e vjelë përmes

Materialet e punimeve (proceedings)**ISBN: 978-1-78911-007-4**

gjuhës së folur të shqiptarëve të Çamërisë. Regjistrimi i dëshmimeve reale, të ruajtura në trajtë dokumentacioni, do të ndërtojë një bankë të dhënash për t'u shfrytëzuar në të ardhmen nga brezat pasardhës. Intervistat në këtë punim janë lënë në çamërisht, duke u përshtatur më pas në gjuhën standarde, pasi synohet që përmes të dhënave të hidhet dritë mbi të shkuarën tonë historike, por edhe mbi probleme që lidhen me historinë e gjuhës shqipe. Gjithashtu, me anë të këtij studimi dhe tjerëve që do të pasojnë, studiuesit e ardhshëm të disiplinave dhe fushave të ndryshme do të kenë mundësinë të analizojnë në varësi të interesave të ndryshme gjithë kapitalin social e gjuhësor të kësaj bashkësie.

Me anë të punimit në fjalë kërkohet gjithashtu të krijohet një model për t'u shfrytëzuar edhe për studime që lidhen me bashkësi të tjera shqiptare në kontakt (ose me krahina të veçanta të tyre) siç janë, bashkësitë e shqiptarëve të Malit të Zi, të Kosovës, të Maqedonisë. Punimi në fjalë mund të jetë edhe një model i mirë për t'u ndjekur edhe për bashkësitë e hershme shqiptare në emigracion, siç është ajo e arbëreshëve të Italisë, e arvanitasve të Greqisë, shqiptarëve të hershëm të Turqisë, arbëreshëve të Karakurtit të Ukrainës, arbëreshëve të Zarës në Kroaci, arbëreshëve të Mandricës në Bullgari, grupimeve të hershme të shqiptarëve në Amerikë, Australi ... etj.

Siç është përmendur në abstrakt, studimi është mbështetur në një fushë të përbashkët midis sociologjisë dhe gjuhësisë. Po vijojmë më poshtë me disa të dhëna teorike nga fusha e sosiologjisë

Historia e folur dhe formësimi i memories kolektive

Historia gojore dhe formësimi i memories kolektive, ka një rëndësi të veçantë në zhvillimin e kontekstit akademik. Përveç metodave të ndryshme për të studiuar historinë e folur dhe formësimin e memories kolektive, teoritë e të folurit në kontekstin filozofik e sociologjik, e kanë origjinën e tyre herët. Ndërsa në kontekstin historik, ato janë të reja dhe të pakta, në aspektin socio-kulturor dhe gjuhësor, mbledhja, sistemimi dhe analizimi i dëshmimeve kolektive, formojnë arkivën e folur të historisë ose ndryshe, historinë e folur.

“Historia e folur”, është zhvilluar për herë të parë si koncept akademik në vitet 1940, në Universitetin e Kolombias, nga Allan Nevins. Zhvillimi dhe njohja e saj akademike u realizua në vitin 1960-të dhe vazhdon ende në ditët e sotme, si një disiplinë e domosdoshme dhe urë lidhëse ndërmjet disiplinave të shkencave të ndryshme gjuhësore dhe atyre sociale.

Metodologjia e historisë së folur, përqendrohet te intervistimi i personave që kanë parë me sytë e tyre ngjarje të së shkuarës, me qëllim rikonstruktiv historik të këtyre ngjarjeve. Studiuesi gjatë procesit të realizimit të studimit të ngjarjes, mundëson intervistimet, regjistrimin e dëshmimeve, zbardhjen e intervistimeve, arkivimin e materialit dhe kthimin e tij në material të shkruajtur sipas origjinalitetit dhe transkriptimit, në bazë të indikatorëve të përcaktuar për studimin.

Metodat e përdorimit për të analizuar ngjarjet, mundësojnë ndërveprim shkencor e ndërdisiplinor. Gjithësesi, është shumë delikate mënyra e të treguarit të ngjarjeve, analizimit të gjuhës së kujtesës, procesit të formësimit të kujtesës dhe ndërtimit imagjinar-shkencor historik.

Historia e folur, ka një shtrirje në kohë të dëshmimeve gojore, e cila limitohet nga perceptimet kohore dhe nga kohëzgjatja e jetës së njeriut. Kjo ndodh për shkak të limitit të përcaktuar që dëshmitë e folura nuk mund të kalojnë 70-75 vite.

Për sa i përket kujtesës, në shkencat sociale ajo kategorizohet si personale dhe kolektive. Formësimi i kujtesës, është një proces nëpërmjet të cilit zgjidhet se çfarë duhet të kujtojmë dhe çfarë nuk duhet të kujtojmë. Kujtesa lidhet me procesin e memorizimit të

Materialet e punimeve (proceedings)**ISBN: 978-1-78911-007-4**

historisë së një vendi dhe është domosdoshmëri dokumentimi. Procesi i formësimit të kujtesës kolektive kërkon lirinë politike, për arsye se ai paraqet proces identitar të individit ose grupit të intervistuar.

Fjala kujtesë, një nga komponentët e konceptimit të kujtesës sociale, konsiderohet si kontribut i fushës së psiko-sociologjike, në literaturën e shkencave shoqërore. Megjithatë, edhe shumë disiplina të tjera i kanë kushtuar vëmendje të madhe kujtesës. Për shembull, sociologjia e ka përfshirë ‘kujtesën’ në fushat e saj të studimit, konkretisht përta i përket ‘formësimit të kujtesës’ me marrëdhëniet shoqërore, mitet e antropologjisë, duke u bërë funksionale në jetën shoqërore për sa i përket marginalizimit të grupeve dhe historisë së ringjalljes/ripërtëritjes së traditës (Devine, 2003: 13-18). Kujtesa, në kuptimin e saj më të përgjithshëm, është "emri i sistemit që regjistron të kaluarën tonë, të cilës ne mund t'i referohemi kur është e nevojshme, dhe për këtë arsye ndikon në momentin tonë të tanishëm" (Arkonaç, 2005, 181). Pasi ka kaluar një kohë e caktuar që kur mendja e individit ka përjetuar ndonjë përvojë, efekti i kësaj përvoje shfaqet në një nga veprimet tona. Kjo do të thotë se ajo që fitohet përmes përvojes, ruhet në mendjen tonë në një mënyrë ose në një tjetër. Sistemin që ndërmerr funksionin e ruajtjes, e përcaktojmë si ‘memorie’ (Özakınar, 2009; 10). Kujtesa në boshtin e koncepteve si njohja, kujtimi, harrimi, rimarrja, të mësuarit , e vazhdon ruajtjen dhe regjistrimet e saj nëpërmjet përsëritjes. Shumë nga këto koncepte kanë gjithashtu një rol të rëndësishëm në të kuptuarit e kujtesës sociale.

Për të kuptuar kujtesën dhe funksionimin e saj, së pari duhet të kuptojmë ‘njohjen’. Çdo person merr informacion nga bota e jashtme, e përpunon dhe e rindërton këtë informacion që vjen nga jashtë së bashku me informacionin që ekzistonte në kujtesën e tij. ‘Bota mendore e njeriut ka një strukturë që lejon takimin dhe bashkëpunimin e vazhdueshëm të informacionit që ekziston në mendje me atë që vjen nga jashtë (Arkonaç, 2005; 92). Ky informacion i përpunuar në mendjet tona më vonë bëhet konkret me anë të gjuhës dhe veprimeve tona. Procesin e perceptimit, memorizimit, rindërtimit dhe konkretizimit të informacionit që hyn në mendjen tonë e quajmë ‘njohje’. Njohja është sistemi që tregon se si funksionon kujtesa. Çështje e rëndësishme për sociologjinë është se si ne e perceptojmë informacionin që vjen nga jashtë, sepse mënyra jonë e perceptimit nuk lidhet vetëm me botën tonë mendore. Ne e perceptojmë së bashku, me atë që kemi vendosur në mendjen tonë deri atëherë dhe me të gjitha blerjet që kemi fituar gjatë procesit të socializimit. Me fjalë të tjera, çfarë dhe si e perceptojmë ne, ndryshon në varësi të një sërë faktorësh, nga struktura e shoqërisë në të cilën jetojmë deri te sistemi politik, ambienti ku jetojmë dhe eksperiencat e jetesës. Ashtu si në kujtesën individuale, përsëritja është jashtëzakonisht e rëndësishme në kujtesën sociale për të harruar dhe mbajtur mend të dhënat. Ajo që na ka ndodhur në të kaluarën përcakton mënyrën se si i vlerësojmë ngjarjet që përjetojmë në jetën tonë të përditshme. Kujtimet janë dëshmi se si i kemi përjetuar ngjarjet, jo kopje të vetë ngjarjeve. Përvojat janë të koduara nga rrjetet e trurit, lidhjet e të cilave janë formuar nga takimet e mëparshme me botën. ‘Kjo njohuri paraekzistuese ndikon fuqishëm në mënyrën se si ne kodojmë dhe ruajmë kujtime të reja, duke kontribuar kështu në natyrën, strukturën dhe cilësinë e kujtimit të asaj që kujtojmë për atë moment’ (Schacter, 2010; 22). Trajtimi i kujtesës nga psiko-sociologjia në këtë mënyrë na lejon të vendosim lidhje midis kujtesës njerëzore dhe kujtesës sociale. Ashtu si në kujtesën individuale, ajo që regjistrohet në memorien sociale nuk mund të harrohet ose të mbahet mend plotësisht. Mbetjet e çdo artikulli të hequr nga memoria sociale bëjnë që të ndodhë ringjallja me hyrje të reja në kujtesë.

Në pamje të parë, kujtesa njerëzore duket të jetë një sistem individual i bazuar në përvoja shumë subjektive. Gjithashtu, fakt është që çdo përvojë subjektive formësohet nga

disa kushte shoqërore. Ajo që lejon që përvojat subjektive të ndodhin, është ekzistenca e një mjedisi në të cilin ne mund të përjetojmë. Marrëdhënia midis kujtesës individuale të bazuar në përvojat subjektive dhe kujtesës sociale të bazuar në ndërveprimin shoqëror është si marrëdhënia midis gjuhës dhe të folurit të formuluar nga Saussure. Historia e folur dhe memoria kolektive, realizohen nëpërmjet instrumentit ‘gjuhë’. Edmund Husserl, në aspektin e fenomenologjisë, pohon se veprimi dhe subjekti i të menduarit janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën si dhe janë të ndërsjellta. Qëllimi bën dallimin në këtë ndërsjellje. Bota e të jetuarit, është elementi kryesor eksperimentit të jetësor. Gjuha formohet pas të gjitha proceseve shoqërore që përjetojmë dhe në këtë aspekt është një fenomen tërësisht shoqëror. Fjalimi zhvillohet me iniciativën e individit. Por individët nuk mund të flasin pa gjuhë (Funkestein, 1993; 9). Nga ky këndvështrim, cilësia dhe sasia e mjedisit shoqëror që përjetojmë shihet si jashtëzakonisht e rëndësishme në formimin e kujtesës individuale.

Jeta sociale që ne jetojmë përfshin një shumëllojshmëri të gjerë komunikimi, ndërveprimi dhe informacioni, dhe e gjithë kjo ndodh brenda një rrethi shkëmbimi. “Kujtesa është sociale për shkak të të gjitha kujtimeve që ne ndajmë me të tjerët. Ajo lidhet me unitetin e gjuhës, simboleve, ngjarjeve dhe një konteksti social dhe kulturor” (Misztal, 2003; 11). Me hyrjen në lojë të faktorit historik, të gjitha këto emocione dhe mendime të përbashkëta çojnë në formimin e qëndrimeve dhe sjelljeve kolektive që mund të shfaqen kolektivisht. Në kuptimin më të përgjithshëm, na lejon të kemi një qëndrim, sjellje dhe psikologji të përbashkët. Memoria sociale, përcaktohet si ‘bota’ njohëse e formuar nga të dhënat e ofruara nga emocionet, mendimet dhe vlerat. Natyrisht, kjo botë njohëse nuk formohet gjithmonë nga ajo që ndahet në varësi të procesit normal të zhvillimit të shoqërive. Me ndërhyrjen e sferës politike, ndërhyrjet politike që ndahen, mendohet se ndahen, apo edhe nëse ndahen, sugjerojnë se nuk jemi në të njëjtën botë me të tjerët, çojnë gjithashtu në formësimin e kujtesës sociale.

Maurice Halbbachs ishte studiuesi i parë social që kritikoi përdorimin e konceptit të kujtesës në fushën e psiko-sociologjisë, tërhoqi vëmendjen në dimensionin social të konceptit dhe i mundësoi atij të hyjë në literaturën moderne të sociologjisë. Ndikimi i Bergson dhe Durkheim, të cilët janë emra të rëndësishëm në botën e mendimit të shkencave shoqërore, në formësimin e teorisë së kujtesës sociale është padiskutim intensiv. Në fakt, ky ndikim ndihet gjithmonë si në trajtimin e kujtesës ashtu edhe në konceptet që ai përdor në lidhje me kujtesën.

Paul Ricoeur thekson se, vendimin e guximshëm filozofik për të lidhur kujtesën, i cili konsiderohej një koncept shumë individual në atë kohë, drejtpërdrejt me grupin ose shoqërinë, ia detyrojmë Maurice Halbbachs-it dhe shprehet se ai është guri i themelit në studimet e kujtesës sociale (Ricoeur, 2012; 139). Tema kryesore në të gjitha studimet e Halbbachs është se kujtesa varet tërësisht nga kushtet shoqërore. Ai nuk e konsideron kujtesën nga perspektiva biologjike apo neurologjike. Sipas tij, është e pamundur të kesh një kujtesë që rritet absolutisht vetëm. Ai shkon më tej dhe thekson se një kujtim që mund të konsiderohet në bazë të psikologjisë do të ketë vetëm një kuptim metaforik (Assmann, 2005; 40). Sipas tij, ajo që është individuale nuk është kujtesa apo komponentët e kujtesës, kujtimi dhe harresa, por ajo që është individuale, është perceptimi. Secili nga elementët e tjerë që i nënshtrohen kujtesës formohet brenda një lidhjeje shoqërore. Pas përcaktimit të kujtesës në këtë mënyrë, Halbbachs përpiket të kuptojë marrëdhënien midis grupeve shoqërore dhe kujtesës dhe përpiket të zbulojë se si grupet shoqërore ndërtojnë identitetin përmes kujtesës. Në veçanti, në artikullin "Rindërtimi i së kaluarës" në veprën e tij, *Mbi kujtesën kolektive*, ai shqyrton se si ngjarjet e së

Materialet e punimeve (proceedings)**ISBN: 978-1-78911-007-4**

kaluarës rindërtohen përmes kujtimit ose harresës dhe se si praktikatat e solidaritetit formohen përmes kësaj (Halbëachs, 1992; 46-50).

Pas zbulimit të varësisë së kujtesës nga mjedisi social, Halbëach përqëndrohet në marrëdhënien e saj me kohën dhe hapësirën. Sipas tij, koha dhe hapësira janë dy figurat bazë të kujtimit. Më saktësisht, manifestimi konkret i të kujtuarit shfaqet në konceptet e kohës dhe hapësirës. “Figurat e të kujtuarit duan të mishërohen në një vend të caktuar dhe të përditësohen në një kohë të caktuar, domethënë ato bazohen gjithmonë në një vend dhe kohë konkrete, edhe pse jo në kuptimin gjeografik apo historik” (Assmann 2002; 42). Në këtë mënyrë, çdo akt kujtimi bazohet në një vend dhe kohë konkrete. Hapësira mbulon të gjithë botën materiale në të cilën ndodh ngjarja e kujtuar, ndërsa koha i referohet rishfaqjes periodike të kujtimit. Tema e hapësirës dhe e kohës, të cilën Halbëachs e trajton në veprën e tij është kujtimi kolektiv. Kujtimi kolektiv, bëhet shumë më kuptimplotë kur merret parasysh së bashku me temën e përkatësisë në grup, të cilën ai e trajton në një vepër tjetër. Sipas tij, çdo kujtim formësohet nga përkatësia në një grup të caktuar. Kujtesa sociale ekziston dhe bartet me grupin të cilit personi i përket. Prandaj, ai zbulon aspektin konkret të kujtesës në kohë dhe hapësirë, si dhe përkatësinë në një grup. Secili grup përmban dhe mbarë kujtesën sociale paralelisht me një vend të caktuar dhe duke kryer në mënyrë ritmike disa rituale.

Ndërsa kujtesa sociale e shikon grupin nga brenda dhe synon të pasqyrojë imazhin e së kaluarës në një formë të paharrueshme në të gjitha nivelet dhe refuzon ndryshimet e thella, historia i lë të tilla periudha të pandryshueshme jashtë pamjes, si boshllëqe në mes dhe i numëron ato si fakte historike. Të gjitha këto, tregojnë vetëm elemente që tregojnë ndryshimin si proces ose ngjarje. Nga ana tjetër, ndërsa kujtesa në grup, siç u përmend më parë, thekson dallimin e historisë së saj dhe veçantinë e saj kundrejt të gjitha kujtimeve të tjera grupore, historia nuk i sheh të gjitha këto dallime por sheh faktet se asgjë nuk është e veçantë, e përkundrazi, çdo gjë është e krahasueshme me çdo gjë tjetër; çdo histori mund të lidhet me një tjetër dhe të gjitha janë veçanërisht të njëjta. Ajo e riorganizon hapësirën historike në një strukturë plotësisht homogjene ku është shumë e rëndësishme dhe kuptimplotë” (Assmann, 2005; 46 -47). Ndërsa Assmann thekson në këtë mënyrë kontrastin midis historisë dhe kujtesës, ai thekson se kujtesa nuk ka një dimension universal, sepse kujtesa është specifike për një grup.

Historia e folur përmes çamërishtes dhe memoria kolektive

E folmja e Çamërisë është shumë premtuese për t’u thelluar në argumentime me vlerë që lidhen me identitetin e popullit shqiptar. Gjuha e kësaj krahine (krahinës më jugore shqiptare) servit tipare të fazave të kapërcyera të gjuhës shqipe. Për një gjuhë të vjetër shqipe, ballkanase në të njëjtën kohë, por të dokumentuar shumë vonë, çamërishtja e hershme, përkrah arbërishtes së hershme dhe gjuhës së autorëve më të vjetër shqiptarë, duke mos përjashtuar edhe të folmet më skajore të shqipes, është pjesë mjaft e rëndësishme e trashëgimisë tonë kombëtare.

Sado e dhimbshme dhe e prekshme që mund të tingëllojë, duhet thënë se luftat midis popujve a kombeve (përfshirë edhe ato të trojeve, pakicave etnike dhe territoreve të tyre) kanë ekzistuar dhe vazhdojnë të ekzistojnë ende. Herë ato kanë qenë të hapura e krejtësisht mizore e herë të fshehta, të nëntëshme e krejtësisht manipuluese.

Interferencat e huaja kanë depërtuar deri tek institucionet shqiptare, siç ndodhi me skandalin e shkrimit të tabelave sinjalizuese të rrugëve në gjuhën greke në zonat e skajit jugor të Shqipërisë shtetërore. Sigurisht që kjo ishte një ngjarje e cila tronditi opinionin publik aso kohe dhe u korigjua shpejt, por nuk ka qenë e vetmja e këtij lloji në shërbim të

strategjive të kahershme për aneksimin e autonomisë së Vorio-Epirit nga ana e shtetit grek të cilin ato gjithmonë e kanë pretenduar (Frashëri 2015: 3,4)⁴⁴.

Megjithatë, pavarësisht këtyre të dhënave dhe shumë të tjera si këto, duhet thënë se në të gjitha pretendimet territoriale që shtetet fqinje mund të kenë shfaqur me kohë, gjuha shqipe sidomos toponimia shqiptare përfshirë këtu edhe toponiminë e Shqipërisë etnike, ka qenë gjithmonë një pararojë e fuqishme e mospërbushjes së strategjive të tyre gjeopolitike.

Edhe pse kombet shpeshherë përfshijnë në vetvete edhe territore të huaja ose gjuha me anë të së cilës ato identifikohen nuk është gjuha e origjinës, ky nuk është rasti i shqipes. Gjuha shqipe është provë e qartë e ekzistencës tonë territoriale dhe në mbështetje të këtij fakti, çamërishtja ka peshë të madhe.

Lidhur me qëllimin e këtij punimi, dokumentimin e fakteve historike përmes gjuhës së folur të shqiptarëve të Çamërisë dhe arkivimin e tyre si mjet dokumentimi, është e qartë që kjo nismë do t’u shërbente në radhë të parë të gjitha fushave, por në veçanti e në mënyrë të drejtpërdrejtë prurjet e këtij studimi, do t’u shërbenin shkencave gjuhësore e sociologjike si një kontribut i drejtpërdrejtë veçanërisht, në fushën e historisë së gjuhës shqipe, si dhe në çështje që lidhen me aspekte social-kulturore duke mos përjashtuar dhe ato psiko-sociale etj. Studimi i çamërishtes i shërben gjithashtu edhe historisë së popullit tonë, duke kontribuar veçanërisht në zgjidhjen e problemeve që lidhen me etnogjenezën dhe autoktoninë e shqiptarëve.

Kemi preferuar të ruajmë origjinalitetin e teksteve në çamërisht, pasi gjuha shqipe është e lidhur ngushtë me historinë e kombit shqiptar. Siç u përmend, gjuha shqipe është provë e qartë e ekzistencës tonë territoriale dhe lidhur me një fakt të tillë, edhe Çamërishtja është provë e qartë e ekzistencës territoriale të krahinës më jugore të Shqipërisë etnike dhe jo vetëm, por siç e përmendëm më lart, ajo është pjesë e qenësishme e identitetit tonë kombëtar.

Lidhur me gjuhën dhe rëndësinë e saj në dokumentimin e fakteve, duke e parë atë në kuadër të përgjithshëm të një varieteti krahinor, mund të themi se çamërishtja ka evoluar në tri drejtime të ndryshme në përshtatje me tri kontekstet përkatëse me të cilat ky varietet ka qenë në kontakt.

1. Varianti krahinor i çamërishtes i cili flitet ende sot në mënyrë të fshehtë në krahinën e Çamërisë në Greqi.

Situata e gjuhës shqipe tek shqiptarët e Çamërisë në Greqi mund të përkufizohet si një situatë e gjuhëve në kontakt. Shqiptarëve ortodoksë të Çamërisë, u është mohuar e drejta për të folur gjuhën shqipe të krahinës së Çamërisë. Hulumtimet në terrenin shqiptar në Çamëri kanë qenë të pamundura për shkak të pengesave që shteti grek vendos në lidhje me këtë krahinë. Nuk duhet neglizhuar edhe gjuha shqipe e folur prej arvanistave e cila daton në shekujt XIV, XV, mbase dhe XVI. Tiparet e kësaj gjuhe janë mjaft të ngjashme me çamërishten. Njihen rreth 900 katunde arbëreshe në Athinë (Bellusci 2004)⁴⁵. Ato ruajnë ende gjuhën, kulturën dhe traditat shqiptare, porse gjithësesi kjo është një temë tjetër.

2. Varianti tjetër i këtij varieteti krahinor është edhe çamërishtja e folur prej shqiptarëve të Çamërisë në Turqi. Gjuha shqipe e krahinës së Çamërisë flitet sot ende nga shqiptarët e Çamërisë të shpërngulur në Turqi pas marrëveshjes së Lozanës,

⁴⁴ Frashëri Kristo, *Historia e Çamërisë, “Vështrim historik”*, UETPRESS, f.3,4, Tiranë 2015

⁴⁵ Bellusci, A. *Gli arbërori- arvaniti, un popolo invisibile* (Ricerche etnografiche nell’ Elade,- 1965- 2000), Cosenza 2004.

të cilët për shkak të besimit të tyre mysliman, iu nënshtruan shkëmbimit turko-grek, duke “u shkëmbyer” si turq dhe jo si shqiptar (të detyruar nga dhuna e përditshme psikologjike që ushtronte politika greke). Evoluimi i të folmes së kësaj krahine në Turqi, ka ndjekur pak a shumë të njëjtën rrugë sikurse të gjitha të folmet në emigracion, pavarësisht disa ndryshimeve në mënyrën e integritit gjuhësor e atij shoqëror. Megjithatë të gjitha intervistat i karakterizon i njëjti motiv: ai i mallit për vendlindjen dhe krenaria për origjinën shqiptare të Çamërisë (Troplini 2018)⁴⁶

3. Varianti i tretë është ai i çamërishtes në Shqipërinë shtetërore. Shqipja e Çamërisë flitet ende sot prej kësaj pjese të pafatë në territorin shtetëror shqiptar edhe pse kjo e folme ka qenë në kontakt të vazhdueshëm me një shqipe më të evoluar. Popullsia e shqiptarëve myslimanë të Çamërisë iu nënshtrua gjenocidit të egër grek pas 1944-ës. Nga shpërngulja e dhunshme humbën jetën qindra e mijëra shqiptarë. Shqiptarët e Çamërisë të dëbuar me dhunë nga trojet e tyre drejt territorit shtetëror shqiptar, vuajnë edhe sot e kësaj dite amanetin e prindërve dhe gjyshërve të tyre për t’u kthyer një ditë të qetë në vendlindje, në vatrën e tyre dikur të lara me gjak. (Troplini 2012, 2015)⁴⁷

Në Shqipërinë shtetërore ato u mirëpritën nga bashkëkombasit vendas, por varfëria ekstreme shqiptare i përfshiu ato. Edhe pse në vendin e vet, shqiptarët e Çamërisë kanë paguar haraçet e një diaspore të shprishur anekënd Shqipërisë, të shpërndarë si “jabanxhinj të paqenë”, duke vuajtur mbi supë diskriminimin dhe paragjykimet e mbjella nga pushteti diktatorial i kohës.

Varianti i çamërishtes në Shqipëri fillimisht kishte një diferencë të madhe me shqipen e evoluar. Çamërishtja vijoi të ruajë format konservuese të shqipes së arbëreshëve dhe të gjuhës së dokumentit të parë të shqipes së shkruar të Mesharit të Gjon Buzukut (Troplini 2009)⁴⁸. Megjithatë bashkë me integrimin shoqëror nën diktaturën komuniste, filloi të shkrihej edhe çamërishtja e hershme. Thelbi i intervistave mbetet po i njëjtë: dhimbja e madhe e shkaktuar nga gjenocidi, vuajtjet fizike e psikologjike, ëndrra për të parë vendlindjen e tyre, apo ëndrra e trashëguar tek brezat pasardhës për të parë vendin e origjinës, krenaria e të qenit shqiptar nga Çamëria.. etj. Të gjitha këto, dëgjohen e lexohen pothuajse tek çdo intervistë të cilat ndër të tjera janë ligjëruar përmes variantit të bukur të çamërishtes.

Më poshtë po servirim disa pjesë të intervistave të bëra midis harqeve kohore të ndryshme.

Intervista 1

Abdul Sulejmani 93 vjeç, Durrës 2024.⁴⁹

Intervistuesi: Sa vjeç jeni?

⁴⁶ Abdurahmani, Troplini, E. *Linguistic change in the Albanian language of Izmir’s Cham*, (4th Eurasian Conference on Language and Social Sciences, Riga- Latvia, July 24 - 27, 2018), selected for collection of scientific articles “*Language. Language in Various Cultural Contexts*” (*Valoda -2018, Valoda dažādu kulturu konteksta*) indexed in “EBSCO Publishing”, ISSN 1691-6042, ISBN 978-9984-14-861-8.

⁴⁷ Troplini, E. *E folmja e Çamërisë dje dhe sot. Shqyrtime dialektologjike, etnolingustike dhe sociolingustike rreth gjuhës shqipe të shkruar dhe të folur prej çamëve*, (temë disertacioni) Tiranë 2012; Abdurahmani, Troplini, E. *Çamërishtja, aty ku skajet atakohen*, (Monografi shkencore) 2M printing, Durrës 2015

⁴⁸ Troplini, E. *Bashkëpërkime të elementeve gjuhësore të veprave më të hershme shqipe, me çamërishten e sotme*, AKTET, Revistë shkencore e Institutit Alb Shkenca, Nr.4, 2009, f. 547-553 ISSN 2073-2244

⁴⁹ Kjo është një intervistë e bërë enkas për studimin në fjalë. Ajo nuk është shfrytëzuar ndonjëherë.

Materialet e punimeve (proceedings)

ISBN: 978-1-78911-007-4

- *Un jam, datëlindja një mars njëmijë nëntqind tridhjet e një (1931), po në dokumenta kam dy shkurt tridhjet e tre (33). Kjo nuk është e saktë sepse kur e kemi regjistruar në dizet e pesën (45-ën), ishte gjyshja në shtëpi. Ajo ia futi kot, biles babën time e buri 6 vjeç më të madh, kështu që mbush 93 vjeç me 1 mars. (Intervistuesi: edhe më shumë se 100!) Faleminderit, po rrojta shumë më duket.. (qesh)*

Intervistuesi: Do të na tregosh ndonjë gjë për vendin ku ke lindur? Sa vjeç erdhe këndeje ti xha Abdul?

- *Kam lindur në Varfanj, grekët i thonë Parapotamo' se e kanë ndërruar që në njëmijë nëntqind tetdhjetë e gjashtën (1986)-ën. Kam ardh n' Shqipëri rreth tremjet 13 vjeç. Po Varfanji është 10-12 kilometra afër Igumenicës. Igumenicë i thonë grekët se ne i thoshim Gumenicë.*
- *Erdhëm në fillim, u vendosëm n' Konispol, një di muaj. Pastaj erdhëm në Delvinë një di-tri ditë, në Gjirokastër, pastaj në Fier. Në Fier ndënjëm dy muaj. Atje na gjeti çlirimi i Shqipërisë 28 nëntori. Me 5 janar nisemi nga Fieri në Durrës, se kutu në Durrës babai im kishte një kushëri ardhur që në kohën e Italisë. Gjetëm një shpi me qera atje. Në Durrës, më 6 janar 1945.....*

Ndërpret intervistuesi: në Durrës ku? Në plazh?)

- *Jo, vemë në qitet, ndënjëm ca kohë me qera, pastaj shkuam në plazh. Kështu që 6 janar e kam ditë historike se familja ime është vendosur në Durrës. Familja ime dhe familja e Hajredin Kasos, Luan Kasos (sqaron), që ish sot në plazh me gjith të vëllanë. Jemi dy familjet e para çame që u vendosëm në Durrës. U çdo 6 janar e festoj se populli i Durrësit na ka pritur me derë hapur. E xhumaje babai im shkoi në xhami. Ata e muarn vesh që ishm ne çamër (e ka fjalën për besimtarë, pasi po të të thoje që ishe çam, ishe edhe besimtarë myslimanë) . Që at ditë shtëpia jonë u mbush me dihma, vishin durrsakët me duar plot: kush na sillte ushqime, kush veshmbathje... Babai im pastaj filloi tregtinë. Jemi mirënjohës sa të na rrahi zemra për qytetarët e Durrësit, jo në Durrës, por kudo u pritën çamët.*

Intervistuesi: Ka qenë e vështirë ardhja këtu ?...

- *Të vështirë e kemi pas. Pastaj babai filloi tregtinë...Shkonte në Tiranë, mirrte sende, me një karroc në Durrës atje ku isht Pallati i Kulturës sot*

Intervistuesi: Po atje në Çamëri, si ishte fshati Varfanj?

- *Varfanj fshati im kishte 163 shtëpi, shumica ishën të mesëm. Një 6-7 familje ishën të pasura; kishin dele, ulli më shumë, bagëti më shumë... Një njëzet familje ishin pa pasuri por nuk ishin të varfra, nuk ishin, se ishin punëtorë. Përshembull babai im..., ne kishim dy shtëpi se ishim dy vllazër; një shtëpi një kaçë, një shtëpi dy katshe. Babai, në dimër mirrej me lutërvë, me punishte vaji, mirrte hak. Në verë bënte lëmënj me grurë, mirrte hakun. Kishim rreth dyzet rrënjë ulli. Kur mbaronte kjo punë, babai mirrej me tregti, kështu që i kishim të gjitha në çamëri....etj.*

(Abdul Sulejmani 93 vjeç, 2024)

Përshtatur në gjuhën standarde...

Intervistuesi: Sa vjeç jeni?

- *Datëlindja ime është më 1 mars 1931, por në dokumenta e kam dy shkurt 1933. Kjo e fundit nuk është e saktë sepse kur e kemi regjistruar më 1945 ka qenë gjyshja në shtëpi. Ajo e ka dhënë gabim datëlindjen, madje edhe babain tim e kishte regjistruar 6 vjet më të madh. Kështu unë mbush me 1 mars 93 vjeç*

Intervistuesi: edhe më shumë se 100!

- *Faleminderit, por, po rroj shumë më duket.. (qesh)*

Intervistuesi: Do të na tregosh ndonjë gjë për vendin ku ke lindur? Sa vjeç erdhe këndeje ti xha Abdul?

- *Kam lindur në Varfanj, (sqaron) grekët i thonë Parapotamo'.ato e kanë ndërruar emërtimin që më njëmijë e nëntqind e tetëdhjetë e gjashtën (1986)-ën. Kam ardhur në Shqipëri rreth trembëdhjetë (13) vjeç. Varfanji është 10-12 kilometra afër Igumenicës. Igumenicë i thonë grekët se ne i thonim Gumenicë. Kur erdhëm në fillim, u vendosëm në Konispol, për dy muaj. Pastaj erdhëm në Delvinë ku ndënjëm dy-tri ditë, më pas në Gjirokastër e pastaj në Fier. Në Fier ndënjëm dy muaj. Aty na gjeti çlirimi i Shqipërisë, 28 nëntori. Me 5 janar u nisëm nga Fieri për në Durrës, pasi këtu në Durrës babai im kishte një kushëri që kishte ardhur që në kohën e Italisë. Gjetëm një shtëpi me qera aty. Në Durrës, më 6 janar 1945.....*

Ndërpret intervistuesi: Në Durrës, Ku? Në plazh?)

- *Jo, shkuam në qytet, ndënjëm pak kohë me qera, pastaj shkuam në plazh. Kështu që 6 janarin e kam ditë historike pasi familja ime është vendosur në Durrës. Familja ime dhe familja e Hajredin Kasos e Luan Kasos (sqaron), e cila është sot në plazh (sqaron) hajredini me të vëllain . kemiqenë dy familjet e para çame që u vendosëm në Durrës. Unë çdo 6 janar e festoj sepse populli i Durrësit na ka pritur me derë hapur. Ditën e premte (të xhumanë) babai im shkante në xhami. Durrësakët e morën vesh që ishim çamë (e ka fjalën për besimtarë, pasi po të të thoje që ishe çam, ishe edhe besimtarë myslimanë). Që atë ditë shtëpia jonë u mbush me ndihma. Durrsakët vinin me duar plot: kush na sillte ushqime, kush veshmbathje.... Babai im pastaj filloi tregtinë. I jemi mirënjohës me gjithë zemër qytetarëve të Durrësit, jo vetëm në Durrës, por çamët u pritën kudo.*

Intervistuesi: Ka qenë e vështirë ardhja këtu ?...

- *Të vështirë e kemi patur. Pastaj, babai filloi tregtinë. Shkonte në Tiranë, mirrte sende, me një karrocë dhe i shiste në Durrës, aty ku është Pallati i Kulturës sot...*

Intervistuesi: Po atje në Çamëri, si ishte fshati Varfanj, ma përshkruan dot?

- *Varfanji, fshati im, kishte 163 shtëpi, shumica ishin shtresë e mesme. Nja 6-7 familje ishin të pasura, (që do të thotë se) kishin dele, kishin më shumë ullinj, më shumë bagëti, Nja njëzet familje ishin pa pasuri, por nuk ishin të familje të varfëra, (përsërit) nuk ishin, sepse ishin punëtorë. Përshembull babai im... , ne kishim dy shtëpi se ishim dy vllazër (i ati me të vëllanë); një shtëpi një katëshe, një shtëpi dy katëshe. Babai, në dimër merrej me punishten e vajit (lutërvinë), dhe nga ajo merrte fitimin (e punës së secilit që sillte ullinjtë për të bërë vaj). Në verë bënte kotoleta (lëmënj) me grurë, dhe nga kjo merrte sërish fitimin e punës . Kishim rreth dyzet rrënjë ullinj. Kur mbaronin këto punë, babai mirrej me tregti, kështu që, i kishim të gjitha në çamëri....etj.*

Analizë

Kjo është një intervistë e cila në radhë të parë flet për shpërnguljen e shqiptarëve të Çamërisë nga trojet e veta dhe vështirësinë e përshtatjes së tyre po në tokën amë. Lëvizja qytet më qytet tregon karvanin e gjatë të peripecive të familjeve çame të dëbuara me dhunë. Përpos të tjerave, këtu spikat qartë fenomeni social i mikpritjes nga shqiptarët e Shqipërisë shtetërore, tradita e mikpritjes shqiptare e jo vetëm, por edhe respekti ndaj besimit mysliman

dhe rëndësia e një domeni kaq të rëndësishëm në jetën sociale të shqiptarëve në atë kohë. Intervista mishëron karakterin e fortë të shqiptarëve të çamërisë, forcën, zgjuarsinë dhe aftësinë e tyre për t’u përshtatur.

Intervista 2.

Namëk Bayru 76 vjeç, Izmir (Turqi) 2017⁵⁰

Intervistuesi: Si e keni emrin? Si quheni?

- *Namëq/ Namëk/në Shqipëri Namëk më thonë / Namëk//*

Intervistuesi: Si quhej babai yt në Çamëri ?

- *Hasan Hysejn Busht i thonë babait // Hasan isht gjyshi im (g&gj, y&u) / gjyshi // ç i thoonë ?/ Kujt je ti?/ù jam djali i Hasan Hysejn Bushit/ ga (g&k) Bushanjtë/ se janë me ëmër ata në Karbunar // Mal Bushin-ë / s’ka njeri pa e njohurë// Ata në Sarandë të gjithë më pjesin mua/ ç e ke Mal Bushinë?// Babai im me Mal Bushinë ish djali Minxhosh (xh &nj) / xhixho (e përkthen vetë)/ ja ashtu/ ja ashtu...(qesh)*

Intervistuesi: Çfarë moshe keni? Sa vjeç jeni?

- *ù kam shtadhjet e gjashtë*

Intervistuesi: Këtu keni lindur?

- *Kam lindur kutu*

Intervistuesi: Si quhet ky vendi ku jetoni?

- *Karshiaka//Izmir/ Karshiaka/ Serinkui/ kutu/ Serinkui*

Intervistuesi: Çfarë mbiemri keni patur në Çamëri?

- *Bushi/ Bushataj/*

Intervistuesi: Keni të afërm (kushërinj) në Shqipëri?

- *Në Sarandë/ ka ant e babait// edhe ka ant e nanësë/ i kam.../ në Vlorë kam/në Elbasan kam/ keshi tri teze/ në Elbasan// àta... àtje vete dhe viij tani / ne gonërt e atijt/ ëëë ... Osman Zeqiri, Sejko Zeqiri/edhe në Elbasan.../ Gëzim Zeneli ishtë/ e kam djaln e ...gon e tetos .../ ashtu//*

Intervistuesi: Ka shumë çam këtu në Izmir?

- *Ka, ka çam shumë/ andaj e kemi hapur këtë (e ka fjalën për shoqatën Çamëria)/ ku...jaso këta.../ I mora përpara/kemi hapur kështu një lokal e shoqatë bahçe (bashkë)// kemi edhe një musus tani / hem turk/ hem shqiptar (qesh) / Shefqet Balla/ e ke ndier Shefqet Ballën? ai është musus tani / vijnë të bëjnë / të mësojnë shqip/ mësohën shqip// edhe ù e harrova shqipen tani/ se ata llafofen modern/ù di çamçe....(qesh)//*

Intervistuesi: Si quhej fshati ku kanë jetuar prindërit?

- *Karbunar*

Intervistuesi: A keni qenë ndonjëherë në Çamëri ju?

- *Dua të vete/ ama s’kam vatur akoma.....// keshi shum merak të vete në Karbunar/ të shoh uëndet e babait/ shpiat e babait..../ se kan garë akoma....// kur vajata në Sarandë/ ata kishin vatur/ kanë parë / shpitë ashtu rrinë / as ullinj të nuku gasinë kaurrtë tani/ ullinj të bienë / s’venë të bledhin njerztë/ trëmen ka Mal Bushi Akoma (qesh)*

⁵⁰ Kjo intervistë është bërë në Karshiaka të Izmirit në Turqi. Ajo është shfrytëzuar pjesërisht për punimin me titull: Abdurahmani, Troplini, E. *Linguistic change in the Albanian language of Izmir’s Cham*, (4th Eurasian Conference on Language and Social Sciences, Riga- Latvia, July 24 - 27, 2018.

Materialet e punimeve (proceedings)

ISBN: 978-1-78911-007-4

Intervistuesi: A mund t’i merrni pronat tuaja në Çamëri?

- *Jo, jo, jo/ s’ marrëmë (ë&i)/ se Ataturku çu bëri?/ në Andallai/ në njist e tre/ Ataturku çu bëri?/ venezollësë i kërkoi kaurrtë/ Ataturku i mori muslimantë// (flet për shkembimin e Lozanës)/// e pëstaj këtu na dhanë vënd*

Intervistuesi: Po gjyshërit tuaj, atje kanë jetuar... në Karbunar?

- *Atje/ gjyshja, gjyshja e gjyshit (g&gj; y&u)// vetëm babai më molloisi si prallëzë njëherë/ çu kanë shkruarë (çu u kan vriturë... vrarë (e korrigjon vetë fjalën) etj...*

(Namëk Bayru 76 vjeç, 2017)

Përshtatur në gjuhën standarde

Intervistuesi: Si e keni emrin? Si quheni?

Namëk Bayru: *Namëq, Namëk* (korrigjon sipas shqiptimit tonë) *shqip më thonë Namëk.*

Intervistuesi: Si quhej babai yt në Çamëri ?

Namëk Bayru: *Hasan Hysejn Busht quhet babai // Hasani është gjyshi im (g&gj, y&u). Pra, kur më pyesin mua, i kujt je? - Unë përgjigjem: Unë jam djali i Hasan Hysejn Bushit nga Bushanjtë, pasi ato kanë qenë me emër në Karbunarë. Nuk ka njeri që nuk e njeh Mal Bushin Ata në Sarandë të gjithë më pyesnin mua/ çfarë e ke Mal Bushin? Babai im me Mal Bushin ishin djem xhaxhallarësh.*

Intervistuesi: Çfarë moshe keni? Sa vjeç jeni?

Namëk Bayru: *Unë jam shtatëdhjetë e gjashtë.*

Intervistuesi: Keni lindur këtu?

Namëk Bayru: këtu *kam lindur*

Intervistuesi: Si quhet ky vendi ku jetoni?

Namëk Bayru: *Karshiaka, Izmir. Karshiaka, këtu quhet Serinkui.*

Intervistuesi: Çfarë mbiemri keni patur në Çamëri?

Namëk Bayru: *Bushi/ Bushataj/*

Intervistuesi: Keni të afërm (kushërinj) në Shqipëri?

Namëk Bayru: *Kam në Sarandë nga ana e babait, edhe nga ana e nënës kam. Kam në në Vlorë, kam në Elbasan. Në Elbasan kisha tri teze. Atje shkoj dhe vij tani...; tek kushërinjtë e Osman Zeqirit, Sejko Zeqirit. Në Elbasan është edhe Gëzim Zeneli....E kam kushërinin e tezes.*

Intervistuesi: Ka shumë çam këtu në Izmir?

Namëk Bayru: *Ka, ka shumë çamë. Prandaj hapëm edhe shoqatën Çamëria. I mora përpara (I urdhërova) dhe kemi hapur një lokal dhe shoqatë bashkë (ato herëpashere organizoheshin në aktivitete në formë eskursionesh duke u mbledhur të gjithë bashkë e duke festuar festa të ndryshme në lokale. Kemi edhe një mësues tani edhe turk edhe shqiptar (bën shaka dhe qesh). Shfaqet Balla. Ke dëgjuar për të? Ai është mësues i shoqatës tani, ku shqiptarët vijnë që të mësojnë gjuhën shqipe. Më duket se dhe unë e kam harruar shqipen sepse ato komunikojnë shqipen moderne, ndërsa unë di çamërisht (qesh)*

Intervistuesi: si quhej fshati ku kanë jetuar prindërit?

Namëk Bayru: *Karbunar*

Intervistuesi: A keni qenë ndonjëherë në Çamëri ju?

Namëk Bayru: *Dua të shkoj, por nuk kam vajtur akoma. Kam shumë merak të shkoj në karbunar, të shoh vendet e babait. Shtëpitë e babait nuk i kanë prekur akoma.... Kur vajta në Sarandë, mora vesh që ata kishin shkruar dhe kishin parë që shpitë rrinin ashtu. As ullinjtë*

Materialet e punimeve (proceedings)

ISBN: 978-1-78911-007-4

nuk i ngacmonin vendasit; ullahtë bienin e nuk shkonin t'i mblidhnin. S'shkonin t'i mblidhnin njerëzit se tremben nga Mal Bushi akoma (qesh)

Intervistuesi: A mund t'i merrni pronat tuaja në Çamëri?

Namëk Bayru: *Jo, jo, jo/ si marrim dot sepse çfarë bëri Atatürk. Në 1923 shkëmbeu grekët ortodoksë me shqiptarët myslimanë çamë (flet për shkëmbimin e Lozanës). Pastaj këtu (në Izmir) na dhanë vend*

Intervistuesi: Po gjyshërit tuaj, atje kanë jetuar... në Karbunar?

Namëk Bayru: *Atje, gjyshja.... Gjyshi. Një herë ma tregoi si përrallë babai si janë larguar (shqiptarët e çamërisë), si ka ndodhur spastrimi, si janë vrarë etj.*

Analizë

Intervista është bërë në Izmir të Turqisë, kryesisht në Karshiaka, në vitin 2017. Namëk Bayru është i biri i Hysen Bushit. Ky i fundit ka lindur në fshatin Karbunar të çamërisë, ndërsa Namëk Bayru ka lindur në Izmir të Turqisë. Namëk Bayru sot ka ndërruar jetë.

Intervista serviret për të kujtuar që shpërngulja e shqiptarëve të çamërisë ka nisur fillimisht më 1923 me Marrëveshjen e Lozanës, sipas së cilës, u bë shkëmbimi turko-grek. Shqiptarët e çamërisë për shkak të besimit të tyre mysliman, u shkëmbyen si turq dhe jo si shqiptar, të detyruar kësajsoj të largohen në masë në Turqi. Duhet theksuar që në intervistat e tyre është pohuar që ato kanë qenë të detyruar të largohen nga gjendja jo e qëndrueshme e shqiptarëve të çamërisë në trojet e veta; nga dhuna e përditshme psikologjike që ushtronte politika greke.

E njëjta brengë lexohet edhe tek shqiptarët e çamërisë së Izmirit; pamundësia për ta parë edhe një herë çamërinë, vendin e të parëve të tyre. Siç shihet edhe nga intervista, Turqia ka ende shqiptarë të Çamërisë që flasin çamërisht edhe pse (siç është konstatuar edhe në punime të tjera) çamërishtja tek shqiptarët e Çamërisë së Izmirit po kalon në bjerrje. Ky është një fenomen i njohur tashmë i gjuhës në emigracion, jetëgjatësia e së cilës mund të zgjasë me përafërsi deri në katër breza.

Intervista 3.

Naile Habibi, 80 vjeç, Plazh- Durrës 2000⁵¹

*Joo mir u kish sellë/ me greg u kish sellë mirë//
edhe kur u trazua axhere Shqipëria me Itali e me këto/ ish gregu atje/ i mblodhi eksori /
i ngriti të gjithë/ ka shtatëmbëdhjetë e rëpjetë i mblodhi eksori i shkuli të gjithë//
kufi/ kufi me Turqi e këto/ saa kur ishën atje këndojën edhe zojt e turkut/ i ndijën këta
atje ku i kish shpënë gregu// pësaj i mirr i kap gregu axhere// bëri kërdinë axhere gregu / bëri
kërdinë/ u sillte mirë më përpara/ si vëllezër/ ata si nevet/ vëllezër gjithë/ edhe vineshin kur
na holënë/ kur i muarrnë vëllezër baballarë / çish kishnë / eksori i thojm ne kushtu// vineshin
kaurr e fshatit / vineshin katër- pesë kaurrë që rrinë në fshatin tonë/ që ruajnë që mos bënë
kërdinë/ pa me kristianë / s'kish gjë me kristianë / ai e kish me ne//*

⁵¹ Intervista është bërë në lagjen nr. 13 Plazh- Durrës, e ashtuquajtur nga banorët e saj (çamë), Lagjja “Bregu i Kanalit”. Intervista është shfrytëzuar për punimin e doktoraturës: Troplini, E. *E folmja e Çamërisë dje dhe sot. Shqyrtime dialektologjike, etnolingustike dhe sociolingustike rreth gjuhës shqipe të shkruar dhe të folur prej çamëve*, Tiranë 2012.

Materialet e punimeve (proceedings)

ISBN: 978-1-78911-007-4

*gregu vargan/ armë/ kuel/ Allah/ galorë të tërë të tërë/ mbushur xhadetë/ vendet//
açere u e tremb nevet/ kur shikuam rrugës / se e keshëm shtëpinë përrmbi rrugë neve/ rrugën
e keshëm poshtë// ka të katrat anë që të veje / greg që shkuan rrugës jo që vinin / rrumulë / ja
tan-ja si n'kët kehe e ba mënd// etj.*

Naile Habibi (80 vjeçe),

2000

Përshtatur në gjuhën standarde

Jooo... mirë u sillnin; grekët (njerëzit e thjeshtë) u sillnin mirë (përgjigje e pyetjes, “si u sillnin me ju grekët para dhe gjatë periudhës së spastrimit etnik?”)

(pastaj vijon me rrefimin seçfarë kishte ndodhur realisht në Çamëri)

Kur Shqipëria u trazua me Italinë (këtu e ka fjalën për vitet 1923), ishte greku atje (forcat greke), i mblodhi eksori, i ngriti të gjithë nga shtatëmbëdhjetë e lart, i mblodhi eksori, i shkuli të gjithë....

Në kufi, në kufi me Turqinë... ishin aq afër, sa që kur ishin atje, dëgjoheshin edhe zogjt e turkut kur këndonin. I dëgjonin ato atje ku i kishte vendosur greku.

Pastaj (e ka fjalën për 1944-ën, në kohën e gjenocidit) i mori greku (zervistët) atëhere, bëri kerdinë greku atëhereSilleshin mirë (kalonin mirë) më përpara, si vëllezër..., si ata, si neve... ishim si vëllezër të gjithë.... më pas erdhën dhe na hoqën (nga shtëpitë), i morën vëllezër, baballarë... çfarë kishin, i morën eksori i thonim ne... vinin kaurrët (ortodoksët) e fshatit, vinin katër- pesë kaurrë (ortodoks) që rrinin në fshatin tonë që të ruanin që të mos bënin kerdinë ... se me kristianët (e ka fjalën për ortodoksët) s'kishte gjë greku me kristianët, ai e kishte me ne (e ka fjalën për myslimanët)

Grekët shkonin vargan me armë, kuaj, -Allah! Galorë të tërë ishin mbushur xhadetë, vendet... atëhere u trembëm ne, kur pamë rrugës (sqaron) sepse e kishim shtëpinë sipër rrugës, rrugën e kishim poshtë... nga të katër anët, shihje grek shkonin rrugës, rremujë..., ja, tani si në këtë kohë e mbaj mend....

Analizë

Intervista i është marrë folëses Naile Habibi rreth viteve 1999- 2000. Folësja Naile Habibi (në atë kohë 80 vjeçe), kishte lindur në Çamëri. Sot ajo nuk jeton më. Nuk i është kushtuar shumë vëmendje koherencës së mendimeve, pasi objektivi ka qenë çamërishtja dhe dukuritë e saj. Lidhur me këtë të fundit, folësja nuk ka qenë në dijeni me qëllim që ajo të fliste lirshëm. Intervista duket që është emocionale.

Gjithësesi përmes rrjedhës emocionale të mendime të një të moshuare, jo aq në koherencë në shprehjen e tyre, përveç vjeljes së dukurive të pastra të çamërishtes ne njihemi me disa fenomene historike e sociale njëkohësisht si:

- Shkëmbimi turko-grek sipas Marrëveshjes së Lozanës;
- Spastrimi etnik i 1944-ës i popullsisë shqiptare myslimane të Çamërisë;
- Spikat, harmonia midis dy kombësive, asaj greke dhe shqiptare;
- Del shumë qartë në pah edhe harmonia fetare midis myslimanëve dhe ortodoksëve
- Mbi të gjitha, aty lexohet fare qartë akti makabër i gjenocidit grek i 1944-ës.

Intervista 4.

Materialet e punimeve (proceedings)

ISBN: 978-1-78911-007-4

Bahrije Habibi 68 vjeç, Plazh- Durrës 2000.⁵²

Neve rrugës kur u nisëm sehften e pa:rë/ erdhëm në Grikohuar/ ja thonë njëit fshat atje// dënjam atje sa dënjam/ nuk na pranuan ata// çam ishin ka neve// edhe na lane ne katua/ i thomi katua bu:drunit neve// na lanë atje ato//
erdhëm me kuel rrugës/ ngarkuar me plackë/ me ushqim që hajëm rrugës// erdhëm në Sajavë// në Sajavë ndënjëm thujaj njëzet dit në bina t'ullinjve// (kollitet) se m'ka zën e kolla// atje bëmë çadre me velënxa i thomi ne/ ju i thoni batanije/ po ne i thoshim velënxa leshi// me velenxa në bina të ullirit/ ndënjëm njëzet dit atje// atje erdhi gjermani/ i prishi urat gjermani/ i prishi urat// ne kalojmë me lundra// erdhi gjermani i prishi urat// edhe na shtiheshim me lundra me drrasa/ na shtihijnë në lum// lumi .. / dallga të na mi:rr ku të na përplaste// na shtihijnë me litarë/ me turkuza i thoshim neve// lidhur drrasa:të/ e na shtijnë pes e pese/ pes e pese qe na nxi:rr ka lumi// na xuarrnë matanë// Gjermani vinej me .. / çu
thonë/ me tankse mrapa/ na vinej mrapa me tankse// erdhëm në Ninat/ ja thonë një fshati Ninat// atje ishin kacolle/ të Çamerise posi// erdhëm në Konispol// u ulëm në një fushë të Konispolit atje// vineshin ushtart e vrarë/ që i vriste Gjermani me tope// e prishi Sajadhën/ fshat i Greqisë// i binte me tope/ i prishi shpitë/ por ama ... frika jone// kur dualm në rrugë të Konispoli/ vineshin
ushtartë e vrarë// vër llamarinën/ teneqë/ vënë mbi kalë edhe shtrire ushtrinë të vrarë/ edhe i shpij gjith e kush në vënd të tij për të varrosur..... etj.

(Bahrije Habibi 68 vjeç, 2000)

Përshtatur në gjuhën standarde...

Neve kur nisëm rrugën herën e parë, erdhëm (arritëm) në Grikohor, (Grikohor) i thonë një fshati atje. Ndenjam atje sa ndenjëm e ato nuk na pranuan. Ishin çam si ne dhe na lanë në bodrum. I themi katua bodrumit ne..., aty na lanë ato.

Erdhëm me kuaj rrugës, të ngarkuar me plaçka e me ushqim që hanim rrugës. Më pas erdhëm (arritëm) në Sajavë. Në Sajavë ndenjëm thujajse njëzet ditë nën ullinj (në fund të ullunjve). (kollitet) Se më ka zënë dhe kolla... . Atje bëmë çadra me velenxa (batanije); ju i thoni batanije ndërsa ne i thonim velenxa leshi. Ndenjam njëzet ditë me batanije në fundet e ullinjve. Atje erdhi gjermani. Gjermani i prishi urat; i prishi urat e ne kalonim me lundra. (përsërit) Erdhi gjermani, i prishi urat dhe neve na shtynin me lundra me dërrasa. (tregon mënyrën sesi kaluan lumin) Na shtynin në lum. Lumi (ishte i thellë) me dallgë të mëdha të rrezikshme që mund të na përplasnin. Na shtynin me litarë, (sqaron) me turkuza i thonim neve...(tërkuzat) që lidhnin dërrasat e na shtynin pesë e nga pesë që të na nxirrnin nga lumi. Na nxorrën matanë. Gjermani na vinte mbrapa me ... ç'u thonë atyre... me tanksa.

Erdhëm (arritëm) në Ninat. Ninat, i thonë një fshati. Atje kishte kasolle të Çamërisë, - posi!

Erdhëm në Konispol. U ulëm në një fushë të Konispolit. Atje vinin ushtarët e vrarë; i vriste gjermani me topa... e prishi Sajadhën (fshat i Greqisë), i binte me topa. I prishi shtëpitë... ama frika jonë kur dolëm te rruga e Konispolit?

⁵² Intervista është bërë në lagjen nr. 13 Plazh- Durrës, e ashtuquajtur nga banorët e saj (çamë), Lagjja “Bregu i Kanalit”. Intervista është shfrytëzuar për punimin e doktoraturës: Troplini, E. *E folmja e Çamërisë dje dhe sot. Shqyrtime dialektologjike, etnolingustike dhe sociolingustike rreth gjuhës shqipe të shkruar dhe të folur prej çamëve*, Tiranë 2012.

Materialet e punimeve (proceedings)

ISBN: 978-1-78911-007-4

Vinin ushtarët e vrarë... . Kishin vënë një llamarinë (sqaron) teneqe mbi kuaj, mbi të cilën kishin shtrirë ushtarët e vrarë aty dhe i çonin për t'i varrosur

Analizë

Intervista është marrë rreth viteve 1999- 2000 nga folësja Bahrije Habibi (në atë kohë 68 vjeçe), e lindur në Çamëri. Sot nuk jeton më. Si në çdo intervistë të njerëzve të thjeshtë, të paarsimuar, spikat emotiviteti.

Në këtë intervistë spikasin vështirësitë që shqiptarët e çamërisë kanë hasur gjatë spastrimit etnik të 1944-ës. Në këtë intervistë bien në sy disa toponime (emra vendesh) si: Grikohori, Sajava, Konispoli, Ninat-i. Mjaft interesant duket çasti kur e intervistuarra pohon ngjashmërinë midis kasolleve të Ninatit dhe atyre të çamërisë.

Intervista 3.

Intervista 5.

Feim Hyseni 72 vjeç, Plazh-Durrës 2000.⁵³

Në Tetor të dizetësë/ filloi lufta itallo-greke// në Tetor ù kam qënë nxënës shkollë// erdhën tre aeroplane/ ditn' e parë që e mësuajtëm neve/ e këptuam neve që u hap lufta// ern tër aeroplant e shkuajtën mbi fshatin tonë/// ishim në shpi/ që msojëm neve/ se shkoll s 'kishim/ e dualm përjashta/ se athere s'kishim parë aroplan para lufte// para se t'hapej lufta s'kishim parë aroplan// e duallm përjashta/ na thotë ai mësusi/ ishte grek/// u trondit shtëpia/ u tronditën gjith toka ka zhurmat e aroplanvet/// na thotë ai mususi/ na foli grekçe/ nesër nuku kemi shkollë/ ikni m'shpiat tuaja// ikëm neve/ edhe ai iku që at dit a .. // iku dhe ai mususi// edhe kshu u hap lufta/ filloi lufta// filloi qeëerrria greke pëstaj/ filloi t'i arrestonte çamrit/ muslimant/ neve muslimanvet/// filloi mblodhi njhere dorn'e pare// iku mas nja dy jav a njëze dit a sa shkoi// filloi dor'e dytë// pas një muji/ prap filloi edhe dor'e tretë/ deri n'të fundit pastaj/ mori ata pleq/ fare pleq kshu t'mbaruar/ edhe cunakër të rinj// i çoi atëj nga kufiri turk/ greko-turk// atëj nëpër ishuj i coi të gjithë burrat// neve ngelëm n'shpi/ burrë s'kishte më/// erdhi

gjermani athere pësaj që shkeli Greqinë/ edhe i lroi t'burgosurit që gjeti në Greqi// dënjëm nga di-tre vjet pësaj/ dystenjë/ distedi/ distetre/ n' distekatrën pësaj që qe ajo e fundit// qe ajo e fundit// u ashpsua gjendja pësaj/ edhe u vu kufiri// u vu kufiri atëj/ ne s'keshëm ne pushk/ ajo ishte qeveri/ kishte tope/ mitraloze/ tanke/ avione/ si pun e Kosoves/ t'paktën Kosova kishte diçka/ armë .. / po ne keshëm pak..... etj.

(Feim Hyseni 72 vjeç, 2000)

Përshtatur në gjuhën standarde

Në tetor të dyzetës, filloi lufta italo-greke. Në tetor, unë kam qënë nxënës shkollë. Ditën e parë që e kuptuam neve, erdhën tre aeroplanë. E kuptuam që u hap lufta, pasi erdhën aeroplanët e kaluan mbi fshatin tonë. Ishim në shtëpi duke mësuar se shkollë nuk kishim

⁵³ Intervista është bërë në lagjen nr. 13 Plazh- Durrës, e ashtuquajtur nga banorët e saj (çamë), Lagjja “Bregu i Kanalit”. Intervista është shfrytëzuar për punimin e doktoraturës: Troplini, E. *E folmja e Çamërisë dje dhe sot, Shqyrtime dialektologjike, etnolingustike dhe sociolingustike rreth gjuhës shqipe të shkruar dhe të folur prej çamëve*, Tiranë 2012.

Materialet e punimeve (proceedings)

ISBN: 978-1-78911-007-4

(sqaron) *e më pas dolëm përjashta sepse para luftime s'kishim parë ndonjëherë aeroplanë. (përsërit) Përpara se të shpërthente lufta s'kishim parë aeroplanë. Dolëm përjashta; na thotë mësuesi (sqaron) ishte grek...u trondit shtëpia, u trondit toka nga zhurma e aeroplanëve...Na thotë ai mësuesi (sqaron) na foli greqisht: nesër nuk kemi shkollë, ikni në shtëpitë tuaja. Ikëm neve, edhe ai iku që atë ditë, iku dhe ai mësuesi edhe kështu u hap lufta; filloi lufta.*

Filloi qeveria greke pastaj, filloi të arrestonte çamët myslimanë; neve myslimanëve. Filloi të mbliidhte njëherë dorën e parë. Pas dy javë a njëzet ditë filloi me dorën e dytë. Pas një muaji, filloi përsëri dora e tretë, deri në të fundit pastaj që mori pleqt e çunakërit e rinj (e ka fjalën për adoleshentë të vegjël). I çuan nga kufiri greko-turk, andej nëpër ishuj... Neve ngelëm në shtëpi. Burra s'kishin më. Më pas erdhi gjermani që shkeli Greqinë dhe i liron të burgosurit. Ndenjëm dy-tri vjet pastaj dhe në dyzet e një, dyzet e dy, dyzet e tre... në dyzet e katrën që ajo e fundit ku u ashpërsua gjendja pastaj, u vu kufiri andej... Ne nuk kishim pushkë. Ajo ishte qeveri, kishte topa, mitralozë, tanke, avionë... Si puna e Kosovës ... T'paktën Kosova kishte diçka ...armë ...por ne kishim pak....

Analizë

Duhet të kujtojmë që intervistat janë marrë përmes ligjërimit gojor. Ato janë tejet emocionale dhe në shumicën e rasteve tregohen përmes kujtimeve të fëmijërisë.

Tek kjo intervistë vlen të theksohet krahasimi në fund që individi folës bën me Kosovën, duke e konsideruar gjendjen e shqiptarëve të Çamërisë shumë më të rëndë. Duhet thënë që ky krahasim në kohën e gjenocidit të ushtruar ndaj shqiptarëve të Kosovës nga shteti serb gëllonte tek të gjithë shqiptarët e çamërisë. Ato (sikurse dhe ne) kanë qenë tepër të ndjeshëm ndaj situatës së dhimbshme të Kosovës. Teksa i dëgjoje në atë kohë, dukej sikur ato përjetonin gjenocidin e dytë.

Intervista 6

Ramadan Jaho 80 vjeç, Plazh- Durrës 2000

Fatime Jaho 69 vjeç, Plazh- Durrës 2000⁵⁴

Do t'them prishjen njhe:r/ si u prishmë ka Çamëria// ikën miftiu i Paramthisë/ miftiu i Paramthis edhe Sali Hafuzi/ nji i par' i Paramthis// ajo Paramthia qi themi neve ish qitet si Durrësi// gjisma ishte kaurr/ gjisma ishën myslimanë// edhe ... këta ikën vënë atëj në popull i thomi ne/ në popull në nji vënd të mshefetë që ishte zerva/ ishte zerva grek atje bërna// edhe që të pajtohejn punë/ që të rregulloheshin kto/ dhe grek dhe kta/ të rrishin më një vënd që të mos vriteshin/ mos priteshin// mirëpo ata i prîn kur vënë/ edhe u rreglluan// jo mos u tundni se neve su prekim me duar//

Greket pësaj më përpara që vran atje/ vran atë miftin dhe Sali Hafuz/ /ata di që vënë atje/ ata di që vënë atje që bënë pajtimin me grekë// / e plasi lufta vrasja që u bë/ plasi vrasja/ vëllavrasja// histori e Çamërisë kjo isht//

⁵⁴ Intervista është bërë në lagjen nr. 13 Plazh- Durrës, e ashtuquajtur nga banorët e saj (çamë), Lagjja “Bregu i Kanalit”. Intervista është shfrytëzuar për punimin e doktoraturës: Troplini, E. *E folmja e Çamërisë dje dhe sot, Shqyrtime dialektologjike, etnolingustike dhe sociolingustike rreth gjuhës shqipe të shkruar dhe të folur prej çamëve*, Tiranë 2012.

Materialet e punimeve (proceedings)

ISBN: 978-1-78911-007-4

(vijon e shoqja) plasi lufta përsaj/ plasi lufta/ ne jeshëm më pak/ ata grejt ishnë më shumë// si pun’ e serbit me kosovën// na përzunë ka shpiti moj t’keqen nana/ edhe kalamajt në lum i hidhën/ që s’do hidhën lekat/ u shpëtojnë kalamajt në lum ka frika// se vineshin prapa ato t’na gjëmoj neve// po ù kam qën e vogël///

(vijon përsëri i shoqi) ju bani mënd ma mirë/ ku e di ù/ sa talaçe ka pas kjo kok// un kam qen njizet vjec xham// kush me lih mua/

(Ramadan dhe Fatime Jaho 80 dhe 69 vjeç, 2000)

Përshtatur në gjuhën standarde

Do të të them prishjen njëherë, si u prishëm nga çamëria (si filloi konflikti që çoi në spastrimin etnik të shqiptarëve të çamërisë përmes gjenocidit të ushtruar nga shteti grek). (Fillimisht) Iku myftiu i Paramithisë (qytet i Çamërisë) dhe Sali Hafuzi, një i parë i Paramithisë (një njeri me pozitë në qytet); (sqaron) Paramithia që i themi neve, ishte qytet si Durresi, ku gjysma ishin kaurrë (ortodoksë), gjysma ishin myslimanë... Këta shkuan të takonin njerëz në një vend të fshehte ku ishte dhe Napolon Zerva, me qëllim që të negocionin e të pajtoheshin e gjërat të rregulloheshin, kështu të rrinin në një vend shqiptarët dhe grekët e të mos kishte (viktima) vrasje. Ata i priten mirë kur shkuan dhe u duk sikur i rregulluan gjërat e ranë në ujdi. “Ju mos lëvzni (u thanë) se ne nuk u prekim me dorë!” Porse nga ana tjetër, të parët që vranë ishin dy negociatorët: mytiun dhe Sali Hafuzin, pikërisht ata të dy që shkuan atje që bënë pajtimin me grekët. Dhe kështu plasi lufta, (sqaron) gjenocidi që u be... (lë të kuptojë ... që të gjithë ne e kemi dëgjuar); plasi vrasja, vëllavrasja. Historia e çamërisë kjo është.

(vijon e shoqja) Plasi lufta pastaj, plasi lufta. Ne ishim më pak, grekët ishin më shumë, njëllor sikurse serbët me Kosovën. Na përzunë nga shtëpitë moj të keqen nana edhe kalamjtë i kanë hedhur në lumë pasi kanë ngatërruar bokshet e rrobave me atë të fëmijëve të vegjël, (në shpejtësi e sipër) nga frika se vinin prapa e na gjëmonin ato neve...Po unë kam qenë e vogël... (drejtohet nga i shoqi dhe i kërkon të vazhdojë ai pasi ai ka qenë djalë i ri tek të njëzetat në atë kohë)

(ai pohon që për shkak të moshës nuk mban mend mirë) Ju mbani mend më mirë, ku e di unë? Sa telashe ka patur kjo kokë! Unë kam qenë njëzet vjeç xhanëm ...kush më linte mua... etj.

Analizë

Edhe pse nuk është vendi për analiza subjektive, në këto pak rreshta lexohet qartë strategjia ç’ njerëzore e Napolon Zervës.

Po të vemë re, i intervistuari e konsideron vëllavrasje, pasi tek të gjithë të intervistuarit del në pah bashkëjetesa në harmoni midis popullit grek dhe shqiptarëve të Çamërisë, pavarësisht besimeve të ndryshme fetare.

Siç vihet re dhe nga intervista, në Paramithi bashkëjetonin të dy besimet fetare, ortodoksizmi dhe myslimanizmi.

Intervista 7

Qamile Hasani (rreth 30 vjeç), Plazh- Durrës 2000⁵⁵

⁵⁵ Intervista është bërë në lagjen nr. 13 Plazh- Durrës, e ashtuquajtur nga banorët e saj (çamë), Lagjja “Bregu i Kanalit”. Intervista është shfrytëzuar për punimin e doktoraturës: Troplini, E. *E folmja e Çamërisë dje dhe sot*,

Materialet e punimeve (proceedings)

ISBN: 978-1-78911-007-4

Intervistuesi: A ndjeheshit të paragjykuar ju Qamile kur flisnit çamërisht?

Qamile Hasani: *Problemi u ka pas ndier/ por un nuk para e kam folur/ se edhe me shpi../ jo se 'kemi dash ta folim/ po si duket ka ecur gjuha dhe nuk është folur shumë// vetëm kur thoja se jam çame/ sepse nuk e besonte njeri/ jo/ me t'vërtet që nuk je/ biles kishte plot që/ se është një pjesë ktu n'hekurudha që e flasin goxha/ dhe kishte plot vendalije që flisshin çamshe// unë nuk e di ...//probleme kishim me vendasit/ problemi u kishte ndier gjithandej se ishte vetë sistemi që i kishte ngrit çamët goxha*

Dersa e merrshin vesh (që ishte çame) // edhe kur e merrshin vesh../ t'jenë çamët kshu si ty,- thoshin, mir është/// se ç'kishin çamët që nuk e kisha un/ nuk e di// kur thoje çame//ua .. ku ka çame kshu t'bukur si ty/ po un thoja ndonjë t'shëmtuar nuk njof çame/ t'bukra gati njof shumë///

Unë kam katër vëllezër// dhe nusët i kemi perzier/ nuk i kemi të gjitha çame/etj.

(Qamile Hasani 30 vjeçe, 2000)

Analizë

Kjo është një intervistë e cila i është bërë një vajze të brezit të ri çam⁵⁶, brezi i cili ka përjetuar sistemin diktatorial.

Në fillim të intervistës spikat qartë dallimi midis gjuhës së përdorur nga brezi i ri çam dhe asaj të përdorur nga brezat paraardhës. Ajo deklaron që nuk e fliste çamërishten. Përdorimi i çamërishtes tek brezi i ri filloi të kalojë në bjerrje për shumë arsye, një prej të cilave ka qenë edhe paragjykimi gjuhësor.

Në intervistë, spikat qartë fenomeni i paragjykimit shoqëror ndaj shqiptarëve të Çamërisë të cilët edhe pse u shpërngulën në tokën e tyre, në Shqipërinë e tyre, u bënë në vazhdimësi subjekt paragjykimesh duke mbajtur mbi supë fatin e “jabanxhiut të paqenë”.

Literaturë

Abdurahmani, Troplini, E. *Çamërishtja, aty ku skajet atakohen*, (Monografi shkencore) 2M printing, Durrës 2015

Abdurahmani, Troplini, E. *Linguistic change in the Albanian language of Izmir's Cham*, (4th Eurasian Conference on Language and Social Sciences, Riga- Latvia, July 24 - 27, 2018), selected for collection of scientific articles “*Language. Language in Various Cultural Contexts*” (*Valoda -2018, Valoda dažādu kulturu konteksta*) indexed in “EBSCO Publishing”, ISSN 1691-6042, ISBN 978-9984-14-861-8.

Arkonaç Sibel (2005).Psikoloji: Zihin Süreçleri Bilimi, Alfa Yayınları, İstanbul.

Assmann Jan (2005). *Collective Memory and Cultural Identity*, Neë German Critique, Cultural History/Cultural Studies Vol. 65, pp. 125-133

Bellusci, A. *Gli arbërori- arvaniti, un popolo invisibile* (Ricerche etnografiche nell' Elade,- 1965- 2000), Cosenza 2004.

Devine Patrick (2003). *A Theoretical Overview of Memory and Conflict*, (Editör: Ed Cirns, Michael D. Roe). *The Role Of Memory in Ethnic Conflict*, Neë York: Palgraëe Macmillan, s. 9-34.

Frashëri Kristo, *Historia e Çamërisë, “Vështrim historik”*, UETPRESS, f.3,4, Tiranë 2015

Funkestein Amos, (1993). *Perception Of Jeëis History*, Berkeley: University of California Pres.

Shqyrtime dialektologjike, etnolingustike dhe sociolingustike rreth gjuhës shqipe të shkruar dhe të folur prej çamëve, Tiranë 2012.

⁵⁶ Për moshën e saj dyshohet... mendohet se ajo ka qenë 28, 30 ose 33 vjeç, porse gjithësesi ajo i përkiste në atë kohë brezit të ri çam të të intervistuarve.

KONFERENCA E PARË NDËRKOMBËTARE NË GJUHËSI
“Ligjërimi i shkruar dhe i folur, probleme reale dhe propozime konkrete për zgjidhjen e tyre”

Materialet e punimeve (proceedings)

ISBN: 978-1-78911-007-4

Misztal Barbara (2003). Theories Of Social Remmembering, Philadelphia: Open University Pres

Özakupınar Yılmaz (2009). Hafıza, Ankara: Ötüken Yayınları.

Ricoeur Paul (2012). Tarih Hafıza Unutuş, (Çeviren: M.Emin Özcan). İstanbul: Metis Yayınları.

Schacter L. Daniel (2010). Belleğin İzinde: Beyin, Zihin ve Geçmiş (Çeviren: Eda Özgül). İstanbul: Yapı Kredi Yayınları.

Troplini, E. *Bashkëpërkime të elementeve gjuhësore të veprave më të hershme shqipe, me çamërishten e sotme, AKTET*, Revistë shkencore e Institutit Alb Shkenca, Nr.4, 2009, f. 547-553 ISSN 2073-2244

Troplini, E. *E folmja e Çamërisë dje dhe sot. Shqyrtime dialektologjike, etnolingustike dhe sociolingustike rreth gjuhës shqipe të shkruar dhe të folur prej çamëve*”, (temë disertacioni) Tiranë 2012

*Parimet e drejtshkrimit të gjuhës shqipe
dhe propozimet e Këshillit Ndërkademiç për Drejtshkrimin*

PROF. ASOC. DR. FLAMUR SHALA
Universiteti i Prizrenit “Ukshin Hoti”

Abstrakti

Gjuha standarde ka vlerë shoqërore dhe intelektuale, që i shërben komunikimit në një bashkësi shoqërore. Të gjithë pjestarët e një kombi i takojnë një bashkësi shoqërore, ndërsa gjuha standarde është shenjë e kësaj bashkësie. Gjuha standarde tregon një gjendje të gjuhës së shkruar, përkundër përdorimit të gjuhës së folur dialektore. Si varietetet gjuhësore, gjuha standarde është mbi dialektet. Nga aspekti i marrëveshjes, “koncensusit” të gjerë gjuhësor mbi normën e pranuar dhe kodifikimin e saj, gjuha standarde shënon varietetin gjuhësor për përdorim zyrtar. Çdo ndryshim i mundshëm i saj diskutohet dhe duhet të jetë “koncensual”.

Gjuha historikisht i nënshtrohet zhvillimit dhe ndryshimit. Këtij pohimi i përgjigjet thënia e Sosyrit (1977) se “lumi i gjuhës rrjedh pa shkëputje; a është rrjedha e tij e qetë apo e vullshme, kjo është çështje tjetër”.

Kujdesi që i kushtohet ruajtjes së gjuhës standarde i ndihmon zhvillimit të pandërprerë të gjuhës. Ajo i mbivihet gjuhës popullore dhe ekzistenca e saj nuk varet krejt nga zhvillimi brenda saj, por nga kujdesi që kemi për të. Në këtë rast, kujdesi për gjuhën standarde është ruajtja dhe zhvillimi i “koncensusit” gjuhësor, në funksion të ruajtjes së gjuhës. Ruajtja e gjuhës standarde pa koncensus, “mbetet identike me vetveten”. Ndryshe “lumi i gjuhës rrjedh” dhe po u ndal lumi në shtrirjen e tij, uji nuk ka shijen e atij që rrjedh. Edhe gjuha më normative, dikur nuk është e tillë, jo për nga forma, por për nga funksioni.

Parimi themelor i drejtshkrimit të gjuhës shqipe është parimi fonetik. Ky parim plotësohet dhe herë-herë “pengohet” nga parimi morfologjik dhe historiko-tradicional. Në këtë punim do të trajtohen parimet e drejtshkrimit të gjuhës shqipe, në veçanti lidhur me ë-në e patheksuar, dhe propozimet e Këshillit Ndërkademiç për Gjuhën Shqipe, të botuara në dy vëllime: Propozime për Drejtshkrimin (1976-2014), më 2022.

Fjalët kyçe: *Gjuhë standarde, drejtshkrim, parime, propozime, ndryshime etj.*

1. Hyrje

Nga pikëpamja e historisë së gjuhës standarde shqipe, standardizimi i shqipes letrare është e arritur e madhe kulturore dhe historike e shqiptarëve. Kjo e arritur është rezultat i përpjekjeve të vazhdueshme intelektuale të shqiptarëve ndër breza për standardizimin e drejtshkrimit të gjuhës shqipe.

Nga pikëpamja e një rruge aktiviteteve kulturore e gjuhësore, veçohen disa faza të periudhës kombëtare të zhvillimit të pikëpamjeve për gjuhën dhe standardizimin e saj. Ndër të tjera, për t’u veçuar janë pesë vjetët e diskutimit (publik) të Rregullave të Drejtshkrimit të Shqipes (Projekt), nga viti 1967 deri më 1972. Në pikën 4. të parimeve të përgjithshme të këtij projekti thuhet se “drejtshkrimi i shqipes, në pajtim me prirjet e përgjithshme të zhvillimit të gjuhës letrare, synon njësimin e mëtejshëm të normës kombëtare mbi bazën e trajtave të përbashkëta” (RRDSH -Projekt, 1967, f. 7.).

Nga pikëpamja e planifikimit dhe politikës gjuhësore, deri në vitin 1968 (deri në Konsultën gjuhësore të Prishtinës) Tirana e Prishtina kanë zhvilluar politika e planifikime gjuhësore jo të njëjta për drejtshkrimin e gjuhës shqipe. Shkaku i vetëm i politikave të ndryshme ishte ndarja e popullit shqiptar me kufij administrativë e politikë në dy shtete (ose

tri, përfshirë shqiptarët në Greqi, e tani në 5 shtete, pa përfshirë diasporat arbëreshe) dhe rrjedhimisht në administrata të ndryshme.

Nga pikëpamja e njësimimit të drjetshkrimit të gjuhës standarde, Kongresi i Drejtshkrimit (1972) aprovoi Rregullat e Drejtshkrimit të Shqipes - Projekt (1967), me pak ndryshime (Drejtshkrimi i Gjuhës Shqipe, 1973, Kongresi i Drjetshkrimit të Gjuhës Shqipe, 20-25 nëntor, 1974). U njësuara drjetshkrimi i gjuhës shqipe edhe me synimin për njësimin kulturor e arsimor të shqiptarëve në të gjithë hapësirën e tyre gjeografike në Ballkan.

Drejtshkrimi i gjuhës shqipe, i kodifikuar në vitin 1973, u bë shenjë gjuhësore e shqiptarëve. Sot e 50 e sa vjet më parë, gjuha standarde shqipe me këtë drejtshkrim përdoret në komunikim të përditshëm zyrtar në të gjitha rastet e organizimit shtetëror, arsimor, shkencor, kulturor, letrar e publicistik.

Nga pikëpamja gjuhësore, Drejtshkrimi i gjuhës shqipe mbështetet në 4 parime themelore: Parimin fonetik, morfologjik, historiko-tradicional dhe leksikor-kuptimor.

Dihet, parimi themelor i drejtshkrimit të shqipes është parimi fonetik (Kongresi i Drjetshkrimit të Gjuhës Shqipe, 20-25 nëntor, 1974, f. 97.). Ai mbështetet edhe nga parimi morfologjik me synim “që të ruhen sa më të qarta në shkrim struktura dhe njësia e trajtës, si dhe struktura e formimit të fjalëve” (RRDSH-projekt-1967, f. 7.), ndërsa sipas parimit historiko-tradicional ruhen trajtat me përdorim sipas traditës gjuhësore. Parimi leksikor-kuptimor ka vendin e vet.

Më poshtë shtrohen çështje të gërshetimit të përdorimit të ë-së së patheksuar në disa raste, lidhur me parimet themelore të drjetshkrimit të gjuhës së sotme standarde shqipe, propozimet e KNGJSH-së dhe të dy komisioneve, të ASHAK dhe ASHSH.

1.1 Mbledhjet e KNGJSH

Mbledhjet e Komisionit Ndërkademiq për Gjuhën Shqipe janë mbajtur në një periudhë nga viti 2006-2014. Përfundimet e mbledhjeve të KNGJSH, të asaj të vitit 2006 (Prishtinë) dhe të vitit 2010 (Tiranë), “rreth problemeve të leksikut e të terminologjisë në shqipen standarde”, janë botuar për diskutim të gjerë, dhe nuk janë botuar në librat që i kemi në dorë (Propozime për drejtshkrimin 1976-2014, 2022, f. 53.).

Mbledhjet e KNGJSH vazhduan të mbahen dhe të trajtojnë çështje të caktuara me përfundime si ato të mbledhjes së KNGJSH të 27 qershorit 2012, të mbledhjes së KNGJSH të 16 prillit 2013, me përfundime të mbledhjes së 16 dhjetorit 2013 dhe me përfundimet e mbledhjes së KNGJSH të 14 marsit 2014. Që nga viti 2005 janë mbajtur disa mbledhjet e dy akademive: mbledhja e KD të ASHAK-ut, më 13 tetor 2005 dhe në nëntor 2005 si dhe një e ASHSH 17.11.2005. Një mbledhje e KD të ASHAK-ut dhe KD të ASHSH është mbajtur më 21.09. 2006 (Propozime për Drejtshkrimin -1976-2014 -I, 2022.).

1.2 Rishikimi i literaturës

Standardizimi i drejtshkrimit të gjuhës shqipe, në Kongresin e Drejtshkrimit të vitit 1972, u arrit pas një rruge të gjatë drejt njësimimit të drejtshkrimit të gjuhës letrare shqipe. Vendimtare për njësimin ishte Konsulta Gjuhësore e Prishtinës (1968). Aprovimi në Prishtinë i Rregullave të Drejtshkrimit të Shqipes – Projekt (Tiranë, 1967) i hapi rrugë diskutimit të mëtejshëm të Projektit deri në Kongres. Libri *Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe 20-25 nëntor 1972* (Instituti Albanologjik i Prishtinës, 1974) përfshin dokumente të rëndësishme, akte dhe kumtesa për drejtshkrimin e njësuar të gjuhës shqipe. Që në rezolutën e Kongresit konstatohet përdorimi i normës së përbashkët letrare kombëtare, në Prishtinë e në Tiranë, në Shkup e në Podgoricë, gjithandej ku flitet e shkruhet gjuha shqipe, në të gjitha veprimtaritë

Materialet e punimeve (proceedings)

ISBN: 978-1-78911-007-4

shoqërore (KDGJSH 20-25 nëntor 1972, 1974, f. 95.). Konstatimi në Kongres (pika e parë e konstatimeve në Rezolutë, 1974, f. 96.) se “Shqipja letrare e kohës sonë ka hyrë tashmë në fazën më të lartë të zhvillimit të saj, në fazën e kristalizimit të plotë e përfundimtar” dhe se “Kjo shkallë e lartë zhvillimi kërkon edhe përcaktimin e normave drejtshkrimore sa më të plota, sa më të njësuara dhe të qëndrueshme”, dhe, ndër të tjerë, konstatimi se “Drejtshkrimi nuk është vetëm një çështje shekncore, por edhe një problem i rëndësishëm shoqëror...” etj. (KDGJSH 20-25 nëntor 1972, 1974, f. 96, 97), konsistojnë lidhur me pikën e parë të parimeve që vendosi Kongresi që “Rregullat e Drejtshkrimit të mbështeten sa më gjerë në trajtat e përbashkëta të gjuhës kombëtare shqipe”.

Nisur nga dy tipare, siç thotë Kostallari, të gjuhës letrare kombëtare: prirja e saj “për t’u bërë gjuhë e përbashkët e gjithë popullit” dhe se rregullat e drejtshkrimit përbëjnë “karakterin ligjësor të normativitetit” si tipar i gjuhës letrare, norma del të jetë “nacion qendror” si “për çdo gjuhë letrare kombëtare” (Kostallari, 1973, f. 32.). Sipas Kostallarit, në prerjen horizontale të tipareve të sipërpërmendura, gjuha e sotme letrare shqipe “nuk përfaqëson një shkrirje mekanike të varianteve letrare, por është një sintezë e re e elementeve të gjuhës shqipe”, në të gjitha nënsistemet e saj. Sipas tij, “rastet e pastandardizuara janë relativisht të pakta...”, (b.f. *dubletet normative*), të cilat, edhe ato, i janë nënshtruar procesit të kristalizimit përfundimtar të strukturës gjuhësore normative (Kostallari, 1973, f. 33.).

Kur flet për *dubleta* dhe *apostrofin*, Çabej (1974, f. 127.) thotë se “edhe kur të kenë gjetur zgjidhje shumica e çështjeve të kësaj fushe, puna e drejtshkrimit nuk ka mbaruar”.

Thelbi i tipareve themelore të drejtshkrimit dhe roli i faktorëve gjuhësorë e shoqërorë janë të lidhur, siç thotë Kostallari (1973, f. 8.), me “veçoritë historike të formimit të gjuhës sonë letrare kombëtare dhe të normës letrare, të parë si një sistem në zhvillim, që ka jo vetëm të kaluarën e të sotmen, por edhe të ardhmen”.

Që nga aprovimi i “Rregullave të drejtshkrimit të gjuhës shqipe – projekt”, (Prishtinë, 1968), e deri në Kongresin e Drejtshkrimit, studiues të gjuhës shqipe me kumtesa dhanë kontributin e tyre, edhe në Kongres. Në kumtesat të botuara në “Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe 20-25 nëntor 1972” (Prishtinë, 1974) trajtohet një numër i kosiderueshëm çështjesh si, bie fjala, trajtimi i shkrimit të shkronjave të mëdha, emrave të përveçëm, fjalëve të huaja etj.. Përveç tjerash, trajtohen tema që lidhen me parimet e drejtshkrimit, me parimin fonetik si në kumtesat: “Parimi fonetik e zbatimi i tij në drejtshkrimin e shqipes” (Domi, 1974, f. 111.), “Drejtshkrimi dhe grafika e shqipes” (Lafe, 1974, f. 163.), “Drejtshkrimi dhe shqiptimi letrar” (Dodi, 1974, f. 143.); me parimin morfologjik: “Rreth disa çështjeve të zbatimit të parimit morfologjik në drejtshkrimin e shqipes” (Agalliu, 1974, f. 215.) dhe me parimin historiko-tradicional: “Reth parimit tradicional-historik në drejtshkrimin e shqipes” (Beci, 1974, f. 157.). Në trajtimin e këtyre parimeve zënë vend çështje të rëndësishme të drejtshkrimit për të cilat nuk është mbyllur debati gjuhësor e shkencor as në ditët tona. Edhe më vonë (e deri më sot), vetëm për shkrimin e ë-së ka dhjetra kumtesa që trajtojnë ë-në e patheksuar në pozicione të caktuara brenda fjalës dhe gërshetimin e saj në parimet e drejtshkrimit, si në artikullin “Mbi gërshetimin e parimit fonetik me parimin morfologjik në disa rregulla të drejtshkrimit të shqipes”, (Topalli, 1974, f. 221.) etj..

Nga aspekti i trajtimit të zhvillimit të ngadalshëm e të pandërprerë të gjuhës, me elementet përbërëse të saj, drejtshkrimi rregullon “këtë realitet të lëvizshëm”. Çështje të diskutueshme, siç përmend Domi, sjell drjetshkrimi i ë-së së patheksuar, “që del sot si tingull i paqëndrueshëm, i dobësuar në shkallë të nrdyshme, e si pasojë i një dëgjueshmërie të ndryshueshme” (KDGJSH, 1974, f. 115.). Ndërkaq, kjo -ë e patheksuar është njëfarë

udhëkryqi ku gërshetohen parimet e drejtshkrimit të gjuhës shqipe (Karapinjolli-Stringa, 2002, f. 292-297, 2022, f. 97.).

Gjuha zhvillohet dhe pasurohet vazhdimisht. Ajo, siç shprehet Ismajli (2022, f. 34) “ka një natyrë dinamike në çdo kohë dhe dinamizmin e saj e karakterizon gjithprania e diversitetit, e heterogjenitetit, e rregullsisë dhe e varieteteve”.

Mbi bazë të normës së shkruar dhe parimeve, drejtshkrimi merr formën e tij dhe standardizohet. Në thelb, forma e shkruar e gjuhës së sotme shqipe edhe sot mban “distancë” me shprehjen gojore, jo vetëm nga shkaku se gjejnë shprehjen e tyre aspekte fonetike dialektore (dihet se nuk duhet ngatërruar variante dialektore me standardin si varietet), por, siç shkruan Ismajli (2022, f. 35.), se “me faktin se standardizimi lidhet me formën e shkruar, distanca midis shprehjes gojore dhe të shkruarës u shtrohet gjykimeve të vlerësisë”. Fjala është se sot kushdo që përdor standardin, në një rast a në një tjetër, nuk e shqipton ashtu siç e shkruan.

Gërshetimit të parimeve të gjuhës shqipe i jepet një vend i veçantë edhe në kumtesat, të cilat përrfshihen në librin *Propozime për drejtshkrimin (1976-2014) -I-II-*, 2022. Lidhur me disa nga këto propozime që prekin parimet flitet në pjesën e *diskutimit përmbledhës* të kësaj kumtese

1. Metoda

Metoda e krahasimit dhe analizës gjuhësore mundëson krahasimin e rregullave të drejtshkrimit të ngritura mbi bazën e parimeve të drejtshkrimit të gjuhës shqipe (KDGJSH 20-25 nëntor, 1974) me propozimet e KNGJSH më 2012, 2013 dhe 2014, që në disa raste janë të një vije të trajtimeve në Kongres (1972) dhe propozimeve (Propozime për Drejtshkrimin 1976-2014 I-II, 2022), që lëkundin këto rregulla e rrjedhimisht edhe parimet e drejtshkrimit. Po ashtu mundëson analizën e trajtimeve gjuhësore për çështje të caktuara drejtshkrimore lidhur me parimet e drejtshkrimit, në punimet e përmbledhuara në dy vëllimet “Propozime për drejtshkrimin 1976-2014 I-II” (2022).

1.1. Mbledhja dhe analiza e të dhënave

Mbledhja e të dhënave lidhur me trajtimin e formave të fjalëve sipas propozimeve të dy akademive shqiptare, asaj të Kosovës (sipas përfundimeve të mbledhjeve të KD të ASHAK) dhe të Shqipërisë (sipas përfundimeve të mbledhjeve të KD të ASHSH) krahasuar me trajtat e fjalëve sipas parimeve të drejtshkrimit të kodifikuar (Tiranë, 1973), ka dhënë rezultatet e kërkuara, shtuar edhe trajtimet e autorit të kësaj kumtese.

Artikujt për çështje drejtshkrimore, të autorëve të ndryshëm që janë marrë me drejtshkrimin (rreth 100 sish), të përfshirë në dy vëllimet e botuara nga Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve – Shkup dhe Shoqata e Gjuhësisë Shqiptare (Propozime për drejtshkrimin 1976-2014, 2022), në parim përbëjnë shprehje të mendimit pas trajtimit të problemeve të drejtshkrimit të gjuhës shqipe, qoftë si trajtime me rezultate, qoftë si propozime të përkufizuara për ndryshime të drejtshkrimit në pika të caktuara. Po ashtu trajtohen edhe kumtesat e studiuesve të gjuhës shqipe, të cilët kanë bërë vërejtje në disa pika të parimeve të drejtshkrimit, të aprovuara në Kongresin e Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe më 1972, të botuara më 1974 në Prishtinë (KDGJSH 20-25 nëntor, IAP, 1974).

Në këtë punim zë vend më shumë trajtimi i parimeve të drejtshkrimit të gjuhës shqipe në raport me propozimet e KNGJSH, në veçanti lidhur me ë-në e patheksuar, në pozita të ndryshme dhe me shkrimin e trajtave të shumësit të emrave që në të pashquarën marrin -nj.

2. Rezultatet

Parimi fonetik është parimi bazë i drejtshkrimit të gjuhës shqipe. Ky parim synon të japë sitemin fonologjik edhe pse „nuk përkon gjithnjë me parimin fonematik“ (Domi, 1974, 114). Bie fjala plak-plakë; kunat-kunatë etj..

Janë disa propozime që prekin të gjitha parimet, që kanë të bëjnë me ë-në e patheksuar paratheksore – parimin morfologjik (besëlidhje, pjesëmarrës etj), pastheksore (ujëra-ujra, sikurse vajra etj., i dobët-i dohti, i cekët-i cekti etj.) dhe fundore – parimin tradicional (grurë-grur, burrë-burr, sikurse mur) dhe në veçanti me ë-në mbështetëse - parimin fonetik (shoqëror- shoqror, mjekësi-mjeksi etj.).

Gërshetimi i fonetik me parimin morfologjik dhe me atë historik-tradicional duket më mirë te fjalët si *besnik dhe besëlidhje*. Ndërtimi i rregullës me heqjen e ë-së paratheksore në fjalët e formura me prejardhje a përbërje, më temë në -ë: me fjalën *besë* fjala *besnik* shkruhet pa -ë (jo besënik), sipas parimit historiko-tradicional, dhe tjetra shkruhet *besëlidhje*, pra me -ë, dhe ruan një parim tjetër, parimin morfologjik, ndërsa e-ja në fjalën *besë* në të dy fjalët, *besnik e beslidhje*, ka të njëjtën gjatësi (të shkurtër) e rrjedhimisht të njëtin shqiptim.

Zbutja e bashkëtingëllores *nj* në -j fundore të emrave dhe mbiemrave mashkullorë në shumës si *i ri-të rinj-të rij; i zi-të zinj-të zij; mi-minj-mij* etj. prek parimin fonetik e morfologjik (Propozime, 2022, f. 59.). Sipas analizës sonë del e panevojshme edhe ruajtja e *j*-së; shumësi formohet edhe me trajtën të *ri-të ritë; të zi-të* (të zitë e ullirit), *mi-mitë, sikurse thithitë* etj. **J**-ja ruhet në emrat si *thua-thoj, përrua-përre(o)j* etj.

Siç kemi parë dalin rreth 66 propozime për ndryshime të drejtshkrimit të gjuhës shqipe, nga të cilat shumica janë propozime të KD të ASHAK-u, të diskutuara dhe shumica të pamiratuara nga KD ASHSH (Propozime për Drejtshkrimin 1976-2014, 2022).

3. Diskutim përmbledhës

Rishikimi i rregullave të drejtshkrimit të gjuhës shqipe ndodh në një kohë të zhvillimit të shoqërisë shqiptare të integruar nga aspekti kulturor dhe gjuhësor dhe jo vetëm; ndikimi i librit në shoqërinë tonë është i dukshëm dhe është në funksion të përdorimit të drejtë të gjuhës së shkruar standarde. Puna dhjetëvjeçare e komisioneve të dy akademive të shkencave dhe komisioni i KNGJSH-së, ka rezultuar me një përmbledhje të propozimeve, në parim të diskutuara, dhe me propozimet e të dy komisioneve të ASHSH-së dhe ASHAK-ut.

3.1. Ë-ja e patheksuar

Lidhur me drejtshkrimin e ë-së së patheksuar ka vështirësi edhe nga shkak i një faktori të rëndësishëm: “në shkrimin e ë-së gërshetohen të gjitha parimet e drejtshkrimit: fonetik, morfologjik dhe tradicional” (Karapinjalli-Stringa, 2002, f. 292-297; 2022, f. 29.). Sado që duket se ë-ja e patheksuar është një element fonetik “real”, vërehet shkalla e ndryshme e realizimit të saj sipas rrethmit fonetik.

3.2. Parimet dhe ë-ja e patheksuar

Nga aspekti i parimit fonetik, zanorja -ë e patheksuar ka nxitur kaheër që gjuhëtarët të merren me të. Parimi morfologjik e ruan strukturën morfemore dhe “ka plotësuar parimin fonetik” (Lafe, 2007; 2022, f. 35). Lafe përmend se ky parim ka ndikuar në krijimin e një norme shqiptimore si në fjalët: *vend, mendje, brenda, zemër* etj, në shqiptimin me e, në vend të ë-së (mëndje, vënd, brënda etj.) dhe edhe te fjalët: *i madh, të ligj, u dogj* etj, ku menjanohet shurdhimi i bashkëtingëllores fundore i *math, të liq, u doq* etj..

Fjalët e prejardhura si *amtar, nevojtari, rojtari, meshtari, qëndrestari* më temë me **-ë** fundore të fjalëve fjalëformuese (amë, nevojë, rojë, meshë, qëndresë etj) shkruhen pa **-ë** paratheksore dhe merren si përjashtime në drejtshkrimin e shqipes, për shkak të ngulitjes prej kohësh të shqiptimit, krahas disa fjalëve që janë formuar në gegërishte si *ranishte, zanore* etj (Lafe, 2002, 37.). Rrjedhimisht nuk është e nevojshme që këto fjalë t'i kthehen “rregullës”, të shkruhen me **-ë**, por fjalët me **-ë** si *pjesëmarrës, flakëroj, frymëzoj* etj., të kthehen “në përjashtime” që nënkupton të shkruhen pa **-ë** dhe këto fjalë të shkruhen sipas një rregulle të re.

4.2.1 Ë-ja paratheksore

Nga këtu themi se edhe propozimi i KNGJSH lidhur me menjanimin nga drejtshkrimi të **ë-së** morfemore në fjalët si: *pjesëmarrës, pjesëtoj, copëtoj* etj. bashkë me “përjashtimet” *amtar, nevojtari, rojtari, meshtari, qëndrestari*, të kthehen në “rregull” dhe të shkruhen *antar, flakroj, frymzoj, coptoj, pjesmarrës, beslidhje* etj. me pak përjashtime si *naftëtar, luftëtar*, ku takohen dy bashkëtingëllore dhe *nismëtar*, ku në kufij të rrokjes kemi dy sonante *-sm* (Propozime I, 2022, KNGJSH, 54-55)

Këto forma fjalësh që i “mbron” parimi morfologjik, parimi fonetik u jep vendin e vet dhe siç thotë Domi (1974, f. 115.), “kur shndërrimet fonetike janë kthyer në fakte të qarta, të pamohueshme të përgjithshme e të konsoliduara, në gjuhë ato duhet t'i pasqyrojë drejtshkrimi”

Ruajtja e **ë-së** të kthen te ajo që e thotë Beci (1974, f. 159.), i cili shton se “si duhet vlerësuar ruajtja e **ë-së** në fjalët e prejardhura ose të përbëra të tipit: *gojëtar, pjesëtim, mirëqenie* etj., ku zanorja e temës së fjalës ka humbur gjatësinë për shkak të saj në pozicion të patheksuar”.

Duhet shtuar atë që thotë Beci në Kongres (KDGSH, 1974, f. 159.) se “Si duhet vlerësuar **ë-ja** fundore në sistemin grafemik të gjuhës letrare, si morfemë apo si shenjë diakritike që vlen për të shënuar shkallën e gjatësisë së zanoreve para saj”. Menjanimi i **ë-së** morfemore, duke mos qenë një fonemë me funksion, kur fjala e re e formuar ka ndërruar temën tashmë, nuk e dëmton parimin morfologjik, sepse ka ndodhur të shihet me fjalët si *nevojtari, qëndrestari*, përkundrazi forcon parimin fonetik. Nga kjo pikëpamje shkrimi fonetik nuk përkon gjithëherë me atë fonematik, ndërsa ky i dyti është i lidhur me parimin morfologjik (Beci, 1974, f. 158.).

3.3. Ë-ja e patheksuar fundore

Ë-ja fundore ka disa funksione dhe, siç dihet, karakterizon temat emërore të gjinisë femërore të tipit *mollë*; si mjet dallues i shumësit nga njëjësi në sistemin emëror dhe mbiemëror (student-studentë, punëtor-punëtorë etj); si një formant fjalëformues të tipit *pres-presë* dhe si formant në sistemin foljor te tipat e foljeve punojmë, mësojmë etj. (Hysa, SF. 2002, f. 75-80, 2022, f. 27.). Për shkak të ndarjes dihotomike femërore-mashkullore dhe për të thjeshtuar rregullën drejtshkrimore, preket parimi historiko-tradicional, se emrat e tipit *djalë, burrë gjumë, kalë, lëmë, lumë, brumë* etj, të shkruhen pa **-ë** në fund, pa u njëtesuar me fjalët *mollë, fjalë* etj. për shkak të vlerës që ka **ë-ja** në këto kategori. Ndërsa drejtshkrimi ruan **ë-në** fundore sipas parimit tradicional në fjalët *djathë, brumë* etj. “del i këshillueshëm të hequrit dorë nga ruajtja e **ë-së** së patheksuar fundore te një numër i kufizuar emrash mashkullore” si **lum-i, djal-i, djath-i, brum-i, burr-i** etj (Domi, 1974, f. 117.). Me këtë propozim del edhe KNGJSH (Propozime, 2022, f. 55.). Janë rregullat sa më të thjeshta që ruajnë dhe sigurojnë qëndrueshmërinë e drejtshkrimit të gjuhës shqipe.

3.4. Ë-ja mbështetëse

Drejtshkrimi i gjuhës shqipe e trajton si problem në raste të veçanta (1973, f. 44.) në rastet kur ë-ja është paratheksore (shoqëror, gjyqësor, kombëtar, fajësoj, pyllëzoj etj.) dhe ka dhënë zgjidhje kur ajo është në pozicione pastheksore (i fisëm, i mesëm etj.) pa folur për të si ë-mbështetëse. Ë-ja mbështetëse është trajtuar si një dukuri gjuhësore e kushtëzuar fonetike dhe lidhur me temën fjalëformuese. Në disa formime ajo duket të jetë e kushtëzuar fonetike nga struktura fjalëformuese, ndërsa në disa të tjera nuk duket të jetë e tillë (Dodi, 1981, SF, nr.3, f. 103-108; Propozime II, 2022, f. 10.). Dodi (1981, 2022) shton se përveç ë-së mbështetëse shqipja ka edhe -a-në mbështetëse si në fjalët *peshkatar, gjakatar, moshatar* etj. e lidhur me prapashtesën -tar, pa u mbështetur në kushte fonetike; më shumë e kushtëzuar nga morfema konkrete fjalëformuese. Dalja e ë-së mbështetëse lidhet me kushtet fonetike që u përmendën, si dhe strukturën fjalëformuese, me llojin e prapashtesës (2022, f. 13). Ë-ja mbështetëse që përdoret në fjalët si armiqësi, besnikëri, kombëtar, pakësoj etj. është e motivuar nga struktura fonetiko fjalëformuese me fjalët e tipit: bardhësi, burrëri, mirësoj etj. (Karapinjalli-Stringa, 2002, f.292-297; Sipas propozimeve për drejtshkrimin (1976-2014 II, 2022, f. 30.), ruajtja e ë-së mbështetëse del të jetë e panevojshme, sepse është në shpërputhje me rregullat e drejtshqiptimit. Arsyeja se ë-ja mbështetëse përdoret në fjalët ku ka tri bashkëtingëllore del të jetë i diskutueshëm (harkëtar-harktar, bujqësi-bujqsi etj. e cka të bëhet me e *sotnja, e ardhmja*, krhasoni: *kombtar, harktar* me *tundte, ardhte* etj. Janë kufijtë e rrokjeve a të morfemave që lehtësojnë shqiptimin e këtyre fjalëve (Karapinjalli-Stringa, 2002, 2022, f. 31.).

Në mbështetje në shqiptimin e sotëm letrar, është i drejtë propozimi i KDGJSH-së (2022, f. 55.) që të shkruhen pa -ë mbështetëse fjalët si: *krejtishtë, lavdroj, plehroj, shtetror* etj. Të shkruhen pa ë mbështetëse edhe fjalët: *emrore, dimroj, numrim, zemroj (zemra)* etj.

3.5. Ë-ja pastheksore

Menjanimi i ë-së pastheksore, si në fjalët ujëra-ujra, djadhëra-djathra, drithëra-drithra, sikurse vajra, fshatra etj. njëjtëson rregullën për shkrimin trajtës së shumësit të pashquar e të shquar (ujra-t, djathra-t, drithra-t etj.) të këtij tipi të të emrave. Po kështu shkruhen edhe numërorët mijëra-mijra, ashtu si qindra (Propozime për Drejtshkrimin, 2022, f. 33.)

Përgjithësimi i prapashtesës -të te mbiemrat me -ët dhe -të përkon me natyrën e mbiemrit, me shqiptimin e sotëm të përgjithësuar. Shkrimin e mbiemrave me -të e jo me -ët e ka përmendur Idriz Ajeti (1974, f. 135; 1952, në 17 konkluzionet e mbledhjes për gjuhën shqipe) se janë të drejta trajtat i *haptë, i lagtë, i përbashktë* etj. siç propozon KNGJSH (2022, f. 56.): i zhdërvjelltë e jo me -ët, i *dushktë, i myshktë, i paktë, i ultë*, si i *ftohtë* shkruhet i *coftë*, si i *mëndafshhtë* shkruhet i *rrafshhtë* etj. Ndërkaq mbiemri i *pasmë* propozohet të hyjë në sistemin i *mesëm - e mesme, i fisëm - e fisme*, me shpjegimin se mbaron me bashkëtingëlloren (-m), ashtu si si i madh – e madhe, dhe nuk mund t’i takojë paradigmes së mbiemrave që mbarojnë me zanoren -ë si i mirë-e mirë).

Mbiemri i *sigurt* të shkruhet i *sigurtë* me theks në zanoren -u, si i *sinqertë* (Propozime, 2022, f. 57.)

3.6. Shumësi i pashquar i emrave dhe mbiemrave që mbarojnë me bashkëtingëlloren -nj

Duhet shënuar propozimin e ASHAK-ut për shkrimin me -j në shumësin e pashquar të emrave dhe mbiemrave mashkullorë si *mullinj, ullinj, të rinj, të zinj* etj. Sipas pikës 2 të shkrimit të bashkëtingëlloreve, propozohet që “format e shumësit *ftonj, thonj, ullinj, mullinj,*

përrenj, të shkruhen me **-j**, në mbështetje të evolucionit që kanë pësuar këto trajta: *ftoj*, *ullij*, *mullij*, *përrej* etj. Edhe mbiemrat: *i drunj të mëdhenj*, *të rinj*, *të zinj*- të shkruhen me **-j**”. Ky propozim u pranua nga KNGJSH, sipas përfundimeve nga mbledhja e KNGJSH, më 16 prill 2013 (Propozime për drjetshkrimin, 2022, f. 59.)

Pas mendimit tim, shumësi i emrave me **-i** të theksuar, si *ulli-nj*, *mulli-nj*, *mi-nj* etj. dhe i mbiemrave si *i zi*, *të zi-nj*, *i ri*, *të ri-nj* etj., të shkruhen pa **-nj**, po se po, po edhe pa **-j**: *disa mulli*, *ulli*, *mi*, (sikurse thi-thitë), *disa të zi* (të zitë), *të ri* (të ritë), etj.

Përfundime

1. Zhvillimi gjuhësor është një antonimi, siç thotë Martine (1983, f. 229.), “midis nevojave komunikative të njeriut dhe tendencës së tij për ta rrudhur në minimum veprimin mendor dhe fizik”. për të vazhduar se “në çdo stad të zhvillimit të gjuhës vendoset një lloj ekuilibri midis nevojave të komunikimit që kërkojnë njësi më të shumta, më specifike, dhe inercionit që shpie te përdorimi i një numri me vlerë më të përgjithshme”, ndërsa “gjuhëtarit i intereson vetëm shkaktësia e brendshme e këtij zhvillimi” (228). Thënia e Sosyrit (Kursi, 1977) se “lumi i gjuhës rrjedh pa shkëputje”, i përgjigjet pohimit se gjuha historikisht i nënshtrohet zhvillimit dhe ndryshimit.

2. Kujdesi që i kushtohet ruajtjes së gjuhës standarde i ndihmon zhvillimit të pandërprerë të gjuhës. Ekzistenca e saj nuk varet nga kujdesi që kemi për këtë zhvillim. Kujdesi për gjuhën standarde është ruajtja dhe zhvillimi i “koncensusit” gjuhësor, në funksion të ruajtjes së gjuhës. Ruajtja e gjuhës standarde pa koncensus, “mbetet identike me vetveten”. Po u ndal lumi në shtrirjen e tij, uji nuk ka shijen e atij që rrjedh. Edhe gjuha më normative, dikur nuk është e tillë, jo për nga forma, por për nga funksioni.

3. Parimi themelor i drejtshkrimit të shqipes është parimi fonetik. Ky parim plotësohet dhe herë-herë “pengohet” nga parimi morfologjik dhe historiko-tradicional. Këto tri parime bien ndesh njëri me tjetrin.

4. Në thelb, forma e shkruar e gjuhës së sotme shqipe edhe sot mban “distancë” me shprehjen gojore, jo vetëm nga shkaku se gjejnë shprehjen e tyre aspekte fonetike dialektore, por edhe nga shkaku se kushdo që përdor standardin, një një rast a në një tjetër, nuk e shqipton ashtu siç e shkruan.

5. Rregullat e drejtshkrimit të gjuhës standarde konformzojnë (term i sociolinguistikës) drejtshqiptimin dhe drejtshkrimin në shkallën më të lartë të përdorimit të gjuhës, në këtë rast, të gjuhës shqipe.

Literatura:

- Ajeti, A. 1998, *Studime gjuhësore I-VI*, Prishtinë.
 Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës, 2022, *Shqipja standarde sot*, Prishtinë.
 Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Grup autorësh, 2002, *Gramatika e gjuhës shqipe 1*, Tiranë.
 Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Grup autorësh, 2002, *Gramatika e gjuhës shqipe 2*, Tiranë.
 Çabej, E. 2006, *Studime etimologjike në fushë të shqipes I-VII*, Tiranë.
 Çeliku, M. 2001, *Çështje të shqipes standarde*, Tiranë.
 Dodi, A. 2004, *Fonetika e gjuhës së sotme shqipe*, Tiranë.
 Domi, M., Totoni, M., Cikuli, N., Floqi, S. 2002, *Rregullat e pikësimit në gjuhën shqipe*, Tiranë.
 Instituti
 Dhrimo, A., Memushaj, R. 2015. *Fjalor Drejtshkrimor i Gjuhës Shqipe*, Tiranë.

- Instituti Albanologjik i Prishtinës, 1974, *Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe 20-25 nëntor 1972*, Prishtinë.
- Instituti Albanologjik i Prishtinës, 1987, *Çështje të studimeve albanologjike*, Prishtinë.
- Instituti Albanologjik i Prishtinës, 2008, *Konsulta gjuhësore e Prishtinës*, Prishtinë.
- Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore, të Shqiptarëve - Shkup, Shoqata e Gjuhësisë Shqiptare, 2022, *Propozime për Drejtshkrimin (1976-2014) -I- dhe -II-*, Shkup.
- Ismajli, R. 1998, “*Në gjuhë*” dhe “*për gjuhë*”, Pejë.
- Ismajli, R. 2003, *Standarde dhe identitete*, Pejë.
- Kostallari, A. 1973, *Gjuha e sotme letrare shqipe dhe disa probleme themelore të drejtshkrimit të saj*, Tiranë.
- Lloshi, Ll. 2011, *Shqipja gjuhë e hapur dhe dinamike*, Tiranë.
- Martine, A. , *Elemente të gjuhësisë së përgjithshme*, Prishtinë.
- Memushaj, R. 2011, *Shqipja standarde*, Tiranë.
- Munishi, Z. 1984, *Gjuha shqipe dhe kultura e të shprehurit*, Prishtinë.
- Munishi, Z. 2013, *Zgjedhimi i foljeve*, Prishtinë.
- Murati, Q. 2009, *Për shqipen standarde*, Prishtinë.
- Raka, F. 2005, *Historia e shqipes letrare*, Prishtinë.
- Rugova, B. & Sejdiu-Rugova, L. 2015, *Hyrje në gramatikën e tekstit të gjuhës shqipe*, Prishtinë.
- Rugova, B. 2021, *Ideologjia e gabimit gjuhësor*, Prishtinë.
- Sulejmani, F. 1984, *Praktikumi i gjuhës së sotme letrare shqipe*, Prishtinë
- Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë, 2021, *Emil Lafe personalitet i shquar i gjuhësisë shqiptare*, Tiranë.
- Universiteti Shtetëror i Tiranës-Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, 1967. *Rregullat e Drejtshkrimit të Shqipes* (Projekt), Tiranë.

Shumëgjuhësia dhe të drejtat gjuhësore në Republikën e Kosovës

PROF. ASS. DR. FATON KRASNIQI
Instituti Albanologjik – Prishtinë

Abstrakt

Shumëgjuhësia dhe të drejtat gjuhësore në Republikën e Kosovës janë respektuar dhe janë avancuar në vazhdimësi dhe kjo për ne është një e arritur dhe një vlerë e shtuar shoqërisë sonë. Republika e Kosovës i ka mbështetur dhe respektuar në vazhdimësi dhe mënyrë institucionale të gjitha gjuhët e pakicave kombëtare. Gjithashtu Ligji i Kosovës mbi Përdorimin e Gjuhëve, i miratuar në vitin 2006, saktësisht thotë se shqipja dhe serbishtja janë gjuhët zyrtare të Kosovës dhe për këtë arsye të gjitha institucionet dhe ofruesit e shërbimeve publike janë të detyruara të sigurojnë përdorimin e tyre të barabartë në sistemin gjyqësor, institucionet shtetërore dhe komunale, ndërmarrjet publike, në media, arsim, shërbime sociale dhe në sektorin privat dhe një gjë e tillë ka ndodhur. Shumëgjuhësia në Kosovë është vlerë e shtuar dhe si e tillë është vlerësuar nga bota perëndimore. Republika e Kosovës gjithmonë ka qenë e përkushtuar në promovimin e vlerës së shumëgjuhësisë, duke pasur parasysh se kjo vlerë është mjet për ruajtjen e karakterit fort të pasur dhe të larmishëm të shoqërisë sonë. Sa i përket përdorimit të gjuhëve zyrtare (dy gjuhësisë, shumëgjuhësisë), në institucione komunale dhe shtetërore qytetarët e saj i ka trajtuar në mënyrë të barabartë në komunikim, në dokumente zyrtare, në takime publike, në ueb – faqet e institucioneve, emrat zyrtarë të qyteteve dhe fshatrave, shesheve, bulevardeve, rrugëve etj., kurse gjuhët në përdorim zyrtar në nivel komunal kanë funksionuar në përputhje me kornizën ligjore, si në shpalljen e konkurseve komunale njoftimeve të ndryshme komunale. Kuvendet komunale në seancat e tyre kanë lektorë dhe përkthyes profesionalë, ku çdo material përkthehet me kohë dhe është në funksion të qytetarëve dhe zyrtarëve komunalë.

Fjalët çelës: *shumëgjuhësia, gjuha zyrtare, të drejtat gjuhësore, komunat, komunitetet*

Hyrje

Republika e Kosovës i ka gjithsej 38 komuna, gjuha shqipe është gjuhë zyrtare në 35 komuna, në Komunën e Zubin Potokut⁵⁷ dhe Zveçanit⁵⁸, Mitrovicës Veriore⁵⁹ gjuha shqipe nuk është gjuhë zyrtare, apo nuk përfillet nga institucionet komunale; gjuha serbe është gjuhë zyrtare në 38 komuna të Republikës së Kosovës; gjuha boshnjake është gjuhë zyrtare në tri komuna dhe gjuhë në përdorim zyrtar në një komunë të Republikës së Kosovës (në komunën e Dragashit⁶⁰, Pejës⁶¹, Prizrenit⁶², Istogut⁶³); gjuha turke është gjuhë zyrtare në dy komuna dhe gjuhë në përdorim zyrtar në tri komuna të Republikës së Kosovës (në komunën e Prizrenit⁶⁴, Prishtinës⁶⁵, Mamushës⁶⁶, Mitrovicës Veriore⁶⁷, Gjilanit⁶⁸). Të gjitha njoftimet,

⁵⁷ org/wiki/Opština_Zubin_Potok

⁵⁸ <http://www.opstinazvecan.rs/>

⁵⁹ kk.rks-gov.net/mnao/?lang=sr-Latn-CS

⁶⁰ <https://kk.rks-gov.net/dragash/>

⁶¹ <https://kk.rks-gov.net/peje/>

⁶² <https://kk.rks-gov.net/prizren>

⁶³ <https://kk.rks-gov.net/istog/>

⁶⁴ kk.rks-gov.net/prizren/default.aspx?lang=tr-TR

⁶⁵ tr.wikipedia.org/wiki/Prishtine_Belediyesi

⁶⁶ tr.wikipedia.org/wiki/Mamuša_Belediyesi

⁶⁷ kk.rks-gov.net/mnao/?lang=sr-Latn-CS

shpalljet, ftesat në komunat e Republikës së Kosovës bëhen në gjuhët zyrtare të tyre. Gati të gjitha komunat në Republikën e Kosovës kanë përkthyesit e tyre gjuhësorë, të cilët janë të obliguar që të gjitha materialet gjuhësore t'i përkthejnë në gjuhët zyrtare të atyre komunave. Në të gjitha komunat e Republikës së Kosovës ka gjithsej pesëdhjetë e dy profesionistë gjuhësorë. Të gjitha komunat ofrojnë mbështetje të brendshme me shërbime të brendshme gjuhësore kanë një deri dy profesionistë gjuhësorë. Komuna më “multilinguale”, në Republikën e Kosovës është komuna e Prizrenit. Komuna e Prizrenit njih katër gjuhë zyrtare gjuhën shqipe, turke, serbe, boshnjake. Kurse numri i përgjithshëm profesionistëve gjuhësorë në institucionet qendrore të Republikës së Kosovës është gjithsej 48 profesionistë gjuhësorë, pra përkthyes dhe lektorë. Republika e Kosovës me kushtetutën e saj u ka dhënë shumë të drejta gjuhëve të pakicave kombëtare, veçanërisht pakicës serbe dhe turke.

Të drejtat gjuhësore në Republikën e Kosovës sigurohen përmes Kushtetutës, Ligjit për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës dhe ligjit për përdorimin e gjuhëve⁶⁹. Sipas këtyre dokumenteve ligjore, gjuha shqipe, gjuha serbe dhe alfabetet e tyre përkatëse gëzojnë status të barabartë dhe qytetarët e tyre kanë të drejtë në përdorimin e cilëndo prej tyre në marrëdhënie me institucionet publike të Kosovës⁷⁰. Për më tepër, gjuhëve të komuniteteve joshumicë mund t'u akordohet statusi i gjuhëve zyrtare, apo gjuhëve në përdorim zyrtar.

Ligji për përdorimin e gjuhëve parasheh:

- Gjuha shqipe dhe gjuha serbe dhe alfabetet e tyre janë gjuhë zyrtare në Republikën e Kosovës dhe kanë status të barabartë (neni 2.1);
- Gjuhët e tjera të komuniteteve, si gjuha turke, gjuha boshnjake, gjuha rome do të jenë gjuhë në përdorim zyrtar në nivel komunal, sipas kushteve të përcaktuara në këtë ligj (neni 1.2.);
- Përbërjen demografike të popullsisë së një komune të nevojshme për të vendosur një gjuhë të një komuniteti si gjuhë me statusin e gjuhës zyrtare apo në përdorim zyrtar. Në këtë mënyrë, nëse pjesëtarët e një komuniteti, gjuha amtare e të cilëve nuk është njëra nga dy gjuhët zyrtare dhe të cilët përbëjnë 5% të popullsisë së përgjithshme të komunës, gjuhës së tyre mund t'i akordohet njohja si gjuhë në nivel komunal (neni 2.3).
- Për shkak të “traditës”, gjuha turke ka statusin e gjuhës zyrtare në komunën e Prizrenit (neni 2.3).
- Të gjitha gjuhët zyrtare të komunës janë të barabarta me njëra-tjetrën (neni 7.1); të drejtën për të marrë shërbimet në dispozicion dhe dokumente nga institucionet komunale në cilëndo gjuhë zyrtare (neni 7.2); detyrim, që, sipas kërkesës, të ofrohen shërbime të përkthimit në të folur dhe për t'i vënë ato në dispozicion (neni 7.3); se të gjitha dokumentet zyrtare duhet të ruhen dhe nxirren në të gjitha gjuhët zyrtare të komunës (neni 7.6); se institucionet komunale duhet të sigurojnë një mjedis pune të favorshëm për përdorimin e cilëndo gjuhe zyrtare nga ana e stafit të tyre (neni 7.5).
- Të drejtën e personave që u përkasin komuniteteve gjuha e të cilëve është në përdorim zyrtar që të komunikojnë në institucionet publike të Republikës së Kosovës në gjuhën e tyre (neni 8.1. 8.2); rregulloret dhe aktet ndihmëse komunale duhet të nxirren dhe të publikohen në gjuhët e këtyre komuniteteve, nëse ata e kërkojnë (neni 8.3);

⁶⁸ tr.wikipedia.org/wiki/Gilan_Belediyesi

⁶⁹ Ligji për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës nr. 03/L-047.

⁷⁰ Ligji për përdorimin e gjuhëve {nr.02/L-37}, neni 2.2., Prishtinë (2006).

- Emrat zyrtarë të institucioneve e organeve komunale dhe shenjat që tregojnë emrat e komunave, fshatrave, rrugicave e vendeve tjera publike duhet të jenë të vendosura në gjuhët zyrtare që kanë statusin e gjuhës zyrtare në komunë (neni 9.1, 9.2);
- Institucionet e Republikës Kosovës në nivel komunal janë të obliguara që nëpërmjet akteve të tyre nënligjore të rregullojnë hollësisht përdorimin e gjuhëve, në përputhje me dispozitat e këtij ligji (neni 35).⁷¹

Qytetarët e Republikës së Kosovës kanë të drejtën e përdorimit të gjuhëve zyrtare në nivel lokal, ata mund ta përdorin cilëndo gjuhë zyrtare në komunat e vendit dhe institucionet gjegjëse komunale. Kurse sa i përket diskriminimi në baza gjuhësore në Republikën e Kosovës është i ndaluar dhe sanksionohet, si p.sh.: kur gjuha neglizhohet gjatë ofrimit të shërbimeve publike në administratë, organizatë ose ndërmarrje publike. Dihet botërisht se gjuhët luajnë rol kryesor në promovimin e dialogut ndërkulturor. Njohja e gjuhëve të ndryshme botërore forcon bashkëpunimin ndërshtetëror, ndërkulturor dhe ndërinstitutional dhe ne shumëgjuhësinë në vendit tonë e shohim si vlerë të çmuar për të cilën kemi punuar dhe po punojmë që të arrijmë rezultate të kënaqshme të funksionalizimit të mëtejshëm.

Sa i përket gjuhës zyrtare ajo është gjuha formale që përdoret në një shtet të caktuar. Gjuha zyrtare është një gjuhë e cila flitet nga të gjithë funksionarët e shtetit. Disa shtete si Kanadaja kanë dy gjuhë zyrtare: gjuhën angleze dhe gjuhën frënge dhe zakonisht një punonjës i punësuar në administratën e shtetit, i cili ka të bëjë me publikun, duhet të dijë të komunikojë, të flasë dhe të shkruaj, në të dyja këto gjuhë⁷². Kurse me "Gjuhë rajonale ose gjuhë e pakicës", nënkuptojmë gjuhët që janë përdorur në mënyrë tradicionale brenda një territori të caktuar të një shteti nga shtetasit e atij shteti, të cilët e formojnë një grup numerikisht më të vogël se pjesa tjetër e popullsisë së shtetit, nuk i përfshinë as dialektet e gjuhës (gjuhëve) zyrtare të shtetit dhe as gjuhët e shtegtarëve; "territori në të cilin përdoret gjuha rajonale apo e pakicës" nënkupton zonën gjeografike në të cilën gjuha në fjalë është mënyra e shprehjes së një numri të njerëzve, që justifikon marrjen e masave të ndryshme mbrojtëse dhe mbështetëse të parashikuara në këtë kartë; "gjuhët joterritoriale" nënkupton gjuhët e përdorura nga shtetasit e shtetit, të cilat ndryshojnë nga gjuha ose gjuhët e përdorura nga pjesa tjetër e popullsisë së shtetit, por që ndonëse të përdorura në mënyrë tradicionale brenda territorit të atij shteti nuk mund të identifikohen me një vend të caktuar⁷³.

Përfundim

Qytetarët e Republikës së Kosovës kanë të drejtë të përdorin njërin nga gjuhët zyrtare gjatë shërbimeve që pranojnë gjatë përkujdesjes shëndetësore, si në sportelet e informimit, faturat nga kompanitë publike, aplikimet dhe dokumentet e tjera të ngjashme, që ofrojnë institucionet publike, aplikimet në qendrat sociale, aplikimet për punë, kërkesat për hapje biznesi, kërkesa për çështje sociale e urbane, kërkesa dhe ankesa në zyrat e Policisë së Kosovës, në zyrat Forcës së Sigurisë së Kosovës, në Postën e Kosovës, regjistrimin e veturës, regjistrimin pronës, regjistrimin e biznesit, informacionet në stadione dhe palestra sportive, aeroporte, autostrada, etj. Institucionet e Republikës së Kosovës që nga themelimi i tyre kanë qenë të obliguara që në të njëjtën kohë t'i publikojnë të gjitha informacionet publike në formë elektronike dhe të shtypur në gjuhët zyrtare të kuvendeve komunale dhe kjo ka funksionuar me përpikëri. Gjithashtu një rol të rëndësishëm dhe shumë profesional ka luajtur Kuvendi i Republikës së Kosovës, por edhe ministria e Administratës dhe Pushtetit Lokal pasi e ka

⁷¹ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2440>, f. 2.

⁷² https://sq.wikipedia.org/wiki/Gjuha_zyrtare.

⁷³ Karta Evropiane për Gjuhët Rajonale ose Minoritare Strasbourg, më 5.11.1992.

Materialet e punimeve (proceedings)

ISBN: 978-1-78911-007-4

pasur gjithmonë në prioritet përdorimin e gjuhëve si një prej kushteve që duhet përmbushur komunat për t'i kontribuar zbatimit të programit kombëtar për MSA-në, në mënyrë që kjo çështje të zbatohet shumë seriozisht në nivel lokal. Sa i përket Ligjit për gjuhët Kosova është shumë para shteteve të rajonit, pasi garantohet që në së paku 5% të komuniteteve jo shumicë gjuha e tyre të ketë statusin zyrtar në komunë. Dhe kur themi se ne jemi para shumë shteteve të rajonit me Ligjin e gjuhëve e argumentojmë me faktin se në Maqedoninë e Veriut ligji për gjuhët parasheh diçka tjetër, pasi gjuhë zyrtare mund të jetë vetëm ajo gjuhë që e flasin mbi 20 % e qytetarëve. Kurse Ligji për gjuhët i Republikës së Kosovës e ka bërë një “lëshim” dhe një gjë të tillë, një term të tillë nuk e kam hasur në hulumtimet tona. Pra ky ligj, po e citoj: Për shkak të “traditës”, gjuha turke ka statusin e gjuhës zyrtare në komunën e Prizrenit (neni 2.3), Ligji për gjuhët. Komuniteti turk në Prizren nuk i arrin as 5% të numrit të përgjithshëm të pakicave kombëtare, por ligji për gjuhët e favorizon këtë komunitet me termin: për shkak të “traditës” që në linguistikë është term i ri dhe i cili e arsyeton gjuhën turke si gjuhë zyrtare në Komunën e Prizrenit, prandaj me të drejt themi se shumëgjuhësia dhe të drejtat gjuhësore në Republikën e Kosovës janë avancuar dhe respektuar më shumë se në çdo vend të rajonit.

Literatura

Fjalor i shprehjeve parlamentare dhe ligjore, OSBE, Prishtinë, 2005.

Kasumaj, Sylë, *Fjalor i termave të drejtësisë*, IAP, Prishtinë, 2019.

Karta Evropiane për Gjuhët Rajonale ose Minoritare Strasbourg, më 5.11.1992

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Prishtinë, 2008.

Ligji për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës nr. 03/L-047.

Ligji për përdorimin e gjuhëve {nr.02/L-37}, Prishtinë, 2006.

Monitorimi dhe vlerësimi i të drejtave gjuhësore, Republika e Kosovës, Prishtinë, 2015.

org/wiki/Opština_Zubin_Potok

<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2440>.

<http://www.opstinazvecan.rs/>

<https://kk.rks-gov.net/dragash/>

<https://kk.rks-gov.net/peje/>

<https://kk.rks-gov.net/prizren>

<https://kk.rks-gov.net/istog/>

https://sq.wikipedia.org/wiki/Gjuha_zyrtare

kk.rks-gov.net/mnao/?lang=sr-Latn-CS

kk.rks-gov.net/mnao/?lang=sr-Latn-CS

kk.rks-gov.net/prizren/default.aspx?lang=tr-TR

tr.wikipedia.org/wiki/Priştine_Belediyesi

tr.wikipedia.org/wiki/Mamuşa_Belediyesi

tr.wikipedia.org/wiki/Gilan_Belediyesi

Leksiku dialektor në faqet e revistës “Gjuha shqipe”, mundësi për pasurimin e shqipes standarde

PROF. ASOC. DR. ABDURRAHIM MAXHUNI
Instituti Albanologjik, Prishtinë

Abstrakt

Gjuha e ruajtur në gojën e popullit është pasuri e çdo populli. Aty më së miri jeton mendësia, aty më së miri ruhen kultura e tradita e një populli. Dialektet kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë burim kryesor i pasurimi të gjuhës standarde. Duke e parë rëndësinë e dialekteve, gjuhëtarët historikisht janë kujdesur të mbledhin fjalë e shprehje dialektore, për t’i ruajtur nga zhdukja dhe për të shërbyer si mundësi për pasurimin e gjuhës standarde. Përveç mbledhjes së materialit leksikor, janë bërë studime dialektore pothuajse për pjesën më të madhe të të folmeve të të dy dialekteve të shqipes, janë botuar monografi e fjalorë dialektorë, janë mbajtur konferenca e janë botuar akte të konferencave. Instituti Albanologjik, në Prishtinë, me rastin e themelimit të revistës së saj “Gjuha shqipe”, më 1982, në mesin e rubrikave të saj, rëndësi të veçantë i ka kushtuar leksikut dialektor. Si rezultat i kësaj, në faqet e kësaj reviste janë botuar 74 njësi bibliografike, duke përfshirë qindra fjalë e shprehje dialektore, të cilat mund të shfrytëzohen për pasurimin e Fjalorit shpjegues të shqipes. Në këtë kumtesë, do të shpërfaqim pjesë nga pasuria dialektore e botuar në këtë revistë.

Fjalët kyçe: *fjalë, shprehje, dialekt, pasurim, shqipe standarde.*

Hyrje

Është e njohur se burim kryesor i pasurimit të gjuhës standarde janë dialektet, të cilat në vazhdimësi e ushqejnë me fjalë e shprehje të krijuara dhe të ruajtura më së miri në gjuhën e popullit. Duke u nisur nga ky fakt i pamohueshëm, gjithnjë shtrohet nevoja që të vjelët materiali leksikor, ajo pjesë që nuk është vjelë ende, nga dialektet e të folmet, me qëllim të ruajtjes, e të përpunimit dhe të shihet mundësia e përfshirjes në leksikon e përgjithshëm të gjuhës, në bazë të valencave kuptimore, dendurisë së përdorimit etj. Në historinë e gjuhësisë shqiptare, vazhdimisht i është kushtuar rëndësi e veçantë mbledhjes së leksikut dialektor, qoftë nga nismat individuale, apo edhe grupore, si dhe nëpërmjet organizimit të ekspeditave kërkimore-shkencore, veprimtari e cila ka kohë që është ndërprerë. Megjithatë, puna për mbledhjen e thesarit leksikor ka vazhduar në forma të ndryshme dhe rezultatet e mbledhjes janë paraqitur në fjalorë dialektorë, në botime të veçanta, me rastin e studimit të të folmeve të ndryshme, e që janë dhjetëra të tillë, në konferenca e përmes botimit në revista të ndryshme shkencore. Materialet e mbledhura në terren kanë zënë vend të madh në revistën “Gjuha shqipe”. Revista “Gjuha shqipe”, organ i Institutit Albanologjik, në mesin e shumë rubrikave, një rubrikë i ka kushtuar materialit leksikor, ose fjalës së rrallë shqipe. Që nga themelimi i saj, më 1982 e deri më sot janë botuar 74 njësi bibliografike, nga treva të ndryshme shqipfolëse, duke përfshirë *Rugovën, Pejën, Ulqinin, Kumanovën, Podrimen, Syriganin, Rahovecin, Llapin, Opojën, Anën e Malit, Petreshicën, Postribën, Malësin e Plavës dhe të Gucisë, Anamoravën, Gjakovën, Kërçovën, Prizrenin, Dervenin etj.* Kryesisht janë botuar materiale nga areali i gegërishtes. Materiali i botuar në faqet e revistës “Gjuha shqipe” mund të kalfisikohet në *fjalë, frazeologji dhe toponimi*. Duke u nisur nga numri i madh i leksikut dialektor i botuar në faqet e revistës në fjalë, materiali i botuar mund të shërbejë për pasurimin e Fjalorit të Madh, i

Materialet e punimeve (proceedings)

ISBN: 978-1-78911-007-4

cili po përgatitet nga Akademia e Shkencave dhe Institutet. Andaj, punonjësit shkencorë të Insitutiti Albanologjik si bashkëpunëtorë e hartues të këtij Fjalori kanë mbledhur këtë leksik, duke e materializuar në formë elektornike dhe e kanë dërguar në redaksinë e Fjalorit, për të përzeqjdhur fjalë e shprehje, të cilat do të mund të përfshiheshhin në Fjalorin e Madh.

Materiali i botuar mbulon fusha të ndryshme, kryesisht të botës materiale të anëve nga është vjelë, mirëpo shtresa leksikore e pasqyruar nuk është në përpjestim, disa fusha mbulohen më tepër sesa disa të tjera, varësisht nga orientimi i popullsisë së vendeve nga është vjelë. Fjalësi më i pasur del nga fusha e bujqësisë, e blektorisë, e veshëmbjathjes, e mejteve të ndryshme, e emërtimeve të ndryshme, në mesin e të cilave edhe ato pezhorative. Duke u nisur nga natyra e kumtesës, që nuk lejojnë hapësirë për ta paraqitur në mënyrë të hollësishme të gjithë fjalësinë e botuar, në vazhdim mund të përmendim disa shtresa leksikore, të cilat mendojmë se janë më të pasura dhe janë me interes.

Fusha e emërtimeve të mjeteve të punës del mjaft e pasur, e motivuara semantikisht dhe e formuara sipas frymës popullore, e cila bart bukurinë e ligjërimit të folur popullor. Nga kjo fushë tematike dalin emërtime të veglave të punës bujqësore e të veglave shtëpiake, të kuzhinës etj., si:

piçangí – a.f. shkop dygrremç që shërben për të tërhequr enën nga zjarri.

bacung -a, f.sh. -a, -at mjet prej druri në të cilin mbahet ujë.

bizga – i m.sh. -a, -at zgavër druri apo skutë e errët në të cilën lihen gjëra të vjetra.

lysor/e -ja f.sh. -e, -t dërrasë rrafshuese që shërben për të rrafshuar llaçin gjatë lyerjes së mureve.

thumat, m. sh. -a, -at mjeti prej druri me majë të mprehtë e të holluar, që përdoret për të zhveshur misër.

cakorr/e, -ja f. sh. -e, -et sopatë e vogël.

ferrasht, -i m. sh. mjet që përdoret për të mbledhur thërrimet e bukës.

kacerr/e, -ja f.sh. -e, -et sopatë e vogël.

lugor/e, -ja f.sh. -e, -et enë e vogël druri për kripë.

borrël, qysqi, tokmak i trashë hekuri.

kamx/ë -a. f. sh. -a, -at. dy shkopinj në formë të kërra-bës, me të cilët fëmijët kalojnë ujin, që nuk është shumë i thellë.

gjoc/ë, -a f. sh. -a, -at mjet i vogël, i punuar nga druri dydegësh, me llastikë anash, me të cilin fëmijët i gjuajnë me gur zogjtë.

frúshk/ë, ~a f.sh.a, ~at thikë e madhe.

malúg/e, -a f. sh. -a, -at lugë e madhe druri për të përzier kaçamakun.

Fusha e bujqësisë

Edhe fusha e bujqësisë del mjaft e pasur në materialet e botuara në revistë. Ndonëse shumica e kësaj shtrese leksikore përbëhet nga emërtimet për sende konkrete, siç janë emërtime për tokën e veglat e punës, ka edhe fjalë të cilësisë e të veprimit, emërore, mbiemërore e foljore. Vend të veçantë zënë edhe emërtimet e tokës sipas përmbajtjes, konfiguracionit, ngjyrës, lagështisë e thatësisë etj. Emërtimet e fjalëve, si ato për sende e objekte, ashtu edhe ato të proceseve të punës që lidhen me këtë fushë tematike, janë bërë në rrugë të ndryshme, sipas karakteristikave të zonave të caktuara popullore. Nga kjo fushë mund të sjellim këta shembuj:

ndrrojç, -i m. sh. -a, -at një dru me dorëz nja 20 cm, që shërben për të çelur bira në tokë për të mbjellë fidane.

kashtaline, -i m.sh. – a, t mbeturinat e kashtës në lëmë e gjetkë.

Materialet e punimeve (proceedings)**ISBN: 978-1-78911-007-4***mellishtë* f. tokë e bardhë e mirë.*kuqisht/ë*, -a, f.sh. -a, -at tokë e kuqe.*gërtuçe* m. ara të mbjella me misër.*renisht/ë*. -a f. tokë me rërë.*bunc/ë*, ~ a f. sh. ~a, ~at. Copë-dheu e pashkrifët që mbetet pasi të lëvrohet toka.*cokin/ë*, -a tokë me gurë të imët.*copór/e*, ~ja f.sh. ~e, ~et. Vegël bujqësore prej metali, me bisht të gjatë në formë shpatuke. Në anën e poshtme ka llapë të mprehtë, ndërsa në anën e sipërme dy gremça. Përdoret zakonisht për prashitje.*halí*, ~ja f.sh. ~i, ~itë. tokë e askujt.*muq*, ~i m.sh. ~e, ~et. grumbull i vogël sane që vihet nëpër ara dhe qëndron aty, deri të bartet e të vihet mullari.*civere* -ja f.sh. -e, -et, dy shtaga mbi të cilat vihet bari i kositur për ta bartur.**Emërtimet e kafshëve**

Terrenet e mira e të përshtatshme për mbajtjen e kafshëve, si dhe një ndër ekonomit familjare më të zhvilluara ka ndikuar që blektoria të zhvillohet dhe në të njëjtën kohë të pasurohet me fjalë. Thuajse çdo familje, në pjesët rurale ka mbajtur kafshë shtëpiake. Emërtimet për kafshë janë bazuar në ngjyrën e turpit, formën e brirëve, formën e veshëve, shenjat në ballë, madhësinë e trupit etj. Si rezultat, kanë dalë emërtime interesante dhe formime të pasura leksikore për këtë fushë, si:

kapric/ë -a f. lopë me brirë të hapur.*luloj/ë*, -a f. ka me njollë të bardhë në krye.*malloj/ë* -a f. ka me krye të madh e me brirë të hapur.*murroj/ë*, -a f. ka i murrmë.*rrnok-i* m. qengj njëvjeçar.*kllaposh/ë*, f.sh., -a, -at dhi pa brirë.*korbush/ë*, f. sh. -a, -at lopë me qime ,të zeza si korbi, emërtim ky i ndërtuar mbi bazën krahasimtare me korbin.**Njësitë frazeologjike**

Shprehjet frazeologjike përbëjnë një pasuri të madhe për gjuhën shqipe. Duke pasur një rrugë të gjatë zhvillimi, ato janë tregues i zakoneve, shprehive e ndjenjave të shumta për çështje të ndryshme jetësore të brezave të tërë, duke përfshirë: lindjen, jetën, vdekjen, punën, dashurinë, urrejtjen, pleqërinë e fusha të tjera që lidhen me botën shpirtërore e materiale të njeriut. Dialektet dhe të folmet mbesin burim i madh krijues dhe njëkohësisht pasurues i fondit frazeologjik të shqipes. Ndërmjet ligjërimiave e stileve të gjuhës letrare shqipe ka ndryshime nga mënyra e përvetësimit të njësisve frazeologjike të gjuhës së folur, nga mënyra e krijimit të njësisve frazeologjike të reja sipas gjedheve popullore, nga mjetet dhe tipat strukturorë që pasurojnë fondin e frazeologjisë në përputhje me kërkesat e ligjërimin e të stilit.⁷⁴

Në faqet e revistës “Gjuha shqipe” janë botuar njësi frazeologjike të trevave të ndryshme, të cilat padyshim janë një pasuri e madhe dhe me vlera potenciale për t’u përfshirë edhe në Fjalorin e Madh të shqipes. Klasifikimi i këtyre njësisve bëhet në bazë të strukturës e nga vlera leksiko-gramatikore: me vlerë emërore, mbiemërore, foljore, ndajfoljore dhe nga shkalla e motivimit.

⁷⁴ Jani Thomai, *Çështje të frazeologjisë së gjuhës shqipe*, 1981, Tiranë, f. 53.

Materialet e punimeve (proceedings)

ISBN: 978-1-78911-007-4

I ka cofë morri – s’ka autoritet.*I ka ra shi n’kallamoq* – i kanë ardhur punët mirë.*I ka kcy kandari*- është bërë nervoz.*Ja di zorrt e barkut* – ia di të gjitha punët, e njeh mirë.*Me ça drrasa* - të flasësh kot.*Me ja dhan rrugt* – të ndahesh.*Me ja mbush vesht* – i flas, e bindi për të keq dikë.*Dasma në katund, dajret n’shehër* – gjëra të largëta që i parashikojmë që për t’i realizuar është e pamundur.*Sot laget, n’mot rruhet* – dembel i madh.*Tue gjujt lepurin e vret zagarin* – nuk është i zoti për asgjë.*I mathë patkojt pa thuma* - është njeri shumë i zoti.*Ka rënë në brazdë* - ka bërë kthesë, ka rënë në hulli, ka rënë në rrugë.*Është bërë gisht* - është ligështuar nga shëndeti.*I kanë rënë trutë në qafë* - për dikë që është matufosur, e nuk di ç’flet”.*Iku me bisht ner kam* - iku i turpëruar e kokulur.*Dardha e ka bishtin përmas* - çdo punë lë gjurmët e veta, ka pasojat e saj.*Sillu okolla dardhës t’ahmatit* - punë që s’bëhet, punë që s’mund të realizohet, punë e kotë.*Asht i huntit e i konopit* - është njeri ngatërrestar, është belaxhi.*Hini lankave* - zakonisht thuhet për dikë, që nuk e zgjedh bisedën e futet andej kah nuk i përket ose që nuk i lejohet të thuhet në një situatë të caktuar.*Mos e shtin therrën n’kam t’shnosh* - mos krijo probleme pa nevojë.*la kam hangër kokrrat* - e kam nënshtruar.

Leksiku toponimik

Toponimet me format e tyre të ngurosura janë më të qëndrueshme sesa fjalët e leksikut të përgjithshëm, dhe si të tilla paraqesin material me interes si për gjuhësinë ashtu edhe për historinë. Ndonëse kjo fushë në revistë mbulohet pak, këtu mund të përmendim pjesë nga ky leksik i botuar në faqet e revistës “Gjuha shqipe”. Shumë nga toponimet kanë si bazë emrat si *ara, bunari, fusha, guri, kepi, kodra, livadhi, kroi, lëndina, lisi, lugu, mullini, përroi* etj.

Ara Azemit, Ara Vathit, Bunari i Demës, Fusha Seçishtës, Kepat e Çobanve, Kepi Kozarit, Kodra Lisit, Kodra Pashës, Kroji Brijës, Livadhet Kadis, Lugi Melishtës (Fadil Curri).

Ara e Pojatës, Arat Haroze, Bari Gat, Bungishta, Dushkaja, Guri Madh, Kodra e Dushçeve, Kroni i Barit t’Gatë, Lugi Shtogave, Vorret e Mërtajës (Isuf Musliu).

Në mesin e këtyre toponimeve, përveç emërtimeve me burim shqiptar, si: *Ara e Pojatës, Bari Gat, Drishta, Dushkaja, Guri Madh, Kodra e madhe, Kroni Ftoft, Kroni Pulës, Zabeli Dashlakve*, dalin edhe toponime me burim sllav, si: *Arrnicat, Blegicat, Lipovica, Prrocka e Karitës* etj., si dhe toponime të përziere, si: *Jazbinat e Mavës, Llaza Avdisë, Prrocka e Karitës* etj.

Në vend të përfundimit

Leksiku dialektor, i shprehur me fjalë e njësi frazeologjike është me interes për dialektologjinë leksikore, dhe si i tillë paraqet rëndësi të veçantë. Në gjirin e popullit ruhen më së miri fjalët e burimit shqip, të cilat zbulojnë shumë për mendësinë, traditat e zakonet e shqiptarëve. Si të tilla, duhet të gjurmohen, të evidentohen dhe të botohen, në mënyrë që të ruhen nga zhdukja. Ky leksik përveç bukurisë që bart në formimin e tij, mund të shërbejë edhe për pasurimin e Fjalorit të Madh të Shqipes. Këtu kemi paraqitur vetëm një pjesë të

Materialet e punimeve (proceedings)

ISBN: 978-1-78911-007-4

vogël të korpusit të prëgjithshëm të leksikut dialektor në botuar në faqet e revistës “Gjuha shqipe”, që do të mund të shërbej edhe për të gjithë ata që merren me studimin e dialekteve.

Njësitë bibliografike të botuara në rubrikën Fjalë e rrallë shqipe

1. Afërdita Abdullahi Dërmaku, *Njësi frazeologjike nga Rrafshi i Dukagjinit*. – 2022, nr. 2-2022, f. 99-104.
2. Ahmet Maloku, *Fjalë të rralla nga disa katunde të Kosovës*. – 1984, nr. 2-1984, f. 45-46.
3. Ali Cenaj, *Fjalë e shprehje të rralla nga rrethi i Ulqinit*. – 1984, nr. 3-1984, f. 38-41.
4. Ali Cenaj, *Fjalë e shprehje të rralla nga rrethi i Ulqinit*. – 1985, nr. 1-1985, f. 37-41.
5. Ali Cenaj, *Fjalë e shprehje të rralla nga rrethi i Ulqinit*. – 1985, nr. 2-1985, f. 37-41.
6. Avdyl Sula, *Fjalë dhe shprehje popullore*. – 2008, nr. 1-2008, f. 73-100.
7. Avni Dehari, *Fjalë të rralla në rrethinat e Kumanovës*. – 2007, nr. 3-2007, f. 81-90.
8. Bahtijar Kryeziu, *Toponimia e fshatrave Kranidell dhe Sedllar të Hashanisë*. – 1990, nr. 1-1990, f. 42-58.
9. Destan Bajraktari, *Fjalë të rralla nga treva e Podrimes*. – 1983, nr. 1-1983, f. 23-24.
10. Fadil Curri, *Toponimia e Hanit të Elezit*. – 2017, nr. 3-2017, f. 79-100.
11. Fadil Sulejmani, *Fjalë popullore nga Malësia e Sharrit të Tetovës*. – 1983, nr. 2-1983, f. 26-29.
12. Faton Krasniqi, *Kontributi i prof. dr. Anton Pançevit për albanologjinë*. – 2020, nr. 3-2020, f. 115-123.
13. Feriz Shaban Seferaj, *Njësi frazeologjike nga fshati Syriganë i komunës së Istogut*. – 2000, nr. 1-2, 2000, f. 69-70.
14. Fetah Berisha, *Fjalë të rralla nga Podrimja*. – 1988, nr. 1-1988, f. 51.
15. Fetah Berisha, *Fjalë të rralla nga Podrimja*. – 1989, nr. 2-1989, f. 85-86.
16. Fridrik Dulaj, *Fjalë të së folmes së Rahovecit me rrethinë*. – 2017, nr. 3-2017, f. 51-78.
17. Gani Ahmeti, *Fjalë të rralla nga treva e Llapit*. – 1989, nr. 1-1989, f. 67-71.
18. Hajrip Koçinaj, *Fjalë e shprehje të së folmes së Opojës*. – 2015, nr. 1-2015, f. 125-180. Hajrip Koçinaj, *Fjalë e shprehje të së folmes së Opojës*. – 2015, nr. 2-2015, f. 101-151.
19. Hajrip Koçinaj, *Fjalë e shprehje nga e folmja e Opojës*. – 2014, nr. 2-2014, f. 113-165. Hajro Ulqinaku, *Fjalë të rralla të rrethinës së Ulqinit*. – 2006, nr. 3-2006, f. 72-94.
20. Hajrip Koçinaj, *Fjalë të mbledhura nga gurra popullore në Opojë*. – 2016, nr. 2-2016, f. 113-124.
21. Halil Bogaj, *Material leksikor nga Drenica*. – 1984, nr. 2-1984, f. 40-44.
22. Halil Bogaj, *Fjalë e shprehje të rralla nga Drenica*. – 1984, nr. 3-1984, f. 35-37.
23. Halil Bogaj, *Fjalë e shprehje të rralla nga Drenica*. – 1985, nr. 1-1985, f. 32-36.
24. Haxhi Shabani, *Fjalë e shprehje të rralla nga Ana e Malit*. – 1988, nr. 3-1988, f. 63-67.
25. Haxhi Shabani, *Frazeologjizma nga Ana e Malit*. – 1989, nr. 1-1989, f. 72-76.
26. Ibrahim Goçi, *Material leksikor nga krahinat*. – 1989, nr. 3-1989, f. 86-89.
27. Ibrahim Goçi, *Material leksikore të krahinave të ndryshme*. – 1982, nr. 1-1982, f. 39-41.
28. Ibrahim Goçi, *Termet e huaj t'i zëvendësojmë mundësisht me ata të shqipes*. – 1983, nr. 2-1983, f. 30.
29. Instituti Albanologjik i Prishtinës, *Ligj për përdorimin publik të gjuhës shqipe*. – 2015, nr. 3-2015, f. 163-171.
30. Isuf Musliu, *Toponimia e Petreshticës*. – 2011, nr. 1-2011, f. 113-122.
31. Isuf Musliu, *Leksiku i Petreshticës*. – 2011, nr. 2-2011, f. 97-117.
32. Majlinda Bushaj, *Fjalë e shprehje popullore nga e folmja e gegërishtes veriperëndimore (krahina e Postribës)*. – 2017, nr. 2-2017, f. 87-106.
33. Majlinda Bushaj, *Fjalorth i njërive frazeologjike në krahinën e Postribës*. – 2020, nr. 2-2020, f. 113-132.
34. Mehmet Ahmetaj, *Material leksikor nga Malësia e Plavës dhe e Gucisë*. – 1983, nr. 1-1983, f. 25-28.
35. Mehmet Ahmetaj, *Fjalë e shprehje popullore dhe disa eufemizma*. – 1984, nr. 1-1984, f. 37-39.
36. Mehmet Ahmetaj, *Material leksikor nga krahinat*. – 1985, nr. 3-1985, f. 41-43.
37. Mehmet Ahmetaj, *Fjalë e shprehje të rralla nga krahinat*. – 1986, nr. 1-1986, f. 65-66.
38. Mehmet Ahmetaj, *Fjalë e shprehje të rralla*. – 1986, nr. 3-1986, f. 43-49.

39. Mehmet Ahmetaj, *Frazeologjizma nga krahina e Plavës dhe e Gucisë*. -1987, nr. 2-1987, f. 65-67.
40. Mehmet Ahmetaj, *Fjalë e shprehje të rralla nga krahinat*. -1987, nr. 3-1987, f. 63-65.
41. Mehmet Ahmetaj, *Fjalë e shprehje të rralla nga krahinat*. -1988, nr. 2-1988, f. 68-69.
42. Mehmet Ahmetaj, *Frazeologjizma nga krahinat e Plavës dhe e Gucisë*. -1988, nr. 3-1988, f. 68-72.
43. Mehmet Ahmetaj, *Fjalë e shprehje të rralla nga krahinat*. -1989, nr. 1-1989, f. 65-66.
44. Mehmet Ahmetaj, *Fjalë e shprehje të rralla nga krahinat*. -1989, nr. 3-1989, f. 84-85.
45. Mehmet Ahmetaj, *Frazeologjizma nga krahina e Plavës dhe e Gucisë*. -1988, nr. 1-1988, f. 52-54.
46. Mehmet Ahmetaj, *Fjalë e shprehje të së folmeve shqipe në Mal të Zi*. -1998, nr. 1-1998, f. 54-57.
47. Mehmet Halimi, *Disa shprehje frazeologjike të Anamoravës*. -1988, nr. 2-1988, f. 70-77.
48. Mehmet Halimi, *Material leksikor nga krahinat*. -1988, nr. 3-1988, f. 59-62.
49. Miço Samara, *Treguesi i fjalëve antonime (I)*. -1986, nr. 3-1986, f. 83-93.
50. Miço Samara, *Treguesi i fjalëve antonime (II)*. -1987, nr. 3-1987, f. 89-101.
51. Naim Berisha, *Material leksikor nga Gjakova me rrethinë*. -2011, nr. 3-2011, f. 129-142.
52. Naim Berisha, *Material leksikor nga rrethinat e Gjakovës*. -2012, nr. 2-2012, f. 93-120.
53. Qemal Murati, *Fjalë të rralla nga treva e Kërçovës*. -1983, nr. 3-1983, f. 43-48.
54. Qemal Murati, *Frazeologjizma dhe shprehje të tjera nga goja e popullit*. -1986, nr. 2-1986, f. 53-63.
55. Qemal Murati, *Fjalë e shprehje të rralla nga krahinat*. -1986, nr. 2-1986, f. 65-66.
56. Qemal Murati, *Material leksikor nga krahinat*. -1987, nr. 2-1987, f. 62-64.
57. Qemal Murati, *Fjalë dhe shprehje nga krahina e Hasit të Prizrenit*. -2005, nr. 3-2005, f. 67-75.
58. Redaksia, *Emra njerëzish mbi bazën e gjuhës shqipe* [Marrë nga “Fjalor me emra njerëzish”, Tiranë, 1982]. -1984, nr. 3-1984, f. 53-57.
59. Redaksia, *Emra njerëzish mbi bazën e gjuhës shqipe*. [Marrë nga “Fjalor me emra njerëzish”, Tiranë, 1982]. -1985, nr. 1, f. 51-56.
60. Redaksia, *Emra njerëzish mbi bazën e gjuhës shqipe* [Marrë nga “Fjalor me emra njerëzish”, Tiranë, 1982]. -1985, nr. 2-1985, f. 52-64.
61. Redaksia, *Fjala shqipe në vend të fjalës së huaj* [Ribotim nga “Gjuha jonë” 1983, nr. 3]. -1985, nr. 3-1985, f. 72-78.
62. Redaksia, *Emra njerëzish mbi bazën e gjuhës shqipe* [Marrë nga “Fjalor me emra njerëzish”, Tiranë, 1982]. -1985, nr. 3-1985, f. 79-91.
63. Redaksia, *Fjala shqipe në vend të fjalës së huaj*. [Marrë nga “Gjuha jonë” 1982, 1, 2]. -1986, nr. 1-1986, f. 57-63.
64. Redaksia, *Emra njerëzish mbi bazën e gjuhës shqipe*. [Marrë nga “Fjalor me emra njerëzish”, Tiranë, 1982]. -1986, nr. 1-1986, f. 79-93.
- Redaksia, *Emra njerëzish mbi bazën e ilirishtes*. [Marrë nga “Gjuha jonë” 1982, 1, 2] -1986, nr. 2-1986, f. 79-94.
65. Redaksia, *Fjala shqipe në vend të fjalës së huaj*. [Marrë nga “Gjuha jonë” 1982, 1, 2] -1986, nr. 2-1986, f. 47-52.
66. Redaksia, *Fjala shqipe në vend të fjalës së huaj* (marrë nga “Gjuha jonë” 1/1983). -1986, nr. 3-1986, f. 76-82.
67. Redaksia, *Fjala shqipe në vend të fjalës së huaj*. [Marrë nga “Gjuha jonë” 1984, 2]-1987, nr. 2-1987, f. 59-61.
68. Redaksia, *Fjala shqipe në vend të fjalës së huaj*. [Marrë nga “Gjuha jonë” 1984, 2]-1987, nr. 2-1987, f. 59-61.
69. Redaksia, *Fjala shqipe në vend të fjalës së huaj*. (Marrë nga “Gjuha jonë” 1987/1) -1988, nr. 3-1988, f. 54-58.
70. Redaksia, *Fjala shqipe në vend të fjalës së huaj*. (Marrë nga “Gjuha jonë” 2/1987). -1989, nr. 1-1989, f. 49-53.
71. Redaksia, *Fjala shqipe në vend të fjalës së huaj* (Marrë nga “Gjuha jonë”, 1989/4). -1990, nr. 1-1990, f. 35-37.
72. Remzi Nesimi, *Fjalë të rralla nga e folmja e Dervenit*. -1989, nr. 2-1989, f. 81-84.
73. Sejdi Gashi, *Materialle onomastike nga treva e Istogut*. -2020, nr. 2-2020, f. 1010-112.

Pasurimi i strukturës sintaksore të shqipes me dukuri e mjete shprehëse

PROF. ASOC. MIMOZA ZEKAJ
Universiteti i Gjirokastrës

Abstrakt

Gjuha letrare ka arritur një shkallë të lartë përsosje e zhvillimi në ditët e sotme. Ndikim parësor në këtë zhvillim luan rrafshi sintaksor, i cili ndikon drejtpërdrejt në intelektualizimin e saj të mëtejshëm, nëpërmjet përsosjes e pasurimit me mjete e dukuri të reja shprehëse. Rol të rëndësishëm në këtë proces luajnë shkrimtarët.

Në këtë punim kemi bërë objekt dukurinë sintaksore të “parcelizimit” ose “copëzimit”, si një nga mënyrat më efektive të sintaksës ekspresive, e përdorur me mjeshtëri në krijimtarinë letrare të F. Kongolit.

Me parcelizimin ose copëzimin shkëputen më vete fjali ose gjymtyrë, fjali të mëvetësishme, fjali të përbëra të lidhura ngushtë me fjalitë e mëparshme. Në shumë përdorime kjo dukuri ka sjellë ndarjen e frazave në një ose disa fjali të nënrenditura, në një a disa fjali të bashkërenditura, ose duke dalë të shkëputur disa ose një gjymtyrë fjalie.

Përdorimi, vlera, mundësitë që ka krijuar kjo dukuri, kanë bërë që gjuha e përdorur nga ky autor, herë si ligjërim i personazheve, herë si ligjërim i autorit, të jetë mjaft e larmishme.

Parcelizimi krijon mundësi që ligjërimi të jetë më elastik, më i zhdërvjellët, më pranë qëllimit të autorit, duke anashkaluar disa skema të ngurta e të zakonshme. Sot kjo dukuri shprehëse ka marrë një përhapje të gjerë,

Fjalët kyçe; *gjuhë, pasurim, strukturë sintaksore, dukuri, shprehëse.*

Gjuha letrare ka arritur një shkallë të lartë përsosje e zhvillimi në ditët e sotme. Ndikim parësor në këtë zhvillim luan rrafshi sintaksor, i cili ndikon drejtpërdrejt në intelektualizimin e saj të mëtejshëm, nëpërmjet përsosjes e pasurimit të strukturës sintaksore me mjete e dukuri të reja shprehëse.

Sintaksa është rrafshi i lidhur më shumë, më drejtpërdrejt me funksionin themelor të gjuhës si realizuese dhe shprehëse e mendimit dhe si mjet komunikimi i një shoqërie të caktuar⁷⁵. Është një nga rrafshet e saj, që nëpërmjet zhvillimit të strukturës sintaksore e bën gjuhën më të aftë për të shprehur mendime komplekse e abstrakte dhe për të dhënë në mënyrë sa më të saktë raporte të ndryshme sintaksore e ngjyime të tyre.

Sintaksa është ajo pjesë themelore e gjuhës, që pothuajse ashtu si leksiku, është e ndjeshme ndaj ndryshimeve historike, shoqërore e kulturore të një populli, ndaj lëvizjeve mendore e përparimit të ideve në përgjithësi, prandaj ajo është në zhvillim të pandërprerë⁷⁶. Struktura e fjalisë dhe e frazës është bërë shumë më e zhdërvjellët dhe e larmishme, por edhe më e ndërlikuar e me mundësi të shumta për të shprehur edhe format më abstrakte të mendimit dhe ndjenjat më të holla njerëzore.

Rol të rëndësishëm në këtë proces luajnë shkrimtarët. Me një shumësi metodash e provash gjuhësore kanë mundësuar lexime e trajtime të ndryshme, kanë mundësuar interpretime, shpjegime gjuhësore e stilistike me interes, të cilat kanë ndihmuar jo vetëm të kuptuarit më të plotë të një vepre letrare, po edhe dekodimin më të hollë të mesazheve të saj.

⁷⁵ Domi, M., “Dukuri të zhvillimit të strukturës sintaksore të gjuhës sonë letrare të sotme”. *SF*, 4, 1984, f. 59.

⁷⁶ Mansaku, S., “Zhvillime të strukturës sintaksore të shqipes dhe norma”. *SF*. 3-4, 2002, f. 43.

Trajtimet e tilla zakonisht fillojnë me hetimin e veçantive në rrafshet e ndryshme gjuhësore, me parapëlqimet e shkrimtarit, me shmangiet e qëllimshme⁷⁷

Në këtë punim kemi bërë objekt një nga mjetet produktive të sintaksostilistikës, dukurinë sintaksore të “parcelizimit” ose “copëzimit”, si një nga mënyrat më efektive të sintaksës ekspresive, e përdorur me mjeshtëri në krijimtarinë letrare të F. Kongolit. Kemi zgjedhur këtë autor, sepse në veprat e tij ka arritur të materializojë një realizëm urban, duke qëndruar midis formave klasike të romanit realist dhe dukurive të reja dhe interesante të modernes⁷⁸. Këtë gjë e mbështet më së miri fraza e thyer, e çlirët, e copëzuar. Kemi zgjedhur disa prej romaneve të tij, të cilat e paraqesin autorin tonë si dëshmitar të modifikimeve strukturore⁷⁹.

Parcelizimi është një nga mjetet kryesore të stilit të thyer, një nga mënyrat më efektive e më të përdorura të sintaksës ekspresive, i cili sjell ndarjen e frazave të përbëra a të thjeshta në dy a më shumë pjesë më vete, ose duke dalë më vete një a disa gjymtyrë të fjalisë. Kjo shkëputje realizohet me anë të intonacionit i cili në ligjërimitin e shkruar pasqyrohet me shenjë pikësimiti ndarjeje të fortë. Përftesat e tjera sjellin copëtimin e fjalisë ose të periudhës, veçimin e fjalive ose sintagmave deri te nxjerrja e gjymtyrëve si fjali më vete, duke lënë si të vetmin mjet lidhës pranëvënien⁸⁰.

Duke kundruar krijimtarinë letrare të F. Kongolit, vëme re se shkëputjen a copëzimin e fjalive të bashkërenditura, të nënrenditura, të një a disa gjymtyrëve të fjalive i ka realizuar për arsye të ndryshme.

Së pari, një pjesë të thënieve autori e ka shkëputur për të spikatur tipare, rrethana, për të saktësuar a sqaruar anë të veçanta të tyre, për t’i individualizuar, për t’i bërë më të dallueshme nga pjesa tjetër. Ja si shkruan: *Ishte një pasdite me një diell të madh në horizont, që më shumë të verbonte se të digjte. E njëjta zbrazëti në rrugicën me pluhur. E njëjta qetësi e shurdhër. Dhe dera prej hekuri përballë, gjysmë e hapur..*(Kufoma, f. 32). *E përfytyronte të veshur me kostume dhe këmisha elegante. Një xhongler. Një supermagjistar. Gjithçka e tij ishte e zgjedhur. Mjediset ku e kalonte kohën. Femrat. Pijet. Vrasësit e paguar. Maskarenjtë që bënin lojën e tij* (Te porta., f. 33).

Së dyti, për t’i dhënë pjesës së thënies rolin shtesor në shtjellimin e mendimeve dhe ideve, në zgjerimin me elemente të tjera, të cilat shpesh janë pasqyruese të drejtpërdrejta të mendimeve të autorit. *Unë e dija ekzistencën e tij, ia ndieja praninë... Dhe shpina më akullohej. Dhe këmbët më bëheshin dru. Dhe goja më lidhej* (I humb., f. 121). *Më beso, do të kisha dashur shumë që ajo të rrinte. Pa më dhënë asnjë shpjegim. Thjesht të rrinte. Por ajo u largua* (Te porta., f. 252).

Së treti, shkëputja apo ndarja e disa frazave të përbëra, veçanërisht me bashkërenditje, në shumicën e rasteve është përdorur për të komunikuar pa shumë vështirësi me lexuesin, për ta bërë ligjërimitin më të rrjedhshëm dhe më të natyrshëm, ashtu siç ndodh në ligjërimitin bisedor apo në prozën popullore. Ja si shprehet; *Sa të shkojnë gjërat deri në fund, askush s’është marrë me të. Prandaj rri si pulë e lagur* (Ne të., f. 273). *Por kjo që e pamundur. Edhe për Sonjën, edhe për mua* (I humb., f. 61). *Kurse prifti ishte i vjetër. Dhe me kulturë* (Kufom., f.184).

⁷⁷Islamaj Sh., *Gjuha, ligjërimi, fjala*. Prishtinë, 2004, f. 229.

⁷⁸Prendi, A., *Letërsi shqipe bashkëkohore*. Fiorentia. Maj, 2015, f. 111.

⁷⁹Veprat letrare në të cilat kemi bërë vjeljen e lëndës, janë: “I humburi”, 1992; “Kufoma”, 1994; “Ëndrra e Damokleut”, 2001 (botim itretë); “Te porta e shën Pjetrit”, 2005; “Ne të tre”, 2006 (botim i katërt); “Misteri i mjellmës”, 2022.

⁸⁰Lloshi, Xh., *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*. Tiranë, 2004, f. 94.

Së katërti, Fatos Kongoli është një shkrimtar që i respekton teknikat e romanit realist dhe tregohet i kujdesshëm me lexuesin për t’i pranuar e kuptuar pa vështirësi thyerjet e forta dhe kapërcimet e romanit modern. Pra, copëzimin e linjës logjike a kronologjike të romaneve të tij e ka mbështetur gjerësisht edhe nga pikëpamja gjuhësore, duke kapërcyer skemat e ngurta të zakonshme, duke i dhënë elasticitet frazës së tij. Konkretisht: *Dhe e përfytyroja Sonjën të mbështjellë në një nap të zi. Napë tymrash e pluhurash. Tymra e pluhura të ferrit. Ku të ishte? Diku. Edhe ajo, edhe Ladi. Të humbur diku. Pa shpresë. Përjetësisht. Ata larg meje, unë larg tyre. I humbur në një barkë me gjashtë veta dhe katër klane. Po ata ku të kishin humbur?* (I humb., f. 102)

Së pesti, për ta bërë më të larmishëm ligjërimin, më ekspresive frazën, më të zhdërvjellët stilin, autori i shfrytëzon me mjeshtëri efektet që arrihen nga ky parcelizim. Ai duket veçanërisht bukur natën: një oaz hareje. Me drita shumëgjyreshë. Dhe emrin llamburitës “Laura” (Te port., f. 53). Fytyra ime e parruar më trembi. Iu shmanga. U nguta të kthehesha në dhomë, të vishesha... Veshur me të zeza. Jo i veshur me kostum të zi. Njëqind herë më mirë (po aty, f.116).

Në krijimtarinë e F. Kongolit kemi vëmë re se janë copëzuar fjali të përbëra me marrëdhënie të përziera, fjali të përbëra me bashkërenditje, fjali të përbëra me nënrenditje, janë shkëputur një a disa gjymtyrë më vete. Duke parë shpeshtësinë e përdorimit të copëzimit apo parcelizimit, rrethanat ku është përdorur më gjerësisht, efektet që ka sjellë, nga pikëpamja strukturore, dallojmë disa kategori:

a, Ndahen apo shkëputen nga fraza e përbërë ku bëjnë pjesë një a disa fjali të bashkërenditura, me larmi marrëdhëniesh strukturore, semantike e lidhëzore. Kjo është një nga mënyrat e përdorura më dendur. Fjalitë e copëzuara fillojnë me lidhëza të ndryshme bashkërenditëse, si: shtuese, kundërshtore, veçuese a përmbyllëse. Ja si shprehet: *E vërteta e parë: duhej të të kisha larguar prej kohësh nga jeta ime. Ose, thënë drejt, duhej të kisha pasur burrërinë të largohesha nga jeta jote prej kohësh* (Te porta., f. 13). *Pra, nuk do ta mësoj kurrë nëse je ndier ndonjëherë tradhtarë ndaj meje. As dua ta mësoj* (po aty, f.14). *...jam ngatërruar e një vrasje. Prandaj jam i detyruar të fshihem. Dhe të lë këtë dëshmi* (Te porta., f. 39). *Ata tjetërsoheshin, nga skllëvër ktheheshin në zotër. Ndërsa unë nga mbretëreshë në një skllave që pranoja paratë e tyre...*(Te porta., f. 157). *Ajo nuk e dinte se ekzistonte një tigër. Kurse mua më vinte t’i thosha të heshte* (I humb., f. 121). *Të nesërmen u larguan. Dhe nuk u kthyen më* (Kufoma, f. 39).

b. Në fjalitë e përbëra me nënrenditje copëzohen, duke dalë më vete, fjalitë e nënrenditura me një shumësi ane semantike e mjete lidhëse. Ndarja e tyre ndodh edhe për shkaqe sintaksore, edhe për shkaqe stilistikore. *Ndërsa Flora qe sjellë ndaj tij me një ftohtësi rrëqethëse. Sikur midis tyre s’kishte asgjë. Sikur e shihte për herë të parë. Dhe për Hektorin asnjë fjalë* (Kufoma, f. 165). *Një tigër që mund të hante dhe Vilmën. Siç kishte ngrënë Ladin. Siç kishte ngrënë Sonjën. S’doja që ai të hante edhe Vilmën* (I humb., f. 121). *Po të tregoj vetëm një pyetje. Të cilën ai nuk ma bëri. Jo se harroi...*(Te port., f. 168).

Ndarja më e madhe e fjalive të nënrenditura ndodh te fjalitë me nënrenditje shkakore, qëllimore, rrjedhimore, te disa fjali të nënrenditura krahasore, te ndonjë kohore. Veçimi i fjalive të varura, duke u nisur nga mënyra e organizimit të të gjithë fjalisë së përbërë, mund të dalë i plotësuar me fjali të varura varg, me stukturë paralele ose me skema të përziera. Bie në sy edhe veçimi i disa ndërtimeve me forma foljore të pashtjelluara, sidomos disa ndërtime me përcjelloren. *Isha gati ta shoqëroja në fund të botës me kusht që ta mbante gjuhën të kyçur pas dhëmbëve. Sepse rrugët qenë njëlloj të rrezikshme si lokalet* (Kufoma, f. 99). *Tani them më mirë të mos kisha shkruar. Që të mos shihja se sa i ulët bëhet njeriu. Sa i dobët, sa zero* (I

humbur., f. 90). *Po të tregoj një pyetje. Të cilën ai nuk ma bëri. Jo se harroi* (Te porta., f. 168). *Te lokalet e mrekullueshme vrg njëri pas tjetrit. Ku ti je i përnatshëm dhe jeta është një festë pa fund... Nëse do të mund të flemë sado pak* (Te porta., f. 212).

c. Shkëputja e gjymtyrëve të pazgjeruara ose të zgjeruara është një nga kategoritë më të përdorura në këto romane. Përdorimi i tyre me mjeshtëri nga autori, e ka pasuruar e përsosur gjerësisht strukturën sintaksore të frazave të përdorura. Me përdorimin e tyre, thëniet janë më të zhdërvjellta, më të çlirta, me ngjyime të shumta, pasqyruese të drejtpërdrejta të të gjitha gjendjeve, përjetimeve dhe emocioneve të autorit e personazheve.

Parcelizimi i gjymtyrës a i gjymtyrëve paraqitet i larmishëm. Del i thjeshtë a kompleks, i njëfishtë ose i shumëfishtë, i pazgjeruar ose i zgjeruar, i vetëm ose i kombinuar me mjete të tjera gjuhësore stilistike, si përsëritje, e thjeshtë ose e përforcuar, ndërtime emërore⁸¹.

Një nga shkëputjet më të thjeshta është veçimi i një gjymtyre, që mund të dalë e pazgjeruar ose e zgjeruar me fjalë ose grupe fjalësh. Veçimi i gjymtytëve jep më shumë efekte stilistikore dhe e ndihmon më shumë thyerjen e frazës. Mund të shkëputet edhe një gjymtyrë kryesore, kryefjala apo kallëzuesi, dhe në raste të veçanta edhe kallëzuesi emëror. *Pse nuk merresh me sport? U gërdhesha. U shkunda. Po dridhesha. Djemtë ikën me vrap drejt çadrës. Edhe Vera* (Ne të., f. 47). *Po qaja. E ndoqa. Deri pranë shtëpisë* (I humb., f. 31). *Dhe qeshi. Dhe u skuq përsëri* (f. 127). *...se cili nga ne është më budallai. Gaboheni! Unë isha karremi. Peshku. Hila* (Kufoma., f.159). *Mjediset ku e kalonte kohën. Femrat. Pijet. Vrasësit e paguar* (Te., f. 33). *Të gjitha janë grisur, janë hedhur, janë djegur. Këpucët. Tavllat e cigareve. Veglat e rrojës. Letërnyoftimi. Syzet e diellit. Syzet optike* (Te port., f.59).

Parcelizimi është përdorur edhe për veçimin e gjymtytëve homogjene të përdorura në forma të ndryshme. *Puna është të të vrasë ty dhe vetë të dal i larë. Jo vetëm i larë, por dhe i fituar. Jo vetëm i fituar, por edhe i sistemuar. i rehatuar, i trashëguar, i lumturuar, i burrëruar* (I humb., f. 173). *Si një mekanizëm i kurdisur që rrëmon. Të kaluarën dhe të tashmen* (Ne të., f.149).

Shkëputja e gjymtyrëve të dyta ia shton edhe më shumë vlerën stilistikore frazave ku janë përdorur. Janë veçuar gjymtyrë me marrëdhënie përcaktore, kundrinore, rrethanore. *Me frikën në sy doemos. Një mrekulli.* (I humb., f. 125). *Në të vërtete e kam vrarë me qindra, ndoshta me mijëra herë. Në ëndërr. ... këshillat e saj ishin për mua të papranueshme. Për të zezën time. Për mallkimin tim* (Kufom., f. 26). *Larg njerëzve. Ju nuk meritoni më shumë. Vemje, vemje...* (Kufoma., f. 163). *Gjithçka tjetër që rrafshuar. Edhe shtëpia e tyre* (Kufoma., f.169). *E përfytyronte të veshur me costume dhe këmisha elegante. Një xhongler. Një supermagjistër* (Te port., f. 33).

Parcelizimi ose shkëputja e frazave të ndryshme apo e gjymtyrëve e përdorur me mjeshtëri dhe art nga ky autor, i ka dhënë ngjyime e larmi të madhe ligjërimin të përdorur në romanet e ndryshme. Nga ana tjetër, kjo mjeshtëri dhe ky art i autorit ka pasuruar dhe përsosur strukturën sintaksore të shqipes me mënyra dhe mjete efektive të stilit të thyer. Këto mënyra e kanë modifikuar edhe më shumë sintaksostilistikën e shqipes.

Situatat e funksionimit të një gjuhe standarde, qoftë kjo edhe e vendosur prej kohësh, ndryshojnë lidhur ngushtë me ndryshimet shoqërore dhe kulturore të bartësve të saj, prandaj është detyrë e përhershme e shoqërisë njerëzore, e njerëzve të shkencës dhe të kulturës të

⁸¹ Domi, M. Studime sintaksore. Vepra I, f. 375.

vërejnë dhe të përcjellin ndryshimet që kanë ndodhur dhe të përcaktojnë qëndrimet që duhen mbajtur dhe detyrat që duhen zgjidhur për t’iu përgjigjur gjendjeve dhe kërkesave të reja⁸².

Bibliografia

Domi, Mahir. *Studime sintaksore*. Vepra I. Tiranë, 2013.

Domi, Mahir. “Dukuri të zhvillimit të strukturës sintaksore të gjuhës sonë letrare të sotme”, *SF*, 4, 1984.

Floqi, Spiro. “Mbi disa aspekte të zhvillimit të sintaksës së periudhës në shqipen letrare pas çlirimit”, *SF*, 1, 1970.

Islamaj, Shefkie. *Gjuha, ligjërimi, fjala*. Prishtinë, 2004.

Lloshi, Xhevat. *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*. Tiranë, 2004.

Mansaku, Seit. “Zhvillime të strukturës sintaksore dhe norma”, *SF*, 3-4, 2002.

Mansaku, Seit. “Rreth pasurimit dhe përsosjes së strukturës sintaksore të shqipes së sotme”. *Gjuha jonë*, 1-2, 2000.

Prendi, Arben. *Letërsi bashkëkohore*. Shkodër, 2015.

Lista e librave të vjelë

“I humburi”, 1992;

“Kufoma”, 1994;

“Ëndrra e Damokleut”, 2001 (botim i tretë);

“Te porta e shën Pjetrit”, 2005;

“Ne të tre”, 2006 (botim i katërt);

“Misteri i mjellmës”, 2022.

⁸² Mansaku, S., “Rreth pasurimit dhe përsosjes së strukturës sintaksore të shqipes së sotme”. *Gjuha*

*Fjala shqipe nën trysninë e fjalës së huaj
Gjuha e medias vizive në ditët e sotme*

DR. MANOLA KAÇI (MYRTA)
Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës

DR. AURELA BASHA
Universiteti “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan

Abstrakt

Gjuha shqipe në fondin e saj leksikor, përveç fjalëve të burimit vetjak, ka të pranishme edhe fjalë të huazuara nga gjuhë të tjera. Një pjesë e këtyre huazimeve kanë depërtuar shumë herët në shqipe dhe janë përshtatur me sistemin e saj në atë shkallë, sa vështirë të dallohen nga vetë fjalët autoktone të gjuhës shqipe.

Kohët e fundit, për shkak të zhvillimit të gjithanshëm gjeopolitik të popujve dhe globalizmit, vihet re ndikimi i gjuhëve që përfaqësojnë shoqëri më të zhvilluara (sidomos i gjuhës angleze) në shumë gjuhë të tjera. Një përhapje e tillë shpjegohet me nevojën për të realizuar një komunikim pa pengesa leksikore e semantike.

Këtë dukuri e hasim edhe në shqipe, ku përhapja dhe shtrirja e “rrënjëve të saj” është më e gjerë dhe më dominuese, nga sa mund të duket në një vështrim të thjeshtë. Fjalë të burimit të huaj (sidomos anglicizmat) i takojmë gjerësisht jo vetëm në komunikimin e përditshëm, por edhe në komunikimin zyrtar, në median e shkruar, po aq sa edhe në atë vizive. Nëse do të përqendrohemi në median vizive apo pamore e cila njihet për rolin dhe ndikimin e saj të padiskutueshëm në një shoqëri lidhur me përdorimin gjuhësor, vërehet që përhapja dhe “zënia vend” e tyre shfaqet në një shkallë mjaft të gjerë. Në rastin e shqipes, mbështetur në dendurinë e shpeshësive të shfaqjes dhe përdorimit të tyre, një situatë e tillë gjuhësore do të shndërrohej në një faktor të cilin do ta cilësonim si të rrezikshëm.

Natyrshisht, zhvillimi shoqëror shpie shpesh në domosdoshmërinë e huazimeve, deri diku edhe në pamundësinë e shmangies së depërtimit të tyre. Sot, shqiptarët gjenden të rrethuar me fjalë të huazuara të cilat i përdorin po me aq *lehtësi* dhe *natyrshmëri*, sa edhe fjalën shqipe. Në kontekste të tilla gjuhësore, kur fjala e huaj zotëron një status apo “pushtet” të kësaj natyre, specialistët e gjuhës duhet t’i kushtojnë një vëmendje e posaçme gjuhës së tyre amtare apo “gjuhës marrëse” nëpërmjet hartimit të politikave gjuhësore në dobi të përdorimit të fjalës shqipe, kundrejt fjalës së huaj.

Fjalët çelës: *Globalizëm, huazimet në gjuhë, leksiku autokton, politika gjuhësore, gjuhë amtare*

Huazimi përbën dukurinë e ndërveprimit të gjuhëve mbështetur në shkaqe të ndryshme historike, shoqërore a kulturore. Huazimet në shqipe nuk përbëjnë një çështje e të re. Kemi të bëjmë me një fushë të hershme studimore, sikurse kanë qenë edhe vetë marrëdhëniet e shqipes me gjuhët e tjera. Huazimet e para në shqipe vijnë prej gjuhëve të vjetra, si: greqishtja e vjetër, latinishtja apo sllavishtja para shekullit të X-të, duke vijuar më tej me turqizmat në shek e XV. Ndërkohë, në dekadat e fundit që cilësohen si etapa e globalizmit, gjuha shqipe gjendet nën ndikimin e gjuhëve evropiane, por kryesisht të anglishtes, si gjuha që përcjell zhvillimet më të fundit të teknologjisë dhe fushave të tjera të veprimtarive shkencore e shoqërore.

Kur flasim për huazimet në shqipe, duhet bërë një studim i detajuar dhe një shtresëzim i tyre që lidhet me kohën në të cilën kanë hyrë huazimet, si dhe me mënyrën se si ato kanë zënë vend në gjuhën shqipe. Gjatë dhjetëvjeçarëve të fundit, në tërësinë e studimeve për huazimet ka mbizotëruar prirja për ta parë praninë e tyre në shqipe si një dukuri sa të dobishme, po aq edhe të dëmshme. Gjuhëtarët shqiptarë, me të drejtë, nuk e vënë theksin tek

huazimet e vjetra, pra tek ai grup huazimesh që kanë hyrë në shqipe nga greqishtja e vjetër, latinishtja, turqishtja si dhe tek ndërkombëtarizmat, të cilët janë bërë tashmë pjesë e ngurosor e leksikut të gjuhës shqipe, apo siç i emërton gjuhëtari Gjovalin Shkurtaç “mishi dhe ashti i shqipes”⁸³. Po kështu, gjuhësia shqiptare nuk e vë theksin në atë grup huazimesh të cilat kanë hyrë bashkë me objektin, dukurinë që përfaqësojnë apo çdo funksion emërtues për të cilin shqipja nuk e ka një fjalë të brumit të saj. Grupi i huazimeve që janë bërë në vazhdimësi lëndë studimore dhe janë parë si të dëmshme për gjuhën janë huazimet të cilat gjuhëtari Xhevat Lloshi i cilëson si të panevojshme.⁸⁴ Bëhet fjalë për huazimet të cilat kanë hyrë dhe përdoren gjerësisht në gjuhën shqipe, pavarësisht pranisë së fjalës shqipe. Krijimi i një rrethane të tillë gjuhësore që nuk i sjell asnjë dobi substraktit të gjuhës, por përkundrazi e rëndon atë, natyrisht, ia humbet pastërtinë dhe dlijësinë shqipes dhe ndikon në aspektin e të kuptuarit të saj nga të gjitha shtresat shoqërore. Mbi të gjitha, ky realitet gjuhësor duket se prek, në një farë mënyre, autoktoninë e gjuhës duke mos u dukur si gjuhë shqipe, ajo që në të vërtetë është apo duhet të jetë shqip.

Duke u përqendruar tek huazimet e panevojshme që gjallojnë në gjuhë “përkrah fjalës shqipe”, duhet vënë re që ky grup fjalësh, kryesisht, janë pronë apo pjesë e leksikut të shtresës së shkolluar të shoqërisë shqiptare, individëve të cilët kanë një rol dhe një funksion të rëndësishëm në shoqërinë shqiptare dhe që, së fundmi, përcaktohen me fjalën “elitë”. Nëse kufizohemi në shek. XX do të vëmë re që në gjysmën e parë të tij gjuha e huaj me të cilin gjendej më tepër në kontakt elita shqiptare shqiptare ishte frëngjishtja, ndërsa që nga vitet `60, kur u prishën marrëdhëniet me BS dhe anglishtja zëvendësoi rusishten, si gjuhë e huaj në shkollë, anglishtja mori përparësi dhe pati ndikim aq sa mund të lejonte izolimi i Shqipërisë së kohës. Një tjetër gjuhë evropiane e cila u vu në kontakt me shqipen rreth viteve `70, ishte italishtja, ndonëse bashkëveprimi me të ka qenë më i ngushtë gjatë pushtimit italian në Shqipëri. Pikëtakimet me gjuhën italiane të kësaj periudhe mund të përkufizojmë si “kontakte të fshehta” që realizoheshin nëpërmjet kanaleve italiane, kryesisht në zonat bregdetare⁸⁵, për t`u zhvilluar më tej në vitet `80, por kryesisht në vitet `90. Në vitet `90 rikthehet, gjithashtu, ndikimi i anglishtes e cili vijon të veprojë edhe ditëve të sotme me një trysni mjaft të dukshme.

Ky anglishtizim i shqipes apo italianizim i saj, siç e lexojmë shpesh në literaturën gjuhësore, herë në mënyrë të vetëdijshme, e herë në mënyrë deri diku aq të pavetëdijshme, sa arrin të cënojë rregullat e shqipes, i ka shtrirë krahët në leksikon e fushave më të rëndësishme të zhvillimit të shoqërisë shqiptare dhe, në këtë përcaktim, vështirë të mbetet jashtë suazës së saj media në tërësi dhe media pamore në veçanti.

Pyetja që merr vlerë në këtë aspekt do të ishte: Çfarë ka ndodhur me leksikon që përdoret në mediat shqiptare gjatë ndikimit të gjuhëve evropiane? Në ç`masë dhe në ç`mënyrë ka ndodhur ndikimi i huazimeve, kryesisht nga anglishtja, italishtja apo edhe ndonjë gjuhë tjetër?

Çdokush është i vetëdijshëm për rolin tejet të rëndësishëm të medias në shoqëri dhe, mbi të gjitha, për raportin e veçantë me gjuhën. Siç shkruan me të drejtë gjuhëtari Sh. Rrokaj: “Ajo po bëhet një faktor përcaktues për fatin e standardit dhe marrëdhëniet e tij me gjithëgjuhën”, por në anën tjetër media ajo është përcaktuar “si “prishëse” e gjuhës dhe si

⁸³ Gjovalin Shkurtaç, « Shqipja e sotme », Tiranë, 2010, f.210.

⁸⁴ Xhevat Lloshi, Dysorët e përfutur nga purizmi, « Gjuha shqipe » I, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë 2011. f.27.

⁸⁵ Anila Omari, Vëzhgime rreth zhvillimeve të shqipes së sotme nën ndikim të gjuhëve të huaja, « Gjuha jonë », Qendra e Studimeve Abanologjike, Instituti i Gjuhësisë, 1-4, Tiranë, 2009, f. 187.

“konsumatorja” më e madhe e fjalëve dhe strukturave të huaja”.⁸⁶ Të ndjekësh sot median pamore në Shqipëri, nuk përbën kurrfarë vështirësie për të kuptuar vendin që ka zënë fjala e huazuar në strukturat gjuhësore të gjuhës sonë amtare. Nëse përqendrohemi vetëm në sferën e televizionit, mjafton të vëresh emërtimet e kanaleve kombëtare shqiptare dhe të programeve të tyre dhe, lehtësisht, arrin të ndërgjegjësohesh për atë që ka ndodhur dhe është duke ndodhur në shqipe. Nuk është aspak rastësi që një prej kanaleve televizive me një përhapje dhe shikueshmëri më të lartë në Shqipëri është emërtuar “Top-channel”. Nëse vijojmë më tej, emërtimet që hasim janë: Top News, News 24, Ora news etj. Të njëjtën dukuri e takojmë edhe në emërtimin e emisioneve qoftë me këndvështrim politik, qoftë me këndvështrim kulturor etj., si: Open, Opinion, Check-in etj, etj.

Përveç çështjes së emërtimeve, çfarë është e dukshme dhe shfaqet rëndom në botën e televizionit dhe që, në njëfarë mënyre, pa kurrfarë droje mund ta përcaktojmë si një shqipe që “të vret veshin” është përdorimi tejet i shpeshtë i një grupi fjalësh të huazuara që duket se kanë zënë vend midis fjalëve të shqipes. Ky ndikim i anglishtes dhe i italishtes në shqipe, kryesisht në aspektin leksikor, por edhe në atë gramatikor, natyrisht është pasqyruar në ligjërimin e përdorur në këtë media e cila, me të drejtë, mishërohet si pasqyrujesja më e drejtpërdrejtë e shqipes së sotme standarde.

Televizionet shqiptare, sikurse e parashtruam, kanë patur një ndikim të dukshëm të italishtes, i cili lidhet me kontaktet e vazhdueshme të televizioneve italiane qysh në vitet ’70 duke bërë të mundur, në këtë mënyrë, përfshirjen “në shqipen e televizionit” fjalë me burim nga italishtja, siç është huazimi “anoncoj”, të cilin e takojmë shpesh edhe të shqiptuar “anoncoj”, me kuptimin “njoftoj një lajm në television, lajmëroj, paraqes”. Kjo fjalë e huazuar duket se ka marrë përparësi në botën e medias përkundrejt fjalëve shqipe “jap, paraqes, njoftoj” të cilat përkundrejt fjalës “huazoj” mbartin kuptime polisemantike.⁸⁷

Fjalë me burim nga italishtja që takohen shpesh në median pamore janë të shumta, por e shohim të udhës të përqendrohemi në pjesë të kufizuar të tyre që shfaqet relativisht me një denduri më të madhe përdorimi: *precedencë* për përparësi, *spostoj* për zhvendos, shmang; *resurse* për burime; *desiluzion* për zhgënjim; *ordiner* për i rëndomtë, *i izoluar* për i vetmuar, *injurancë* për padije, *latente* për e fshehtë, *situatë* për gjendje, *hezitim* për ngurrim, *nacional* për kombëtar, *prezencë* për prani etj.

Të pranishme në botën e televizionit janë edhe latinizmat: *stigmatizoj* për damkos, njollos; *pervers* për i mbrapshtë, *i çoroditur*, *i deformuar*; *disproporcion* për shpërpjesëtim; *kualitet* për cilësi; *kuantitet* për sasi; *permanent* për i përhershëm, i pandërprerë, i qëndrueshëm; *enorme* për e jashtëzakonshme, e tepërt; *favor për përkrahje*; *amendoj* për ndreq, rregulloj, përmirësoj, vë në përdorim, zbattoj; *konditë* për kusht etj.

Nëpërmjet italishtes, në këtë periudhë kanë hyrë edhe anglicizma si: mis, spot (publicitar), play off, turn over.⁸⁸

Një përhapje të gjerë kanë marrë huazimet nga anglishtja: *alokoj* për caktoj, caktim; *draft* për projektligj, projektstatut, projekt marrëveshje; *lajv* apo *llajv* (live) për drejtpërdrejt; *paneli* për grupi, trupi; *trend* për modë, *no coment* (pa koment), *show* (shfaqje), *nonstop* (pa pushim) *audiencë* (dëgjueshmëri), *derby*, *videoclip*, etj., etj.

⁸⁶ Sh. Rrokaj, Ç`gjuhë flasim? “Gjuha Shqipe” 2, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 2011, f. 28.

⁸⁷ Shih Anila Omari, Vëzhgime rreth zhvillimeve të shqipes së sotme nën ndikim të gjuhëve të huaja, “Gjuha jonë”, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Gjuhësise, 1-4, Tiranë, 2009, f. 189.

⁸⁸ Anila Omari, Vëzhgime rreth zhvillimeve të shqipes së sotme nën ndikimin e gjuhëve të huaja, “Gjuha jonë” 1-4, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Gjuhësise, Tiranë, 2009, f. 188.

Duhen veçuar nga ky grup huazimet derbi (derby)⁸⁹ dhe videoklip (videoclip) për të cilat gjuha ende shqipe nuk ka një fjalë gjegjëse nga brumi i saj dhe, në rrethana të tilla, meqenëse këto huazime i vijnë në ndihmë shqipes për të përmbushur funksionin komunikues, duhen parë si huazime të nevojshme.

E shohim të udhës të japim disa shembuj huazimesh të panevojshme në disa prej emisioneve politike më të ndjekuara në Shqipëri. Natyrisht, përcaktimi i tyre si të panevojshme mbështetet në faktin që për secilin prej huazimeve gjuha shqipe ka fjalën e saj gjegjëse, ndaj është me vend mendimi i Cabejit: “Ka një mori fjalësh të vendit, që pa dëm kuptimor janë në gjendje t’ua zënë vendin fjalëve të huaja”. Ajo që të bie në sy në këtë grup huazimesh është përkatësia në kategori leksiko-gramatikore. Vihet re një mbizotërim i emrave, gjë që tregon funksionin kryesisht emërtues të tyre, vijuar nga foljet dhe mbiemrat.

Në emisionin me titull “Open” të datës 2.03.2023 janë vënë re këto huazime: primare (parësore), impresion (përshtypje, mbresë), konfidenciale (me mirëbesim), influencë (ndikim), axhendë (rend i ditës), aprovim (miratim), determinoj (përfundoj), implikim (zbatim), progres (përparim), në fokus (në vëmendje), agravon (përkeqësohet), konstatoj (vërej), aprovoj (miratoj) evitim (shmangie), show (shfaqje), bravo (të lumtë) etj.

Në emisionin “Top story” të datës 20.06.2023 janë përdorur këto huazime: startojmë (fillojmë), sekondare (dytësore), primare (parësore), prezencë (prani), eksperiencë (përvojë), agravim (rëndim), implementim (zbatim) impakt (ndikim), negociatë (bisedim), kompromis (marrëveshje), opinion (mendim), probabilitet (mundësi), brutal (i egër), racional (i arsyeshëm), fals (jo i vërtetë), prioritet (përparësi), divergjencë (mosmarrëveshje, mospajtim), i indinjuar (i zemëruar), manualisht (dorazi), determinojnë (përcaktojnë), aprovim (miratim), vakant (bosh, i lirë), iniciativë (nismë), konkluzion (përfundim).

Në emisionin “Opinion” të datës 23.06.2023 janë përdorur këto huazime: investigim (hetim, hulumtim), aprovim (miratim), replikë (përgjigje, kundërpërgjigje), kontestoj (kundërshtoj), sensacional (i bujshëm), konfrontoj (ballafaqoj), koicidencë (rastësi), iniciativë (nismë), progres (përparim), angazhim (përfshirje), solid (i fortë, i qëndrueshëm), aparencë (dukje), impresion (lë mbresë, bën përshtypje), refuzim (kundërshtim, mospranim) etj.

Janë për t’u vënë re edhe shprehjet më të zakonshme që përdoren për fillimin e emisioneve të tilla të cilat, gjithashtu përmbajnë huazime të panevojshme. Disa syresh janë: “Mirëmbërma! Startojmë emisionin e sotëm...”; “Në fokus të këtyre zgjedhjeve janë...”; “Pa humbur kohë prezantojmë panelin...” etj.

Në tërësinë e huazimeve të përfshira në shqipe dhe të pasqyruara në sferën e televizionit, një tjetër dukuri që bie në sy është përdorimi i disa ndërtimeve gramatikore. Kështu qoftë në ligjërimin e drejtuesve të emisioneve apo të spikerve, siç jemi mësuar ta dëgjojmë më shpesh, qoftë në ligjërimin e elitës shqiptare në fushën e politikës, ekonomisë, teknologjisë, kulturës etj., takohen shpesh: grupi i emrave të veprimit me prapashtesën –im: *angazhim, eksplorim, eliminim, konformim, korrektim, likuidim, neglizhim, penalizim, rekomandim, unifikim*; grupi paradigmatic i emrave të formuar me sindajshtesën ose afiksoidin krye-: *kryedeputet, kryekomunist, kryebandit, kryeopozitar*; një sërë “kompozitash” të formuara nga një temë emërore + një temë tjetër emërore dhe një temë emërore + një temë mbiemërore: *krimministër* (ministër i krimit), *barazkonkurenca* (konkurenca e barabartë), *barazpeshë* (peshë e barabartë), *barazvlerë* (vlerë e barabartë) etj.⁹⁰

⁸⁹ Kemi të bëjmë me një huazim mjaft të përdorur në terminologjinë sportive.

⁹⁰ Shih Idriz Metani, Gjurmë semantike dhe strukturore në shqipen e sotme, “Gjuha Shqipe” 2, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 2011., f. 42-45.

Në këtë ligjërim, janë të pranishme, gjithashtu, edhe disa ndërtime të huaja, si: *konform ligjit, për momentin, jam/mbetem në pritje, bëj me dije, sjell në vëmendje, rastin e kemi lajmëruar, në fund të ditës etj.*⁹¹

Po ndalemi tek një huazim mjaft i përhapur në botën e televizionit, fjala “startoj”. Ndonëse shqipja ka fjalën e saj “filloj”, në mënyrë tërësisht të pakujdesshme ka marrë përhapje anglishtshqipja “startoj”, një fjalë të cilën do të përcaktonim si as shqip, dhe as anglisht, edhe për vetë veçantinë e shqiptimit. Kemi të bëjmë me një huazim i cili i është përshtatur një prej gjedheve të fjalëformimit të foljeve në shqipe dhe, nëse do ta krahasojmë me foljen “filloj”, në aspektin akustik tingëllon jo në harmoni përkrah fjalëve shqipe, brenda kontekstit gjuhësor në të cilin përdoret.

E vlerësojmë me vend të përmendim në këtë linjë të pasqyrit të hulumtimeve tona qëndrimin e gjuhëtarit Xh. Lloshi i cili shkruan: “Për ardhjen e anglicizmave në kushtet e globalizmit nuk është e mjaftueshme të thuhet hyrja e huazimeve. Jemi përballë ndërhyrjes së huazimeve angleze në gjuhën shqipe”.⁹² Shembuj të tillë të prirjeve që shfaqin huazimet në gjuhën shqipe përbëjnë aspektin themelor në të cilin duhet të mbështeten studimet mbi shqipen, pasi të tilla dukuri nuk e vijnë në ndihmë gjuhës, as nuk e pasurojnë atë, përkundrazi, e shtrembërojnë sistemin leksikor dhe gramatikor të saj.

Është mëse e natyshme që, nën trysinë e globalizmit, gjuhët të japin e të marrim midis tyre dhe në këtë proces përparësinë e kanë gjithmonë gjuhët më të zhvilluara. Huazimet nuk duhen parë si një dukuri që e çënon një gjuhë, por si një dukuri e cila, nëse përmbush një mungesë në aspektin leksikor a semantik, duhet t`i njihet vlera e pasurimit të gjuhës. Nga ana tjetër, të gjitha ato huazime që nuk e kryejnë këtë funksion, por e mbishtresojnë me dysorë leksikorë apo me emërtime sinonimike, duhen parë si të panevojshëm në gjuhë dhe duhet gradualisht t`u nënshtrohen polikave gjuhësore të zëvendësimit gradual të tyre me fjalët autoktone të gjuhës.

Bibliografia

- Gramatika e gjuhës shqipe I, Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 1995.
- Gjuhë jonë 1-4, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2007.
- Gjuha jonë 1-4, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2009.
- Gjuha jonë 3-4, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2000.
- Gjuha jonë 1-4, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2004.
- Gjuha jonë 1-4, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2006
- Gjuha shqipe 1, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë 2011.
- Gjuha shqipe 3, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë 2011.
- Gjuha Shqipe 2, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 2011.
- Gjovalin Shkurtaj, Shqipja e sotme, Tiranë, 2010.
- Gjovalin Shkurtaj, Kulturë e gjuhës, SHBLU, Tiranë, 2005.

⁹² Xh. Lloshi, Ndërthurja e globalizmit në rrjedhat e shqipes, ‘Gjuhë jonë’ 1-4, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i letërsisë, Tiranë, 2007, f. 32.

Veçantitë e gjuhës në prozën e Kutelit

PROF. ASOC. DR TEUTA VINCA KAFEXHOLLI
Universiteti “Ukshin Hoti” në Prizren

PROF. AS. DR. XHEVAHIRE TOPANICA
Kolegji UBT Prishtinë

Abstrakt

Në këtë punim do të përpiqemi të paraqesim një pamje për veçantitë gjuhësore të prozës së Mitrush Kutelit, sepse ky shkrimtar në veprat e tij, e sidomos në prozën e tij, i kushton një vëmendje të veçantë aspektit gjuhësor.

Gjuha e personazheve në veprat e Kutelit është e pasur me atë fjalor që e krijon koha dhe hapësira përkatëse. Dihet se Kuteli në krijimtarinë e tij, e sidomos në prozën e tij merr nga populli, dhe ia kthen popullit në laboratorin krijues, e kjo do me thënë të veshur me gjuhë specifike, artistike që të bën për vete dhe të rrëmben që me leximin e parë, sepse prozat e tij paraqesin një realitet të kohës dhe vendit dhe kjo arrihet në mënyrë mjeshtërore përmes gjuhës së personazheve, që në shkencën teorike quhet diferencim gjuhësor, prandaj dëshpërohej kur i jepeshin vërejtje në ortografi e gjuhësi për trajtat që i largoheshin të folmes së zonës ku zhvillohen ngjarjet e tregimeve.

Fjalët çelës: *kontributi gjuhësor, ortografi, diferencim gjuhësor, specifikat dialektore.*

Hyrje

Krijimtaria e Mitrush Kutelit përbëhet nga shumë fusha veprimi. Ai njihet, pos si prozator me tregime e romane, pos si studiues (kritik), përkthyes (Përkthenjësi M.K. ka lënë vepra klasike me përkthime të mrekullueshme. Përkthimet e tij janë një metapsikozë), gazetar e publicist, veprimtar për çështje kombëtare me gazetatat e revistat “Bota letrare”, “Shqipëria e re” etj., si njëri nga themeluesit e Lidhjes së Shkrimtarëve të Shqipërisë, si kryetar i studentëve shqiptar në Rumani, folklorist e poet, por edhe si ekonomist i spikatur.

Botimet në fushën ekonomike (1931-1936); “Mendime mbi krizën bujqësore”, “Tri probleme në lidhje me Bankën Kombëtare të Shqipërisë”, (broshurë shqip ku kritikoi politikën financiare italiane në dëm të Shqipërisë), “Huarat me forcë në qarkullimin e monedhës”, “Sistemet e bankave të emisionit të vendeve të Ballkanit” (tezë doktorate), “Bankat bujqësore të vendeve të Ballkanit”, “Kapitalet e huaja në bankat e mëdha të Bullgarisë”, “Banka Kombëtare e Shqipërisë”, “Kreditë bujqësore në Rumani”, “Dhjetë leksione mbi monedhën, kreditin dhe shkëmbimet”, “Kriza e kontrollit në shoqërinë parashtetërore”.

Botimet në fushën e letërsisë: “Netë shqiptare” (botimi I, 1938), “Ago Jakupi dhe të tjera rrëfime” (1943), “Këngë e britma nga qyteti i djegur”, “Kapllan Aga i Shaban Shpatës”, “Sulm e lot”, “Shënime letrare”, “Havadan në havadan” (1944), “Pylli i gëhtenjave” (1958), “Xinxifilua” (1962), “Tregime të moçme shqiptare” (1965). Veç ribotimeve, pas vdekjes së tij u botuan “Në një cep të Ilirisë së Poshtme” (1983), me kapituj nga dy romane të pambaruara, si dhe “E madhe është gjëma e mëkatit”, shkruar më 1946 e botuar së pari në vitin 1993.

Përkthime: Më 1937 përktheu e botoi rumanisht përmbledhjen “Proverba albanese”.

Materialet e punimeve (proceedings)

ISBN: 978-1-78911-007-4

Në gjuhën shqipe përktheu "Vjersha nga Eminesku"(1939), "Kapedan Gardeni me shokë"(1944), në vitet 50-60 "tregimet e Peterburgut" dhe "Frymë të vdekura" (Gogoli), "Kujtimet e një gjahtarit"(Turgenjevi), "Zotërinjtë Gollovlijovë" dhe "Prralla"(Sallitkov – Shçedrin), "Fabula"(Krillov), "Armiqtë", "Tregime të zgjedhura", "Prralla të Italisë" (Gorki), trilogjia, "Ruga e mundimeve" (A.Tolstoi), "Vërshimet e lumenjëve", dhe "Tregimi i pyjeve" (K. Paustovski), "klasikë rusë", "Klasikë sovjetikë", "Shpartallimi"(Fadejev), "Fati i njeriut" (Shollohov), "Vetmi"(N.Virta), "Në shtëpinë tonë" (Kolduell), "Mitri Kokor" dhe "Korija e mrekullive" (Sadoveanu), etj. Poashtu edhe prozë nga Aleksandër Pushkin, poezi të Pol Elyarit e Pablo Nerudës, prozë polake, turke, persiane, arabe, mongole, etj.

Punoi si drejtor i Bankës Kombëtare të Rumanisë, lektor në Universitetin e Bukureshtit, Konsulent kryesor për monedhën në Bankën Kombëtare të Shqipërisë- më 1943-44 dhe drejtor në Bankën e Shtetit Shqiptar nga janari 1945 deri në korrik 1946.

1. Vëmendja e veçantë e Kutelit për aspektin gjuhësor

Vepra e Mitrush Kutelit është e madhe, shumë e madhe në diakroni e sinkroni, aty është një epokë e tërë. Në gojë të personazheve Mitrush Kuteli vë aq këngë popullore sa që *folkloristi*, mund të hartojë një vepër të madhe me këngë popullore apo antologji, *etnologu* i gjen të gjalla edhe zakonet edhe kulturën materiale të veshjeve, ritualet etj. Edhe *gjuhëtarit* që i duhen frazeologjitë i ka nëpër faqet e prozës kuteliane për të hartuar një vëllim të plotë, *leksikologu* - gjithashtu; ai që studion poetikën do të gjejë vlera artistike të shumta, thurje të mrekullueshme kompozicionale, me gjuhë të pasur poetike e hartime të rralla, me sintaksë shqipe, me alegori e ironi, që u mpleksen personazheve me monologë e dialogë plot gjallëri e kolorit.

Lexusit dhe studiuesit kanë vënë re se Kuteli në krijimtarinë e tij, e sidomos në prozë merr nga populli, dhe ia kthen popullit të gatuar në laboratorin krijues d.m.th. të veshur me gjuhë specifike, artistike... Ashtu kanë vepruar edhe teoricientët apo studiuesit e huaj.

Mitrush Kuteli në veprat e tij e veçanërisht ato në fushën e prozës, i kushtonte vëmendje të veçantë aspektit gjuhësor, prandaj dëshpërohej kur i ipeshin vërejtje në ortografi e gjuhësi. Për trajtat që i ndryshoheshin, ai thoshte "i largohet së folmes reale të zonës ku zhvillohen tregimet në kohë përkatëse"⁹³, sepse prozat e tij paraqesin një realitet të kohës dhe vendit dhe kjo arrihet në mënyrë mjeshtërore përmes gjuhës së personazheve, që në shkencën teorike quhet diferencimi gjuhësor.

Duke krahasuar botimet e para prej vitit 1943 deri në botimet e 2001-shit, vërehen disa synime të A. Paskos për ndërhyrjet në aspektin ortografik (apo drejtshkrimor). Ky aspekt vërehet edhe në faqet e librit Mitrush Kutelit në 100- vjetorin e lindjes, të organizuar nga dy akademitë, ajo e Tiranës dhe Prishtinës. Pikërisht në këtë libër të botuar në Prishtinë A.Pasko-Pekmezi gjerë e gjatë vështron gjuhën e Kutelit në aspektin morfologjik, ortografik dhe ndryshimet që i janë bërë gjatë botimeve dhe ribotimeve pas 1967-tës. Po japim një fragment për të sqaruar konkretisht këtë dukuri: "Trajtën e përemrit "ay", nuk pranon ta zëvendësojë me "ai", që thotë se është një tingull më i butë dhe nuk i përshtatet së folmes së heronjve të tij. Prandaj shkruan: "Lutem të m'i ruani, të paktën këta tinguj".

Nuk pranon ndryshimin e trajtës "shëmbitër" me "shëmitër" dhe as "shkumbë" me "shkumë": për të parën, për shkak të prejardhjes nga trajta e vjetër "Bitri"; për të dytën shkruan se kjo do kërkonte ndryshimin e toponomastikës, duke e bërë "Shkumbanore" – "Shkumanore".

⁹³ Shih A.Pasko, "Mbi disa ndryshime në gjuhën e Kutelit në botimet pas vitit 1967- krijime origjinale dhe përkthime", ASHAK, 2007, f.55.

Dihet qartësisht se trashëgimia jonë letrare ka specifikën gjuhësore dialektore nga dy gjuhët letrare paralele që nga Buzuku, Budi, Bardhi, Bogdani e deri te krijuesit e ditëve tona: Fishta, Konica, Kuteli, Koliqi, Migjeni etj.

Kuteli krahas kontributit në folkloristikë, ai ka dhënë kontribut edhe në gjuhësinë ashtu si edhe për letërsinë. Nga gjuha që ka në shkrimet e tij, mund të hartohet, me punë ekipore, *një fjalor kutelian* siç bëri një studiues tjetër për Fishtën⁹⁴

Në veprën “Probleme aktuale të kulturës së gjuhës shqipe”, po veçoj një mendim se: “*gjuha është biografia e popujve*”, ajo bën të mundshme që thesari kulturor i një populli të vjetërohet gjuhësisht shumë më ngadalë se sa do të vjetërohej gjuhësisht po të shkruhej në dialekte⁹⁵ (R.Q.). Dhe le ta përsërisim edhe një herë atë mendimin aq të njohur, kreativ e të vërtetë që tha vetë Kuteli kur gjendej jashtë atdheut se “vdekja e një shkrimtari fillon atëherë kur pushon të flasë me vetë veten në gjuhën e tij. Nis atëherë përleshja e shprehjeve dhe veshja e mendimeve me petka të huaja... të cilat ay vetë i errësuar nga pikëpamja e gjuhës, s’ka se si t’i dallojë se janë të huaja”. Sa aktual na duket dhe mbetet ky mendim i Kutelit në kohën dhe ditët tona, kur dihet se si janë shpërndarë shqiptarët në të katër anët e botës dhe se sa i fuqishëm është monopoli i gjuhëve të mëdha të botës.

Ai sikur të ketë ditur mendimin eseistik të një shkrimtari të njohur që thotë: “Ata që japin kontribut për gjuhën, ata japin kontribut për vetëdijën kombëtare. Në qoftë se e bëni gjuhën poetike të këndshme; në qoftë se e bëni gjuhën të kumbueshme si zëri i gjyles së topit apo i kambanës; në qoftë se e bëni gjuhën e qartë, të plotë kuptimisht, të logjikshme, të rrjedhshme, - ta dini se këto virtyte i keni inkuadruar edhe në vetëdijen e popullit. Por, në qoftë se gjuha e juaj është e rëndë, konfuzë, e patrajtshme, e rrejshme, qofshi të mallkuar, sepse kështu e keni cenuar qenien shpirtërore të popullit”.⁹⁶

Për Mitrush Kutelin si ekonomist dihet mjaft, por ajo që tha Mojkom Zeqo për Kutelin si ekonomist m’u duk e veçantë. Ai tha thelbin e kësaj veprimtarie: “Ai ka qenë një ekonomist; mendimi i tij si ekonomist është gjithashtu trashëgimi e kombit. Ai ka punuar pranë thesarit të shtetit shqiptar duke qenë përherë i ndershëm dhe i varfër. Sipas mitologjisë grifonët ishin ruajtës të floririt. Kuteli ka qenë grifon i bankës shqiptare. **Por, ai, më shumë se sa grifoni i floririt, ka qenë grifon i bankës gjenetike të kulturës dhe gjuhës shqipe. Për këtë ai do të meritojë respektin e brezave**” (nënv.im). Ky studiues, pos me trinomin Koliq-Kuteli-Migjeni, e ndërlihd edhe me Ndre Mjedën për motivet e lashtësive historike të Ilirisë, për çka edhe Petra Kulevica pat thënë se Kuteli e njëjtte historinë në gishta.⁹⁷

Po aty autori M. Zeqo e fut me të drejtë në grupin e shkrimtarëve bilingual (shumëgjuhësor): Bogdan, N.Frashër, S.Frashër, Fan Nol, Vaso Pash, M. Camaj etj.⁹⁸

Në vend të përfundimit

Pra, Mitrush Kuteli, jo vetëm që e pasuron gjuhën me fjalë të harruara, jo vetëm që e pasuron leksikon me sintaksën e natyrës së gjuhës sonë, jo vetëm që vë në gojën e personazheve frazeologjitë e mrekullueshme të gjuhës, por ai në gjithë krijimtarinë e tij ngjall edhe dashurinë ndaj gjuhës shqipe.

⁹⁴ Pjetër Jaku: Fjalor fishtian, Lezhë, 2000.

⁹⁵ R.Qosja, “Probleme aktuale të kulturës së gjuhës shqipe”, botimi i IAP, Pr. 1983, f.3 dhe f.73.

⁹⁶ Karel Čapek, Marsija ili na marginama literature, Kultura Beograd, 1967, f.215; këtu cituar sipas veprës.

⁹⁷ Shih, P. Kulevica. “Me Mitrushin” f.62 dhe vepra 5, f.144. Më gjërësisht për këtë çështje flitet në kapituj të tjerë).

⁹⁸ “Dialog me Mitrush Kutelin”, “Doruntina” nr. 12-13, Kumanovë, 1997, f.89.

Materialet e punimeve (proceedings)

ISBN: 978-1-78911-007-4

Idealet e shprehura në krijimtarinë e Mitrush Kutelit, më rikthejnë në një moment të rëndësishëm: në momentin kur bën sakrifica prometejane për ruajtjen e gjuhës amtare. Dhe le ta përsërisim edhe një herë atë mendimin aq të njohur, kreativ e të vërtetë që tha vetë Kuteli kur gjendej jashtë atdheut se “vdekja e një shkrimtari fillon atëherë kur pushon të flasë me veten në gjuhën e tij”.

Bibliografia

- ARISTOTELI, *Poetika*, Rilindja, Prishtinë, 1984.
 BASHOTA, Sali, *Kuteli, prozator, poet, kritik*, Rilindja 1999.
 BEJKO, Sadik, *Homo civitates, Iliria post*, Prishtinë, 3.2.2006.
 BULO, Prof. Dr. Jorgo, *Magjia dhe magjistaret e fjalës*, Dituria, Tr. 1998.
 CAMAJ, Martin, *Kuteli ende i pazbuluem*, në Hylli i Dritës, Tiranë, nr. 3-4, 1994.
 ÇABEJ, Eqrem, *Për gjenezën e literaturës shqipe*, Rilindja, Pr. 1970.
 ÇAPEK, Karel, *Marsija ili na marginama literature*, Kultura Beograd, 1967.
 HAMITI, Sabri, *Letërsia moderne shqipe*, UET Press, Tiranë, 2013.
 JORGAQI, Nasho, M.K. *Vepra letrare 5*, Sh.B.N. Frashëri, 1990.
 KOLEVICA, Petraq, *Me Mitrushin*, Tiranë, 1997.
 KUTELI, Mitrush, *Aga Jakupi e të tjera rrëfime*, Tiranë, 1943 (botim i autorit).
 KUTELI, Mitrush, *Balta shqiptare*, Tiranë, 1975.
 KUTELI, Mitrush, *Pylli i gështenjave*, NSHBT, Tiranë, 1958.
 KUTELI, Mitrush, *Tregime të motçme shqiptare*, Rilindja, Prishtinë, 1971.
 KUTELI, Mitrush, *Në një cep të Ilirisë së Poshtme*. MK, Tiranë, 2012.
 KUTELI, Mitrush, *Sulm e lot*, Tiranë, 1944.
 LLOTMAN, Jurij, *Kultura dhe bumi, Aleph*, Tiranë, 2004.
 MARKAJ, Mirosh, *Vende dhe njerëz në veprën e Mitrush Kutelit*, Pogradec, 1987.
 MATOSHI, Hyseni, *Shpalime letrare* LAP, Prishtinë, 2005.
 PASKO, Atalanta, PVZ, SHB M. Kuteli, Tiranë, 2001.
 QOSJA, Rexhep, *Kontinuitete*, Rilindja, Prishtinë, 1972.
 SINANI, Shaban, *Për letërsinë shqipe të shekullit të 20-të*, Naim Frashëri, Tiranë.
 ZEQQO, Mojkom, *Dialog për Mitrush Kutelin*, Doruntina 12-13, Kumanovë, 1997.

Atë Marlaskaj e ndihmesa e tij në fushë të edukimit gjuhësor

DOC. BORA LOGU
Universiteti “Luigj Gurakuqi”, Shkodër.

DR. ZAMIRA SHKRELI
Universiteti “Luigj Gurakuqi”, Shkodër

Abstrakt

Botimi anastatik i veprimtarisë shumëdimensionale të atë Marlaskaj, dalë në vazhden e Botimeve Françeskane, qershor-korrik 2022, është një pasqyrë e qartë për të kundruar figurën e bashkëpunimin e tij të ngushtë me z. Luigj Gurakuqin, dom Ndre Mjedën, e të tjerë emra të ndritur në fushë shkollës e jetës politike, sociale e kulturore të Shqipërisë së shekullit të kaluar. Për atë Marlaskaj, çështja e edukimit shkollor, qe objektivi themelor i veprimtarisë së tij.

Në këtë botim janë përfshirë artikuj të tij në shtypin periodik të kohës, si: “Ora e Maleve” e “Hylli i Dritës”, si dhe një botim i veçantë “ Nji monument historik pazotsije në lamë t’Arësimit në Shqyni”. Botuesi shkruan se “... Në këtë punim spikat At Ambrozi me njohunitë e tij në filozofi e literaturë, tue ba këtë vepër të vogël ndër punimet ma të bukura të publicistikës apologjetike shqiptare.”

Kushdo që merr në dorë botimin e mësipërm fillon e lexon të dhënat për jetën e tij, duke mësuar shumë për jetën e veprimtarinë e këtij ati françeskan, me shumë kontribute në shumë fusha e drejtime të jetës shoqërore, politike, kulturore në Shqipërinë e kohës, por që vijnë të vyeshme, e me shumë interes për studiuesit e sotëm, posaçërisht ata **në fushë të shkollës, të rëndësisë që kishte e ka mësimi i saktë i gjuhës amtare. Nënvizojmë se disa nga çështjet e mësipërme janë edhe objekt i këtij punimi.**

Në veprën studimore kushtuar jetës e veprës së atë Gjergj Fishtës, shkruar mjeshtërisht nga sivëllau i tij françeskan, atë Daniel Gjeçaj, me titullin “ GJERGJ FISHTA- jeta dhe vepra”, duke folur për veprimtarinë e atë Fishtës si anëtar i shoqërisë “Bashkimi”, në mes tjerash ai shkruan:

“... Merret vesh se nga zotësia që kishte dhe nga kompetenca në botëkuptimin evropian e modern, nga shpirti organizues që zotënonte,(është fjala për prelatin Imzot Prengë Doçi- shënimi im, B.L) mblodh rreth vetit yndyrën e personaliteteve letrare të vendit e sidomos të Veriut. Kështu bani bashkëpunëtorë Dom Dedë Kolecin, Fishtën, Imzot Kolecin, Dom Ndoc Nikajn, Atë Pashk Bardhin, **Atë Ambroz Marlaskaj**, Luigj Gurakuqin, etj.”

Fjalë çelës: *shkollë, dituri, edukatë, gjuhë amtare, françeskanë.*

Atë Ambroz Marlaskaj u lind më 19.11.1884, në Kushnen të Mirditës. Veshi zhgunin e shën Françeskut të Azisit më 10.10. 1900. U shugurua meshtar më 19.10.1907. Teologjinë e bëri në Tirol të Austrisë. Mbrojti doktoratën në Universitetin Gregorian, Romë. Qe profesor në gjimnazin Françeskan në Shkodër, si dhe në Universitetin Antonian në Romë. Kaloj në Amshim më 14.6.1939, në Romë. Qe profesor i teologjisë, studiues i gjuhës e kulturës shqipe, pedagogjist, atdhetar, publicist, deputet në Parlamentin Kombëtar, e rregulltar plot virtyte e kulturë.

Siç nënvizohet, me të drejtë, në hyrje të librit “Shkollë e dituní”, **(BF, Shkodër, 2022,fq,3)** “ *Vepra e At Ambroz Marlaskajt asht shumë pak e njohun prej publikut shqiptar.* ”. Ai ishte pjesëtar i Opozitës së kohës, si pjesë e Grupit të deputetëve të Shkodrës . **Botimi anastatik i veprimtarisë shumëdimensionale të atë Marlaskajt, dalë në vazhden e Botimeve Françeskane, qershor-korrik 2022, është në mes tjerash një pasqyrë e qartë për të kundruar figurën e tij në bashkëpunim të ngushtë me figura të ndritura të historisë e kulturës sonë, si: z. Luigj Gurakuqi, dom Ndre Mjeda, z. Nush Bushati, Hafiz Ibrahim Repishti, z.**

Xhemal Bushati e z. Hilë Mosi. Për atë Marlaskajn, si për shumë klerikë të nderuar e të vleftë, sikurse edhe për dom N. Mjedën, pjesëmarrja në politikë u pa si akti më i lartë i shërbimit ndaj atdheut. Kjo veprimtari e ofruar me mish e me shpirt Shqipërisë e popullit shqiptar, që rrjedhat e historisë po e merrnin rrëmbyeshëm, mësojmë se atë Ambrozit do t'i kushtonte shumë rëndë. Në vazhdim të të dhënave të shkruara në hyrje të veprës, botuesi nënvizon: “*Me marrjen e pushtetit nga Ahmet Zogu, AT Ambroz Marlaskajt iu desht me u fshehtë prej kërcënimit të dekës e ma vonë kaloi në Itali, ku edhe qendroi deri sa mbylli sytë.*” (*Po aty, fq.3*)

Në këtë botim janë përfshirë artikujt e tij në shtypin periodik të kohës, si: “Ora e Maleve” e “Hylli i Dritës”, si dhe një botim i veçantë me titullin, “Nji monument historik pazotsije në lamë t’ Arësimit në Shqyni”. Botuesi shkruan, se “... Në këtë punim spikat At Ambrozi me njohunitë e tija në filozofi e literaturë, tue ba këtë vepër të vogël ndër punimet ma të bukura të publicistikës apologjetike shqiptare.” (*po aty, fq.3*). Vëllimi në fjalë i paraqitet lexuesit profesionistë, e atij të interesuarit për çështje të edukimit në përgjithësi, e atij gjuhësor në veçanti, duke dashtë të ndriçojë ndihmesa konkrete e bashkëkohore të Marlaskajt.

Kushdo që merr në dorë botimin e mësipërm fillon e lexon të dhënat për jetën e tij, duke mësuar shumë për jetën e veprimtarinë e këtij ati françeskan me shumë kontribute në shumë fusha e drejtime të jetës shoqërore, politike, kulturore në Shqipërinë e kohës, por që vijjnë të vyeshme, e me shumë interes për studiuesit e sotëm, posaçërisht ata në fushë të shkollës, të rëndësisë që kishte e ka mësimi i saktë i gjuhës amtare. Nënvizojmë, se disa nga çështjet e mësipërme janë edhe objekt i kësaj kumtese.

Në veprën studimore kushtuar jetës e veprës së atë Gjergj Fishtës, shkruar mjeshtërisht nga sivëllau i tij atë Daniel Gjeçaj, me titullin “GJERGJ FISHTA- jeta dhe vepra”, BF, Shkodër, 2007, duke folur për veprimtarinë e atë Fishtës si anëtar i shoqërisë “Bashkimi”, në mes tjerash autori shkruan: “... Merret vesh se nga zotësia që kishte dhe nga kompetenca në botëkuptimin evropian e modern, nga shpirti organizues që zotënonte, (është fjala për prelatin Imzot Prengë Doçi- shënimi ynë.) mblodh rreth vetit undyrën e personaliteteve letrare të vendit e sidomos të Veriut. Kështu bani bashkëpunëtorë Dom Dedë Kolecin, Fishtën, Imzot Kolecin, Dom Ndoc Nikajn, Atë Pashk Bardhin, Atë Ambroz Marlaskaj, Luigj Gurakuqin, etj.” (“Gjergj Fishta-jeta dhe vepra”, BF, Shkodër, 2007, fq. 18).

Është kjo renditje e ky vlerësim, që ndërton shtratin kulturor e shpirtëror mbi bazën e të cilit do të ishte e udhës të ishte ngritur e thelluar historia e shtetit, shoqërisë dhe e gjuhës sonë shqipe. Në figurën e ndihmesën e Marlaskajt do të kishim mund të vjelnim disa parime mjaft të rëndësishme në fushë të shkollës, e të didaktikës e metodologjisë së gjuhës shqipe.

Në vëmendjen tonë do të jenë disa prej artikujve shkruar me kompetencë prej kësaj figure të spikatur në historinë e vendit tonë, të gjuhësisë shqiptare e të shkollës sonë:

1. Mbi ortografi të shqipes (ndarë në dy pjesë), i cili siç do ta vërejmë përqendrohet për mes një analize me kritere të qarta në disa nga rregullat e Komisionit Letrar të Shkodrës, duke kërkuar të riformatohen referuar hapave gjuhësor, që prekin rrafshet të ndryshme të gjuhës.

2. Shkollat t’ona, ku gjen pasqyrim të përpiktë në pikëpamje didaktike e metodologjike edukimi gjuhësor i nxënësit.

Materialet e punimeve (proceedings)

ISBN: 978-1-78911-007-4

3. Trajtimi i “Karakterit”(ndarë në tri pjesë), një analizë e hollësishme e natyrës psikologjike e edukative, mbi të cilën ndërtohet e gjithë puna mësimore-edukative në shkollë.

4. Rreth Kongresit Arësimuer të Tiranës, në të cilin shtjellohen me ndërgjegje të lartë punët e të nxënit e të edukimit në Shqipërinë e kohës.

Në leximin e kujdesshëm të artikullit “Mbi ortografi të sotshme”, bie në sy renditja e qartë e arsyeve që diktojnë analizën e autorit në disa nga rregullat e Komisionit Letraro. Një ndër objektet e analizës është bërë përdorimi i drejtë i grupeve të bashtingëlloreve *mb, nd, ngj*, në dy prej radhonyëve të fjalëve shqipe, ku përdoren grupet e mësipërme. Vërejmë se janë dy ata grupe fjalësh, ku autori sugjeron duke analizuar; radhoni i parë janë fjalët onomatopeike, si psh; bumbullue(sipas rregullit të KL; bumullue(sipas Marlaskajt)-(shih At Ambroz Marlaskaj, O.F.M, “Shkollë e Dituni”, B.F, Shkodër, 2022, fq.18). Forma e propozuar nga Marlaskaj mbështetet në parimin fonetik, duke arsyetuar se fjala të shkruhet ashtu si dëgjohet dukuria atmosferike. Forma e sugjeruar nga ai mbështetet me zbatimin e këtij parimi, i cili përdoret në dialektin e gegërishtes, ku grupet *mb,nd, ng, ngj, janë asimiluar në bashtingëllore të thjeshta*. Fenomen ky që haset edhe në disa të folme të toskërishtes, si psh, në labërishten. (Shih: Gjovalin Shkurtaj, “ Dialektet e shqipes, Tiranë, 2016, fq.54). Radhoni i dytë janë fjalë me burim vendas e të huaj, ku kriteri që përdoret për analizën drejtshkrimore është ai etimologjik. Si psh, *pëllambë per pëllamë, tuej e përkrahë me fjalë helenishte “palame”shplaka e dorës; rremb-rem, tuej e përkrahë me fjalë latinisht”ramus”*.(Shih: At Ambroz Marlaskaj, Shkodër, 2022, fq. 18), *rrumbullak-rrumullak, prej rrumull(fjalë e brumit vendas-shënimi ynë; dhanderr-dhanerr pa dyshim prej verbit me dhanë*.(Shih: Marlaskaj, *vep.cit, fq. 18*).

Formimi i Marlaskajt e profesionalizmi i mbështetur fort në ndërgjegjen e përpunuar në të gjitha dimensionet njerëzore, shpirtërore, e filologjike e çojnë atë të gërmojë e të përimëtojë, në çdo rast me preokupimin e vetëm shkrimin e saktë të gjuhës shqipe duke ndihmuar e orientuar kështu si duhet shqipfolësin.

Një grup më vete që gjen analizë në penën e autorit është tufa e foljeve dhe emrave, si psh : *shkojmë, folë, bājme, punëtorë, kryetarë, etj*, për të cilët ai shkruan, se “ ... “ë” nuk do të shkruhet në fund të fjalës, por mbrenda sajë. “ (Shih: Marlaskaj, *vep.cit, fq.21*). Me arsyetimin e mbështetur në kriterin morfemor e fjalëformues, duke specifikuar , se”m”nuk u përket fjalëve, por mbarimit a se caktimit të vehteve.-(pra e vlerëson si mjet gramatikor, prapashtesë trajtëformuese, - shënimi ynë). Analiza vazhdon me përimtimin e formës emnore shumë të caktueme nuk shkruajmë punëtorët por punëtorët, pse “t” asht caktimi i fjalës punëtorë në shumë, njashtu nuk do të shkruhet shkojmë e bajmë, por shkojmë, bajmë. (Shih: Marlaskaj, *vep. cit, fq. 21*).

Nënvizojmë, se vëmendjen tonë e kanë tërhequr kriteret mbi bazën e të cilave ndalet analiza e rishikimit të rregullave të shqyrtuara prej tij: 1. hapja për përmirësim e arsyetim; 2. kriteri i zgjedhur; 3. shkrimi sa më i thjeshtë i gjuhës.

Në hollitë të kësaj logjike, që na duket e drejtë dhe e saktë në pikëpamje pragmatike, dhe filologjike, në fund të fundit hartimi i rregullave drejtshkrimore e drejtshqiptimore nuk është tjetër veçse- formimi solid gjuhësor i përdoruesve të gjuhës- duke parë atë si mjet komunikimi, sa më pranë atij që e përdoron atë.

Një vëmendje të posaçme i kushtohet shkrimit të parafjalëve *më, në, të cilat sipas tij Komisia Letraro në tregimet e veta i shkruan me mb, nd, jo vetëm para fjalësh që fillojnë me zanore..., por edhe para fjalësh që fillojnë me bashtingëllore*.Për një rregull të tillë,

Marlaskaj kundërshton, si më poshtë: “ *Këta do me thanë çiltas me dashtë me vu njeri mendimet e veta si rregulla për t’u ndjekë prejë tjetër kuej, pa pru as arrsyjejet e mendimeve.*” (Shih: Marlaskaj, vep.cit., fq.22).

Në rastet e perzgjedhura për t’i bashkëndarë në hapësirën e kësaj kumtese në fushë të drejtshkrimit të gjuhës shqipe të arsyetuara nga atë Marlaskaj, si dhe në tjera raste të perzgjedhura prej tij, nënvizojmë se analiza i përket motit të largët 1922, por kriteret e punës janë bashkëkohore sot e gjithë ditën. Për të analizuar e për vendosur formën e duhur në secilin nga rastet, që ai analizon, ndjek tri kriteret bashkëkohore, atë fonetik, etimologjik e morfologjik. Ky këndvështrim e kjo metodë e bazuar me kriteret e mësipërme që më 1922, koha kur është shkruar ky artikull, e vendosur në truall të shqipes së sotme, e bën edhe me të drejtë atë që shkruan studiuesi Mehmet Elezi në parathënien e librit “Drejtshkrimi i gegnishtes ose gegnishtja e standardizuese”, Tiranë, 2021, ku në mes tjerash veçojmë: “*Nji hapje me kriteret shkencore për pasunitë e gjuhës shqipe në dialektin gegë, të përjashtueme për arsye jashtëgjuhësore, do ta shëndetësonte gjuhën. Do t’ia forconte imunitetin. Do ta mbushte me energji të reja.*” (Shih: **Mehmet Elezi, vep.cit, fq.9**).

Në analizën e rasteve e në kriteret që ka ndjekur gjejnë pasqyrim merakut e preokupimi që në atëbotë kanë pasë pena të tilla, si Marlaskaj, i cili ishte një prej anëtarëve të Komisionit Letrar të Shkodrës. Në vazhden e kësaj hapje e të këtij merakut, ai ndalet në shqyrtim edhe një tjetër rregull, atë të shkrimit saktë të grupit të fjalëve që në trup të tyre kanë bashtingëlloren “j”. Për këtë rregull ai shkruan duke e sqaruar, se “...j në mes të rrajës e të mbaresave a, e ndiehet vetun nder njata emna, qi kan j-enë mbrendë, a qi mbarojën me zanore të gjatë, b.f. uzdajë, pajë, lojë.ftujë, dhe, rrëfé, palare, kala, raha, gjâ, û, ...un nuk e di, se kush thotë: shpi-ja, Shqypni-ja, mëni-ja, dhi-ja, etj, por në zâ gjithkund ndiehet: shpi-a, Shqypni-a, mëni-a, dhi-a, etj. (Shih: **Marlaskaj, vep. cit. fq. 23**). Në rregullat e drejtshkrimit të gjuhës shqipe, për këtë grup emrash të gjinisë femërore thuhet: “*emrat femërorë që dalin me zanore të theksuar përveç i-së, në të gjitha trajtat, kur zanorja e theksuar ndiqet nga një zanore tjetër : kala-kalaja; rrufe-rrufeja, etj., por bukuri-bukuria; liri-liria...etj.*” (Shih: *Drejtshkrimi i Gjuhës Shqipe, Tiranë, 1973, fq.75*).

Në artikullin “*Msimi i gjuhës amtare*”, vjen e thellohet figura e studiuesit Marlaskaj, i cili i ka për zemër e për zeje punët e mësimin e të përdorimit të gjuhës shqipe, por tashma konkretisht në shkollë, aty ku formohet shqipfolësi. Në hyrje të këtij shkrimi tërheq vëmendjen konkluzioni i tij në raport me mësimin e shqipes në klasat e larta të arsimit shqiptar në atë kohë, më 1921. Konkluzion që na duket se vjen përshtat në disa aspekte, edhe sot sa i takon formatimit të lëndës shkollore Gjuhë shqipe. Ai shkruan: “*Per kurrnji landë msimit të shkollave të nalta nuk gjejmë pikpamje, vendime e rregulla mâ të ndryshme e në daç të thuesh edhe në kundërshtim me njena tjetren, sa në msim të gjuhës shqype.*” (Shih: **Marlakaj, vep.cit, fq. 33**).

Pikëpamjet sa i takon përmbajtjes, kompozimit e shtrimit të kësaj lënde shkollore, Marlaskaj i grupon si më poshtë:

- Disa mendojnë, se kryet e punës në mësimin e gjuhës duhet ta zërë ortografia e trajtimi i mbarë foljeve;
- Të tjerë, se themeli i gjuhës është ushtrimi praktik ndër folje, e pjesë të tjera të ligjeratës;
- Të tjerë mendojnë, se ushtrimi ndër rregulla të gramatikës e të sintaksës e bëjnë nxënësin të jetë i karikuar në studimin e gjuhës në pikëpamje historike e filologjike;

- E një grup më vete përbëjnë ata që mendojnë, se në mësimin e gjuhës nxënësi duhet të merret me fuqinë e fjalive e të foljeve (semantika e fjalisë me bërthamën rreth së cilës krijohet ajo-foljen.) Në këtë grup tërheq vëmendjen koncepti shumë i rëndësishëm në organizimin sintaksor të fjalisë se bërthama është folja-kallëzues, si dhe shkrirja e këtij elementi themelor morfo-sintaksor me semantikën.

Rreshtimi i këtyre pikëpamjeve në fushë të të nxënimit të gjuhës amtare prej atë Marlaskajt mendojmë, se është një tablo e qartë e metodologjive të ndryshme mbi të cilat mbështetjet zhvillimi e shtjellimi i kësaj lënde në shkollën shqiptare të kohës, ku jetoi e veproi studiuesi. Vërejmë, se ai është shumë solid e i përpiktë në analizat që bën në këtë fushë, kur e bashkon platformën e konceptimit të mësimin të gjuhës amtare në bashkëlidhje e bashkëveprim me mësimin e gjuhëve të huaja. Marlaskaj shkruan: “*Msuest e gjûhvet të hueja presin qi me msim të gramatikës shqype t’i vehet themel njoftsive gramatikore të gjithmarshme qi lypen per të zânun ç’do gjûhë*”. (Shih: Marlaskaj, vep.cit, fq.34).

Në penën e Marlaskajt sa i takon procesit të edukimit gjuhësor të nxënësit në lëndën e gjuhës amtare në procesin shkollor dalin në dritë qartazi, duke vazhduar edhe sot të ndriçojnë rrugën e mësuesit apo didaktit të saj. Marlaskaj shkruan: “*Fmia prâ, sidomos në klasat e nalta, jo vetun do të zanë me e njoftë gjûhën e vet, por edhe do t’a dijnë, e at herë ka me dijtë plotsisht kuer setcillen fjalë, setcillen folje e mëndyrë të thanunit të mrrije me kuptue mas ç’do pikpamjet në daç letrare, në daç logjike, historjake, morale, skencore, etj.*” (Shih: Marlaskaj, vep.cit, fq. 34). Autori bën mjeshtrisht dallimin në mes rrafshit të njohjes e rrafshit të dijes, duke i dalluar ata sipas niveleve të punës në procesin e të nxënimit nga cikli në cikël. Një karakteristikë tjetër që spikat në analizën se si duhet të ndërtohet mësimi i gjuhës shqipe në shkollë, është mbështetja në zbatimin e zberthimin e parimit ndërdisiplinor të kësaj lënde, i cili duhet zotëruar mirë nga mësimdhënësi i saj. Në këtë kontekst, në mes tjerash, ai nënvizon: “... *Msuesi do t’a zotnojnë aq mirë e aq hapët landën e vet sa kurr mos të ngushtohet me u bâ qolja e robi i sajë, por landa do të jetë në dorë të tij një vegël e elmizë aq e përdorshme sa aj pa zorë aspak t’a qesin në punë ku e si t’a lypin programi qi ndjekë, gjëja, koha, klasa e psikologia e fmis.*” (Shih: Marlaskaj, vep.cit, fq. 35).

Metodologjia që duhet të udhëheqë mësuesin në mësimdhënien e lëndës së gjuhës amtare është një prej preokupacioneve profesionale të atë Marlaskajt, të cilën e shtrin dhe e analizon sipas shkollave gjuhësore.

Një grup janë ata që në plan të parë vendosin logjikën në raport me gramatikën, një grup tjetër vendosë në plan të parë gramatikën të trajtuar si traktat filozofik. Mjeshtrisht dhe përmes një gjuhe të zhdërvjelltë, autori tregon, shpreh qartë format e punës që duhet të ndjekë mësuesi i gjuhës amtare, si dhe ku duhet të synojë mësimnxënien e kësaj lënde. Në çdo rast e hap në analizat e punës edukuese e formuese në shkollë, e në lëndën shkollore të gjuhës shqipe, ai udhëhiqet nga parimi: “*Tjeter âsht me njoftë një send e tjeter âsht me e dijtë.*” (Shih: Marlaskaj, vep.cit, fq.34). Marlaskaj me parimet e tij në fushë të didaktikës së mësimdhënies së gjuhës shqipe kishte me qenë sot e gjithë ditën një model pune për mësuesit. Në penën e tij shprehet saktë, sa më poshtë: “*Me të vertetë se fmia do zanë me mendue marë, por gjith herë mas gjejës shpirtnore në të cillën gjindet e mas natyrës së mjeteve e të rrethanave neper të cillat e prejë të cillave do të marrin shkas e ndihmë per me ja mrritë kti qellimi...*”

Njimend se âsht punë e zorshme, por nuk âsht e qi s’bahet, e në kta mahet e dishmohet aftsia e msuesit të giuhës. Kuer, tuej ndjekë gjurmë per gjurmë rregullat e morfologis e të syntaxit, nuk shmanget askund prejë shpirtit të giuhës por ma tepër i ep jetë e

fuqi të ré mëndyrve të thanunit e vetive të veçanta të gjuhës..”(Shih: Marlaskaj, vep.cit, fq. 38).

Një përshkrim i tillë i objektit, qëllimit e mënyrës së zbatimit të procesit të zhvillimit të kësaj lënde do t’i bënte nder teksteve të didaktikës, si dhe parimit të shkrimit e përpilimit të teksteve shkollore. Të konceptuarit e të punuarit me këtë frymë e në këtë drejtim e lëndës së gjuhës shqipe në shkollë do të kishte ndihmuar për fryte më dobiprurëse në formimin e nxënësve, jo thjesht në dhënie të informacioneve gramatikore, që merren e rimerren nga klasa në klasë, nga cikli në cikël. Parimi i Marlaskajt ka të bëjë me edukimin e mendjes e shpirtit së nxënësit me gjuhën amtare. Rrethi i studimit e edukimit gjuhësor kalon përtej saj duke e parë atë në raport dhe bashkëpunim me gjuhët e tjera. Ai ashtu si sivëllezërit e tij, e kanë konceptuar edukimin gjuhësor të nxënësit duke e parë shqipen në dritën e gjuhëve indoeuropiane, familjes gjuhësore së cilës i përket, sigurisht me të gjitha specifikat e saj në të gjitha sistemet e nënsistemet.

Në këtë pikë të raportit të shqipes me gjuhët e huaja, si disiplina shkollore në një anë, e si marrje e dhënie e fjalëve e formave, apo strukturave gramatikore nga gjuha në gjuhë, Marlaskaj është shumë i qartë. Ai shkruan: “*Asht e dijtne se gjithsecilla gramatikë ka palcin e vet qi janë rregullat e veçanta qi ka në vedi, e kishte me kenë një gabim i madh me dashtë me e sajue gramatikën t’onë.... Kishte me i u ba një dhunë gjuhës amtare me pasë per t’i majtë porsit të shmanguna a se gjymtime të gjuhës amtare ç’do trajtë a rregull qi nuk perkon me gramatikë të huej...*”(Shih: Marlaskaj, vep.cit, fq. 37).

Do të ishte mjeshtrorë të ekuilibrohet thellimi i karakteristikave të gjuhës shqipe përmes strukturave të saj fonetike, morfo-sintaksore, leksiko-semantike në natyrën e saj, duke kërkuar të rindërtohet filli i saj historik, pa harruar se shqipja është një degë më vete e familjes gjuhësore indoeuropiane.

Në këtë linjë të marrëdhënies e raporteve të gjuhëve në procesin e mësimdhënies e mësimnxënies në rrjetin shkollor, na vjen në ndihmë edhe parimi për të cilin shkruante edhe mjeshtri i gramatikës shqipe atë Justin Rrota, në librin e tij “Sintaksi i shqipes”. Në mes tjerash, duke folur për parimet që ka ndjekë për kategorizimin e gjymtyrëve të fjlaisë, ai shkruan: “... *Ky kategorizim i a shtron rrugën xânsit për të fituem mâ lehtësisht mësimin e gjûhvet klasike. Kjo kje edhe arsyeja edhe, q ina shtyni të shtijshim pa kursim në tekstin e paraqitun fjalë teknike të përdorimit ndërkombëtar. Kishim para sysh, se ky sintaks u drejtohet mâ shumë do të mirren me mësimin e gjuhëvet të hueja, klasike a moderne. Këtë e theksojn si një gjâ të nevojshme edhe Programat Arsimore(1940) ku thonë: Nxansi duhet të zotnojë mirë e pa pëshjtjellime terminologjinë gramatikore, si shqip, si latinisht.*”(At Justin Rrota, “Sintaksi i shqipes”, Botimimi III, BF, Shkodër, 2005, VIII).

Në të tilla këndvështrime e parime të ideuara, të shprehura e të përdorura

në atë botë kishte me qenë e drejtë të shikohej e të analizohej edhe gjendja e situata e sotme e shkollës sonë, posaçërisht e gjuhës shqipe, duke kuptuar kështu edhe më mirë se çka mund të përmirësohet, apo edhe të riformatohet, pa pasë kurrfarë mendimi me mohue meritat e punës që është bërë e bëhet në këtë lëmi.

Literatura:

1. At Ambroz Marlaskaj, O.F.M, BF, Shkodër, 2022.
2. At Justin Rrota, O.F.M, BF, Shkodër, 2005.
3. At Daniel Gjeçaj, O.F.M, BF, Shkodër, 2007.

KONFERENCA E PARË NDËRKOMBËTARE NË GJUHËSI
“Ligjërimi i shkruar dhe i folur, probleme reale dhe propozime konkrete për zgjidhjen e tyre”

Materialet e punimeve (proceedings)

ISBN: 978-1-78911-007-4

4. Drejtshkrimi i gegnishtes ose Gegnishtja e standartizueme; Përgatitja për botim, parathania dhe shenimet Mehmet Elezi.
5. Gjovalin Shkurtaç, “Dialektet e shqipes”, Tiranë, 2016.
6. Drejtshkrimi i gjuhës shqipe, Tiranë, 1973.

Shumëgjuhësia dhe të drejtat gjuhësore në Republikën e Kosovës

PROF. AS. DR. FATON KRASNIQI
Instituti Albanologjik - Prishtinë

Abstrakt

Shumëgjuhësia dhe të drejtat gjuhësore në Republikën e Kosovës janë respektuar dhe janë avancuar në vazhdimësi dhe kjo për ne është një e arritur dhe një vlerë e shtuar shoqërisë sonë. Republika e Kosovës i ka mbështetur dhe respektuar në vazhdimësi dhe mënyrë institucionale të gjitha gjuhët e pakicave kombëtare. Gjithashtu Ligji i Kosovës mbi Përdorimin e Gjuhëve, i miratuar në vitin 2006, saktësisht thotë se shqipja dhe serbishtja janë gjuhët zyrtare të Kosovës dhe për këtë arsye të gjitha institucionet dhe ofruesit e shërbimeve publike janë të detyruara të sigurojnë përdorimin e tyre të barabartë në sistemin gjyqësor, institucionet shtetërore dhe komunale, ndërmarrjet publike, në media, arsim, shërbime sociale dhe në sektorin privat dhe një gjë e tillë ka ndodhur. Shumëgjuhësia në Kosovë është vlerë e shtuar dhe si e tillë është vlerësuar nga bota perëndimore. Republika e Kosovës gjithmonë ka qenë e përkushtuar në promovimin e vlerës së shumëgjuhësisë, duke pasur parasysh se kjo vlerë është mjet për ruajtjen e karakterit fort të pasur dhe të larmishëm të shoqërisë sonë. Sa i përket përdorimit të gjuhëve zyrtare (dy gjuhësisë, shumëgjuhësisë), në institucione komunale dhe shtetërore qytetarët e saj i ka trajtuar në mënyrë të barabartë në komunikim, në dokumente zyrtare, në takime publike, në ueb – faqet e institucioneve, emrat zyrtarë të qyteteve dhe fshatrave, shesheve, bulevardëve, rrugëve etj., kurse gjuhët në përdorim zyrtar në nivel komunal kanë funksionuar në përputhje me kornizën ligjore, si në shpalljen e konkurseve komunale njoftimeve të ndryshme komunale. Kuvendet komunale në seancat e tyre kanë lektorë dhe përkthyes profesionalë, ku çdo material përkthehet me kohë dhe është në funksion të qytetarëve dhe zyrtarëve komunalë.

Fjalët çelës: *shumëgjuhësia, gjuha zyrtare, të drejtat gjuhësore, komunat, komunitetet*

Hyrje

Republika e Kosovës i ka gjithsej 38 komuna, gjuha shqipe është gjuhë zyrtare në 35 komuna, në Komunën e Zubin Potokut⁹⁹ dhe Zveçanit¹⁰⁰, Mitrovicës Veriore¹⁰¹ gjuha shqipe nuk është gjuhë zyrtare, apo nuk përfillet nga institucionet komunale; gjuha serbe është gjuhë zyrtare në 38 komuna të Republikës së Kosovës; gjuha boshnjake është gjuhë zyrtare në tri komuna dhe gjuhë në përdorim zyrtar në një komunë të Republikës së Kosovës (në komunën e Dragashit¹⁰², Pejës¹⁰³, Prizrenit¹⁰⁴, Istogut¹⁰⁵); gjuha turke është gjuhë zyrtare në dy komuna dhe gjuhë në përdorim zyrtar në tri komuna të Republikës së Kosovës (në komunën e Prizrenit¹⁰⁶, Prishtinës¹⁰⁷, Mamushës¹⁰⁸, Mitrovicës Veriore¹⁰⁹, Gjilanit¹¹⁰). Të gjitha

⁹⁹ org/wiki/Opština_Zubin_Potok

¹⁰⁰ <http://www.opstinazvecan.rs/>

¹⁰¹ kk.rks-gov.net/mnao/?lang=sr-Latn-CS

¹⁰² <https://kk.rks-gov.net/dragash/>

¹⁰³ <https://kk.rks-gov.net/peje/>

¹⁰⁴ <https://kk.rks-gov.net/prizren>

¹⁰⁵ <https://kk.rks-gov.net/istog/>

¹⁰⁶ kk.rks-gov.net/prizren/default.aspx?lang=tr-TR

¹⁰⁷ tr.wikipedia.org/wiki/Prištine_Belediyesi

¹⁰⁸ tr.wikipedia.org/wiki/Mamuşa_Belediyesi

¹⁰⁹ kk.rks-gov.net/mnao/?lang=sr-Latn-CS

njoftimet, shpalljet, ftesat në komunat e Republikës së Kosovës bëhen në gjuhët zyrtare të tyre. Gati të gjitha komunat në Republikën e Kosovës kanë përkthyesit e tyre gjuhësorë, të cilët janë të obliguar që të gjitha materialet gjuhësore t'i përkthejnë në gjuhët zyrtare të atyre komunave. Në të gjitha komunat e Republikës së Kosovës ka gjithsej pesëdhjetë e dy profesionistë gjuhësorë. Të gjitha komunat ofrojnë mbështetje të brendshme me shërbime të brendshme gjuhësore kanë një deri dy profesionistë gjuhësorë. Komuna më “multilinguale”, në Republikën e Kosovës është komuna e Prizrenit. Komuna e Prizrenit njih katër gjuhë zyrtare gjuhën shqipe, turke, serbe, boshnjake. Kurse numri i përgjithshëm profesionistëve gjuhësorë në institucionet qendrore të Republikës së Kosovës është gjithsej 48 profesionistë gjuhësorë, pra përkthyes dhe lektorë. Republika e Kosovës me kushtetutën e saj u ka dhënë shumë të drejta gjuhëve të pakicave kombëtare, veçanërisht pakicës serbe dhe turke.

Të drejtat gjuhësore në Republikën e Kosovës sigurohen përmes Kushtetutës, Ligjit për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës dhe ligjit për përdorimin e gjuhëve¹¹¹. Sipas këtyre dokumenteve ligjore, gjuha shqipe, gjuha serbe dhe alfabetet e tyre përkatëse gëzojnë status të barabartë dhe qytetarët e tyre kanë të drejtë në përdorimin e cilëndo prej tyre në marrëdhënie me institucionet publike të Kosovës¹¹². Për më tepër, gjuhëve të komuniteteve joshumicë mund t'u akordohet statusi i gjuhëve zyrtare, apo gjuhëve në përdorim zyrtar.

Ligji për përdorimin e gjuhëve parasheh:

- Gjuha shqipe dhe gjuha serbe dhe alfabetet e tyre janë gjuhë zyrtare në Republikën e Kosovës dhe kanë status të barabartë (neni 2.1);
- Gjuhët e tjera të komuniteteve, si gjuha turke, gjuha boshnjake, gjuha rome do të jenë gjuhë në përdorim zyrtar në nivel komunal, sipas kushteve të përcaktuara në këtë ligj (neni 1.2.).
- Përbërjen demografike të popullsisë së një komune të nevojshme për të vendosur një gjuhë të një komuniteti si gjuhë me statusin e gjuhës zyrtare apo në përdorim zyrtar. Në këtë mënyrë, nëse pjesëtarët e një komuniteti, gjuha amtare e të cilëve nuk është njëra nga dy gjuhët zyrtare dhe të cilët përbëjnë 5% të popullsisë së përgjithshme të komunës, gjuhës së tyre mund t'i akordohet njohja si gjuhë në nivel komunal (neni 2.3).
- Për shkak të “traditës”, gjuha turke ka statusin e gjuhës zyrtare në komunën e Prizrenit (neni 2.3).
- Të gjitha gjuhët zyrtare të komunës janë të barabarta me njëra-tjetrën (neni 7.1); të drejtën për të marrë shërbimet në dispozicion dhe dokumente nga institucionet komunale në cilëndo gjuhë zyrtare (neni 7.2); detyrim, që, sipas kërkesës, të ofrohen shërbime të përkthimit në të folur dhe për t'i vënë ato në dispozicion (neni 7.3); se të gjitha dokumentet zyrtare duhet të ruhen dhe nxirren në të gjitha gjuhët zyrtare të komunës (neni 7.6); se institucionet komunale duhet të sigurojnë një mjedis pune të favorshëm për përdorimin e cilëndo gjuhe zyrtare nga ana e stafit të tyre (neni 7.5).
- Të drejtën e personave që u përkasin komuniteteve gjuha e të cilëve është në përdorim zyrtar që të komunikojnë në institucionet publike të Republikës së Kosovës në gjuhën e tyre (neni 8.1. 8.2); rregulloret dhe aktet ndihmëse komunale duhet të nxirren dhe të publikohen në gjuhët e këtyre komuniteteve, nëse ata e kërkojnë (neni 8.3);

¹¹⁰ tr.wikipedia.org/wiki/Gilan_Belediyesi

¹¹¹ Ligji për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës nr. 03/L-047.

¹¹² Ligji për përdorimin e gjuhëve {nr.02/L-37},neni 2.2., Prishtinë (2006).

▪ Emrat zyrtarë të institucioneve e organeve komunale dhe shenjat që tregojnë emrat e komunave, fshatrave, rrugicave e vendeve tjera publike duhet të jenë të vendosura në gjuhët zyrtare që kanë statusin e gjuhës zyrtare në komunë (neni 9.1, 9.2);

▪ Institucionet e Republikës Kosovës në nivel komunal janë të obliguara që nëpërmjet akteve të tyre nënligjore të rregullojnë hollësisht përdorimin e gjuhëve, në përputhje me dispozitat e këtij ligji (neni 35).¹¹³

Qytetarët e Republikës së Kosovës kanë të drejtën e përdorimit të gjuhëve zyrtare në nivel lokal, ata mund ta përdorin cilëndo gjuhë zyrtare në komunat e vendit dhe institucionet gjegjëse komunale. Kurse sa i përket diskriminimi në baza gjuhësore në Republikën e Kosovës është i ndaluar dhe sanksionohet, si p.sh.: kur gjuha neglizhohet gjatë ofrimit të shërbimeve publike në administratë, organizatë ose ndërmarrje publike. Dihet botërisht se gjuhët luajnë rol kryesor në promovimin e dialogut ndërkulturor. Njohja e gjuhëve të ndryshme botërore forcon bashkëpunimin ndërshtetëror, ndërkulturor dhe ndërinstitutional dhe ne shumëgjuhësinë në vendit tonë e shohim si vlerë të çmuar për të cilën kemi punuar dhe po punojmë që të arrijmë rezultate të kënaqshme të funksionalizimit të mëtejshëm.

Sa i përket gjuhës zyrtare ajo është gjuha formale që përdoret në një shtet të caktuar. Gjuha zyrtare është një gjuhë e cila flitet nga të gjithë funksionarët e shtetit. Disa shtete si Kanadaja kanë dy gjuhë zyrtare: gjuhën angleze dhe gjuhën frënge dhe zakonisht një punonjës i punësuar në administratën e shtetit, i cili ka të bëjë me publikun, duhet të dijë të komunikojë, të flasë dhe të shkruaj, në të dyja këto gjuhë¹¹⁴. Kurse me "Gjuhë rajonale ose gjuhë e pakicës", nënkuptojmë gjuhët që janë përdorur në mënyrë tradicionale brenda një territori të caktuar të një shteti nga shtetasit e atij shteti, të cilët e formojnë një grup numerikisht më të vogël se pjesa tjetër e popullsisë së shtetit, nuk i përfshinë as dialektet e gjuhës (gjuhëve) zyrtare të shtetit dhe as gjuhët e shtegtarëve; "territori në të cilin përdoret gjuha rajonale apo e pakicës" nënkupton zonën gjeografike në të cilën gjuha në fjalë është mënyra e shprehjes së një numri të njerëzve, që justifikon marrjen e masave të ndryshme mbrojtëse dhe mbështetëse të parashikuara në këtë kartë; "gjuhët joterritoriale" nënkupton gjuhët e përdorura nga shtetasit e shtetit, të cilat ndryshojnë nga gjuha ose gjuhët e përdorura nga pjesa tjetër e popullsisë së shtetit, por që ndonëse të përdorura në mënyrë tradicionale brenda territorit të atij shteti nuk mund të identifikohen me një vend të caktuar¹¹⁵.

Përfundim

Qytetarët e Republikës së Kosovës kanë të drejtë të përdorin njërin nga gjuhët zyrtare gjatë shërbimeve që pranojnë gjatë përkujdesjes shëndetësore, si në sportelet e informimit, faturat nga kompanitë publike, aplikimet dhe dokumentet e tjera të ngjashme, që ofrojnë institucionet publike, aplikimet në qendrat sociale, aplikimet për punë, kërkesat për hapje biznesi, kërkesa për çështje sociale e urbane, kërkesa dhe ankesa në zyrat e Policisë së Kosovës, në zyrat Forcës së Sigurisë së Kosovës, në Postën e Kosovës, regjistrimin e veturës, regjistrimin pronës, regjistrimin e biznesit, informacionet në stadione dhe palestra sportive, aeroporte, autostrada, etj. Institucionet e Republikës së Kosovës që nga themelimi i tyre kanë qenë të obliguara që në të njëjtën kohë t'i publikojnë të gjitha informacionet publike në formë elektronike dhe të shtypur në gjuhët zyrtare të kuvendeve komunale dhe kjo ka funksionuar me përpikëri. Gjithashtu një rol të rëndësishëm dhe shumë profesional ka luajtur Kuvendi i Republikës së Kosovës, por edhe ministria e Administratës dhe Pushtetit Lokal pasi e ka

¹¹³ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2440>, f. 2.

¹¹⁴ https://sq.wikipedia.org/wiki/Gjuha_zyrtare.

¹¹⁵ Karta Evropiane për Gjuhët Rajonale ose Minoritare Strasbourg, më 5.11.1992.

Materialet e punimeve (proceedings)

ISBN: 978-1-78911-007-4

pasur gjithmonë në prioritet përdorimin e gjuhëve si një prej kushteve që duhet përmbushur komunat për t'i kontribuar zbatimit të programit kombëtar për MSA-në, në mënyrë që kjo çështje të zbatohet shumë seriozisht në nivel lokal. Sa i përket Ligjit për gjuhët Kosova është shumë para shteteve të rajonit, pasi garantohet që në së paku 5% të komuniteteve jo shumicë gjuha e tyre të ketë statusin zyrtar në komunë. Dhe kur themi se ne jemi para shumë shteteve të rajonit me Ligjin e gjuhëve e argumentojmë me faktin se në Maqedoninë e Veriut ligji për gjuhët parasheh diçka tjetër, pasi gjuhë zyrtare mund të jetë vetëm ajo gjuhë që e flasin mbi 20 % e qytetarëve. Kurse Ligji për gjuhët i Republikës së Kosovës e ka bërë një “lëshim” dhe një gjë të tillë, një term të tillë nuk e kam hasur në hulumtimet tona. Pra ky ligj, po e citoj: Për shkak të “traditës”, gjuha turke ka statusin e gjuhës zyrtare në komunën e Prizrenit (neni 2.3), Ligji për gjuhët. Komuniteti turk në Prizren nuk i arrin as 5% të numrit të përgjithshëm të pakicave kombëtare, por ligji për gjuhët e favorizon këtë komunitet me termin: për shkak të “traditës” që në linguistikë është term i ri dhe i cili e arsyeton gjuhën turke si gjuhë zyrtare në Komunën e Prizrenit, prandaj me të drejt themi se shumëgjuhësia dhe të drejtat gjuhësore në Republikën e Kosovës janë avancuar dhe respektuar më shumë se në çdo vend të rajonit.

Literatura

Fjalor i shprehjeve parlamentare dhe ligjore, OSBE, Prishtinë, 2005.

Kasumaj, Sylë, *Fjalor i termave të drejtësisë*, IAP, Prishtinë, 2019.

Karta Evropiane për Gjuhët Rajonale ose Minoritare Strasbourg, më 5.11.1992

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Prishtinë, 2008.

Ligji për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës nr. 03/L-047.

Ligji për përdorimin e gjuhëve {nr.02/L-37}, Prishtinë, 2006.

Monitorimi dhe vlerësimi i të drejtave gjuhësore, Republika e Kosovës, Prishtinë, 2015.

org/wiki/Opština_Zubin_Potok

<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2440>.

<http://www.opstinazvecan.rs/>

<https://kk.rks-gov.net/dragash/>

<https://kk.rks-gov.net/peje/>

<https://kk.rks-gov.net/prizren>

<https://kk.rks-gov.net/istog/>

https://sq.wikipedia.org/wiki/Gjuha_zyrtare

kk.rks-gov.net/mnao/?lang=sr-Latn-CS

kk.rks-gov.net/mnao/?lang=sr-Latn-CS

kk.rks-gov.net/prizren/default.aspx?lang=tr-TR

tr.wikipedia.org/wiki/Priştine_Belediyesi

tr.wikipedia.org/wiki/Mamuşa_Belediyesi

tr.wikipedia.org/wiki/Gilan_Belediyesi

Veçori të termave në medie nga fusha e teknologjisë

PROF. AS. DR. SEJDI GASHI
Instituti Albanologjik-Prishtinë

Abstrakt

Në fokus të këtij punimi është çështja e fjalësit terminologjik në medie nga fusha e teknologjisë.

Në Kosovë dhe në Shqipëri, ashtu si edhe në mbarë botën, leksiku i shkencave të informacionit (kupto teknologjisë) po fiton gjithnjë e më shumë rëndësi, për shkak të zhvillimit teknologjik dhe numrit në rritje të përdoruesve të pajisjeve elektronike. Shpejtësia me të cilat depërtojnë këta terma në një gjuhë të caktuar (në rastin tonë në shqipen) e vështirëson procesin e përshtatjes (përkthimit) apo gjetjes së barasvlerësit të tyre. Veçanërisht kjo është e dukshme te termat në artikujt e botuar në medie, të cilët, me sa kemi pasur mundësi të hulumtojmë, në shumë raste nuk përkthehen, nuk përshtaten as kur shqipja e ka një barasvlerës të kënaqshëm, ose kur ekziston mundësia e përshtatjes së tyre.

Fjalët çelës: *gjuhë, medie, terma, teknologji, internet, pajisje elektronike, inteligjencë artificiale, semantikë.*

Hyrje

Shkrimi në vetvete është shpikje e përmasave historike. Në të gjitha kohërat, zbulimet e ndryshme e veçanërisht teknologjia ka formësuar përdorimin e gjuhës. Lashtërisht, historia ka dëshmuar në mënyrë të përsëritur se çdo mjet i ri komunikimi ka një ndikim të madh në gjuhë, sidomos në trajtën shkrimore të saj. Edhe sot ndodh kështu. Porse, në ditët tona, ky relacion është më kompleks dhe më dinamik. Kështu, nga njëra anë, roli i inteligjencës artificiale po rritet gjithnjë e më tepër, por nga ana tjetër, po rriten edhe shqetësimet për privatësinë, etikën apo sigurinë që cenohen si rezultat i këtyre teknologjive. Duke qenë se media luan një rol parësor në edukimin e njerëzve, përdorimi i terminologjisë së saktë nga sfera e teknologjisë është hapi i parë i edukimit cilësor të masës, sidomos nga pikëpamja gjuhësore. Përderisa, digjitalizimi vazhdon t’i transformojë shoqëritë tona, ai ka ndikuar edhe në gjuhën e përdorur për të përshkruar këtë proces. Termat që përshkruajnë proceset e digjitalizimit në shumë raste duken të paqartë. Për shembull, fjalët- terma *digjital – kibernetik – online- inteligjencë artificiale* në dukjen e parë nuk kanë dallim në përdorimin dhe kuptimin e përgjithshëm të tyre. Po ashtu, mund të ndodhë që termat e përdorur fillimisht në një kuptim thjesht teknik në fushën e shkencave kompjuterike, të ndryshojnë kuptimin e tyre kur fillojnë të përdoren në kontekste të tjera, si për shembull në komunikimin politik apo në situata konflikti¹¹⁶.

Në Kosovë e Shqipëri, ashtu si në mbarë botën, terminologjia e teknologjisë po fiton gjithnjë e më shumë rëndësi, për shkak të zhvillimit teknologjik dhe numrit në rritje të përdoruesve të pajisjeve elektronike në të gjithë botën. Studiuesi N. Caka që është marrë me çështje të terminologjisë së informatikës pohon se: “Numri i termave të krijuar për të shprehur konceptet e reja që kanë të bëjnë me informatikën dhe me teknologjinë e informacionit vazhdimisht rritet, meqë vazhdimisht rritet numri i pajisjeve të reja të teknologjisë së informacionit dhe i programeve kompjuterike. Sipas tij, duke qenë se këto pajisje e këto

¹¹⁶ https://stratcomcoe.org/cuploads/pfiles/digital_terminology_nato_stratcom_coe_14-10-2020.pdf (qasur së fundmi më 20.12.2023).

programe kryesisht vijnë nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, e bashkë me to dokumentacioni përcjellës me termat përkatës në gjuhën angleze, del e domosdoshme që vendet joanglishtfolëse të ballafaqohen me çështjen e përkthimit, në gjuhë vendi, të dokumentacionit dhe të termave që i shoqërojnë këto pajisje dhe këto programe, shpesh menjëherë pas hedhjes së tyre në treg”.¹¹⁷

Duke qenë se shpejtësia me të cilat depërtojnë këta terma në një gjuhë të caktuar (në rastin tonë në shqipe) e vështirëson procesin e përshtatjes (përkthimit) apo gjetjes së barasvlerësit të këtyre termave. Veçanërisht kjo është e dukshme me termat në artikujt e botuar në medie, të cilët, me sa kemi pasur mundësi të hulumtojmë, në shumë raste nuk përkthehen, nuk përshtaten as kur shqipja e ka një barasvlerës të kënaqshëm, ose kur ekziston mundësia e përshtatjes së tyre. Raste të tilla kemi hasur shpesh në artikujt që kemi marrë në shqyrtim, si ne mediat në Kosovë, po ashtu edhe në ato në Shqipëri. Tekst-shkruesit e këtyre lajmeve në shumicën e rasteve i kanë lënë termat ashtu siç kanë hyrë nga gjuha e huaj (kryesisht nga anglishtja, por edhe nga gjuhë të tjera).

Ja disa shembuj: **Cache:** Një grup skedarësh të ruajtur në hard diskun tuaj që ndihmojnë shfletuesin tuaj të shfaqë më shpejt faqet që keni vizituar tashmë. Ai shfaq skedarët nga hard disku juaj në vend të uebit; **Cookie:** Një pjesë e vogël e informacionit që mund t’ju kërkohet të pranoni kur lidheni me serverë të caktuar nëpërmjet një shfletuesi uebi. Përdoret gjatë gjithë sesionit tuaj si një mjet për t’ju identifikuar. Një cookie është specifike dhe dërgohet vetëm te serveri që e ka krijuar atë; **Cross-Platform:** Ndër-platforma (a.k.a. agnostik, aplikacion agnostik dhe platformë agnostike) i referohet diçkaje që është e ndërveprueshme midis sistemeve dhe platformave të ndryshme operative. Ndër-platforma, megjithatë, është më e fokusuar në softuer që mund të funksionojë në çdo sistem operativ dhe në çdo arkitekturë të procesorit; **Data center:** Pajisje që përdoren për të ruajtur sistemet kompjuterike dhe komponentët e lidhur, të tilla si telekomunikacioni dhe sistemet e ruajtjes. Në përgjithësi, përfshin furnizime rezervë të energjisë dhe pajisje sigurie; **Download:** Procesi i transferimit të një ose më shumë skedarëve nga një kompjuter i largët në kompjuterin tuaj lokal. Veprimi i kundërt është ngarkimi; **Network adapter:** Një pajisje që lidh kompjuterin tuaj me një rrjet; i quajtur gjithashtu një kartë përshtatës ose kartë e ndërfaqes së rrjetit.; **Phishing:** Phishing është një lloj inxhinierie sociale ku një sulmues dërgon një mesazh mashtrues të krijuar për të mashtruar një viktimë njerëzore për të zbuluar informacione të ndjeshme ndaj sulmuesit ose për të vendosur softuer me qëllim të keq në infrastrukturën e viktimës; **Router:** Një pajisje që përdoret për lidhjen e dy Rrjeteve Lokale (LAN). Është detyra e ruterit të kalojë trafikun dalës nga pajisjet tuaja lokale në internet dhe të kalojë trafikun hyrës nga interneti në pajisjet tuaja; **Username:** Një emër i përdorur në lidhje me një fjalëkalim për të fituar akses në një sistem kompjuterik ose një shërbim rrjeti; **Vishing:** Phishing me zë, ose vishing, është përdorimi i telefonisë për të kryer sulme phishing.

Sot, ligjërimin shqip të shkruar, por edhe atë të folur e kanë vërshuar një lumë termash jo-shqip si: *disketë; formatoj, formatim, internet, intranet, klikoj, klikim, kompjuter, kompjuterik, kompjuterizoj; kursor, mikroprocesor, mikrokompjuter; printer, printoj, printim, i printuar; monitor, monitoroj, monitorim, laser, disk, disk magnetik, disk optik, dritare, dosje, ikonë, skedar, kujtesë, meny, mouse, save, virus, tast, tastierë* etj. Së këndejmi,

¹¹⁷ N. Caka, *Terminologjia e informatikës në gjuhën shqipe dhe standardizimi i saj në fjalorë*, marrë nga:

https://www.academia.edu/3613797/Terminologjia_e_informatik%C3%ABs_n%C3%AB_gjuh%C3%ABn_shqipe_dhe_standardizimi_i_saj_n%C3%AB_fjalor%C3%AB (qasur së fundmi më 20.12.2023).

studiuessi N. Caka thekson se “sasia dhe shpejtësia e madhe e depërtimit të këtyre termave nga anglishtja në gjuhët e tjera e vështirëson krijimin me sukses të një terminologjie të njësuar të informatikës në shumicën e gjuhëve. Për shkak të pamundësisë së reagimit të shpejtë dhe me sukses, shpesh përqafohet termi i anglishtes, madje pa përshtatjen e nevojshme fonetike, morfologjike e semantike”¹¹⁸, prandaj, sot, gjendje e tillë mbretëron edhe në gjuhën shqipe.

Marrëdhëniet sistemore të fjalësit terminologjik

Në sistemin e leksikut të përgjithshëm janë të njohur tipat e marrëdhënieve sistemore të fjalëve; marrëdhëniet e shumëkuptimisë, të sinonimisë, homonimisë dhe të antonimisë¹¹⁹. Megjithatë, dukuritë semantike në terminologji kanë specifikën e tyre, sidomos kur këto kundrohen brenda një fushe të dijes a të veprimtarisë njerëzore, sepse jashtë tyre dukuritë e mësipërme semantike kanë pak a shumë të njëjtat karakteristika me ato të leksikut të përgjithshëm. Kjo do të thotë se dukuritë semantike (sinonimia, antonimia, polisemia) mund të studiohen me vlerën e tyre të plotë vetëm, kur vështrohen brenda një fushe të veçantë të dijes (pra, në rastin tonë në fushën e terminologjisë që vjen nga teknologjia. Megjithatë, edhe pse më sipër u shprehëm se termat kanë karakteristikë monosemantizmin, pra njëkuptimësinë, përsëri ka terma që kanë strukturë shumëkuptimëshe, por, problematikat e tilla nuk janë objekt thelbësor i kësaj trajtëse dhe më imtësisht mund t’i trajtojmë në një rast tjetër. Parë në aspektin e terminologjisë ka një dallim aq të theksuar mes kuptimeve të këtyre koncepteve, saqë ato mund të shihen si shenja të dallueshme. Kjo lidhet me monosemantizmin e termit. Sipas studiuesses H. Pasho, në fushën e terminologjisë fjala term nuk zhvillohet semantikisht dhe si rrjedhim, ndryshe nga sistemi i gjuhës së përgjithshme këtu, parimisht, nuk ka kushte për shfaqjen e sinonimisë dhe shumëkuptimisë¹²⁰. Por, sistemi terminologjik përdor fjalën dhe funksionin sipas ligjeve të gjuhës, prandaj të gjitha prirjet e zhvillimit kuptimor të fjalës, në mënyrë të veçantë prirja për shumëkuptimësi, te termi ruhet në mënyrë potenciale dhe realizohet vetëm atëherë kur ka kushte të përshtatshme për t’u realizuar.

Faktikisht, funksioni më i rëndësishëm i termit ka të bëjë komunikimin sa më cilësor e të qartë të specialistëve të një fushe të caktuar, prandaj për këtë arsye edhe në rastet kur një term mund të shfaqet shumëkuptimesh, terminologët punojnë që ai term të jetë njëkuptimësh. Puna për njësimin e gjuhës së terminologjisë presupozon, në radhë të parë, përpunimin e parimeve, të mënyrave e të modeleve njësores, të specializuara që i përgjigjen kërkesës së domosdoshme që çdo term të emërtojë vetëm një nocion.

Literatura

Aristotel Spiro, *Terminologjia gjuhësore: nga traditat kombëtare te komunikimi i njësuar ndërkombëtar*, Terminologjia në shkencat e ligjëritimit, Elbasan 2014, f. 221-229.

Grup autorësh, *Fjalor i gjuhës së sotme shqipe*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2006.

Hëna Pasho, *Vështrim mbi disa shfaqje të shumëkuptimisë të sinonimisë dhe të antonimisë në terminologjinë e ekonomisë në gjuhën shqipe*, SF, 3/1986.

https://stratcomcoe.org/cuploads/pfiles/digital_terminology_nato_stratcom_coe_14-10-2020.pdf (qasur së fundmi më 20.12.2023).

¹¹⁸ Po aty.

¹¹⁹ H. Pasho, *Vështrim mbi disa shfaqje të shumëkuptimisë të sinonimisë dhe të antonimisë në terminologjinë e ekonomisë në gjuhën shqipe*, SF.Nr.3,1986, f.114-126.

¹²⁰ Po aty.

KONFERENCA E PARË NDËRKOMBËTARE NË GJUHËSI
“Ligjërimi i shkruar dhe i folur, probleme reale dhe propozime konkrete për zgjidhjen e tyre”

Materialet e punimeve (proceedings)

ISBN: 978-1-78911-007-4

Jani Thomai, *Probleme të leksikut në shqipen standarde*, në aktet e “Seminarit V Ndërkombëtar të Albanologjisë, Tetovë, 3-4 tetor 2011.

Manjola Zaçellari, *Vështrim rreth disa çështjeve mbi pastërtinë e gjuhës shqipe*, në: “Gjuha shqipe”, 1/2021, Instituti Albanologjik-Prishtinë.

Nebi Caka, *Terminologjia e informatikës në gjuhën shqipe dhe standardizimi i saj në fjalorë*, në: https://www.academia.edu/3613797/Terminologjia_e_informatik%C3%ABs_n%C3%AB_gjuh%C3%ABn_shqipe_dhe_standardizimi_i_saj_n%C3%AB_fjalor%C3%AB (qasur së fundmi më 20.12.2023)
Qemal Murati, *Fjalor i gabimeve gjuhësore*, Instituti Albanologjik- Prishtinë, 2004.

Kontributi fishtjan për gjuhën shqipe në shkrimet e tij publicistike

DR. ROVENA MIKELI (VATA)
Akademia e Shkencave e Shqipërisë,
Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë (IGJL)

Abstrakt

Krijimtaria publicistike e Gjergj Fishtës është jashtëzakonisht e pasur. “Gjuha shqipe, “D. Ndre Mjedja: Juvenilja (Vjenë 1917), “Visari Komtar”, “Abati i Mirditës”, “Të rriturit e fëmijës”, “Kaprolli i Kaçanikut”, “Ushtria austro-hungare e të mëkambunit e Shqipërisë”, “Hylli i Dritës” e shkollat”, “Kryeqyteti i Shqipërisë”, “Koha e re në Shqipëri”, “Rrokull Shqipërisë”, “Gjuha e msimit”, “Shqiptarët dhe të drejtat e tyre”, “Kanuni i Lekë Dukagjinit”, “A jemi shqiptarë a por do të bahemi”, “Një atentat shurdh”, etj., janë vetëm disa nga artikujt të cilët ai i botoi në revistën “Hylli i Dritës” dhe në gazetën “Posta e Shqipërisë”.

Përmes këtyre shkrimeve Fishta dha një kontribut të çmueshëm për gjuhën shqipe. Për të vlerësuar një kontribut të tillë do të ndalemi tek shkrimi me titull “Gjuha e msimit”, që paraqet edhe objektin e këtij studimi. “Gjuha e msimit” paraqet një artikull në të cilin gjuha shqipe shihet e lidhur me traditat, doket, ritet e zakonet, ndjesitë, përjetimet, betimet, urimet dhe mallkimet, të cilat qenies humane i vijnë instiktivisht për t’i shprehur në gjuhën amë. Fishta ndalet edhe në didaktikën mësimdhënëse dhe formën pedagogjike të të nxënës, duke marrë si pikë orientimi modelet më të mira të qytetërimeve evropiane.

Ky shtjellim do jetë si rezultat i kombinimit të metodave sociologjike dhe pedagogjike, respektivisht në “Pedagogjinë sociale”, apo në faktin se edukimi nuk është përgjegjësi vetëm e prindërve apo e institucioneve përkatëse, por shkon më gjerë, si një përgjegjësi e përbashkët e gjithë shoqërisë, në varësi të rrethanave shoqërore, arsimore, politike e ideologjike të kohës.

Si konkluzion mund të themi se në të gjitha këndvështrimet gjuhën shqipe Fishta e shihte si një element të lidhur përjetësisht me kombin, atdheun, identitetin kombëtar, gjeografinë dhe etnografinë shqiptare, konkretisht me historinë, kulturën, edukimin e fëmijëve, me psikologjinë e shqiptarit, duke ofruar kështu një kontribut të pamohueshëm për gjuhën shqipe dhe për disiplinat e tjera albanologjike.

Fjalë kyçe: *komb, atdhe, gjuhë shqipe, shkolla, mësues, etj.*

Hyrje

Leximet, rileximet, studimet e kërkimet ndaj figurës dhe personalitetit të Gjergj Fishtës janë të shumta. Po ashtu, të panumërta janë edhe studimet për krijimtarinë e tij letrare, opusi krijues i së cilit ndahet në pesë fusha kryesore: në epikë, satirikë, lirikë, dramatikë e publicistikë (Çapaliku Stefan, 2022, p. 13).

Trajtimi i veprave të Fishtës paraqet një përpjekje komplekse pasi që si një shkrimtar “dytematik” (atdheu dhe feja), duke paraqitur historinë, duke himnizuar virtytet e shqiptarëve, të shoqëruar me plot dhunti për rrëfim epik, apo si një dramaturg satirik e i mprehtë, Fishta zbulohet si një kultivues shumëgjinish letrare (Thomai Jani, 2017, p. 333).

Ndonëse mund të themi se katër fushat e para (epika, satirika, dramatika e publicistika) janë trajtuar nga shkencat albanologjike, të njëjtën nuk mund ta themi për publicistikën pasi që studimet në këtë fushë të krijimtarisë së Fishtës nuk janë në nivel shterrues.

Gjergj Fishta i njohur me të drejtë si “Homeri Shqiptar” la një pasuri të jashtëzakonshme edhe në fushën e publicistikës, ku shkrimet e tij në këtë aspekt dallojnë për emocionin dhe forcën e fjalës, për atdhetarinë e lidhur përjetësisht me elementin e gjuhës shqipe, të çështjes kombëtare dhe të ndërtimit të identitetit të shqiptarëve (Shabani Sinan, 2018, p. 233), duke përshkruar, analizuar, interpretuar dhe transmetuar tek të tjerët tiparet kryesore në formimin e

Materialet e punimeve (proceedings)

ISBN: 978-1-78911-007-4

identitetit kombëtar sikurse që janë mitet, kujtimet, vlerat, traditat dhe simbolet (Leoussi Athena & Grosby Steven, 2007, p. 21).

Me bindje mund të themi se Gjergj Fishta ishte promovuesi më i madh ndër shqiptarë i gjuhës shqipe në shkrimet e tij publicistike. Që në fillim të krijimtarisë së tij publicistike ai vuri gjithë potencialin e tij në shërbim të zhvillimit dhe të mbrojtjes së gjuhës dhe të shkollës shqipe. Përmes një universi social-kulturor që ka thurrur, me universin e njeriut me histori e kulturë të shkruar e të pashkruar, me jetën tokësore e përjetësinë qiellore, me të përditshmen e të përcuditshmen, me gjithçka që ndien e ëndërron – Fishta paraqet shqiptarin e pathënë në shkolla e biblioteka, është vetë ai në të cilin bashkëjetojnë pranueshëm kultura evropiane me mendësitë tradicionale të popullit të vet, shprehur ritualeve dhe në një gjuhë kaq vitale si shqipja (Çobani Tonin & Ballabani Ndue, 2022, p. 17).

Prandaj, qëllimi i tij konsistonte në ngritjen e nivelit kulturor e arsimor dhe nxitjen e dëshirës së bashkombasve për përparim dhe atdhedashuri, dy shtylla që do ta mbanin në këmbë shoqërinë shqiptare, të goditur nga pushtimi shumëshekullor osman (Vuji Mark, 2007, p. 215).

Shkrimet e para publicistike të Fishtës i gjejmë në revistën “Hylli i Dritës”, revistë të cilën vetë e themeloi dhe e drejtoi, botimi i së cilës nisi me 1 tetor të vitit 1913, e cila konsiderohet si revista e parë me një program të qartë atdhetar, politik dhe kulturor (Vata Rovena, 2014, p. 77).

Krahas revistës “Hylli i Dritës”, “Posta e Shqypnisë” ishte një gazetë po ashtu e themeluar dhe drejtuar nga Fishta, që dilte në Shkodër dy herë në javë në shqip dhe në gjermanisht (Çobani Tonin & Ballabani Ndue, 2021, p. 18).

Që të dyja, ishin dy organe të rëndësishme, ku u botuan më së shumti shkrimet publicistike të Gjergj Fishtës, respektivisht u trajtuan tema me fokus gjuhën, historinë, kulturën, politikën, diplomacinë etj, apo një varg temash tjera që preknin aspekte të zhvillimit të proceseve shoqërore përmes gërshetimit të studimeve në fushat tjera si antropologjia, arkeologjia, sociologjia, religjioni krahasues, filozofia, folklori, drama, etj (Ingold Tim, 1994, p. xix).

Objekt i këtij studimi janë çështjet që kanë të bëjnë me gjuhën shqipe. Këto çështje janë trajtuar në kuadër të artikujve si: *Gjuha shqipe, D. Ndre Mjedja: Juvenilja (Vjenë 1917), Visari Komtar, Abati i Mirditës, Të rriturit e fëmijës, Kaprolli i Kaçanikut, Ushtria austro-hungare e të mëkambunit e Shqipnisë, “Hylli i Dritës” e shkollat, Kryeqyteti i Shqipnisë, Koha e re në Shqipni, Rrokull Shqipnisë (7), Gjuha e msimit, Shqiptarët dhe të drejtat e tyre, Poetët e mëdhej t’Italisë, Kanuni i Lekë Dukagjinit, A jemi shqiptarë a por do të bahemi?, Një atentat shurdh, Tash, që asht ba Shqipnia, duhet përba shqiptarët*, etj., titujt e të cilëve i përzgjidhte me kujdes.

Pasi që opusi krijues i Fishtës lidhur me këtë çështje është i gjerë, fokusi i studimit tonë do të vihet tek “*Gjuha e msimit*”, që përfaqëson një nga artikujt më reprezentativ e që i drejtohet drejtpërdrejtë gjuhës shqipe, të cilën e konsideronte si “... pasaporte e gjallë, që provon identitetin e të qenit shqiptar...” (Vuji Mark, 2007, p. 217).

Në shkrimin prozë “*Gjuha e msimit*”, të botuar në revistën “Hylli i Dritës”, nr. 8, viti 1914 në Shkodër, gjuha shqipe identifikohet me gjuhën e vendit, pra me kultin e të parëve, aq shumë të promovuar në epikën fishtjane, në kryeveprën e letërsisë shqipe “Lahuta e Malcisë”. Pra, për Gjergj Fishtën gjuha amtare është gjuha vetme që shqiptarët duhet të mësojnë: “... tujë dftue se vetem n’gjûhë âmtare do t’u epet msimi t’bijve t’Shqyptarve.” (Fishta Gjergj, 1914, p. 234)

Në këtë shkrim Fishta bën një ndërlidhje midis gjuhës me traditat, doket, ritet e zakonet, ndjesitë, përjetimet, betimet, urimet dhe mallkimet, ku çdo qenie humane i vjen instiktivisht për t'i shprehur këto në gjuhën e vendit të tij. Një reflektim i tillë e bën Fishtën një detajist të botës shpirtërore të shqiptarëve, për të cilin, jo më kot Ernest Koliqi shprehej: “... *realiteti shqiptar i pasqyruem për mrekulli në veprën e Gjergj Fishtës, i cili me synin e tij depërton ndër skutat ma të thella e hulumton mbrapsjet misterioze të shpirtit kolektiv, për me zbulue forcat e origjinës dhe të esencës specifike etnike. Gjen genin e racës mes banorëve të maleve që e kanë rrujtë të pacënuem humanizmin e tyne fillimor, prej të cilit lulëzojnë përvojat mijvjeçare të popullit shqiptar*” (Koliqi Ernest, 1999, p. 36).

Synimi kryesor i Fishtës ishte që ta lartësohej tradita shqiptare, nëpërmjet tipareve të veta themelore, që janë pjesë përbërëse e strukturës së një kombi (Vata Rovena, 2013, p. 554). Si një institucion që do t'i ruante dhe kultivonte këto tipare ishte shkolla, të cilën ai e konsideronte si një tempull të dijes ndërsa dijen e barazonte me dritën: “*Praa: njaj qi nuk don qi gjûha shqype t'perdorohet per gjûhë msimit nder t'gjitha Shkollët fillestare t'Shqypniës, aj don qi vëndi i jonë mos t'perparojë aq saa mûndet me perparue, e qi t'rrin gjithmonë n'terr e i verbtë, e aj âsht, paa dyshim anmiku i Shqypniës*” (Fishta Gjergj, 1914, p. 236).

Sikurse shihet përparimi i kombit ndërlidhet me shkollën shqipe dhe me mësimin e gjuhës shqipe në shkolla, në të kundërtën stagnimi në një çështje të tillë cilësohej si armik i Shqipërisë. Në këtë pikë vërehet qartazi ndërlidhja e drejtpërdrejtë e gjuhës shqipe me identitetin kombëtar shqiptar: “...*nji Shqyptaar, qi msimin e parë ja ep fmiës s' vet n' nji gjûhë t'hujë, aj asht trathtaar i komit t'vet; sikursé edhë jânë anmiq t'Shqypniës t'gjith njatà, qi majnë Shkollë n'ket dhe e qi s'e përdorojnë gjûhën shqype si gjûhë msimit*” (Fishta Gjergj, 1914, p. 234).

Periudha që pasoi Pavarësinë e Shqipërisë krijoi kushtet për ngritjen e sistemit arsimor shtetëror në Shqipëri. Mu në këtë periudhë, pra në vitin 1914, Fishta botoi artikullin “*Gjuha e msimit*” përmes së cilit bënte thirrje për institucionalizimin e gjuhës shqipe në shkolla dhe në zhveshjen e arsimit dhe edukimit të fëmijëve nga religjioni dhe politika, në përputhje me interesat kombëtare dhe shtetërore (Fishta Gjergj, 1930a, pp. 237–238).

Thjesht, në vend të shkollave fetare apo të shkollave në gjuhë tjera që kishin ekzistuar para Pavarësisë, ai kërkonte një shkollë laike shqipe: “*Veç, per m'e skjarue edhë mâa mirë kuvëndin, na thomë qi gjûha shqype do t' jeet gjûhë msimit, mos tjetër, nder t'gjitha Shkollët fillestare t'Shqypniës a) ç'do besimit, b) ç'do komsiet e c) nën rregullim t' ç' do Pushtetit a fuqiet t'veçanët qi t'jeen. Ç'do besimit: Shkollët fillestare nuk jânë seminare lituegjiet, por jânë vënde, kû, neper t'njoftuna besimtare e dijetare do t'zhdrivillohet mëndja e fmieve. Ç'do komsiet: nierz komesh tjera, qi nuk jânë fisit shqyptaar, kaa aq pak n'Shqypnië t'sodshme, saa mos me këne nevoja m'e e mârrë n'kujdes nder Shtete t'gjetnueme, po e xâam, gjûha e Gabelve, qi banojnë n'pakica t'vogla. Nën rregullim t'ç' do Pushtetit a fuqiet t'veçantët: Shkollët nuk janë vegla politiket; por jânë troje t'bekueme, kû do t'trajtohet karakteri i nierit, qi t'bâhet i zoti me i krye detyrët e veta si duhet ndaj Zotit, vehten e shoqin*” (Fishta Gjergj, 1914, p. 234–235).

Sikurse shihet nga paragrafi paraparak, Gjergj Fishta shprehej se gjuhën shqipe duhej ta mësonte çdo fëmijë, ndërsa për të plotësuar vizionin e tij, ai do të trajtonte edhe didaktikën mësimdhënëse dhe formën pedagogjike të të nxënit, duke marrë si pikë orientimi modelet më të mira të qytetërimeve evropiane.

Në vazhden e këtij vizioni Gjergj Fishta përgjatë një analize retrospektive sjell në shkrimet e tij publicistike kontributin e autorëve të letërsisë shqipe, të cilët në veprat e tyre letrare, sollen hijeshinë e gjuhës shqipe, kur përmend rastin e Pjetër Budit, apo pastërtinë e

gjuhës së Pjetër Bogdanit, ndërtimin estetik të periudhave, veçon veprat e Naimit dhe Asdrenit të cilët e bënë gjuhën shqipe të fliste SHQIP. Gjithashtu sjell në kujtesë edhe ndihmesën e autorëve arbëresh të Italisë, siç etiketon rastin e Varibobes, Serembes, Santorit, De Rades, Zef Skiroit apo kur sjell në vemendje edhe disa libra shkollorë të shoqërive letrare, si shoqëria “Bashkimi” dhe ajo “Agimi” (Fishta Gjergj, 1930b, pp. 644–645).

Të gjithë këta faktorë të sipërcituar patën një qëllim të përbashkët gjuhën shqipe dhe institucionalizimin e saj, ku falë punës dhe kontributit të tyre, u bë e mundur që gjuha shqipe të njihet si gjuhë mësimi gati në të gjitha shkollat, si dhe të futet si gjuhë zyrtare në të gjitha zyrat e shtetit. Por, periudha në fjalë shoqërohej me divergjenca të shumta dhe skepticizmin që shoqëria shqiptare kishte ndaj arsimit dhe edukimit të brezave të rinj, që ishin pasojë e sundimit qindra vjeçar osman dhe të ndikimit të bindjeve religjioze.

Karshi këtyre perceptimeve Fishta ironizonte mendimin absurd të disa shtresave të shoqërisë shqiptare të kohës, në lidhje me kuptimin e problemit se nga kush dhe si do të përgatitet brezi i ri për të përballuar sfidat që e prisnin kombin, të cilat nënvleftësonin shkollat në gjuhën shqipe dhe preferonin t’i çonin fëmijët në çfarëdo shkolle tjetër. Tek “*Gjuha e msimit*” ai nxjerr në dritë të diellit këtë plagë të shoqërisë së atëhershme shqiptare” (Vuji Mark, 2007, p. 221).

Gjergj Fishta u bëri thirrje të gjithë faktorëve ndihmues dhe ndikues, që të bënin çmos për mësimin e gjuhës shqipe, ai fillonte nga e përgjithshmja për të kaluar tek e veçanta.

Si fillim ai u drejtohej të mbarë shqiptarëve pa dallim moshe, gjinie, feje, krahine, statusi shoqëror, që të gjithë bashkë duke menduar-thotë Fishta-për gjuhën shqipe dhe në gjuhën shqipe, që shqiptarët të mësojnë të parën gjuhën shqipe. Gjergj Fishta paralajmëronte se nëse shqiptarët nuk do mësojnë shqip, ata do vdesin së qeni shqiptar. Më pas ai kërkonte ndihmë prej faktorëve ndikues, që gjuha shqipe të bëhej pjesë e shkollës, duke iu drejtuar fillimisht mësuesve, shoqërive atdhetare dhe atyre letrare si dhe të revistave apo periodikëve të kohës.

Në këtë ligjëratë Gjergj Fishta u drejtohej shqiptarëve me një kërkesë në formë urdhëruese, e cila në prozën e Fishtës ndeshet si veta e dytë njëjës, ashtu edhe veta e dytë shumës e urdhërues (Haxhi Artan, 1997, p. 101), ku pikë së pari drejton gishtin drejt prindërve, duke i parë këta si faktorin kyç, që fëmijët e tyre të mësojnë shqip. “*Mësojuni fëmijëve të dinë dhe të lexojnë mirë gjuhën shqipe, pasi në rast të kundërt do të thotë të jetosh në ferr*”, ndërsa për ta konkretizuar këtë ndërhyrje ai do citojë mendimin e Bajronit, kur shkruante se: “*Me niete t’mira t’metuna thaat, thotë Byroni, është shtruar kalldrami i ferrit...*” (Fishta Gjergj, 1914, p. 238).

Të mësuarin e gjuhës shqipe Fishta e vinte në paralele të njëjtë me jetën apo vdekjen e kombit shqiptar, prandaj duke e cilësuar si një çështje jetike, ai me një ton përsëri urdhërues u përkujtonte shqiptarëve: “*Shqyptarë! mos t’rriim fjetun n’ket çastje, prejë t’cillës rrjedhë a jeta a deka e Shqypniës. Shqypnia kaa teper anmiq, do t’mdhej e do t’vogjel, por t’gjith si një një t’rrezikshem: nuk duhet qi t’i bânna edhë na anmiq me ploshtië e me t’pakujdes t’onin. Sod është koha me u zhgjue Shqyptarët e me u diftue se janë gjallë tuj, lypë neper mjete t’arrsyeshme, t’drejtat e veta, e tujë u bashkue verevertë me mëndime; pse, si t’i kemi mendimet s’bashkut, kemi me pasë edhë pûnën e intereset m’nja, e kshtu, t’bashkuem me mendime, me pûne e me interese, kemi me kênë t’fortë e t’gjytetnuem. E bashkimin e mëndimeve t’ona t’a fillojmë me t’lypun t’drejtat e t’gjuhës s’onë, qi është vegla mâa para nper t’cillen na mûnd t’perpjekim mëndimet t’ona*” (Fishta Gjergj, 1914, p. 238).

Është interesante të cekën edhe disa paradokse të shoqërisë shqiptare të kohës. Në varësi të kushteve ekonomike shumë të rinj shqiptarë u shkolluan në shtete të ndryshme:

Materialet e punimeve (proceedings)

ISBN: 978-1-78911-007-4

Austro-Hungari, Itali, Perandori Osmane, etj., prej të cilëve kishte edhe të tillë që mburrehin se nuk dinin të shkruanin një letër në gjuhën shqipe. Këtyre Fishta u drejtohej me një ton kritik e ironik: “*E se na ktû nuk jemi tujë thânë një fjalë paa temel, na dishmon eksperjenca, ke orë-e ças na qet rasa me ndie, kahë Shqyptarë, t’meçem e t’naltuem edhe m’kâmë nderet, pa farë marrjet e trupit, dishmojnë perpara kujdo se nuk diin me shkruë një leter shqyp, sepsë kishin me u majtë per t’fyemun, me pasë me u thânë se nuk diin me shkruë një leter n’at gjûhë, me t’cillen t’u jeet dhânë msimi nder Shkollë fillestare*” (Fishta Gjergj, 1914, p. 237).

Gjergj Fishta ftonte të gjithë mësuesit shqiptarë, u bënte thirrje intelektualëve, shoqërive atdhetare e letrare, si dhe fletoreve apo revistave të kohës, që në fokus të trajtesave të tyre të kishin primare çështjen e gjuhës shqipe, duke u bazuar në tri faktorë. Pra sipas Gjergj Fishtës gjuha shqipe të mësohet prej të gjithëve nga çdo lloj besimi, kombësie dhe rregullimi. Në kohën kur jetoi dhe shkroi Gjergj Fishta kishte jo pak revista dhe gazeta funksionale, siç mund të përmendim: revistën “Ora e Maleve”, revista “Leka”, “Kumbona e së Diellës”, “Zani i Sh’na Ndout”, revista “Albania”, gazeta “Dielli”, Fletorja “Bashkimi”, fletorja letrare “Illyrija”, revista “Përpyjekja shqiptare”, revista “Tomorri”, gazeta “Tomorri i Vogël”, revista “Shkëndija”, revista Shëjzat” etj, të cilat kishin në rubrikat e tyre trajtesa për gjuhën shqipe, pasi drejtoheshin nga atdhetarë dhe dijetarë të penës dhe të kalemmit, ashtu siç shprehej Gjergj Fishta në shkrimet e tij publicistike: “*Prandej na t’shtÿym vetem prejë dishirit t’perparimit t’komit Shqyptaar, e per saa mûndet me pasë randsië fjala jonë, po grishim me shpnësë t’gjith Shqyptarët e dijes e t’kndimit: t’gjith Msuest shqyptarë: t’gjitha shoqniët letrave e atdhetare, si edhë t’gjitha fletoret e Perkohshmet e Shqypniës qi neper ato mjete e nder ato vënde qi t’ja u mârrë mëndja se âsht mâa mirë, e tujë u majtë gjithmonë permrënda caqeve t’arrsytes e t’nierziës, t’lypin qi gjûhe shqype t’vêhet per gjûhë msimit nder t’gjitha Shkollët elementare a se fillestare t’Shqypniës ç’do besimit, e komsiet e rregullimit qi t’jeen. Me ket pûnë na do t’i diftojmë botës, se Shqyptari din me nderue e me çmue t’huejin, po; por din me dashtë edhë vedin. Prejë zânit e prejë puplash njihet zogû: prejë gjûhet e prejë dokjesh do t’njifet Shqyptari. Shqyp kaa folun Dukagjini, Skanderbegu, Leka i Madh e Pirroa: shqyp do t’flasin edhë nipat e tyne. E kush, Shqyptaar, mos e dashtë Shqypniën e gjûhen shqype, kerkoftë fara e tii me shkop e me strajcë, si para e kuqe neper dheë*” (Fishta Gjergj, 1914, p. 238–239).

Ndonëse promovoi fuqishëm mësimin e gjuhës shqipe, Gjergj Fishta nuk botoi ndonjë vepër gjuhësore, por gjuhën shqipe e pasuroi, e përpunoi, e lëmoi dhe kontribuoi në tubimet shkencore me karakter gjuhësor” (Osmani Tomor, 1997, p. 72). Tërë veprimtaria atdhetare e Fishtës në lëmë të propagandës ishte mbështetur mbi këtë koncept, të cilit ai i përkushtoi jetën, në ruajtjen e gjuhës shqipe.

Ai vetë e kish kuptuar fort mirë se për sa kohë shqiptarët do të ruanin gjuhën, s’do të bënin gjë tjetër veçse do të ruanin edhe kombësinë” (Resuli Namik, 1996, p. 259), bindje të cilën e kishte shprehur edhe në një artikull tjetër të kohës. “A jemi shqyptarë a por do të bâhemi?”, ishte i qartë në mendimin e tij për gjuhën dhe ruajtjen e saj, pasi ruajtja e gjuhës do të thoshte ruajtje e kombit: “*Mâ i kjarti shêj i kombsís âsht njisija e gjûhës*” (Fishta Gjergj, 1930a, p. 654).

“*Gjuha është “rrnesa e kombit”, prandaj kërkohet kujdes i vazhdueshëm për të*” (Gokaj Nuri, 1997, p. 83), këtë shprehje kishte Gjergj Fishta parasysh kur shkruan se: “*Edhë populli shqyptar, si t’gjith popujt tjerë, e kâ ndi nëvedi fuqin e pushtetin e fjalës, e prandej âsht orvatë me e zhvillue e me e hijeshue sa mâ fort t’amlen gjûhen e vet komtare. Kta e dishmon jo vetem “folklorâ” e tij, qi âsht nder mâ të bukurat e t’interesantshmet e Europës,*

Materialet e punimeve (proceedings)

ISBN: 978-1-78911-007-4

por edhe monumentat letrarë qi të bijt e ktij popullit kan prodhue, e per të cillt ktû duem të bisedojm” (Fishta Gjergj, 1930b, p. 644).

Me të drejtë studiuesi i letërsisë shqipe Stefan Çapaliku në një kumtesë të mbajtur në vitin 1997, do të shprehej: “Kjo fytyrë e veprave të Fishtës transmetohet sot e kësaj dite prej një gjuhe tejet të pasur shqipe edhe pse standardi i sotëm gjuhësor po e ekstrakomunikon atë dita-ditës. Në këtë pikëpamje fenomeni Fishta bëhet më emergjent për kulturën e sotme shqiptare në raport me traditën tonë” (Çapaliku Stefan, 1997, p. 18), mbyllet citati.

Po sot ku jemi me gjuhën shqipe?!!!

Shoqëria e sotme moderne digjitale e ka futur gjuhën shqipe në një mjegullnajë, duke e keqpërdorur, keqshkruar dhe duke keq komunikuar me të.

Përfundim:

Shkrimet dhe pena fishtjane në fushën e publicistikës meriton përgëzim, duke na e dhënë të gatshëm modelin e referimit, me qëllim të mirëpërcaktuar, për të nxjerr në pah elementin e gjuhës shqipe. Gjergj Fishta, kërkoi “strehë” për gjuhën shqipe, që të ishte pjesë përbërëse e të gjitha shkollave fillestare të Shqipërisë, me kushtin e vetëm që të përdorej si gjuhë e parë.

Kontributi i Gjergj Fishtës në shkrimet publicistike rreth çështjes së gjuhës shqipe është i pamohueshëm, ku në secilin rast ai e shihte këtë element të lidhur përjetësisht me kombin, atdheun, me identitetin kombëtar, me gjeografinë dhe etnografinë shqiptare, me historinë, me kulturën, me edukimin e fëmijëve, me psikologjinë e shqiptarit, me Shqipërinë, duke ofruar kështu jo vetëm një kontribut të pamohueshëm për gjuhën shqipe, por edhe për disiplinat e tjera albanologjike.

Literatura

- Çapaliku Stefan. (1997). *At Gjergj Fishta-poet kombëtar*. Presented at the At Gjergj Fishta, Komb-Letërsi-Gjuhë, Shkodër. Shkodër: Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi.”
- Çapaliku Stefan. (2022). *Fishta satirik*. Tiranë: Enti Botues Gjergj Fishta.
- Çobani Tonin & Ballabani Ndue. (2021). *At Gjergj Fishta: Vende-vite-vepra*. Prishtinë: Drita.
- Çobani Tonin & Ballabani Ndue. (2022). *Letërsia dhe artet që na duhen – eseistike*. Prishtinë: Drita.
- Fishta Gjergj. (1914). Gjûha msimit. *Hylli i Dritës*, 8.
- Fishta Gjergj. (1930a). A jemi shqyptarë a por do të bähemi? *Hylli i Dritës*, 12.
- Fishta Gjergj. (1930b). Nji atentat shurdhë. *Hylli i Dritës*, 12.
- Gokaj Nuri. (1997). *Pikëpamje të Gjergj Fishtës për gjuhën letrare shqipe*. Presented at the At Gjergj Fishta Komb-Letërsi-Gjuhë, Shkodër. Shkodër: Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi.”
- Haxhi Artan. (1997). *Rreth formave të urdherores në prozën e Fishtës*. Presented at the At Gjergj Fishta, Komb-Letërsi-Gjuhë, Shkodër. Shkodër: Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi.”
- Ingold Tim. (1994). *Companion Encyclopedia of Anthropology Humanity, Culture and Social Life*. London & New York: Routledge.
- Koliqi Ernest. (1999). *Kritikë dhe estetikë*. Tiranë: Shtëpia botuese: Apollonia.
- Leoussi Athena & Grosby Steven. (2007). *Nationalism and Ethnoscymbolism: History, Culture and Ethnicity in the Formation of Nations*. Edinburg: Edinburg University Press.
- Osmani Tomor. (1997). *Gjergj Fishta në veprimtaritë gjuhësore të shqipes*. Presented at the At Gjergj Fishta, Komb-Letërsi-Gjuhë, Shkodër. Shkodër: Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi.”
- Resuli Namik. (1996). *Tribut Gjergj Fishtës, poetit shqiptar. Jeta e Re*, 3.
- Shabani Sinan. (2018). *Antropologji e identitetit – studime në antropologji kulturore*. Tiranë: Shtëpia botuese Naimi.

KONFERENCA E PARË NDËRKOMBËTARE NË GJUHËSI
“Ligjërimi i shkruar dhe i folur, probleme reale dhe propozime konkrete për zgjidhjen e tyre”

Materialet e punimeve (proceedings)

ISBN: 978-1-78911-007-4

Thomai Jani. (2017). *Studime për gjuhën shqipe: Dialektologji, Shqipja standarde, Kulturë gjuhe, Për personalitete dhe vepra*. Tiranë: Akademia e Studimeve Albanologjike.

Vata Rovenà. (2013). *Kulti i shqipes dhe kulti i të parëve në veprën e Fishtës*. Presented at the Studime të Gjuhës Shqipe, Prishtinë. Prishtinë: Universiteti i Prishtinës.

Vata Rovenà. (2014). *Periodikët si histori e letërsisë dhe kodifikuese letrare, rasti i “Shêjzave”*,. *Albanologji, Vëllimi 5*.

Vuji Mark. (2007). *Filozofia arsimore e akademikut Gjergj Fishta*. Lezhë: Enti Botues Gjergj Fishta.

Varianti verior në normën letrare

DR. ALGERT KALICA

Universiteti « Aleksandër Xhuvani », Elbasan

Abstrakt

Dialekti verior ka një paraqitje më të gjerë nga ç'mendohet në leksikun e gjuhës kombëtare. Aty kanë hyrë tërë fjalët e dialektit verior me gjegjës në toskërishte, në leksikun e përbashkët, si dhe ato pa gjegjës. Në rrafshin fonologjik, në disa raste, norma letrare ka imponuar formën veriore në dëm të formës jugore. Në sistemin morfologjik, ka raste kur është përzgjedhur fjalëforma e variantit verior. Për formimin e gjuhës letrare kombëtare, janë përdorur gjerësisht parimet e gjuhësisë përshkruese. Kjo shfaqet në rrafshin leksikor, fonologjik dhe gramatikor. Në aspektin normativ, gjuha letrare kombëtare nuk është e njëanshme sepse ka përzgjedhur në mënyrë thujtë të barabartë fjalë e fjalëforma nga të dyja dialektet. Kështu, jo rrallë, ajo ka zgjedhur njësinë leksikore, formën fonologjike apo paradigmen gramatikore që i përket dialektit verior.

Fjalë kyçe: *gjuhë letrare kombëtare, normë letrare, gegërishte, gjuhësi përshkruese, gjuhësi normative*

Objekti, rëndësia, lënda dhe metoda e studimit

Dialekti verior ka një paraqitje më të gjerë nga ç'mendohet në leksikun e gjuhës kombëtare, dhe në leksikët e specialiteteve. Objekt i këtij studimi janë fjalët e dialektit verior në leksikun e normës letrare. Sa e gjerë është paraqitja e tyre në fjalorin drejtshkrimor, ç'përndarje kanë sipas strukturës fonetike, gramatikore, leksikore dhe fjalëformuese? Cilat janë parimet, rregullat dhe përjashtimet që kanë lejuar hyrjen e këtyre fjalëve në leksikun e njësuar? Në ç'masë është përshkruese dhe në ç'masë është normative gjuhësia që hartoi normën letrare? Për këtë do të kërkojmë në *Fjalorin Drejtshkrimor* dhe *Fjalorin e Gjuhës së Sotme Shqipe* fjalët e variantit verior. Për të gjetur parimet dhe rregullat që kanë sjellë përfshirjen e fjalëve dhe fjalëformave veriore në normën letrare do t'i drejtohem Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe, referatit në kongres të Androkli Kostallarit dhe mjaft studimeve të përmendura në bibliografinë e këtij studimi. Ndonjëherë rregulla është eksplicite: ajo tregon se një fjalë apo fjalëformë është përzgjedhur nga varianti verior (p.sh., pjesorja e tashme me *-ues* (*mësues*) dhe jo me *-onjës* (*mësonjës*); ndonjëherë përfshirja në normën letrare e një fjale a fjalëforme është sipas parimit të gjuhësisë përshkruese. Për të përcaktuar nëse një fjalë apo fjalëformë e caktuar i përket dialektit verior, do t'u drejtohem parimeve, modeleve dhe shembujve në *Atlasin Dialektologjik* dhe në librat e dialektologjisë të përmendur në bibliografi. Gjithashtu, *Studimet Etimologjike* të Çabeut përcaktojnë nëse fjala është e mbarë gjuhës apo e një dialekti. *Formimi i gjuhës letrare kombëtare shqipe, Gramatika [...]* e Dilo Sheperit dhe mjaft studime na japin ca paradigma veriore në kundërvënie me ato jugore, p.sh., v. *mas*, *këpus* ≠ j. *mat*, *këput*. *FGJSSH* dhe *Fjalori Drejtshkrimor* kanë ndonjëherë shkurtesën *krahin*. tek fjalët apo format dialektore, si tek *tambël*, *cull*.

Zhvillim

Ka dy forma të formimit të një gjuhe letrare kombëtare: njëra me anë të konvergimit të dialekteve, sipas parimit të enëve komunikuese, dhe tjetra me anë të përzgjedhjes së një dialekti. Sipas të parës, fjalë a fjalëforma të një dialekti, hyjnë në përdorimin e të dyja dialekteve. Kështu ndodhi me fjalët *vajzë* dhe *rini* që hynë nga varianti verior në jugorin dhe u bënë pjesë e leksikut të përbashkët. Më pas, leksikografia i përshkroi këto fakte të përgjithshme në gjuhën letrare. Për të dytën, shembull përfaqësues është Franca, ku si gjuhë kombëtare u zgjodh nëndialekti i krahinës *Île de France*, me kryeqendër Parisin, sepse aty qëndronin mbretërit. Në kuptimin e ngushtë, gjuha kombëtare që vendoset me anë të zgjedhjes së një dialekti bëhet sipas metodës së gjuhësisë normative, ndërsa gjuha kombëtare që formohet me konvergim të dialekteve paraqitet me anë të parimeve të gjuhësisë përshkruese. Në studimet e kohës së kongresit dhe deri në fund të monizmit, përligjet teza e gjuhësisë përshkruese, me argumente dhe shembuj, sesi gjuha letrare është formuar duke paraqitur elemente të përbashkëta dhe elemente të dallueshme të secilit dialekt. Në praktikë, kjo nuk është plotësisht e mundur, sepse edhe fjalët e përbashkëta edhe fjalët e dialekteve kanë paraqitje të ndryshme në zona të ndryshme. Aty-këtu, duhet imponuar rregulla e drejtshkrimit, drejtshqiptimit apo e zgjedhjes së një fjale a fjalëforme në vend të një tjetre. Këto rregulla janë të rendit fonologjik, morfologjik dhe leksikor. Kështu, p.sh., për fjalët e leksikut të përbashkët, duhet përcaktuar në duhet vendosur *ë*-ja e shumësit (*disa *mjek*, apo *disa mjekë?*). Për fjalët dialektore: forma veriore apo jugore: *zanore* apo **zërore?* *Asnjanës* apo **asjatëror?* Në shumës, *veta* apo **vetë?* *Nipa* apo **nipër?* Në femërore, *tri* apo **tre?* Edhe brenda një dialekti të caktuar duhet zgjedhur forma përfaqësuese midis nëndialekteve dhe të folmeve. Kështu, duhet zgjedhur midis nëndialektit veriperëndimor dhe të folmes së Tiranës: *tamël* apo *tomël?* Edhe brenda nëndialektit duhet zgjedhur: si Buzuku, Bardhi e Bogdani apo si Migjeni e Fishta? *Tambël* apo *tamël?* *Katund* apo *katun?* *Fytyrë* apo *ftytyrë?* *Tëlyen* apo *tlyn*¹²¹?

Një analizë e hollësishme e fjalorëve dhe studimeve shkencore të kohës, dëshmon se gjuha kombëtare letrare është formuar në masë të madhe sipas parimeve të gjuhësisë përshkruese¹²². Në sistemin leksikor të gjuhës sonë, shumica e elementeve janë të përbashkëta. Pjesa tjetër përbëhet nga elemente të hyra nga njëri apo tjetri dialekt që dallojnë nga struktura fonologjike, gramatikore, leksikore dhe fjalëformuese.

Tri rrafshet bazë të gjuhës janë fonologjia, gramatika dhe leksiku. Sipas vështrimit strukturalist që përshkon normën letrare¹²³, fonologjia dhe gramatika janë sisteme të mbyllura, që nuk lejojnë thujse fare ndërhyrje. Rëndom, në fonologji dhe gramatikë, norma është imponuar duke përzgjedhur përdorimin e njërit ose tjetrit dialekt; por jo rrallëherë kanë hyrë të dyja format dialektore. Leksiku është sistem i hapur, pra lejon hyrje-daljet të elementeve që

¹²¹ Në këtë rast flitet për normë variant që i kundërvihet konceptit normë e njësuar. Shih: Miço Samara, *Formimi i gjuhës letrare kombëtare shqipe* (Tiranë: Universiteti i Tiranës, Fakulteti i historisë dhe i filologjisë, Katedra e gjuhës shqipe, Botim i dytë i plotësuar dhe i përpunuar, 1984), 108.

¹²² Në pjesën më të madhe të studimit të referatit të kongresit, edhe shpjegohet sesi është “formuar historikisht sistemi normë [...] sistemi drejtshkrim” edhe përshruhen gjerësisht fakte të gjuhës, si aspekte fonologjike (numër rrokjesh, ë të zëshme, të pazëshme...), morfologjike (-ë e shumësit, e së ardhmes dëftore, e dëshirores...), leksikore... Shih: Androkli Kostallari, *Gjuha letrare shqipe dhe disa probleme themelore të drejtshkrimit të saj* (Tiranë: Akademia e Shkencave e R.P. të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe letërsisë, 1973), 6 – 7, 38-45, 72-73 etj.

¹²³ Norma, drejtshkrimi, gjuha rëndom emërtohen « sistem », « strukturë », jonorma, nënstandardet krahinore etj., « nënsistem ». Kostallari, *Gjuha letrare shqipe*, 38-40, 63 etj.

janë leksemat ose fjalët. Në parim fjalët e të dyja dialekteve kanë rrugë të hapur në normën letrare. Kështu, në gjuhën letrare, kanë hyrë mjaft fjalë të nëndialekteve veriore, me preferencë të nëndialektit veriperëndimor, që është variant i Buzukut, Budit, Gjeçovit, Fishtës, Marin Sirdanit, Migjenit dhe mjaft të tjerëve.

Sistemi fonologjik

Në disa raste, norma letrare ka imponuar formën veriore. Kështu, në disa raste është privilegjuar forma konservative pa rotacizëm dhe/ose me *a* në vend të *ë*-së: *ranishte*, *ranor* dhe jo **rërishte*, **rëror*, *zanore* dhe jo **zërore*¹²⁴, *dhanore* dhe jo **dhërore*; *asnjanës* formuar nga *as* – *njani*, dhe jo **asjatëror* si tek *Gramatika* e Dilo Sheperit; *bamirës* e jo **bëmirës*, *vendas* e jo *vendës*. Parashtesat mohuese janë marrë sipas formantit të gegërishtes: *sh* dhe *zh* në vend të *ç*: *zhduk* – *çduk*; *shthur* – *çthur*; *shpërbëj* – *çpërbëj*¹²⁵.

Tek fjalët njërrrokëshe, në rrokje të mbyllur nëndialekti jugor i shurdhon bashkëtingëlloret: *tog*, *tok*, *zog*, *zok*, *breg*, *brek*, *zogj*, *zoq*, *rend*, *rent*. Norma letrare ka peshkuar fjalëformën veriore me zanore të zëshme.

Përsa i përket dallimit *i* ≠ *e* që paraqesin temat e disa fjalëve, në disa raste, është përzgjedhur forma veriore: *qira* dhe jo *qera*. Në ndonjë rast tjetër në normën letrare janë përfshirë edhe forma veriore dhe jugore sipas metodës përshkruese: v. *dhimbje* – j. *dhembje*.

Mes formës konservative grykore veriore dhe qiellzorimit jugor, kanë zgjedhur ndonjëherë të parën: *kiamet* në vend të *qamet*. Forma veriore grykore dhe forma jugore e palatalizuar shfaqen të dyja në këtë rast: v. *shkelm* – j. *shqelm*.

Format me *s* të gegërishtes dhe me *t* të toskërishtes kanë hyrë të gjitha: *shëtis*, *shëtit*; *ëmbëlsoj* – *ëmbëltoj*, por tek emërimi vetëm forma veriore ky hyrë: *ëmbëlsi*; *mas* – *mat*; *këpus* – *këput*; *zbus* – *zbut*; *lus* – *lut*; *fërkas* – *fërkat*; *mbys* – *mbyt*; *kullos* – *kullot*; *avis* – *avit*; *ngjis* – *ngjit*; *godas* – *godit*; *grabis* – *grabit*, *dremis* – *dremit*, *zbavis* – *zbavit*, *kosis* – *kosit*, *krasis* – *krasit*, *mbllaçis* – *mbllaçit*, *lajthis* – *lajthit*¹²⁶.

Tek çiftet e bashkëtingëlloreve preferohet forma konservative e paasimiluar e toskërishtes. Kështu, në normën letrare nuk para kanë hyrë format e asimiluara të gegërishtes, por ka raste kur të dyja format kanë hyrë në normën letrare, si *gj* < *ngj*: f. *gjasë*, f. *e ngjarë*, as. *të ngjarë*: *me gjasë* ≠ *ka të ngjarë*.

Për formën *shk(ë)lyej* të së folmes të Tiranës dhe *shkyj* të nëndialektit veriperëndimor toskërishtja ka formën e palatalizuar *shqyej* e cila e ka hyrë në normën letrare, por emrin e prejardhur nga kjo folje ka zgjedhur formën e variantit verior: *shklesë*.

Sistemi gramatikor

Nga gegërishtja në normën letrare ka hyrë forma femërore *tri* e numërorit *tre*, dhe jo forma *tre* që ka toskërishtja. Po kështu, në disa raste, shumësi ka hyrë nga varianti verior dhe jo varianti jugor: *veta* ≠ **vetë*, *nipa* ≠ **nipër*. Në ndonjë rast përdoren të dyja variantet e shumësit: *princa* dhe *princër*.

¹²⁴ Siç shfaqet tek Ilia Dilo Sheperi, *Gramatika dhe sindaksa e gjuhës shqipe* (Tiranë: Albin, ribotim, 2001).

¹²⁵ *Albanian, Basic differences between gegë and toskë dialects – Ndryshimet tipike midis gegënishtes dhe toskënishtes* (Monterey, California: Defense Language Institute, Department of Defense, shtator 1965, rishikuar më prill 1968).

¹²⁶ Këtë dysi fonetike në të folur e vë re edhe Dilo Sheperi, *Gramatika dhe sindaksa*, 104.

Për pjesoren e tashme dhe për emrat e prejardhur nga pjesorja e tashme, është zgjedhur formanti verior me *-ues* dhe jo *-onjës*: *mësues* dhe jo *mësonjës*; *mëtues* dhe jo *mëtonjës*¹²⁷, *hetues*, *zhurmues*. Kjo shfaqet edhe në emërtimet e pathjeshta të leksikut të përgjithshëm dhe të termave të shumë specialiteteve *bravapunues*, *hekurpunues*, *metapunues*.

Mbiemrat e nyjshëm me *m* dhe *t* të tipit *i sotëm*, *i fisëm*, *i larmë*, *i hekurt*, *i mermertë* për analogji kanë dhënë formimin e pjesoreve të shkuara përkatësisht me *m* dhe *t*¹²⁸. Në krye të herës kjo ka qenë dukuri e gjithë gjuhës, por vetëm gegërishtja e ka ruajtur, ndërsa në toskërishte me rotacizëm ka dhënë *-r(ë)*, *-u-r*¹²⁹. Kështu, mbiemrit prejfoljor *e folme* të gegërishtes i përkon *e folur* në toskërishte. Të dyja janë përfshirë në fjalor si terma të gjuhësisë me kuptime të ndryshme: *e folur* i kundërvihet konceptit *e shkruar* (në stilistikë, pragmatikë etj.) ndërsa *e folme* është një nënndarje e nëndialektit në dialektologji. Pjesorja e shkuar me mbaresën *-të*, mbiemri prejfoljor përkatës dhe ndajfolja sipas formës geqe që gjendet tek Buzuku, p.sh., *kla-të*, *pi-të*, *vu-të*, *pa-të* shpesh është marrë nga gegërishtja¹³⁰: *i thatë*, *thatë* – *i tharë*, *tharë*; *i shkrifët* – **i shkrifur*; *i zbrazët* – *i zbrazur*; *i hapët*, *hapët* – *i hapur*, *hapur*. Emrat prejpjesorë *rrenë-a*, *lypë-a* e kanë burimin tek gegërishtja. Për analogji me të tjera ndajfolje të prejardhura me prapashtesën *-as* si *barkas*, *majtas*, *rishtas*, në gegërishte janë formuar disa ndajfolje të prejardhura nga pjesore plus po këtë prapashtesë, të cilat kanë hyrë në normën letrare, si *haptas* nga (*i*) *hapët*¹³¹.

Një rast kur norma letrare ka përzgjedhur formën e dialektit të veriut është pjesorja e shkuar *pasë* dhe jo *pasur* tek format e mbipërbëra të së kryerës e të më së kryerës dëftore *kam pasë larë*, *kisha pasë larë* dhe të së kryerës habitore *paska pasë larë*¹³².

Sistemi leksikor

Bashkë me gjegjësit e toskërishtes, në leksikun e gjuhës kombëtare kanë hyrë tërë fjalët e dialektit verior që shfaqin dysi¹³³, si: *hulli* – *brazdë*; *qokth* – *gjon*; *kallnor* – *janar*, *fror* – *shkurt*, *dryn* – *kyç*, *katinar*; *çel* – *hap*; *çerdhe* – *fole*; *çoj* – *shpie*; *çohem* – *ngrihem*; *fik* – *shuaj*; *fytyrë* – *surrat*, *faqe*; *herët* – *shpejt*; *katund* – *fshat*; *krejt* – *fare*; *mbërrij* – *arrij*; *midis* – *në mes*; *rend* – *bredh*, *vrapoj*; *rrej* – *gënjej*¹³⁴; *shpinë* – *kurriz*; *tambël* – *qumësht*; *tinëz* – *fsheturazi*; *tëlyen* – *gjalpë*; *kërtollë* – *patate*; *ndërroj* – *këmbej*; *krye* – *kokë*; *xhajë* – *xhaxha*, *ungj*; *axhë* – *xhaxha*, *ungj*; *hut* – *buf*; *mëzat* – *dem*; *shkapes* – *përplas*; *giciloj* – *gudulis*; *gërgas* – *ngacmoj*, *ngas*; *nguc* – *ngacmoj*, *ngas*.

Ka edhe fjalë të variantit verior me gjegjës në leksikun e përbashkët, pra këta gjegjës shfaqen në të dyja dialektet: *cull* – *djalë*; *tatë* – *atë*, *baba*; *cullë* – *mullë*; *kall* – *ndez*; *qit*, *qes* – *nxjerr*; *thi* – *derr*; *gore* – *bushtër*, *shakë*, *buçe*; *i zyrtë* – *i errët*, *i ngrysur*; *zharg* – *barkas*.

¹²⁷ Si tek titulli i këngës XXII të *Odisesë*, përkthyer prej Pashko Gjeçit.

¹²⁸ Shaban Demiraj, *Morfologjia historike e gjuhës shqipe*, Pjesa I, (Tiranë: Universiteti i Tiranës, Fakulteti i historisë dhe i filologjisë, 1973), 103 – 105.

¹²⁹ Shih: Demiraj, *Morfologjia historike*, 188.

¹³⁰ Po aty, f. 182, 186.

¹³¹ Po aty, f. 186.

¹³² Fatmir Agalliu etj., *Gramatika e gjuhës shqipe*, Vëllimi 1: *Morfologjia*, (Tiranë: Akademia e Shkencave, 2002), 289, 293.

¹³³ Një pjesë e këtyre dysive gjendet tek: Gjovalin Shkurtaç, *Dialektet e shqipes. Tiparet e përbashkëta dhe dallimet dialektore, sipas hartave të ADGJSH-së* (Tiranë: Botimet Morava, 2012), 105.

¹³⁴ *Rrej*, *rrenë*, *i rrejshëm* janë leksema të hyra nga dialekti verior në normën letrare së bashku me gjegjësit toskë *gënjej*, *gënjeshtër*, *i gënjeshtër*. Mbiemri *i rremë* shfaqet edhe në fjalët e përbëra *i kuqerremë*, *i bardhemë*, *i verdhemë*.

Përfshirja në fjalor e të gjitha fjalëve të dialektit gegë që shfaqin dysi të plotë në dialektin toskë, e atyre që shfaqin dysi në dialektin e përbashkët dëshmon se është zbatuar gjerësisht metoda e gjuhësisë përshkruese për formimin e gjuhës letrare.

Ka raste kur, dy fjalë që në dialekte emërtonin të njëjtën realie¹³⁵, hyjnë në normën letrare për të shënuar realie të ndryshme, si v. *qerpik* – j. *qepallë*. Këtu shfaqet aspekti normativ i gjuhësisë.

Ndonjëherë, nëse në leksikon e përgjithshëm ka hyrë forma jugore, leksiku i specializuar ka zgjedhur formën veriore: j. *gjerësi* ≠ v. *gjani* fiz. «Largësia midis pikës më të tejme që arrin një trup gjatë luhatjes dhe pikës kur ai qëndron në qetësi, hapi i lëkundjes». Edhe fjala *mjedis* u peshkua nga dialekti verior në fillim për t’u përdorur si term i gjeografisë, më vonë u bë pjesë e leksikut të përgjithshëm.

Në disa raste, leksiku i përgjithshëm ka përfshirë edhe variantin verior edhe variantin jugor, *i vranët* – *i vrenjtur*; *vranësi* – *vrenjtje*, *vrenjtësi*, *vrenjtësirë*; *vranët* – *vrenjtur*; por leksiku i specializuar i meteorologjisë ka vetëm çerdhen e fjalëve: *i vranët*, *vranësi*, *vranët*. Gjithashtu, *tash*, *i tashëm* / *e tashme*, *tashmë* që kanë hyrë në normë krahas gjegjësve *tani*, *i tanishëm* / *e tanishme*, *tanimë*, mirëpo në specialitetin e gjuhësisë vetëm varianti verior *e tashme* ka hyrë.

Ka mjaft fjalë a fjalëforma që në krye të herës kanë qenë pjesë e dialektit verior dhe më pas janë bërë pjesë e mbarë gjuhës, sipas parimit të konvergimit. Ato kanë hyrë në normën letrare jo nga varianti verior por si fakt i mbarë gjuhës, siç janë *vajzë*¹³⁶, *garuzhdë*¹³⁷, *rini*.

Në normën letrare kanë hyrë edhe leksema që nuk kanë gjegjës në dialektin jugor¹³⁸, si *amtar*, *akullnajë*, *berr*, *fatos*, *kaçurrel*, *kandërr*, *kreshnik*, *mashtroj*, *ranishte*, *rreng*, *shmang*, *shtang*, *zanafillë*, *zanë*.

Përfundime

Varianti verior ka një paraqitje të gjerë në normën letrare. Bashkë me gjegjësit e toskërishtes, në leksikon e gjuhës kombëtare kanë hyrë tërë fjalët e dialektit verior që shfaqin dysi. Po kështu, kanë hyrë tërë fjalët e variantit verior me gjegjës në leksikon e përbashkët. Në normën letrare kanë hyrë edhe leksema të variantit verior që nuk kanë gjegjës në dialektin jugor. Ka raste të dysisë ku është përfshirë njëloj varianti gegë dhe toskë, që njëri syresh të shënojë një realie të re, apo për ta ngritur njërin në statusin e termit duke e futur në një leksik të specializuar dhe për ta lënë tjetrin në leksikon e përgjithshëm. Mjaft fjalë a fjalëforma që në krye të herës kanë qenë pjesë e dialektit verior më pas janë bërë pjesë e mbarë gjuhës, sipas parimit të konvergimit. Ato kanë hyrë në normën letrare si fakt i mbarë gjuhës.

Për sa i përket rrafshit fonologjik, në disa raste, norma letrare ka imponuar formën veriore në dëm të formës jugore. Kështu, jo rrallë është privilegjuar forma konservative pa rotacizëm, me *a* në vend të *ë-së*. Po kështu, parashtesat mohuese janë marrë sipas formantit të gegërishtes. Në rrokje të mbyllur përgjithësisht tek fjalët njërrrokëshe është privilegjuar varianti gegë i zëshëm i bashkëtingëllores fundore. Përsa i përket dallimit *i* ≠ *e* që paraqesin temat e disa fjalëve, në disa raste, është përzgjedhur forma veriore, në ndonjë rast shfaqen të dyja. Aty këtu, forma veriore grykore dhe forma jugore e palatalizuar shfaqen. Është përfshirë tërë seria e dysive gegërisht ≠ toskërisht të foljeve me *s* ≠ *t*. Tek çiftet e bashkëtingëlloresve

¹³⁵ Shih: Shkurtaç, *Dialektet e shqipes*, 105.

¹³⁶ Samara, *Formimi i gjuhës letrare*, 109.

¹³⁷ Eqrem Çabej, *Studime etimologjike në fushë të Shqipes IV* (Tiranë: Botimet Çabej), 1996.

¹³⁸ Samara, *Formimi i gjuhës letrare*, 102.

preferohet forma konservative e paasimiluar e toskërishtes, por ka edhe raste kur të dyja format kanë hyrë në normën letrare.

Në sistemin morfologjik, ka raste kur është përzgjedhur fjalëforma e variantit verior, si në të gjitha format e pjesores së tashme me *-ues*, në disa pjesore të shkuara me *m* dhe *t*, në disa emra prejpjesorë me *n*, disa ndajfolje të prejardhura nga pjesore plus prapashtesën *-as*, në disa shumëse, në femëroren e një numërori, në të pjesoren e shkuar *pasë* për formimin e disa formave të mbipërbëra të së kryerës e të më së kryerës dëftore dhe të së kryerës habitore.

Për formimin e gjuhës letrare kombëtare, janë përdorur gjerësisht parimet e gjuhësisë përshkruese. Kjo shfaqet në rrafshin leksikor, fonologjik dhe gramatikor. Në leksikun e gjuhës kombëtare kanë hyrë tërë fjalët e dialektit verior që shfaqin dysi, ato me gjegjës në leksikun e përbashkët dhe ato që nuk kanë gjegjës në dialektin jugor. Mjaft fjalë që kanë hyrë në normën letrare si fakt i mbarë gjuhës, në krye të herës kanë qenë pjesë e dialektit verior. Gjithashtu kanë hyrë mjaft fjalëforma që shfaqin dysi fonemash në të dyja dialektet.

Në aspektin normativ, gjuha letrare kombëtare nuk është e njëanshme sepse ka përzgjedhur në mënyrë thuajse të barabartë fjalë e fjalëforma në të dyja dialektet. Jo rrallë, ajo ka zgjedhur njësinë leksikore, formën fonologjike apo paradigmen gramatikore që i përket dialektit verior. Në sistemin leksikor, në rastin e dysive, ndonjëherë variantit gegë i kanë caktuar një denotacion të ri, apo i kanë dhënë peshën e termit duke e futur në një leksik të specializuar. Për sa i përket fonologjisë, ka raste kur norma letrare ka imponuar formën veriore. Në sistemin morfologjik, ka raste kur është përzgjedhur fjalëforma e variantit verior.

V	J	P
amtar		
akullnajë		
argëtoj		dëfrej
bamirës	*bëmirës	
berr		bagëti e imët
bravapunues	*bravapunonjës	
cucë	çupë	vajzë
culan		leckaman, i leckosur
cull		djalë
cullak		djalë
cullak <i>mb. ndaj.</i>		lakuriq <i>mb. ndaj.</i>
cullë		bark, mullë
çapë		kafshatë
çel	hap	
çelës	kyç, katinar	
çerdhe	fole	
çikë	çupë	vajzë
çohem	ngrihem	
çoj	shpie	
çun		djalë
dac	maçok	
dredhëz	luleshtrydhe	
dryn	kyç, katinar	
dhimbje	dhembje	

fatos fik fror fytyrë gocë gore gjasë gërgas giciloj qokth hapët (i) haptas herët hut hulli kaçurrel kiamet kall kallnor kandërr katund kërcënoj kërtollë krejt kreshnik krye lëndoj log marri marrisht mashtroj, mashttrim mbërrij metalpunues mësues mëtues mëzat midis mjedis ndërroj nguc nipa njeh, njehem, njehje njehatore njehsoj, njehsim, njehsueshëm njoftoj pasë (kam pasë larë)	shuaj shkurt surrat, faqe çupë ngjarë (të) ngacmoj, ngas gudulis gjon, çotë hapur (i) hapur shpejt buf brazdë *qamet janar fshat kanos, kanosem fare kokë plagos marrëzi marrëzisht arrij *metalpunonjës *mësonjës mëtonjës dem në mes këmbej ngacmoj, ngas *nipër lajmëroj *patur *qera	“trim i fortë” vajzë bushtër, shakë, buçe grifshë “me flokë të përdredhur vetiu” ndez insekt (huazim, or. dijetare) patate “hero epik i rapsodeve” shesh, lëndinë e vogël numëroj, numërim vajtore, vajtuese llogarit, llogaritshëm, llogaritshëm
--	---	--

<p>qira ranishte ranor rend rrej i rrejshëm rrenë rrenës rreng rrengshor shmang shtang, shtangem shtazë shkapës shkrifët (i) shkelm shkues shpinë tambël tamblatore (m., mb.) tash tashëm (i), tashme (e) tëlyen tinëz tri (f.) thi vranët (i) vranësi, vranësirë vranshëm zanë zanore i zbrazët zbulues zymtë zhangë, zhangël zharg zharg, zhargas zhurmues</p>	<p>*rërishte *rëror bredh, vrapoj gënjej i rremë gënjeshtër gënjeshtar dredhi dredharak</p> <p>*shtëzë (Stud. Etimologjike) përplas shkrifur (i) shqelm *shkonjës, mblesës, lajmës kurriz</p> <p>tani tanishëm (i), tanishme (e) gjalpë fshehurazi *tre (f.)</p> <p>vrenjtur (i) vrenjtësi, vrenjtësirë vrenjtur</p> <p>*zërore (Ilia Dilo Sheperi) *i zbrazur *zbulonjës</p> <p>*zhurmonjës</p>	<p>*pasur (kam *pasur larë)</p> <p>kafshë</p> <p>qumësht lopë qumështore, qumështore</p> <p>derr</p> <p>i errët, i ngrysur zhapë, lapër lëkurë zvarrë</p>
<p><i>shëtis, ëmbëlsoj, mas, këpus, zbus, lus, fërkas, mbys, kullos, avis, ngjis, godas, grabis, dremis, zbavis, kosis, krasis, mbllaçis, lajthis</i></p>	<p><i>shëtit, ëmbëltoj, mat, këput, zbut, lut, fërkat, mbyt, kullot, avit, ngjit, godit, grabit, dremit, zbavit, kosit, krasit, mbllaçit, lajthit</i></p>	

*Me yllth fjalët e dialektit jugor që nuk kanë hyrë në normë, pra nuk shfaqen në fjalor.

Bibliografi

- Agalliu, Fatmir, Engjëll Angoni, Shaban Demiraj, Ali Dhrimo, Emil Lafe dhe Ethem Lika. *Gramatika e gjuhës shqipe*, Vëllimi 1: *Morfologjia*. Tiranë: Akademia e Shkencave, 2002.
- Albanian, Basic differences between gegë and toskë dialects – Ndryshimet tipike midis gegënishtes dhe toskënishtes*, Defense Language Institute, Department of Defense, Monterey, California, SH.B.A., shtator 1965, rishikuar më prill 1968.
- Çabej, Eqrem. *Hyrje në historinë e gjuhës shqipe, I, II*. Tiranë: Universiteti i Tiranës, Fakulteti i historisë dhe filologjisë, 1976.
- Çabej, Eqrem. *Studime etimologjike në fushë të Shqipërisë I, II, III, IV, VI, VII*. Tiranë: Akademia e Shkencave të R(PS) të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, 1982, 1976, 1987, 1996, 2002, 2006.
- Çabej, Eqrem. *Studime etimologjike në fushë të Shqipërisë V*. Tiranë: Botimet Çabej, 2014.
- Demiraj, Shaban. *Morfologjia historike e gjuhës shqipe*, Pjesa I, II. Tiranë: Universiteti i Tiranës, Fakulteti i historisë dhe i filologjisë, 1973.
- Dilo Sheperi, Ilija. *Gramatika dhe sindaksa e gjuhës shqipe*. Tiranë: Albin, 2001.
- Gjinari, Jorgji, Bahri Beci, Gjovalin Shkurtaç, dhe Xheladin Gosturani. *Atlasi dialektologjik i gjuhës shqipe*, Vëllimi I, II. Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Università degli studi di Napoli L'Orientale, Dipartimento di Studi dell'Europa Orientale, 2007.
- Gjinari, Jorgji, dhe Gjovalin Shkurtaç. *Dialektologji*. Tiranë: Shtëpia botuese e librit universitar, 2009.
- Gjinari, Jorgji. “Gjuha letrare, drejtshkrimi dhe nëndialektet e shqipes”. *Studime Filologjike*, no. 1 (1973): 131.
- Gjinari, Jorgji. “Marrëdhëniet e sotme të dialekteve me gjuhën letrare”. *Studime Filologjike*, no. 1 (1985): 43-52.
- Kostallari, Androkli, Mahir Domi, Eqrem Çabej, Emil Lafe. *Drejtshkrimi i gjuhës shqipe*. Tiranë: Akademia e Shkencave e R.P. të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, 1973.
- Kostallari, Androkli, Mahir Domi, Emil Lafe, dhe Nikoleta Cikuli. *Fjalor Drejtshkrimor*. Tiranë: Akademia e Shkencave e R.P. të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, 1976.
- Kostallari, Androkli, Jani Thomai, dhe Xhevat Lloshi. *Fjalor i gjuhës së sotme shqipe*. Tiranë: Akademia e shkencave e RPSSH, Instituti i gjuhësisë dhe i letërsisë, 1980.
- Kostallari, Androkli. “Mbi disa veçori strukturore funksionale të gjuhës letrare shqipe të kohës sonë”. *Studime Filologjike*, no. 2 (1970): 29-33.
- Kostallari, Androkli. *Gjuha letrare shqipe dhe disa probleme themelore të drejtshkrimit të saj*. Tiranë: Akademia e Shkencave e R.P. të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe letërsisë, 1973.
- Samara, Miço. *Formimi i gjuhës letrare kombëtare shqipe*. Tiranë: Universiteti i Tiranës, Fakulteti i historisë dhe i filologjisë, Katedra e gjuhës shqipe, Botim i dytë i plotësuar dhe i përpunuar, 1984.
- Shkurtaç, Gjovalin. *Dialektet e shqipes. Tiparet e përbashkëta dhe dallimet dialektore, sipas hartave të ADGJSH-së*. Tiranë: Botimet Morava, 2012.

Zhvillimi i aftësive komunikative përmes teknologjisë

PROF. AS. DR. HELENA GRILLO MUKLI
Universiteti “Aleksandër Moisiu”, DURRËS

Abstrakt

Gjithnjë e më shumë zhvillimi i sotëm teknologjik paraprin zhvillimet që vijnë disiplina të tjera shkencore apo shkenca shoqërore. Në lëmin e gjuhësisë lidhja mes gjuhës e teknologjisë sjell trajtesa të llojeve të veçanta, të cilat lidhen jo vetëm me zhvillime të ndërsjellta midis dy disiplinave, por dhe me zhvillime të brendshme gjuhësore në nënsistemet e saj. Informimi në ditët e sotme sjell dinamika të ndryshme gjuhësore, të cilat nxiten nga mjetet e përdorimit teknologjik, ashtu dhe përshpejtojnë apo nxitin gjuhën, jo vetëm në nënsistemin leksikor të gjenerojë fjalë të reja, por dhe struktura të caktuara sintaksore. Në punim hulumtohet prirja e revolucionit teknologjik në mësimdhënie e nxënie, dhe varësia e ndikimi i këtyre mjeteve në aftësinë shprehëse të nxënësve. Ky punim është mbështetur në matje konkrete në shkolla 9 -vjecare në zonat rurale dhe urbane duke anketuar mësues dhe nxënës të këtyre shkollave mbi përdorimin e rëndësinë e teknologjisë në sistemin arsimor e kryesisht në mësimdhënie. Nuk është në fokus ballafaqimi midis dy zonave (rurale-urbane) pavarësisht matjeve që janë realizuar, të cilat kanë vlerësuar përdorimin e teknologjisë në mësimdhënie e nxënie. Punimi i vjen në ndihmë përmirësimit të vazhdueshëm të mësimdhënies, ashtu dhe procesit të të nxënësve efektiv mes teknologjisë.

Fjalë kyçe: *Komunikim, aftësi gjuhësore, teknologji, informacion.*

Hyrje

Aftësitë komunikuese lidhen së pari me njohjen e zotërimin e të mësuarit të gjuhës si mjet komunikimi e nuk bazohet vetëm në teori, gramatikë (morfologji, sintaksë), por mësimdhënësit duhet t’i aftësojnë nxënësit që teoritë e fituara t’i zbatojnë dhe aplikojnë edhe në praktikë, në të folur, në të shkruar si dhe në situata tematike. “Prova e teorisë së mirë është aftësia e saj për t’u drejtuar drejt praktikës. Nga ana tjetër praktika e mirë mbështet teorinë.”¹³⁹ Aleksandër Xhuvani në Didaktikën e vitit 1937 shkruan: “Gjuha asht një mjet tepër i randësishëm i të mësuarit, se asht burimi i gjithë njohjeve t’ona, pra i gjithë qytetnimit mbarë... është mjet i shkëmbimit të mendimeve t’ona në çdo degë të jetës së njeriut dhe pasqyra e qytetnimit të popullit.”¹⁴⁰ Që nga shekulli XX e deri në ditët tona, interesi kërkimor e shkencor mbi gjuhën amtare, mësimi i saj që nga mosha e hershme, ka qenë dhe është në qendër të diskutimeve dhe trajnimeve të shumta teorike dhe praktike. “Synimi i parë i mësimdhënies së gjuhës amtare duhet të jetë aftësimi i fëmijëve për të komunikuar në mënyrë sa më cilësore në të gjitha nivelet me të gjithë ata që përdorin atë gjuhë si të parë.”¹⁴¹ Ndryshimet kurrikulare paraprinë dhe ndryshime që lidhen me mjete e burime të tjera të përvetësimit të gjuhës e aftësive komunikuese. Lindi domosdoshmëria e realizimit të komunikimit jo vetëm në klasë, por dhe online, si dhe zhvillimi teknologjik ndikoi në rikrijimin e situatave të tjera komunikative që kapërcejnë gjuhën si mjet. Në ditët e

¹³⁹ Allan C. Orstein: Francis Hunkins, Kurrikula, bazat, parimet dhe problemet, ISP, Tiranë, 2003, f.30

¹⁴⁰ Aleksandër Xhuvani: Didaktika, Elbasan, tetor, 1937, f.18.

¹⁴¹ Rexhep Ismaili: Standarde dhe identitete: Histori, procese dhe lëvizje standardizuese në fushë të gjuhës, Pejë, 2003, Dukagjini, f. 159.

Materialet e punimeve (proceedings)

ISBN: 978-1-78911-007-4

sotme rol vendimtar në zhvillimin e aftësive komunikative luan teknologjia. Teknologjia e ndihmon nxënësin të zhvillojë të gjitha llojet e aftësive nga ato më të thjeshtat deri te ato më të ndërlikuarat. Megjithatë, që teknologjia të jetë e suksesshme, mësuesi duhet të bëjë zgjedhje të informuara në lidhje me qasjen pedagogjike, nevojat e nxënësit dhe rezultatet e të nxënës. Për mësuesin, sa e rëndësishme është të dijë se për çfarë do ta përdorë teknologjinë, po aq e rëndësishme është të dijë dhe mënyrën se si e nxëna mund të përmirësohet përmes teknologjisë.

Metodologjia

Metodologjia e punimit është komplekse, pasi mbështetet në trajtesa teorike të dy disiplinave: komunikim dhe teknologji. Zhvillimi i aftësive komunikative, kryesisht të nxënësve hetohet në mjedise shkollore dhe trajtohen në ndërveprimin e raporteve mësues-nxënës. Punimi fokusohet në këto marrëdhënie jo si realizime të komunikimeve të grupeve sociale, por në marrëdhënien komunikuese brenda klasës, në realizimin e kompetencave bazë të programit mësimor. Zhvillimi teknologjik solli ndryshime të prekshme jo vetëm në raportet sociale, por dhe shkollore. Punimi fokusohet në ndikimin e këtyre mjeteve në mësimdhënie. Për të vlerësuar rëndësinë e teknologjisë kryesisht në mësimdhënie u hartua (Shtojca 1), e cila u shpërnda në mënyrë elektronike për analiza statistikore të të dhënave. Shtojca u aplikua nga mësues e nxënës në bashkësi rastësore. Kjo shtojcë ka për qëllim të ravijëzojë rëndësinë e teknologjisë në mësimdhënie, si dhe të nxjerrë rezultate konkrete për përdorimin e mjeteve teknologjike gjatë orëve mësimore.

Nga pikëpamja teorike aftësitë komunikative krahas aftësive e ligjërimin në rregjistra të caktuar gjuhësorë, përdorimit të drejtë të gjuhës realizohen edhe si:

Aftësi semantike

Ndërveprimi semantik mundëson përpunimin e informacionit nga burime të jashtme në një mënyrë kuptimplote. Ai siguron se kuptimi i saktë i informacionit të shkëmbyer kuptohet dhe ruhet gjatë gjithë shkëmbimeve mes palëve. Ndërveprimi semantik përfshin aspektet e mëposhtme:

□ Ndërveprimi semantik ka të bëjë me kuptimin e elementeve të të dhënave dhe marrëdhëniet ndërmjet tyre. Ai përfshin zhvillimin e fjalorit për të përshkruar shkëmbimin e të dhënave, dhe siguron që elementët të kuptohen në të njëjtën mënyrë gjatë komunikimit.

□ Ndërveprimi sintaksor është rreth përshkrimit të formatit të saktë të informacionit që do të shkëmbehet në aspektin e ciklit të lartë, formatit dhe skemave.

Aftësi pragmatike

Brenda teorisë relevance, dy proceset lokale pragmatike të pasurimit dhe lirimimit të materialit konceptual të koduar gjuhësor janë dhënë trajtime mjaft të dallueshme. Pasurimet e llojeve të ndryshme, duke përfshirë ato që përfshijnë një forcim logjik të konceptit leksikor, kontribuojnë në propozimin e shprehur nga shprehja, pra në kushtet e së vërtetës. Lirimet, duke përfshirë edhe përdorimet metaforike, nuk hyjnë në propozimin e shprehur nga shprehja ose ndikojnë në kushtet e saj të së vërtetës; ata qëndrojnë në një ngjashmëri interpretuese të marrëdhënieve 'me konceptin e koduar gjuhësor që përdoret për t'i përfaqësuar ato.

Si realizohet e ndikon teknologjia në mësimdhënie e në zhvillimin e aftësive komunikative.

Materialet e punimeve (proceedings)

ISBN: 978-1-78911-007-4

Teknologjia nuk të garanton mësimdhënie/nxënie të dobishme, madje përdorime të papërshtatshme të saj mund ta bëjnë të nxëniet më të vështirë. Ky është rasti për shembull kur nxënësi shpenzon më të shumtën e kohës për selektimin e shkrimit dhe zgjedhjen e ngjyrave në detyrat e tij në vend që të planifikojë, të shkruajë dhe të rishikojë idetë e tij lidhur me detyrën e dhënë. Megjithatë për integrimin e teknologjisë flitet shumë, pak mësues kanë një vizon apo filozofi të qartë për mënyrën e integritit të saj në kurrikul me qëllim rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe të nxëniet.

Tri pyetje ndihmojnë mësuesin për të përcaktuar meritat e teknologjisë në një orë mësimi apo në një situatë të caktuar. Ato janë:

- A është përmbajtja mësimore e vlefshëm? (A janë rezultatet e të nxëniet të qarta, të lidhura me kompetencat kyçe dhe nivelet e arritjes së nxënësve);
- A e angazhojnë nxënësin aktivitetet e përzgjedhura mësimore?
- Sa e ka përmirësuar teknologjia mësimin në mënyrë që pa të, nuk do të ishte e mundur?

Mësuesi duhet të jenë sa kompetent në lidhje me dijet, aftësitë dhe qëndrimet që ai dëshiron t’u mësojë nxënësve, po aq sa dhe vëzhgues i aftë i mjedisit në të cilin nxënësit ndërtojnë dijet dhe ndërveprojnë me njëri tjetrin. Për këtë qëllim, filozofia e arsimit dhe qasja arsimore luajnë një rol të rëndësishme në kornizën teorike të integritit të teknologjisë për përmirësimin e orës mësimore. Për t’u siguruar se mjetet e teknologjisë janë përdorur në mënyrë efektive mësuesi duhet t’i përdorë ato nëpërmjet zbatimit të teorive të përshtatshme të mësimdhënies. Filozofia e kurrikulës së arsimit bazë është bazuar në qasjen konstruktiviste. Kjo qasje përkufizon: “*të mësuarit ndodh kur personi ndërton së bashku mekanizmin për të mësuar dhe versionin e tij unik të dijeve, plotësuar këto me përvojat dhe aftësitë e tij personale*”¹⁴². Sipas kësaj qasjeje dija ndërtohet, nuk transmetohet ndaj nxënësi gjeneron dije të reja nëpërmjet aktiviteteve, përvojave dhe eksperimenteve. Qasja konstruktiviste me fokus nxënësin në qendër, nxit përfshirjen e nxënësit në procesin e ndërtimit të dijeve dhe kërkon mënyra që mësuesi të jetë lehtësues në procesin mësimor dhe jo të diktojë informacionin. Kjo qasje dukshëm lidhet më mirë me integrimin e teknologjisë.

P.sh., mësimi zbulues si një formë e qasjes konstruktiviste inkurajon angazhimin aktiv, nxit motivimin, autonominë, përgjegjshmërinë dhe pavarësinë e nxënësit. Nxënësi udhëzohet nga mësuesi të bashkëveprojë dhe kryejë eksperimente për ta ndihmuar atë të ndërtojë dije dhe aftësi duke u nisur nga dijet dhe aftësitë paraprake. Detyra e mësuesit është të bashkërendojë informacionin e duhur në një mënyrë të përshtatshme për të ndihmuar nxënësin ta kuptojë atë. Aktivitetet vizuale me programet kompjuterike mund të jenë komponentë thelbësorë për të ndihmuar nxënësin të shohë se si konceptet zbatohen në situata reale. Kjo i jep mundësi nxënësit për të eksploruar mjedise më komplekse.

Një shembull i përdorimit të teknologjisë janë simulimet nëpërmjet lojërave kompjuterike ku nxënësit luajnë rolin e vendimmarrësit në situata historike në mënyrë që të shikojnë rëndësinë e këtyre ngjarjeve në jetën e tyre të përditshme dhe të zhvillojnë më mirë aftësitë e të menduarit kritik dhe të zgjidhjes së problemit. Forma të tjera të përdorimit të teknologjisë janë dhe udhëtimet virtuale në kohë. Nxënësit mësojnë rreth kulturave të ndryshme duke parë fotografi, filma, videoklipe, prezantime në poëer-point dhe tekste të përzgjedhura. Nxënësit, gjatë navigimit nëpër udhëtimin virtual, u përgjigjen pyetjeve të


¹⁴² Roblyer, M.D. (2006). Integrating educational technology into teaching. Upper Saddle River, N.J.: Merrill Prentice Hall.

mësuesit. Duke përdorur teknologjinë në qasjen konstruktiviste mësuesit e kanë më të lehtë të përfshijnë nxënësit në aktivitetet mësimore. Ata mund të krijojnë aktivitete për nivele dhe stile të ndryshme të të nxënës si dhe mund të zgjerojnë gamën e informacioneve që janë në dispozicion të nxënësit.

Teknologjia është më shumë sesa një mënyrë tjetër/ndryshe e prezantimit të informacionit, ajo është sistemi nëpërmjet të cilit informacioni prezantohet. Teknologjia, si pjesë e teorisë konstruktiviste të mësimdhënies, është korniza e metodologjisë së mësimdhënies/nxënies, e cila siguron aftësitë për të suportuar të gjitha format kryesore të kësaj teorie.

Nëpërmjet analizave sasiore iu dha përgjigje pyetjes mbi përdorimin e rolin e teknologjisë në zhvillimin e aftësive komunikative.

- A e integroni teknologjinë në lëndët tuaja?
- Cilat mjete përdorni ?



Nga analizat e rezultateve nxënësit e përdorin kompjuterin për të gjetur informacion në masën 70 % .

Mësuesit e përdorin kompjuterin në klasë për të përforcuar çështjet që kam shpjeguar në masën 60 %

Nxënësit e mi përdorin word-in për të kryer detyrat e shtëpisë në masën 30 %

Nxënësit e përdorin power –point-in për të bërë prezantime në klasë në masën 15 %

Rekomandime

Të përfshihen në trajnime kryesisht mësuesit e zonave rurale mbi përdorimin e teknologjisë.

Të integrohet mësimdhënia tradicionale duke edukuar dashurinë për librin dhe ndërtimin e portofoleve dhe dosjeve me shkrim dore dhe Word.

Në zonat urbane të përmirësojmë ndjeshëm njohjen e mjeteve teknologjike dhe përdorimin funksional të tyre.

Rezultatet e punimit do të përdoren për ndihmesa konkrete në bashkëpunime me projekte në fushën dixhitale, edhe pse ky studim nuk është gjithëpërfshirës, por i kufizuar në Qarkun e Vlorës.

Shtojca 1

1. Përdor kompjuterin në klasë për të përforcuar çështjet që ka shpjeguar.
 - a. Po
 - b. Jo

2. Nxënësit e përdorin kompjuterin për të gjetur informacion.
 - a. Po
 - b. Jo
 - c. Ndoshta

3. Nxënësit përdorin word-in për të kryer detyrat e shtëpisë.
 - a. Po
 - b. Jo

4. Përdor power –point-in për të bërë prezantime në klasë.
 - a. Po
 - b. Jo

Bibliografia

- Thomas Wasow, The Handbook of Linguistics, Mark Aronoff, Janie Rees-Miller, Blackwell Publishers Ltd, 2001.
- Andrew Carnie, Syntax: a Generative Introduction, Second Edition, Blackwell Publishers Ltd, 2006.
- Liliane Haegeman, Introduction to Government and Binding Theory, Second Edition, 1998, Blackwell Publishers Ltd,
- Roblyer, M.D. (2006). Integrating educational technology into teaching. Upper Saddle River, N.J.: Merrill Prentice Hall.
- Allan C. Orstein: Francis Hunkins, Kurrikula, bazat, parimet dhe problemet, ISP, Tiranë, 2003.
- Aleksandër Xhuvani: Didaktika, Elbasan, tetor, 1937.
- Rexhep Ismaili: Standarde dhe identitete: Histori, procese dhe lëvizje standardizuese në fushë të gjuhës, Pejë, 2003, Dukagjini.

Rëndësia e menaxhimit të aftësive gjuhësore dhe implikimet në biznesin ndërkombëtar

DR. ERION AVLLAZAGAJ
Universiteti “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan

Abstrakti

Komunikimi efikas në kushtet e zhvillimit të tregut dhe ekonomisë globale, si dhe realizimi i një procesi kompleks që ai përfaqëson, është i ndikuar nga një mori faktorësh. Duke qene se është i lidhur në mënyrë të drejtpërdrejt me suksesin e një sipërmarrje biznesi ai përbën një nga prioritetet kryesore të çdo kompanie të suksesshme duke luajtur një rol thelbësor, pothuajse në të gjitha fushat e biznesit, duke filluar që nga komunikimi i qartë midis punonjësve deri tek mbështetja e klientëve të klasit të parë. Shumë kompani, në procesin e marketimit dhe publikimit të tyre, evidentojnë me krenari dhe një kënaqesi të dukshme rëndësine që ato i japin procesit të komunikimit në punën e tyre, duke filluar që nga mesazhet kryesore që përdorin për të shitur produktet dhe shërbimet e tyre deri te reagimet e sinqerta që percillen për rezultatet dhe kontributin e punonjësve të tyre.

Tejkalimi i kufizimeve gjuhësore në kompanitë shumëkombëshe i shërben një qëllimi të thjeshtë: të sigurohet që kompetencat gjuhësore të mos kufizojnë përfitimet e komunikimit fitimprurës në një gjuhë të vetme. Kompanitë që merren me studimin dhe vlerësimin e problemeve që krijohen nga kufizimet gjuhësore dhe që njëkohësisht janë të përkushtuara për funksionimin e mirë të komunikimit ndërgjuhësor dëshmojnë qartë një ndikim të dukshëm pozitiv në suksesin e biznesit të tyre nepërmjet kësaj vëmendje të shtuar dhe të domosdoshme përkundrejt komunikimit dhe kompetencave gjuhësore.

Fjalë Kyçe: *komunikimi, kufizime gjuhësore, komunikim ndërgjuhësor, proces, shërbime*

Ndikimi i gjuhës në menaxhimin ndërkombëtar

Anglishtja konsiderohet si gjuha botërore e biznesit global. Ky fakt dhe realitet, i provuar prej një kohe relativisht të gjatë për funksionin që përfaqëson në kushtet e globalizimit, krijon një bazë të përbashkët për komunikim, por gjithashtu, thekson faktin që një pjesë e madhe e komunikimit të biznesit ndërkombëtar zhvillohet në një gjuhë të huaj. Një fushë kërkimore që rritet në mënyrë eksponenciale fokusohet në ndikimin që kane kufizimet gjuhësore në strategjitë, njerëzit dhe efikasitetin e kompanive shumëkombëshe përgjatë punës dhe aktivitetit të tyre¹⁴³.

“Kufijtë e gjuhës sime janë kufijtë e botës sime” Shprehet Wittgenstein¹⁴⁴, i cili ishte nder te paret (që në vitin 1922) që evidentoi rëndësinë e gjuhës për shkëmbimin dhe mirëkuptimin njerëzor, deri vonë shumë menaxherë dhe studiues të menaxhimit besonin se futja e një gjuhe uniforme të korporatës mund të kapërcejë të gjitha barrierat e komunikimit në kompanitë shumëkombëshe. Megjithatë, përdorimi i një gjuhe me rol global si anglishtja

¹⁴³ John Henley, Outsourcing the Provision of Software and IT-Enabled Services to India: Emerging Strategies

International Studies of Management & Organization, Vol. 36, No. 4, International Strategy and Cross-Cultural Management (Winter, 2006/2007), Fq. 111-131

¹⁴⁴ H. O. Mounce, Philosophy, Solipsism and Thought the Philosophical Quarterly (1950-), Vol. 47, No. 186 (Jan., 1997), Fq. 1-18

doli të ishte më problematik sesa pritej. Meqenëse aftësitë e anglishtes zakonisht shpërndahen në mënyrë të pabarabartë midis fuqisë punëtore të korporatave globale, atributet tilla gjuhësore shpesh shkaktojnë pengesa komunikimi dhe keqkuptime. Prandaj, kufizimet dhe pengesat gjuhësore paraqesin pengesa të rëndësishme për shkëmbimin e njohurive ndërkombëtare dhe bashkëpunimin efektiv. Bazuar në këtë pasqyrë, një degë jashtëzakonisht aktive e kërkimit të menaxhimit të lidhur me gjuhën është shfaqur që nga fundi i viteve 1990.

Një gamë e gjerë këndvështrimesh teorike përdoren për të kapur ndikimin kompleks të gjuhës në biznesin ndërkombëtar. Hulumtimi i menaxhimit ndërkulturor, për shembull, thekson ndërveprimet midis kulturës dhe gjuhës dhe tregon se zgjedhja e një gjuhe të caktuar biznesi mund të nxisë vlerat e lidhura, modelet e mendimit dhe modelet e sjelljes¹⁴⁵. Studiuesit e sjelljes organizative përdorin identitetet sociale për të shpjeguar se si dallimet gjuhësore brenda një fuqie punëtore mund të çojnë në formimin e grupit me tipare të caktuara, të trashguara dhe të modifikuara, në kushtet e ekonomisë globale. Po ashtu, mund të dobësojnë identifikimin me kompaninë dhe të dëmtojnë transferimin, kontrollin, koordinimin dhe komunikimin e njohurive. Studimet ekonomike lidhin distancën më të lartë gjuhësore midis kombeve me vëllime më të ulëta tregtare, ndërsa kërkimi strategjik e pozicionon gjuhën si një element të rëndësishëm të distancës psikologjike dhe tregon efekte në rrugët e diversifikimit ndërkombëtar.

Gjetjet empirike tregojnë ndikime gjuhësore në nivele të ndryshme të komunikimit të biznesit global. Shumë punonjës të kompanive shumëkombëshe ndihen të ngarkuar nga pengesat gjuhësore, pasi aftësitë gjuhësore mund të përcaktojnë mundësitë personale të karrierës. Ata që kanë aftësitë e kërkuara gjuhësore mund të kontrollojnë rrjedhat e informacionit dhe mund të kenë mundësi për tu futur më lehtë në pozicione kyçe. Në të kundërt, mungesa e njohurive shpesh çon në humbjen e statusit¹⁴⁶.

Kufizimet apo pengesat në komunikim që lidhen me gjuhën mund të ndikojnë gjithashtu në kohezionin e ekipeve shumëgjuhëshe, në ndërtimin e besimit midis kolegëve dhe menaxherëve, atmosferën e punës, shkëmbimin e njohurive dhe forcën inovative të grupit në nivel korporate, nëpërmjet statusit dhe praktikave gjuhësore që identifikojnë atë. Mund të ndikojnë gjithashtu në marrëdhëniet ndërmjet sipërmarrjeve qendrore dhe filialeve të tyre në vende të tjera, si dhe në suksesin e aleancave strategjike dhe bashkimeve apo dhe blerjeve ndërkombëtare. Distanca gjuhësore midis gjuhëve kombëtare, ose midis gjuhës globale angleze dhe gjuhëve zyrtare të vendeve të caktuara ndikon në kostot e transaksionit dhe shpesh përcakton zgjedhjen e vendeve të synuara për investime direkte¹⁴⁷. Ende ka shumë punë për të bërë për të kuptuar plotësisht ndikimin e shumëanshëm të gjuhës në botën e globalizuar të biznesit. Jo vetëm modelet teorike shpjeguese për menaxhimin ndërkombëtar përfitojnë nga një kuptim më i thellë i këtyre efekteve gjuhësore, por dhe rekomandime praktike që jepen në funksion të një menaxhimi efikas të gjuhës dhe një klimë gjithëpërfshirëse komunikimi, mund të rrjedhin gjithashtu prej tyre.

¹⁴⁵ Günter K Stahl, Rosalie L Tung, Towards a more balanced treatment of culture in international business studies: The need for positive cross-cultural scholarship, *Journal of International Business Studies*, Vol. 46, No. 4 (May 2015), Fq. 391-414

¹⁴⁶ Joel Mokyr; *The Political Economy of Knowledge: Innovation and Resistance in Economic History* Historical Origins of the Knowledge Economy, Princeton University Press (2002) Fq. 218-283

¹⁴⁷ Yadong Luo, Oded Shenkar; *The Multinational Corporation as a Multilingual Community: Language and Organization in a Global Context*, *Journal of International Business Studies*, Vol. 37, No. 3 (May, 2006), Fq.321-339

Roli i gjuhëve në suksesin e një sipërmarrjeje biznesi

Në botën tonë dinamike dhe në ndryshim të shpejtë, kompanitë janë vazhdimisht në kërkim të strategjive efektive për të nxitur zgjerimin dhe për të stimuluar rritjen optimale. Sektorët shumë konkurrues të biznesit dhe reklamave tani kërkojnë si një domosdoshmëri absolute një nivel të lartë aftësie në shumë gjuhë. Mbështetja vetëm në anglisht, që dikur konsiderohej si gjuha universale e biznesit, nuk konsiderohet më e mjaftueshme. Në një botë të ndërlidhur dhe të larmishme kulturore, bashkëveprimi me audiencë të ndryshme në gjuhët e tyre amtare nuk është thjesht një dëshirë, por një domosdoshmëri absolute.

Për fat të mirë, prezantimi i mjeteve inovative si *-Convey This-* është dëshmuar të jetë një aset i paçmuar në tejkalimin e pengesave gjuhësore dhe lehtësimin e komunikimit të qetë dhe shumëgjuhësor me klientët. Ka ikur kohët kur kompanitë luftonin me kompleksitetin dhe kostot e larta të shërbimeve të përkthimit. Me *Convey This*, një zgjidhje gjithëpërfshirëse, kufizimet gjuhësore zhbëhen pa mundim dhe kosto, duke i lejuar bizneset të angazhohen me audiencën e tyre të synuar në gjuhën e tyre të preferuar.

Duke shfrytëzuar plotësisht mundësitë e komunikimit shumëgjuhësh, kompanitë krijojnë një shumëllojshmëri mundësish rritjeje dhe zgjerimi. Duke mos u kufizuar më në një treg të vetëm, ata kanë zgjeruar dhe vazhdojnë të zgjerojnë aktivitetet dhe sipërmarrjet e tyre në mënyrë eksponenciale si dhe ndërtojnë marrëdhënie të forta me një klientelë globale duke arritur pa vështirësi klientë potencial në mbarë botën, duke demonstruar një kuptim dhe njohje të thellë të dëshirave dhe preferencave të tyre individuale¹⁴⁸.

Ndërsa kompanitë nisin këtë udhëtim transformues të thyerjes së pengesave dhe kufizimeve gjuhësore, ato bëhen të frikshme për potencialet e tyre të pashfrytëzuar. Duke shfrytëzuar aftësitë e jashtëzakonshme të *ConveyThis*, kompanitë jo vetëm që rrisin tërheqjen e tyre ndërkombëtare, por bëhen gjithashtu përcues të diversitetit kulturor dhe vlerave që ai përfaqëson, duke nxitur lidhje të vërteta me konsumatorët me prejardhje të ndryshme kulturore. Për këtë arsye theksohet rëndësia e krijimit të kompetencave të duhura shumëgjuhësore për vetë mundësitë e pakufishme të komunikimit shumëgjuhësh në fillimin e një rruge që do të çojë në rritje dhe prosperitet të jashtëzakonshëm për sipërmarrjet e biznesit ashtu dhe për eksperiencat e gjithanshme profesionale, studimore dhe jetësore¹⁴⁹.

Përfitimet e drejtpërdrejta nga kompetencat gjuhësore

Sigurimi i materialeve ose përmbajtjes së marketingut në gjuhën amtare të një personi përfaqëson një avantazh të dukshëm. Kur njerëzit konsumojnë në mënyrë të rrjedhshme informacion në gjuhën e tyre, truri aktivizon rritjen e aktivitetit në korteksin frontal, i cili është përgjegjës për përpunimin racional të informacionit. Kështu, ju mund të siguroheni që audiencë juaj të kuptojë plotësisht përmbajtjen tuaj, pavarësisht nga aftësitë gjuhësore të tyre. Megjithatë, vendimet e blerjes ndikohen kryesisht nga nevojat psikologjike dhe jo nga logjika e pastër. Kur preket korteksi frontal, të menduarit emocional zë një vend të dytë, duke e bërë të vështirë për biznesin dhe sipërmarrjet të ndikojnë në vendimet e blerjes. Duke komunikuar në gjuhët amtare të klientëve, tregtarët dhe pronarët e bizneseve mund të krijojnë një mjedis të rehatshëm ku emocionet ndikojnë në procesin e vendimmarrjes, duke rezultuar në shitje më të larta dhe kënaqësi më të lartë të klientit nëpërmjet përmbushjes së kërkesave të tij.

¹⁴⁸ Roland Wenzlhuemer; connectivity in Global History from: Globalization: Past, Present, Future, University of California Press (2023) Fq. 11-26

¹⁴⁹ Elizabeth McNeill: Writing and Reading (with) Polar Bears in Yoko Tawada's "Etüden im Schnee" (2014)

The German Quarterly, Vol. 92, No. 1 (Winter 2019), Fq. 51-67

Procesi i krijimit të aftësive shumëgjuhësore

Procesi i të mësuarit të një gjuhe të dytë shkon përtej përfitimit të thjeshtë financiar tregon se kjo përpjekje sjell edhe përfitime të shumta për mendjen e njeriut. Këto përfitime arrijnë thellë në proceset tona njohëse dhe shkojnë përtej përfitimeve sipërfaqësore. Studimet shkencore kanë zbuluar një lidhje të jashtëzakonshme midis të folurit të gjuhëve të shumta dhe sëmundjeve njohëse si Alzheimer dhe çrregullimeve psiqike në tërësi. Komunikimi në gjuhë të ndryshme mund të vonojë shfaqjen e këtyre sëmundjeve. Mësimi i një gjuhe të dytë mund të veprojë si një mburojë mbrojtëse mendjet tona nga rënia e pashmangshme që vjen me kalimin e moshës.

Përveç kësaj, bota e dygjuhësisë është e lidhur me rritjen natyrore të trurit të njeriut¹⁵⁰. Kur njerëzit zhyten në nuancat e ndërlikuara të një gjuhe të huaj, në mendjet e tyre ndodh një transformim i jashtëzakonshëm. Ashtu si një lule që lulëzon, truri zgjerohet dhe lulëzon, duke zbuluar aftësi të fshehura që më parë ishin të panjohura. Përvetësimi i një gjuhe të dytë bëhet një katalizator për zhvillimin intelektual dhe krijon terren pjellor për zhvillimin e inteligjencës.

Përfitimet e të qenit i rrjedhshëm në një gjuhë të huaj shkojnë përtej aftësive gjuhësore. Një competence e re gjuhesore përmirëson aftësitë e përgjithshme gjuhësore dhe u mundëson individëve të maksimizojnë aftësitë e tyre për të kryer shumë detyra, rregullimin e vëmendjes, mendimin, shprehitë dhe artikulin në gjuhën e tyre amtare. Strukturat gjuhësore ndërthuren në rrugët e trurit, duke mundësuar një shtrirje të gjerë midis dimensionale të ndryshme gjuhësore. Në fakt, gjuhët luajnë një rol të domosdoshëm në fushën e rritjes e shkallës perceptivë, njohëse, analizuëse dhe argumentuëse të individit¹⁵¹. Ato ofrojnë një mori përfitimesh mendore që shkojnë shumë përtej përfitimit financiar. Ato janë çelësi që mundëson njohuri të thella dhe pasuron pa masë jetën tonë.

Hyrja dhe funksionimi më i lehtë në tregun global

Tejkalimi i pengesave gjuhësore mund t'u japë punonjësve aftësitë dhe njohuritë që u nevojiten për të krijuar biznesin e tyre në tregje të reja si dhe për të kapërcyer sfidat që mund të sjellë ky zgjerim. Sipas një sondazhi të Wells Fargo, 87% e kompanive amerikane besojnë se zgjerimi ndërkombëtar është i nevojshëm për rritjen afatgjatë të tyre në tregun global. Ndërsa kompanitë pajtohen me faktin se zgjerimi është thelbësor në terma afatgjatë, shumë prej tyre nuk po përgatiten siç duhet për ndryshim.

Zhvillimi i aftësive gjuhësore të nevojshme për të bërë biznes në tregje të reja kërkon kohë. Kjo do të thotë që kompanitë që duan të bëhen globale duhet të investojnë në programet e mësimi të gjuhëve të huaja për personelin dhe burimet e tyre njerëzore sa më shpejt që të jetë e mundur.

Zgjerimi i klientelës dhe marrëveshjeve tregtare

Shitja e një produkti ose shërbimi kërkon aftësi të shkëlqyera komunikimi. Përpara se të shpenzojnë paratë e tyre të fituara me vështirësi, klientët duan të dinë saktësisht se për çfarë

¹⁵⁰ Suzanne Quay, Simona Montanari: Early Bilingualism: From Differentiation to the Impact of Family Language Practices, *Bilingualism Across the Lifespan: Factors Moderating Language Proficiency*, American Psychological Association (2016) Fq. 23-42

¹⁵¹ Werner H. Kelber; Language, Memory, and Sense Perception in the Religious and Technological Culture of Antiquity and the Middle Ages (1995) *Imprints, Voiceprints, and Footprints of Memory: Collected Essays of Werner H. Kelber*, Society of Biblical Literature (2013) Fq. 133-166

po paguajnë dhe çfarë përfitimesh mund të presin. Shumë kompani zotërojnë komunikimet e shitjeve në gjuhën e tyre kryesore të punës, por nuk mund të vazhdojnë në gjuhë të tjera dhe humbasin një pjesë të madhe të tregut. Duke kapërcyer këto kufizime gjuhësore dhe duke fituar aftësinë për të shitur në shumë gjuhë, kompanitë mund të arrijnë më shumë klientë dhe të arrijnë të njëjtat rezultate të shkëlqyera që arrijnë në gjuhën e tyre kryesore të punës. Përfitimet e aftësive të mira të gjuhëve të huaja nuk kufizohen vetëm në momentet kur kompanitë përpiqen të shesin në mënyrë aktive. Ofrimi i mbështetjes së klientit në gjuhë të tjera mund të ketë një ndikim të madh në suksesin e një kompanie. Sipas një raporti nga Common Sense Advisory, 76% e konsumatorëve preferojnë të blejnë produkte nga kompanitë që ofrojnë shërbimin ndaj klientit në gjuhën e tyre amtare¹⁵². Të folurit me njerëzit në gjuhën e tyre amtare shkon përtej niveleve të shitjeve dhe përshkrimeve të produkteve. Ai luan një rol vendimtar në ndërtimin e besimit dhe besnikërisë së klientit. Kur komunikohet në gjuhën amtare të klientit global, i deshmohet atij perkushtimi dhe gadishmeria për të permbushur nvojtat dhe kerkesat e tij.

Kuptimi i mirëfilltë i komunikimit në gjuhën e klientit

Duke qënë të ndërgjegjshëm për përfitimet e mësimin të gjuhës, është koha të shqyrtojmë se çfarë do të thotë të flasësh gjuhën e një klienti dhe se si kompanitë mund ta arrijnë këtë qëllim. Është e lehtë të shikosh të folurit e gjuhës së një klienti si një mjet për t'u kontrolluar, por kjo nuk është mënyra se si ne i shohim aftësitë e komunikimit në gjuhën tonë amtare. Aftësitë tona të komunikimit përmirësohen gjatë gjithë jetës, sepse ne dimë se sa më mirë të shprehemi nëpërmjet thellimit dhe reflektimit të mendimit kritik në komunikim, aq më shumë arrijmë¹⁵³.

E njëjta gjë vlen edhe për gjuhët e huaja, edhe nëse kompanitë duket se i kushtojnë më pak vëmendje një niveli të lartë të aftësive të gjuhëve të huaja. Shumë kompani ndërkombëtare kërkojnë që punonjësit e tyre të kenë njohuri të gjuhës së punës në nivelin B2, d.m.th., që nenkupton aftësinë e të kuptuarit dhe komunikuarit në shumicën e situatave. Ndërsa kjo mund të jetë e mjaftueshme për të qëndruar brenda një komunikimi rezultativ dhe cilësor, folësit ka të ngjarë të kenë nevojë për një nivel më të lartë të aftësisë gjuhësore për të bindur një klient hezitues për të blerë një produkt ose shërbim.

Roli i tejkalimit të pengesave gjuhësore në stimulimin e suksesit të një sipërmarrjeje

Në përfundim të parashtrimit analitik të mësipërm rikonfirmohet edhe njëherë fakti se komunikimi efikas është në fokusin qendror të interesit të çdo kompanie të suksesshme dhe luan një rol pothuajse në të gjitha fushat e biznesit, nga komunikimi i qartë midis punonjësve deri tek mbështetja e klientëve të klasit të parë. Shumë kompani krenohen shumë për punën e tyre të komunikimit, që nga mesazhet kryesore që përdorin për të shitur shërbimet e tyre dhe deri tek vleresimet që u perjellin punonjësve të tyre për suksesin që ato kanë realizuar nëpërmjet komunikimit me tregun dhe konsumatorin global.

Tejkalimi i pengesave gjuhësore në kompanitë shumëkombëshe i shërben një qëllimi të thjeshtë: që konsiston në kerkesen e sigurimit të aftësive gjuhësore që maksimizojnë suksesin nëpërmjet përfitimeve që vijnë nga komunikimi fitimprurës jo vetëm në një gjuhë të

¹⁵² Ian Ayres, Alan Schwartz; The No-Reading Problem in Consumer Contract, *Law Stanford Law Review*, Vol. 66, No. 3 (MARCH 2014), Fq. 545-609

¹⁵³ Mary Jo Festle; How We Teach. *Transforming History: A Guide to Effective, Inclusive, and Evidence-Based Teaching*, University of Wisconsin Press (2020) Fq. 87-141

Materialet e punimeve (proceedings)**ISBN: 978-1-78911-007-4**

vetme. Kompanitë që merren seriozisht me tejkalimin e pengesave gjuhësore në komunikim dhe janë të përkushtuara për funksionimin e mirë të komunikimit ndërgjuhësor dëshmojnë qartë një ndikim dukshëm pozitiv në suksesin e biznesit dhe sipërmarrjeve të tyre.

Bibliografia

Elizabeth McNeill: Writing and Reading (with) Polar Bears in Yoko Tawada's "Etüden im Schnee" (2014) *The German Quarterly*, Vol. 92, No. 1 (Winter 2019), Fq. 51-67

Günter K Stahl, Rosalie L Tung, Towards a more balanced treatment of culture in international business studies: The need for positive cross-cultural scholarship, *Journal of International Business Studies*, Vol. 46, No. 4 (May 2015), Fq. 391-414

H. O. Mounce, Philosophy, Solipsism and Thought, *the Philosophical Quarterly* (1950-), Vol. 47, No. 186 (Jan., 1997), Fq. 1-18

Ian Ayres, Alan Schwartz; The No-Reading Problem in Consumer Contract, *Law Stanford Law Review*, Vol. 66, No. 3 (MARCH 2014), Fq. 545-609

John Henley, Outsourcing the Provision of Software and IT-Enabled Services to India: *Emerging Strategies International Studies of Management & Organization*, Vol. 36, No. 4, *International Strategy and Cross-Cultural Management* (Winter, 2006/2007), Fq. 111-131

Joel Mokyr; The Political Economy of Knowledge: Innovation and Resistance in Economic History; *Historical Origins of the Knowledge Economy*, Princeton University Press (2002) Fq. 218-283

Yadong Luo, Oded Shenkar; The Multinational Corporation as a Multilingual Community: *Language and Organization in a Global Context*, *Journal of International Business Studies*, Vol. 37, No. 3 (May, 2006), Fq.321-339

Mary Jo Festle; How We Teach. Transforming History: *A Guide to Effective, Inclusive, and Evidence-Based Teaching*, University of Wisconsin Press (2020) Fq. 87-141

Roland Wenzlhuemer; connectivity in Global History from: *Globalization: Past, Present, Future*, University of California Press (2023) Fq. 11-26

Suzanne Quay, Simona Montanari; Early Bilingualism: From Differentiation to the Impact of Family Language Practices, *Bilingualism Across the Lifespan: Factors Moderating Language Proficiency*, *American Psychological Association* (2016) Fq. 23-42

Werner H. Kelber; Language, Memory, and Sense Perception in the Religious and Technological Culture of Antiquity and the Middle Ages (1995): *Collected Essays of Werner H. Kelber*, *Society of Biblical Literature* (2013) Fq. 133-166

Transformimi i formantit ligjërimor të mësuesit të gjuhës shqipe dhe letërsisë

DR. NATASHA POROÇANI
Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës

Abstrakt

Duke tentuar të kuptojmë procesin e transformimit ligjërimor përgjatë procesit të mësimdhënies së gjuhës shqipe dhe letërsisë në AML, synojmë ta analizojmë atë përgjatë aktit të mësimdhënies nga protagonistët kryesorë të këtij procesi, mësuesit. Mbështetur në dialektikën e transformimit të dukurive përgjatë evolucioneve kurrikulare, mësuesi ndryshon si në formatin e tij ligjërimor: komunikimi, niveli ligjërimor, përzgjedhja semantiko-leksikore etj., ashtu edhe në modalitetet e dhënies së njohurive shkencore, qoftë didaktikisht, qoftë pedagogjikisht.

Përmes metodës hulumtuese dhe krahasuese, studimi e vlerëson procesin në modalitete ligjërimore të mësimdhënies sipas niveleve dhe dinamikave kurrikulare.

Gjithashtu, përmes metodës analizuese, studimi argumenton se si vetë epistemat e gjuhës amtare dhe letërsisë në këtë nivel formimi (AML), ndikojnë në transformimin e figurës së mësuesit duke e kaluar nga mësuesi tradicional i metodikës përshkruese, në mësuesin si interpretues dhe ndërmjetës ndërdisiplinor.

Në përfundim kemi arsyetur përputhshmërinë e transformimit të ligjërimit të mësuesit /didaktit me ndryshimet kurrikulare të ndërvarura nga ndryshimet e konteksteve socio-kulturore.

Fjalë kyçe: *ligjërim, mësues, kurrikula, gjuhësi e zbatuar, transformim.*

Kontributi i personelit akademik, e sidomos kontributi i mësuesve, është thelbësor në suksesin e sistemit arsimor. *Mësuesit janë interlokutorët mes shoqërisë në zhvillim dhe nxënësve që përgatiten për të qenë pjesë e kësaj shoqërie*¹⁵⁴. Kjo pjesë, mbase më e rëndësishmja e dokumentit europian dedikuar shkollës, pohon rolin e mësuesit me gjithë komponentët e tij, në zhvillimin shoqërisë njerëzore.

Referuar vlerësimit të mësipërm, pohojmë se sot mësuesit janë ndodhur para jo pak sfuidash sa profesionale, aq edhe sociale, të cilat në fakt janë sfida edhe për vetë sistemin arsimor shqiptar: mësimdhënia në tërësi dhe specifikisht mësimdhënia e gjuhës shqipe dhe letërsisë në AML, gjenden para problematikave të qenësishme që lidhen, ndër të tjera, edhe me formatin e mësuesit, me produktivitetin e punës së tij, më aftësitë shumëfishe që ai duhet të zotërojë.

Koha na servir sot dy tipologji mësuesish: mësuesit e sistemit universitar 4-vjeçar, të cilët ndodhen para direktivës së vetme të ndryshojnë formatin e tyre formues drejt një tjetër formati që ofron kurrikula me kompetenca, e cila vendos në qendër nxënësin.

Dhe grupi i dytë i mësuesve që sapo ka mbaruar sistemin 3+2, i cili duhet të punojë me kurrikulën e re, me në qendër nxënësin, pa kaluar nga metodologjia tradicionale. Ky grup i dytë presupozohet të mos i nënshtrohet mësimdhënies tradicionale me në qendër mësuesin, nëpërmjet së cilës sipas Deëy trajnon veten me aplikimin e dijeve referuese universitare, por edhe të dijeve që mund të mos i ketë hasur në universitet (këtu do të përmendja nevojën e hapësirës që Fakultet e Edukimit duhet t’u japin shkencave të aplikuara).

Nëse i hedhim një vështrim analizues strukturës së kurseve të diplomës në shkencat gjuhës shqipe dhe letërsisë, sistemi duket se karakterizohet nga dy ide themelore: *nga njëra*

¹⁵⁴ https://archivio.pubblica.istruzione.it/neës/2007/allegati/all_avviso200707.pdf

Materialet e punimeve (proceedings)

ISBN: 978-1-78911-007-4

anë kemi idenë komplekse të profesionalizmit të mësuesit në materiet e gjuhës dhe të letërsisë dhe nga ana tjetër idenë e një kurrikule të integruar, e cila zhvillohet kryesisht në nivelin +2.

Ideja komplekse e profesionalizmit të mësuesit është e lidhur me kapërcimin e ndarjeve dhe pjesëzimit në imazhin e mësuesit: nuk kemi një mësues ekspert vetëm në përmbajtje, vetëm në metodat e mësimit, vetëm kujdestar të edukimit, vetëm edukator. Kurrikula e re në të cilën thuhet se mësimit në kurrikulën me kompetenca

siguron kompetencat për të nxënësit gjatë gjithë jetës/bazohet në bindjen se çdo nxënës mund të jetë i suksesshëm/bazohet në njohuritë paraprake të nxënësve dhe e planifikon të nxënësit mbi bazën e tyre/planifikohet për rezultate të nxënësit që synojnë kompetencat/laftëson nxënësit të përdorin njohuritë/siguron partneritetin mësues-nxënës në procesin e mësimit dhe të të nxënësit/mbështetet në situata të nxënësit reale ose të ngjashme me realitetin/bazohet në parimin e integritetit lëndor/ërkohet nga parimi i përzgjedhjes/zhvillohet mbi bazën e burimeve të shumëllojshme të informacionit/mbështetet në TIK/përfshin sistematikisht nxënësit në eksperimente e vëzhgime¹⁵⁵,

nënkupton aftësimin e mësuesit në njëkohësi.

Kuptojmë se profesioni i mësuesit kërkon një shumësi aftësish: **kulturore** (të lidhura me njohuritë disiplinore lëndore), **didaktike** (e qenësishme kjo në metodologjitë e mësimit, të bazuara këto kohë në një integrim jo fort të qëndrueshmë ndërdisiplinor, madje do të thonim larg idesë themelore që termi dhe parimi tregon); **relacionale** (marrëdhëniet me nxënësit kanë marrë një tjerër dimension dhe dinamikë, përmes së cilave gjuha është themeli i komunikimit dhe letërsia, qasja më e mirë ndaj këtij komunikimi). Kjo shuësi aftësish, mbështetet edhe në kërkesën themelore që korniza kurrikulare e gjuhës dhe letërsisë vendos për mësuesin: **Mësuesit do ta përdorin programin e gjuhës shqipe për të krijuar një tablo të qartë rreth asaj se çfarë duhet të dinë dhe të jenë të aftë të bëjnë nxënësit dhe se si duhet ta ndërtojnë mësimit për të pajisur nxënësit me kompetencat kyçe dhe të lëndës, si dhe për të përmbushur kërkesat e programit¹⁵⁶.**

Le t'u hedhim një vështrim këtyre aftësive.

Në epokën e shoqërisë që nxë, *aftësitë kulturore*, duhet të sigurohen në nivele të larta, pavarësisht nga segmenti specifik shkollor në të cilin mësuesi i gjuhës dhe letërsisë do të huazojë punën e tij/saj; qoftë për të nxitur një formë të lëvizshmërisë vertikale të mësuesve që nuk provokon rënie të cilësisë së performancës së formimit; qoftë sepse në një kulturë që ndryshon me shpejtësi, vetëm formimi adekuat mbi bërthamat themelore të dijes do t'u mundësojë mësuesve të ndjekin transformimet e strukturave disiplinore. P.sh. në lëmin e gjuhës kategoritë gramatikore nuk merren më vetëm thjeshtë si të tilla, por në fuqinë e tyre shprehëse diskursive, çka kërkon aftësi të tilla multikulturore që ndihmojnë në çkodimin e teksteve dhe në interpretimet e tyre opërmes ngërthimeve shumëfishë.

Aftësitë e mësimit, në kuadrin e shkollës autonome, misioni kryesor i së cilës është sigurimi i standardeve të larta të planifikimit didaktik dhe organizativ, duhet të përfaqësojnë trashëgiminë e përbashkët profesionale të të gjithë mësuesve, për, të garantuar një plan trajnimi profesional të aftë për t'iu përmbajtur me përpikmëri dhe fleksibilitet nevojave formuese të vetë stafit. Në këtë kuadër mësuesi i gjuhës dhe letërsisë gjendet para emergjencës së një formati të ri mësimit: mësimit me në qendër nxënësin. Kjo do të thotë që të dy tipologjitë që përmendëm më lart, derivojnë të njëjtën domosdoshmëri:

¹⁵⁵ Korniza kurrikulare e arsimit parauniversitar të Republikës së Shqipërisë, MAS, Tiranë 2014, fq. 44

¹⁵⁶ <https://ascap.edu.al/wp-content/uploads/2018/09/GJUHE-SHQIPE-KL-X-XI.pdf>

perfeksionimin e aftësive profesionale, për të përshtatur dijet e tyre të referencës në traspozime aplikative.

Në gjuhë, konceptet e tiplogjisë tekstuale, në letërsi gërshetimi analizave të autorëve me metodën historiciste, me analiza tekstesh mbështetur te analizat diskursive.

Unifikimi i aftësive profesionale, në nivel departamenti, pra kjo bazë e përbashkët është e nevojshme nga stili kolegjal dhe pjesëmarrës i punës që kërkon kurrikula e re, e cila, në të vërtetë, implikon një kulturë të përbashkët didaktike nga ana e stafit mësimdhënës. Rrjetet profesionale në shkolla janë sisteme komplekse që mund të kthehen agjentë themelorë ose instrumente ndryshues për personat që marrin pjesë në to dhe janë në gjendeje të lidhin shumë subjekte, duke i dhënë konkretësi dhe autonomi didaktikës, përmes zhvillimit të formave *kërkim-veprim* të cilat vlerësojnë përvojat projektuese të shkollave në funksion të një edukimi permanent bazuar në *formim-eksperimentim-vlerësim*.¹⁵⁷

Aftësitë relacionale, në kuadër të një shkolle të hapur e cila sa po vjen e po bëhet multikulturore (pse jo edhe multi etnike), qëndrojnë si të pashmangshme për një menaxhim pedagogjik të dinamikës sociale, në drejtime të tilla, që të vlerësojnë, mbrojnë dhe përmirësojnë stilet e komunikimit të pranishëm në komunitet e shkollave, me modalitet të tilla që të jenë të afta për të garantuar hapjen e saj dhe kohezionin e saj njerëzor dhe qytetar.

U kuptua gjithashtu se kompleksiteti i profesionalizmit të mësuesit nuk është vetëm shumëllojshmëria e dimensioneve të kompetencave të përfshira, por edhe fakti se këto dimensione janë të ndryshme për shkak se ndërthuren dhe integrohen në kontekstin e praktikave shkollore.

Nga këtu ideja e dytë, ajo e *kurrikulës së integruar*. Ideja e një kurrikule të integruar bazohet në lidhjen e lëndëve, mësuesve dhe praktikave sipas një rrethi midis teorisë dhe praktikës. Në këtë logjikë, d.m.th linjat kurrikulare synojnë jo aq shumë transmetimin e njohurive që do të zbatohen në praktikë, se sa ndërtimin e strukturave konceptuale të afta për të interpretuar përvojën e formimit dhe për të udhëhequr formulimin e hipotezave të punës nga mësuesit. Në fushën e gjuhës dhe letërsisë, drejtimet integruese janë të shumëfishta. Jo vetëm për faktin e se gjuha shqipe është filli që lidh gjithë sistemin kurrikular, por edhe sepse gjuha dhe letërsia paisin nxënësin me aftësitë dhe shprehjet e domosdoshmë për t'iu qasur cilësdo fushë njohjeje.

Gjithë procesi i shkrimit dhe interpretimit në të dy materiet (gjuhë dhe letërsi) nuk synojnë vetëm përvetësimin thjesht të aftësive operacionale, por mbi të gjitha synojnë të bashkojnë (shkrijnë) njohjet teorike deklarative me ato proceduriale, duke i shndërruar në *aftësi inteligjente, me një profil reflektues*. Në fund të fundit, procesi i shkrimit në gjuhë dhe letërsi nuk duhet parë si një praktikë e thjeshtë, por si terren në të cilën mësimi kulturor (të mësuarit nga mësues tashmë me përvojë) ndërthuret me praktikën e kërkim-veprimit (në qerthullin veprim-reflektim) duke krijuar tensionin e duhur midis inovacionit dhe traditës së mësimdhënies. Elementi risi më i rëndësishëm i këtij impianti (pra mësimdhënies së gjuhës dhe letërsisë) qeveriset nga *perspektiva e integruar* sipas së cilës ndërtohen marrëdhëniet ndërmjet pajisjeve, gjë që i bën ato të ndërthuren në mënyra të ndryshme në forma të lëvizshme, shpeshherë të lëvizshme në mënyrë të paparashikuar. Motorri i kësaj lëvizjeje janë mësuesit e gjuhës dhe letërsisë. Në fakt, marrëdhënia e mësuesit me vetë mësimdhënien në kurrikël e re mund të konceptohet në dritën e një logjike hierarkike, sipas së cilës së pari vjen teoria dhe më pas praktika (*punëtori dhe stazhi*), që përbën zbatimin e saj. Por në realitet, një logjikë hierarkike dhe sekuenciale e këtij lloji nuk vlen për mësuesin e shkencave humane në

¹⁵⁷ Cit. F. Marone, *Emozione e affetti nel processo formativo*, ETS, Pisa 2006, R. Biagioli, *Rete di scuole e progettazione formativa, Strumenti e metodi*, Carocci, Roma 2012.

përgjithësi. Ajo do të thyente përmbledhjen e njohurive të fituara gjatë rrugës universitare, njohuri të cilat përbëjnë mbetjen akademike në kuptimin jo fort pozitiv, dhe jo të shkrihen në praktikën aktuale profesionale. Në fakt, çdo praktikë komplekse profesionale nuk kërkon aplikim të thjeshtë të njohurive dhe zgjidhjeve të marra në mënyrë abstrakte, por aftësinë për t'u përbërur në mënyrë inteligjente dhe reflektuese me problemet e fushës së veprimtarisë. Për ta bërë konkrete këtë analizë, do të merrnin një shembull:

Për të aftësuar nxënësin në analizën e zërthimit të çdo lloj teksti, mësuesi e vendos nxënësin përpara tekstit me alternativën e vetme globale: **të emërtojë faktin, dukurinë që vjen përmes tekstit**. Në këtë problem të maddh nxënësi orientohet drejt:

alokucionit dhe referencës/shprehive referenciale (përshkrimet, emrat, indikatorët) / kompetencës leksikore/zgjedhjeve interpretuese të shprehive referenciale (qasja, conotacionet) lëvizjeve komunikative.

Sa përshruam e zhbën proceden hierarkike. Nga ana tjetër, edhe një logjikë e thjeshtë empirike, e cila mund t'i referohet një profesioni të ndërtuar tërësisht mbi përvojën profesionale, karakterizohet nga kufizime të rënda. Sipas kësaj zgjedhjeje kompetenca profesionale mësohet nga praktika mësimore e realizuar direkt në shkollë, pra përgatitja mësimdhënëse fillestare e mësuesit kufizohet vetëm në njohuritë që do të mësohen praktikisht; për më tepër formimi fillestar i mësuesit, limitohet në dijet që mësohen në një dhënie modeste të dijeve pedagogjiko-didaktike, që duhet vetëm të formojnë orientim të parë të përafërt. Pjesa tjetër do të mësohet me vitet, duke punuar drejtpërdrejt në klasë.

Gjithsesi, ajo çka ne synojmë të qartësojmë është formati i ri i mësimdhënies në kurrkulën me kompetenca, të cilën e përbëjnë një mësues i mirë, pra që dijet e tij referenciale janë të qëndrueshme. Por, nëse logjika hierarkike përkthehet në një perspektivë lineare që është e pamjaftueshme për të formuar një aftësi komplekse, logjika empirike keqkupton të mësuarit nga përvoja. Mësuesi që ka dalë nga sistemi 3+2 nis të ndodhet në mes dy alternativave, të cilat i ka qartësuar Dewey. Dewey¹⁵⁸ dalloi dy mënyra të të mësuarit nga përvoja: një mësim përmendësh, i bazuar në një proces të thjeshtë testimi dhe gabimi; dhe të mësuarit inteligjent, bazuar në reflektimin mbi lidhjet mes ideve dhe fakteve. Nëse të mësuarit nga përvoja ndodh mekanikisht, pa refleksivitet inteligjent, do të formohen zakone profesionale të ngurtë dhe të pavetëdijshme. Pajisjet profesionale të mësuesit, pra, do të ndeshen me kristalizimin në një seri skriptesh fikse, të cinguar në fleksibilitet. Pra për të gjetur një të mesme të artë, themi se logjika e integritit duket më e aftë të shkojë përtej kufijve të modelit hierarkik dhe atij empirik. Në fakt, përtej kështimit për të formuar aftësitë kulturore, didaktike dhe relacionale, një model i tillë ka një vlerë të shtuar. Nëse është e vërtetë që mësuesi mëson edhe nga praktika e vet profesionale, është po aq e vërtetë se cilësia e një mësimi të tillë varet nga mënyra se si ai ka mësuar të përfitojë nga përvoja: qoftë mekanikisht, qoftë me refleksion apo me inteligjencë.

Në këtë mënyrë identifikohet vlera e shtuar e modelit të integruar: formimi kolateral i një kompetence metakognitive që tenton të shtojë aftësitë e tjera të përmendura, por në një nivel më të lartë. Bëhet fjalë për një aftësi të një niveli logjik më të lartë se të tjerët, sajë të cilës mësuesi rregullon shprehjet.

Përfundime

Këtë metaekspertizë të veçantë mund ta shohim si një dhomë e kontrollit mendor gjatë procesit të mësimdhënies: lejon drejtim të ndërjegjshëm dhe inteligjent; në mënyrë metaforike, po mund të themi se i hap rrugën një qëndrimi reflektues të vetë mësuesit dhe një

¹⁵⁸ John Dewey, *Democrazia e educazione*, La Nuova Italia, Firenze 2000 (1996), fq 186-194

Materialet e punimeve (proceedings)

ISBN: 978-1-78911-007-4

pirrijeje investigative ndaj praktikës së vet profesionale. Kjo është një mënyrë që vërteton pohimin e Baldaccit¹⁵⁹ se *mësimdhënia është një fushë problemesh që duhet trajtuar nën procesin e të menduarit dhe në frymën e kërkimit, sipas një procesi në të cilin: bën pyetje, formulon hipoteza pune, teston ato, reflekton rezultatet dhe kështu kthehet për të bërë pyetje të reja, e kështu me radhë. Pra e konfiguruar kështu, mësimdhënia garanton kërkim-veprim të vazhdueshëm. Dhe mësuesi bëhet një hulumtues i vazhdueshëm i formimit të tij, siç do të kishte dashur Deëy¹⁶⁰.*

Falë modelit të integruar, pra, është e imagjinueshme që formimi fillesatër universitar i mësuesve, përtej pajisjes së tyre me një sërë aftësish dhe parimesh bazë, i lejon ata të mësojnë nga përvoja e tyre në një mënyrë inteligjente, duke hedhur kështu themelet për një edukim në shërbim të përhershëm dhe cilësor.

Bibliografia

- Eduard Sapir, *Gjuha - Hyrje në shkencën e ligjërimit*, Rilindja, Prishtinë 1980.
- F. Marone, *Emozione e affetti nel processo formativo*, ETS, Pisa 2006.
- Ferdinand de Sosyri, *Kursi i gjuhësisë së përgjithshme*, Dituria, Tiranë.
- John Dewey, *Democrazia e educazione*, La Nuova Italia, Firenze 2000.
- *Korniza kurrikulare e arsimit parauniversitar të Republikës së Shqipërisë*, MAS, Tiranë 2014, fq 44
- Osvald Dykro & Cvetan Todorov, *Fjalori enciklopedik i shkencave të ligjërimit*, Rilindja, Prishtinë, 1984.
- P. Auer. (2011). *Dialect&standard:a typology of scenarios in Europe*, ([http://paul.igl.unifreiburg.de/auer/userfiles/downloads/\(2011\)%20Dialect%20vs.%20standard%20a%20typology%20of%20scenarios%20in%20Europe.pdf](http://paul.igl.unifreiburg.de/auer/userfiles/downloads/(2011)%20Dialect%20vs.%20standard%20a%20typology%20of%20scenarios%20in%20Europe.pdf))
- R. Biagioli, *Rete di scuole e progettazione formativa, Strumenti e metodi*, Carocci, Roma 2012.
- Rolan Barti, *Avventura semilogjike*, Dukagjini, Prishtinë, 2008.
- Tomorr Plangarica, *Gjuha shqipe në arsimin shqiptar: çështje të metodës*, Botuar në: “*Gjuha shqipe në arsimin shqiptar: çështje të metodës*”, në « Politikat shkencore për lëndët e Gjuhës dhe Letërsisë në arsimin shqiptar », Konsultë Kombëtare, organizuar nga QSA&MAS, Tiranë, 12 prill 2010.
- Web-site
- https://archivio.pubblica.istruzione.it/neës/2007/allegati/all_avviso200707.pdf
- <https://ascap.edu.al/ep-content/uploads/2018/09/GJUHE-SHQIPE-KL-X-XI.pdf>
- <https://ascap.edu.al/wp-content/uploads/2018/01/Letersi.pdf>
- <https://diasporashqiptare.al/2020/12/20/at-gjergj-fishta-homeri-i-pavdekshem-shqiptar/>

Massimo Baldacci, *La formazione dei docenti nel tirocinio*, në *L'orientamento e la formazione degli insegnanti del futuro*, University Press, Firenze 2014.

John Dewey, *Le fonti di una scienza dell'educazione*, La Nuova Italia, Firenze 1996.

Ngërthimi bashkëbisedimor si element analize e ligjërimit politik

DR. ARDITA DYLGJERI
Universiteti i Elbasani “Aleksandër Xhuvani”

Abstrakt

Ligjërimi si aktivitet i të folurit dhe jo vetëm, si çdo sjellje sociale, është i rregulluar nga normat. Janë këto norma që e formësojnë ligjërimin dhe njëkohësisht e bëjnë atë të arsyeshëm, koherent dhe koheziv. Rrjedhimisht, çdo akt i të folurit/ligjërimit nuk mundet të ngjizet pa u justifikuar në një mënyrë a tjetër e drejta e tij për t’u shfaqur i tillë, siç ai paraqitet duke respektuar rregullat dhe ligjësitë e duhura.

Grice, një filozof gjuhe i njohur, i cili ka marrë në shqyrtim ngërthimet kuptimore në punimet e tij, propozon se të kuptuarit a të kapurit e kuptimit të komunikuar të një thënieje nuk është çështje konvencioni apo rregulle. Ai vë theksin te zbatimi apo edhe moszbatimi i maksimave të bashkëbisedimit dhe rastet kur këto fenomene hasen. Në ligjërimit politik, kjo qasje bëhet sa interesante, po aq dhe problematike. Ligjërimit politik tipizohet më së shumti si ligjërimit argumentues, provokativ, nxitës, por edhe i pasuruar me manovrimet gjuhësore, akte të tërthorta dhe ngërthime bashkëbisedimore që gjenden lehtësisht të përfaqësuara aty.

Ky artikull synon që jo vetëm të parashtrijë një shpjegim të shkurtër teorik të asaj çka implikaturat/ngërthimet kuptimore nënkuptojnë, por dhe më tej, të analizojë raste konkrete, ku dashur padashur, ligjëruesit (politikëbërësit) të angazhuar në biseda apo intervista politike shmangin respektimin e maksimave të bashkëbisedimit. Në varësi të situatave, ata tentojnë në mënyrë të ndërgjegjshme ose të pandërgjegjshme të “manipulojnë” intervistuesit dhe audiencën në të njëjtën kohë. Përgjithësisht, për të arritur këtë synim final, politikëbërësit krijojnë mundësi për implikatura/ngërthime kuptimore të shumëllojshme.

Fjalë kyçe: *ngërthim bashkëbisedimor, ligjërimit politik, maksima, zbatim, moszbatim.*

Hyrje

Analiza e gjuhës si një sistem abstrakt duket e papranueshme në ditët e sotme me të gjitha zhvillimet në analizën e diskursit si disiplinë në kryqëzim disiplinash. Ndaj, duke u nisur nga kjo, përshtatja e konceptit të dialogizimit e çon filozofin sovjetik Michael Bakhtin (1929) drejt ndërveprimit verbal/të folur të cilin ai e konsideron si thelbin e teorisë ligjërimore. Në vazhdim të kësaj teorie, Todorovi dhe me tej Ducrot parashtrijë idenë që diskursi nuk është një entitet homogjen, ide këto që do të çonin zhvillimet në fushën e ligjërimit në një nivel tjetër.

Teoria e implikaturave dhe maksimave bashkëbisedimore të propozuara nga Grice, sidomos të analizuara nga pikëpamja e ligjërimit politik përbëjnë interes të veçantë studimi. Duke marrë si objekt të këtij punimi, ngërthimin bashkëbisedimor të realizuar më së shumti përmes zbatimit dhe moszbatimit të disa prej maksimave bashkëbisedimore, ky artikull synon të evidentojë se qëllimi i tyre është mohimi i së vërtetës apo së paku i një pjese të saj. Ky qëndrim duket se në pjesën më të madhe të copëzave të ligjërimit është i qëllimshëm dhe i vullnetshëm nga ana e ligjëruesve, që në kontekstin konkret janë politikëbërësit. Duke “ndërtuar kështjella në ajër”, me teknikat karizmatike, klishetë dhe gjuhën eufemistike që politikëbërësit përdorin, ata tentojnë të manipulojnë audiencën duke u fshehur të vërtetën.

Në fillim, shkurtimisht do të parashtrijë një shpjegim teorik të asaj çka implikaturat/ngërthimet kuptimore, si një çështje shumë e debatuar, nënkuptojnë, më pas do të ndalemi te katër maksimat dhe nënmaksimat bashkëbisedimore që Grice-i veçon, dhe më tej do të rrekemi të analizojmë raste konkrete, ku dashur-padashur, ligjëruesit të angazhuar në

biseda apo intervista politike shmangin respektimin e maksimave. Në varësi të situatave, pasazhet ligjërimore që do të merren në shqyrtim i përkasin dy periudhave të ndryshme që kanë shenjuar ndryshime të rëndësishme historike, politike, sociale e ekonomike. Më specifikisht, analiza do të përqendrohet te ligjërimi politik i lëvruar gjatë diktaturës komuniste dhe ajo e pas viteve `90 në Shqipëri.

Përmes këtij punimi, nuk do të tregojmë thjesht faktin që ligjërues të ndryshëm zgjedhin të “dhunojnë” një apo disa nga maksimat e bashkëbisedimit, për të realizuar qëllimet e tyre politike duke hapur mundësi për implikatura/ngërthime kuptimore të shumëllojshme, por njëkohësisht, do të përpiqemi të krahasojmë dhe kontrastojmë zbatimin dhe moszbatimin e maksimave të bashkëbisedimit në rrethana dhe kontekste të ndryshme ligjërimore.

1. Diskursi politik si bashkëbisedim. Dialogizimit dhe polifonia.

Analiza e dukurive gjuhësore, e përqendruar thjesht në njësitë e nënsistemeve të ndryshme gjuhësore, pavarësisht nga vlerat që përftohen në procesin e të thënit, në përdorimet gjuhësore në përputhje me situata të ndryshme komunikative është e pamjaftueshme në ditët tona. Teoritë e ndryshme që lidhen me proceset e të thënit, janë përqendruar pikërisht në këtë shfaqje të rëndësishme të diskursit.

Teoritë e të thënit, ato të pragmatikës gjuhësore, të analizës së diskursit e të tekstit kanë sjellë tashmë një tjetër qasje në lidhje me ngjizjen e interpretimin e diskurseve e teksteve. I vërejmë fillësat në këtë qasje të re ndaj realitetit të folur (përtej sistemit gjuhësor e njësisve të tij), qysh me konceptin e *dialogizmit*, të përfutur nga Michael Bakhtin-i (1929), një ndër konceptet që u vu në bazë të interpretimit të dukurive ligjërimore. Në zanafillë të teorisë së Bakhtin-it gjendet pikëvështrimi i tij që mund ta përgjithësojmë sipas kësaj reference: “të flasësh, do të thotë të komunikosh, dhe të komunikosh, do të thotë të ndërveprosh”¹⁶¹.

Të shprehurit a mënyra e të thënit nuk është e kuptuar si një akt individual, por një aktivitet social i bashkëpërcaktuar nga një tërësi lidhjesh dialogjike. Në fakt, për Bakhtin-in “dialogu, në kuptimin e ngushtë të termit, përbën, veçse një prej formave, më të rëndësishme, të ndërveprimit verbal. Por ne mundet ta kuptojmë fjalën “dialog” në një kuptim të gjerë, duke përfshirë këtu çdo shkëmbim verbal, të çdolloj tipi qoftë”¹⁶². Nocioni i dialogizmit është pra njëri prej përbërësve thelbësorë të asaj çka mund ta quajmë dimensionin ndërveprues i diskursit.

Për Bakhtin-in, çdo formë monologjike është e tillë veçse nga forma e jashtme, por, për nga forma semantike dhe stilistike, ajo është në fakt mirëfilli dialogjike, pasi në çdo rast vihet re prania e disa zërave, shpeshherë në formën e ndërtekstualitetit (çështje të cilën e morëm në shqyrtim në kapitullin pararendës).

Në vazhdim të kësaj teorie, Todorovi përvijoi idenë që diskursi nuk është një entitet homogjen, por një “entitet i përshkuar nga prania e tjetrit”¹⁶³. Për këtë autor, “Diskursi takon diskursin e tjetrit në të gjitha rrugët që çojnë drejt objektit të tij, dhe ai nuk mundet të mos hyjë me të në ndërveprim të gjallë dhe intensiv.”¹⁶⁴

¹⁶¹ Bakhtine M. (1929) cituar te Plangarica T. “Analiza e gjuhës dhe diskursit”, Cikël ligjëratash, Infobot, Elbasan, 2014, fq. 85.

¹⁶² Bakhtine M. (1977:136) cituar te te Plangarica T. “Analiza e gjuhës dhe diskursit”, Cikël ligjëratash, Infobot, Elbasan, 2014, fq. 85.

¹⁶³ Todorov T. “Introduction to Poetics” (Theory and history of literature) University of Minnesota Press, First edition, 1981, fq. 98.

¹⁶⁴ Po aty.

Ducrot-ja sjell kontributin e tij në çështjet që lidhen me polifoninë e diskursit, duke bërë dallimin midis *folësit* dhe *thëniepërfutuesit*. Për këtë autor, *subjekti folës* është qenia empirike/konkrete me mish e kockë, “një element i përvojës; folësi nga ana e tij është “një qenie e diskursit” i cili është “përgjegjës i thënies, të cilit i referohet përemri unë dhe shënjesit e tjerë të vetës së parë”; ndërsa *thëniepërfutuesi*, më së fundi, është prej “këtyre qenieve që janë të afta të shprehen përmes procesit të thënit, pa i atribuar atyre dhe aq fjalë precize”¹⁶⁵.

Në këtë këndvështrim, polifonia semantike përbën parimin bazë për shqyrtimin e çështjeve që përfshihen në analizën e diskursit, pasi këtu “Kuptimi nuk paraqitet si shtesë e domethënies dhe të diçkaje tjetër, por si ndërtim i përfutur, i bartur prej situatës apo rrethanave në të cilat është ngjizur përfutësia ligjërimore”¹⁶⁶.

Mendimi që çdo diskurs është polifonik, zhvillohet më tej te Jacqueline Authier-Revuz (1982), ku konceptet e *dialogizmit* dhe të *polifonisë* janë trajtuar nën formën e *heterogjeniteteve përbërëse*.¹⁶⁷

Në përfundim të teorive të paraqitura më lart, mund të arrihet në përfundimin se, duke qenë se çdo formë diskursi është heterogjene dhe me karakter polifonik, ajo duhet konsideruar dhe interpretuar duke marrë parasysh këndvështrime të ndryshme të entiteteve pjesëmarrëse aty, si aspektin social, po ashtu edhe atë gjuhësor.

2. Implikaturat/ ngërthimet bashkëbisedimore.

Ligjërimi si aktivitet i të folurit dhe jo vetëm, si çdo sjellje sociale, është i rregulluar nga normat. Ekzistojnë norma si: (“maksimat bashkëbisedimore”, “ligjet e diskursit”, “postulatet e bashkëbisedimit”...) të cilat matarojnë çdo shkëmbim gjuhësor: të jetë i arsyeshëm, të mos përsëriten gjërat, të japë informacione e duhura për situatën, etj.

Sipas Grice, “Kontributi bashkëbisedimor i ligjëruesve duhet të jetë në përputhje me objektivin dhe drejtimin që ka komunikimi verbal apo biseda në fjalë”¹⁶⁸.

Ai numëron gjithsej nëntë maksima bashkëbisedimore që modelojnë përdorimin efektiv dhe të dobishëm të gjuhës. Sipas përafrisë mes tyre, “këto maksima mund të grupohen në katër kategori bazë: maksima e sasisë, maksima e cilësisë, maksima e relevancës dhe ajo e mënyrës”¹⁶⁹.

1. Maksima e sasisë. Jini informues.
2. Maksima e cilësisë. Kontributi juaj duhet të jetë i vërtetë.
3. Maksima e relevancës. Jini relevantë në atë që flisni.
4. Maksima e mënyrës. Jini të qartë në atë që pohoni.

Gjatë bashkëveprimit verbal, ligjëruesit përballen me situata të veçanta në të cilat i duhet të zgjedhë mes dy a më shumë kuptimeve që të arrijë te interpretimi më i saktë i mundshëm i mesazhit të dhënë. Në të tilla raste, Grice sugjeron që të ndërfiten edhe aftësitë inferenciale/arsyetuese të folësve.

¹⁶⁵ Ducrot, O., “Le dire et le dit”, Paris: Editions de Minuit, 1984, fq. 173-233.

¹⁶⁶ Po aty, fq. 182.

¹⁶⁷ Jacqueline Authier-Revuz, “Hétérogénéité montrée et hétérogénéité constitutive: éléments pour une approche de l'autre dans le discours”, Revue de Linguistique Paris, 1982, fq. 134.

¹⁶⁸ Grice, P. “Studies in the Way of Words”. Harvard University Press, 1989fq. 34.

¹⁶⁹ Ibid.

Por, sipas Stainton, kjo nuk do të thotë që ligjëruesit duhet që të dëgjojnë njëri-tjetrin pa e ndërprerë, pa e kundërshtuar e pa ndërhyrë në atë që po thuhet nga tjetri¹⁷⁰. Në të tilla raste, ligjëruesit përpiqen të interpretojnë, deduktojnë ose ngrenë inferenca/arsyetime apo implikatura bashkëbisedimore.

Te Levinson, në varësi të qëndrimit që mban folësi ndaj maksimave, implikaturat mund të kategorizohen në dy tipa. Kështu, ai mund të zgjedhë t`i respektojë ose mos zbatojë ato, por kjo nuk do të thotë ndërprerje apo deformim të bashkëbisedimit si proces¹⁷¹.

3. Zbatimi versus thyerja e maksimave të bashkëbisedimit të Grice në ligjërimin politik gjatë periudhës së diktaturës komuniste.

Në përgjithësi, gjatë periudhës së diktaturës komuniste, Enver Hoxha për të dhënë shembullin e më pas shumë të tjerë që e pasuan atë, nuk preferonin që të bënin intervista. Ato intervista të rralla që botoheshin, ose ishin frut i përpunimit të deklaratave në fillim dhe pastaj pyetjeve që ishin të caktuara për t`u përgjigjur, ose kalonin nëpërmjet filtrave të kujdesshëm, me qëllim kodifikimin dhe rikodifikimin e mesazheve që duhej të përcilleshin.

Megjithatë, *Maksimat e bashkëbisedimit* rëndom mund të konstatohen të pazbatuara apo thyera në intervistat e pakta në numër të fillimit të vendosjes së diktaturës ose gjatë botimeve dhe bashkëbisedimeve mes Enver Hoxhës, si “lideri e ligjëruesi suprem” dhe njerëzve të thjeshtë të cilët mund të ishin anëtarë Partie, profesionistë si: inxhinierë, ekonomistë, gra madje dhe pionierë të vegjël.

Në intervistën dhënë për gazetën *Bashkimi* më 18 maj 1946, ku në fokus ishte aksioni i rinisë në rrugën Peshkopi – Bicaj, edhe pse në fillimet e veta duket haptazi mënyra kapilare e kontrollimit apo kodifikimit të mesazhit. Pyetjet më tepër bazoheshin tek rëndësia që do të kishte për pushtetin kjo veprimtari sesa në të dhëna reale statistikore dhe /ose të lidhura me synimin e vërtetë të shfrytëzimit të krahut të lirë të punës, i cili, ose në mënyrë “vullnetare” ose në formën e ndëshkimit përbënte bazën reale të investimeve me kosto të ulët.

1. Pyetje: Ç`rëndësi ka për pushtetin aksioni që po ndërmerr rinia për ndreqjen e rrugës Peshkopi- Bicaj?

Përgjigje: Rruga që po ndërtojmë që nga Peshkopia në Bicaj ka një rëndësi shumë të madhe për pushtetin dhe për popullsinë e të gjitha krahinave rreth e rrotull ku ndërmerren këto punime.. Rruga është mjeti që çon përparimin, domethënë zhvillon ekonominë e vendit, e përmirëson këtë, përmirëson jetesën e popullit. Rruga është nga ana tjetër mjeti që ndihmon zhvillimin politik dhe kultural të atyre krahinave që do ta përdorin. Duke e ndjerë këtë nevojë të madhe dhe duke e çmuar rëndësinë e kësaj rruge, qeveria e Republikës sonë vendosi që punimet të fillojnë menjëherë...¹⁷²

1. Eliminimi i identitetit të gazetarit. Ardian Vehbiu te “Shqipja totalitare”, do t`a quante fenomenin si “shkërmoqja e autorit”.

2. Maksima e relevancës (përshtatshmërisë) respektohet. Megjithatë, në përgjigjen e dhënë evidentohet një rast specifik i thyerjes së maksimës së sasisë. Enver Hoxha, ligjëruesi në fjalë, gjatë përgjigjes së tij përpiqet të përforcojë lidhjen ideologjike mes pushtetit dhe popullit. Në këtë mënyrë, sasia e informacionit të përçaruar në përgjigje tejkalonte

¹⁷⁰ Barber, A., Stainton, J. R. “Philosophy of language and linguistics, Elseiver, Oxford, 2009, fq. 10.

¹⁷¹ Levinson, Stephen C. “Pragmatics” (Cambridge textbooks in linguistics), 1983, fq. 104.

¹⁷² Hoxha E. “Vepra 3” (Janar 1945-Dhjetor 1946), Naim Frashëri, Tiranë, 1969, fq. 352.

Materialet e punimeve (proceedings)

ISBN: 978-1-78911-007-4

kufijtë e çka duhej konsideruar si e nevojshme. Sqarimet dhe analizat që bëhen nga ligjëruesi shkojnë përtej pritshmërive, duke mbushur plot dy faqe.

2. Pyetje: Sekretarët e organizatave-bazë të Partisë ndjekin kurse apo shkolla? Organizoni seminare me ta dhe kur, e përse e keni bërë seminarin e fundit? Si i zhvilloni këto seminare, si diskutohet në to dhe çfarë gjërash interesante ngrënë sekretarët e organizatave-bazë?

Enver Hoxha: Dëshira e Partisë është që të gjithë anëtarët e saj të venë në shkolla, po kështu edhe masat e popullit, por një gjë e tillë nuk ka mundësi të bëhet për të gjithë, prandaj ne duhet t'i vëmë rëndësi punës që, duke i studiuar këta artikuj (artikujt e “Zërit të Popullit”), komunistët dhe masat të bëhen më të qartë politikisht dhe të përgatiten teorikisht.¹⁷³

Në pamje të parë, duket se përgjigjet janë relevante me pyetjen e bërë, pra maksima e relevancës/përkitshmërisë zbatohet pasi ligjëruesi përgjatë gjithë diskutimit ruan të njëjtën linjë logjike. Megjithatë, duke vështruar me një sy më të kujdesshëm, në pasazhe specifike të ligjërimit Hoxha ndërmerr të drejtën për t'iu përgjigjur pyetjes duke përmendur lloj-lloj formash që mund të shërbejnë për edukimin dhe formimin e masave, përveç asaj që është tema apo fjala çelës e pyetjes “seminaret”. Ndërkaq, maksima e vërtetësisë në kontekstin e përgjithshëm, në lidhje me të rolin dhe cilësitë që duhej të gëzonte sekretari i organizatës bazë, madje edhe epërsia e tij ndaj kryetarit të organizatës bazë, përmendur në të njëjtin akt ligjërimit, thyhet.

3. Pyetje e pjesëmarresve: Si ju duket puna që ka bërë gazeta «Pionieri- kundër paragjykimeve fetare?

Shoku Enver: Artikujt të tillë ka pasë. Paragjykimet duhen luftuar, por duhet të kemi parasysh një gjë: Të moshuarit i besojnë këto gjëra. Nga ata influencohen edhe kalamanët. Ato janë në kundërshtim me shkencën. Të punojmë, por me sistem e takt, pa u grindur sa dhe jeta në familje të bëhet e padurueshme. Duhet që fëmijët të influencohen më shumë nga ne se sa nga pleqtë dhe t'ua hapin sytë këtyre. Të kaluarve nga mosha është zor t'u ndrohet mendja menjëherë. Artikujt mbi këto gjëra duhen shkruar me shumë kujdes¹⁷⁴.

Duket sikur të vegjëlit po kërkonin të merrnin miratimin jo politik, por emocional për punën e tyre dhe atë që do të zhvillohej në të ardhmen. Për këtë arsye, edhe përgjigja ruan njëfarë ekuilibri në respektimin e maksimave, madje në këtë pasazh të gjitha maksimat respektohen. Madje, për arsye stilistike, në mënyrë të pandërgjegjshme (si pjesë e të folmes së tij) ai përdor edhe terma si “kalamanët”. Në këtë akt ligjërimit, gjithashtu ligjëruesi respekton maksimën e mënyrës duke dhënë edhe këshilla për shmangien e konflikteve të mundshme që mund të burojnë nga artikujt për fëmijët dhe të kaluarit nga mosha.

4. Zbatimi versus thyerja e maksimave të bashkëbisedimit të Grice në ligjërimit politik pas viteve '90.

1. i24news: Si po e përballon Shqipëria situatën e emigracionit që ka prekur Evropën gjatë këtij vit?

Kryeministri Edi Rama: Ne nuk jemi të prekur, sepse nuk jemi pjesë e korridorit që shtrihet nga Turqia në Greqi, Maqedoni, Serbi dhe deri në veri të Evropës, por jemi të përgatitur nëse do të përballëshim. Vendi ynë e di mirë se çdo të thotë të përballosh flukse emigratore të shkaktuara nga luftërat dhe konfliktet e përgjakshme, sepse ne kemi strehuar

¹⁷³ Hoxha E. “Vepra 27”, (Qershor 1964 - Tetor 1964), 8 Nëntori, 1978, fq. 37 - 44.

¹⁷⁴ Hoxha E. Vepra, Vëllimi 4, (Janar 1947 - Dhjetor 1948), Naim Frashëri, 1970, fq. 2-3.

gjysmë milionë refugjatë nga Kosova, gjatë periudhës së spastrimit etnik të diktatorit të atëhershëm në Beograd. Ndaj, jemi të gatshëm të ndihmojmë dhe angazhohemi për të qenë solidarë siç e do tradita jonë më e mirë.¹⁷⁵

Kryeministri Edi Rama: Ne nuk do të hapim kufirin, s’kemi arsye ta bëjmë këtë gjë, sepse nuk kemi as kushtet, as fuqinë dhe as delirin që mund të shpëtojmë botën. (Intervistë e Kryeministrit të Shqipërisë për emisionin Top Story. 2020)

Folësi, në pohimet e mësipërme, shkel dukshëm maksimumin e cilësisë duke deklaruar një pohim të kundërt me një të mëpasshëm. Që në rastin e deklaratës së parë, folësi ishte në dijeni për kapacitetet dhe aftësitë e duhura për t’ju përgjigjur një situatë emergjence. Një pohim i tillë hidhet poshtë në një distancë shumë të afërt kohore, periudhë në të cilën kapacitete pritëse të Shqipërisë nuk kishin sesi të ndryshonin në mënyrë kaq drastike.

Kryeministri deklaroi në rastin e dytë se Shqipëria nuk ka as mundësinë, as kapacitetet dhe as synimin për ta bërë një gjë të tillë. Në kontekste të ndryshme (i pari në një intervistë nënjë stacion televiziv në Izrael, ndërsa i dyti në një stacion televiziv në Shqipëri) janë përdorur nga folësi, dy pohime të ndryshme, madje në kundërshti me njëri-tjetrin.

Një mënyrë tjetër e shpërfilljes së maksimumit të cilësisë është kur folësi e realizon atë në mënyrë të ndërgjegjshme dhe sipas nevojave të tij, duke përdorur metaforën apo ironinë¹⁷⁶.

2. Arsen Hoxha: A nuk do të kishte qenë më mirë që ju të kishit qenë pjesë e këtij komisioni? (Komisioni hetimor A.D)

Ish-kryeministri Berisha: Jo, ishte anti-kushtetues. Pse? ...

Gazetari: Qeveria iu përgjigj një akuze të bërë në parlament nga ish ministri i mbrojtjes...

Sali Berisha: ...Nuk pranoi qeveria hetimin tonë se do të dilte që TIMS-in, të cilin nuk e kalon as Presidenti pa u regjistruar, Riformato e kaloi nga njerëzit e z. Rama. Do të dilte se, z. Rama me zonzjën Balluku po bëjnë gjithçka për të marrë VIP-in në funksion të trafikut, për ta transferuar nga Ministria e Jashtme, e cila nuk mund ta përdorë për trafik, nuk mund ta them këtë, por për ta kaluar në Autoritetin e zonzjës Balluku, e ndrikullës.¹⁷⁷

Përgjatë këtyre pyetje-përgjigjeve të njëpasnjëshme në intervistën e cituar, ligjëruesi Sali Berisha thyen maksimumin e sasisë (është disi tipike e këtij personazhi politik), duke dhënë informacione, të cilat jo domosdoshmërisht lidhen me pyetjen, dhe për më tej, si në shumë raste të ligjërimit politik cenohet edhe maksima e relevancës. Qëllimisht, Berisha e lidh diskutimin me një emër specifik duke tentuar që të krijojë në subkoshiençë një lidhje midis mungesës së transparencës dhe moszbatimit të ligjit në një grup individësh realë ose të hamendësuar, me ndikimin e drejtpërdrejtë të “kastës” drejtuese të vendit në momentin e dhënë.

Në këtë rast, Sali Berisha përdor epitetin “ndrikull” për t’iu referuar drejtoreshës së Albcontrol-it në atë kohë, duke aluduar se ajo po shërbente si dëshmitare e “martesës” së propaganduar mes trafikantëve dhe qeverisë. Në këto kushte, maksima e mënyrës thyhet qëllimisht nga ligjëruesi për të nxitur një formë alternative të komunikimit bazuar tek “fshehja

¹⁷⁵Intervistë e Kryeministrit të Shqipërisë gjatë vizitës së tij në Izrael për i24news. <http://www.kryeministria.al/al/newsroom/lajme/izraeli-miqesi-e-vjeter-dhe-perspektiva-te-reja-bashkepuniimi&page=11>

¹⁷⁶ Levinson, Stephen C. "Pragmatics", (Cambridge textbooks in linguistics), 1983, fq.109.

¹⁷⁷Intervista e plotë e ish-kryeministrit Sali Berisha në emisionin “30 MINUTA” tek <http://vizionplus.al/intervista-e-plote-e-ish-kryeministrit-sali-berisha-ne-emisionin-30-minuta/>.

Materialet e punimeve (proceedings)

ISBN: 978-1-78911-007-4

e mesazhit” nëpërmjet koncepteve dhe aluzioneve pavarësisht nga fakti që mesazhi mund të mos dekriptohet nga audienca në mënyrën dhe në formën e dëshiruar nga ana e ligjëruesit.

Konkluzione

Si përfundime të këtij punimi, përveç rolit dhe rëndësisë që mbart ngërthimi kuptimor si mjet pragmatiko-ligjërimor, rasteve të zbatimit dhe moszbatimit të maksimave të bashkëbisedimit në copëza të ndryshme ligjërimore, u evidentuan edhe dallime mes mënyrave dhe formave të ndryshme të komunikimit dhe ligjërimit politik që i përkasin dy periudhave krejtësisht të ndryshme kohore, politike e sociale: asaj të diktaturës komuniste dhe asaj të pluralizmit politik në Shqipëri.

Nëse do të bëjmë dallimin mes bashkëbisedimit si proces në ligjërimit politik gjatë diktaturës komuniste dhe atij në ditët e sotme, do të konstatojmë se gjatë periudhës së parë, edhe pse ligjërimi ishte i mbyllur brenda disa kufijve të pacenueshëm, ai përsëri mbetet një komunikim që fshihet pas anonimatit. Kështu, edhe në rast se bëhej fjalë për ndonjë intervistë të rrallë, pyetjet e drejtuara nuk ishin të formuluar nga gazetari. Ai ishte thjesht përcuesi i një pyetje të formësuar më parë në redaksi, nën kontrollin e rreptë të organeve të censurës. Edhe pas realizimit të bisedës ose intervistës, kjo e fundit do të kalonte në nivele të tjera redaktimi dhe censure. Në këto kushte, mund të analizojmë se komunikimi mes ligjëruesve dhe audiencës nuk ishte i sinqertë, por ishte produkt i një përpjekjeje për të qenë politikisht dhe ideologjikisht korrekte.

Gjatë periudhës pas viteve `90, ekziston auto-censura. Është vetë ligjëruesi që tenton të japë përgjigje politikisht korrekte, pa u ndikuar nga institucione të veçanta të censurës. Në rast se në ligjërimit politik të diktaturës komuniste, moszbatimi i maksimave të Grice konstatohet vetëm atëherë kur humbet koherenca ose kur ligjëruesi tenton të japë mesazhe sa më të gjera, përtej tematikës reale të bisedës; situatë tjetër ndodh në ligjërimit politik pas viteve `90 kur moszbatimi i këtyre maksimave ndodh si pasojë e përgjigjeve të aty për atyshme, reagimit të menjëhershëm, ndonjëherë edhe emocional, por edhe si pasojë e matjes së impulsit të audiencës së paku vizualisht.

Bibliografia

Tekste

- Bakhtine M. (1929) cituar te Plangarica T. “Analiza e gjuhës dhe diskursit”, Cikël ligjëratash, Infobot, Elbasan, 2014.
- Barber, A., Stainton, J. R. “Philosophy of language and linguistics, Elseiver, Oxford, 2009.
- Ducrot, O., “Le dire et le dit”, Paris: Editions de Minuit, 1984.
- Grice, P. “Studies in the Way of Words”. Harvard University Press.
- Hoxha E. “Vepra 3” (Janar 1945-Dhjetor 1946), Naim Frashëri, Tiranë, 1969.
- Hoxha E. “Vepra”, Vëllimi 4, (Janar 1947 - Dhjetor 1948), Naim Frashëri, 1970.
- Hoxha E. “Vepra 27”, (Qershor 1964 - Tetor 1964), 8 Nëntori, 1978.
- Levinson, Stephen C. "Pragmatics “(Cambridge textbooks in linguistics), 1983.
- Todorov T. “Introduction to Poetics” (Theory and history of literature), University of Minnesota Press, First edition, 1981.

Websit-e

- Intervista e plotë e ish-kryeministrit Sali Berisha në emisionin “30 MINUTA” tek <http://vizionplus.al/intervista-e-plote-e-ish-kryeministrit-sali-berisha-ne-emisionin-30-minuta/>.
- Intervistë e Kryeministrit të Shqipërisë gjatë vizitës së tij në Izrael për i24news. <http://www.kryeministria.al/al/newsroom/lajme/izraeli-miqesi-e-vjeter-dhe-perspektiva-te-reja-bashkepunimi&page=11>

Komunikimi dhe të shprehurit kompetencë gjuhësore

DR. FEIME LLAPASHTICA LIPSCOMB
Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Prishtinë

Abstrakt

Trajtimi i kompetencë gjuhësore komunikimi dhe të shprehurit është qëllimi i këtij punimi. Gjuha është lëndë më e rëndësishme e të mësuarit. Ajo në shkollë mësohet si lëndë e veçantë, nëpërmjet të së cilës zhvillohet identiteti i nxënësve dhe është objektiv i të kuptuarit të secilës lëndë. Mësimi i gjuhës bazuar në kompetencë është sfidë me të cilën sot ballafaqohen mësimdhënësit. Koncepti kompetencë është një ndër sfidat me të vështira me të cilën sot mësimdhënësit ballafaqohen në klasë, prandaj trajtimi i kësaj teme në këtë punim ka rëndësi të veçantë si për mësimdhënësin ashtu edhe për nxënësin. Me qëllim që nxënësit dhe të rinjtë të zhvillohen si personalitete, të mësojnë dhe të marrin pjesë aktive në shoqëri, është me rëndësi që t’i kuptojnë porositë që u drejtohen dhe të shprehen në mënyrë të qartë nëpërmjet gjuhëve, simboleve, shenjave, kodeve dhe formave artistike. Që kompetencat gjuhësore të zhvillohen e të arrihen nxënësit duhet nxiten dhe udhëzohen që të përqendrohen më shumë në atë se Si të mësojmë dhe jo Çka të mësojmë, e cila mundëson një vlerësim më të saktë të aftësive gjuhësore të tyre sesa në interpretimin e një informacionit të ri.

Ky punim për komunikimin dhe të shprehurit si kompetencë gjuhësore, do t’u ofrojë mësimdhënëseve përvoja të reja për ta kuptuar drejtë këtë koncept, duke ju dhënë idenë që nxënësit duhet të përqendrohen më shumë në pjesën "e bërë" të mësimin, e cila mundëson një matje më të saktë të aftësive dhe shkathtësive gjuhësore të tyre. Në fund do të nxjerrim disa konkluzione, të cilat ndihmojnë mësimdhënësit t’i tejkalojnë vështirësitë e mësimin të gjuhës bazuar në kompetenca.

Fjalë kyçe: Kurrikulë, gjuhë, komunikim, kompetencë, performacë,

“Më të mirën gjë që njohu e kuptoi njeriu në jetë është të mësuarit”

(Naim Veqilharxhi)

Komunikimi dhe të shprehurit është kompetencë gjuhësore e cila pritet të arrihet nga nxënësit në të gjitha shkathtësitë gjuhësore: si në të folur, në të shkruar dhe në të lexuar. Gjuha shqipe është lëndë e veçantë, sepse kjo duhet të jetë objektiv i mësimin në secilën lëndë mësimore.

Në Kurrikulën e re komunikimi dhe të shprehurit është një ndër kompetencat kryesore e cila rrjedh nga qëllimet e përgjithshme të arsimit parauniversitar dhe përcakton rezultatet kryesore të të nxënit, të cilat nxënësit duhet t’i arrijnë në mënyrë progresive dhe të qëndrueshme gjatë sistemit të arsimit parauniversitar.¹⁷⁸ Koncepti kompetencë është një ndër sfidat me të vështira me të cilën sot mësimdhënësit ballafaqohen në klasë, prandaj trajtimi i kësaj kompetence e gjuhësore në këtë punim ka rëndësi të veçantë si për mësimdhënësin ashtu edhe për nxënësin. Me qëllim që fëmijët dhe të rinjtë/të rejat të zhvillohen si personalitete, të mësojnë dhe të marrin pjesë aktive në shoqëri, është me rëndësi që t’i kuptojnë porositë që u drejtohen dhe të shprehen në mënyrë adekuate nëpërmjet gjuhëve, simboleve, shenjave, kodeve dhe formave artistike. Për të komunikuar në mënyrë efektive, nxënësi përkraket që të shfrytëzojë në mënyrë të pavarur, kritike dhe kreative/krijuese mjetet dhe mundësitë e komunikimit dhe të shprehurit¹⁷⁹. Mësimdhënësit duhet të përgatiten për t’i ndihmuar

¹⁷⁸ Shih, Korrniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës, f.13

¹⁷⁹ Po aty, f.15.

Materialet e punimeve (proceedings)**ISBN: 978-1-78911-007-4**

nxënësit që më lehtë ta zhvillojnë dhe arrijnë këtë kompetencë. Nxënësit duhet të aftësohen që gjuhën ta përdorin në një mënyrë anë për një komunikim sa më efektiv dhe në anë tjetër, gjuhën duhet ta mësojnë për të shprehur identitetin dhe vlera kulturore. Gjuha është mjet që shërben për të formësuar mendimet dhe për komunikuar, ajo ka sistem, strukturë të organizuar dhe rregulla për çdo mënyrë të komunikimit. Sipas Kurrikulës gjuha duhet mësuar e integruar nëpërmjet letërsisë. Organizimi gjuhësor për të folur dhe në një tekst të shkruar letrar është i domosdoshëm, në mënyrë që mesazhi të kuptohet nga të gjithë. Nëpërmjet gjuhës shprehen; ndjenjat, kultura, krijimet artistike gjuhësore dhe stilistike. Aspekti gjuhësor dhe stilistik i një tekst letrar, duhet të kuptohet nga lexuesi se ka dy funksione, një ku nëpërmjet gjuhës ndërtohen mendimet të cilat barten në formën e shkruar tek lexuesi, ndërsa funksioni tjetër është bartja e mendimit të tjerët e që është thënia e shkruar e cila quhet tekst. Komunikimi dhe të shprehurit është kompetencë, të cilën mësimdhënësit duhet të synojnë që ta zhvillojnë dhe arrijnë në klasë, me metoda, forma dhe teknika më efektive dhe kreative të mësimdhënies dhe mësim nxënies. Kjo kompetencë arrihet nëse nxënësit nxiten dhe udhëzohen të përqendrohen më shumë në pjesën “e bërë” të mësimi, pra në atë se si të mësojmë dhe jo çka të mësojmë, e cila mundëson një vlerësim më të saktë të aftësive gjuhësore të tyre sesa në interpretimin e një informacionit të ri. Gjatë mësimdhënies si sfidë dhe problem është mos përgatitja dhe aftësimi i mësimdhënësve për t’i përcjellë dhe vlerësuar me kompetencë profesionale aftësitë e nxënësve për arritjen e rezultateve së kurrikulës. Mësimdhënia është një proces i organizuar, i cili mund të realizohet në forma dhe metoda të ndryshme, pra varësisht sesi organizohet mësimi i gjuhës përcaktohet edhe pritshmëria. Sipas disa rezultate të nxjerra nga raportet e monitorimit të mësimdhënies së gjuhës në disa klasë kemi konstatuar se mësimdhënësit ende nuk i japin rëndësinë e duhur zhvillimit të kompetencave gjuhësore, por zbatojnë metodën tradicionale jep dhe merre informacion apo përkufizim.

Në fakultet edhe sot si në të kaluarën përgatitja dhe aftësimi i mësimdhënësit bëhet vetëm për t’iu përgjigjur lëndës dhe klasës ku jep mësim, për të bartur te nxënësit informatën e re. Një praktikë e tillë e përgatitjes së mësimdhënësit nuk përmbush interesin e nxënësit dhe të nxënësve të tij. Sot duhet ta vëmë mësimdhënien në funksion të të nxënësve, pra jemi në kohën kur duhet të bëhet më shumë për zhvillimin e kompetencave gjuhësore.

Rezultatet e kurrikulës dhe kompetencat gjuhësore arrihen më lehtë, kur mësimdhënësi përdor strategji, forma, teknika, metoda ndërvepruese, programe individuale etj., që të lehtësojnë procesin e të nxënësve të të gjithë nxënësve. Përmbushja e interesave dhe e nevojave të nxënësve përbën një nga vështirësitë themelore të mësimdhënies, kjo ka të bëjë me aftësinë e mësimdhënësit se si e planifikon mësimin, zgjedh metodat që përshtaten interesave të nxënësve dhe gjendjes reale të klasës.

Zhvillime profesionale nga Institucionet shtetërore dhe shumë OJQ-që vendore e ndërkombëtare nëpërmjet trajnimeve, seminareve kualifikuese, punëtori, kanë ofruar literaturë bashkëkohore, përvoja dhe alternativa të mësimdhënies dhe të nxënësve për mësimdhënësit. Në kë trajnime mësimdhënësi ka marrë përvojë dhe përkrahje se ai vetë mund ta përdorë lirinë profesionale për planifikim të procesit mësimor, të zgjedhë atë që i pëlqen, atë që i duket më e përshtatshme, atë që mund ta realizojë më lehtë në kushtet e shkollës e të klasës ku jep mësim, por duhet ta dimë se planifikimi i mësimit është mjeshtëri e së secilit mësimdhënësit.

Suksesi i një ore mësimore është i kushtëzuara nga zgjedhja dhe zbatimi i një metode sa më të efektshme, i një metode që ka parasysh vëllimin e informacionit të ri, kushtet reale të klasës dhe formimin gjuhësor të çdo nxënësi. Komunikimi i ndërsjellët është një metodë që mund të praktikohet në secilën pjesë të orës, në fillim të orës, gjatë paraqitjes së njohurive të

reja, gjatë praktikës së drejtuar nga mësime të mësuara, gjatë punës në grup, gjatë përpunimit të informacionit, gjatë kontrollit të praktikës së pavarur etj. Përvojat vetjake të nxënësve duhet të merren parasysh nga mësime të mësuara gjithmonë për koncepte të reja që trajtohen në orën e mësimit. Për të pasur efektivitet në komunikim dhe të shprehur, mësime të mësuara i nxit nxënësit që sa më shumë të komunikojnë, të bëjnë pyetje dhe japin mendime kritike e argumentuese gjuhësore, të lexojnë e të nënvizojnë për të veçuar, për të analizuar, për të krahasuar një tekst me përvojat vetjake, ndërveprimi i tillë me nxënës rrit vlerat e komunikimit të mësuara-nxënës dhe nxënës-nxënës, ngritë nivelin e komunikimit për informacionet që trajtohen, gjejnë e japin argumente për të mbrojtur secili idetë e veta. Kjo metode nuk përjashton përdorimin e formave të mësimit në grup, e cila është shumë e efektshme për përfundimin e njohurive nga nxënësit, kjo formë e të nxënës nxjerrë mësime të mësuara nga forma tradicionale, i cili dikur ishte në qendër të vëmendjes, kjo formë e mësimit është më atraktive dhe çlodhëse. Në grup, nxënësi punon më i lirë, ai e sheh veten më të pavarur e të barabartë me të tjerët, harron se aftësitë e tij i “vëzhgon” mësime të mësuara, nxitet, vihet në rend me të tjerët për të qenë “pjesëmarrës” i të bërit që do të dalë nga idetë e tij.

Tekstet shkollor ndikojnë shumë në zhvillimin kompetencave gjuhësore. Të lexuari është kompetencë gjuhësore e cila duhet të zhvillohet sipas qasjes “Të lexojmë për të mësuar.”

Komunikimi është aftësi për të transmetuar informatën duke përdorur gjuhën në mënyrën të drejtë drejtë. “Trajtimi i gjuhës si mjet komunikimi është një tendencë në gjuhë, ndërsa pedagogjia e kundërshton mësimin e gjuhës nëpërmjet gramatikës. Sipas Morrow (1977) dhe Widdowson (1978), komunikimi është një ndërveprim shoqëror, i paparashikueshëm dhe krijues në formë, në të cilin dy ose më shumë persona e përdorin gjuhën drejtë për t’u kuptuar. Komunikimi zhvillohet në ligjërime dhe kontekstet sociologjike në të cilat folësit përdorin gjuhën e përshtatshme dhe janë në gjendje të interpretojë mesazhin. Canale dhe Swain (1980) kanë thënë “Komunikimi është një proces krijimi që ndryshon vazhdimisht të kuptuarit, shkëmbimin dhe negocimin e kuptimit.”

Për ta për të vlerësuar performancën komunikuese, duhet të bëhet dallimi ndërmjet kompetencës së komunikimit dhe komunikimit të momentit. Duhet theksuar se komunikimi i momentit ka dy përbërës, përkatësisht njohuritë dhe aftësitë, të cilat përfaqësojnë shfaqjen e mendimeve në një situatë konkrete. “Hymes (1972) thekson, se kompetenca e komunikimit mund të përkufizohet si zotërimi i “Modeleve të sjelljes sociolinguistike të gjuhës së synuar”. Këto modele quhen nga Hymes rregullat e të folurit dhe ato i referohen sjelljes së të folurit.

Qëllimi kryesor i të mësuarit të gjuhës, është të komunikosh në mënyrë efektive. Përdorimi i sistemeve leksikore dhe gramatikore gjatë komunikimit është thelbësore për nxënësit, të cilët duhet të dinë se si t’i shfaqin në një raport me një folës të caktuar. Gjithashtu është, e nevojshëm që nxënësit të përdorin njohuri gjuhësore si fonologjike, leksikore, sintaksore në përvojën e përditshme dhe të njohë modelet e ndërveprimit. Ka rregullat të ndryshme për të folurit-komunikim, që si nxënësit duhet të dinë në mënyrë që të dërgojnë, interpretojnë dhe përgjigjen siç duhet për një mesazh të dhënë apo të marrë.

Sipas Canale dhe Swain (1980) “Kompetenca e komunikimit përbëhet nga katër kompetenca si : kompetenca gramatikore, kompetencë, sociolinguistike, kompetencë ligjërime dhe kompetenca strategjike. Kompetenca gramatikore është zotërimi i kodit të gjuhës. Që do të thotë se folësit njohin, përdorin dhe respektojnë rregullat e gjuhës, ku përfshijnë fjalorin, fjalën dhe formimin e fjalive, shqiptimi, drejtshkrimi dhe semantikën gjuhësore. Kompetenca e komunikimit është njohuria, shkathtësia qëndrimi dhe vlera se si të shprehin dhe kuptohen folësit në mënyrën e duhur”.

“Kompetenca sociolinguistike përfshin rregullat sociokulturore të përdorimit të gjuhës që në thelb do të thotë se folësi është në gjendje të krijoj dhe të kuptojë thënie në kontekste të ndryshme. Çdo ndërveprim ka rregullat e veta, qëllimi dhe roli i folësit është të përcjellë kuptimin në një formë të përshtatshme për një kontekst të caktuar. Ka një tendencë që mësimi i gjuhës t’i shmanget zhvillimit të kompetencës sociolinguistike. Kjo ide është e gabuar sepse çon në situatë në të cilën nxënësit nuk janë në gjendje të komunikojnë siç duhet në varësi të kontekstit”.

Kompetenca e ligjërimit i referohet përdorimit të gjuhës së folur apo ndonjë varianti gjuhësor

në një situatë të caktuar, pra është aftësia e folësit për të kombinuar format gramatikore dhe kuptimin për të arritur një tekst të unifikuar të folur apo të shkruar në një zhanër të veçantë. Uniteti i tekstit varet nga në forma e thënies që duhet të jenë të lidhura në mënyrë strukturore, që teksti të jetë sa më i lehtë për t’u kuptuar.

Kompetenca strategjike, është ajo, të cilën nxënësit duhet ta përdorin nëse ndodh një ndërprerje gjatë komunikimit, nëse folësi nuk ka aftësi të mjaftueshme komunikuese. Kompetenca strategjike përdoret nga folësi edhe kur dëshiron të rrisë efektin e komunikimit ose të zgjidh probleme sociolinguistike. Nxënësit duhet të inkurajohen dhe t’u jepet mundësia për të përdorur strategji të ndryshme në komunikim si strategjia e komunikimit verbal e cila bëhet përmes komunikimit me gojë ose me shkrim, strategjia e komunikimit jo verbal e përbëhet nga shprehjet e fytyrës, toni i zërit ose gjuha e trupit.

Strategjia e komunikimi është një organizim, i cili përshkruan se si një individ do të komunikojë me audiencën e tij të synuar. Ajo përfshin një sërë qëllimesh dhe objektivash, mesazhe kryesore, forma dhe metoda për të matur suksesin e përpjekjeve të komunikimit. Një strategji komunikimi shërben për të ndihmuar folësit që t’i arrijë qëllimet e tij të komunikimit, qoftë për të informuar, edukuar, bindur ose angazhuar audiencën e saj të synuar. Mund të përdoret për qëllime të ndryshme, të tilla si promovimi i një produkti ose shërbimi të ri, ndërtimi i vetëdijes për rreziqet globale, administrimin e një krize ose ndikimi në opinionin publik për gjëra me rëndësi. “Strategjitë efektive të komunikimit janë të përshtatura për nevojat dhe preferencat specifike të audiencës së synuar dhe marrin parasysh kontekstin më të gjerë social, kulturor dhe politik në të cilin ato veprojnë. Ato mbështeten në forma të ndryshme komunikimi, si media sociale, email, media tradicionale, ngjarje dhe reklama, për të arritur audiencën e synuar.”

Si mund ta dimë që nxënësit janë kompetentë në gjuhë?

Një mënyrë për të gjykuar këtë kompetencë bëhet nëpërmjet vlerësimit të performancës së nxënësve. Performanca është një masë e saktë për ta vlerësuar se çka është në gjendje nxënësi të bëjë, kjo është edhe kërkesë e Kurrikulës së re në mënyrë që nxënësi të demonstroj shkathtësi në zgjidhjen e një problemi gjuhësor.

Kompetenca dhe performance

Chomsky e ndan kompetencën dhe performancën, ai e përshkruan “Kompetencën si një kapacitet të idealizuar që gjendet si një pronë ose funksion psikologjik ose mendor dhe performancën si prodhimi i fjalëve të vërteta. Shkurtimeisht, kompetenca përfshin “njohjen” e gjuhës dhe performanca përfshin “të bërit” diçka me gjuhën. Vështirësia paraqitet në atë se si të vlerësohet kompetenca pa vlerësuar performancën e nxënësve. Duke vënë në dukje dallimin në mes të kompetencës dhe performancës shohim dobinë duke i lejuar nxënësit që mësojnë gjuhën për të dalluar një gabim në të folur apo të shkruar. Për të kuptuar këtë dallim, është

mirë të mendojmë një kohë kur ne kemi “bërë me një varg gabimesh” gjatë të lexuarit të asaj që kemi shkruar.

Më poshtë po japim një shembull:

Një shprehje e paraqitur gjuhësisht jo drejt si: Këtë fundjavë Ne notuar në det.

Nëse pyesim a është ky gabim për shkak të kompetencës apo performancës? Jemi të vetëdijshëm se një nxënës në gjuhën shqipe do të duhej të dinte të përdorte drejtë kohën e shkruar të foljes notoj, kjo do të duhej matur nëpërmjet performancës së nxënësit.

Mësimdhënësit e gjuhës duhet ta dinë dallimin në mes të kompetencës dhe performances, për të ilustruar dallimin intuitiv që karakterizohet nga intuita ”Që është i aftë për ta vërejtur e për të njohur diçka në bazë të përvojës e të dijeve të fituara më parë “ mes rastit duke thënë ne notuar dhe faktin që një nxënës nuk ka i aftësitë e përdorimit të drejtë foljes notoj në vetën e tretë shumë të kohës së shkruar kemi notuar si në shembullin: Këtë fundjavë Ne kemi notuar në det.

Si funksionojnë kompetencat dhe performancat në programin e gjuhës?

Thamë se “kompetenca dhe performanca përfshijnë “njohjen” dhe “bërjen”. Në të kaluarën e afërt, shumë programe të mësimin të gjuhës dhe letërsisë janë përqendruar më shumë në pjesën e “njohjes” (kompetencës) së mësimin të gjuhës, ku fjalët dhe fjalitë janë paraqitur dhe praktikuar në një mënyrë që t’i ndihmojë më së miri nxënësit të përvetësojnë format. Krejt ajo çka nxënësit kanë mësuar është informacioni, të cilin ata e kanë marrë nëpërmjet leximit, shkrimit, dëgjimit dhe të folurit. Vështirësia e kësaj qasje të programeve është se nxënësit nuk është në gjendje ta përdorin gjuhën në mënyrë të natyrshme, sepse gjuhën e kanë mësuar nëpërmjet “diturisë”, prandaj nxënësit kanë pasur dhe kanë vështirësi na atë si të “bëjnë” diçka me gjuhën. Në mënyrë që nxënësit të përqendrohen më shumë në pjesën “e bërë” të mësimin, e cila lejon një matje më të saktë të aftësisë gjuhësore, mund të përdoret një qasje më komunikuese në mësimdhënie, kjo qasje përqendrohet në marrjen e nxënësve për të bërë gjëra me gjuhën, duke i inkurajuar ata që të “Mësojnë përmes gjuhës.” Nga e gjithë ajo që u thamë lartë kemi nxjerrë disa konkluzione, të cilat do të jenë sugjerime për mësimdhënësit se si t’i tejkalojnë vështirësitë dhe ta përmirësojnë mësimdhënien dhe të nxënit e gjuhës.

KONKLUZIONE

- Përgatitjen e vazhdueshme profesionale e mësimdhënësve për mësimdhënie dhe të nxënë bazuar në ndryshimet e kurrikulës.
- Zhvillimi profesional i mësimdhënësve dhe tendencat për kalimin nga mësimi tradicional në mësimin bashkëkohor.
- Të kuptuarit e procesit të mësimdhënies si nxitje për koncepte dhe praktika të reja, më të përparura e më efektive.
- Të kuptuarit e rëndësisë së disa procedurave dhe veprimtarive të procesit mësimor si: planifikimi, metodologjia e mësimdhënies, të nxënit arritja e objektivave, si dhe përdorimi i materialeve dhe teksteve shkollore që ndikojnë në mënyrat si të mësohet e jo çka të mësohet.
- Përqendrimi në gjuhën e gramatizuar (në fonetikë, leksik morfologji e sintaksë,etj), nga mësuesi ku gjuha duhet të mësohet nëpërmjet letërsisë.
- Përdorimi i, teksteve ,i materialeve dhe mjeteve didaktike, i teknologjisë së informacionit e të komunikimit për mësimin e gjuhës dhe të letërsisë.

- Shfrytëzimi i botimeve didaktike e shkencore të cilët përmbajnë elemente të pedagogjisë dhe didaktikës .
- Shfrytëzimi i bibliotekave të shkollave, zhvillimi i materialeve didaktike, mediave dhe platformave elektronike.
- Kompetenca e komunikimit hap mendjen dhe ndërveprimet individuale në shoqëri .

Bibliografia:

- 1.Korniza e kurrikulit të Ri për – Arsimit parashkollor, fillor, i mesëm dhe i mesëm i lartë, Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë, Prishtinë, 2001.
 - 2.Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës (e rishikuar) Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë, Prishtinë, 2016.
 - 3.Kurrikula bërthamë I, II, III, të rishikuara, Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë, Prishtinë, 2016.
 - 4.Fullan, Majkëll, Forcat e Ndryshimit, depërtim në thellësitë e reformës arsimore, përkthyer nga Majlinda Nishku, Tiranë , Pegi 2002.
 - 5.Kërkime pedagogjike, përmbledhje punimesh, Instituti Pedagogjik i Kosovës, Prishtinë, 2014.
 - 6.Musai, Bardhyl, Metodologjia e mësimdhënies, Tiranë, 2003.
 - 7.Plani dhe programi mësimor për lëndën Gjuhë shqipe dhe letërsi kasat: 1-13, Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë, Prishtinë, 2003-2006.
 - 8.Planifikimi i mësimit dhe vlerësimit, udhëzues 6, Qendra për arsimin e Kosovës , Prishtinë, 2004.
 - 9.Qendra për Arsim Demokratik (CDE), Mësimdhënia dhe të nxënëet ndërveprues – Modele për zhvillimin e të menduarit kritik (Shkencat shoqërore, për klasat 6-12), Tiranë, 2005.
 - 10.Schader, Bazil Bazat dhe arsyet,Doracak ,botuar nga Qendra IPE,e shkollës së lartë Pedagogjike Curich.
 11. Ndreca, Mikel: Fjalor fjalësh e shprehjesh të huaja, Prishtinë,1985
- <https://www.youtube.com/watch?>
<https://www.youtube.com/watch?>
<https://www.youtube.com/watch?>
<https://www.youtube.com/watch?>
https://www.edu.gov.mb.ca/k12/cur/languages/asl/framework/language_competence.pdf

Kultura gjuhësore, vepra letrare, lexuesi

MIRELA SARACI

Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë

LAURETA KONOMI

Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë

ERMELINDA KASHAH

Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë

Abstrakt

Në këtë kumtesë do të përcillet mendimi sesi aftësitë gjuhësore janë një prej faktorëve më të rëndësishëm të cilët ndikojnë në transmetimin e mesazhit të një vepre letrare të lexuesit.

Letërsia si arti i fjalës ndërtohet dhe shprehet me fjalët {gjuhën} e cila e diferencon nga artet e tjera. Fjalët, fjalitë dhe lidhjet midis tyre, ndërtojnë jo vetëm strukturën gjuhësore por edhe realitetin e një vepre letrare dmth botën e brendshme të saj (personazhet, peisazhet, ndjenjat, idetë etj.) Raporti midis gjuhës dhe veprës letrare është një raport i ndërlikuar por edhe i pashmangshëm. Duke qenë se letërsia është një grumbull veprash, është e pamundur që në shyrtimin e saj të mos përfshihet gjuha. Pasuria gjuhësore, si tipar kryesor i veprës letrare përmban në vetvete fjalët dhe kuptimet e tyre, shprehjet dhe figurat e ndërtimit sintaksor, stilet dhe tipet e ligjërimit. Vepra letrare nuk është vetëm krijim artistik por edhe gjuhësor, prandaj nga aftësitë kreative të përdorimit të gjuhës artistike gjatë procesit krijues të secilit autor varet se sa e realizuar është një vepër letrare në aspektin artistik. Duke qenë se letërsia është arti më i popullarizuar dhe roli i saj është transmetimi ndërmjetësues midis njerzve mjete kryesor për ta realizuar këtë mision është gjuha.

Fjalët kyçe: *bestseller, letërsi, lexues, ligjërimit, gjuhë artistike*

Studimi dhe analiza e një vepre letrare nga ana gjuhësore nuk është i lehtë. Duke qenë se vetë gjuha është një sistem i ndërlikuar, por me mundësi të shumta shprehëse, kritika letrare dhe ajo gjuhësore, ka theksuar rëndësinë rolin dhe funksionin e gjuhës në veprat letrare si nga ana stilistike ashtu dhe ajo estetike.

Sa më komplekse të jetë struktura gjuhësore, aq më komplekse është edhe vepra letrare. Boshti kryesor që merret për analizë në një vepër letrare është struktura gjuhësore e saj, sepse çfarë është thënë atje është realizuar përmes gjuhës dhe me gjuhën. Struktura e brendshme, realiteti, përmbajtja, është realizuar me fjalë, togje fjalësh, fjalive dhe nëpërmjet të cilave në kuptojmë brendinë, përjetojmë realitetin e brendshëm të veprës, por edhe atë të shkrintarit.

Fjala është elementi kryesor që depërton thellë në shpirtin e lexuesit, prandaj aq sa shkrintari do të gjejë dhe do të përdorë mjeshtërisht mjete shprehëse gjuhësore, aq do të lidhet edhe lexuesi me veprën letrare.

Një vepër letrare është e ndërtuar me protagonistë, ngjarje, tablo, përshkrime psikologjike, ide, apo edhe vecori fizike të personazheve, caste dhimbjeje, lumturie etj. Realizimi i kësaj strukture letrare duhet vlerësuar edhe nga aspekti gjuhësor sepse kështu do të mund të kuptojmë sa e realizuar është kjo vepër, sa e kuptueshme dhe sa tërheqëse, sa e tipizuar sa e individualizuar dhe sa e shton kërshtërinë të lexuesit.

Si art i fjalës ajo i ndihmon individit në pasurimin e mjeteve gjuhësore si në rrafshin leksikor ashtu edhe në rrafshin semantik e sintaksor. Skema e komunikimit autor-vepër-lexues ka qenë vepruese në nivele të ndryshme në kohë të ndryshme.

Dikur letërsia ka qenë një ndër ndikuesit kryesor në formimin kulturor, psikologjik, ideologjik dhe gjuhësor të individëve në një shoqëri duke qenë se ofronte së bashku dijen, informacionin dhe pasurimin e imagjinatës dhe shijen estetike e artistike.

Në ditët e sotme për arsye të ndryshme që lidhen me zhvillimin e teknologjisë digjitale dhe përhapjes së informacionit në rrugë të ndryshme, veprat letrare shkojnë më pak në duart e lexuesve dhe atëherë kur shkojnë, lënda që ato përcjellin sfidohet nga lënda që vjen prej burimeve të tjera si interneti, mediat sociale televizive, etj. Në kushte të tilla ai tekst sintetik dhe kompleks që vjen prej letërsisë pranohet me rrallë dhe atëherë kur pranohet dekodimi i tij mund të realizohet ose jo.

Letësia, përfaqësuar prej botuesve dhe autorëve që kanë ende ambicien të afirmohen dhe kontribuojnë me talentin e tyre janë gjendur përballë një sfide për të cilën kanë menduar edhe zgjidhjet.

Në këtë mënytë ne shohim të botohet dhe ribotohet më pak në llojin e romanit klasik realist apo edhe modern dhe të botohet më shumë në llojin e historive pjesërisht reale që kanë në bazë motivin e suksesit apo çelësit që të aftëson për realizimin e ambicieve dhe arritjeve, në vend të romaneve psikologjik hasim më tepër trajtesa të llojit psikologjik dhe sociologjik të gërshetuara me vëzhgime sjelljesh problematike, etj.

Në një kërkim mbi librat që kërkohen më shume nga lexuesi ne konstatojmë si librat më të shitur e rrjedhimisht edhe më të lexuarit tituj të tillë si “Sekreti”, Rhonda Byrne, “Katër marrëveshjet”, Don Miguel Ruiz, “Mbaron me ne”, Colleen Hoover, “Zonja e krimit”, Agathe Crist, “Të menduarit shpejt dhe të menduarit ngadalë”, Daniel Kahneman, “Forca e faktit” nga Hans Rosling, “Lehtësia e padurueshme e qenies”, Milan Kundera, “Të bëhesh” nga Michelle Obama,¹⁸⁰ “Zëra nga Çernobili” nga Svetlana Aleksieviç. “Baba i pasur, baba i varfwr”, Sharon Lehter, “Mendo dhe pasurohu”, Napoleon Hill.¹⁸¹

Ndërsa ndër autorët shqiptarë vecojmë Tom Kuka (Enkel Demi), Ben Blushi, Brunilda Zllami, Mira Meksi, Virion Graci, Flutura Acka, etj.

Sic vërehet autoret shqiptarë janë më të paktë në numër dhe ajo që është për t’u theksuar është mungesa e titujve të librave në poezi gjë që dëshmon se letërsia është e detyruar të kalojë nga rruga e fushave të tjera të dijes për të arritur te lexuesi dhe të përdorë edhe mjetet gjuhësore të ligjërimeve të tjera për të realizuar një komunikim më të pranuar me lexuesin. Nga këto prirje mund të dallojmë këto prirje të zhvillimit të letërsisë sot:

Së pari, llojet e mirëvillta letrare sidomos ato të prozës artistike po i humbasin vecoritë thelbësore tipologjike të përmbajtjes së tyre duke u formësuar si lloje të ndërmjetme që dalin si rezultat i gërshetimit të rrefimit letrar me analizën sociologjike dhe psikologjike (në rastin e titujve të tipit baba i pasur, baba i varfët, Si të bëhesh milioner, Arti i të bërit miq, arti i suksesit, etj); si lloj i ndërmjetëm midis publicistikës dhe prozës artistike (“Të jetosh në ishull”, “Shqipëria tjetër”, Ben Blushi, “Rrethimi”, “Flama” nga Tom Kuka); si lloj i ndërmjetëm midis letërsisë dhe reportazhit apo analizës dhe shkrimit eseistik, etj.¹⁸²

Një prirje tillë reflektohet edhe në gjuhën me të cilën ndërtohet teksti i ketyre librave e cila sic pritet është faktike, objektive dhe me prani të termave dhe fjalëve të huazuara nga gjuhët prej të cilave vijnë veprat e përkthyer. Sintaksa e këtij ligjërimi, në rastet kur

¹⁸⁰ “Të bëhesh” nga Michelle Obama, fq.76,80, botuar me 2018

¹⁸¹ “Kështjella” nga Ismail Kadare, fq.132,150 - Libri u botua për herë të parë në vitin 1970.

¹⁸² “Lulet e verës” nga Lasgush Poradeci, fq.68 - Ky vepër poetike u botua në vitin 1911.

Materialet e punimeve (proceedings)

ISBN: 978-1-78911-007-4

përkthimi realizohet jo në mënyrën e duhur profesionale, vjen edhe me skema jo tipike të sintaksës së gjuhës standarte shqipe. Po e ilustrujmë këtë me një shembull nga romani “Të jetosh ne ishull”:

“Je në shtëpinë e Zotit, i tha imami, si për t’i thënë mos u habit. A ha Zoti ullinj, qeshi ai duke u përpjekur ta ngrohte xhaminë me shaka. Imamit nuk i lëvizi asnjë muskul. Ullinjtë i ha unë. Doktorët thonë se bëjnë mirë për veshkat. Pse do të vish në Islam, e pyeti thatë imami, pa e lënë të vazhdonte udhëtimin e tij nëpër muret bosh të xhamisë. Aliu iu përgjigj se nuk kishte ndonjë shkak, por mendonte se Islami është një gjë që duhet provuar. Unë fitoj sa për t’u ushqyer, nisi të shpjegonte. Nuk kam ndonjë arsye të veçantë. Islami është feja e Perandorisë dhe unë e respektoj si një shtetas i rregullt. Nga Islami vijmë ligjet, taksat, ushtria dhe drejtësia. E këto nuk mund t’i zbatosh si duhet po nuk njohe burimin e tyre të vërtetë. Shpejt ose vonë, të gjithë do të bëhen myslimanë. Babai më ka thënë që punën e sotme mos e lër për nesër. Unë zgjohem herët në mëngjes, si kafshët që shes dhe shëroj, prandaj nuk e kam vështirë të falem në oraret që përcakton feja juaj. Njoh shumë të tjerë që do të ishin bërë myslimanë në qoftë se do të kishin regjimin e bagëtive. Sa vjeç je? Tridhjetë e nëntë i mbusha në korrik. Ka myslimanë të tjerë në fshatin tënd? Jo, tha ai, unë do të jem i pari. Njeh ndonjë mysliman tjetër? Kroi kokën dhe u kujtua. Njoh Ali Tepelenën.”¹⁸³

Së dyti, kjo lloj letërsie në mënyrë të padeklaruar nuk i njeh si funksion të parë vetes edukimin estetik, por zbulimin e një informacioni dhe servirjen e tij në formën më intriguese të mundshme. Në këtë mënyrë kanë gjetur hapësirë edhe subjekte me histori fetare të tipit Graaliil shenjte, Dan Braun, etj, të cilët karakterizohen nga thurja e subjekteve me një zinxhir ngjarjesh mistike

Së treti, lexuesi prirret të tërhiqet më tepër nga subjektet thriller të cilët përfshijnë sot shijet e lexuesve që nuk kanë përvojë të madhe leximi. Në njëfarë mënyre duket se subjektet thriller zëvendësojnë subjektet erotike dhe dramet psikologjike.

Në ngjarshmëri me skenarët e filmit thriller ata ndërtojnë subjekte me aventura kriminale dhe subjekte me element fantastiko shkencore. Këta lloj librash veprojnë mbi lexuesin përmes imazheve që nxisin emocionet e frikës, kureshtjes dhe dëshirës dhe jo aventurën intelektuale dhe estetike.

Së katërti, romani ka pësuar modifikimet e tij në formë dhe përmbajtje dhe kjo si pasojë e sfidës qëi vendos atij edhe kinematografia. Titujt që hasim më shpesh, si : Gjuetari i balonave, Princesha,.... lidhen me histori nga bota lindore e cila përbën një lloj misteri që lidhet me abuzimin , ndalimin, dhunën dhe aventurën për t’i shpëtuar përndjekjes së mjedisit dhe pushtetit të familjes.

Këto lloj subjektesh e përqëndrojnë vëmendjen te fabula interesante dhe realiteti i porsazbuluar më shumë se te ndërtimi estetik dhe artistik i subjektit dhe te gjuha me të cilën do të komunikojmë me lexuesin.¹⁸⁴

Lexuesi intrigohe nga një mënyrë jetese e panjohur e organizuar përmes rregullash estetike dhe fetare. Keto tekste ofrojnë informacion kulturor, sociologjik dhe historik i cili kryen funksion njohës dhe informues. Gjuha me të cilën realizohen këto tekste është koncize, lakonike dhe pa nentekst. Me poshtë po sjell një shembull nga romani “Sarah” I autorit Jean Sasson:

“Kishte rënë muzgu. Disku i zjarrtë i diellit po zhytej dalëngadalë në horizont. Për besimtarët myslimanë kishte ardhur koha për lutjen e katërt të ditës. E ulur në ballkonin e

¹⁸³ “Te jetosh ne ishull”, fq.120,136 botuar nga Ben Blushi me 2018.

¹⁸⁴ “Hijet e dritës” nga Migjeni (Millosh Gjergj Nikolla), fq.98 - Poezi e Migjenit u botua për herë të parë në shekullin e 20-të.

dhomës së gjumit, shihja tim shoq e tim bir tek largoheshin nga oborri i madh i pallatit tonë në drejtim të xhamisë. Me ta u bashkua edhe një grumbull tjetër burrash që u përshëndetën me njëri – tjetrin shumë përzemërsisht.

Nuk ia shqita sytë djalit tim që e doja si sytë e ballit, derisa pashë të futej në xhami bashkë me të atin, por pa mua. E të mendosh që ai ishte mish i mishit tim, gjaku i gjakut tim! Atë çast u ndjeva krijesa më e vetmuar e rruzullit tokësor.¹⁸⁵

Lindjet e meshkujve janë të dokumentuara në regjistrat familjarë apo në ato të fiseve, por nuk gjen as edhe një të tillë për femrat. Emocioni i zakonshëm që shprehet në rastet kur lind një femër është keqardhje ose turpi.

Shpesh e kam pyetur veten: Përderisa ardhja dhe largimi ynë nga kjo botë nuk regjistrohet askund, mos ndoshta kjo do të thotë se ne gratë e shkretëtirës nuk ekzistojmë? Më shumë se padrejtësitë e jetës, ishte pikërisht pyetja e mësipërme ajo që më shtyu të ndërmarr këtë hap të rrezikshëm për t’ju treguar historinë time.”

Në përfundimt mund të themi se gjuha e teksteve letrare po rrudhet drejt një stili të zhveshur i cili nuk priret më nga aktivizimi i fjalëve të rralla, nga krijimi i neologjizmave, nga përfshirja e termave të rinj të gjuhëve të huaja si tagër, domen, diskurs, establishment, etj.

Gjuha e letërsisë së sotme po e prish balancën midis funksionit denotativ dhe konotativ, pasi ajo është e detyruar të mundësojë komunikimin e shpejtë me lexuesin dhe të shmangë angazhimin kritik dhe krahasues.

Literature

1. "Kështjella" nga Ismail Kadare, fq.132,150 - Libri u botua për herë të parë në vitin 1970.
2. "Hija e maleve" nga Gjergj Fishta, fq.110 - Ky poezi epike u shkrua në vitin 1902 dhe u botua më vonë në vitin 1931.
3. "Lulet e verës" nga Lasgush Poradeci, fq.68 - Ky vepër poetike u botua në vitin 1911.
4. "Nëntori i një kryeqyteti" nga Fan Noli, fq.101 - Ky libër u botua për herë të parë në vitin 1927.
5. "Hijet e dritës" nga Migjeni (Millosh Gjergj Nikolla), fq.98 - Poezi e Migjenit u botua për herë të parë në shekullin e 20-të.
6. "Mbledhja e veprave", nga Eqrem Cabej, botuar më 1987.
7. "Gjuha dhe letërsia", nga Martin Camaj, botuar më 1976.
8. "Kadareja dhe Balzaku", nga Rexhep Qose, botuar më 1992.
9. "Vepra të zgjedhura", nga Fatos Lubonja, botuar më 2006.
10. "Metodologjia e analizës së tekstit letrar", nga Isuf Elezi, botuar më 2010

¹⁸⁵ "Sarah", nga Jean Sasson, fq. 223,240 botuar me 1992.

***Leksiku dialektor-krahinor i autorëve gegë që ka gjetur pasqyrim në fjalorët
shpjegues të shqipes.***

(Frang Bardhi, Nikollë Gazulli, Benedikt Dema)

DR. ANISA KOSTERI
Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”

Abstrakt

Si objekt të kësaj kemi vënë nxjerrjen në pah të leksikut veriperëndimor të shqipes përmes autorëve Frang Bardhi, Nikollë Gazulli e Benedikt Dema. Të tre këta autorë, leksikografë, fjalorët e të cilëve, në llojin e tyre të veçantë, kanë pasqyruar të folmen e gegërishtes veriperëndimore, leksikun e të folmes së Malësisë së Madhe dhe zonave përreth saj, duke përfshirë edhe qytetin e Shkodrës; më së pari, për arsye se të tre janë folës të lindur të kësaj të folmeje. Afrimi pranë e pranë dhe kundrimi krahasimtar, përmasës dhe diferencues i veprave leksikografike të këtyre autorëve me karakteristikat kryesore të së folmes së gegërishtes veriperëndimore, është bërë për faktin se, Bardhi, Gazulli e Dema kanë qenë (ndonëse me kulturë filologjike e albanologjike të ndryshme) folës të lindur të idiomës geqe të kësaj treve. Vepra e Frang Bardhit, botuar në vitin 1635 zuri një vend themelor në leksikografinë shqiptare, ku shërbeu si bazë për hartimin e fjalorëve të tjerë gjuhësorë. Nga Dom Nikollë Gazulli kemi “Fjalorthe i ri” (fjalë të rralla të përdorura në Veri të Shqipnisë), Qershor, 1941, i cili mund të thuhet se shënoi dhe lindjen e leksikografisë dialektore shqiptare.

Nga Atë Benedikt Dema kemi “Fjalor fjalësh të rralla të gjuhës shqipe”, Ky Fjalor është një shtesë e fjalëve që i bëhet Fjalorit të gjuhës shqipe, 1954, duke përfshirë shumë lema që nuk përmenden, ose që kanë një kuptim të ndryshëm nga ai i pasqyruar në Fjalorin e '54. Për hartimin e këtij Fjalori, ai u mbështet tek “Fjalori i Bashkimit”, 1908, “Fjalorthe i Gazullit” 1941, tek disa vepra të Fishtës e Kanuni i Lekë Dukagjinit, duke mos lënë pa përmendur edhe punën e vyer studimore që ka mbledhur vetë autori prej gojës së popullit. gjë që do të thotë se fjalësi dialektor krahinor i gegërishtes veriore ka shërbyer për pasurimin e gjuhës dhe larmishmërinë e saj përmes nuancave e ngjyimeve leksikore. Por sa ka gjetur pasqyrim ky leksik në fjalorët normativë të shqipes?

Si objekt të kësaj kumtese kam synuar që, nëpërmjet shqyrtimeve dhe paraqitjes sa më të gjerë të leksikut të fiksuar në disa prej fjalorëve më të njohur të gegërishtes veriperëndimore, të mbërrihet edhe në një pamje relativisht të qartë e të plotë të vlerave njohëse të atyre fjalorëve si të tillë, po edhe, mbi të gjitha, të shihet se sa ka përfituar prej tyre përfshirja në fjalorët e mëdhenj të shqipes dhe sa kanë peshuar të dhënat a prurjet e gegërishtes veriperëndimore në pasurimin potencial dhe real të leksematikës dhe thesarit ligjërimor të shqipes në tërësi.

Në analizë kam marrë tre fjalorë dialektorë, Fjalorin e Frang Bardhit, të Dom Nikollë Gazullit dhe Atë Benedikt Demës. Dihet mirëfilli se gjuha dhe kultura shqiptare e karakterit evropian, doli nga kleri katolik shqiptar me “Formulën e pagëzimit”, të arqipeshkvit të Durrësit, Imzot Pal Engjëllit, më 1462.

Por, është për të ardhur keq se, me përjashtim të Bardhit e pak të "Fjalorit të Bashkimit", për asnjë nga këta klerikë dijetarë, nuk u fol për sa vjet asnjë fjalë, ndonëse puna e tyre ishte e ditur. Dhe, çka është më keq, mjaft nga ata u mohuan egërsisht. Këto leksikografë shqiptarë të trevës së veriut dhanë një ndihmesë themelore në vatërimin e shkrimtarisë së vjetër shqipe, por nuk duhet lënë pa përmendur edhe ndihmesa e hullia e mbarë gjuhëlëvruese e gjuhëdashëse e filluar më herët nga veprat e Buzukut, Budit dhe Bogdanit.

Afrimi pranë e pranë dhe kundrimi krahasimtar, përmasës dhe diferencues i veprave leksikografike të këtyre autorëve me karakteristikat kryesore të së folmes së gegërishtes

veriperëndimore, është bërë për faktin se, Bardhi, Gazulli e Dema kanë qenë (ndonëse me kulturë filologjike e albanologjike të ndryshme) folës të lindur të idiomës geqe të kësaj treve.

Bardhi qe përgatitur me kulturë klasike perëndimore në Propagandën Fide në Romë, sipas gjasave zotëronte gjuhët klasike dhe italishten moderne e i takoi ta përballte për herë të parë shqipen me një gjuhë aq të lëvruar, siç ishte latinishtja e shkruar – provë që ia doli me sukses.

Megjithëse kjo vepër e parë leksikografike u hartua me qëllimin që misionarët e huaj klerikë të mësonin shqipen e ta përdornin në shërbesat fetare, nuk mund të themi, se në fjalësin e Bardhit mungon leksiku popullor, me fjalë të përdorimit të përditshëm në rafshin mesatar e të ulët.

Edhe Gazulli ishte klerik, por i formuar gjuhësisht dhe filologjikisht jo në shkollën latine (dhe i mungon përgatitja linguistike klasike), por në atë kohë (para Luftës së Dytë Botërore) në shkollën austro-gjermane, ku prej më se një shekulli ishte bërë qendra e studimeve albanologjike evropiane. Fliste e shkruante veç latinisht, greqisht, por edhe italisht, gjermanisht e frëngjisht.

Bie në sy, së pari, tek ky leksikograf jo vetëm mbledhja e kujdesshme me kritere shkencore e lemave, por edhe shpesh shpjegimet etimologjike, etnolinguistike dhe etnografike.

Për këtë, ky Fjalor ka pasur referime dhe është bërë mbështetje për mjaft gjuhëtarë me emra të huaj dhe vendës, si: Jokli, Pedersen, Desnickaja, Çabej, Riza, Beci, Shkurtaç, Simon Pepa etj.

Ky Fjalor nuk është vetëm krahinor (siç është quajtur rëndom), por ai përmban edhe të dhëna sa i takon të folmeve të tjera, të gegërishtes verilindore e qendrore.

Bashkë me Fjalorin e Pano Tases “Fjalë të mbledhuna në Jug të Shqipërisë”, vepër e së njëjtës seri, përbëjnë një fillesë me vlerë të leksikografisë dialektore shqiptare.

Benedikt Dema, dhe ky një klerik, i cili dha ndihmesë me vlerë në gjuhësinë shqiptare, duke lënë gjurmët e tij në lëmë të leksikografisë, me “ Fjalor fjalësh të rralla të gjuhës shqipe” të mbledhura në Veri të Shqipërisë.

Duke iu kthyer *Fjalorit* dygjuhësh latinisht- shqip, duhet theksuar se, vepra ka rëndësi të madhe për kulturën kombëtare, sepse shënon të parin fjalor të shqipes të hartuar nga një shqiptar e jo një i huaj (një meritë të tillë mjaft vende nuk e kanë). Shumë fjalë ose kuptime fjalësh do të ishin harruar e zhdukur, po të mos ishte ky Fjalor. Këtu gjejmë pasqyrim mjaft fjalë të brumit vendës.¹⁸⁶

Sigurisht, që vlerat pozitive janë ato që e karakterizojnë këtë vepër gjuhësore duke e vlerësuar Bardhin si leksikograf, i cili mori përsipër të pasqyronte pasurinë leksikore të gjuhës së vet.

“Fjalorth i ri” (fjalë të rralla të mbledhuna në Veri të Shqipërisë)” i dom Nikollë Gazullit, që doli si vëllim XI i serisë “Visaret e Kombit” (Tiranë, 1941), përmban 5000 lema. Simon Pepa numëron 4819 fjalë të rralla¹⁸⁷. Sipas studiueses Ledi Shamku,¹⁸⁸kriteri sasior

¹⁸⁶ Konferenca Ipehkvnore e Shqipërisë “Krishtërimi ndër shqiptarë” (Simposium Ndërkombëtar, Tiranë, 16-19 Nëntor 1999), S.Pepa, *Kontributi i klerit katolik në leksikografinë shqiptare*, “Krishtërimi ndër shqiptarë”, Shkodër, 2000, f.445-446.

¹⁸⁷ S.Pepa, *D.Nikollë Gazulli- themelues i leksikografisë krahinore dhe i asaj onomastike*, “Gjurmime kulturore”, Shkodër 2000, f.44.

¹⁸⁸ A.Haxhi – T.Topalli, *Nikollë Gazulli, (Ledi Shamku-Shkreli, Parathënie e botimit anastatik të Fjalorit të Gazullit, Tiranë, nëntor, 2005, f.5-16)*, “Leksikon, gjuhëtarë shqiptarë dhe albanologë”, Shkodër, 2012, f.42.

nuk ngre peshë, sepse ky është një fjalor i tipit shpjegues dhe përshkruar dhe e rëndësishme është metodologjia e hartimit, gjë që Gazulli e ka pasqyruar në mënyrën më të përsosur.

Për Gazullin gjuha e folur e popullit, është ajo që duhet t’i japë shkrimtarit fondin themelor të mjeteve të shprehjes dhe se lëvruesi i gjuhës letrare duhet të depërtojë në shtresa të thella të saj, në leksikon dialektor e krahinor përkatës.

Fjalësi i tij përfshin mjaft aspekte të jetës shqiptare, historisë, gjeografisë, kulturës (kryesisht zonave të gegërishtes veriperëndimore) duke na dhënë një pasuri leksiko-frazeologjike të shqipes, duke i dhënë lemave përkatëse ngarkesa e ngjyrimet kuptimore të reja e duke zgjeruar valencat e tyre në bashkëvajtje me kategori të tjera morfologjike.

Si njohës i mirë i gjuhëve të huaja dhe me një përgatitje të lartë filologjike klasike e moderne, në shumicën prej fjalëve, ai jep edhe përgjegjëset e tyre në gjuhë të tjera, si italisht e latinisht, ose edhe gjermanisht e frëngjisht, kjo ndoshta për të treguar edhe etimologjinë e asaj fjale.

Fjalori i Gazullit ka shërbyer dhe shërben si pikë mbështetje e konkretizimi për mjaft dijetarë që merren me shqipen e historinë e saj.

Atë Benedikt Dema dhe vepra e tij “Fjalor fjalësh të rralla të gjuhës shqipe”, një punë mbledhëse 18 -vjeçare, është një thesar më tepër në leksikologjinë e leksikografisë shqiptare, e cila mbërrin në duart tona, vetëm kur gjen dritën e botimit nga shtëpia botuese Toena, në 2005. Kur shikon me vëmendje të veçantë Fjalorin, vëren, se sa mund i është dashur autorit të mbledhë andej e këndej gjithë atë mori fjalësh dhe sa e çmueshme është puna e tij, sepse ai mblodhi fjalë nga gurra popullore, të cilat përdorshin në atë periudhë nëpër malësira dhe sidomos që kishin një kuptim të ndryshëm, ose nuk gjindeshin fare në Fjalorin e gjuhës shqipe 1954. Këto fjalë sot e pasurojnë dhe e zgjerojnë gjuhën tonë nëse vihen në përdorim.

Autori vetë për hartimin e këtij fjalori, u mbështet tek Fjalori i Bashkimit 1908, Fjalorthi i Gazullit dhe tek Atë Gjergj Fishta.

Ky Fjalor përmban fjalë e shprehje të papërmendura, ose që kanë një kuptim të ndryshëm nga Fjalori i gjuhës shqipe 1954. Në parathënien e librit autori shprehet: “ *Përmban fjalë e fraza të paçekuna ase me një vështrim të ndryshëm a të shtuem në Fjalorin e Gjuhës shqipe t’Insitutit të Shkencave të botuem në Tiranë, 1954.*”¹⁸⁹

Fjalorët dialektorë të shqipes gjithnjë përmbajnë në vete një pasuri të madhe të leksikut, saqë edhe pse mendojmë se ne mund ta njohim deri diku, prapë se prapë na duket i padëgjues e i panjohur. Visari i shprehjeve dhe frazave aq të bukura që shkrihen në Fjalor, tregon se sa mirë janë ruajtur me fanatizëm këto në mendjen dhe zemrën e shqipfolësve.

Këto leksikografë nën petkun e mirëfilltë të një eruditi, shpalosin mjaft vlera morale e shpirtërore, të cilat, përveç dashurisë për fjalën shqipe, kurimin e përdorimin e saktë të saj, transmetojnë edhe dëshirën për ruajtjen e trashëgimisë së vyer, e cila përbën edhe tharmin e vetë një kombi.

Me anë të punës së tyre kanë hyrë në ndërgjegjen e kombit si individë me vlerë të madhe shpirtërore, por edhe shkencore, ku gjurmimi i fjalës shqipe, dëshira për ta vënë në përdorim atë dhe për të mënjeluar fjalët e huaja të panevojshme, si dhe ruajtja me një fanatizëm jo të heshtur të gegërishtes, mishëronin madhështinë e tyre.

Mirëpo gjithë kjo etje e dëshirë për ruajtjen e fjalës shqipe që kishin këta mjeshtër të saj, duket sikur ka mbetur e kufizuar vetëm në disa parametra të paracaktuar, të cilat ende nuk mund të kalohen. Sot Fjalorët normativë të shqipes, sado të kompletuar e të shterruar në dukje, lënë mjaft për të dëshiruar në listimin e lemave të gjuhës sonë, gjithmonë e më shumë

¹⁸⁹B.Dema, “Fjalor fjalësh të rralla të gjuhës shqipe”, Tiranë, 2005, f.7, (botuar nën kujdesin e Dom Nikë Ukgjinit dhe redaktimin shkencor të Akademikut Kolec Topalli dhe Prof.dr. Tefë Topalli).

duke u vendosur në hije dialektet, kryesisht gegërishtja. Prirja për t’i lënë në harresë, duke i struktur në një qoshe të errët, në kuadrin e krahinorizmave, nuk është e drejtë, por as nuk i shërben shqipes dhe fuqisë shprehëse të saj. Siç shprehet Akademiku Gjovalin Shkurtaj, “*Dialektet (përkat. të folmet) nuk zhduken, por rrojnë sa të rrojnë vetë bartësit e tyre; kjo do të thotë se ato nuk humbin, nuk asgjësohen, por vetëm mund të mënjanojnë, të tkurren e të mbeten në hije e pa u përdorur, por kurdoherë të plotvlershme e të zonjat për të hyrë në përdorim nëse do ta lypë nevoja*”¹⁹⁰. Leksiku i përdorur në këta Fjalorë shpreh idenë e bashkekzistencës të këtyre lemave në ligjërimin e folur, por edhe në të shkruar, si dhe futjen në përdorim të sinonimeve dhe varianteve leksikore të një fjale, të cilat veç e pasurojnë më tepër leksikon e shqipes.

U morën në analizë këta Fjalorë sepse: të tre ishin priftërinj me kulturë filologjike, të tre dhanë ndihmesa të vyera në lëmë të leksikografisë, duke na lënë tre fjalorë të pasur e me vlera dhe, më e rëndësishmja, vërejmë se në këta fjalorë, pasqyrohet e folmja geqe, përkatësisht zona e Zadrimës, Shkodrës e Malësisë së Madhe.

Por, pavarësisht kësaj vlere që kanë kata fjalorë nga ana leksikore, sa vlerë kanë ato në bashkekzistencën e këtyre lemave në ligjërimin e folur dhe në atë të shkruar?

Jemi munduar të analizojmë, por edhe të paraqesim grafikisht, sa ka gjetur pasqyrim ky leksik krahinor-dialektor në fjalorët normativë të shqipes. Si fjalorë normativë, kam marrë në shqyrtim Fjalorin e ‘54 dhe të ‘80, ndonjëherë i jam referuar edhe Fjalorit të 2006. Natyrisht, nuk mund ta paraqesim të plotë fjalësin e listuar, pasi nuk do të mjaftonte kjo kumtesë, por jam munduar t’i paraqes grafikisht, duke i kushtuar më tepër rëndësi mungesës së këtyre lemave në fjalorët normativë të shqipes.

Sa i takon Fjalorit dygjuhësh latinisht-shqip të Frang Bardhit, dijmë se ai përfshin rreth 4500 fjalë latine, të cilave u përgjigjen rreth 2500 fjalë shqipe. Krahas fjalëve jepen edhe togfjalësha që tregojnë përdorimin e tyre. Nga këto kemi:

a) Fjalë që nuk janë përfshirë në Fjalorët 1954, 1980.

Janë veçuar 38 fjalë të tilla.

Duke qenë se nuk janë ndeshur tek Fjalorët normativë, jam konsultuar me Leksikon historik të gjuhës shqipe nga Kolë Ashta, vëllimi III, ku gjejmë një shpjegim mjeshteror nga dora e tij.

Përmendim raste si: **me gheçletciem** (me gëdhelëtuem), (f.2). Sipas K.Ashtës e kemi, *argëtohem, josh*; **ndeguefcim** (ndëgueshim), (f.5). Ashta e jep për *haptas, çeltas*; **chembegnenia** (këmbënjenia, f.18). Sipas K.Ashtës: 1. *marrëzi*. 2. *të lanun mendsh*. 3. *pallavra*. 4. *punë e turpshme, faqe e zezë*. 5. *ai që thotë fjalë të jashtëzakonshme*; **cianciatuer** (çançatuer), (f.29). Sipas K.Ashtës: *tallje, llapazan*; **sceregiuer** (sherëgjuer), (f.32). Ashta jep variantin latinisht për *hipokrit*; **deluçete** (dëludhëtë), (f.41). Tek K.Ashta e kemi: *vërshim, përmbytje*; **me u gumezune** (me u gumeacunë), (f.41). K. Ashka e ka: *argtohem, tallem, vë në lojë*; **scriuaa** (shkrivār), (f.49). Tek K.Ashta e kemi: *ai që mëson tjetrin të shkruajë*; **labdurij** (labdurī), (f. 59). E ndeshim tek K.Ashta, *mburrjet për kërcënim ndaj dikuj*; **statpulchyer** (shtatpulqyer), (f.63). Tek K.Ashta e kemi: *ai që e ka trurin si pulqyer, si gishti i madh i dorës, shkurtabiq, xhuxhimaxhuxh*; **dellues** (dellues), (f.65). K.Ashta e shpjegon për *nevrik* etj.

Mjaft mirë mund të themi se, në Fjalorin e Bardhit, ndonëse kanë kaluar rreth 400 vjet, mund të gjenden fjalë të cilat duhen aktivizuar në Fjalësin aktiv të shqipes së sotme, përndryshe të variantit të shkruar të Veriut e më gjerë; prej këtej, në stile të ndryshme, të përdoren në gjuhën e njësuar. Fjalë të tilla, mund të jenë: **dellues** -nevrik, **cianciatuer**- llapazan, **sceregiuer** -hipokrit, **scriuaa** (shkrivār)- *ai që mëson tjetrin të shkruajë* etj.

¹⁹⁰ Gj. Shkurtaj, “Dialektet e shqipes”, Tiranë 2012, f.15

Materialet e punimeve (proceedings)

ISBN: 978-1-78911-007-4

b) Fjalë me kuptim shtesë, të shpjguara në Fjalorët e viteve 1954,1980.

Kemi 23 fjalë të marra në shqyrtim. Mund të ilustrjmë një shembull:

camareia (kamareja), (f.6). Në F.'54 e kemi me dy kuptime, **kamare-ja**- 1. *vend i çelur në mur në formë qemeri, zakonisht në të dy anët e vatrës, ku vihen filxhanet; përgjithësisht çdo vend i hapur në mur në formë qemeri, për të vendosur diçka.* 2. *vapori, kabinë* (F.'54, f.196). Në F.'80. e kemi me katër kuptime: **kamare-ja** – 1. *vend i hapur në murin e njëstëpie, zakonisht në të dyja anët e oxhakut, ku mbahen enë e sende të vogla që përdoren përditë (xhezve, filxhanë etj.); dollap i vogël pa kanata në mur; vrimë në mur.* 2. *hapësirë e vogël si dritare në murin midis dy qemereve të urës.* 3. *krah. vendi ku pula pjell vezët, furrik.* 4. *kabinë në vapor.* (F.'80, f.775). Ashta shkon më tej në shpjegimin e kësaj leme: *merimangë*, (Leksiku historik i gjuhës shqipe 3, Shkodër, 2000, f.157).

c) Fjalë që përfshihen vetëm tek Fjalori i 1954.

Janë marrë 16 fjalë te Bardhi. Kjo mbase për faktin që ky Fjalor ishte i pari që hartohet si fjalor shpjgues pas Luftës II Botërore. Tek ky fjalor gjenden mjaft krahinorizma dhe dialektizma të gegërishtes veriperëndimore. Po përmendim vetëm disa prej tyre:

brunze (bruncë), (f.2). Bardhi, për **bruncë** ka kuptimin e **bakrit**, duke u nisur edhe nga përkthimi nga latinishtja në shqip i kësaj fjale. F.'54 e përdor si të tillë, **brunc-i** – *bronc* (F.'54, f.48). K. Ashta shkon më tej në shpjegim, 1. *rrem, bronc.* 2. *pare bronci* (Leksiku historik i gjuhës shqipe 3, Shkodër, 2000, f.106).

i ftemanchte (i shtëmanktë), (f.4). F.'54 e përdor me të njëjtin kuptim, **i shtëmëngët** – *i mëngjër* (F.'54, f.544).

ç) Fjalë që përfshihen vetëm tek Fjalori i 1980.

Janë veçuar 4 raste të tilla.

rcoreia (rkoreja), (f.11). Fjalori i '80 e shpjegon në këtë mënyrë, **rëkore-ja** – *radhiqe, resë* (F.'80, f.1654).

mbarreia, suna (mbarreja, dhuna), (f.33). Këtë dialektizëm e ndeshim me të njëjtin kuptim në F.'80. **marre-ja** – *turp* (F.'80, f.1064).

zurlla (curla), (f.49). Në F.'80 e kemi, **curle-ja** – *melodi me curle* (F.'80, f.234).

d) Fjalë që janë përfshirë në të dy Fjalorët ('54,'80).


Janë marrë në shqyrtim 79 fjalë.

Fjalori i Bardhit, pasqyrimi i leksikut në Fjalorët normativë të shqipes (1954,1980).

- 1) *Fjalë që nuk janë përfshirë në Fjalorët e 1954,1980*
- 2) *Fjalë me kuptim shtesë*
- 3) *Fjalë që janë përfshirë vetëm në Fjalorin e 1954*
- 4) *Fjalë që janë përfshirë vetëm në Fjalorin e 1980*
- 5) *Fjalë që janë përfshirë në të dy Fjalorët (1954,1980)*

Materialet e punimeve (proceedings)

ISBN: 978-1-78911-007-4



Fjalori i Gazullit

a) Fjalë që nuk janë përfshirë në Fjalorët (1954, 1980)

Fjalësi i “Fjalorit” përmban 5000 lema. Janë shqyrtuar rreth 265 të tilla të cilat nuk gjejnë pasqyrim në fjalorët e shqipes.

ângël (f. 47) – 1.?, 2. *jam ftofë e bâ angel: jam ftofë e bâ koçâ* .

babarrun-e (f.51)- *i fortë, trimaloç-e: i fuqishëm shtatit.*

capllue (f.80)- *me mungue, me firue.*

qofe-ja (f.94) - *zëmër qofe, njeri qofe, njeri i shtruem e i paburnni.*

qýet (f.96)- *mandej.*

dordull (f.112) - *plot sa s’zen mâ.*

ndërdomna (f.282) – *me mbetë, me qënë ndërdyzash, mos me dijtë m’e da njënen dysh etj plot.*

Vërejmë se nga shumësia e lemave që ndodhen në Fjalorthin e Ri të N.Gazullit, të paraqitura më lart, prej tyre, mendojmë se fjalët e mëposhtme mund të gjejnë hapësirë përdorimi edhe në Fjalorët normativë të shqipes së sotme, (mbi bazën e ususit gjuhësor) si: **akulltar-e** (f.44)- *njeri qi e ka menden akull, qi i peshon fjalët.* **caktár-e** (f.79) – *që rrin në cak, që ruen cakun.* **danisë** (f.104) - *me danue, me e da mēnden, me vendue, me këputë.* **dae-ja** (f.104) - *të dam-t; de-ja, krh. dreja,për: droe-ja.* **dhândrrorë-t** (f.119)-*të dy të martuemit rishtaz.* **dyzme-ja** (f.118)- *njeri me dyzme, me hollime, dyzmeli-ja, për grua nature.* **lêjetar-e** (f.233) – *kush xir lëjën.* **ndeshëtar-e** (f.284) – *kush del me ndeshë kendin, me i dale para kuj.* **ndeshëzi-zezë** (f.284) – *ogur-zi-zezë, përkundra: ndeshëmirë, orgurmirë.* **patur-i** (f.301) – *i pasun e rrodhëc, koprrac.* **ngufshëm-i,- e, -ja** (f.289)- *qi ngufë, a gufon shpejt.* **plakrri** (f.328) – *me nisë m’u plakë.*

Fjalori i Gazullit duke qenë i karakterit shpjegues, jep gjithnjë e më fort idenë se sa e pasur është shqipja në kundruallësinë e saj. Shtresimi leksikor me fjalë të marra nga fondi i gegërishtes, kryesisht asaj perëndimore, por jo vetëm, sot ka shumë mundësi të marrë një shtysë për secilin gjuhëtar në vetvete, pse jo, për të rigjallëruar leksikun e gegërishtes edhe në përdorim më të gjerë dhe jo ta kufizojë përdorimin e saj vetëm në situata joformale, në shtëpi, me të afërmit, miqtë etj. Sepse, gjithnjë e më tepër brezi i ri i shqipfolësve është inkuadruar në një horizont të kufizuar fjalësh, vetëm në standardin, duke mos iu krijuar mundësia të shkojë më tej tek veprat e autorëve të vjetër, duke mos i njohur fare ato, madje edhe gjuha e tyre t’i duket si joshqipe.

Një ndarje tjetër:

b) Fjalë me kuptim të ndryshëm në Fjalorët e tjerë të shqipes (1954,1980)

Kemi 22 raste të tilla. Po japim një shembull:

Materialet e punimeve (proceedings)

ISBN: 978-1-78911-007-4

bigë-a (f.61) – *birë, vrimë*. Jepet me këtë kuptim të veçantë, pasi në Fjalorin e sotëm të shqipes 2006, ka edhe kuptimin: 1. *dru a diçka tjetër që mbaron me një degëzim më dysh; vendi i degëzimit ose vetë degëzimi; furkaçe*. 2. *vinç i madh me dy krahë*. 3. *çift e drejt përpyjetë*.

c) Fjalë me kuptim shtesë në Fjalorin e vitit 1954, 1980

Kemi dalluar rreth 50 fjalë të tilla.

mjekatar-e (f.265) – *njeri qi mbahet për mjek, por s’është*. F.’80, **mjektar-i** – 1. *mjekës, mjek*. 2. *magjistër* (F.’80, f.1156).

natara-ja (f.277) – *grue natara: qi din me punue gjithfarë rângësh shpije*. F.’80, **natar-e** – *mendjehollë, që ia pret mendja; i shkathët, që i vjen ndoresh për çdo punë; natara-ja* – *secila nga të dy rrotullat e vogla në trajtë makaraje ku varen liqtë e vegjës* (F.’80, f.1198).

ç) Fjalë që përfshihen vetëm tek fjalori 1954

Janë gjetur rreth 75 fjalë.

burzue (f.77) – *me nisë djali m’u pjekë, m’u qymë, m’u rudithë mustakësh, m’u ndjersë musteqesh*. F.’54, **burrezohem** – *thuhet kur nis djali të piqet, t’i dirsë mustaqja* (F.’54, f.52).

përkye (f.311)- *m’u kulë, çplâ, lakue, shtrëmbënue*. F.’54, **përkyej** – *ndrydh, shtrembëroj, lakoj* (F.’54, f.400).

përlim-i (f.311) - *detyrë; me la borxhin*. F.’54, **prelim-i** – *detyrë* (F.’54, f.400).

- Fakti që mjaft fjalë nga Fjalori i Gazullit (1941), janë pasqyruar vetëm në Fjalorin e vitit 1954 dhe jo më vonë, gjen shpjegim me afrinë në kohë të publikimit të këtyre veprave, me një dekadë ndërmjet.
- E dyta, hartuesit e Fjalorit të 1954-ës e kanë njohur dhe çmuar në mënyrë të veçantë si një prej botimeve të njohura të serisë së Visareve të Kombit.
- Mendojmë gjithashtu se gjuhëtarët leksikografë që punuan për mbledhjen dhe përzgjedhjen e fjalësit të fjalorit të parë shpjegues të shqipes (1954), kanë pasur mendimin se, në rrjedhën e natyrshme të zhvillimit të variantit të shkruar të Veriut, shumë fjalë dialektore të mbledhura nga Nikollë Gazulli, mund të ishin përdorur sot e gjithë ditën brenda standardit të shqipes.
- Së katërti, duhet vënë në dukje se edhe Fjalori i vitit 1954 ka mjaft trajta fjalësh krahinore, të cilat në kohën tonë, jo vetëm që nuk përdoren, por edhe kalojnë në harresë.

d) Fjalë që përfshihen në Fjalorin e 1980-s

Kemi ndeshur rreth 55 raste të tilla. Siç shihet, numri i fjalëve të vjela nga Gazulli dhe të pasqyruara në Fjalorin normativ të gjuhës shqipe (1980), është numerikisht më i madh; çka do të thotë, se natyrshëm, ai është më gjithëpërfshirës, megjithëse nuk mund të quhet *thesarius* i gjuhës sonë. Së dyti, duhet shënuar se ky fjalor me mbi 40 mijë fjalë përmban edhe kuptime – shtesë në krahasim me fjalorin e Gazullit.


e) Fjalë që janë përfshirë në të dy fjalorët (1954,1980)

Janë pasqyruar rreth 75 fjalë të tilla. Nga paraqitja e shkurtër më sipër, del që hartuesit e Fjalorit të shqipes të vitit 1980, kanë përfshirë një numër jo të vogël lemas, vjelë prej Fjalorit të Gazullit. Për këtë mendojmë se është gjykuar i drejtë përdorimi aktiv i tyre në variantin e

shkruar e të folur të Veriut, pasi shumë e shumë fjalë gjenden në gjuhën e autorëve të kohës, si, te Migjeni, Koliqi, Fishta e Mjeda etj.

Fjalori i Gazullit, pasqyrimi i leksikut në Fjalorët normativë të shqipes (1954,1980).

1. Fjalë që nuk janë përfshirë në Fjalorët (1954,1980)
2. Fjalë me kuptim të ndryshëm
3. Fjalë me kuptime shtesë
4. Fjalë që janë përfshirë vetëm në Fjalorin e 1954
5. Fjalë që janë përfshirë vetëm në Fjalorin e 1980
6. Fjalë që janë përfshirë në Fjalorët normativë (1954,1980)



Fjalori i Benedikt Demës

a) Fjalë që nuk janë përfshirë në Fjalorët (1954, 1980)

Janë rreth 75 fjalë që nuk i gjejmë të pasqyruar në Fjalorët normativë. Siç vërehen, janë të shumta fjalët që nuk i ndeshim të përfshira në Fjalorët respektivë 1954,1980. Dema, kryesisht është munduar të na japë leksikun e fjalëve të rralla të malësive të Veriut, ka mbledhur fjalë në zonat më të skajshme e të thella veriore, kështu që edhe fjalësi është mirëfilli krahinor, por që edhe në ligjërimin bisedor të po këtyre trevave zor përdoren aktualisht, sepse, siç e thekson edhe vetë ai, është munduar të pasqyrojë fjalë e lema të cilat nuk janë të përfshira në Fjalorin e 1954, ose që kishin kuptime të ndryshme apo shtesë nga ato të përdorimit të përditshëm.

aksem(i) (f.12) – *guximtar*.

amitë (f.12) - *pajtue femijën*.

amshtik(f.12) - *i amshtë, me shije myku*.

bacan-i (f.17) - *dash me tru te bardhemtë e të lkuqem*.

cadyll-i (f.33) - *strajsë, ku qiten fashojt mbasi t'u hiqet mjalta, per me xjerrë dyllin (tue e shtrydhë)*.

dumak-u (f.50) – *tra*.

germuet (f.69) - *i vështirë, i pashteg*.

rrihun (i) (f.189) - *i pahajr, hashari*.

b) Fjalë me kuptim të ndryshëm

Materialet e punimeve (proceedings)

ISBN: 978-1-78911-007-4

Kemi 10 raste të tilla. Për shembull:

ajar-i (f.11) - *kreshnik, fatos*. F.'54, nuk e ka. F.'80, **ajar-i** – 1. *kosh i madh që përdorej për të matur drithin; masë drithërash*. 2. *sasia e pjesëve të një metali të çmuar që gjendet te një mijë pjesë të një përzierjeje me metale të tjera, karat*. 3. *barazi në peshë, baraspeshë, drejtpeshim; përpjestim i barabartë, përputhje e plotë në masë e në kohë* (F.'80, f.15).

ajue (f.12) – *ajë*. F.'80, **ajoj-** *lag ose mbush me ujë një vozë a një enë tjetër prej druri* (F.'80, f.16).

alle-ja (f.12) – *lulealle*. F.'80, **alle-ja** – 1. *ngjyra e kuqe e ndezur*. 2. *dhi me qime të kuqe të ndezur* (F.'80, f.26).

rragë-a (f.186) - *fjalisje, shamatë*. F.'80, **rragë-a** – 1. *pëlhurë e trahsë prej liri, që përdoret për thasë etj., burdhë*. 2. *përparëse prej kësaj pëhure, që vihet për të mos u fëlliqur gjatë punës; rragë-a – shih rragatë-a* (F.'80, f.1676).

c) Fjalë me kuptim shtesë

Kemi 21 raste të tilla.

çudue (f.41) – *perçudnue*. F.'80, **çudoj** – 1. *i prish pamjen dikujt a diçkaje, e shëmtoj, e përçudnoj*. 2. *e përdhunoj, e çnderoj (një vajzë)* (F.'80, f.279).

gris (f.74) - *kush grine me fjale, kush flet shume*. F.'54, **gris** – 1. *ha, prish rrobat nga të përdorurit e gjatë*. 2. *shqyej një copë letër a një cope, e çjerr* (F.'54, f.147).

ç) Fjalë që përfshihen vetëm në Fjalorin e 1954

Tek Fjalori i Demës vërejmë një dukuri të tillë, siç e theksuam më lart, që shumë lema nuk gjejnë pasqyrim në Fjalorin e 1954, gjë që përkon edhe me idenë e hartimit të këtij Fjalori, që të paraqesë fjalë që nuk janë në Fjalorin e 1954, ose të kenë formë të njëjtë, por kuptime të kundërta. Janë ndeshur vetëm pesë raste të tilla.

allkë-a (f.12) - *hallkë, rreth hekuri, qi u vëhet bagtive*. F.'54, **allkë-a** – *ledh arash* (F.'54, f.8).

amball-i (f.12) – *jamball (turq), zakarezë*. F.'54, **jamball-i** – *bimë e familjes së Leguminozëve, me kërcell të gjatë e me lule të mbledhura në vile* (F.'54, f.186).

amsht-i (f.12) - *amshti, samtim*. F.'54, **amshti-a** – *të qenët i amshtë* (F.'54, f.9).

çukulitë (f.42) – *qukatë*. F.'54, **çukit** – *çoket me sqep; thuhet edhe për piskimin e gjarprit* (F.'54, f.70).

vuejshem (f.235) - *me vishtirsi, mund*. F.'54, **vuejshëm (i)** – **vuejshme (e)** - *që mund të durohet* (F.'54, f.620).

zalikë-a (f.238) – *zali*. F.'54, **zali-a**- *të fikët* (F.'54, f.626).

d) Fjalë që përfshihen në Fjalorin e 1980

Ndryshe nga Fjalori i vitit 1954, në Fjalorin e vitit 1980, ndeshim më shumë fjalë të Benedikt Demës, të cilat kanë kuptime të ngjashme por edhe të njëjta në të dy Fjalorët. Kjo mund të jetë rastësi (duke marrë parasysh faktin se Fjalori i Benedikt Demës, u botua në vitin 2005), ose mund të shpjegohet me faktin se Fjalori i 1980, ka lëndë të pasur leksikore e frazeologjike, gjë që nuk ka lënë mënjanë përfshirjen e leksikut krahinor të gegërishtes. Janë pasqyruar 35 fjalë.

e) Fjalë që përfshihen në të dy Fjalorët 1954,1980

Janë rreth 60 fjalë që gjenden në të dy fjalorët normativë.

Fjalori i Benedikt Demës dhe pasqyrimi i leksikut të tij në Fjalorët normativë (1954,1980)

1. *Fjalë që nuk janë përfshirë në Fjalorët (1954,1980)*


2. *Fjalë me kuptim të ndryshëm*

3.Fjalë me kuptime shitesë

4.Fjalë që janë përfshirë vetëm në Fjalorin e 1954

5.Fjalë që janë përfshirë vetëm në Fjalorin e 1980

6.Fjalë që janë përfshirë në Fjalorët normativë (1954,1980)



Trashëgimia gojore e popullit del mjaft e pasur, duke e ngritur shkallë më lart gegërishten e lënë në hije. Shpjegimet analitike të togjeve leksikore dhe objektiviteti me të cilin këtë autorë operojnë, i bëjnë këto vepra të qendrojnë pa droje në krah të fjalorëve të tjerë normativë të shqipes.

Konkluzioni a përfundimi ynë kryesor është se të tre këta “të mëdhenj të leksikografisë shqipe” (Bardhi, Gazulli, Dema) na lanë një trashëgimi të pasur gjuhësore, ku secili prej tyre është “i parë” në llojin e vet.

Fjalori i Bardhit përbën Fjalorin e parë të mirëfilltë dygjuhësh shqip – italisht, Gazulli na la Fjalorin e parë krahinor (të gegërishtes veriperëndimore), Dema, gjithashtu, i parë në llojin e vet, ku me punën e tij hulumtuuese, na pasqyrooi një shtesë fjalësh që nuk ekzistonin në Fjalorin e gjuhës shqipe të ’54, ose që kishin një kuptim të ndryshëm nga ky Fjalor.

Kam dëshirë ta mbyll me një citim të studiueses Ledi Shamku, citim i cili i referohet Fjalorit të Gazullit, por mendoj se i rrin mirë edhe Fjalorit të Bardhit dhe të Atë Benedikt Demës.

“Nxjerrja e gegnishtes nga hiesina dhe reshtja e ftohtësisë ndaj saj kërkojnë dritë; dritë që ende nuk është ndezur, porse mund të ndizet në çdo rast.”¹⁹¹

Bibliografi

A.Haxhi – T.Topalli, *Nikollë Gazulli, (Ledi Shamku-Shkreli, Parathënie e botimit anastatik të Fjalorit të Gazullit, Tiranë, nëntor, 2005, f.5-16), “Leksikon, gjuhëtarë shqiptarë dhe albanologë”, Shkodër, 2012.*

B.Dema, “Fjalor fjalësh të rralla të gjuhës shqipe”, Tiranë, 2005, (botuar nën kujdesin e Dom Nikë Ukgjinit dhe redaktimin shkencor të Akademikut Kolec Topalli dhe Prof.dr. Tefë Topalli).

Gj. Shkurtaç, “Dialektet e shqipes”, Tiranë 2012.

F. Bardhi, “Fjalorit dygjuhësh latinisht- shqip”, 1635.

L.Shamku-Shkreli, *Parathënie e botimit anastatik,* Fjalori i Gazullit”, Tiranë, 2005

N.Gazulli, “Fjalorth i ri” (fjalë të rralla të mbledhuna në Veri të Shqipërisë) Tiranë, 1941.

S.Pepa, *Kontributi i klerit katolik në leksikografinë shqiptare,* “Krishtërimi ndër shqiptarë”, Konferenca I peshkvnore e Shqipërisë “Krishtërimi ndër shqiptarë” (Simposium Ndërkombëtar, Tiranë, 16-19 Nëntor 1999), Shkodër, 2000.

S.Pepa, *D.Nikollë Gazulli- themelues i leksikografisë krahinore dhe i asaj onomastike,* “Gjurmime kulturore”, Shkodër 2000.

¹⁹¹L.Shamku-Shkreli, *Parathënie e botimit anastatik,* Fjalori i Gazullit”, Tiranë, 2005, f.16.

Raporti i lidhore me paskajoren në ligjërimin e folur dhe të shkruar

PHD.C. LIRIDONA MEHMETI
Universiteti publik i Gjilanit “Kadri Zeka”

Abstrakti

Një nga tiparet dalluese morfologjike mes dy dialekteve të shqipes në fushë të gramatikës është paskajorja me format e saj (geg. *me mendu-* tosk. *për të menduar*). Gjithashtu, praktikisht format e paskajores mund t'i zëvendësojmë me format e mënyrës lidhore, gjë që kjo paraqet mënjanimin e paskajores në gjuhët ballkanike (Sh. Demiraj, R. Ismajli, A. Xhuvani, E. Lafe, E. Likaj, B. Beci, D. Luka, Gj. Shkurtaç dhe J. Gjinari, N. Veselaj, M. Çeliku, S. Riza).

Si argumente kryesore refuzuese rreth mospërfshirjes së paskajores *me+pjesore* në normën standarde, që daton nga fundi i viteve '40-të të shekullit që lamë pas, por që përsëriten vazhdimisht. Veçohen, përpos konstatimit se një formë e tillë i mungon bazës së përzgjedhur si normë letrare (toskërishtes), edhe për këto dy fakte: e para, është lidhorja (*format e lidhore*); e dyta, është paskajorja e dytë ose togu: për+emri i nyjshëm foljor asnjans (tipi për të+pjesore ose për+gerundi), që të dyja këto fakte arsyetohen me përparësinë e dukshme se kanë shtrirje në të dy dialektet. Në të vërtetë, këto dy argumente, duke pasur përhapje në të dy dialektet: gegërishte e toskërishte, ndonëse ishin sinonime të pjesshme, u konsideruan absolutisht të vetëmjaftueshme dhe fuqiplota për zëvendësimin e paskajores së mirëfilltë.

Në këtë punim paraqesim lidhoren në raport me paskajoren, duke dhënë shembuj praktikë të gjuhës së folur e të shkruar. Kemi përdorur metodën përshkruese dhe të analizës. Pra, qëllimi i punimit është trajtimi i lidhore në raport me paskajoren, në ligjërimin e folur dhe të shkruar.

Fjalët çelës: *format e lidhore, format e paskajores, lidhorja-paskajorja, dialektet, gjuha standarde.*

Hyrje

1. Shqyrtimi teorik

Sipas Sh. Demirajt (1988:41), riorganizimi i sistemit foljor të gjuhës shqipe, në pjesën më të madhe, është kryer qysh në periudhën parashkrimore të saj. Një nga dukuritë më të diskutueshme me karakter ballkanik është zëvendësimi i shkallëshkallshëm i paskajores nga lidhorja, që është një dukuri e përfutur vetëm në gjuhët ballkanike. E tillë paraqitet gjendja edhe për dukuritë e tjera të strukturës gramatikore të shqipes me karakter ballkanik, siç janë: përdorimi i lidhore në funksion të paskajores, ndërtimi i kohës së ardhme me pjesëzën *do*.

Ndërtime tjera, në gjuhën shqipe, janë edhe format e ndërtuara me foljen *kam*, me anë të cilës ndërtohen forma të së ardhmes, në rastet kur ndiqen nga paskajorja, duke krijuar format: *kam me shkue* (në dialektin gegë), *kam për të shkuar* (në dialektin toskë), si dhe kur ndiqet nga një folje në mënyrën lidhore, duke krijuar formën: *kam të shkoj*, që kryesisht përdoret në të folmet e diasporës së Italisë (Topalli, 2010:105,106).

Gjithashtu, edhe sipas B. Becit (2016:253), prej skajit jugor e deri në skajin verior të truallit të shqipes në të gjitha të folmet e toskërishtes dhe të gegërishtes ka dy forma për të ardhmen: një që ndërtohet me pjesëzën *do* dhe lidhoren (*do të shkoj*) dhe një tjetër e formuar nga folja *kam* dhe paskajorja (*kam për të dalë/kam me dalë*).

Ndërsa, sipas M.Çelikut (1968:30), forma kryesore zotëruese që përdoret në gegërishten e jugut është forma me *do+lidhore*, pjesëza *të* e lidhore shumë herë mungon (*do*

t`vij, do t`pjek, do hiki). Ai konstaton të drejtë mendimin e Gj.Pekmezit që e jep si formë kryesore për Elbasanin të ardhmen me *do*, por nuk e sheh të drejtë të ardhmen me *do+lidhore* si lloj i dytë i të ardhmes, siç pohon G.Vajgandi, si dhe e analizon të drejtë mendimin e M.Lambercit, i cili e njih në mbarë gegërishten formën e së ardhmes me *kam+paskajore*, të ndryshme nga toskërishtja.

Sipas A.Desinckajas (1972:40; cit.nga B.Beci 2016:255), në gegërishte paraqitet tipi i ashtuquajtur i Evropës së Perëndimit: kombinimi analitik i trajtave të kohës së tanishme të foljes ndihmëtare kam me infinitivin: *kam me luftue (luftu), ke me luftue* etj. Në toskërishte paraqitet tipi ballkanik: kombinimi analitik i trajtave të mënyrës lidhore të kohës së tashme të foljes që zgjedhohet me pjesëzën *do* (trajta e ngurosur e foljes *dua*): *do të luftoj, do të luftosh*. Ky dallim nuk është absolut, sepse në të folmet geqe të Jugut, më të përhapura janë trajtat e tipit të dytë, që u përgjigjen atyre toske. Kombinimi analitik *kam për të luftuar* (toskërishte), *kam për të luftue* (gegërishte) përdoret gjithkund, më tepër në toskërishte, por në përgjithësi jo aq gjerësisht.

Sipas J.Gjinarit (1989:69), si veçori relevante e absolute që dallon dy dialektet e shqipës është marrë paskajorja e gegërishtes *me punue*, e cila mungon në toskërishte. Në dialektin jugor funksionet e saj i luan forma e tipit *për të punuar* dhe *lidhorja*. Sipas tij, në të folmet veriore dallohen për trajtën e veçantë të paskajores, e cila është perifrastike, është e përbërë nga parafjala *me+pjesoren*: *me dal, me mbledh, me vra, me la, me diftu, me ble*. Kjo mungon në jug dhe funksionet e kësaj i kryen lidhorja ose paskajorja tjetër (*për të shkruar*), por edhe në veri kjo paskajore nuk është e përdorur njësoj, ekziston aty edhe trajta e paskajores *për me shku*.

Ndërkaq, R.Ismajli (2003:53), pohon se në fushë të gramatikës tiparet ekskluzivisht geqe apo toske nuk janë të shumta, porse ato përshkojnë tërë sistemin. Ndonjëherë shtrirja nuk e përfshin tërë gegërishtem apo toskërishten, herën tjetër hapësira të caktuara nga dy dialektet, kështu që variacionet dalin të larmishme. Sipas tij, është gjë e njohur se funksionet sintaksore të paskajores në toskërishten dhe në shqipen standarde rimerren nga lidhorja, të cilën e ka edhe gegërishtja. Sido që të jetë, shqipja standarde ashtu edhe toskërishtja, për shkak se nuk e kanë paskajoren e tipit *me punue*; i përdorin format e lidhores ndjeshëm më dendur, ndërsa gegërishtja përmes përdorimeve shumë më të dendura të paskajores ka zhvilluar mundësi të stërholluara të shprehjes sintaksore dhe stilistike në këtë drejtim.

1.1. Objekti dhe metodologjia e punimit

Në këtë punim trajtojmë lidhoren në raport me paskajoren, duke dhënë shembuj praktikë të gjuhës së folur e të shkruar. Kemi përdorur metodën përshkruese dhe të analizës. Pra, qëllimi i punimit është trajtimi i lidhores në raport me paskajoren, në ligjërimin e folur dhe të shkruar.

2. Lidhorja në raport me paskajoren

Sipas Sh.Demirajt (1988:865), lidhorja është një nga mënyrat e trashëguara të gjuhës shqipe, e cila gjatë zhvillimit historik të kësaj gjuhe ka pësuar ndryshime largvajtëse si nga ana kuptimore-funksionale, ashtu edhe nga ana formale. Këto ndryshime janë përftuar qysh në periudhën parashkrimore të gjuhës shqipe e kjo del e qartë, po të krahasohet gjendja e sotme e kësaj gjuhe me atë të veprave të shkruarëve tanë më të vjetër.

Sipas E.Likajt (2015:38), lidhorja e sotme është kristalizuar si formë morfologjike analitike, por gjithmonë ka pasur nevojë për plotësime a përforcime modale në përputhje me kuptime me kuptimet e gjera sintagmatike të saj, të cilat e veçojnë atë nga gjithë sistemi

mënyror i shqipes. Shformësimi i foljeve modale të paravendosura lehtësohet nga rrethana që lidhorja në vetvete vërtet është një formë analitike, por e pajisur edhe me mjete të pasura eptimore. Po ashtu, sipas tij, në shqipen e sotme janë tri karakteristika formale që e dallojnë lidhoren nga dëftorja: pjesëza *të* për të gjitha kohët, tema e njësuar në të gjitha vetat, mbaresat e veçanta për vetën e dytë dhe të tretë njëjës.

B.Bokshi (2010:65,66), vlerëson se pjesëza *të* e lidhores nuk ishte lidhëz që jepte kuptimin e qëllimit, siç është shprehur Sandfeldi. Me origjinën e saj përemërore, ajo ishte indiferente ndaj kuptimeve të trashëguara të lidhores së lashtë dhe u bë lidhëz e funksioneve të kufizuara të fjalive të varura të kësaj mënyre. Kështu, për shkak të neutralitetit të tillë, ajo u bë pjesë e pandashme e mënyrës lidhore, d.m.th., u përdor dhe kur lidhorja dilte në funksione të fjalisë së pavarur a kryesore. Format e futurit *do të punoj*, *kam të punoj* dhe format *duhet të punoj* e *mund të punoj* tregojnë se në këtë kohë lidhorja e kishte përfutur pjesëzën *të* në funksione të fjalisë së varur dhe dilte me të vetëm në këto funksione.

B.Rugova (2015:180), thekson se duhet të kemi parasysh karakterin kompleks të lidhores, meqenëse konstruktet foljore që paraqesin mundësi, domosdoshmëri, kushtëzim, dëshirë, lejim, obligim: *mund të punoj*, *duhet të punoj*, *do të punoja*, *do të kisha punuar*, *dua të punoj*, *le të punoj*, *kam për të punuar*, të cilat si nga aspekti strukturor, por edhe nga ai semantik përbëjnë forma të lidhores. Sipas tij, kjo paraqet ndërlikueshmërinë e konceptit të mënyrës në gjuhën shqipe, pasi këto forma nuk janë të përfshira te lidhorja e as si mënyra më vete, por si folje gjysmëndihmëse me vlerë modale, edhe pse si ndërtime e kuptime paraqesin forma të lidhores.

Sipas Topallit (2010:215,217), mënyra lidhore i ka krijuar format kohore sipas formave të dëftores, por ndryshe nga kjo, lidhorja nuk ka krijuar forma për të ardhmen, meqenëse kuptimi kohor i lidhores priret drejt këtij caku kohor. Madje, lidhorja nuk ka krijuar as forma për të kryerën e thjeshtë, as forma për të kryerën e tejshkuar, pasi kuptimi kohor i tyre nuk pajtohet me modalitetin lidhor. Pra, mënyra lidhore shpreh veprime të mundshme, të dëshiruara, të supozuara ose ireale. Ajo mund të shprehë edhe urdhra, lutje, urime, duke zëvendësuar në këto kuptime mënyrën urdhërore dhe dëshiroren.

Kurse, S.Riza (1994:213) pohon se vlerat kryesore që i njihen mënyrës lidhore apo nënrendore përmblihen në idenë e një veprimi të interpretuar ose të paraqitur subjektivisht nga folësi/ja sipas asaj që ky veprim përbën objektin, për shembull të një vendimi, këshillimi, parashikimi, urdhërimi, supozimi, kufizimi, përlejimi. Në anën tjetër, vargëzimi i shtatë funksioneve a vlerave të kësaj mënyre foljore, kurrsesi nuk përbën një përkufizim të saj, sepse në bazën e cilësdo kategori kuptimore duhet vënë një koncept themelor. Përkundrazi, me mënyrën lidhore (nënrendore) folësi/ja shpreh ekzistencën e një objekti të dhënë, përkatësisht ekzistencën e një fenomeni përkatës, kundrejt mënyrave të tjera, me anë të cilave shprehim kryesisht cilësime kufizuese, si: *habi*, *kusht*, *dëshirë*, *urdhër*.

J.Rrota (1943:46), pohon se mënyra lidhore nuk është e shkëputur më vete, por e varur ose e lidhur për ndonjë kusht. Sipas tij, pothuajse në shumicën e herave lidhorja shpreh një mendim si dëshirë ose për një gjë që mund të jetë ose pritët të ndodhë. Si rrjedhim i kësaj, lidhorja shpeshherë përfshin edhe të ardhmen e kushtoren për nga kuptimi që shprehin format e saj. P.sh., *të shkojmë*, *të lexoni*, *të mendojnë*.

Sipas E.Çabejt (1986:109), lidhorja shpreh një veprim eventual, një veprim që pritët të ndodhë, mendohet ose dëshirohet të ndodhë. Gjithashtu, edhe W.Cimochowski (2004:228), vlerëson se lidhorja në gjuhën shqipe shërben kryesisht për të shprehur mundësinë. Sipas tij, përdorimi i kësaj mënyre në fjali shpreh, pothuajse gjithmonë nocionin e mundësisë, ose një veprim që është paramenduar.

I.Ajeti (1978:11,16), paraqet një vështrim mbi përdorimin e lidhore apo koniunktivit në dy kryedialektet e shqipes- toskërishten dhe gegërishten, duke marrë shembujt nga veprat e shkrimtarëve të letërsisë së vjetër, publicistikës, emisionet e radios, teatrit dhe tekstet e nxënësve.

...Për këtë a ka mundësi me ba publikun për vehte dhe me e sjellë kush **të don** dhe kah **të don**, në vend që ta përdorte **kush të dojë** dhe **kah të dojë**... (Rilindja, 1951, nr.74, fq.3)

“...E ai që të **të mallkonjë** të jetë mallkuom... Ngrehu ati em, e na ngajetsë birit tit: për se **të më bekonjë** shpirti i yjt. (I.Rrota, monumenti më i vjetër i gjuhës shqipe: Gjon Buzuku, fq.18, Shkodër, 1938).

“...E mos **të vinjë** fështirë me uruom për muo...” (Pjetër Budi, Shkrimtarë shqiptarë, I, Tiranë, 1941)

“...Mbas të lenjë njeri, hana, ka forcë e ruen ndjerë mbë katër vjet...” (P.Bogdani, Shkrimtarë shqiptarë, I, fq.56).

J.Gjinari (1989:69), në studimin për degëzimin historik të dialekteve të shqipes paraqet veçoritë e hershme që dallojnë dialektet, ndër të cilat përmend edhe lidhoren, e cila në dialektin e toskërishtes kryen funksionin e paskajores geqe, p.sh., *me punu-të punoj*, që konsiderohet njëra prej dallimeve relevante e absolute ndërmjet gegërishtes dhe toskërishtes

Lidhur me këtë, albanologu R.Ismajli (2003:53), vlerëson se funksionet sintaksore të paskajores në toskërishten dhe në gjuhën standarde i rimerr lidhorja, të cilën e ka edhe gegërishtja. Sipas tij, shqipja standarde ashtu si toskërishtja, për shkak se nuk e ka paskajoren e tipit *me punue*, i përdor format e lidhore ndjeshëm më dendur, ndërsa gegërishtja përmes përdorimeve shumë më të dendura të paskajores që ka zhvilluar mundësitë stërholluar të shprehjes sintaksore dhe stilistike në këtë drejtim.

Shembuj:

Duhet **me** punue, pra. Do gjetë ilaçi i kësaj sëmundjeje.

Punon **pa** ia ditë për nder. Mos u nis **pa** u **pa me** mue.

Pra, fjalëzat **pa** dhe **me** funksionojnë si opozita, mirëpo parafjala **me** u bë pjesë e paskajores.

S.Riza (1994:215), paraqet dallimin e përdorimit të lidhore dhe paskajores midis toskërishtes dhe gegërishtes.

Dëshiroj që mbasi të kem mbushë moshën madhore **të lejohem me sprovue** forcat...

Ti **të punosh**: do të punosh dhe do me punue. E di se kam me shkue, por a **të shkoj** se?

Sipas Gj.Shkurtajt (2010:156), trajtat e foljeve në dialektet e shqipes paraqesin dallimet që spikatin më tepër në sistemin gramatikor. Duhet përmendur praninë e disa formave foljore, si: paskajorja e tipit *me+pjesore* (*me shkue, me marrë, me pru, me vjelë*), në gegërishten dhe mungesa e saj, përkatësisht humbja e saj në toskërishten.

Sipas N.Veselajt (2000:14,18), veta e parë njëjës e së tashmes së lidhore e ndërtuar të+dëftore *të punoj* karakterizohet si trajtë sinonimike përfaqësuese barasvlerëse ndaj paskajores së mirëfilltë, trajta e vetës së dytë të njëjësit të së tashmes së kësaj mënyre *të punosh* konsiderohet kryesisht si trajtë zëvendësuese e konceptit të paskajores. Si duket, një rol të tillë ia ngallmuan gramatikanët tanë, të cilët duke e ndjerë mungesën e paskajores në standard, në kërkim të një barasvlerësi sa më adekuat mes trajtave të lidhore ndaj konceptit të paskajores së anashkaluar, si përkim sinonimik si më të përshtatshëm ndër trajtat e tjera të lidhore krahaso: *të punoj, të punosh, të punojë, të punojmë, të punoni, të punojnë*, shenjuan apo ngarkuan vetën e dytë të njëjësit të lidhore *të punosh*, ndaj paskajores së mirëfilltë të përjashtuar: *të punosh-me punue*, që *të kesh-për me pasë*. Duke vepruar kështu sipas urdhër-direktivave imponuese, sipas tyre, gjetën zgjidhjen më të përshtatshme të ndihmuar nga

Materialet e punimeve (proceedings)

ISBN: 978-1-78911-007-4

logjika, mbase edhe nga prirja që mund të kenë vërejtur, sepse, vërtet trajta e vetës së dytë të njëjësit të së tashmës së lidhore rrah më shumë drejt konceptit të paskajores: *të punosh-me punue*, që *të kesh-për me pasë*, në fjalë të urta e kontekste të tjera, prandaj stimuloan këtë trajtë: *të punosh, të kesh*, duke i dhënë doza abstraksioni dhe me këtë u përpoqën me krijue një trajtë të barasvlershme ndaj zëvendësimit të nocioneve për shkak të mungesës së realitetin gjuhësor të paskajores së mirëfilltë. Krahaso fjali-periodhën në dy versionet me paskajore dhe me lidhore:

Duhet me punue për me pasë (për të pasë) një të ardhme më të mirë; Duhet të punosh që të kesh (për të pasur) një të ardhme më të mirë.

Pra, edhe varianti me lidhore (veta e dytë njëjës) ishte dhe është pronë e dy dialekteve, prandaj siç e thamë me këtë u përforcua destinim-zbatimi me këtë sqarim: “Kjo vetë e dytë e së tashmës së lidhore (*të punosh, të kesh*) i ka këputur lidhjet kuptimore me vetën e dytë dhe funksionalisht del në basvlerësi të plotë me paskajoren gege”.

2.1. Përdorimi i lidhore dhe paskajores

Dallojmë edhe çështje zëvendësimi në idioma, fjalë të urta, përgjithësisht në frazeologji, si dhe vargëzim çështjesh ndërzëvendësuese, sfidime ndërkëmbimi të treshit sinonimik: emër-paskajore-lidhore. Shembuj:

1. *Mësim, mësim dhe vetëm mësim;/Me mësuë, me mësuë dhe vetëm me mësuë;/Të mësosh, të mësosh dhe vetëm të mësosh!*

2. *Durim, durim-shpëtim;/Shumë me durue për me shpëtue;/Me durue, me durue-me shpëtue;/ Duro, duro-shpëto;/ Shumë të durosh që të shpëtosh!*

3. *Të punuarit (puna) është nder;/Me punue është nder;/Të punosh është nder.*

4. *Detyra e nxënësit:mësim e dëgjueshmëri;/Detyra e nxënësit:me mësuë dhe me ndëgjue;/ Detyra e nxënësit:të mësojë dhe të dëgjojë.*

Pjesë të korpusit hulumtues kemi edhe poezinë “Paskajore” shkruar nga Sabri Hamiti në vitin 2002.

Në këtë poezi janë përdorur trajtat foljore në variantin dialektor, më saktësisht, në dialektin e gegërishtes. Struktura e formave foljore, më saktësisht lidhorja dhe paskajorja shprehen me forma dialektore, të cilat kryesisht dalin me folje ndihmëse *kam* e *jam*, si dhe me trajta të pashtjelluara foljore: me foljen *kam+paskajorja gege (kam me të dashtë)*; me foljen *jam/është+paskajorja gege (asht me shkue)*; me foljen *due+e tashmja e lidhore (due+të vdes)*, me pjesëzën *do+paskajorja gege (do me thanë)*; me paskajoren gege (*me pasë, me shkue, me mendue, me mbetë, me rrokë, me i thanë, me dashunue, me e puthë, me u ngutë, me u derdhë, me vdekë*).

Përfundime

Përgjatë këtij punimi qartazi kuptojmë se lidhorja pa rezervë është e pranuar si mënyrë në sistemin foljor të shqipes, krahas mënyrave të tjera. Mirëpo, historikisht, ajo paraqet një trajtë mënyrore shumëdimensionale, si për nga ndërtimi ashtu edhe për nga kuptimi e përdorimi.

Sa i përket ndërtimit të lidhore, ka përafëri me trajtat e dëftores, përveç pjesëzës *të*, me të cilën u kundërvihet mënyrave tjera. Mirëpo, lidhur me pjesëzën *të* ka hipoteza për përcaktimin e saj si pjesëz gramatikore, duke e kategorizuar herë si lidhëz, përemër, fjalëz, tregues gramatikor.

Historikisht, zanafilla e kuptimit të lidhore është e paqartë, pasi ka mendime se me anë të formave të lidhore shprehim vullnetin (*voluntativ*), të ardhmen (*deliberativ*) dhe

parashikimin (*prospektiv*). Kuptimisht, lidhorja paraqet ndërthurje modalitetesh me trajtat e saj, të cilat kur shoqërohen me foljet modale shprehin mundësi, domosdoshmëri, obligim, lejim, kufizim, dëshirë, kusht. Siç shihet, ende është i paqartë kuptimi zanafillës i lidhores, sikurse burimi i saj në indoevropianishte.

Lidhorja përdoret dendur në gjuhën e folur e të shkruar, siç e pamë edhe nga shembujt. Në rrafsh sintaksor përdoret, kryesisht, në fjalitë e pavarura-bashkërenditëse, por edhe në ato të varura-nënrenditëse gjen mjaft përdorim. Kurse, në rrafsh morfologjik format e lidhores zëvendësojnë format e paskajores, veçanërisht në gjuhën standarde.

Referencat

- Ajeti, Idriz. (1978). *Studime gjuhësore*. Prishtinë: Rilindja.
- Beci, Bahri. (2016). *Struktura dialektore e shqipes*. Tiranë: UET Press.
- Bokshi, Besim (2010). *Periodizimi i ndryshimeve morfologjike*. Prishtinë: ASHAK.
- Cimochowski, Waclaw. (2004). *Për gjuhën shqipe*. Prishtinë: ASHAK.
- Çabej, Eqrem. (1986). *Studime gjuhësore VII*. Prishtinë: Rilindja.
- Çeliku, Mehmet. (1968). *Mbi grupimin e të folmeve të gegërishtes jugore dhe mbi disa tipare të tyre*. Prishtinë: Studime filologjike 3.
- Demiraj, Shaban. (1988). *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*. Tiranë: Rilindja.
- Ismajli, Rexhep. (2003). *Standarde dhe identitete*. Pejë: Dukagjini.
- Gjinari, Jorgji. (1989). *Dialektet e gjuhës shqipe*. Tiranë: Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë.
- Likaj, Ethem. (2015). *Zhvillime të mjeteve gramatikore të shqipes*. ASHSH.
- Riza, Selman. (1994). *Sistemi foljor i letrarishtes shqiptare bashkëkohore*. Tiranë: ASHSH
- Rugova Bardh, Sejdiu-Rugova Linditë. (2015). *Hyrje në gramatikën e tekstit të gjuhës shqipe*. Prishtinë: Trembelat.
- Rrota, Justin. (1943). *Sintaksa e gjuhës shqipe*. Tiranë: Biblioteka Françeskane “Gjergj Fishta”.
- Shkurtaç, Gjovalin. (2010). *Shqipja e sotme*. Tiranë: U.F.O Press
- Topalli, Koleç. (2010). *Sistemi foljor i gjuhës shqipe*. Tiranë: QSA/IGJL.
- Veselaj, Nuhi. (2000). *Paskajorja-çështje e shqipes standarde*. Prishtinë: Dardania Sacra.

*Fjala e rrallë e popullit burim i pashtershëm për pasurimin e gjuhës shqipe-
krahina e Postribës*

MAJLINDA BUSHAJ
Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”

Abstrakt

Vitet e fundit gjurmimi i fjalëve e i shprehjeve popullore ka rënë. Ka marrë përparësi fjalëformimi dhe huazimi. Në gjuhën e popullit gjenden, jo vetëm fjalë të rralla, por edhe kuptime të reja me të cilat ndërtohen shumë fjalë e njësi frazeologjike. Fjalë të tilla sjellin ngjyrimet e ndryshme emocionale, përdorime të llojllojshme e shprehësi të lartë. Klasat më të pasura të fjalëve janë ato që lidhen me veçoritë e punës, të jetesës, të natyrës e të zhvillimit shoqëror-kulturor të folësve. Objekt i këtij studimi është leksiku i Postribës me veçoritë e tij, kryesisht fjalët që nuk paraqiten të regjistruara në fjalorët e gjuhës shqipe, apo në studime të veçanta, ose që sjellin kuptime të reja. Rëndësia e kësaj zone qëndron në disa aspekte. Së pari kjo lidhet me historinë, trashëgiminë dhe kulturën, afërsinë me qytetin e Shkodrës. Postriba ka pozitë gjeostrategjike shumë të rëndësishme. Kjo zonë lidh Shkodrën me zonën turistike të Thethit dhe komunat e Dukagjinit me zonën e Shllakut. **Objekt i këtij studimi** janë prurje të veçanta dialektore të kësaj zone të mbledhura në terren kohët e fundit në fushën e leksikut. Fushat ku jam ndalur:

- a) **Terminologjia bujqësore:** Fjalët që lidhen me **bujkun**, me **tokën**, me **mënyrën e punimit** të saj janë të shumta dhe të larmishme, si: *vangë, tun, treçinish, shpor* etj. Veglat dhe almiset janë tregues të një tradite të lashtë bujqësore.
- b) **Termet e botës bimore** përbëjnë një grup mjaft të pasur. p.sh. për rrushin: **larúshk**, rrush **rrezina**,
- c) **Terminologjia blegtorale:** Emërtesat e kafshëve: Këto dalin në një klasë të gjerë njësisht që është modelore, sistematike dhe semantikiisht të specializuar, që janë mjaft të larmishme si: *bacë, balushe, bardhokë, brenhaptë, gala, gice, keleshë, kuqe, lāca, larushë, rogushë* etj..
- d) Në grupe tematike mund të gruponim edhe disa emra që tregojnë **vegla të punës, paisje shtëpiake, gatimet tradicionale** etj. si: **kryelanë, pulenër, përvlak** etj.

Mbledhja e leksikut nga goja e popullit ka një rëndësi të madhe, sepse vetë struktura kuptimore e fjalëve në gjuhën shqipe paraqet një botë të madhe, të pasur e në lëvizje të pandërprerë. Mbledhja e fjalës së popullit është e përhershme sepse gurra popullore është e pashtershme dhe se dita-ditës ajo pasurohet më lëndë të re.

Fjalë kyçe: *dialekt, Postribë leksik, morfologji, fjalëformim* etj.

Postriba shtrihet në verilindje të qytetit të Shkodrës, në të ashtuquajturën zona e Mbishkodrës. Nën themelet e kësaj zone me emrin Postribë janë rrënojat e një qyteti të lashtë i njohur me emrin Drivast¹⁹². Ky emër paraqet interes të madh për gjuhën shqipe. Shfaqet herët në burimet dokumentare, për të parën herë në shek. VIII dhe si i tillë rreshtohet me ato toponime që me ndërrimet e pësuar gjatë kohëve në gojë të shqiptarëve, shërben për të vërtetuar autoktoninë e tyre në vendin ku banojnë.

Postriba kufizohet në veri me komunën Gruemirë dhe konkretisht me përroin e Vrakës, fshatrat Rrash e Vorfë, në lindje me fshatin Xhan të zonës së Dukagjinit dhe Dajc të bajrakut të Sumës, në jug me zonën e Temal Dushmanit, fshatin Vukaj, Ukbibaj të zonës së Shllakut dhe Bardhaj të komunës Rrethina, në Perendim kufizohet me Hotin e Ri, Grudë e Re, Guci e Re. Banori vendas quhet Postribas/e. Sot në këtë zonë përfshihen 12 fshatra: Boks,

¹⁹² Shih D. Luka *Rreth prejardhjes së emrit Drisht*, në vëllimin “Shkodra në shekuj” II, Shkodër, 1999 dhe *Studime gjuhësore I* (Kontribut për etimologjinë e gjuhës shqipe A-D), Shkodër, 1999, f. 371.

Materialet e punimeve (proceedings)

ISBN: 978-1-78911-007-4

Dragoç, Kullaj, Mes, Myselim, Drisht, Vilzë, Ura e Shtrenjtë, Prekal, Domen, Shakotë dhe Fshati i Ri¹⁹³. Ka një popullsi prej 12000 banorësh. Sipërfaqja e saj është 180 km². Rreth 20% e sipërfaqes së saj shtrihet në fushë. Pjesa tjetër është kodrinore dhe malore. Lartësia e saj më e vogël është në luginën e Shtodrit në 37 m mbi nivelin e detit. Lartësia e saj më e madhe është maja e Cukalit me 1722 m mbi nivelin e detit.

Rëndësia e kësaj zone qëndron në disa aspekte. Së pari kjo lidhet me historinë, trashëgiminë dhe kulturën. Një ndikim të veçantë ka edhe pozicioni gjeografik, larmia e territorit,¹⁹⁴ afërsia me qytetin e Shkodrës. Postriba ka pozitë gjeostrategjike shumë të rëndësishme. Kjo zonë lidh Shkodrën me zonën turistike të Thethit dhe komunat e Dukagjinit me zonën e Shllakut.

Në Postribë ndodhet “Ura e Mesit”, një monument i rrallë me vlera kulturore dhe arkitektonike në Shqipëri. Postriba është një nga krahinat më të vjetra të Veriut. Fshatrat e saj po t’i ndjekim nëpër dokumente na dëshmojnë mjaft herët. Kryet e vendit për nga lashtësia e zë Drishti, kryeqendra e kësaj krahine që, siç shkruan prof. Çabej “Ky emër na shfaqet për herë të parë në shek. VIII të erës sonë, por burimet i ka në kohën më të vjetër”¹⁹⁵. Pastaj dalin me rradhë edhe fshatra të tjera si: *Mesi*, *Domni* (në vitin 1485)¹⁹⁶, *Myselimi* (më 1621)¹⁹⁷, *Ura e Shtrejtë*(më 1685)¹⁹⁸ etj. Si krahinë ka mjaft gjëra karakteristike nga krahinat e tjera. Për këtë gjë H. Koplikaj shkruan: “*Banorët e kësaj krahine ...për kah doket, zakonet e më tepër kah veshja kanë ndryshim prej atyre të vendeve të tjera ...duket se këta banorë...trashëgojnë disa gjëra prej të parëve, qi banojshin këtu, ndoshta prej qytetarëve të Drishtit të dikurshëm.*”¹⁹⁹

Objekt i këtij studimi janë prurjet e kësaj zone në fusha të ndryshme të jetës. Materiali i kësaj kumtese është mbledhur në krejt zonën. Një pjesë e këtyre fjalëve janë të panjohura për studiuesit e gjuhës, ose nuk kanë gjetur pasqyrim në fjalorët e gjuhës shqipe, ose kanë përdorime e kuptime të tjera që nuk gjenden në fjalorët e derisotëm dhe në botime e studime të ndryshme.

Mjerisht, megjithë prurjet e pamohueshme të gjuhës shqipe, disa fjalë nuk janë studiuar si duhet. Kjo duket edhe në fjalorët e shqipes e deri edhe në “Fjalorin e vitit 2006” ku megjithë plotësimet, shtesat dhe përmirësimet e bëra në lëndën që përmban e në

¹⁹³ Kjo ndarje i përket vitit 2015. F. Luli në studimin “E folmja e Postribës” SF 3/1974 përfshin në këtë zonë edhe fshatrat Rrash, Vorfë dhe Sumë. Nga fundi i shekullit XVII e fillimi i shekullit XVIII Postriba ka qenë shumë më e përhapur. Për *Sardenjen, Vjerdhën, Mazrekun, Shllakun, dhe Gushtën*, Frang Bardhi, më 1641 i quan popuj të qytetit të Drishtit. (Relacione për gjendjen e Shqipërisë veriore dhe të mesme vëllimi II) cituar sipas F. Luli SF 3/1974 f. 68.

¹⁹⁴ Malet dhe fusha e gjerë pjellore i japin një pamje të bukur dhe tërheqëse kësaj zone. Kjo zonë ka burime natyrore si lumi Kir, përroi i Mesit, lumi i Vrakës, përroi i Rrasekut, përroi i Rrotaçit në Urë të Shtrenjtë, Shtodri-Myselim.

¹⁹⁵ E. Çabej, *Problemi i autoktonisë së shqiptarëve në dritën e emrave të të vendeve*, Studime rreth historisë së gjuhës shqipe, Tiranë, 1977, f. 15.

¹⁹⁶ *Deferi i regjistrimit të Sanxhakut të Shkodrës*, i vitit 1485, vëllimi I, Tiranë 1974, përkthyer nga Selami Pulaha, f. 362, 405, 398 etj. cituar sipas Simon Pepës, *Gjurmime kulturore*, Shkodër 2000, f.58.

¹⁹⁷ *Relacion mbi gjendjen e Shqipërisë Veriore dhe të Mesme në shek. XVII*, vëllimi II, f. 258, 308, 384.

¹⁹⁸ Pjetër Bogdani, *Cuneus Prophetarum*, I/IV/17, cituar sipas Fran Luli, *Vështrime gjuhësore rreth toponimisë së Postribës dhe të Gruemirës*, “Studime filologjike”, 4, 1976, f. 97. (cituar sipas Simon Pepës, *Gjurmime kulturore*, Shkodër 2000, f.58.).

¹⁹⁹ H. Koplikaj, vep e cituar, po aty nr. 19, 11 prill 1937, f.74.

përpunimin e saj leksikologjik e leksikografik, disa fjalë nuk janë pasqyruar me kuptimin e tyre të plotë. Po ndalemi në ndonjë shembull.

Fjala **rrashqiel**, gjendet në *Fjalorin* e gjuhës shqipe të vitit 1980, pa shpjegim duke iu referuar fjalës **grabujë**. (Fjalor 1980, f.1635). Ndërsa fjala **grabujë** “vegël bujqësore me dhëmbë metalikë të kthyer dhe me një bisht të gjatë prej druri, që shërben për të mbledhur barin, kashtën etj. krehër, dhëmbës. (Fjalor 1980, f.567). Në zonën e Postrribës *rrashqielet* janë të llojeve të ndryshme: a) rrashqiel druri për mbjellje duhani e kallomoqi, b)rrashqiel sane për të mbledhë sanë. Ndërsa **grabuja** ka kuptimin e një vegle bujqësore që përdoret për pastrimin e tokës gjatë punimit, ajo ka tre ose katër dhëmbë në dallim me rrashqelin, i cili ka mbi 15 dhëmbë, shërben si masë për drejtim dhe vendosje largësie gjatë mbjelljes.

Fjala **bótë** në *Fjalorin* e 1980, përveç dhjetë kuptimeve të tjera, ka edhe shpjegimin “një lloj deltine me ngjyrë përhimë në të bardhë, që përdoret në disa krahina për të larë kokën ose rrobat; lloj deltine që përdoret për të bërë enë, për të lyer muret” (Fjalor 1980:169) në *Fjalorin* e 2006 f.105 gjejmë shpjegimin bótë “baltë e përhimë në të bardhë; deltinë”. Në këtë të folme fjala **botë** ka kuptimin “lloj balte dheu me ngjyrë të kuqe që shërben për të ndërtuar enë të ndryshme, si dhe në kohët e hershme kur mundonin mjetet e ndërtimit shërbente për mbushjen në vend të llaçit të pjesëve të shtëpisë që ndërtoheshin me thupra,” dhe jo për lyerjen e shtëpive, për larjen e kokës ose të rrobave.

Fjala **çini** gjendet në *fjalorin* e gjuhës shqipe të vitit 2006, f. 300 me dy kuptime “1. Pjatë gjelle, 2. Brokë, kanë” ne kemi ndeshur këtë kuptim “pjatë metalike me lustër që përdoret për qerasje” etj.

Kjo lëndë e gurrës popullore i pasuron njohuritë tona për disa fusha të ndryshme të leksikut, si: bota bota bimore e shtazore, elemente që lidhen me kulturën materiale e shpirtërore me doket, zakonet etj., që e pasurojnë më tej me njësi të tjera leksiko-semantike paradigmaticë e këtyre fushave duke bërë kështu që të zgjerohet më shumë informacioni gjuhësor për botën shqiptare. Po paraqesim disa nga fushat kryesore të fjalëve të mbledhura të kësaj zone.

Veshja mbetet një nga manifestimet më të fuqishme të kulturës popullore. Studimi i saj kontribuon për të ndriçuar disa aspekte me interes në historinë e popullit. Studiuesi Kahreman Ulqini në veprën *Qytetërim e traditë popullore në ecurinë e formimit të kombit shqiptar* shkruan:“...ndonëse *Postrriba gjeografikisht i përket Mbishkodrës, veshja e banorëve të asaj krahine ka më shumë afri me atë të Nënshkodrës*”²⁰⁰. Kjo zonë ka përdorur një tip të veshjeve që ka qenë e ndryshme dhe lehtësisht e dallueshme nga ajo e krahinave të tjera të vendit tonë. Kjo mbështet edhe nga dokumentet e shkruara të asaj kohe. Më 1937 Hashim Kopliku shkruan: “...keta banorë, trashigojnë gjâna prej të parvet, qi banojshin këtu, ndoshta prej qytetarëve të *Drishtit, të dikurshëm, pse shumë doke e zakone ashtu edhe veshje e mbathje nuk përkojnë aspak me të fshqinjëve të tyre të Dukagjinastvet e të malsorvet të Malcis së Madhe.*”²⁰¹ Eljaz Kraja e quan këtë veshje “... origjinale, e lindur, e zhvilluar dhe e ruajtur në këtë zonë, pra është pjesë e trashëgimisë kulturore të popullit tonë.”²⁰² Këtu po paraqesim disa elemente të reja, sepse një studim i plotë është botuar në *Buletin Shkencor*.²⁰³ **Bëthicë-a** “shparga i vogël që u vihej fëmijëve në shpinë për të mos u ftohur, gjatë periudhës së dimrit”; **greshme~t** “punime me grep që bënin gratë në fund të tlinave, për zbukurim”;

²⁰⁰ K. Ulqini, *Qytetërim e traditë popullore në ecurinë e formimit të kombit shqiptar*, Shkodër, 2012, f. 139.

²⁰¹ Hashim Kopliku, *Postrriba* botuar në revistën “Cirka”, Vjeti II, nr.19, 11 Prill 1937 f.74.

²⁰² Shih. Eljaz Kraja, “Kumtari i Muzeut Popullor të Shkodrës”, Shkodër, 1978, f.167.

²⁰³ Shih. *Elemente kulturore në vështrim gjuhësor*, BSHSH, Shkodër, 2013, f. 223-233.

kâmrik~u “copë e bardhë që përdorej për qepjen e veshjes së gruas katundare”; **naplungë** “mjet i punuar me lesh deleje për t’u ngarkuar fëmijët në shpinë, përdorej nga gratë, si formën e *shpargut* por më i ngushtë, quhet ndryshe ngarkojcë”; **kûle** “lloj veshjeje për burra në formën e branavekëve”; **leshenik** “lloj palltoje prej leshi. *Pjeket fiku, veshet lesheniku*”; **râshë** “veshje për gratë malësore, e veshur poshtë fundit me greshme”; **nrî** “copë e punuar në avlëment rreth tri metër e gjatë dhe ka shërbyer për të lidhur fëmijën në djep, për të mos rënë nga djepi”; **pacek** “një jastek i vogël që përdorin gratë nën xhubletë për ta mbajtur atë të hapur” etj.

Blegtoria është mjeshtria kryesore jo vetëm e fshatrave malore, por edhe atyre fushore. Këtu mbizotërojnë bagëtitë e imëta dhe gjedhet. Egziston një numër i madh emërtimesh për këto kafshë. Një pjesë e tyre janë të mbarë shqipes, si nga koha e formimit ashtu edhe nga mënyra e përdorimit, ndaj kanë zënë vend në fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe. Si të tilla ato janë pjesë e trashëgimisë së përbashkët kombëtare. Këto emërtime dalin në një klasë të gjerë njësisht, që është modelore, sistematike dhe semantikisht të specializuar, me nënklasa, grupe e nëngrupe, që gjallojnë si taksonomi tepër interesante e të larmishme. Nga puna në këtë zonë kemi grumbulluar një lëndë gjuhësore me shumë njësi leksikore e fraezologjike, “*nëpërmjet të cilës mund të zbulohen vlera historike, dialektologjike, sociolinguistike, etnolinguistike, etnokulturore, psikologjike, kulturore etj.*”²⁰⁴

Këtu në caqet e një kumtese po paraqesim disa që paraqesin interes leksikor. Me vlerat shënuese, shprehëse, emocionale dhe stilistikore, që këto fjalë bartin i kapërcejnë kufijtë e dialektit. Ndeshim një sasi të madhe të emrave të kafshëve. Një pjesë e madhe e tyre janë emërtime të vëna mbi bazën e ngjyrës, të shenjave me ngjyrë ose të moshës, brirëve etj. Ndër emërtimet e botës shtazore del një pasqyrë e larmishme e emërtimeve të bagëtive të imëta e të trasha. Këtu vepron prirja e gjuhës sonë për terma njëfjalësh, mbizotërojnë formimet me ndajshesa ose fjalët e përbëra.

Në këtë zonë gjendet një sasi e madhe emrash për dhi, dele, lopë, kuaj, mushka etj. disa prej të cilave po i japim këtu: **balushe** (=dele me fytyrë të zezë), **bardhok** (= dele e bardhë me veshë të mëdhenj), **bardhushë** (dhi me ngjyrë të bardhë), **balushan** (=dashi pa brirë), **bacan** (dash me brirë i bardhë), **cipërr** (=dhi me gji të vogël), **gale**(= dele me me ngjyra të ndryshme si ngjyra e bardhë me shenja të zeza), **gice**(=dele me ngjyrë të kuqe), **kebésh**(= dhi me brirë të kthyer dhe të mprehta), **krotan**(=dash me brirë të kthyer), **lāca**(=dhi e zezë me të bardhë, ose e kuqe me të bardhë), **rogushë**(=dele e bardhë me brirë), **rrekë**(=dhi me ngjyra të ndryshme, por me rreka nën gushë), **shara** (=dele me pika në fytyrë), **shegë**(=lopë me ngjyrë të kuqremtë), **shtierë**(=qengj njëvjeçar), **shytan** (=dash me brirë pak, ose aspak), **shytë**(=dhi pa brirë), **vidushë**(=dhi me ngjyrë të zezë me dy vija në fytyrë), **majs** (=vath bagëtish në oborr, e rrethuar me gardh), **vonake** (=ajo bagëti që pjell me vonesë), **shytë** (=lopë pa brirë), **kuqlie** (= dhi me trup të kuq), **lashte** (=dhi që pjell herët, më herët se dhitë e tjera), **bojlie** (=dhi e kuqe, ngjyrë vishnje), **shkrove**(=dhi e zezë, turitë e zeza me vija të bardha), **vathe** (= dhi me rreka në qafë), **ballhane** (=dhi me ballin si hana), **kamlie** (=dhi me këmbën me shenja, trupin një ngjyre), **vjedullushe**(=dhi si vjedulla në fytyrë), **kebeshe** (=dhi me ngjyrë krejt të zezë), **thije**(=dhi e thinjur, me ngjyrë të përhimë), **lapotë**(=dhi me veshë të gjatë të mëdhenj), **kaçurrele**(=dhi që ka brirët përpjetë *si puna e cjamin*), **zylyfte** ose **zylyftare**(=ngjyrën e trupit e ka pasur të zakonshme, leshin e madh të qerpikëve dhe të syve strehë), **kuqlie**(=lopë e kuqe), **drena**(= lope) etj.

Disa emra kafshësh lidhen me dallimet në moshë. Kështu p.sh. për dhitë: **ëth** (=nga lindja deri në një vit); **ftuja-ftujaku** (=nga një vjeç deri në dy vjeç); **dhi** (=nga tri vjeç e më

²⁰⁴ Valter Memisha, *Pesha e fjalës shqipe*, Tiranë 2011, f. 46.

Materialet e punimeve (proceedings)

ISBN: 978-1-78911-007-4

shumë); për delet: **qengj** (deri në 1-2 vjeç); **rrunxë** (nga 2 vjeç deri në tri vjeç); **delme** (=tri vjeç e më shumë). Me mjaft interes janë disa shprehje frazeologjike të krijuara mbi bazën e kafshëve si: *i hap sytë si lopa n'brakë* (lopa kur shkon me pi ujë i hap syt shumë se mendon se po i marohet uji)=i hap sytë kot; *më kanë marrë si lopë n'teqe* kur jam martu=pa asgjë, pa pajë etj.

Kemi mbledhur edhe një numër të vogël sëmundjesh që paraqesin interes: **plasa** “sëmundje që prek dhinë, paralizë e tyre”; **flutra** “sëmundje e dhive që shfaqet me këlbazë”; **çala** “infeksion i thundrës së kafshës, p.sh. *u ka ra çala*”; **dybza** “sëmundje që u del edhe shfaqet me puçrra në gojë”; **tatakurte** “sëmundje e kuajve e pashërueshme”; **lija** “sëmundje e pulave”; **glasa** “sëmundje e pulave që shfaqet me dalje jashtë të shpeshta e me dobësi të trupit” etj.

Termat e botës bimore përbëjnë një grup mjaft të pasur. Nga sfera e drurëve, pemëve e bimëve të buta dhe të egra interes leksikor paraqesin emrat e përveçëm të disa variteteve si p.sh. për rrushin: **larúshk** (=rrush i egër me kokrra të vogla dhe të ëmbla. Kokrrën e ka në ngjyrë të murrët); **çelek** (=lloj rrushi, me kokrra të zeza dhe shumë i ëmbël); **shesh** i zi (= lloj rrushi ka hyrë në zonën e Postribës në periudhën e vonë, me ngjyrë të zezë, kokrrën e ka të fortë); rrush **rrezina** (=është pak picigjat edhe ky i langshëm vilin e ban të mujshëm, të langshëm); fik **laraman**: (=fiku *laraman* â me vija, mâ i âmël se të tjerët);fik **kastravec** (= lloj fiku, i madh i ëmbël, me ngjyrë jeshile); fik **sulltan** (=fik që piqet dy herë); fiq **të egjer** (=lloj fiku që shërben për t'ua vënë fiqve bajunë, që të mbajnë i egri është me godit fiqtë e tjerë/vehet për mizë, mos me ra bajuni n'tokë); **pufagaca** (=një lloj si kallomoq i vogël që mbillet në arë dhe shërben për të bërë kokoshka për fëmijët; ndryshe pupagjel); rrush **llazinë** (=ka një cilësi të mirë, rrush i bardhë me kokërr të madhe); **kacube**(= lloj rrushi kokërrmadh); man **kalldrum** (=man kokërrmadh dhe i bardhë); **manakuq** (=man me ngjyrë të kuqe, kokërrvogël dhe shumë i ëmbël); **tharbtushe** (=shegë majahoshe, kokërrmadhe e bardhë. *Kur ka ra flâma â përdor tharbtusha*); fik **puc** (=lloj fiku shumë i pjekur); **toç** (=lloj lakre që shërben për t'u ngrënë e kundërta e lakrës *foragjer* që përdoret nga bagëtia); **dymlek** “lloj pjepni, rumbullak me vija -vija); **våde** (=lloj pjepni me vija të gjata, i ëmbël shumë); **dimnak** (=fik që piqet në periudhën e vonë të vjeshtës, në prag të dimrit); **llup** (=lloj fiku kokërrmadh *â kân i fik kokërrmadh llupi*); **malacak** (=lloj fiku i vogël, *mishkuq, lëkurën e ka të bardhë*); fik **patëllxhan** (=fik me lëkurë të hollë të fortë dhe të ëmbël, me ngjyrën e patëllxhanit); **funça** (=dy tre gjethet e fundit të duhanit quhen funça); **i leti** (=para duhanit të mirë është i lehti, duhan i cili nuk ka as peshë as cilësi të mirë); **majça** (=tre katër gjethet në maje të duhanit quhen *majça*); **zgjedhça** (=dora e dytë e vjeljes së duhanit quhet *zgjedhçë*); **filiz** (=gjethet vjeshtore që prodhon duhani gjatë periudhës së vjeshtës); **tamëlçore** (=bimë mjeksore që shërben për shërimin e disa sëmundjeve, është përdorur edhe për gatimin e lakrorëve të ndryshëm); **therëbuta** (=qumështore. *Laknorin e kena ba me veshljepra, me therëbuta, kampata e tamëlçore*); **kampata** (=bimë mjeksore në formën e këmbës së patës, që shërben edhe për gatim. Del brigjeve të arave në periudhën e pranverës); **njomishtë** (=bari që del pas kositjes së parë quhet *njomishtë*) etj.

Emërtime lojërash si: **shkopecingla** “lodër fëmijësh me dy shkopinj, një shkopi i bie me një tjetër që është më i vogël, cili i hedh më larg, fiton”; **shkopedojkë** “lojë me gurë, gjuajtja e gurëve në një gropë”; **rrasevizë-a** “lojë që bëhet në formën e drejtkëndëshit, i cili ndahet në tre drejtkëndësha më të vogël, i katërti ndahet përgjysmë, luhet me një këmbë të ngritur larg, zhvendoset, në qoftëse ndesh në vizë bën gabim dhe humbet lojën. Luhet me një rrasë prej guri”; **kapuças** “Vendosen 10 kësula dhe lojtarët ndahen në dy grupe ku njëri prej

grupeve fsheh nën kësulë një kokërr unaze (kokërr guzhinete). Kush e gjen kokërrin i këndon këngë ose vargje ofenduese grupit tjetër”; **fashakukë** (=Loja kukafshehtas) etj.

Bie në sy se në këtë grup tematik fjalët e përbëra me zanore lidhëse që kanë emrin si përbërës të parë janë parësore dhe kanë prodhimtari të madhe. Kjo është një dëshmi tjetër që tregon se në të folmet popullore të gjuhës shqipe kanë marrë një zhvillim të madh tipat e fjalëve të përbëra, tek të cilat funksionin përcaktues e kryen përbërësi i parë.

Në grupe tematike mund të gruponim edhe disa emra që tregojnë **vegla të punës, paisje shtëpiake, gatimet tradicionale** etj. p.sh. Ndër emërtimet e gatesave tradicionale mund të veçonim: **kryelanë** “lloj gatimi, bukë kallomoqe me vaj e me djathë, pa ujë pa asgjë”; **kaçimak~u** “gjellë me miell misri që përdorej zakonisht në rastet e mungesës së bukës; një lloj qulli i zier me miell misri të skuqur dhe me dhjamë bagëtishtë, bukë e qullët që bëhej me ujë të valuar”; **pulenër~a** “lloj gatimi e njëjtë me kaçimakun, por dallohet nga ai, sepse për gatimin e kaçimakut mielli skuqet, ndërsa në pulendër ziehet mielli pa u skuqur”; **përvlak** “lloj lakrori me miell të misërt, e ngjashme me qullin”; **lacmac** “qumësht dhe kos të përziara së bashku”; **hardiç** “kokrrat e dëllinjave futeshin në një qyp dhe liheshin rreth 20 ditë. Pastaj pihej lëngu i tyre. Ky lëng përdorej si ilaç popullor për shërimin e disa sëmundjeve” etj.

Ndër emërtimet e **paisjeve shtëpiake** dhe të **enëve të gatimit** mund të veçonim: **bavël** “Arkë prej druri e zbukuruar me një shije të veçantë. Zakonisht në të ruheshin, paja e nuseve të reja dhe objektet me vlerë si: vathë, unazë, varëse etj”; **polis-i** “Dërrasa prej druri të vendosura në mur në formën e rafteve. Zakonisht në kuzhinë ku vendoseshin enët e gatimit. Zakonisht polisi ishte i zbukuruar me piktura dhe simbole të gdhendura”; **tilar~i** “enë e madhe prej druri që shërben për shtypjen e rrushit, para pjekjes së rakisë”; **kroshe** “shportë që shërben për vjeljen e perimeve, të frutave etj.; **çini~ja** “pjtatë metalike me lustër që përdorej për qerasje”; **furrac~i**: “mjeti nga i cili nxjerret buka, ose qyrek për pastrimin e shtëpisë”; **gërrnac~i** “enë që shërbente për të ushqyer kafshët shtëpiake si: macen, qenin etj; mjet që shërben për ndarjen e ushqimit, pa dorezë”; **kacile~ja** “vazo ku hidhen frutat”; **kak~ni** “vendi ku pjeket buka, saç”; **qëth~i** “dërrasë e rrumbullakët me bisht të gjatë në të cilën vihet bruma për të gatuar bukë”; **tollorë~ja** “enë ku ruhet qumështi, përdoret si sinonime e fjalës pogure”; **vegsh** “Enë prej balte të pjekur, zakonisht me një vesh, që përdoret për të zier gjellë; poçe balte vorbë; gjella za zë kjo enë”; **vërrcak~u** “thikë që copëton mishin për ta bërë gati për ta gatuar, ndarja në racione”; **bucak~u** “enë prej druri që shërben për të mbajtur ujë, sa gjysma e bucelës. Bucaku ka një vrimë që mbyllet me shtupë druri”; **ulishte** “vend që shërbente për larjen e rrobave me *fi*, atëherë kur mungonte sapuni” etj.

Emërtimet e **veglave bujqësore**: **cakare~ja** “një copë druri që rrah mbi gurin e mullirit, për të nxjerrë kokrrat e drithit”; **caluk~u**: thes i vogël”; **çangë~a** “zile Dragoçi u vihej kafshëve në qafë”; **kocë**: “shuftrat prej hekuri që bashkojnë të dy kaptellët”; **treçimsh** “grabujë, vegël bujqësore që përdoret për të pastruar tokën, përbëhet prej tre dhëmbëve, nëqoftëse ka katër dhëmbë ajo quhet **katërçimsh**”; **rrakel~i** “vegël bujqësore, me dy cepa, në formën e gërbujës që përdoret për shkarkimin e plehut me zitor, ose për të nxjerrë plehun nga *vathi*”; **pykë~a** “Pyka ka qenë dy llojesh, prej hekuri dhe prej druri. Pyka prej hekuri shërbente për çarjen e druve, ndërsa pyka prej druri shërbente për shtërngimin e veglave të punës si: *kosë*, *shat* etj. E ndeshim të përdorur edhe si shprehje fraezologjike: **ti je pykë**=njeri i pagdhundur; **rrotë pyke** që *s'din gja*=i trashë etj”; **qyrek~u** “quhet lopata, por edhe **qyrek vaditje**=një vegël me bisht të gjatë që shërben për vaditjen e bimëve”; **takmak** “mjet prej druri që shërben për të shtypur ullinjët”; **thumat** “vegël për zhveshjem e misrit në arë”;

tulierë “vegël që shërben për të hapë vrima në dru, tuliera ka qenë deri në 1m e 70 cm lartësi”
kajnac “shul prej druri 30 cm që shërben për të mbyllur derën e shtëpisë” etj.

Mjetet e tezgjahut janë mjaft të larmishme si: **birci** “mjet i tezgjahut, ngreh pëlhurën dhe e mbërthen në gozhdë, gjatë punimit të saj”; **bosht** “shkop i hollë dhe i lëmuar me kujdes. Është më i vogël se furka dhe tjerr lesh të gjatë”; **çerkerk** “shërben për mbledhjen e pambukut dhe e *bân masur*”; **çimart** “mjet prej hekuri që vendoset në pëlhurë, *me ndenjë shtrirë mos me u këput fijet që ban nëpër liq e nëpër shpatë*”; **dervishagaça** “shërbejnë me lidh nënkamcat, mos me e prish pëlhurën”; **druga** “mjet i tezgjahut, është më e madhe se meqiku”; **furkë~a**: “Një lloj shkopi me dy të ndara që shërbente për tjerren e leshit”; **gërhanë** “mjet i avëmentit, që shërben për shprishjen e leshit në formën e krehërit me doreza”; **liqtë** (shumës) “mjet prej druri me madhësi gjysmë metre shërbejnë për futjen e perit. Në liq futet peri i cili ngrehet nga shpata”; **masuri** “kallam i vogël që vendoset në meqik”; **meqik** “dru i vogël, sinonim me drugën”; **ngrehci** “mjet prej druri që shërben për ngrehjen e pëlhurës në avëment”; **shpata** “mjet prej druri me madhësi gjysmë metre, e cila shërben për mbledhjen e penjve të liqve. Penjtë e liqve mblidhen nëpërmjet shpatës”; **shtizat** “kallama prej druri gjysmë metre, *shtyjnë pëlhurën mos me u ngatërru fijet*”; **shuli mrapanik** “mjet prej druri që shërben për të lëshuar pëlhurën gjatë punimit në tezgjah. Ka të njëjën gjatësi me shulin paranik”; **shuli paranik** “mjet prej druri e latuar, një metër e gjysmë e gjatë, me anë të cilit mblidhet pëlhura, gjatë punimit në tezgjah”; **thimca** “pjesë e gërhanës që shërben për të shprishur leshin” etj.

Emërtimet e paisjeve të **kalit, gomarit, mushkës** janë mjaft të pasura. Mund të veçonim fjalë të tilla si: **bëthice** “parimet e kalit total quhen bëthice”; **ele-ja** “shtrati i karrocës lidhet me hekur, copa hekuri në formë l-je të cilat forcojnë karrocën”; **ganxhe** “paisje e parimeve të kalit, shërben për të mos ikur karroca *nelt-poshtë*”; **hebe** “dy të trasta të lidhura së bashku që vihen mushkës”; **kashagi** “mjet hekuri në formën e krehërit që shërben për të gudulisur kalin”; **koshake~ja** “sistemi prej rripash që mban samarin pas trupit të kafshës; **loze-ja** “mjet prej gomës së makinës me gjatësi një metër dhe gjerësi 15 cm që shërben për bazamentin e karrocës, vendoset në qendër të shpinës së kalit për shërbim”; **nallça-t** “këpuçë hekuri, patkoj. *Kali mathet me nallça një her në dy javë*”; **nënbarkëse~ja**: “Secili prej atyre rripave të punuar prej liri ose leshi, që shërben për të lidhur samarin ose shalën e gomarit ose të kalit, mushkut etj”; **nënbishte-ja** “Pjesë e samarit, rrip i mbyllur ku futet bishti i kalit”; **nëngojëz~a** “hallka prej metali ose prej litari që shtërngon gojën e kafshës”; **qafore** “beze e mbushur me lesh dhije në vend të pambukut, për të mbajtur parimet e kalit”; **shtrangat** “zingjirë prej hekuri me gjatësi 2 metër, 2 copë, të cilat shërbejnë për tërheqjen e karrocës, për peshë. Ka dy lloj shtrangash, të bëthicës së vogël mbajnë karrocën në **dizhezë**”; **shërbesi** “ndryshe quhet fre-dyzinë, mjet prej hekuri që i vendoset kafshës në gojë për drejtim (kalit)”; **tambure** “Pjesë e paisjes së kalit, copa prej hekuri që shërbejnë për të siguruar guzhinetën për të mos dalë nga vendi”; **ullar** “rrip që shërben për të siguruar kalin në vath, ndryshe quhet kopicë”; **vegie** “një hekur me gjatësi 70 cm i vendosur në karrocë për tërheqjen e karrocës, shërben edhe për kultivator për punimin e tokës”; **sapaj** “mjet i samarit të mushkës për të mbajtur këmbët dhe lidhin barrën që ngarkohet” etj.

Emërtime të **blojës së mullirit** si: **mullis** “person i cili ka drejtuar mullirin”; **koshu** “mjet prej dërrase që shërben për mbajtjen e misrit”; **shokëz** “pjesa e poshtme e mullirit që shërben për të rrotulluar gurin e mullirit”; **plajë** “shtroja e mullirit”; **mullar** “boshti i mullirit”; **pykë** “mjet që shërben për ngritjen e gurit”; **ujem** “haku i punës së mullisit, zakonisht një pjesë miell nga bloja”; **baskaj** “miell i bluar imët ose hollë shumë”; **ndryllç** “kur bluhet hollë mielli i kallamoqit buka bahet *ndryllç*”; **imeterun** “jo imët fort”; **gris** “miell

Materialet e punimeve (proceedings)

ISBN: 978-1-78911-007-4

i bluar trashë”; **burth** “majë metalike e prehur si lapës *a vu me i quk sa mos me tret ujin jashtë*”; **shekza** “mjet që ka shërbyer *për t’ia zvogëluar ujit vendin me dalë me presion me u ra fletëve*”; **pjalmi** “miell i hollë që bie në tavan në formën e tymit” etj.

Në të gjitha këto grupe fjalësh vihet re një mprehtësi e madhe vëzhguese e popullit tonë dhe njëkohësisht një njësi e qartë dhe shumë e qëndrueshme në ndërtimin e emërtimeve sipas parimeve të caktuara.

Një veçori tjetër e këtij leksiku është lindja e kuptimeve të dyta mbi bazën e metaforës e cila ngjet në emra, mbiemra, folje etj. Ky leksik sjell një zgjerim edhe për poliseminë e fjalëve pak a shumë të njohura, duke dhënë për to kuptime e përdorime të veçanta, që nuk pasqyrohen deri tani në fjalorët e gjuhës shqipe të deritanishëm si: **rrakel** “vegël bujqësore”, por edhe **rrakel** “mjet prej druri që shërben për të mbështjellë perin”. Fjala **almise** në FGJSH 2006 ka kuptimin “mjet i thjeshtë pune, vegël bujqësore” (Fjalor 2006, f.37). Në Postribë **almise** quhet parmenda me të gjithë pjesët e saj përbërëse si: dorezën, plorin, shtizën etj. p.sh. *Merr almiset e shko në punë, se duhet dalë pa le dielli*; **Shpor~i**. Përveç kuptimeve në FGJSH kemi: dhë i ngritur në të dyja anët, që shërben për të ndarë arën në disa pjesë, nga ku mund të kalojë lirisht uji për vaditje, p.sh. *Mylli shporin*=përfundoj plotësisht mbjedhjen e një cope toke të një ngastre. Ndarje toke etj. Fjala **mbush** në FGJSH ka kuptimin “shtie diçka në një enë etj” (Fjalor 2006, f.609). Në këtë zonë, *mbush kurtollat* ka kuptimin *prashis për herë të dytë*. Fjala **deng** në fjalorin e gjuhës shqipe del me kuptimin “thes i madh i mbushur plot; rroba mallra etj. të mbështjella të ngjeshura e të lidhura bashkë.” (Fjalor 2006, f. 180). Në këtë të folme del një kuptim i ri, **deng** “Më shumë se një dorëz gjeth i thatë që u vihet bagëtive”. **Dorëz~a** përveç kuptimeve në fjalorin e gjuhës shqipe ndeshim kuptimin “pjesa e parmendës që mban pendari. Është pjesa fundore e parmendës, që shërben për të ruajtur drejtimin e saj, si dhe për të ushtruar një forcë mbi të”; **qëth** “vendi ku gatuhet buka”; **sekondar** “pritë uji”; **toç** “lloj lakre” **gjethe** “mullar me gjethe lisi që përdoren si ushqim për dhitë në dimër”; **kobúre** “koka në majë të preshit që ka farën”; **kocë**: “shuftrat prej hekuri që bashkojnë të dy kaptellët”; **kofshar** “person i cili *grah* kafshët e punës quhet kofshar”; **krástë** “portofol prej lëkure me rryp që vendosej në krah. *Krasta â majt krahqafë me májt lekt át e ka majt vetëm i zoti i shpís tjeterkush jo/nuk ia leju tjetërkujt*”; **lugaç** “njeri i pangopur. *Ça han si lugaç*. *Yyyt lugaç*”; **páftë** “Secila nga dy copat e dërrasave të latuara e me dhëmbëza që përdoren nga barinj të lidhur këmbët e bagëtive kur u thyhen” etj.

Kjo lëndë e mbledhur është edhe një dëshmi për fjalëformimin, për prirjet e zhvillimit të leksikut popullor si dhe për gjallërinë e disa tipave fjalëformues. Në fushën e ndajshesimit bie në sy prodhimtari e formimeve me parashtesa e prapashtesa. Ndër fjalët me parashtesa tërheqin vëmendjen formimet e shumta me nën- si p.sh. **nënbarke** “rripi që shtërngon samarin pas trupit të kafshës”; **nënbishte** “Pjesë e samarit, rrip i mbyllur ku futet bishti i kalit”; **nëngojs** “hallka prej metali ose prej litari që shtërngon gojën e kafshës” etj.

Vlerë të veçantë kanë edhe **kompozitat popullore** si: **biralace** “lloj këpuce me bira”; **bishtpelë** “lloj bari që del në ara”; **brezhaps** “martinel”; **brenhaptë** “dhi me brirë të hapur”; **ballhane** “dhi me ballin e bardhë si hana”; **kampata** “bimë mjeksore në formën e këmbës së patës, që shërben edhe për gatim”; **leshbutë** “lloj deleje me lesh të butë”; **leshrudë** “dele me leshin e shkurtër”; **leshgër** “dele me leshin e egër”; **menemushkë** “kokëfortë”; **mënezi** “xheloz”; **nânloke** “gjyshe”; **bâblok** “gjysh”; **veshlepur** “një lloj bime e vogël, gjethet i ka në formën e veshëve të lepurit, përdoret për lakror”; **trushkul** “budalla, njeri i trashë” etj. Krahas fjalëve të përbëra gjejmë edhe disa fjalë të përngjitura sidomos ndajfolje si: **tehmeteh** “skaj më skaj” etj.

Llojet e ndryshme të fjalëve me ndajshitesa dhe të fjalëve të përbëra e të përngjitura që gjenden në zonën e Postribës tregojnë se sistemi fjalëformues i shqipes letrare mbështetet te gjuha popullore. Kjo lëndë nga gurra e popullit pasuron njohuritë tona për disa njësi leksiko gramatikore si: emrat, mbiemrat, foljet, mbiemrat, ndajfoljet, pasthirrat etj. Në mjaft raste ajo plotëson e zgjeron disa vargje leksikore e fjalëformuese, duke treguar edhe zhvillimin e gjuhës në kohën tonë.

Mjaft emra mund të pasuronin fjalorin e gjuhës shqipe si: **treqimsh** “gërbujë me tre rrema”; **tharbtushe** “lloj shege majahoshe, e tharbët”; **kulloshtër** “lakror për vargun e foljeve *ajkëtor, qumështore* etj”; **brezhapës** “mjet prej hekuri që shërben për hapjen e vijave. Quhet ndryshe martinel”; **gojaçe/e** “njeri që nuk i pushon goja së foluri”; **majçe** “degë të thata që vendosen në vend të pemëve për të mbajtur hardhinë; kreve; shalqinor”; **tamëlçore** “bimë mjeksore që shërben për shërimin e disa sëmundjeve, është përdorur edhe për gatimin e lakrorëve të ndryshëm” **milcë** “një lloj barishteje *ka një aromë të brendshme, për të pasur prodhimtari qumështit, grihej dhe përzihej me kripë dhe u jepej bagëtive* etj.

Një vend të veçantë zënë emrat jofoljorë që emërtojnë njerëzit sipas punës që merren apo sipas, sendit që emërtojnë si: **vegtare** “grua që punon në tezgjah, end pëlhutën”; **gjamtar/e** “person i cili vajton të vdekurin”; **fushatare** “grua që punon tokën”; **pikatore** “grua e zgjuar shumë”; **nânloke** “gjyshe”; **bâblok** “gjyshi”; **vonake** “ajo bagëti që pjell me vonesë”; **kaj** “lulet që nxjerr bima e arrës quhet kaj”. *Sa shumë kajt paska njikja arra*; **cepore** “dhi që ka thyer njërin brirë” etj.

Edhe ndër emrat prejfoljorë që shënojnë njeriun a vepruesin ka mjaft të tillë që nuk pasqyrohen në fjalorët e gjuhës shqipe si: **ngarkojsë** “një copë prej leshi që vihej në shpinë për të ngarkuar diçka, zakonisht nënat lidhnin fëmijët e vegjël, quhej ndryshe edhe **naplungë**”; **qethtar** “njeri që qeth bagëtinë”; **mjelcaku** “personi që mjel bagëtinë”; **lëmojsë** “vegël që shërben për të lëmuar bishtat e veglave bujqësore”; **kapërcyesi** “dru që vihet në hendeqe për të kaluar”; **njomishtë** “bari që del pas kositjes së parë quhet njomishtë”; **qirojse** “mjet që shërben për të zhveshur kallamoqin” etj.

Ndër mbiemrat mund të përmendim një varg mbiemrash që mund të emërzohen si: **shtiake** “grua që shtihet”; në këtë të folme ka mjaft mbiemra të formuar në mënyra të ndryshme që paraqesin interes si: **menelope** “grua e zgjuar shumë”; **menemushkë**: “kokëfortë”; **thepane** “njeri që i bluan mendja gjithçka”; **i bastarduem** “bimë jo e rregullt si bimë” *Kur mjellet toka ka disa bimë që dalin të bastardhume*” etj.

Populli i këtij areali përdor mjaft folje, të formuara me parashtesa ose me prapashtesa, si dhe me parashtesa e prapashtesa njëkohësisht: **brushit** “folje, grij me brushë” **maqnoj** “përdoret për bagëtinë = bie në gj, p.sh. *ka manquë bagtia se nuk e ke mjel mirë*”; **shtërpnu** “kur nuk lidh kokrra bima. *Bima ka dalë shtërpë, ka shtërpnu nuk ka lidh kokrra*” capit “çabzit” etj.

Përemri. Tek brezi i vjetër ndeshim trajta të vjetra përemrash dëftorë që paraqesin interes, si: **jekso, qeksi, njesi, jesi, qeso, njaso, qaso** etj. Në gjinore-dhanore-rrjedhore përemrat ndiqen nga pjesëza -na: **ktina, atina, ksajna, asajna, njektina, jektina**, etj.

Ndajfolja. Ka një larmi të madhe të llojeve të ndryshme. Po paraqesin disa që janë më tipike. Vendi: **qatje, njaty, qaty, atynej, qetynej, askunej, ktunej** etj. Kohe: **parahej, përparanej, itash, masanej**, etj. Mënyre: **qekshtu, njekshtu, qashtu, jeshunej, kshtunej, njekshtunej, ani, curak, fillak, prej atjehit, s’je kurrkunit, kta tjashtmit** etj.

Një interes të veçantë paraqesin edhe **pasthirrat**. Pasthirrat e gjuhës shqipe, si një pjesë e pa ndryshueshme e ligjëratës kanë hyrë në gramatikën e gjuhës dhe janë trajtuar nga shumë gjuhëtarë, por në pikëpamje dialektore studimet janë të pakta. Mund të veçonim

studimin e Gjovalin Shkurtajt mbi të folmen e Malësisë së Madhe²⁰⁵. Në këtë artikull autori duke trajtuar semantikën dhe kuptimet e veçanta të pasthirmave shkruan “...përderisa pasthirrat janë mjete të gjuhës së folur dhe të dialekteve, studimi i tyre në tërësi sado që është i dëshirueshëm, s’është i mundshëm pasi një punë e tillë do të kërkonte gjurmime e humultime të posaçme në shumë vise...”²⁰⁶ për këtë arsye ne u ndalëm në të folmen e Postribës duke për të lehtësuar punën studiuesve për një nga viset e dialekteve shqipe.

Pasthirrat në këtë të folme janë të njëjta me të folmet e tjerë shqipe, por në disa raste ndryshon semantika e tyre. Kështu që mund të japim një pamje për përdorimet dhe vlerat semantike të atyre pasthirmave që përdoren në këtë të folme. Në grupin e pasthirmave urdhërore paraqesin interes ato me anë të cilave thërrasin kafshët dhe shpendët, i nxisin për punë ose i drejtojnë për kullosë etj. Po japim këtu disa nga pasthirrat e përdorura në këtë zonë duke dhënë edhe sqarimet përkatëse me shembuj.

Isha ha ha haaaj: Kur duam të trembim hutin i cili vjen e ha zogjtë e vegjël të kllukave, por edhe zogjtë e rritur. Personi e shikon hutin nga largësia dhe e thërret për ta frikësuar dhe për t’iu mos afruar zogjve disa herë derisa huti të jetë larguar. *Isha ha ha haaaj, isha ha ha haaaj, isha ha ha haaaj*; **âsht** “Kjo pasthirmë përdoret për të trembur qenin kur na sulet duke lehur, kur rrëmben ndonjë ushqim etj. Shpesh pas saj vjen edhe ndonjë fjali dëshirore që shpreh mallkim. *âsht he dreq, âsht he t’hangërt dreqi shpirtin* etj. Në Rrasek përdoret pasthirra *çëbi, çëbi, çëbi*”; **kuri na, kuri na, kuri na:** Kur duam ta thërrasim qenin për ta ushqyer përdorim pasthirmën *kuri* e shoqëruar nga pjesëza *na* disa herë”; **o hoja:** *Kur kan kan shku në mal me bagti. O Xhije –o hoja, -A i gjete bagtinë – Jo he të griftë smuna*”; **eh, eh, eh:** Është tigull që ka bërë nusja kur është martuar. *Sa njieri qi ka ardh me falë vajzen ka qa, kan ardh me pru dhántin ka qa derisa kan ik njerzit/kur kán marr pajen ka qa prap/vetem të shtunën mrama ka vu kanen n’gishta/t’dielen a lodh vajza kan qa njerz t’tjerë n’kam t’vajzës. Është përdorur edhe tingulli *iiii, iiii, iiii*”; **çik, çik, çik** “kur duam të thërrasim pulat për t’i ushqyer”; **dog, dog, dog** “kur thërrasim zogjtë e vegjël për t’i ushqyer”; **Ish, ish, ish** “Kur duam të trembim pulat që bëjnë ndonjë dëm ose hyjnë në arat e mbjella. *Ishshsh mori anej, të shiftë kolera*”; **oj hee** “tingull vajtimi, *Ça bane sot locjo, bane dam t’math, oj hee. Ke lan fmi e robin oj hee*”; **ush more:** *ush de ha*, Kur duam të grahim gomarin; **muçi, muçi, muçi** “për të ndjellur gomarin kur është larg”; **pisssst** kape “kur duam t’i lëshojmë qenin dikujt”; **tigi tigi** “për të ndjellë kecat” **ooooç** “për të grahur qetë, **ujsst ka, jeee ka** “për të grahur të dy qetë”; **oj ca ca ca caaa** “për të grahur dhitë në mal” etj.*

Kjo lëndë leksikore është një dëshmi e gjallë e visarit të madh gjuhësor që jeton e vepron në gjirin e popullit të zonës së Postribës dhe të njësisë së gjerë e të thellë të gjuhës sonë kombëtare. Këto fjalë e shprehje popullore, të regjistruara drejtpërdrejt nga goja e folësve hedhin dritë mbi disa veçori të leksikut e të fjalëformimit të kësaj të folmeje dhe janë material i rëndësishëm për dialektologjinë dhe leksikografinë krahinore. Gjithashtu ato tregojnë edhe mundësitë e pasurimit të mëtejshëm të gjuhës sonë letrare kombëtare me fjalë nga gurra popullore. Në fazën e sotme të zhvillimit të gjuhës sonë letrare dialektet ose të folmet janë një burim i gjallë për pasurimin dhe pastrimin e saj, fjalët nga goja e popullit marrin rëndësi për kulturën tonë kombëtare. Fjalët me burim popullor sjellin vlera të reja leksiko-semantike dhe stilistikore. Mjaft prej tyre shënojnë nocione të reja dhe ngjyime të veçanta kuptimore, ndihmojnë për pasurimin dhe pastërtinë e gjuhës për diferencimet

²⁰⁵ Gj. Shkurtajt, *Një vështrim mbi përdorimin e pasthirmave dhe pjesëzave thirrëse në të folmet e Malësisë së madhe*, SF 1,1972, f.113-126.

²⁰⁶ Gj. Shkurtajt, *Një vështrim mbi përdorimin e pasthirmave dhe pjesëzave thirrëse në të folmet e Malësisë së madhe*, SF 1,1972, f.113.

Materialet e punimeve (proceedings)

ISBN: 978-1-78911-007-4

kuptimore dhe stilistike për shqipërimin e terminologjisë e për larminë e mjeteve leksikore, të sinonimeve të antonimeve etj.

Bibliografia

- AA VV, *Fjalor i gjuhës së sotme shqipe*, bot. i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë (Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë), Tiranë 1980.
- AA VV, *Fjalor i shqipes së sotme*, bot. i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Tiranë 2006.
- Akademia e Shkencave e Shqipërisë, *Gramatikë e gjuhës shqipe*, I Tiranë, 2002.
- K.CIPO, E.ÇABEJ, M.DOMI, A.KRAJINI, O.MYDERRIZI, *Fjalor i gjuhës shqipe*, bot. i Institutit të Shkencave, Tiranë 1954 (rishtypje, bot. Çabej, Tiranë 2005).
- Dialektologjia e gjuhës shqipe*, 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, Tiranë, 1971-2005.
- Gj. Shkurtaç, *Një vështrim mbi përdorimin e pasthërrmave dhe pjesëzave thirrëse në të folmet e Malësisë së madhe*, SF 1, 1972, f.113-126.
- Gj. Shkurtaç, *Pesha e fjalës shqipe*, Tiranë, 2009.
- J. THOMAI, *Leksikologji e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2002.
- J. THOMAI, *Leksiku dialektor e krahinor në shqipen e sotme*, Tiranë 2001.
- V. MEMISHA, *Studime për fjalën shqipe*, Tiranë, 2011.

Veçoritë fonetike-fonologjike të të folmes së Malishevës

PHD (C). QËNDRIM MORINA
Gjimnazi “Hasan Nahi”, Prishtinë

Abstrakt

Ky punim mëton të paraqesë veçoritë fonetike dhe fonologjike të të folmes së Malishevës. Punimi është rezultat i një vëzhgimi në terren, ku përmes incizimeve kemi arritur të kuptojmë format gjuhësore që përdoren. Materialet e incizuara i kemi transkriptuar dhe kanë shërbyer si korpus për të nxjerrë rezultate mbi gjendjen gjuhësore të Malishevës. Punimi, gjithashtu, përbën edhe pjesën teorike, e cila është plotësuar nga autorët që janë marrë më herët këtë çështje, shqiptarë e të huaj.

Përmes këtij hulumtimi do të shqyrtojmë inventarin e fonemave zanore dhe bashkëtingëllore, vlerën fonologjike të gjatësisë së zanoreve, hundorësinë, theksin etj.

Qëllim tjetër i punimit ka qenë që me shembuj konkretë, të nxjerrë nga terreni, të ilustrohen format e ndryshoreve gjuhësore, në mënyrë që të kuptojmë se a arrijnë bashkëbiseduesit të mbajnë qëndrim formal ndaj njëri-tjetrit në situata formale dhe sa janë të kuptueshëm me njëri-tjetrin dhe folësit në rrethinë.

Fjalët kryesore: *E folme, inventar, terren, fonetikë, fonologji, zanore, bashkëtingëllore etj.*

Hyrje

Gjuhëtari i njohur francez Antuan Meje (Antoine Meillet) për dialektologjinë thotë “Nuk ka histori gjuhe pa dialektologji dhe sidomos pa gjeografinë gjuhësore dhe të shënuar mirë”.

Ndërsa për studiuesin polak, Cimohovski “thesari gjuhësor në dialekte është një xeherore e pashtershme të dhënash. Njohja më e thellë e gjuhës shqipe dhe sidomos njohja e fjalësit të saj, varet nga njohja e fjalive që njohin nga dialektet e saj”. (Cimohovski 2004: 25).

Ndryshoret gjuhësore kanë një rëndësi të veçantë gjatë komunikimit njerëzor. Përmes përdorimit të tyre, bashkëfolësit arrijnë të kuptojnë edhe qëndrimin që po mban folësi kundrejt tyre. Shprehjet e ndryshme që përdorim gjatë bisedës na ofrojnë mundësinë të shprehim mirësjellje apo respekt për bashkëfolësin. Prandaj, qëllimi kryesor i këtij punimi është të analizohen ndryshoret gjuhësore (*fonetike-fonologjike*) të të folmes së Malishevës. Përmes të gjeturave në terren, mëtohet t’u jepet përgjigje këtyre pyetjeve:

- *Cilat janë ndryshoret gjuhësore specifike në të folmen e Malishevës?*
- *A ndodh që folësi të mos i zotërojë mirë këto ndryshore në dialekt dhe në standard?*
- *Në cilat tipare tjera dallojnë këto ndryshore nga të folmet tjera të Kosovës?*

Fillimisht do të mundohemi të paraqesim edhe disa të dhëna teorike për çështjen në fjalë. Kemi konsultuar literaturën që kemi pasur në dispozicion nga autorë shqiptarë dhe të huaj, ndërsa për realizimin e hulumtimit kemi zgjedhur si korpus incizimet dhe anketat në grupmosha të ndryshme (15, 30 dhe mbi 55 vjeç). Kjo komunë ka gjithsej 44 fshatra dhe ne kemi anketuar nga një person të moshave të cekura më lartë. Pra, gjatë gjithë hulumtimit kemi anketuar 132 persona. Shembujt janë edhe të bisedave të zakonshme në kafene me miq. Për arsye të ndryshme do t’i paraqesim me iniciale (A, B, C, D) dhe jo me emër e mbiemër.

Përgjithësisht këta fshatra flasin njëjtë, me përjashtim të ndonjë fshati aty-këtu, dhe ne do t'i paraqesim ndryshoret gjuhësore në mënyrë të përgjithshme dhe jo të përsëritura.

1. Të dhëna të përgjithshme për Komunën e Malishevës

Komuna e Malishevës ka një sipërfaqe prej 306.3 km. Ajo kufizohet: në veri me komunën e Klinës dhe të Drenasit, në lindje në komunën e Therandës, në jug me komunën e Therandës dhe të Rahovecit dhe në perëndim me komunën e Rahovecit dhe të Klinës. Qendra komunale e Malishevës, si njësi administrative territoriale, përbëhet prej 39 njësi kadastrale dhe 44 vendbanime, përfshirë këtu edhe vetë qendrën komunale.

Qendër administrative është qyteti i Malishevës, fshatrat janë: Astrazup, Balincë, Banjë, Bellanicë, Berishë, Bubavec, Bubël, Burim, Carrallukë, Damanek, Dragobil, Drenoc, Fshat i Ri, Gajrak, Gullbovc, Gurbardh, Gurishtë, Jancist, Kërvasëri, Kijevë, Lubizhdë, Lladroc, Lladroviq, Llapqevë, Llazicë, Marali, Maxharrë, Mirushë, Mleqan, Ngucat, Pagarushë, Panorc, Plloqicë, Qypevë, Rud, Senik, Shkarashnik, Shkozë, Temeqinë, Terpezë, Terpezë e Poshtme, Turjakë, Vermicë.

Sipas të dhënave statistikore të regjistrimit të popullsisë, supozohet se Malisheva ka mbi 70 mijë banorë.

Që nga regjistrimi i vitit 1971 deri më sot, vlerësohet se popullsia e komunës së Malishevës është rritur për 26,320 banorë ose për 1,010 banorë në vit. Numri i përgjithshëm i familjeve është 8,450, me numër mesatar të anëtarëve për familje 7,7. Përderisa struktura nacionale është 99.9% shqiptarë dhe 0.1% komuniteti RAE. Numri i popullsisë në komunë ka tendencë të rritjes. Që nga regjistrimi i vitit 1971 deri më sot, vlerësohet se popullsia e komunës së Malishevës është rritur për 26,320 banorë ose për 1,010 banorë në vit. Numri i përgjithshëm i familjeve është 8,450, me numër mesatar të anëtarëve për familje 7.7. Përderisa struktura nacionale është 99.9% shqiptarë dhe 0.1% komuniteti RAE. Numri i popullsisë në komunë ka tendencë të rritjes.

Llapushë është nocioni tjetër me të cilin është e njohur një pjesë e madhe e territorit të Komunës së Malishevës. Lashtësia e Malishevës si vendbanim dëshmohet edhe me prezencën e tumës ilire në vetë qendrën e Malishevës, dëshmi kjo që jep të kuptohet se Malisheva ka qenë vendbanim i hershëm ilir bashkë me vendbanimet tjera në komunë, që janë shtrirë përgjatë lumit Mirusha.

2. Ndryshoret gjuhësore

Sipas studiuesit Richard Hudson (2004), një ndryshore gjuhësore është një tërësi alternativash që kanë diçka të përbashkët. Në librin e këtij studiuesi “Sociolinguistika”, ndryshoret gjuhësore klasifikohen sipas nivelit të gjuhës (fonetikë, morfologji, leksik, sintaksë) në të cilat variantet janë *ndryshore*. Pra, sipas Richard A. Hudson, kemi këto lloje të ndryshoreve gjuhësore: fonetike, fonologjike, morfologjike, leksikore, sintaksore etj.

Ndryshore fonetike, në të cilat e njëjta strukturë fonologjike ka sendërtime fonetike të ndryshme. Për shembull, fonema e anglishtes /t/ ka një numër shqiptimesh alternative (mbylltore glotale, mbylltore alveolare, alveolare e aspiruar me zgjidhje frikative dhe kështu me radhë), dhe secili prej tyre vlen si shqiptim i së njëjtës fonemë (Hudson, 2004: 190).

Ndryshore fonologjike, në të cilat e njëjta njësi leksikore ka struktura fonologjike të ndryshme. Edhe për këtë nuk ka diskutim dhe shembujt shkojnë nga ato qëni përkasin një njësie leksikore (p sh. Controversy me theksin në rrokjen e parë ose në rrokjen e dytë) deri në

Materialet e punimeve (proceedings)

ISBN: 978-1-78911-007-4

dallime në shkallë të gjerë që lidhen me klasa të tëra njësisish leksikore, të tipit të tipit të fjalës *house* dhe *happy* me ose pa /h/ (Hudson, 2005: 191).

Me këto që thamë, plotësohet përmbledhja e tipave të ndryshoreve sociolinguistike. Por mbetet fakti që më shunë është studiuar variacioni fonetik dhe ai fonologjik, aë mund t'i quajmë edhe si “*Ndryshore të shqiptimit*”.

Ndryshoret sociolinguistike të japin mundësinë e krahasimeve objektive dhe sasiore midis teksteve dhe kombinohen me mundësitë teknike të regjistrimeve, ato përbëjnë një metodë të shkëlqyer për studimin e ligjërimin të zakonshëm

Në këtë punim do të merremi me ndryshoret fonetike: *a, e, ë, i, o, u, y.*, dhe ato fonologjike, duke përfshirë theksin- që doemos lidhet me gjatësinë e zanoreve, morat, intenzitetin etj.

2.1. E folmja e Malishevës

Objekti themelor i studimit për të folmen e Malishevës përfshin kapitullin e fonetikës, vështruar në rrafshin sinkronik. E folmja e Malishevës përveçohet me tipare që e dallojnë nga të folmet tjera, si në rrafshin fonetik, po ashtu edhe në rrafshin të tjera, khs. *A po dush ujë, a po vish?* (Malishevë) dhe *a po do ujë, a po vjen?* (në të folmet tjera).

Areali dialektor i të folmes së Malishevës paraqet interes për thyerjet e disa fonemave fonetike në përjasje me të folmet tjera të Kosovës. P.sh. në aspektin morfologjik, te foljet supletive: *shoh, jap, bie*, në të kryerën e thjeshtë të vetës së dytë njëjës dalin me format: *pae, dhae, rae*. Shembull tjetër konkret që kemi hasur gjatë incizimeve është edhe te foljet e diatezës pësore-vetvetore, që në pjesën më të madhe të Kosovës dalin format: *vishna, krehna*, etj., në të folmen e Malishevës përdoren format: *veshna, krihna*- por edhe *krehna* etj.

Një tjetër veçori e veçantë e të folmes së Malishevës, në 44 fshatrat e saj, folja **zë** del në format: *nxã, me nxãn, e nxãna, zunã* etj.

Vlen të theksohet se e folmja e Malishevës ka veçori të ngjashme me disa komuna përreth e më pak me disa të tjera. Ngjashmëri më të theksuara ka me të folmen e Suharekës e më pak me atë Gjakovës, Rahovecit e Klinës.

3. Veçoritë e përgjithshme fonetike

Në të folmen e gjuhës shqipe përgjithësisht si dhe në dialektet e saj, dallimet më të mëdha vërehen në fushën e fonetikës. Ndryshimet më të shumta në gjuhën tonë hetohen në realizimin e inventarit të fonemave zanore. Mendoj që mëse miri për ta kuptuar na ndihmon shkoqitja që i kanë bërë kësaj problematike dialektologët e shquar shqiptarë, Jorgji Gjinari dhe Gjovalin Shkurtaç në librin *Dialektologjia*, ku theksojnë: “*Pamja reale e dallimeve të fonemave në inventarin e tyre del ku shihet cdo fonemë në vetvete. Çdo areal ka një invenatar të caktuar fonemash, që e dallon atë nga arealet e tjera dialektore. Asnjë areal nuk e ka gjithë numrin e inventarit të fonemave zanore të të gjitha të folmeve të marra së bashku*”.

Në këtë mes të folmesh, e folmja e Malishevës bën pjesë në arealin e të folmeve me inventarin më të theksuar të fonemave zanore ndërsa theksi në këtë të folme është në morën e parë të këmbës metrike, si për shembull të fjalët: *punë, lumë* etj., ku kemi dy lloj morash: p-u-u-në.

Kështu edhe në të folmen e Malishevës, si në mbarë të folmet e gegërishtes verilindore, theksi zhvendoset nga rrokja e fundit në të parën, si për shembull: *verí-véri, njeríu-njéri*, domethënë ai bie në zanoren nistore.

3.1. Sistemi i fonemave zanoreve

Në të folmen e Malishevës realizohen një numër i konsiderueshëm i fonemave zanore. Vlen të përmendim që në mënyrë rastësore gjatë hulumtimit kemi kuptuar edhe përdorimin e fonemave bashkëtingëllore, edhe pse nuk ishte çështje jona studimore. Nuk është e tepërt të përmendim se kemi 27 fonema bashkëtingëllore, pra mungojnë çiftet q, gj, që janë kthyer në c dhe xh. Q dhe gj, vetëm në të folmet e Preshevës dhe Bujanovcit i dallojnë këto palatale.

3.2. Zanoret

Kryesisht në këtë të folme do të analizojmë zanoret e shqipes në arealin dialektor të Malishevës. Në të folmen e Malishevës kemi zanore të gjata, të shkurtra, zanore gojore, zanore hundore etj. Mbështetur në këtë që thamë, mund ta paraqesim këtë skemë të sistemit të zanoreve, përfshirë këtu natyrisht edhe variantet fonematike:

i:	y:	e:	a:	o:	u:
î	Ý	Ê	Â	Ô	û
ĩ	Ý	Ě	Ǻ		ũ

3.3. Zanorja a

Vokalin **a** të gjatë e ndeshim në të folmen e Malishevës si dhe te folmet e gegërishtes verilindore⁴ në fjalët: vlla:, pla:k, ka:<kau, në këtë të folme del forma kavi, da:rdh, sha:l, kala:, hava:, sefa: etj.

Më poshtë po japim disa fjalë të nxjerra nga të intervistuarit, pa dashur të analizojmë kuptimin e mesazhit, por me theks të veçantë vokalin **a** të gjatë:

A: Vlla:, vlla: por nuk t’falë.

B: Valla:hi pla:ka jem është zojë.

C: Djali lujke poshtë olicës e i thësh bile mos kce havã: o dreq.

D: Ma herët na kanë vjedhë kãvin (kaun, ka:)

3.4. Zanorja e

Me zanoren **e** të gjatë kemi disa emra në këtë të folme: dhe:, fe:, be:, de:g, de:r, dre:k, ke:p, the:rr, etj.

Më poshtë po japim disa shembuj:

A: Gjithmonë e kam pasë një bindje që me fe: e atdhe: nuk ka. Tybe tash janë çoroditë e po folin shka mos ama këto dyja janë të ndame.

B: E ki borxh një dre:k vallahi.

- **C:** Kush bre? Vallahi qekjo që po e thu nuk ka de:r. Qysh po munesh kshtu me thãn?

3.5. Zanorja i

Me zanoren **i** të gjatë kemi gjetur emrat: shpi:, ri:g, li:(lija e ujit), bli:(bliri), ci:k, thi:k, kmi:sh, gurabi:, tepsi: etj.

Shembuj ilustrues:

A: Do me ra shi:

B: Jo bre nuk është për me rã shi

C: Vec nji ri:gë me ra, boll ãsht.

Me zanoren **i** të shkurtër kemi gjetur fjalët: lis, pis, gisht, bisht, trim etj.

Shembuj ilustrues:

A: Dardha ka bisht

B: Ai është pis djâlë, nuk është punë me më dalë përpara e me u bã trim

Zanoren **i** gojore e kemi gjetur te fjalët: livore, livroj, kime (qime), hise, biber etj.

3.6. Zanorja u

Zanoren **u** të gjatë e kemi gjetur te emrat: ku:ll, bu:rr, fu:sh, bu:k, shku:m, dru: etj.

Shembuj ilustrues:

A: Dema, ku:llën që e ka ba, s’e ka bã kush

B: S’kish bu:k te na. Shko n’fu:rr te Elmia në Turjakë.

Me zanoren **u** të shkurtër kemi fjalët: pllug, plum, shkrum etj.

Shembuj ilustrues:

A: Kesh me shkri: plum

B: Buka ish bã shkrum

3.7. Zanorja o

Vokalin **o** të gjatë në të folmen e Malishevës e hasim te fjalët: mo:ll, bo:ll, shko:ll, so:d, dho:m, so:b, go:t, go:j, lo:j, to:j, bo:j, zo:j etj.

Shembuj ilustrues:

A: Prej 8-ve kemi lo:j me Krasniqtë

B: Veni i mirë t’bãn zo:j, veni i keq t’bãn to:j.

3.8. Zanorja ë

Veçoria kryesore e zanores **ë** në të folmen e Malishevës, është kryesisht mostheksimi ose gjysmëtheksimi i saj. Ky tingull karakteristik i gjuhës shqipe sipas masës së ruajtjes, përkatësisht rënies së tij përvec që dallon dy dialektet e gjuhës shqipe, toskërishten, ku ruhet mirë dhe gegërishten, ku në shumë raste ka rënë së përdoruri.

Sipas studiuesit Isuf Musliut (2010), zanorja **ë** në pozicion fundor të fjalëve në këtë të folmeka rënë krejtësisht së përdoruri, kështu që rënia e saj ka shkaktuar zgjatjen e zanores që ndodhet përpara saj, si: djalë, fjalë, shalë, natë, tokë etj.

3.9. Zanorja y

Zanoren **y** të gjatë e kemi hasur te emrat: py:k, cy:k, fty:r, gry:k, dry:, etj.

Shembuj ilustrues:

A: Kur nuk do, mos e lut ma. E ka cy:kën e madhe

B: Dy gisht ãsht kjo fty:r, nuk asht nji hekter

Zanoren y të shkurtër e kemi hasur te fjalët: byk, shyt, rryp, etj.
Shembuj ilustrues:

A: Nji mijë herë i thashë shyt e mos varit se na hupe lojën

B: Kur t’i kryjsh drutë, çoje bykin te shpia e re

3.10. **Hundorësia e zanoreve**

Një ndër fenomenet fonetike që i dallon dy dialektet e gjuhës sonë është edhe nazalizimi i zanoreve, i cili në njërën anë e ka gegërishtja, kurse në anën tjetër i mungon dialektit të jugut, toskërishtes pra. Të folmet e dialektit të gegërishtes i karakterizon hundorëzimi i zanoreve, të cilave në të folmen e toskërishtes i përgjigjen me zanoren *ë* ose me zanore gojore.

Në ligjërimin e Malishevës me hundorësi të lartë shqiptohet zanorja **a** në fjalët: kam (emër), kam (folje); p.sh.: m’u ka pi kâma. Nesër kam me shku në shkollë etj., dhanër, e xhumâ, tâmël, xhâja (a i ki lshu xhân me kullotë; erdhi xhâja etj.

Shembuj të nxjerrë nga anketa:

A: Sa është fitimi për arën që ke mbjellë?

B: Nuk është për me u anku, por nuk ka qaq fitim t’madh, ama atâ (ârën) duhet me punu e mos me lanë batall.

A: Cili është raporti me fqinjët tuaj afër tokës (pronës)?

B: Shkâ me thân! Ata t’vetën, unë temën. Ti tânën, unë temën.

A: A â kjo tokë në emrin e juj?

B: Po. Ky është veni jem. Babë e babgjysh e kanë pâs.

4. **Përfundime**

E folmja e Malishevës paraqet një idiomë dialektore me mjaft interes, e cila përveçohet me tipare të mëvetësishme ligjërimore. Përmes vëzhgimit të drejtpërdrejtë me anketa dhe incizime kemi arritur të kuptojmë se si dalin ndryshoret fonetike (*a, e, ë, i, o, u, y*) dhe fonologjike (theksi, ritmi, intonacioni, mora) në të folmen e Malishevës.

Kemi vërejtur se e folmja e Malishevës bën pjesë në arealin dialektor që ka shumë fonema zanore dhe 27 fonema bashkëtingëllore.

Gjithashtu kemi kuptuar se shqipfolësit e Malishevës përdorin zanore të gjata, të shkruara, gojore, hundore etj. Në këtë mes, e folmja e Malishevës bën pjesë në arealin e të folmeve me inventarin më të theksuar të fonemave zanore ndërsa theksi në këtë të folme është në morën e parë të këmbës metrike, si për shembull të fjalët: *punë, lumë* etj., ku kemi dy lloj morash: *p-u-u-në*.

Kuptuam gjithashtu që ndryshoret gjuhësore kanë një rëndësi të veçantë gjatë komunikimit njerëzor. Përmes përdorimit të tyre, bashkëfolësit arrijnë të kuptojnë edhe qëndrimin që po mban folësi kundrejt tyre. Shprehjet e ndryshme që përdorim gjatë bisedës na ofrojnë mundësinë të shprehim mirësjellje apo respekt për bashkëfolësin.

Gjithashtu arritëm të kuptojmë që në arealin e të folmes së Malishevës, si në të gjitha të folmet e tjera, një ndër fenomenet fonetike që i dallon dy dialektet e gjuhës sonë është edhe nazalizimi i zanoreve, i cili në njërën anë e ka gegërishtja, kurse në anën tjetër i mungon dialektit të jugut, toskërishtes pra. Të folmet e dialektit të gegërishtes i karakterizon hundorëzimi i zanoreve, të cilave në të folmen e toskërishtes i përgjigjen me zanoren *ë* ose me zanore gojore.

Mund të përfundojmë që e folmja e Malishevës është shumë e pasur në leksik dhe shqipfolësit e kësaj komune përdorin forma të ndryshme të komunikimit.

Referencat

- Hudson, Richard (2004). *Sociolinguistika*. Cambridge University Press. (përkth. Mariana Ymeri. Botim i dytë. Tiranë: Dituria.)
- Ajeti, Idriz (1998). *Pamje historike e ligjërimin shqip të Gjakovës në fillim të shekullit XIX*, Vepra 2, ASHAK, Prishtinë.
- Badallaj, Imri (2001). *E folmja e Hasit*, Prishtinë.
- Cimohovski, Vaslav (2004). *Për gjuhën shqipe*, ASHAK, Prishtinë.
- Çabej, Eqrem (1976). *Studime gjuhësore*, Rilindja, Prishtinë.
- Musliu, Isuf (2010). *E folmja e Petreshticës*, Universiteti i Tiranës, Tiranë.
- Demiraj, Shaban (1989). *Gjuha shqipe dhe historia e saj*, Prishtinë.
- Gjinari, Jorgji- Shkurtaç, Gjovalin (2008). *Dialektologjia*, SHBLU, Tiranë.

Zhvillime të reja në shqipe

DR. SC. MIGENA ARLLATI
Universiteti i Evropës Juglindore

Abstrakt

Në këtë punim do të sjell disa vëzhgime lidhur me ndryshimet e “detyruara” nga koha dhe rrethanat e reja shoqërore që po pëson gjuha jonë letrare. Disa prej këtyre ndryshimeve, në rrugë e sipër, po kthehen në prirje të reja të zhvillimit të shqipes.

Pavarësisht përpjekjeve disadekadëshe për njësimin e drejtshkrimit si kërkesë themelore për një gjuhë standarde moderne, natyrshëm shfaqen edhe risitë në zhvillimin e gjuhës së gjallë në të cilën mbështetet gjuha e standardizuar. Sigurisht se gjuhëtarët nuk mund të imponojnë ndryshime në gjuhë por ata mund të drejtojnë vëmendjen në ndryshimet që pëson gjuha me kalimin e kohës, në saje të rrethanave të përgjithshme që ndikojnë në përditshmërinë e jetës, e bashkë me të edhe në të folurit a në të shkruarit. Ndryshimet bëhen qartësisht të dukshme në periudha shndërrimesh të mëdha politike, ekonomike e sociale, siç kanë qenë këto dy dekadat e fundit që nga paslufta në Kosovë, e këto tre dekadat e fundit që nga kthesa politike në Shqipëri.

Përdorimi i fjalëve e ndërtimeve të reja dhe hyrja e tyre në gjuhë, vjen si pasojë e nevojës për t’iu përgjigjur zhvillimit të përgjithshëm ekonomik e shoqëror të vendit në rendin e ri politik dhe në sistemin e ekonomisë së tregut. Prurjet nga fushat e ndryshme të ekonomisë, biznesit, teknologjisë, turizmit, medias, sportit etj., e detyruan shqipen të marrë një numër të madh fjalësh nga gjuhët me të cilat ka marrëdhëniet më të dendura. Po kështu, edhe në fushën e shoqërisë e të kulturës, gjuha u përball me një dyndje përkthimesh nga të gjithë fushat, shpesh herë në përkthime të shpejta, duke e marrë të gatshme fjalën e huaj. Mungesa e terminologjisë së fushave përkatëse apo vonesa e gjuhëtarëve për ofrimin e fjalës përkatëse në shqipe, ka sjellë një dyndje të përdorimit të fjalëve të huaja.

A duhen trajtuar këto probleme në ditët tona, apo ta quajmë se çdo gjë është vendosur një herë e mirë e s’kemi ç’të ndreqim? Probleme ka, prandaj nuk është në dobi të gjuhës të heshtim para tyre.

Fjalët kyçe: *gjuha e gjallë, aspekti vrojtues, rend i ri, fjalë e huaj.*

Duke ditur se gjuha konsiderohet si një organizëm i gjallë i cili ndryshon, pëson, përshtatet e transformohet si pasojë e proceseve me të cilat përballlet një shoqëri, pra folësit e një gjuhe, në kumtesën time do të sjell disa vëzhgime lidhur me ndryshimet e “detyruara” nga koha dhe rrethanat e reja shoqërore që po pëson gjuha letrare shqipe. Sigurisht se disa prej këtyre ndryshimeve, në rrugë e sipër, po kthehen në prirje të reja të zhvillimit të shqipes. Pavarësisht përpjekjeve disadekadëshe për njësimin e drejtshkrimit si kërkesë themelore për një gjuhë standarde moderne, natyrshëm shfaqen edhe risitë në zhvillimin e gjuhës së gjallë në të cilën mbështetet gjuha e standardizuar.

Në proceset e kohës gjuha ecën duke krijuar krijon rrjedhat e saj, dhe për këtë kontribuon një bashkësi e tërë njerëzish që e flasin dhe e shkruajnë. Po këtu përfshihet edhe kontributi i gjuhëtarëve në lëvrimin e saj nga aspekti vrojtues, profesional dhe shkencor, pa harruar kontributin së pari si folës, ashtu si çdo pjesëtar i bashkësisë shqipfolëse.

Sigurisht se gjuhëtarët nuk mund të imponojnë ndryshime në gjuhë por ata mund të drejtojnë vëmendjen në ndryshimet që pëson gjuha me kalimin e kohës, në saje të rrethanave të përgjithshme që ndikojnë në përditshmërinë e jetës, e bashkë me të edhe në të folurit a në të shkruarit. Ndryshimet bëhen qartësisht të dukshme në periudha shndërrimesh të mëdha

politike, ekonomike e sociale, siç kanë qenë këto dy dekadat e fundit që nga paslufta në Kosovë, e këto tre dekadat e fundit që nga kthesa politike në Shqipëri.

Në shqipen e sotme letrare, sidomos në gjuhën e medias, në shtyp, në radio e në television, në zhargonin politik etj., krahas përmbysjes së gjuhës me klishe e me fjalë të zbrazëta, vërehet edhe një “shpërthim neologjik”, një shtim i madh i fjalëve dhe i shprehjeve të reja që sjellin nocione e dukuri të reja të kohës, ngjyresa të reja kuptimore a stilistikore.

Qemal Murati shpreht se fjalëkrijimet e tilla me para e prapashtesa a me përngjitje, me risemantizim etj., janë një pasuri e pallogaritshme për shqipen, që gjuha jonë të mos mbesë në vjetëritë e saj, por të bëhet edhe kjo një gjuhë moderne, si shoqet e saj evropiane²⁰⁷.

Më tej, Murati ndalon në disa fjalëkrijime të qëmtuara në mjetet e informacionit masiv – të shkruara ose të folura:

Absurdistan, agresoj, albanistan, ankimim, armiq siamezë, baltomania, bashkështëpiak, barazitist, barazkonkurrenca, barazlarguar, burra socialist, demodiktatura, deputet i kartolinave, diktaturë punishte, dorëhiqet, dorëmarrje, durmipritur, dypushteti, dufaqësi, emërdhënie, energjizoj, e shembullt, fjalëpeshues, fjalimshkrues, forumokraci, frikësisht, fshesoj, gomari i Trojës, gjerëpërfshirës, gjinekologji politike, gjithëkuptues, gjithnjihet, gjojamesazh, jashtështet, kamatëvonesë, krerucët, krimministër, kryeakademik, kryekurbetçi, kryeqëndrestar, kryerrënja, lëndërisht, malinjisht, manastiri i mendjes, mandatfitues, mbresoi, minipjesës, moralruajtur, nanomafia, nanometër, neorilindas, nismojë, opinionbërje, padobisht, pakshfaqur, parazitgjedhjet, përendimorizëm, përditëve, përkohtë, përshëndoshje, politikëhane, qetësi olimpikë, rastësorët, rifitore, sadopaktë, superfuqizohet, superjetuar, supernjësh, sheshpushim, shfetarizim, shpellar, shumatore, të shembullta, trysnon, thashethembërës, thashethemhapje, vejevijnë, vetëpyetje, vetmorisht, zëvendësdikushi etj.

“Si pasojë e zhvillimit të vrullshëm shoqëror, shqipja e sotme ndodhet para një cunami shpërthyes neologjizmesh, kontaminimesh dialektore dhe strukturash të reja sintaksore. Pikërisht në këtë vorbull neologjie, krahas formimeve të drejta, po krijohen artificialisht e subjektivisht edhe shumë fjalëformime gjuhësisht të padrejta që qarkullojnë në mediat tona dhe e rrezikojnë seriozisht bërthamën e gjuhës sonë”²⁰⁸.

Përdorimi i fjalëve e ndërtimeve të reja dhe hyrja e tyre në gjuhë, vjen si pasojë e nevojës për t’iu përgjigjur zhvillimit të përgjithshëm ekonomik e shoqëror të vendit në rendin e ri politik dhe në sistemin e ekonomisë së tregut. Prurjet nga fushat e ndryshme të ekonomisë, biznesit, teknologjisë, turizmit, medias, sportit etj., e detyruan shqipen të marrë një numër të madh fjalësh nga gjuhët me të cilat ka marrëdhëniet më të dendura.

Po kështu, edhe në fushën e shoqërisë e të kulturës, gjuha përballet me një dyndje përktimesh nga të gjithë fushat, shpesh herë në përktitime të shpejta, duke e marrë të gatshme fjalën e huaj. Mungesa e terminologjisë së fushave përkatëse apo vonesa e gjuhëtarëve për ofrimin e fjalës përkatëse në shqipe, solli një dyndje të përdorimit të fjalëve të huaja.

Për shembull, sot përdoren termat e huaj politikë *lider* e *leadership* të cilat gjithmonë e më shumë po lënë anash fjalët shqipe *drejtues* dhe *udhëheqës* (*partie, organizate...*)

Fjala *kuadër* po lihet në hije nga fjalët: *personel* ose *specialist*.

Leksema *paradë* sot ka mbetur në përdorim kryesisht ushtarak, ndërsa për “paradë mode” ka hyrë *sfilatë* e cila shënon edhe një dukuri të re për shoqërinë tonë.

²⁰⁷ Dr. Qemal Murati, Trajtesa albanologjike, fq. 38.

²⁰⁸ Dr. Qemal Murati, Trajtesa albanologjike, fq. 57.

Materialet e punimeve (proceedings)

ISBN: 978-1-78911-007-4

Fjala *shfaqje* tashmë tingëllon e vjetëruar dhe e gjejmë ngado të zëvendësuar me *spektakël* ose *shou*.

Realizimi artistik i një këngëtarit, që deri vonë është treguar nëpërmjet foljeve: *këndon* apo *vallëzon* ose edhe *ekzekuton*, në ditët tonë është zëvendësuar me: *performon*.

Termi *publicitet* shënon gjithashtu një dukuri të ekonomisë së tregut që nuk njihej më parë dhe nuk përdorej në media, tani gjithkund ka gjetur përdorim në vend të *reklamë*.

Jo vetëm në dhjetëra për të mos thënë qindra leksema vërejmë shmangien e asaj të gjuhës sonë dhe zëvendësimin me një të stilit “modern”. Risi vërehen edhe në zhvleftësimin e mënyrës së fjalëformimit me anë të parashtesave apo prapashtesave. Për shembull, *përmbush në vend të mbush*, *përthellim*, *përngadalësim*, *përqsasje*, *përplotësim*, *përzëvendësim*, *përkujtesë* në vend të *kujtesë etj.*

Edhe formimet me prapashtesat –*im janë* formime të reja: *arsimim*, *ankimim*, *konsumim*. Lemat nga të cilat ka nisur procesi fjalëformues (*arsim*, *ankim*, *konsum*) të japin përshtypjen sikur nuk e përmbushin më mjaftueshëm funksionin e tyre.

Prapashtesa –*najë* si në rastin thashethemnajë, nganjëherë po vendoset vend e pa vend, aq sap o teprohet me fjalëkrijimet e reja me anë të kësaj prapashtese: *zezënajë*, *kulmnajë*, *lulnajë*, *qelqnajë*, *udhënajë*, *trembnajë*, *fshirënajë*. Kjo prapashtese e përhapur në përdorim nga I. Kadareja, tashmë gjendet e përdorur gjerësisht nga shkrimtarët e rinj, jo gjithmonë në sensin e duhur dhe të pranuar të fjalës. Duhet pasur të qartë se dëshira për të sjellë fjalë të reja, nganjëherë po kthehet në një mani të shkrimtarët e rinj, për të krijuar një stil a një gjetje e cila në fakt, bëhen qëllim në vetvete. Varësisht nga kultura gjuhësore dhe niveli i shkrimtarit, krijimet e reja mund të shpërqendrojnë vëmendjen e lexuesit nga teksti. Kur ato nuk mund të integrohen mirë në tekst atëherë jo vetëm se qëllimi artistik nuk është arritur, por bëhet dëm edhe nga ana gjuhësore, për të mos thënë që kthehet në një mani të keqe.

Zhvillime të reja shihen edhe në **strukturën morfologjike**.

Vihet re gjithnjë e më shumë prirja për mospërdorimin e mjeteve gramatikore sintetike ose analitike, karakteristike për ndërtimin e formave gramatikore të fjalëve të shqipes. Kjo dukuri, e cila vërehet sidomos te emrat e më rrallë te foljet, është pasojë e ndikimit të gjuhëve të huaja, por ka raste kur është edhe zhvillim i brendshëm i shqipes. Për shembull, vërehet një ngurtësim në lakimin e emrave tek emrat e përgjithshëm, sidomos ata me fundoret –*e*, –*je*, –*o* në trajtën e shquar. Psh. *i një lule*; *ndaj pajisje të tilla kur janë në përdorim*; *për të marrë një vendim ndaj një mosmarrëveshje*, *Papa vuan një sërë probleme shëndetësore*, *Vazo ishte shekullore*. Në emrat e përveçëm mashkullorë më –*o* kjo prirje duket se po përgjithësohet.

Ndikime nga gjuhët e huaja shihen edhe në rendin e fjalëve në fjalë. Në shqipen e vjetër, rendi i fjalëve në fjalinë kryesore ishte mjaft i lirë, por sidomos në narracion mbizotëronte rendi kallëzues – kryefjalë, siç na e dëshmojnë edhe shembuj nga autorët e vjetër dhe proza e poezia popullore. Përkundrazi, në fjalitë e varura rendi i zakonshëm i shqipes është kallëzues – kryefjalë. Ndërkaq, në ditët e sotme nën ndikimin e gjuhëve të huaja rendi i fjalëve kryefjalë – kallëzues po merr përparësi edhe në fjalitë e varura, kryesisht ffilluese. Gjithmonë e më shumë po dëgjohen ndërtime si: *siç republikanët kanë kërkuar* (nga shtypi i përditshëm), *ashtu siç fqinjët tanë veriorë e jugorë kanë bërë me historinë e tyre*, *gjatë kohës kur tragjedia ndodhi etj.*, prirje që shkon deri në një renditje të panatyrshme të fjalëve, si në rastin: *kur Tani, si të gjithë e thërrisnim ne*, në vend të rendit të zakonshëm: *si e thërrisnim ne të gjithë*.

Vërehet një rend i përmbysur i fjalëve në togfjalësh nën ndikimin e anglishtes, të tipit *contact group*, ku përcaktori vendoset para emrit të përcaktuar, që po shtrihet deri te togfjalëshat me pjesë përbërëse fjalë shqipe, si *Mezuraj Muze*, *Ora Televizion* e deri te *Aldo*

DJ, një formim i kalkuar në mënyrë qesharake, ku emri vetjak i bie të jetë përcaktori i profesionit *DJ*.

Për shkak të prirjes drejt përngjitjes vërehen lëkundje drejtshkrimore në shprehjet e qëndrueshme të tipit *parafjalë + emër* në kallëzore ose rrjedhore. Strukturat me *parafjalë + emër* në kallëzore, që prirjen drejt përngjitjes, përbëhen kryesisht nga *parafjala pa + emër* veprimi më *-im* ose më *-je* në kallëzore, si: *pa dyshim, pa pushim, pa përjashtim, pa kuptim, pa dashje, pa ndërprerje* etj. Në këto struktura vërehet prirja drejt leksikalizimit, drejt humbjes së veçorive morfosintaksore e kuptimore të njëjësive përbërëse.

Këto suksese tuajat, *padyshim* duhet t’i çojmë përpara. (nga shtypi i shkruar). Kjo *padyshim*, është refleksi i asaj dashurie të madhe që kishte mbledhur në zemër. (nga shtypi i shkruar). Është ftohtë, ne marshojmë pa pushim majave, shtigjeve, gërxheve. (nga letërsia artistike). Diçka ka lënë përgjysmë, diçka ia ngacmon *papushim* imagjinatën. (nga shtypi i shkruar). Po dy nga djemtë u prenë rrugën gjoja si *padashje*. (nga letërsia artistike). Izraelitët mitraluan *pandërprerje* rrugën që lidh kryeqytetin libanez me Saindën. (nga shtypi i shkruar).

Të njëjtën dukuri e ndeshim edhe në strukturat analitike *pa masë, pa fund, pa numër*. Për shkak të prirjes së tyre drejt leksikalizimit, në të shkruar po dalin si fjalë të përngjitura. P.sh.: rezultatet e gëzuan *pamasë*. (nga shtypi i shkruar). Janë *panumër* artikujt shkencorë, publicistikë shqip ose në gjuhë të huaj po me autorë shqiptarë, me lëndë nga astronomia. (nga shtypi i shkruar). Maratonë *pafund* mashtrimi (nga shtypi i shkruar).

Lidhur me risitë në sistemin tonë gjuhësor, Kolec Topalli shprehet se disa gjuhëtarë kanë shfaqur mendimin se korrigjimi i disa rregullave të drejtshkrimit mund të krijojë një standard të dytë. Prof. Topalli mendon se kjo është një frikë e kotë, pasi korrigjimi i disa rregullave nuk ka sesi të krijojë një standard të dytë. Ja disa shembuj që profesori na vë në dispozicion: “Deri para pak vitesh, para Kongresit të Drejtshkrimit, shkruhej: *e përgjithëshme, këthenj, punonja, kufinj, libra të reja*; kurse sot shkruajmë: *e përgjithëshme, kthej, punoja, kufij, libra të rinj*. Madje, edhe në referatin kryesor të Kongresit të Drejtshkrimit është shkruar: *ëndërrat, arësye, ka ndjerë, marrëdhënje, ndërgjegja, gjithshka, i pashembëllt, përsa, shumësi tipe* etj.; kurse sot, me korrigjimet që u bënë në Kongres, shkruajmë: *ëndrrat, arsye, ka ndier, marrëdhënie, ndërgjegja, gjithçka, i pashembullt, për sa, shumësi tipa* etj. A mos këto korrigjime çuan në krijimin e një standardi tjetër? Përgjigja është e qartë”.

Deri tani këto përdorime janë konsideruar shmangie nga norma e një gjuhe të zgjedhur, por koha do të tregojë rrugën e mëtejshme të tyre. Këto fakte, që meritojnë studime më të thelluara, flasin për një jetë të pavarur, mbidialektore, të standardit këto dekadat e fundit të zhvillimit të tij. Globalizmi, epoka jonë, Europa e Bashkuar dhe dukuritë e shoqërisë moderne, që po vërshojnë me forcë në shoqërinë shqiptare, kërkojnë fuqizimin e standardit dhe jo krijimin e standardeve të tjera. Shqiptarët e përhapur anekand botës kanë nevojë të bashkohen, të komunikojnë. Europa dhe bota kërkojnë një mjet marrëveshje, një standard. Prandaj përmirësimi dhe zhvillimi i tij, duke përfshirë edhe rishikimin e disa rregullave të drejtshkrimit për të shmangur përjashtimet nga sistemi, është detyrë shkencore e patriotike, përderisa bëhet fjalë për gjuhën e gjithë kombit. Por diskutimi i këtyre problemeve duhet bërë mbi baza shkencore dhe me argumente të mbështetura në ligjet e zhvillimit të gjuhës, pas hulumtimeve të gjata, vrojtimeve dhe studimeve të përimtuara nga specialistë që kanë punuar vite të tëra për të”²⁰⁹.

A duhen trajtuar këto probleme në ditët tona, apo ta quajmë se çdo gjë është vendosur një herë e mirë e s’kemi ç’të ndreqim? Probleme ka, prandaj nuk është në dobi të gjuhës të heshtim para tyre. Evidentimi dhe rregullimi i tyre është i nevojshëm, sepse kjo çon në

²⁰⁹ Kolec Topalli, Drejtshkrimi i shqipes si sistem.

Materialet e punimeve (proceedings)

ISBN: 978-1-78911-007-4

përmirësimin e shqipes. Për ata që mendojnë se nuk duhet rishqyrtuar asgjë në standardin e sotëm, rikujtojmë porosinë e dhënë në Kongresin që vendosi rregullat e tij: “*Struktura e sotme e gjuhës sonë letrare është e hapët e do të mbetet e tillë. Përndryshe zhvillimi i gjuhës letrare do të ndërpritej. Ai që ne quajmë “kristalizimi përfundimtar i normës” në të vërtetë nuk është kurrë përfundimtar, i përjetshëm, statik; ai duhet kuptuar si vendosje e një qëndrueshmërie tipike, por relative të normës, e cila është dinamike, zhvillohet e përsoset*”.

Kodifikimi i gjuhës standarde është planifikim i gjuhëtarëve. Shaban Demiraj thoshte se kjo në të vërtetë është fryt i punës së madhe të disa brezave intelektualësh ku përfshihen shkrimtarë, studiues dhe shkencëtarë të ndryshëm të cilët përcaktuan parimet themelore të kodifikimit. “*E lënë në punë të vet, gjuha njeh veç dialekte*”, thoshte F. De Sosyr.

Në mbarësxhtimin e mekanizmave gjuhësorë duhet punuar me dobi dhe të vendoset rregull në zhvillimet e vetvetishme, të plotësohen zbrazëtitë, të mënjanohej tepritë, të kontrollohen pasojat e kontakteve mes gjuhëve e kulturave.

Emil Lafe me të drejtë pohon se sot problem djegës nuk janë hollësitë e drejtshkrimit e të normës morfologjike (p.sh., a do të shkruhen me –ë fundore emrat mashkullorë, si ballë, djalë, ujë etj.), por ballafaqimi i shqipes me gjuhët e mëdha, veçanërisht me anglishten, në rrafshin leksikor e terminologjik.²¹⁰

Së fundi, citoj thënien e Gëtes: “Secili që flet kujton se mund të flasë edhe mbi gjuhën!” Ndaj, në euforinë anarkike të tranzicionit edhe njëherë theksojmë domosdonë e respektit ndaj gjuhës, e kjo domethënë ngritjen e prestigjit të saj, të lëkundur me pa të drejtë kohët e fundit. Theksojmë se kultura e gjuhës është tipari më i qenësishëm në jetën e njeriut dhe të kombit. Prandaj literatura për gjuhën duhet të studiohet vazhdimisht sepse edhe gjuha u shtrohet ndryshimeve të pandërprera, duhe u zhvilluar dhe pasuruar në mënyrë të pandalshme, zhvillime e ndryshime që duhen bërë në mënyrë të kontrolluar.

Literatura:

Anila Omari, *Vështrim mbi disa prirje të gjuhës së sotme letrare.*

Drejtshkrimi i gjuhës shqipe, Akademia e Shkencave, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 1973.

Emil Lafe, *Konferenca shkencore: Shqipja standard dhe shoqëria shqiptare sot*, AShSh, Tiranë, 2003.

Fjalor i gjuhës shqipe, Akademia e Shkencave, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2006.

Gramatika e gjuhës shqipe I, Akademia e Shkencave, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2002.

Gramatikë historike e gjuhës shqipe, Akademia e Shkencave, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2002.

Kolec Topalli, *Drejtshkrimi i shqipes si sistem.*

Qemal Murati, *Trajtesa albanologjike*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 2005.

Shaban Demiraj, *Çështje të sistemit emëror të gjuhës shqipe*, Tiranë, 1972.

²¹⁰ Emil Lafe, Konferenca shkencore: Shqipja standarde dhe shoqëria shqiptare sot, AShSh, Tiranë, 2003

Mitologjia si intertekst në disa vepra të periudhës së Rilindjes

DOC. DR. MERAL SHEHABI-VESELI
Universiteti i Evropës Juglindore-Tetovë

Abstrakt

Mitologjia, si trashëgimi e lashtë dhe e pasur kulturore, vazhdon të krijojë mbështetje në letërsi dhe në art. Koncepti i mitit si hipotekst ka një prezencë të theksuar në krijimtarinë letrare. Ndërsa përpjekjet për të definuar mitin në një formë të caktuar mund të jenë sfiduese, miti shpesh identifikohet si përrallë e rrejshme me personazhe imagjinare. Autorët e periudhës së romantizmit, shpesh largohen nga realiteti duke u kthye drejt disa mënyrave të reja të gjykimit të botës letrare. Autorët romantikë, tërhequr nga magjia dhe pasionet e mitologjisë, përdorën elemente mitologjike për të shprehur emocionet, konceptet dhe idetë e tyre. Në këtë mënyrë, ata krijuan vepra të mahnitshme që shfaqën thellësinë dhe misterin e mitit në një kontekst të ri. Përdorimi i motiveve mitologjike në poezi, prozë dhe dramë nga autorët romantikë shpesh shërbeu si një mjet për të eksploruar thellësitë e shpirtit njerëzor dhe aspektin kulturor, që më pas të përcjellin mesazhe universale. Sipas studiuesve të intertekstualitetit, koncepti i mitit kuptohet si një shembull i arketipit, ku besohet se miti është një hipotekst universal. Kjo do të thotë se çdo mit është rezultat i një miti tjetër, duke krijuar lidhje intertekstuale me mitet e tjera. Mitet në rastin konkret janë më tepër të shprehura në veprën e Naimit “Historia e Skenderbeut” ku përdoret si hipertekst i hipotekstit. Në punim pikaset edhe miti i Psikës, i cili shërben si hipotekst i poemës së De Radës “Këngët e Milosaos”, si edhe miti i Tomorrit, i cili gjen shprehje në përmbledhjen poetike, të Çajupit “Baba Tomorri”. Në këto vepra mitologjia përdoret si tekst parësor dhe kjo mitologji në hipertekstin e saj nuk fiton kuptim të ri por përdoret me po të njëjtin kuptim me atë, mitologjik. Në studim do të përdoret metoda e krahasimit dhe, do të arrijmë në konkluzion se autorët që kanë përfshirë mitin dhe mitologjinë në veprat e tyre, shfaqin një ndërthurje thelbësore mes krijimtarisë së tyre dhe ngjarjeve mitologjike. Në anën tjetër, ky studim do të dëshmojë se kjo lidhje e thellë dhe e qëndrueshme me mitin e bën secilën vepër letrare ta përjetësojë të vjetrën në një kontekst të ri.

Fjalët çelës: *Interteksti, Mitologjia, De Rada, Naimi, Hipoteksti.*

Hyrje

Mitet në përgjithësi, janë përralla që shumë autorë i fusin në tekstet e tyre, për të arritur qëllime të caktuara. Mitet që dominojnë në këtë periudhë sipas R. Qoses janë të kushtëzuara nga situata historike. R. Qosja dëshmon që poetët romantikë “*duke u përpjekur ta poetizojnë sa më tepër historinë, ata, vërtet e popullarizojnë, por edhe e vullgarizojnë; duke u përpjekur ta bëjnë shkencë sa më tepër poezinë, ata e historizojnë por edhe e bëjnë publicistike. ...duke shkruar shpesh, me një gjuhë zmadhuese, për origjinën, të kaluarën dhe shëmbëlltyrat historike kombëtare, duke sjell historinë në kufi të krijimtarisë imagjinare, kurse krijimtarinë imagjinare në kufi të historisë, romantikët mitizojnë historinë kombëtare dhe shëmbëlltyrat e saj të shquara...*” (Qosja, 2000, f. 192). Miti, i cili gjen përdorim në veprat letrare nga periudha e romantizmit, sikur, ka qëllime tjera. Këtu miti ka funksionin e bashkimit kombëtar dhe, njëkohësisht ngritjes së vetëdijes kombëtare te shqiptarët. Miti dhe historia në veprat e Naim Frashërit është dominant në masë më të madhe e gjejmë në poemë e tij “Historia e Skenderbeut”, ku duke filluar nga titulli lexuesit i referohet një element që na jep të kuptojmë se hipoteksti i saj është historia dhe miti. Jeronim de Rada është i pari që botoi artikullin rreth origjinës së shqiptarëve “Hyjnizime pellazgjike”, por edhe poemën “Skenderbeu i Pafat”, ku përdoren emrat e personazheve si pikasje për intertekstin. Ata emra, ai i shqipëron duke dashur ta informojë lexuesin se origjinën e tyre duhet kërkuar në

Materialet e punimeve (proceedings)

ISBN: 978-1-78911-007-4

mitologji. Për emrin Tetin ai përdor Deti, për Akilin përdor emrin Aq i lehti etj. S`duhet harruar edhe raporti i marrëdhënieve intertekstuale që romantikët krijojnë me malin e shenjtë Tomorr. Ky mal që është vendi ku jetojnë perenditë, na kujton malin Olimp. Romantikët do të ishin shprehur se Olimbi është krijuar duke parë Tomorrit. Ky mal është shumë i lashtë dhe është dëshmitar i historisë kombëtare. Këtu hyjnitë e shqiptarëve e kanë tempullin e tyre, të cilit i falen jo vetëm shqiptarët por edhe të huajt.

Të preokupuar me çështjen e përçarjes fetare të shqiptarëve, romantikët tanë, duke gjakuar bashkimin kombëtar, afirmojnë mitin e Tomorrit, si vend i shenjtë, si tempull, të cilit i falen shqiptarët e të tri feve.

Miti në poemën e Naimit “Histori e Skenderbeut”

Naim Frashëri, e përdor mitin, por në masë të caktuar. Miti është ambiguitet..kjo lojë interesante kukafshehti mes kuptimit dhe formës përcakton mitin” (Bart, 2016, f. 250). Dialogu letrar me mitologjinë është i dukshëm në shumë në veprat *Qerbelaja*, *Abaz Aliu*, *Istori e Skenderbeut* dhe *Vjersha për mësonjtoret e para*. Në këto vepra mitologjia përdoret si tekst parësor dhe kjo mitologji në hipertekstin nuk fiton kuptim të ri, por ripërdoret kuptimi mitologjik.

“Hipertekstualiteti krijon mundësinë e leximit racional të letërsisë, mundësinë e leximit të dy a më shumë teksteve në relacion me njëri-tjetrin. Kjo mënyrë e punës i afrohet asaj që në mënyrë më të lirë do të quhej strukturalizëm i hapur, që u përgjigjet studimeve të mitologut të njohur Levi-Strosit.” (Stros, Mitologjike I,II,III, 2011) Bazuar në këtë tezë na mundësohet të themi se një mit ndihmon të lexohet më mirë dhe më qartë një mit tjetër.

“Trajtimi i temës historike në letërsi, e posaçërisht në poezi, është i lidhur ngushtë me lëndën mitologjike në kuadër të saj. Në letërsinë tonë të sotme, ashtu sikurse në letërsitë e tjera të Ballkanit, historia shumë herë vepron si mit, kurse miti si histori. Sa herë që poetët tanë e kalojnë pragun e Rilindjes Kombëtare dhe futen në epokë më të hershme, historike” thekson A. Uçi në studimin e tij mbi “Marrëdhëniet midis mitit, folklorit dhe letërsisë” e ndiejnë të nevojshme të aktivizojnë motive, figura dhe elemente tjera mitologjike. Aktualizimi i miteve sikundër edhe i ngjajeve dhe i veprimeve historike, nënkupton përpunimin dhe rikrijimin e tyre, në përkim me frymën, idetë dhe ndjeshmërinë e kohës dhe të mjedisit, të cilit i përket krijuesi, sepse “aktualizimi i vërtetë i lëndës mitologjike kërkon që të ndryshohet, të modifikohet të përpunohet të rikrijohet lënda mitologjike në përputhje me pikësynimet e reja krijuese të artistit, me përpyetje për t`u integruar në një kontekst të ri jetësor.” (Vinca, 1997, f. 293)

Heroi kombëtar Skenderbeu në poemën e Naimit, “Histori e Skenderbeut” përveç që cilësohet si hero historik, ai përmbush edhe kërkesat e komunikimit implicit me mitin. Edhe pse, ky komunikim duket pjesërisht në poemë, përsëri mund të thuhet që është i pranishëm në disa këngë. Dialogun letrar me mitin e hasim në disa ngjarje që mund të duken edhe fantastike në poemë:

Ëndrra e nënës së Skenderbeut që do të lind një dragua,

Ngritja në qiell e Skenderbeut që njëkohësisht aludon në heronjtë antik Odiseun,
Eneun

Ringjallja e babait të Skenderbeut, Gjonit dhe kalimi i tij në fantazmë.

Ëndrra e nënës së Skenderbeut për lindjen e heroit kombëtar paraqet një formë të dialogëzmit me mitin, pasi besimi në ëndërr dhe lindja e draguas është tepër mitike. Kjo lindje paraqitet si lindje e jashtëzakonshme. Ngritja e ëndërruar e Skenderbeut në qiell, që ngjason me heronjtë antik Odiseun, Eneun, të cilët arritën në botën e nëndheshme, këto ngjarje poashtu cilësohet si tepër mitike. Ngjitja e heroit kombëtar në qiell paraqitet në këngën e XII:

Materialet e punimeve (proceedings)

ISBN: 978-1-78911-007-4

“Mëndja kishte fluturuar,
Me krahë të lehtë shumë,
Skenderbeu ish qetuar
as xgjuar`ish as në gjumë”

(Frashëri, Vepra 3, *Histori e Skenderbeut*, 1986, f. 180)

Relacioni intertekstual këtu paraqitet në formë të aluzionit. Aluzioni është raport i fshehur ndërtekstor sipas *Pierr Fontanier*, ose mund të thuhet se aluzioni letrar është lojë fjalësh ku lexuesi duhet të kuptojë atë që autori dëshiron t'ia thotë, pa ia thënë haptas. Në (këngën e XII), Skenderbeu i udhëhequr nga ëngjëlli i urtësisë, njihet simbolikisht me jetën e përtej varrit. Sipas, Sabri Hamiti ky episod na kujton diçka nga udhëtimet e Dantes në *Ferr* i udhëhequr nga Virgjili. Nëse marrim këtë ngjarje si hipotekst që të na kujtoj udhëtimin e Dantes, një udhëtim më të hershëm hasim në *Kuran*. Pozita e Skenderbeut “*as i zgjuar e as në gjumë*” na referon në Muhamedin a.s. i cili gjendej në këtë pozitë në shpellën Hira, derisa i vjen shpallja, ai nuk udhëhiqej nga Virgjili, por nga Ëngjëlli i zotit. Një referencë e tillë më tepër aludon te *Kurani*, mbase ky pohim gjen mbështetje në orientimin e Naimit te feja.

Heroi kombëtar, gradualisht zbret nga qielli në tokë, duke u bindur në kërkesën e të tjerëve që të martohet, ai shprehet:

“Tani kërkon një grua
Në robëri të më hedhë”

(Frashëri, Vepra 3, *Histori e Skenderbeut*, 1986, f. 161)

Heroi, i cili nuk u mund nga pushtuesit e ndryshëm, sikur këtu kërkon që të pushtohet nga dora e një gruaje. Ky hero, që u bëri ballë luftimeve dhe pushtuesit shumëshekullore, do të mundet nga pleqëria që e ndryshon njeriun, pleqëria dhe sëmundja e bindin se duhet të dorëzohet. Vargjet në vijim shprehen:

“Atë që se vinte shpata
Edhe ushta e shigjeta
Sëmundja me duar të thata
Ndër roba e shtiu e shkreta”

(Frashëri, Vepra 3, *Histori e Skenderbeut*, 1986, f. 304)

Dhe së fundmi, ringjallja e babait të Skenderbeut dhe kalimi i tij në gjendje të fantazmës është element i mitikës. Autori, zhvillon dialog me trimin mitik, i cili çohet nga varri që ta mbaj premtimin. Gjoni ia kujton Skenderbeut obligimi e tij që duhet të kthehet në atdhe dhe ta çlirojë atë nga pushtuesit. Komunikimi me mitin në këtë poemë hap mundësinë që të shprehemi se “Historia e Skenderbeut” e Naimit, dialogëzon me historinë dhe mitin, në mënyrë shumë të sukseshme, duke na dhënë neve si lexues poemën më të plotë, për Skenderbeun, që u shkrua në periudhën e Rilindjes Kombëtare.

Ringjallja e Gjonit në poemë si element mitik, na kujton edhe dramën e Samiut “Sejdi Jahja”, ku autori përdor mitin e ringjalljes dhe paraqitjen e fantazmës, që në një mënyrë t'i referohet lexuesit raporti i tekstit të tij me një tekst tjetër. Kjo fantazmë e vetdijëson Sejdi Jahjen se qëndresa është e kotë, se çdo ditë vdesin me mijëra njerëz, prandaj i sugjeron që ta dorëzojë kalanë. Edhe epopetë klasike përdorin mitin duke komunikuar me fantazmat apo me njerëzit e vdekur. Komunikimi me fantazmat daton nga kohrat antike më pas edhe personazhi i Shekspirit Hamleti fliste me fantazmën e babait të tij, i cili e ndihmon Hamletin në zgjedhjen e enigmës së vrasjes së tij, ashtu siç ndosh edhe me Gjonin babain e Skenderbeut.

Materialet e punimeve (proceedings)

ISBN: 978-1-78911-007-4

Motivi i Psikës në Këngët e Millosaos të De Radës

Motivi i Psikës ka rrjedhën nga mitologjia, e miti është një nga hipotekstet universale letrare. Mitologjia në përgjithësi përdoret me shumë mjeshtëri në veprat e shumë autorëve. Ky mit i Psikës haset te poema” Këngët e Millosaos”. Sipas atij miti, kishte jetuar një vajzë shumë e bukur, e quajtur Psika, e në të cilën ishte dashuruar Erosi. Mirëpo, nëna e Erosit, zonja e dashurisë, Venera, e xhelozonte këtë dashuri dhe me çdo kusht mendohej ta shkatërronte, duke proklamuar se një djalë nga familja e zotëve nuk mund të marrë një vajzë nga shtresa e ulët. Mirëpo, edhe pas këtyre peripecive dhe spekulimeve, kryezoti Zeusi vendosi që edhe Psika të pranohet në Olimb, në mesin e zotrave dhe kështu e bëri të mundur martesën e Psikës me Erosin. Dashuria, pra triumfoi mbi të gjitha, kurse ky mit mbeti nëpër shekuj si inspirim për artistë në periudhat pasuese. Po i njëjti mit aktualizohet te autorë të ndryshëm të letërsisë, fillimisht te vepra e Molierit dhe Kornejt sado që gjenezën e ka nga vepra”Gomari i artë” i autorit romak Apulei. Andaj gjatë dialogëzimit me mitin e Psikës, De Radës njëkohësisht dialogëzon edhe me autorë që kanë përdorur këtë mit në veprat e tyre.

Sipas mitit të Psikës, De Rada e ndërton poemën “Këngët e Millosaos”. Milosao në këtë rast është (Erosi) derisa Rina është (Psika). Ata janë të dashuruar, por janë nga shtresa të ndryshme, njëri është i pasur (Zot) derisa tjetri i varfër (njeri). Nëna e Millosaos (Venera) sipas mitit, kundërshton këtë dashuri me pretekst se janë nga shtresa të ndryshme. Me ndërhyrjen e Zotit (Zeusit), i cili bën tërmet në Shkodër, zhduken dallimet klasore dhe dashuria e tyre realizohet. Nuk ka asnjë dyshim se De Rada nuk e ka përdorur këtë mit për endjen e fillit të poems së tij, “Këngët e Millosaos”. Miti këtu përdoret si hipotekst, në tekstin e De Radës, por ai konceptohet i njëjtë deri në një pikë, për të vazhduar mëtej në realizimin e kërkesave të romantizmit, luftën për liri të atdheut. Andaj, mund të konstatohet që autori vendos raport të Kenosisit, sipas teminologjisë së H. Blumit.

Miti i Tomorrit te poezia e Çajupit

Përveç mitit të Psikës, romantikët dialogëzojnë me mitin e Tomorrit. Ky komunikim vjen si rezultat i bukurive të pësosura, natyrës, njerëzve të pësosur, andaj duhej të kishte edhe një vend të pësosur, për të adhuruar Zotin. Ky mal ka funksionin e tempullit, por madhështia e këtij mali qëndron në bashkimin e shqiptarëve të të tri feve. Ky mal, i cili ka më tepër privilegje nga Olimbi grek, mundëson që autorët, të përvetësojnë edhe hyjnitë greke, duke i bërë banorë të trojeve shqiptare. Andaj, gjithë bota i faleshin Tomorrit, i cili paraqitet si dëshmitar i historisë së njerëzimit. Naimi këtë iluzion e shpreh në poezinë e tij “Shqipëria”:

*“Gjithë bota vij që moti,
Në Tomorr tek ishte Zoti,
I faleshin Perendisë
Zotit math të Shqipërisë.”*

(Fashëri, 2007, f. 247)

Ky mal i shenjtë, që është edhe fron i Perendisë, e sfidon edhe Çajupin. Çajupi duke komunikuar me pararendësin e tij, Naimin në një rën anë dialogëzon me mitin e Tomorrit, në anën tjetër, e titullon përmbledhjen e tij poetike, “Baba Tomorri”. Në poezinë, me të njëjten titull, Çajupi shprehet:

*“Baba Tomorr, Kish` e shqipërisë,
Mal i lartë, fron i Perendisë,*

Materialet e punimeve (proceedings)

ISBN: 978-1-78911-007-4

*Tek ti vinin njerzitë qëmoti
Për të mësuar se ç`urdhëron Zoti.”*

(Çajupi, 2008, f. 63)

Nuk mund të mos hetohet toni melankolik i autorit, i cili gjendet i gjuhëzuar përpara malit të shenjtë dhe komunikon me të. Ky komunikim dëshmon për mbështetjen e autorit në mitin e malit dhe në mitologjinë shqiptare. Në këtë mënyrë poezia fiton ngjyrim emocional, që gradualisht, të shprehë edhe qëllimin e autorit, thirrjen për kryengritje. Poashtu në dialogun e autorit me malin haset kundëvënja e së tashmes së hidhur, me të kaluarën e ndritur. Dhe poezia fiton vlera më të larta në pjesën e dytë ku me ligjëratën e malit, drejtuar popullit, u pikëtuan çështjet e rëndësishme për lëvizjen politike të kohës.

Përfundime

Pra, jo vetëm historia por edhe mitologjia dhe miti gjejnë shprehje tek autorët e romantizmit shqiptar. Mbështetja në mitologji, ashtu si në histori ka qëllim të realizimit të qëllimit të autorëve romantik, ikjen nga realiteti i hidhur i kohës dhe mbështetje në përralla. Por, ne si lexues këtë ikje në mitologji e shohim si tendencë që veprat e kësaj periudhe të konceptohen me shumë kryqëzime letrare, duke mundësuar një lexim tjetërsoj të tyre, lexim ky që mbëtetet në teorinë e intertekstualitetit. Andaj, mund të konkludojmë se mënyra se si romantikët shqiptarë trajtonin mitin dhe historinë në veprat e tyre këta hipotezë mundësonin që autorët të kishin qëllime të dyfishta: atë poetik dhe kombëtar. Mitet, e përdorura me theks të veçantë nga Naim Frashëri, Jeronim de Rada dhe Çajupi jo vetëm që e poetizonin historinë dhe shëmbëlltyrat historike kombëtare, por veprat e tyre shërbenin si mjet i bashkimit kombëtar dhe ngritjes së vetëdijes kombëtare të shqiptarët. Malin e shenjtë Tomorr e lidhin me një tempull të lashtë, duke e idealizuar si vend të përbashkët të faljes për shqiptarët e të gjitha feve. Kjo ndërthurje e mitit, historisë dhe religjionit solli frymë bashkuese në kohën kur shoqëria shqiptare ishte e preokupuar me çështjen e përçarjes fetare. Në këtë mënyrë, romantikët shqiptarë kontribuan në formimin e identiteti kombëtar, duke i dhënë një dimension më thelbësor dhe të përbashkët historisë dhe mitologjisë së tyre. Te vepra e Naimit "Historia e Skënderbeut," miti dhe historia përbëjnë një pjesë të pamohueshme të përmbajtjes së tij. Vetë, titulli "Historia e Skënderbeut," shërben si paratekst për lexuesin, i cili duhet të përgatitet për një eksplorim të ngjarjeve historike dhe mitologjike. Në këtë kontekst, Jeronim de Rada ka luajtur një rol të rëndësishëm duke ndikuar në krijimin e një perspektive të re mbi origjinën dhe historinë e shqiptarëve. Artikulli i tij "Hyjnizime pellazgjike" dhe poema "Skënderbeu i Pafat" sjellin emrat e personazheve mitologjikë si një mjet për të krijuar intertekstin. Përdorimi i emrave si Teti, Akili, dhe përdorimi i tyre në kontekstin shqiptar tregon një lidhje mes mitologjisë dhe historisë së shqiptarëve. Poashtu edhe miti i Psikës në mënyrë të përkryer kontekstualizohet në poemën "Këngët e Millosaos". Në veprën e Çajupit, malin e shenjtë Tomorr e gjejmë si një simbol të rëndësishëm. Kjo ndërthurje e mitit me historinë është e dukshme në marrëdhënien intertekstuale që krijohet me malin e shenjtë. Romantikët shqiptarë shprehën bindjen se ky mal është një vend i shenjtë, një tempull, i cili përfaqëson njësinë dhe unitetin kombëtar. Krahasimi i tij me malin Olimp sugjeron një lidhje thelbësore mes mitologjisë shqiptare dhe asaj antike.

Teoria e intertekstualitetit, e zhvilluar nga Roland Barthes dhe Julia Kristeva, ka pasuar rol thelbësor në shpjegimin e lidhjeve komplekse mes teksteve letrare. Në kontekstin e autorëve të Rilindjes kombëtare, siç janë Naim Frashëri, Jeronim de Rada, Çajupi dhe të tjerë, kjo teori ofron një dritare tejet interesante për të kuptuar më thellë lidhjet e ndërthurura mes

Materialet e punimeve (proceedings)**ISBN: 978-1-78911-007-4**

tekstit letrar, historisë, mitologjisë dhe traditës kulturore. Përfundimisht, teoria e intertekstualitetit jep një qasje të pasur për të kuptuar se si autorët e Rilindjes kombëtare përdorën tekste të ndryshme dhe lidhjet midis tyre për të ndërtuar kontekst të fortë kombëtar. Ky përdorim i ndërthurjes mes tekstesh dhe konteksteve të ndryshme solli një mënyrë krijuese dhe komplekse për të shprehur dhe ndërthurur ide dhe vlera në shërbim të një identiteti kombëtar të fortë. Ndërtëkstualiteti në studimet letrare shkaktoi shfaqjen e modeleve shumë dimensionale dhe pluraliste të mbështetjes si forca diskursive të marrëdhënive ndërmjet teksteve të tjera dhe njëkohësisht është thelbësore për paraqitjen e mënyrave të reja të interpretimit të një teksti letrar.

Bibliografia

- Allen, G.(2002). *A.Intertextuality*, Routledge, New York.
- Bart, R. (1971). *Književnost, Mitologija, Semiologija*, Nolit, Beograd.
- Bart, R. (2016). *Mitologjitë*, Tiranë:Shtëpia e librit.
- Fashëri, N. (2007). *Vepra I*. Tiranë : Toena .
- Frashëri, N. (1986). *Vepra 3, Histori e Skenderbeut*. Prishtinë: Rilindja.
- Qosja , R. (2000). *Historia e letërsisë shqipe, Romantizmi I*. Tiranë: Toena.
- Stros, K. L. (2011). *Mitologjike I,II, III*. Beograd: Prosveta Beograd.
- Vinca, A. (1997). *Struktura e zhvillimit të poezisë shqipe (1945-1980)* . Prishtinë: Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore të Kosovës.
- Çajupi, A. Z. (2008). *Vepra I*. Tiranë: Toena .
- Piégay-Gros, N. (2011). *Poetika e intertekstualitetit*, Parnas, Prishtinë.
- Shehabi, V. M. (2017). *Aspekte të intertekstualitetit në letërsinë e Rilindjes Kombëtare*, Disertacioni i doktoraturës.

Fjalëformimi në poezinë e Migjenit

LULJETA ADILI-ÇELIKU
Universiteti “Shën. Qirili dhe Metodi”- Shkup

Abstrakt

Në poezinë e Migjenit përveç se shohim një pasqyrë të qartë të gjendjes reale dhe të rënduar të popullit në kohën kur jetonte ai, shohim edhe një gjuhë shumë të pasur dhe krijime gjuhësore shumë korrekte si gjuhësisht ashtu dhe gramatikisht. Poezitë e Migjenit janë ndër poezitë më të popullarizuara tek gjithë shqipfolësit, ata janë kënduar e kompozuar, janë recituar e vënë në skena, pasi janë shumë afërta me hallet e popullit. Por, në këtë punim nuk preken temat e këtyre poezive, në këtë punim shihen krijimet gjuhësore që Migjeni përdor në vargjet e tyre.

Punimi është ndarë në bazë të asaj se me çfarë janë krijuar fjalët jo të parme që gjejmë në poezinë e autorit, pra, kemi fjalë të prejardhura me parashtesim dhe në fjalë të prejardhura me prapashtesim. Në pjesën e dytë kemi fjalët e përbëra. Gjithashtu, në këtë punim në një pjesë më vete do të trajtohen fjalët dialektore që janë përdorur në poezitë e Migjenit. Përdorimi i tyre qoftë për qëllime stilistike apo për të paraqitur në mënyrë reale atë për të cilën shkruante poeti i japin një origjinalitet më të madh poezisë së tij. Për veprën dhe për gjuhën e Migjenit kanë shkruar shumë studiues, por formimet gjuhësore që janë përdorur në gjuhën e tij, nuk janë trajtuar shumë, prandaj u pa e udhës një tekst i tillë për gjuhën e tij, për t'i dhënë famën edhe në fushë të formimeve gjuhësore. Gegërishtja e të cilit premtion shumë për pasurimin e gjuhës letrare.

Fjalë kyçe: Migjeni, fjalëformimi, poezi, parashtesim, prapashtesim, fjalë dialektore.

Hyrje

Migjeni, shkrimtar i cili ta këput shpirtin kur lexon çdo fjalë dhe çdo varg të tij. Këputja shpirtërore vjen nga madhështia e vargut dhe fjalës së tij, pasi nuk pati jetë të gjatë e ne të kishim fatin që të kemi më shumë fjalë e vargje nga ai. Ai e “dogji” shpirti e tij, pasi e ndjeu dhimbjen e madhe për të cilën shkroi sa ishte gjallë. Dhimbja dhe pafuqia përballë saj ia shkurtoi jetën mësuesit të kombit tonë, shkrimtarit të dhimbjes e mjerimit. Rrugës për në punë me, biçikletën e tij, pati mundësi që t'i shohë nga afër të gjithë llojet e njerëzve dhe vuajtjet e ndryshme të tyre.

Zgjedhja e fjalëve për t'i trajtuar temat e dhimbjes e të varfërisë, të padrejtësisë e mjerimit që kishte zënë çdo skutë të shtëpive të shqiptarit, ishte mjeshtëria e tij. Migjeni në letrat solli një gjuhë krejt ndryshe nga ajo që ishte deri në fillimin e shkruarjes së pendës së tij. Gjuha e poezisë së tij është një pasuri shumë e madhe për gjuhën shqipe. Gegërishtja e Migjenit dhe tradita e shkruar e saj, është pasuri kombëtare. Migjeni pati armë të fortë në dorën e tij, si shkodran që ishte dhe vazhdoi ta përjetësoi traditën e gegërishtes së Buzukut, Budit, Bardhit e Bogdanit, e cila vazhdoi me Fishtën e Koliqin, për t'iu dorëzuar stafeta Migjenit të madh i cili e çoi më tej traditën e pararendësve të tij.

Teksti ynë ka pikërisht këtë objekt studimi, gjuhën e pasur të Migjenit, duke i lënë anash anën “shpirtërore” të poezive të tij, formimet gjuhësore të fjalëve që i gjejmë në vargjet e arta të poetit reformist. Duke pasur lirinë absolute në trajtimin e temave, në thurjen e vargjeve ai pati lirinë absolute që të përdorë gjuhën që donte ai. Në krijimet e tij, Migjeni përdori fjalët dialektore me një aftësi të veçantë për të shprehur thelbin emocional dhe për të krijuar imazhe të forta në mendjet e lexuesve.

Duke e shfrytëzuar bukurinë e dialekteve shqiptare, Migjeni u dha poezive të tij një ndjenjë autentike e të pranishme të realitetit folklorik. Përdorimi i fjalëve dialektore i shtoi një ngjyrë të veçantë poezisë së tij, duke e bërë atë më të afërt me zemrën e lexuesit dhe më të lidhur me kulturën dhe traditat e vendit.

Formimi i fjalëve në poezinë e Migjenit

Fjalët e formuara me ndajshtesa përbëjnë një pjesën më të madhe të fjalëve të analizuara në këtë punim. Këto fjalë quhen edhe fjalë të prejardhura. Kanë ardhur nga tema fjalësh të thjeshta si: mal, dorë, besë, ëndërr, gjëmë etj, nga tema fjalësh që janë vetë të prejardhura, si: malësor, dorëzim, i pabesë, gjithësi, gjoksore etj, ose nga tema fjalësh të përbëra e të përngjitura¹.

Sipas vendit se ku i kemi këto ndajshtesa në fjalën temë, mund t'i ndajmë:

- a) Fjalë të formuara me parashtesim
- b) Fjalë të formuara me prapashtesim

Fjalë të formuara me parashtesim

Fjalët me parashtesim janë formuara nga një temë prodhuese dhe me një parashtesë. Këto fjalë janë më të pakta në përgjithësi në gjuhën shqipe, por të njëjtën gjë nuk mund ta themi për poezinë e Migjenit edhe pse gjuha shqipe ka me tepër prapashtesa se sa parashtesa. Migjeni në poezitë e tij ka përdorur fjalë parashtesore, pasi siç edhe kemi përmendur poezia e tij rebelohet ndaj kohës, shoqërisë, pushtetit dhe medoemos se do duhet të përforcohej kjo ndjenjë, ky mëllëf. E kjo bëhej më mirë anë të fjalëve parashtesore të cilat e përforcojnë kuptimin e fjalës temë.

Në punimet e Aleksandër Xhuvanit dhe Eqrem Çabejt „Parashtesat në gjuhën shqipe” janë përfshirë 68 parashtesa të gjuhës shqipe, por një pjesë e tyre tashti janë krejt të vjetruara ose nuk janë më prodhuese (Thomai: 2005, faqe 147). Parashtesat në gjuhën shqipe, si sasi, janë sa një e treta e prapashtesave dhe, veç kësaj, nuk e kanë prodhimtarinë e këtyre të fundit (Gramatika; 1995, faqe 135). Megjithatë, parashtesimi është një nga mënyrat më të rëndësishme e më të gjalla të fjalëformimit të shqipes. Veçanërisht në periudhën e sotme të zhvillimit të gjuhës kjo mënyrë është bërë mjaft prodhimtare, sidomos në terminologjinë tekniko-shkencore e në gjuhën e publicistëve.

Parashtesat që i gjejmë në poezinë e Migjenit janë: ç-, sh-, pa-, për-, m-, z-, pa-, s-, para-, stër etj.

Fjalë me parashtesat ç-, sh-, z-

Gjatë krijimit parashtesor fjala nuk ndërron kategorinë leksiko-gramatikore. Me parashtesën ç-/sh-/zh-/ - krijohen fjalë të reja, me kuptim të kundërt semantik me fjalën nga cila vjen fjala e krijuar (Fjalori 1984, faqe 147), ashtu dhe i gjejmë edhe në këto vargje këto lloj fjalësh, të përdorura për ta forcuar kuptimin e tyre leksikor.

Në poezitë e analizuara, fjalët e hasura me këtë parashtesë, që kemi arriutr të gjejmë janë: **shpërthej, shkëpus, i çmendun, çmendesh, zdrale**

Fjalë me parashtesën m-, n-

mpitas, mshef, mfshehsina, mkëmb, ndigjue, ndigjon

Fjalë me parashtesën për-

përditë, përgjaktë, përzihet, përbuzje, përqark, përbuz, përdihet, përpjekje, përqafoj, përkdhel, përpijë, përndrit

Materialet e punimeve (proceedings)

ISBN: 978-1-78911-007-4

Fjalë me parashtesën stër-:stërzanë.

Fjalë me parashtesën pa-: Shembuj me **pa-**: i **pafat** (me parashtesim, por edhe me nyjëzim ku ka ndërruar kategorinë gramatikore), i **paprekun** (me parashtesim, por edhe me nyjëzim ku ka ndërruar kategorinë gramatikore), **pamëshirë**, **pahirë**, **pakëndueme** etj.

Fjalët e prejardhura të formuara me prapashtesim

Prejardhja prapashtesore është mënyra e formimit të fjalëve të reja me anë të prapashtesave, të cilat bashkohen me tema fjalësh. Tema e një fjalë mund të jetë e parme, e prejardhur, e përbërë ose e përngjitur. Siç e përmendëm edhe më lart, fjalët të formuara me prapashtesim janë më të shumta edhe në gjuhën shqipe, por edhe të fondi i fjalëve të hasura në poezitë e Migjenit është dukshëm më i madh se fjalët me parashtesim.

Më poshtë i kemi analizuar fjalët prapashtesore të grupuara në bazë të prapashtesave.

Fjalë me prapashtesën –im.

Më poshtë janë radhitur fjalë me prapashtesën **–im**. Të njëjtat, në disa raste dalin nga një temë e prejardhur, por përsëri e pamë të rrugës që t'i futim në këtë grup fjalës prapashtesore. P.sh. fjala frymëzim vjen nga fjala **frymë** e pastaj kalon në **frymëz** me prapashtesën **–z** e cila shpreh zvogëlim, e më pas në fjalën **frymëzim**. Shembuj me **–im**: **trishtim**, **fluturim**, **mjerim**, **gëzim**, **tingëllim**, **ngushllim**, **ndërtim**, **kujtim**, **ligshtim**, **ngadhënjim**, **perëndim**, **dyerzim**, **lulzim**, **cicrim**, **vajtım**, **agim**, **ligshtım** etj.

Fjalë me prapashtesën –je

Shembuj me prapashtesën **–je** të hasura në poezinë e Migjenit: **përkdhelje**, **dhimbje**, **urrejtje**, **humbje** etj. Edhe pse të pakta në numër fjalë që kemi arritur t'i gjejmë me këtë prapashtesë në poezitë e autorit në studim, janë shumë domethënëse nga ana përmbajtësore.

Fjalë me prapashtesën –i: **bukuri**, **dashuni**, **tradhti** etj.

Fjalë me prapashtesën –shëm/shme

Kjo prapashtesë është shumë prodhimitare në gjuhën shqipe, me të cilën krijohen pafund mbiemra dhe ndajfolje. Te Migjeni gjejmë të përdorura fjalët, si: **i/e neveritshme**, **i/eturpshme**, **i/e trishtueshme**, **i.e mallkueshëm**, **adhurueshëm**, **dikurshëm**, **mrekullueshëm**, **i pakuptueshëm** e shumë fjalë të tjera.

Fjalët e përbëra në poezinë e Migjenit

Kur takohesh me fjalët e përbëra në poezinë e Migjenit, të përshkon një ndjenjë e veçantë në shpirt nga fjalët e zgjedhura që fut në vargun e tij, nga fjalët më të fuqishmet për përcjelljen e porosisë që do ta bëjë poeti ynë »me misionin e tij« që kishte marrë përsipër, paraqitjen e gjendjes sociale të popullit që po jetonte në vendin e tij të varfër e të padrejtë. Gjejmë fjalët, si: **fatkeqsisht**, **gëzimplot**, **shumëngjyrta**, **mirfill**, **tragjikomik**, **fushqeta**, **bëzanë**, **dyerëzim**, **autobiografi** etj.

Po të shihen nga aspekti leksikor fjalët e përbëra, shohim se Migjeni kërkon një **gëzim**, jo **dosido**, por një **gëzim** i cili do të jetë i plotë, të gjithë të plotësuar nga ai **gëzim** që shpresonte ta sjellte rinia. Nuk mjafton veç një **gëzim** i thjeshtë, **gëzim** që e kishin veç disa shtesa, por edhe të pagëzuarit të gëzoheshin me **gëzimin** e madh.

Fjalë e përbërë ose kompozitë e mirëfilltë në shqipen është bërë ajo fjalë dygjymtyrëshe që formohet nga bashkimi i dy a më shumë temave në një fjalë të vetme, në

një njësi të vetme leksiko-semantike strukturalist të mbyllur, e cila formësohet si një tërësi e pavarur fonetiko-morfologjike ka kategoritë e veta potenciale fjalëformuese, zhvillohet semantikisht dhe kryen funksionet e veta semantike gjithnjë si një tërësi-fjalë, pavarësisht nga veçoritë të fonetike dhe leksiko-gramatikore të komponentëve të saj (Thomai, 2005, faqe 156), të tilla fjalë janë: atëdhe, kryetrim, kryemjek, kryeshejtan, kryefe, gjakëpirës, kryengritës etj.

Shembuj nga fjalët e përbëra të ndara në bazë të asaj a janë këpujore apo përcaktore:

- a) **fjalë të përbëra këpujore:** fushqeta, tragjikomik etj.
- b) **fjalë të përbëra përcaktore:** dyerëzim, jetëdhurim, fatkeqsisht, gëzimplot, shumëngjyra, mirfill, bëzanë, dyerëzim, autobiografi, fatkorb etj

Fjalët dialektore në poezinë e Migjenit

Migjeni, poeti ynë i madh, vinte nga Shkodra edhe pse gjyshërit nuk ishin shkodranë. Ai u lind e u rrit në këtë vend me një kulturë të një niveli shumë të lartë, u bë po ashtu siç ishte dhe betë vendi që e rriti. Në poezitë e tij e sjell të folme e Shkodrës duke na e dhënë mundësinë që ta shohim të pasqyruar realitetin e vendin edhe në gjuhë e në kulturë në atë kohë. Nëpërmjet gjuhës shohim personazhet e tij shumë origjinal, i vuajmë vuajtjet dhe dhembjet bashkë, ashtu siç i vuanin dhe i ndjenin ata. Personazhet e Migjenit janë të veshur me **zhele/tesha** të grisura, të ftohta dhe të grisura në ditë të dimit, poeti **vajtuem/vajtuar** ia thotë **kangës/këngës** dhe vajit për realitetin e **mallkuem/e mallkuar** me formën origjinale siç mallkon një qytetar i thjeshtë i atij vendi. Përemri pronor **im** në poezi qëndron krenar në variantin e tij dialektor **em**, **tim-tem**, një **a** hundore i ndjek këmba-këmbës fjalët e poezisë, si: **kande**, **dangël**, **kanfë**, **kangë** etj. Mbiemrat prejfoljorë të krijuar nga pjesorja, në poezinë e tij janë në variantin e dialektit geg, si: **i trishtuem**, **i pashryem**, **i vajtuem**, **i vuajtun**, **i paknduem**, **i yrryem**, **i kënduem** etj. Në poezinë e Migjenit nuk e gjejmë të përdorur rrotacizmin, pra n-ja nuk ka kaluar në r, si: **i paprekun**, **i pakënduem**, **i çmendun**, **i mërguem**, **errësinë**, **kalbësinë**, **lagështinë** etj. Gegërishtet e pasur të tij e gjejmë në të gjitha ngjyrat e bukura të saj.

Me përdorimin e fjalëve dialektore, Migjeni u dha poezive të tij një atmosferë autentike dhe të pashtershme, duke e bërë atë të njëjtën kohë modern dhe e rëndësishme për poezinë shqipe. Përmes tyre, ai shfaq një vëmendje të veçantë ndaj trashëgimisë kulturore dhe gjuhësore të vendit, duke i dhënë poezisë së tij një karakter unik dhe të veçantë. Përdorimi i këtyre fjalëve në poezinë e Migjenit shënon një kontribut të jashtëzakonshëm në letërsinë shqipe. Ky përdorim me mjeshtëri u jep poezive një identitet zë veçabte dhe i bën ato të vlefshme edhe sot, duke i rikujtuar lexuesit për trashëgiminë kulturore dhe gjuhësore të vendit.

Përfundim

Gjuha e poezisë së Migjenit paraqet një pasuri të madhe për studiuesit e gjuhës shqipe, për artdashësit, për adhruesit e poezisë dhe fjalës së bukur. Si një mjeshtër i vërtetë i thurjes së vargut, i përcielljes së ndjenjës së vuajtjes, ndjenjës së shpresës, ndjenjës së ringjalljes, arriti ta vulosë përjetësinë e tij në letrat e letërsisë shqiptare, për t`u shkruar me shkronja “ari” varrgjet e tij në Antologjinë e poezisë shqipe, ndonëse pati pak jetë, por e mjaftueshme për ta bërë atë.

Poezia e tij, siç shihet dhe në punim, është e pasur me krijime gjuhësore, fjalë ndajshitesore, fjalë të përbëra e sidomos me fjalë dialektore. Fjalët dialektore në poezitë e

Materialet e punimeve (proceedings)**ISBN: 978-1-78911-007-4**

Migjenit shprehin ndjenjat e thella të brengës, vuajtjes dhe vuajtjeve që kaloi shoqëria shqiptare në kohën kur ai jetoi. Kjo zgjedhje letrare e tij krijoi një lidhje emocionale të fuqishme me lexuesin, duke e bërë poezinë e tij një formë e komunikimit të thellë dhe të vërtetë me shpirtin shqiptar. Shpresojmë që ky tekst të jetë një nismë e mbarë për studimin e fjalës së poetit në aspekt fjalëformimi.

Literatura:

1. Adili-Çeliku, Luljeta. Fjalëformimi ne poezine e Naimit, Asdrenit dhe Lasgush Poradecit. Shkup: OFSET-PRINT, 2022.
2. Adili-Çeliku, Luljeta. Punime mbi fjalëformimin. Shkup: OFSET-PRINT, 2023.
3. Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, Drejtshkrimi i gjuhës shqipe. Tiranë, 1973
4. Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, Fjalori drejtshkrimor i gjuhës shqipe. Tiranë, 1976
4. Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, Fjalori i gjuhës shqipe. Tiranë, 2004
6. Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, Gramatika e gjuhës shqipe I. Tiranë,1995
7. Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, Gramatika e gjuhës shqipe II. Tiranë,1995
8. Hysa, Enver. Formimi i emrave me ndajshtesa në gjuhën shqipe, Tiranë, A.Sh.Sh., 2004
9. Thomai, Jani. Leksikologjia e gjuhës shqipe. Prishtinë, 1978
10. Thomai, Jani. Leksikologjia e gjuhës shqipe. Tiranë: Botimet Dudaj, 2005
11. Jorgaqi, Nasho. Për Fan Nolin e të tjerë. Tiranë: Botimet Dudaj, 2001.
12. Migjeni. Vepra. Shkup: VATRA, 1998.

Variacioni gjuhësor dhe kujdesi ndaj gjuhës së shkruar shqipe

IRENA SËRBO
Gjimnazi “Naim Frashëri”, Durrës

Abstrakt

"Gjuha shqipe është i vetmi mjet i ndriçimit dhe përparimit moral.

Ajo është një gjuhë e fuqishme dhe e bukur që duhet të jetë krenaria e folësve të saj dhe një mjet i shenjtë për zhvillimin kulturor dhe intelektual të kombit të vjetër shqiptar". Holger Pedersen, Gjuhëtar danez

E njohur si një nga gjuhët më të vjetra të botës gjuha shqipe bën pjesë në grupin e gjuhëve më të studiuara. Ajo i përket familjes së gjuhëve indoeuropiane dhe ekzistojnë sot teza të shumta që lidhen me prejardhjen e saj.

Dialektet kanë në përbërjen e tyre një numër të konsiderueshëm fjalësh popullore origjinale të njohura vetëm në një zonë të caktuar, për rrjedhojë variacioni i gjuhës rritet dhe mundësitë e të shprehurit në njërin apo tjetrin dialekt, apo pasurimi i fjalorit me fjalë tipike që dy dialektet disponojnë, është lehtësisht e mundshme në sajë të opsioneve të shumta. Dialektizmat ekzistojnë kryesisht në të folurit gojor të popullsisë; tipike kjo për zona të caktuara. Fjalët dialektore nuk hyjnë në gjuhën e përgjithshme letrare, mrëpo përmes të folurit bisedor, ato mund të depërtojnë në gjuhën letrare. Në të folurën artistike, dialektizmat kryejnë funksione të rëndësishme stilistike.

Kohët e fundit vihet re një përzierje e çuditshme ndërmjet dialekteve që vjen si pasojë e keqpërdorimit të gjuhës shqipe, jo vetëm me shkurtimet kaq shumë të përdorshme, por me deformimin e fjalëve dhe çuarjen 'në modë' të diçkaje të tillë.

A duhet të kemi frikë nga humbja e fjalëve apo nga ngushtimi i fjalorit që po i ndodh sot gjuhës shqipe? Në të vërtetë, kjo është një çështje që do të ngrinte diskutime të shumta, por mendoj se kjo lidhet drejtpërdrejtë me edukimin. Si përfundim, gjuha shqipe është një thesar i mbushur me varietete të shumta, që duhen mbrojtur, ruajtur dhe promovuar më tej, jo vetëm si një pasuri e jona, por e historisë dhe e gjithë botës.

Fjalë çelës: *gjuhë e shkruar, dialekt, gegërisht, toskërisht, variacion gjuhësor.*

"Gjuha shqipe është i vetmi mjet i ndriçimit dhe përparimit moral."

Ajo është një gjuhë e fuqishme dhe e bukur që duhet të jetë krenaria e folësve të saj dhe një mjet i shenjtë për zhvillimin kulturor dhe intelektual të kombit të vjetër shqiptar".

Holger Pedersen, Gjuhëtar danez.

E njohur si një nga gjuhët më të vjetra të botës gjuha shqipe bën pjesë në grupin e gjuhëve më të studiuara. Ajo i përket familjes së gjuhëve indoeuropiane dhe ekzistojnë sot teza të shumta që lidhen me prejardhjen e saj. Siç edhe **Prof.dr. Mimoza Karagozi Kore thotë**, çështjet e gjuhës shqipe, gjuhës sonë amtare janë gjithmonë çështje me të cilat duhet të merremi, të mos bjerë kujdesi ndaj saj. Jo vetëm ne gjuhëtarët, por dhe masa e gjerë janë shumë të interesuar për zhvillimin dhe se ku po shkon gjuha shqipe.¹

Ditët e sotme shikojmë kudo në botë zhvillime galopante, të cilat lidhen me shpikje të ndryshme apo marrëdhënie të ndryshme ndërmjet popujve, duke harruar se pasuria, se zhvillimi më i madh i lidhur drejtpërdrejtë me njeriun është gjuha. Pavarësisht se përditshmëria apo lodhja e ditës na bën të mos i vërejmë shkurtimet me të cilat shkruajmë, apo deformimet e vogla që i justifikojmë me mospasjen e kohës, të gjithë e dimë se duhet të kemi kujdes ndaj gjuhës së shkruar, përdorimit të saj dhe mbrojtjes.

Eric Hamp vëren: "*Gjuha shqipe duhet të jetë relativisht e vjetër, ajo daton që në mijëvjeçarin e parë pas-romak.*" Ky pohim sipas tij, lidhet gjithashtu me ekzistencën e dy dialekteve. Ndarja e dy dialekteve të gjuhës shqipe në Toskë dhe Gegë mendohet përpara dyndjeve sllave, sipas prof Eric Hamp (1963).¹

Karakteristikat e dialekteve të shqipes, në trajtimin e gjuhës amëtare dhe të huazimeve nga gjuhët e tjera, kanë çuar në përfundimin se ndarja dialektore i parapriu migrimit sllav në Ballkan.

Gjuha shqipe është konsideruar si një nga gjuhët më vjetra e për rrjedhojë është një gjuhë e pasur në të gjitha aspektet e saj. Të shumta janë karakteristikat dhe veçoritë, por vlen të përmenden dialektet e gjuhës shqipe: gegërishtja dhe toskërishtja.

Dialektet janë cilësuar si thesar i një kombi. Ato e dallojnë një komb drejtpërsëdrejti, kështu një tjetër tipar që e dallon gjuhën shqipe është pikërisht e folura dialektore. Një individ, i cili është folës i dialektit geg, menjëherë kuptohet që vjen nga kjo krahinë. Përdorimi i tyre jo vetëm i dallon individët e një kombi nga njëri-tjetri, por luan një rol mjaft të rëndësishëm në zgjerimin e gjuhës. Dialektet dhe leksiku dialektor janë pjesë përbërëse të pasurisë sonë të përbashkët gjuhësore, rrjedhimisht edhe kulturore e kombëtare, kurse përshtirja dhe larmia e tyre janë dëshmi të historisë sonë.¹

Dialektet kanë në përbërjen e tyre një numër të konsiderueshëm fjalësh popullore origjinale të njohura vetëm në një zonë të caktuar, për rrjedhojë variacioni i gjuhës rritet dhe mundësitë e të shprehurit në njërin apo tjetrin dialekt, apo pasurimi i fjalorit me fjalë tipike që dy dialektet disponojnë, është lehtësisht e mundshme në sajë të opsioneve të shumta. Dialektizmat ekzistojnë kryesisht në të folurit gojor të popullsisë; tipike kjo për zona të caktuara. Fjalët dialektore nuk hyjnë në gjuhën e përgjithshme letrare, mrëpo përmes të folurit bisedor, ato mund të depërtojnë në gjuhën letrare. Në të folurën artistike, dialektizmat kryejnë funksione të rëndësishme stilistike.

Dialektet ushtrojnë trysni mbi gjuhën letrare, veçanërisht në fushën e leksikut, struktura e të cilit është gjithnjë më e hapur se strukturat e tjera (fonetike e gramatikore).¹ Kohët e fundit vihet re një përzierje e çuditshme ndërmjet dialekteve që vjen si pasojë e keqpërdorimit të gjuhës shqipe, jo vetëm me shkurtime të shumta të përdorshme, por me deformimin e fjalëve dhe çuarjen 'në modë' të diçkaje të tillë.

Shumëkush mund të pyeste: "A duhet të kemi frikë nga humbja e fjalëve apo nga ngushtimi i fjalorit që po i ndodh sot gjuhës shqipe?" Në të vërtetë, kjo është një çështje që do të ngrinte diskutime të shumta, por mendoj se kjo lidhet drejtpërdrejtë me edukimin dhe ekzistojnë e besoj se do të ekzistojnë gjithmonë 'të kujdesshmit' që e përdorin në mënyrën më të pastër dhe më të bukur gjuhën shqipe.

Pasuria e gjuhës shqipe lidhet drejtpërdrejtë me dy dialektet dhe nëndialektet e shumta, jo vetëm për numrin e lartë të fjalëve tipike që nuk i kemi në gjuhën standarte, por sepse në këto dy dialekte kemi dëshmi të shumta nga vepra të shumta letrare dhe jo vetëm, të lëna si pjesë e një trashëgimie të apsur që lexohet dhe diskutohet ende e me siguri edhe për shumë shekuj të tjerë.

Si përfundim, gjuha shqipe është një thesar i mbushur me varietete të shumta, që duhen mbrojtur, ruajtur dhe promovuar më tej, jo vetëm si një pasuri e jona, por e historisë dhe e gjithë botës

Bibliografi

<https://albanian.cri.cn/2023/02/03/ARTIYErGKUmdQqda2BKmz2HG230203.shtml>.

Binaj, Agim Binaj dhe Dr. Ilir. *Familja ime*. fq.97.

"<https://albanian.cri.cn/2023/02/03/ARTIYErGKUmdQqda2BKmz2HG230203.shtml>."

Islamaj, Prof. dr. Shefkije. https://gjuhashqipe.com/blog/a_mund_ti_caktohen_kufij_gjuhes.

Samara, M. " Roli i dialekteve të shqipes për zhvillimin e normës letrare në fushën e leksikut." f. 333. Tirane, 1992.

The importance of bilingualism (multilingualism) and the avoidance of consequences

JETMIRA BASHA

Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës

Abstract

The Albanian students are exposed to bilingual education at third grade (mostly) where they start studying a foreign language, mostly English, followed by French, Italian or German. The assignment will define the term bilingual education and then it will be focused on the best bilingual education practices.

During the assignment, there are mentioned some differences between bilingual education and foreign language education. First of all, by defining bilingual education it is understood that it is the use of two languages in the instruction and assessment of learners according to Garcia (2009).

Students in Albanian elementary schools are exposed to bilingual education programs which offer all the students the possibility of becoming bilingual and biliterate. Bilingual education, in practice, integrates language and content, whereas foreign or second-language education emphasizes language teaching.

Bilingual education also has the potential to offer a just education, leveling the power differentials among language groups, as minoritized languages are used in education (Garda, O., and Kleifgen, J. A, 2010). Bilingual education, thus, distinguishes itself in the way in which the two languages are used to construct meaningful content, while affirming diversity and tolerance.

Key words: *bilingual, education, foreign language, consequences, practice.*

This course assignment will be focused on bilingual education at Albanian elementary schools. Albanian elementary schools include first grade up to ninth grade. The Albanian students are exposed to bilingual education at third grade (mostly) where they start studying a foreign language, mostly English, followed by French, Italian or German. The assignment will define the term bilingual education and then it will be focused on the best bilingual education practices.

During the assignment, I mention some differences between bilingual education and foreign language education. Also a total of 5 English teachers were asked about the type of approach they used while teaching English to elementary classes. So, the assignment does not include a full scale questionnaire for teachers, just they were asked about the teaching practices they used while teaching English.

First of all, by defining bilingual education we understand that it is the use of two languages in the instruction and assessment of learners (Garcia, O, 2009). Students in Albanian elementary schools are exposed to bilingual education programs which offer all the

students the possibility of becoming bilingual and illiterate. Mostly English language is the language which is taught at schools and students mostly start it at third grade of sixth grade. The bilingual education program offers the students the possibility of developing the language of school in ways that support their home language practices and identities. Even though, in Albanian schools English language is taught as a foreign language or a second language, beside of the mother tongue. So, by bilingual education the two languages are used as a medium of instruction, while English is taught as a foreign language. However, in traditional language education programs the additional language is explicitly taught as a subject. As such, bilingual education is first and foremost an educational approach to educate students holistically, with language and literacy development in two languages as an educational goal (Martha Bigelow, Johanna Ennsner-Kananen, 2015).

Bilingual education is an educational approach to educate students holistically, with language and literacy development in two languages as an educational goal, in Albanian schools in English, French, Italian or German. Some schools, private ones, may start learning a foreign language even at second grade. Traditional teachers see language as a system of standardized structures through which students listen, speak, read, and write. In contrast, bilingual teachers focus on the development of language practices; that is, on the language of students which is a product of social action and consists of fluid and flexible resources through which students make meaning of what they are learning (Baker, C, 2011).

Bilingual education, in practice, integrates language and content, whereas foreign or second-language education emphasizes teaching the language. Bilingual education also has the potential to offer a just education, leveling the power differentials among language groups, as minorities languages are used in education (Garda, O., and Kleifgen, J. A, 2010). Bilingual education, thus, distinguishes itself in the way in which the two languages are used to construct meaningful content, while affirming diversity and tolerance.

Teaching English or another foreign language to learners is no easy job. Different teachers apply different teaching approaches and practices depending on the class where they are teaching, whether it is a large class or a small one, the age of students etc. For younger learners (mostly those of third or fourth grade) effective classroom strategies have traditionally involved use of songs, rhymes and traditional stories with repeated language structures. The internet can be a rich source of authentic oral models via recorded songs, talking electronic books, podcasts and video clips that help learners with pronunciation as well as acquisition and reinforcement of new vocabulary. English language teaching at elementary classes generally takes place during the school day, at schools either funded by the state or privately financed, and after school in language courses, where learners are sent by their parents for additional English classes, usually to reinforce the English being learned at school, or to help the learners prepare for a specific examination (Baylor, 2002).

While researching for my course assignment, I some elementary school English teachers of the most effective teaching methods that they used while teaching English in their classes. There are several methods of teaching English to pupils who are learning the language for the first time or not or bilingual classes, each with their own unique pros and cons. Depending on the teaching situation, setting, and resources available, any one of these English teaching methods could be right for you and your students.

Some teacher mentioned a focus on grammar rules as one of the most popular English teaching methods in traditional academic settings, perhaps due to the focus on grammar in native language courses. Teaching English as a second language, according to

this approach, should not stray from the model. This approach can only work if the instructor speaks the first language of the students in addition to English, because much of it is based on the teacher’s ability to translate. English grammar rules should be taught conceptually in the student’s native language, with examples provided in simple English sentences that the teacher can translate back to the native tongue so that a solid parallel can be drawn. These grammar rules should be strictly enforced, and students should be allowed to practice proper structure and syntax through the use of examples and quizzes. Also important to this method is vocabulary, as students need a large knowledge bank of English words in order to interpret and form their own English grammar examples. Grammar and vocabulary quizzes fuel this approach, and should be at the forefront of instruction. The English language is examined in terms of grammar rules. (Paris, 2014).

Another method that the teaches mentioned using in elementary classes was the aural English teaching method which focuses on the most natural way to learn a foreign language, which is by hearing it. Children who are raised to speak English learn it first by hearing it from their parents and others around them, long before they ever learn how to read or write. The aural approach is similar, meaning it’s strictly audio-based and should not focus on the reading or writing until long after the students can grasp the language on a speaking level. The actual method involves dialogue. In the beginning, the students will mostly be spoken to. The teacher might use visual cues such as objects to give the students something to associate the words they’re hearing with. Then, they will be instructed to speak the words themselves, coming to grasp vocabulary and basic grammar through hearing and speaking, rather than advanced instruction or writing. Teachers should not write the words they’re saying, and let the bulk of the instruction exist in dialogue (Paris, 2014).

The translative approach was also mentioned by teachers; in fact it is a bit like the grammatical approach, only with a broader focus on the English language’s structure in comparison to the native language of the students. This approach must be taught by an instructor who speaks the same language as their students just like Albanian, and all the pupils must also share a fluency in the same language. English will be taught as a subject like any other, with different elements of the language such as vocabulary, grammar, syntax, speaking, reading, and writing focused on every day. This method will make strong use of notecards, where students can write English vocabulary and grammar concepts on one side, and then translate the word or idea on the back in their native language. This method is best for students learning the English language because of an academic interest in it as a language, and not just an interest or need to know how to speak it. Speaking, reading, and writing the language will be given equal priority, and grammar rules and concepts will not be avoided for a more “natural” approach. It will be taught academically, as any other subject, and is best for students who are interested in this kind of rigorous approach.

In conclusion, bilingual education is good for education and language learning, for students in elementary schools. But bilingual education in the 21st century must go beyond the emphasis on the dominant language (as happens in the United States) or monolingual proficiency in two languages (as in the Common European Framework of Reference for Languages). Translanguaging is used by students and teachers as they make sense of their bilingual worlds, using their entire linguistic repertoires across various modalities (reading, writing, speaking, and listening), and across different people in order to meaningfully learn. For example, although a lesson might be officially in one language, students may discuss, research, and produce work using all their language practices. Teachers who use

translanguaging may not be bilingual themselves, but they always encourage their students to use their entire linguistic repertoire in making meaning (Garcia, O, 2011). However, in Albanian schools, mostly state schools and even private ones (beside of the American and Turkish colleges where English language is expanded in all the subjects) use practices applying to English as a foreign language, mostly grammar, aural and translative approach.

Bibliography

- Baker, C. (2011). *Foundations of bilingual education and bilingualism (5th ed.)*. Clevedon, UK: Multilingual Matters.
- Baylor, A. L. (2002). *What factors facilitate teacher skill, teacher morale, and perceived student*. Computers & Education, .
- Garcia, O. (2011). . *From language garden to sustainable languaging: Bilingual education in a global world. Perspective*. . National Association for Bilingual Education.
- Garcia, O. (2009). *Bilingual education in the 21st century. A Global Perspective*. Wiley-Blackwell: Malden and Oxford.
- Garda, O., and Kleifgen, J. A. (2010). *Educating emergent bilinguals. Policies, programs and practices for English*. New York: Teachers College Press.
- Martha Bigelow, Johanna Ennser-Kananen. (2015). *The Routledge Handbook of Educational Linguistics*. Oxford: Routledge.
- Paris, C. (2014 , June 11). *Udemy*. Retrieved July 1, 2015, from 5 English Teaching Methods That Work: <https://blog.udemy.com/english-teaching-methods/>

KONFERENCA E PARË NDËRKOMBËTARE NË GJUHËSI
“Ligjërimi i shkruar dhe i folur, probleme reale dhe propozime konkrete për zgjidhjen e tyre”

Materialet e punimeve (proceedings)

ISBN: 978-1-78911-007-4



UNIVERSITETI
BARLETI



UNIVERSITETI “ALEKSANDËR MOISIU”, DURRËS
FAKULTETI I EDUKIMIT
DEPARTAMENTI I GJUHËS SHQIPE

**“LIGJËRIMI I SHKRUAR DHE I FOLUR, PROBLEME
REALE DHE PROPOZIME KONKRETE PËR ZGJIDHJEN E
TYRE”**

*“WRITTEN AND SPOKEN LANGUAGE,
REAL & CONCRETE PROBLEM SOLVING PROPOSALS”*



E drejta e botimit, ribotimit apo e përkthimit, i përket vetëm Departamentit të Gjuhës shqipe, pranë Fakultetit të Edukimit, UAMD, Durrës.

SHËNIM: autorët mbajnë përgjegjësi individuale për origjinalitetin e punimit si dhe për të dhënat e tyre personale.